

A portrait of a middle-aged man with short, graying hair, wearing a white chef's hat with a dark red band and a dark suit jacket over a light-colored shirt and a dark tie. He has a neutral expression and is looking directly at the camera. The background is a mottled, light-colored wall.

BOTON 1KlikLarg

**NUSPRODUKTI
I NJË KOMPLOTI DHE
TRADHËTIE**

Tiranë 2022

NUSPRODUKTI
I NJË KOMPLOTI DHE
TRADHËTIE

(publicistikë)

Boton: 1KlikLarg

Biblioteka: Thumbi

Redaktor: Andi Rakipi

Recenzent: Ilir Ramadani
Halid Sadiku

Lektor: Sonja Erebara

Redaktor teknik & dizajn: Ilir Podrimja

Tiranë 2022

Vazhdon Shaqir Fetai të jetë stoik në politikat e H. Sulejman ef. Rexhepit

Puç i bëri, thikën ia nguli pas shpine, e tradhtoi, u bë me shërbimet sekrete, por ama, Shaqir Fetai assesi të heqë dorë nga politikat si, menaxheriale ashtu edhe kadrovike, që i vuri ish-reisul Ulema i BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi! Dhe, për çfarë reforma flet ky farë rrencaku Shaqir Fetai, ky farë injoranti dhe imituesi snob! Imitues i mirë është edhe papagalli, edhe majmuni, megjithatë, nuk bëhen njeri, ngelin të tillë çfarë i ka falur Zoti

Nga Eugen Lata

Shaqir Fetai na informon se e paska zgjedhur dekanin e Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup! Jo ai por, Këshilli Mësimor Shkencor i FSHI-së? Paramendoni se, cili “Këshill” çka ka zgjedhur dhe, për më keq, më katastrofale, paramendoni se ky farë i zgjedhuri nga kush është zgjedhur!

Sido qoftë, qenka zgjedhur Shaban Sulejmani, i cili, dekan u zgjodh nga H. Sulejman ef. Rexhepi. Pra, Shaban Sulejmani është kuadër i Sulejman ef. Rexhepit dhe, për këtë respekt që ia bëri, Shaban Sulejmani do të jetë adhures i pakompromis, me mish e me shpirt, i Sulejman ef. Rexhepit, madje do t'i shpallë “qafira” të gjithë ata që ia prishin Sulejman ef. Rexhepit, edhe pse, më në

fund, ai me shokët e vet ia prishën madje shumë keq, duke ia ngulur thikën pas shpine!

Edhe me këtë rast, Shaqir Fetai dëshmoi se nuk di të bëjë reforma, nuk guxon të bëjë reforma, aq më pak të bëjë reforma kadrovike! Kë të largojë? Të gjithë bashkëpunëtorët e Sulejman ef. Rexhepit, për të cilët ai dëshmon në intervistën e vet të fundit, që të gjithë paskan qenë bashkëpunëtorë të UDB-së, me në krye Shaqir Fetain! Dhe tani ky të bëjë ndryshime kadrovike si hap i parë i reformave? Kë të largojë? Këta të shërbimeve sekrete të tipit të UDB-së? Nuk guxon t'i prekë, sepse ata kanë kryer misionin e tyre që ishte skenar i shërbimeve sekrete, prandaj, ata tashmë janë të brenduar, të mbrojtur, fytyra mbrojtëse dhe përfaqësuse të shërbimeve sekrete në BFI!

Shaqir Fetai kësisoj, duke ecur gjurmëve të veprave të H. Sulejman ef. Rexhepit, në fakt, edhe nuk i prek njerëzit e shërbimeve sekrete por, me këtë, edhe e mbulon paaftësinë e vet, dudurllëkun e vet për sa i përket reformave! Nuk është reformë avancimi i kuadrit të përkohshëm nga kordinues ku i kishte emeruar efendi Rexhepi, ne myftinj ku i ngritë Shaqir Fetai. Mundohet ta përforcojë atë filozofinë udbasheske se, të gjithë jemi të mirë e të ndershëm, i keqi dhe imorali ishte vetem Sulejman Rexhepi!

Shaqir Fetai mendon se reformë është ndërrimi i vendit dhe i pozicionit të kolltukut të reisit!

Shaqir Fetai mendon se reformë është rizgjedhja e Shaban Sulejmanit dekan në FSHI!

Shaqir Fetai po i mban pranë vetes të gjithë ata që kanë dosje të trashë shantazhimi! Sepse, e di që nuk guxojnë të lëvizin nga linjat e tij antifetare e antikombëtare, sepse, sakaq do t'ua zbardhin videoincizimet me plotë amoralitet! I di këto Shaqir Fetai, i di shumë mirë! I di Shaqir Fetai kush sa ka vjedhur, me kë ka vjedhur, për kë ka vjedhur! I di shumë mirë? Dhe i mbanë, sepse i duhen që mos t'ia turbullojnë ujin! Kurse gojën e ka përplotë me reforma!

Po a mund të bëjë reforma një "reis" i cili mendon kështu, i cili për Fakultetin e Shkencave Islame e ka këtë definicion: "Fakulteti i Shkencave Islame ka për qëllim të krijojë kuadër me pikëpamje të reja dhe mënyra konstruktive të të menduarit, të mundësojë

zhvillimin e aftësive dhe pranimin e sfidave e mundësive të cilat i ofron shekulli 21, si dhe krijimin e një ambienti ku përvetësimi i dijes do të jetë në qendër të vëmendjes me çrast do t'i përgatit studentët të ndërtojnë karrierë në sferën e shkencave islame, që të punësohen në institucionet e BFI të RMV dhe institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit.”

Shikojani se cili qenka qëllimi i FSHI-së sipas Shaqir Fetait! “Me pikëpamje të reja dhe mënyrë konstruktive të të menduarit”!!! Mos po do Shaqir Fetai me thënë se FSHI prodhon kuadro që mendojnë në mënyrë konstruktive!!! Po pse, a paska fakultet që po prodhuaka kuadro për të menduar në mënyrë dekonstruktive?! Shaqir Fetai, në mes të FSHI-së, e shpreh këtë definicion të tmerrshëm për FSHI-në! Për të vazhduar pastaj me synimet e FSHI-së, të cilat, sipas Shaqir Fetait, janë: “të mundësojë zhvillimin e aftësive dhe pranimin e sfidave e mundësive të cilat i ofron shekulli 21”! Shaqir Fetai a po flet për kopshte kalamajsh e për foshnjore, për filllore apo për një institucion akademik? Pse ofendon Shaqir Fetai, pse ia merr mendja se është ajka e intelektit kombëtar fetar, pse ky farë snobi e demagogu, ky farë injoranti e hipokriti mendon se nga ky fakultet dalin kuadro me aftësi për “të pranuar sfida e mundësi” që i ofron shekulli 21. Po teologët e tjerë që nuk kanë dalur nga ky Fakultet? Janë nja 700-800 e më shumë që nuk kanë dalur nga FSHI – ndër ta edhe vet Shaqir Fetai, dhe, sipas tij, këta nuk mund të përballen me sfidat e shekullit 21. Po a e di Shaqir ORAO se cilat janë ato sfida të këtij shekulli me të cilat duhet të përballen teologët e vendit. Po ai vetë, a duhet të përballlet apo, të tjerët për të do të përballen me ato sfida, mjafton që Shaqir Fetai të jetë zbatues i politikave që do t'i afrohen qarqet e dyshimta dhe antiislame!

Shaqir Fetai karrierën e ka debolesë! Pisi thotë: “FSHI-ja qenka ambient që përgatit studentët të ndërtojnë karrierë në sferën e shkencave islame”! Pra, studentët do të ndërtojnë karrierë, ashtu siç e ka ndërtuar vetë. Fakultetet janë për ta zhvilluar dhe avancuar mendimin shkencor, o Shaqir Fetai, e jo për të bërë karrierë. Lloi yt shumë njerëz ka lënë në shtëpi, në pamundësi për të bërë karrierë, por ama, për nga mënyra e të menduarit, për nga mendimi i tyre shkencor, janë me mijëra kilomera larg teje, edhe

pse ti je “kryetar i intelektualëve fetar”! Je i sfiduar në debate televizive të cilave u ikë si djalli temjanit!

Dhe, fare në fund, Shaqir Fetai e përmyllë definicionin për FSHI-në: “që të punësohen në institucionet e BFI të RMV dhe institucione të tjera”! Po, pa dyshim, edhe Medresja përgatitë kuadro për nevojat e BFI-së, por, megjithatë, më shumë medresantë ka të punësuar në DBK e në polici se sa në FSHI, më shumë kuadër që kanë mbaruar FSHI-në ka në “institucionet e tjera” se sa që ka të punësuar në BFI!

Përfundimisht, Shaqir Fetai duhet të dalë nga stili i të menduarit sipas H. Sulejman ef. Rexhepit, duhet ta ketë stilin e vet menaxherial, duhet të shkojë disa hapa përtej H. Sulejman ef. Rexhepit në reforma organizative e kadrovike. Shaqir Fetai duhet të ndalojë së miratuari politikat menaxheriale të Sulejman Rexhepit i cili i zhvillonte dikur me po këta njerëz që i janë bërë patarica të kalbura Shaqir Fetait!

Shaqir Fetai nuk ka as tru, as personalitet, as karakter, as dnjitet, nuk ka as aftësi mendore, as fizik, as forcë e as kapacitet psikik, për të vegjetuar në një habitat që do të ishte tjetërfarësh nga ai ku e ka mbajtur për gjith këto vite Sulejman Rexhepi. Prandaj, gjithnjë e më shumë Shaqir Fetai e flet me miq të vet të ngushtë gabimin trashanik që bëri duke e tradhëtuar Sulejman Rexhepin dhe duke ia rrëmbyer postin, i cili, gjithnjë e më shumë po ia rëndon jetën, të vepruarit, të menduarit. Thjesht, ai është buzë një shpërthimi të brendshëm çmendurak. A ta ndihmojë Zoti? Ooo, Zoti ia theftë qafën!/Fakte/28.05.2021

Çka po i pengojnë xhamitë Shaqir Fetait

“Reformat” e Shaqir Fetait nisën me tjetërsime e me shitje të vakëfit, me varshmëri nga buxheti i shtetit, me tjetërsime e shkatërrime të xhamive. Mallkim mbi këtë monstër

Derisa në Dibër po ndodhë një masakër mbi vlerat shpirtërore e kombëtare të shqiptarëve autoktonë, Shaqir Fetai po e bën kokrrën e sefasë në zyren e vet të uzurpuar, duke ftuar mysafirë e duke qerasur njerëz në kundërvlerë të një urimi dhe një përshëndetje, në kundërvlerë të fjalës magjike “jemi të lumtur për sukseset e juaja në drejtimin e BFI-së”!

Sapo lexova një informacion që thoshte se “reformat” e Shaqir Fetait në BFI të RMV-së, që kur e instaloi pushteti aktual maqedonas, që kur pushteti e bëri BFI-në buxhetar të vetin, kanë filluar dhe vazhdojnë më tej me tjetërsimin e vakëfit, me shitjen e vakëfit, me keqpërdorimin e letrave në vlerë, me dreka e darka për të gjithë ata që vijnë ta urojnë, por ama që nuk paguhen nga xhepi i tij por nga arka e BFI-së, me tjetërsimin dhe shkatërrimin e xhamive. Si i pafytyrë futet në xhami dhe, me plotë hipokrizi e injorancë flet me raste të dua hatmeve apo duave të hafizlerëve të rinj, ndërsa i falë xhamitë, si shtetit, ashtu edhe matrapikëve që shkatërrojnë pa dhimbje.

Gjatë Muajit të Ramzanit, lejoi që Xhamia e Manastirit, t’i shndërrohet fillimisht në Kisha e Shën Gjorgjisë, e pastaj në institucion nacional, në “muze”, porse, sa herë të ketë nevojë e shfrytëzon kisha!

Sot, i mbarë opinionin shqiptar u trondit me një aksion të ndrmarrë

nga njerëzit e Shaqir Fetait dhe të porositur prej tij. U prish Muri i 100 dritareve të Xhamisë së Sahatit në Dibër, në oborrin e së cilës gjendet edhe varri i Rilindasit tonë, Seid Najdenit.

Kjo xhami, dhe ky murë me një vlerë sa historike aq edhe kombëtare, u përrua më 26 janar të vitit 2013. Kjo ngjarje, në historinë e Qytetit të Dibrës do të ngelë si e veçantë, sepse tuboi bashkë parinë fetarë më në krye Reisul Ulemanë H. Sulejman ef. Rexhepin, parinë politike lokale e qendrore, me në krye liderin e BDI-së Ali Ahmetin, parinë politike të Kryeqytetit shqiptar më në krye prefektin e atëhershëm Lulzim Bashën, personalitete të larta ushtarake si dhe intelektualë të shumtë me prejardhje nga Dibra. Ngjarja konsistonte me 100 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë, ndërsa kjo datë ishte “murosur” simbolikisht në 100 qemeret e Murit të Xhamisë së Sahatit.

Shaqir Fetait i pengon kjo ngjarje, Shaqir Fetait i pengon kjo simbolikë. Shaqir Fetait i pengojnë të gjitha ngjarjet historike kombëtare. Shaqir Fetait këtë urrejtje kundër vlerave kombëtare e kamuflon duke pirë kafe e duke u “miqësuar” me “intelektualë” e me udhëheqës të Institutit për Trashëgimi Kulturorë e Shpirtërorë të Shqiptarëve të RMV-së si dhe me përfaqësues të Arkivit Shtetëror maqedonas. Mbase duke i lutur që t’ia zhdukin të gjitha dokumentet ku, eventualisht, mund të gjendet pseudonimi i tij “ORAO”!

Me leje dhe me vendim të Shaqir Fetait, alias “ORAO”, nga sot Xhamia e Sahatit do të ngelë pa atë vlerë simbolike që shënon përrimin e saj me rastin e 100 vjetorit të pavarësimin të Shtetit Shqiptar! Ç’mund të presin shqiptarët nga udbashët që mbajnë llogari datat historike e kombëtare serbe?

Sot Shaqir Fetait u përkujdes që të shkatërrohet kjo simbolikë e Murit me 100 dritare, kjo avlli e varrit të njërit prej Rilindasëve më të çmuar kombëtar Hoxhë Seid Najdenit, të shkatërrohet një prej kontributeve më të çmuar të ish-kolegut të tij, të ndjerit Myftiut Ruzhi ef. Lata, i cili, gjithnjë i thoshte Shaqir Fetait “do të vdesësh e nuk do të dalësh nga faza e pubertetit”! Ndërsa ky, shtiret se është në fazën e pubertetit, sepse, realisht, tashmë është në fazën e pjekurisë së argatllëkut në “klubin e udbashëve”! Le t’i rrënojmë vlerat kombëtare e fetare, sepse do të bëjmë biznes, mendon Shaqir Fetait, me trurin e vet të atrofizuar!

Me rrënimin e “Murit me 100 dritare” u “rrënuan” edhe mesazhet historike që u përcollën me rastin e përrimit të tij nga përfaqësues

më të lartë të kombit e të fesë në trojet tona etnike. Kurse atëkohë,
Shaqir Fetait ishte aty, te vendi i mizës së
kalit! / 1KlikLarg/02.06.2021

A kanë të drejtë në fetva honxho bonxhot e Shaqir Fetait

Hoxhallarët e Shkupit, respektivisht, “fetvaxhinjtë” injorantë, që nuk kanë lidhje me problematikën, sjellin vendim për ta bërë haram “Bitcoinin”! Menjëherë pasuan mijëra reagime, nga shumë qytetarë të vendit dhe nga jashtë. Hoxhallarët e Shkupit, gjegjësisht, Myftinia e Shkupit, le të japin fetva për haramin që e bëjnë çdo ditë, e mos të merren me tema të mëdha për të cilat nuk kanë dy gram lidhje

Nga Vesel Shabani

Çka është Bitcoin? Po i thonë “kriptovalutë”! A e kuptojnë hoxhallarët këtë fjalë “kriptovalutë”! A e kuptojnë “fetvaxhinjtë” injorantë të Myftinisë së Shkupit se si prodhohet kjo valutë elektronike? Ku përdoret, pse përdoret, pse dikund lejohet e dikund jo? Çka e dallon këtë valutë nga kartelat e “bankomatit”! A janë haram apo hallall “aksionet” që punëtorë të ndryshëm i kanë nëpër firmat gjigante! Për çka dhe në ç’raste përdoren këto kriptovaluta? Që kur ka filluar të funksionojë Bitcoin. Pse kjo kriptovalutë funksionon që nga viti 2009, ndërsa vetëm tani e bën haram Myftinia e Shkupit? A ka dhënë ndojë fetva “këshilli për fetva” pranë Myftinisë së Shkupit, për shembull, për bastoret. A janë hallall apo haram? Nëse janë haram, pse lejojnë që në mesin e tyre të punojnë persona që më shumë rrinë nëpër bastore se sa në xhami? Ky “këshill i fetvave” pranë Myftinisë së Shkupit, a di të na thotë, a

është haram të shitet, të tjetërsohet vakëfi? Nëse është haram, çfarë ka bërë kjo Myftini për t'u liruar nga këta haramxhinjë? Kush na jep fetva bre? Ata që kanë blerë diploma? Ata që janë me diploma falco? "Teologët" që kanë diplomuar nëpër fakultete si kapet e si përgatitet peshku? Ky "komision i fetvaxhinjëve" pranë Myftinisë së Shkupit, a ka dhënë ndonjë fetva për këta falsifikatorë? Si guxon të lejojë që të jetë "organ" i Myftinisë së Shkupit një komision me peshë, ndërkohë që e di se janë të zhytur deri në gushë në haram!

Ja, jemi në prag të Kurban Bajramit, çastit kur do të paguhen dhe therren mijëra kurbanë. A ka raport se sa është therrur vitin e kaluar, sa janë paguar, sa janë shpërndarë, sa janë vjedhur! Po, po, janë vjedhur, madje nuk janë therrur fare, ndërsa shtrohet pyetja: ky "komision fetvaxhinjësh" krejt injorantë e të pashpirtë, a kanë dhënë ndonjë fetva se, cili është qëndrimi i fesë islame dhe si duhet të ndëshkohen manipulatorët e kurbanit?

Po, Bitcuini, kjo kripovalutë, në botë, ndonëse ka gjetur përdorim të gjërë në shumë institucione bankare dhe të biznesit, megjithatë, pikërisht pse nuk ka mbështetje ligjore, shtetet e ndryshme janë të rezervuar në përdorimin e saj masiv! Transaksionet bankare kryhen me të madhe, më lehtë, më mirë, më lirë! Megjithatë, ligjërisht, nuk janë të lejuar, sepse, shkelin rregullat dhe ligjet ekzistuese bankare e financiare.

Po Myftinia e Shkupit që njihet për shkelje të thella të akteve normative të BFI-së, i ka hije kjo të na japë fetva? I ka hije që të udhëhiqet kjo Myftini nga personi i cili kontrabandohet në krye të këtij organi të BFI-së, kurrë pa e dhënë një ditë kontribut në të mirë të këtij organi para se ta uzurpojë!

I ka hije këtij organi që të bëhet pjesë e lojërave nëntokësore me qëllim që të shërbejë për puç dhe komplot më të ndyta që janë bërë ndonjëherë nëpër institucione, përgjithësisht, të njerëzimit? Është dhënë ndonjë fetva për këtë krim, për këtë tradhëti, për këtë intrigë e hipokrizi?

Cili është qëndrimi islamik i këtij "këshilli për fetva" në pranimin për reis të Shaqir Fetait, njeriut që u instalua nga pushteti maqedonas antiislam e antishqiptar?

Cili është qëndrimi i tyre islamik mbi mënyrën se si erdhi Shaqir Fetai në kye të BFI-së?

Cili është qëndrimi i këtyre fetvaxhinjëve në instalimin e praktikave kriminale që po lëshojnë rrënjë me Shaqir Fetain?

Një fetva: a mund të jetë Shaqir Fetai “reis”? Një fetva tjetër: cili duhet të jetë ndëshkimi për të gjithë ata që përkrahin për “reis” Shaqir Fetain, njeriun i cili i tërhoqi zvarrë nëpër kanalizimin e krimin dhe të tradhëtisë deri në fronin e “reisllëkut” të vet? “Këshilli për fetva” pranë Myftinisë së Shkupit duhet t’u japë përgjigje qindra haramëve që janë bërë në këtë organ para se të dalë te Bitcoinat, sepse, nuk është as e fushës së këtyre fetvaxhinjëve dhe as specialitet i tyre.

Në Maqedoninë e Veriut, në Kosovë, në Shqipëri, në Sanxhak, në Bosnjë, përgjithësisht, në këto vende të varfëra të Ballkanit, edhe pse nuk ka ligj që e rregullon apo që e ndalon përdorimin e Bitcoinit, megjithatë, qeveritë e këtyre shteteve e kanë bërë “haram” vetëmse për faktin që, gjatë prodhimit të kësaj kriptovalute po vidhet shumë rrymë, sepse, duhet një sasi e hatashme e rrymës për t’u prodhuar këto valuta elektronike. Dhe, askush nuk ndëshkohet se prodhon Bitcoin, por, pse e vjedh rrymën gjatë prodhimit të tij. Ky po që është haram. Në këtë akt, në këtë gjest, duhet të përqëndrohet “ky këshill” e jo të futet në sfera për të cilat kurrë më parë nuk ka dëgjuar. Po u del flaka shtëpive, po digjen shumë shtëpi, duke e vjedhur rrymën kriptovalutistët. Por, edhe kjo problematikë do të duhej të ishte e fundit që shqetëson “komisionin për fetva” pranë një organi që vlon nga harami dhe nga harambashët.

Kjo vërejtje u pa edhe nga reagimi i qytetarëve, të cilët, me mijëra komente publikuan duke u tallur me hoxhallarët e Shkupit dhe me Myftininë më të madhe të vendit, e cila, dikur, kur e thoshte fjalën e vet, ishte “ligj në fuqi”. Sepse, kishte peshë vendimi që sillej nga personalitetet autoritativë. Me honxho bonxhot e Shaqir Fetait po tallen të gjithë! Medet!/Politesa/04.06.2021

Njoftimi i Shaqir Fetait për një grabitje të madhe në emër të Allahut xh.sh.

Shikoni se çka njohton Shaqir Fetai! Ky farë “reformats” i leshit, “organizon tubimin e kurbanave të gjallë, respektivisht bëhet tubimi i mjeteve në nivel të çmimit të kurbanit, ku pastaj blehen dhe theren kurbanat. Ndërkaq mishi i kurbanave do të përdoret për nevojat ushqimore në Konvkitin-kuzhinën e Medresesë “Isa Beu” në Shkup!” Një model njoftimi i denjë vetëm për komunitetin pa asnjë ditë shkolle

Nga Uran Memeti

Shaqir Fetai, duke manipuluar në emër të Rijasetit, lëshon një njoftim “të këtij organi kolektiv” (i cili nuk është mbledhur dhe nuk ka debatuar lidhur me temën e njohtimit), përmes së cilës na tregon se kur i bie dita e Kurban Bajramit dhe, na njohton lidhur me rolin e ri të BFI-së!

Shaqir Fetai, ngjashëm si pula kur i vie veza te b..., na njohton se BFI-në e paska shndërruar në shesh-tubim të kuarbanëve të gjallë, në kasaphane, në fermë dhenësh dhe në shoqatë humanitare. Kushdo që do të presë kurban, të mos mundohet fare, le të heq dorë nga “traditat prapanike” që nga hera na ka ngelur që të presim kurban dhe ta shpërndajmë mishin sipas “listës sonë”. Pra,

kurbanin le ta paguaj te Shaqir Fetai, 120 euro, sepse ky do t'i blejë kurbanët, le të jenë edhe 4000 kurbanë, ky do t'i presë, do të shikojë se sa ka nevojë menza e nxënësve të Medresesë Isa Beu dhe, nëse tepron mishi, do ta shpërndajë nëpër nevojtarë!

A mos ka lajthitur fare Shaqir Fetai, apo, do të tregojë se BFI-ja ka nisur me një punë të re, e cila, bën pjesë në “reformat e tij” që po i bën në BFI!!!

Si e para, deri më sot nuk është lexuar asnjë raport i përgatitur nga BFI-ja lidhur me kurbanët. Myslimanët e vendit nuk dinë se sa kurbanë janë therrur vjet, parvjet, para-parvjet, edhe më herët! Ky aktivitet fetar është misterioz, është aq mistik sa, ka nisur t'i ngjajë ritualeve të sekteve ekstreme. Askush nuk di se sa mish shpenzohet në mezen e nxënësve, sa mish shpërndahet, ku shpërndahet ai mish, kush mori nga ai mish, jo që na intereson, por, thjesht, për t'u bërë transparent aktiviteti dhe të shihet se mishi nuk ka shkuar nëpër shtëpitë e nëpunësve të BFI-së, siç shkon rëndomë, madje ka nëpunës që nga 100 pako me mish i “magazinin” në shtëpi të vet, ndërsa i jepen për t'ia shpërndarë gazetarëve, redaksive të cilat pastaj duhet ta mbyllin gojën në raport me punët devijante të BFI-së.

Askush nuk di se ku ruhet mishi, kush paguhet në ruajtjen e atij mishi, a është therrtorja hallall, a janë frigoriferët hallall. Me çfarë frigoriferësh shpërndahet mishi, a arrinë të shpërndahet pa u prishur në tërë territorin e Maqedonisë së Veriut, apo, ju jepet edhe i prishur siç ka ndodhur më herët.

Pse, bie fjala, Shaqir Fetai nuk del me një “studim” dhe t'iu drejtohet opinionit të gjërë mysliman në vend. T'iu thotë se për sa mish ka nevojë BFI-ja që t'i deponojë për nevojat e nxënësve të Medresesë, për një vit! Pse nuk del të thotë se në Maqedoninë e Veriut sivjet kemi targetuar kaq familje të varfër të cilëve do t'u japim mish nga kurbanët e therrur. Pse nuk kërkon të mblidhet kjo sasi e mishit por kërkon para, madje nga 120 euro. Po nëse në ditën e blerjes së kurbanëve do të ngriten çmimet dhe një kurban mund të kushtojë mbi 120 euro, çfarë do të bëjë pastaj Shaqir Fetai?!

Pse nuk i thërret Shaqir Fetai shoqata humanitare në vend dhe, secila të vijë me listën e të varfërve, të ngarkohet me mish dhe ata të bëjnë shpërndarjen e mishit, pa pasur nevojë që të angazhohet BFI-ja dhe, madje, ta shpërndajë mishin te të varfërit sa më shpejt dhe pa asnjë shpensim!

Pse të mos ketë besim ndaj shoqatave humanitare në vend, ndërsa mendon se do t'i besojnë atij, kur tashmë ka dhënë mjaft prova se është një prej “myslimanëve” më antiislam në vend!

Ne, banorët e një pallati ku banojnë rreth 50 familje, kemi komunikuar mbrëmë përmes “grupit” në WatsApp dhe, kemi vendosur që të merremi vesh që, në rast se therrim kurbanë sivjet, t'i blejmë vetë, t'i therrim vetë te livadhi prapa pallatit, me tekbire e me të gjitha ritualet fetare islame dhe, pasi t'ia bëjmë aminin, me shpejtësi secili kurbanin e vet, ta dërgojë në oborrin e Bashkësisë Fetare Islame, pastaj Shaqir Fetai le t'ia mendojë rjepjes së kurbanëve dhe le ta shpërndajë mishin sipas “listave” të tij. Edhe ne do të jemi të kënaqur, sepse do të jemi dëshmitarë të gjallë të therrjes së kurbanëve tona, që mund t'i blejmë edhe nga 80 euro copën dhe, edhe do të jemi më të rehatshëm, sepse do të jemi të bindur se mishin e kurbanëve tanë, sipas Shaqir Fetait, do ta hanë nxënësit e Medresesë dhe familjet e varfëra në vendin tonë. Këtyre hallall kat mbi kat, por ama, nëse mishin tonë do ta hanë nëpunësit e BFI-së, haram deri në ditën e kjametit!

Nga Shaqir Fetai, sivjet është pritur një njoftim tjetërfarësh, është pritur një aksion më i avancuar, është pritur një transparencë dhe një aktivitet që do ta shtojë më shumë besueshmërinë dhe, jo një njoftim që na ofendon, duke e degraduar BFI-në në “kasapnicë” dhe në shoqatë që “e ruan” mishin në kushte vere, deri në shpërndarjen e tij!

Mosmbajtja llogari ndaj amanetit, moskryerja e amanetit dhe, përpjekja për të përfituar nga një aksion islam që kryehet për Allah dhe që u dedikohet të varfërve, pa dyshim që është një haram i madh. Shaqir Fetai po jep isharete se do të kryej pikërisht këtë haram të madh!/1KlikLarg/04.06.2021

Udbashët kalojnë në satrap pastaj vetëeliminohen

Tre argumenta brenda një jave që flasin se tani, Shaqir Fetai, ka kaluar në një standë më të lartë se të qenurit bashkëpunëtor i oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviqit! Tash po e përjeton “forcën” e të qenurit satrap! Fundi i çdo satrapi (diktatori) është vetëeliminimi, i catur nga parandjenja paranojake e çmendisë

Nga Bexhet Halili

Shaqir Fetai, kishte organizuar një “intervistë” sa për t’i përshëndetur “teleshikuesit” e vet nëpërmjet kanalit të YouTube-s, “Ikre”, dhe, sa për t’i flladitur me rrena që i bluan vetëm koka boshe e Shaqir Fetait, sa për t’u vetëlavdëruar, sepse, askush nuk e nderoi “punën” e tij amatoreske për Ramazan ndërsa e kritikuan me mijëra vetë!

Në këtë intervistë Shaqir Fetai flet sikur islami në këtë nënqiell të ketë filluar prej kohës së tij, flet për një atmosferë që kurrë nuk qenka përjetuar më herët, flet për veten si për “një risi” që u ka ndodhur myslimanëve të vendit!

Rrenat e Shaqir Fetait, apo vjedhja e ndihmave humanitare

Shaqir Fetai pa lajthitur nga ndjenja e të qenurit dhe të poseduarit të “forcës” së satrapit, nuk guxon të rrejë aq açik sa të thotë se paska shpërndarë 200 ton ndihma! Ai me këtë deklaratë po humbë gjurmët e 140 tonelatave me artikuj ushqimor e higjienik, dedikuar të varfërve të vendit, të cilat vetëm Shaqir Fetai e di se ku i ka

çuar, sepse, sa i përket pakove, ai ka ndarë vetëm 60 e ca ton ndihma të donuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfit të Turqisë, ndihmë kjo prej 80 tonelatave. Se ku i mori edhe 140 ton e kah i shpërndau, këtë e di vetë Shaqir Fetai me hajnat e vet tashmë të dëshmuar në vjedhjen e ndihmave humanitare. Shaqir Fetai, vetëm nën “hyqmin” e satrapllëkut i jep të drejtë vetes të gënjejë aq shumë, sa të thotë se ka pasur një program të cilën e paska zbatuar qind për qind. Nëse hyni për t’ia analizuar “programin” do të shikoni një koncept prej amatorëve, pika të një entuziasti të shkollave fillore që dëshiron të mbajë një program-event sipas pikëpamjeve të tij fëmijërore. Realiteti i 30 ditëve të Ramazanit flet se, Shaqir Fetai ka dështuar si “gërçka” me atë “program”, i cili, shikuar në pika, nuk është realizuar as 10 për qind. Madje edhe ky 10 përqindëshi nuk i ka bërë nder askujt, me përjashtim të shkaktimit të vetëkënaqësisë!

Cili është synimi kryesor i Shaqir Fetait për Muajin e Ramazanit, apo, çka është sukses për Shaqir Fetain gjatë Muajit të Agjërimit

Shaqir Fetai, vetëm i pajisur me cilësi të një satrapi të pashpirtë guxon të deklarojë se, efektet e Ramazanit janë shumë të kënaqshme, qind për qind më të mira, sepse është mbledhur fitri dhe zeqati më shumë se vitin e kaluar. Pse a për këtë qëllim të Shaqir Fetait është Muaji i Agjërimit, a? Për këtë qëllim të poshtër të Shaqir Fetait myslimanët kanë shpeshtuar ibadetet e tyre, a? Do me thënë se, Shaqir Fetai, ky satrap avdall, paska pritur Muajin e Ramazanit vetëmsa për t’i vjelur “taksat fetare” dhe, sipas tij, ky është qëllimi i këtij Muaji të Bekuar!

Satrapi edhe vjedh edhe rrenë, edhe keqpërdor edhe manipulon, edhe të krip me rrena edhe nuk skuqet fare! Dy janë shtegëdaljet: ose të veprojë Shaqir Fetai ose të dalë e të dëshmojë oponenca e tij, Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI të RMV-së! Shaqir Fetai, satrapi, nuk ka se çka të frikësohet prej transparencës. Nëse është siç thotë ai, aq shumë i suksesshëm, ai duhet të dalë publikisht, me listë, me emër e mbiemër, për secilën xhami në Maqedoninë e Veriut të tregojë se cila xhami sa ka mbledhur dhe sa ka dorëzuar fitra dhe zeqat në BFI! Ta shohim “efektin Shaqir Feta” dhe, nga ana tjetër, kjo transparencë do t’ua pamundësonte myftinive të tij që t’i vjedhin fitrat dhe zeqatet! Jo sa kanë dorëzuar Myftinitë, por xhamitë!

Po flitet se, Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI, i ka të dhënat e

sigurta për mbi shtatëdhjetë për qind të xhamive se sa kanë mbledhur fitra sivjet. Po ashtu, ka raporte edhe nga diaspora dhe, të dhënat e kësaj Lëvizje janë dëshpëruese, janë të dhëna që flasin se myslimanët e vendit as që dëshirojnë të dëgjojnë për nevojat hajdutërie të Shaqir Fetait.

Një prej xhamive më të mëdha në Shkup, të cilën e frekuentojnë xhemat prej rreth 1000 shtëpive, në ditët më të vështira politike e sociale ka arritur të tubojë e të dorëzojë 10 mij e sipër euro, ndërsa, në këtë Ramazan mezi ka arritur të grumbullojë pak më pak se 100 mij denarë, dmth 1500 euro! Pra, në këtë Xhami Shaqir Fetai nuk e ka realizuar as 15 për qind atë që e ka synuar në këtë Ramazan. Shumë keq, tepër gjynah e hipokrizi! Në Ramazan synohet të arrihet kënaqësia e Allahut Mëshirëplotë, vetëm Shaqir Fetai synon të arrijë për qindje të lartë të fitrit dhe zeqatit. Satrap, pra!

Kush takohet me Sulejman Rexhepin lagohet nga puna

Lë të dalë Shaqir Fetai e le të thotë se ç'të keqe i ka bërë Sulejman ef. Rexhepi! Ndërsa Sulejman ef. Rexhepi ka bërë dy të këqia në raport me Shaqir Fetain! Dy të këqia që janë të barasvlefshme sa dy mëkate të mëdha: e ka bërë myfti dhe ua ka pezantuar myslimanëve si alim të madh! Prej bajgës a mund të bëhet lulja aromëmirë?

Pas deklaratës së Sulejman Rexhepit që del si falëbnderim ndaj bashkëpunëtorëve të tij që e vizitojnë, jo si reis, jo si lider të tyre, por, thjesht, si njeri plak, i moshuar, si dikush që ka dhënë kontribut të pamohueshëm në bërjen e tyre "teologë, apo "organe të BFI-së", Shaqir Fetai ka reaguuar me plotë histeri dhe, prej pozitës të satrapit, ia ka ndaluar të gjithëve që të kontaktojnë me Sulejman Rexhepin!

Ashtu siç i ka pasur dy gabime-mëkate Sulejman Rexhepi në raport me Shaqir Fetain, ashtu edhe Shaqir Fetai ka pasur dy dëshira të flakta djallëzore në raport me Sulejman Rexhepin: t'ia ngulë thikën pas shpine, ta tradhëtojë dhe, mundësisht, pas kësaj tradhëtie të rëndë, ose t'i bie pika në tru, ose në zemër, të neutralizohet dhe kurrë të mos ketë mundësi të flasë për Shaqir Fetain ato gjëra që i di vetëm H. Sulejman ef. Rexhepi!

Pra, Shaqir Fetai tashmë është duke e përjetuar turpin e tradhëtisë, nuk dëshiron që ta përjetojë edhe turpin që mund t'ia shkaktojë Sulejman Rexhepi, i cili, sipas deklaratave të atyreve që po e vizitojnë (e që në mesin e tyre ka emisarë edhe të Shaqir

Fetai) po duket gjithnjë e më vital! Kjo e tremb Shaqir Fetain, ndaj dhe ua ndalon njerëzve, si manjak, të kontaktojnë me Sulejman Rexhepin, prej të cilit mund të mësojnë e të dëgjojnë gjëra të rënda për Shaqir Fetain! Po kur të vendosë të flasë Sulejman Rexhepi? Në ç'vrimë do të futet atëherë Shaqir Fetai?!

Si duket fundi i një udbashi

Shaqir Fetai, duke u nisur nga një fakt i një miqësie të hershme, e merr një informacion të rremë dhe, sakaq u del në pritje preshevarëve! I thotë dikush se përfaqësues të medresesë së Preshevës, bashkë me nxënës, do të vijnë në Shkup dhe, meqë myftiu preshevar e ka mik shtëpie Sulejman Rexhepin, paska dëgjuar Shaqir Fetai se, ky delegacion, është i porositur nga Myftiu i Luginës së Preshevës, H. Nexhmedin ef. Saqipi, që ta vizitojnë edhe ish-reisin, H. Sulejman ef. Rexhepin, i cili aq shumë ka dhënë kontribut për Insitucionet islame të kësaj Lugine.

Shaqir Fetai, në deklaratën e vet prej demagogu e hipokriti, pranon publikisht se, me të marrë vesh që do të vizitohet Shkupi nga preshevarë, me insistimin e tij është bërë e mundshme që vizita e parë t'i bëhet BFI-së dhe personalisht Shaqir Fetait. Nuk mundet të kalojë dikush këndej pari e të mos ia urojë “postin dhe sukseset” Shaqir Fetait! Sepse, përmes këtyre vizitave, përmes këtyre urimeve e përshëndetjeve, ai krijon atmosferë false të përjetimit të një dashurie e cila e kamuflon urretjen e madhe gjithëkombëtare kundër një udbashi. Një udbash, një spiun i UDB-së nuk mundet që me zor t'i detyrojë myslimanët që ta duan. Po, do t'i detyrojë deri sa të jetë në rolin e satrapit, porse, megjithatë, ky rol është prej roleve më të shkurta që e kanë përjetuar çdo udbash para se ai të vetëeliminohet dhe të bie në greminën e çmendisë së vet. Ky është fundi i çdo udbashi!

Tallja me preshevarët

Tani, përtej dëshirave, përtej angazhimeve shekullore, përtej gjakderdhjes në veprimtarinë patriotike, përtej luftërave, përtej angazhimeve politike, përtej idealeve kombëtare të çdo shqiptari që nuk ka lidhje me UDB-në, përtej çdo trimi të Idris Seferit dhe pasardhësve të tij patriotë, Lugina e Preshevës (Bujanovci dhe Medvegja) edhe më tej ngelë brenda kufijve të Sërbisë. Atdheu, pra, vatani, është shteti me kufij të pacënueshëm dhe, për secilin qytetar autokton, atdheu është ky vend me këta kufij. Pra, atdheu dhe vatani i çdo shqiptari të Luginës së Preshevës aktualisht është

pjesa etnike brenda kufijve të Serbisë, pra, është vetë Serbia! Shaqir Fetai si eski udbash i gëzohet këtij fakti, ndaj dhe, meqë dikur atdheu i tij (si i gjithë atyreve që kanë jetuar brenda atyre kufijve të mëdhenj) ishte Jugosllavia, ai edhe më tej është nostalgjik për trashëgimtarin e ish-Jugosllavisë dhe, mburret me çdo qytetar të këtij “trashëgimtari” që kontribuon dhe që angazhohet për avansimin e këtij shteti, pra, të Serbisë aktuale. Delegacionit prirës të medresantëve nga Presheva, Shaqir Fetai u jep mirënjohje me këtë përmbajtje: “Kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame të Preshevës – “Në shenjë respekti dhe mirënjohjeje për kontributin tuaj të çmueshëm në shërbim të vlerave kombëtare e fetare në nënqiellin tonë!” Në cilin “nënqiell tonin” o Shaqir Fetai? Në nënqiellin tënd të Serbisë, aty ku u bërë intrigant i përsosur? Presheva i bie në Serbi, o jaran i Dragoviqit! Ose, atij tjetrit, që ia jep mirënjohjen me këtë përmbajtje: “... për kontributin tuaj të çmueshëm në shërbim të vlerave komëtare e fetare, për Zotin, kombin dhe vatanin”! Mos u tall me preshevarët o udbash, sepse dinë të ta kthejnë shumë keq! Ata vdesin për komb e për fe, ndërsa Serbinë nuk e konsiderojnë vatan të tyre, ndaj, ata konsiderojnë se akoma, asgjë nuk kanë bërë për vatanin e tyre, derisa pjesën etnike nuk ia rikthejnë vatanit të tyre të vërtetë. Mos blej patriotizëm në fatkeqësi të tyre. Mos u mundo që me lalë-lule ta kamufloshë udbashllëkun tënd, që tashmë po kalon fazën e satrapit, deri sa të vetëeliminohesh. Nuk e ke të largët këtë ditë, o pishpirik.

“Mjeshtri i madh” i “mjeshtrit të vogël”

Shaqir Fetai paska pritur me pietet “Mjeshtrin e Madh” të gazetarisë shqiptare, mikun e ngushtë të H. Sulejman ef. Rexhepit, të dekoruarin e Bujar Nishanit, Ferdinand Samarxhiun! Sa për informim të Shaqir Fetait, Ferdinand Samarxhiu mbetet injoranti më i madh i gazetarisë shqiptare, prandaj edhe kurrë nuk e keni parë të respektuar e të nderuar nga tv-studiot me renome kombëtare. Në gazetari ose lindë gazetar ose vdes injorant i gazetarisë. Nuk ka gazetarë në botë që e mat profesionin e vet me titur shkencor e me epitete të pushtetit. Epitetet e pushtetit nuk të bëjnë të madh por të motivojnë për servilizëm deri në manire të qenit të zgjebosur.

Ai shtë një sekser i mirë, një marapaz, një llapaqen që as vetë nuk e di se çka fletë sa herë që i drejtohet audiencës së gjërë. Është një

manipulator i shkëlqyeshëm me ndjenjat e fetarëve ndaj dhe, gjithnjë e ke të angazhuar në çastet kur, myslimanët, për emocionet shpirtërore nga gëzimi i festave të shenjta fetare, janë në gjendje t'i shterrin edhe xhepat që ua gjuan Ferdinand Samarxhiu! I paska ngelur t'ia ofrojë një letërnjohtim të shkurtër Shaqir Fetai atij! Ferdinand Samarxhiu e di se si frymon BFI-ja, kështu që, bashkëpunimi me të është i mrëseardhur ekskluzivisht për te. Të planifikoshë që ta bëshë të madh Shaqir Fetain, nuk është mjeshtri e madhe, por, është idiotizëm. Edhe idiot edhe “Mjeshtër i Madh”, sikur nuk shkon! Mos të harrojmë, ky “Mjeshtër i Madh” është prodhim i “sigurimit” të Enver Hoxhës, siç është “reis” edhe Shaqir Fetai si prodhim-ORAO i oficerit të UDB-së Stanko Dragoviqit! Prodhime shkijesh ma!

Paskan rënë dakord që në të ardhmen të kenë një bashkëpunim të përbashkët (hajde fjali hajde!) Bashkëpunimi me këtë “Mjeshtër të Madh” është vetëm një dakordësim për ta kryer një vjedhje të përbashkët të BFI-së! Një sekserizëm i përbashkët në dëm të Institucionit të BFI-së! Një “vigjilencë” prej ORAO-s mbi BFI-në e mjerë!/Opinione/05.06.2021

Shaqir Fetain e tmerrojnë sukseset historike të Shqiptarëve

Banorët e Mateçit ranë nga provimi kombëtar! E patën në mesin e tyre një udbash, i cili, ashiqare tallej me ndodhitë dhe faktet historike të shqiptarëve të kësaj ane, ndërsa ata, nuk ditën t'i heqin hunjtë e gardhqeve dhe t'ia bëjnë shpinën më të butë se barku, t'ia thyejnë një këmbë. Zoti i Madh do t'ua bënte hallall, pa dyshim

Nga Enver Jashari

Banorët e fshtit Mateç vendosën që të ndërtojnë edhe një Shtëpi të Zotit! Me iniciativën e familjes së profesorit Naser Ramadani, me kontributin e tyre si dhe me lëshimin e truallit të tyre për këtë Shtëpi, u hodh edhe guri themeltar i Xhamisë së Re, të cilën dikush e paska emërtuar “Dëshmorët e 2001”!
Të pranishmit, u lodhën duke e përshëndetur njëri tjetrin, madje, myfiu, me pamjen e një lypsi të ngratë, nga egsaltimi i skajshëm dy

herë radhazi e përshëndeti nxënësin e oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviq, instalacionin e pushtetit aktual maqedonas në krye të BFI-së, Shaqir Fetain.

A përshëndetet ky njeri i cili fut huti dhe nuk reagon me kohë, i cili, duke mos i njohur aktet normative të BFI-së, lejon edhe gafa gjatë emërtimit të Xhamisë, i cili, duke u përpjekur gjatë tërë kohës që t'i fshehë dhe t'i shtrembërojë faktet, mbajti një fjalim me të cilën dëshmoi se “nxënësi” ngelë përjetë nxënës (i Dragoviqit)!

Si emërohen xhamitë?

Xhaminë dikush paska vendosur që ta quajnë Xhamia e “Dëshmorëve të 2001”!

Kush e emërtoi dhe kush ia dha lejën, madje nga kush e mori lejen “kumbari” i kësaj Xhamie?

Po për shqiptarët e këtij fshati, në daçi edhe të ngjarjeve historike, të cilët ranë dëshmorë më herët, nuk ka asnjë Xhami? Për shembull Xhamia “Sylë Hotla”!

Ku merret leja e emërtimit të xhamive, a ka këtu donjë rend apo, kujt si t'i kujtohet! Ku regjistrohet ky emër! Pse Shaqir Fetai nuk ua shpjegoi procedurën e emërtimit të një xhamie, duke i orientuar islamikisht dhe juridikisht që entuziastët të mos bëjnë gabime të pariparueshme!

“Dëshmorët e 2001”! Cilët dëshmorë, sepse, edhe pala maqedonase, me të cilën lutuan dëshmorët e Mateçit dhe më gjërë, dëshmon se në këtë vit i ka dëshmorët e vet! Edhe ata thonë “Branitellat e 2001”, me demek “dëshmorët e atdheut të 2001”!

Po këta “Dëshmorë të 2001”, dëshmorë të kujt janë? Për çfarë ranë dëshmorë? Për atdhe? Apo ishin dëshmorë të luftës nacionalçlirimtare! Apo, dëshmorë të kombit që ranë për liri dhe barazi, apo për të drejta të barabarta! Mos i lëni pezull dëshmorët shqiptarë që u vranë gjat konfliktit të vitit 2001 në mes të ushtarëve të UÇK-së dhe policisë dhe ushtrisë maqedonase! Mbase më mirë do të ishte sikur kjo xhami të quhej “Dëshmorët e Kombit”, pavarësisht, vitit, sepse, Kombi Shqiptarë, ndër vite e në histori, gjithnjë ka pasur dëshmorë, qoftë për atdhe, qoftë për liri, qoftë për fe, qoftë për Shqipëri Natyrale. Mbi të gjitha, xhamive sikur nuk u shkon emri që lidhet me ngjarje historike kombëtare, sepse, kombi ynë i përket tri feve dhe disa religjioneve. Mos

manipuloni, mos u mundoni që në evente fetare, t'ju jepni mundësi të rehabilitohen UDB-ashët. Dëshmorët e 2001 ishin në krahun e idealit kombëtar, u rirreshtuan pas bindjeve se po luftojnë për t'ia bashkangjitur trojet etnike Shqipërisë Nënë, ndërsa, Shaqir Fetai, dhe disa Shaqira të tjerë që qenë prezentë në këtë gurëthemel, në krahun e kujt ishin gjatë luftës së 2001? Kë e furnizonin me informacione? Dragoviqët dhe Temelkot, pa dyshim! Abedin Imeri nuk di se nga kush u çliruan banorët e Mateqit më vitin 2001! Nuk e di as Shaqir Fetai! Rastësisht nuk e dinë? Myftiu i Myftinisë së Kumanovës, Abedin Imeri, pasi brenda dy minutave dy herë e përshëndeti "sivëllain" e vet, Shaqir Fetain, i përshëndeti edhe drejtorët e sektorëve të shumtë të BFI-së!

Vërtet, a e di Abedin Imeri se sa sektore ka BFI-ja?

A e di Abedin Imeri se kur u themeluan këto sektore?

A di të na i përmendë vetëm tri sektore Abedin Imeri!

A e di Abedin Imeri se themelues i sektorevë të BFI-së është

Rijaseti, pra, edhe vetë ai si anëtarë i Rijasetit të Shaqir Fetait! A di të na thotë Abedin Imeri se kur ka votuar për themelimin e një prej sektoreve që na qenkan të shumtë në BFI!

A e di Abedin Imeri se sektoret përbëhen nga njësitë, zakonisht, dy-tre e më shumë, se njësitë kanë udhëheqës të tyre dhe, në krye të sektorit zgjidhet apo emërohet një drejtor. Drejtorç të cilëve udhëheqës njësishtë përshëndeti Abedin Imeri, apo ia futi si kau pelës, si zakonisht!

Dhe pastaj merr fjalë ai që ka detyrë t'i tubullojë ngjarjet, t'i fshehë ngjarjet historike, t'i gjymtojë dhe mos të kuptohen se çfarë ngjarjesh kombëtare ishin ato, të mos tregojë se kush i shkaktoi ato ngjarje tragjike që përjetë kanë ngelur në memorien e kombit, të mos ua përmendë emrin armiqve të 2001, të cilët qenë shkaktarë që edhe Mateçi të ketë dëshmorët e vet në atë luftë kundër armiqve të cilët ishin mësuar që shqiptarët e Maqedonisë së Veriut t'i trajtojnë si qytetarë të rendit të dytë, duke ushtruar një aparteid i llojit të vet. Pra, Shaqir Fetai, në këtë "event" kishte rol të dyfishtë: promovues të partisë prej nga vjen dhe, mohues i të vërtetës se partia prej nga vjen është psardhëse e atyreve që e shkaktuan luftën e 2001 kundër politikave të partisë me të cilën sot janë në koalicion. Kjo ishte detyra e parë, detyra e dytë ishte që, askund mos ta theksojë "armikun" dhe as arsyen se pse u luftua; askund mos t'i theksojë emrat apo edhe emrin e etnisë që dha kontribute të paçmueshme kombëtare, porse, të gjitha ato t'ia

mveshë xhamive, dhe, t'i justifikojë aksionet e armikut që në luftëra rrënonte xhami, siç u rrënuar me të njëjtin pretekst edhe Xhamia e Mateçit nga bombardimet e ushtrisë maqedonase. Abedin Imeri, si "reisi i tij" nënvizon se më vitin 2001 u çliruan banorët e Mateçit, ndërsa nuk tregon se nga kush. Po, thotë se, u çliruan nga njerëzit e papërgjegjshëm! Do me thënë, shqiptarët historikisht kanë qenë të shtypur, të nëpërkëmbur e të padrejtësuar nga njerëzit e papërgjegjshëm, sipas Abedin Imerit, myfti! Phu!

Gëzimi i Shaqir Fetait për rastin e dhënë për sakatosje të fakteve historike

Kurse Shaqir Fetai ka ndjerë një gëzim të veçantë që do të jetë në mesin e banorëve të Mateçit, të cilët, u bënë shkak për që të çlirohen edhe viset e tjera të Komunës së Likovës (nga kush të çlirohen?) Shaqir Fetai ndjehet krenar që këta banorë paskan luftuar për barazi dhe për liri si dhe për një të ardhme më të bukur jo vetëm të kombit shqiptar por të mbarë shoqërisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut! Pra, edhe për maqedonasit, serbët, bullgarët, vllahët etj. A ka mundësi mos t'ia lëkundni eshtrat trimave të kombit, o bashkëpunëtorë të Dragoviqëve e të Temelkove!

Shaqir Fetai futet llugave duke u munduar që të vetërehabilitohet dhe, t'i rehabilitojë një dyzinë hoxhallarësh që mendojnë si ai, si ata skuthat, si urithët që punojnë nën tokë, pak aty e pak këtu! Sipas Shaqir Fetait xhamitë qenkan baza që po themeluan ekskluzivisht personalitete të shëndosha! Po çfarë personaliteti të shëndoshë ka krijuar xhamia te Shaqir Fetai, po te baballëku i vet, po te ata që i nënshtrohen dhe ia puthin dorën këtij farë "përpersonaliteti" të cilin nuk e themeloi xhamia por Stanko Dragoviqi!

Po ata personalitete, ata tribunë kombëtare të cilët kurrë nuk kanë shkelur në xhami (qoftë për shkak të bindjeve, ideologjive, përkatësive fetare) por që në dimensionin kombëtar janë të paarritshëm!? Këta a janë me personalitet të fortë apo, këta i sfidon dhe i mund Shaqir Fetai, ky nxënës i xhamisë por edhe i Temelkos dhe Dragoviqit!

Shaqir Fetai u ka borxh një falje publike të gjithë atyre

intelektualëve, atyre patriotëve, atyre shtyllave të kombit, të cilët asnjëherë nuk kanë hyrë në xhami, sepse, i ka fyer, u ka çuar selam se janë pa personalitet, pa shpirt e pa tru! Shaqir Fetai me këtë ligjeratë të tij duhet t'u drejtohet armiqve të popullit shqiptar e që janë miq të ngushtë, miq shtëpie të Shaqir Fetait, sepse, nuk ka nevojë t'u drejtohet shqiptarëve, sepse, ka një përqindje bukur e madhe e shqiptarëve që nuk i frekuentojnë xhaminë por që Shaqir Fetain për intelektualitet e për patriotizëm e mbajnë në maje të kalemit!

Shaqir Fetai flet ashtu siç mendon UDB-ja

Xhaminë paskan mbledhur 3 për qindëshin për universitetet shqiptare të ndara nga universitetet sllave në Kosovë, thotë Shaqir Fetai! Ata Universitete nuk ishin të ndara por, studentët, profesorët shqiptarë, akademikët, ishin dëbuar me dhunë nga okupatorët serbë të cilëve u shërbente Shaqir Fetai dhe, ai 3 % nuk mbledh për ta paguar vetëm arsimin, por, me të mbahej edhe ministria e mbrojtjes, e policisë, mbahej shërbimi sekret kombëtar, mbahej presidenca, deputetët e ish-parlamentit të Kosovës, shkurt, organizohej jeta paralele dhe e pavarur nga okupatori serb, o Shaqir dardhaxhiu! Xhaminë kanë mbledhur edhe fonde të "Atdheu thërret"! Fonde për luftën e UÇK-së, për armatimin e luftëtarëve shqiptar, për luftë kundër serbëve okupatorë! Pse e mohon këtë Shaqir Fetai? Pse i frikësohet këtij fakti, apo, e urren këtë fakt, sepse ia shkëputi raportet me Dragovićin e UDB-së, a!
"Xhaminë ishin ato që me mijëra refugjatë nga Bosnja dhe Hercegovina i mbështetën dhe i futën nëpër shtëpitë e tyre", është margaritari tjetër i Shaqir Fetait, stil ky i tij për ta mohuar angazhimin e familjeve shqiptare, zemërgjerësin e tyre, shpirtin human të shqiptarëve, por, në veçanti, shpirtin luftarak të ish-reisit Sulejman ef. Rexhepi. Pa angazhimin e tij, pa kërcënimin e tij, pa këmbënguljen e tij, pa ultimatumin e tij drejtuar Kiro Gligorovit se do ta ndezë luftën në Maqedoni, asnjë xhami në Maqedoninë e atëhershme nuk do të mund të strehonte asnjë refugjat boshnjak. Sa për dijeni të Shaqir Fetait, pothuajse të gjithë, që të gjithë, janë strehuar nëpër shtëpi të shqiptarëve, dhe janë mbajtur falë kontributit të tyre e jo të sojit të Shaqir Fetait!
Shaqir Fetai e jep një detal që mund ta dijë vetëm UDB-ja! Ai thotë

se xhamitë e Maqedonisë së Veriut paskan siguruar paga mujore me të cilat i paskan mbajtur skamnorët e Kosovës, çdo muaj u paskan çuar rroga! Ky fakt nuk është përmendur në asnjë “defter historik” të Kosovës, por nuk është i shënuar as në arkivin e BFI-së, ndoshta ka qenë si strategji serbe nëpër arkivat e tyre ku ka pasur qasje vetëm Shaqir Fetai, sa për t’i sulmuar xhamitë e për të shpikur “muxhahedinë” që kujdesen për çlirimtarët e Kosovës!

A spiunohet me iman

Për çfarë situate të jashtëzakonshme flet Shaqir Fetai, në të cilën xhamitë paskan qenë shumë mirë të përgatitura dhe ia paskan “tharë pështymën në fyt” një politikani që qenka bindur se xhamtë nuk qenkan vetëm për ibadet. Po për çka, sipas Shaqir Fetait? Për luftë? Nga xhamitë zhvillonin luftë pjesëtarët e UÇK-së? Kështu thoshin vetëm ata që i gjuanin xhamitë për t’i rrafshuar përdhe. Kështu thoshin vetë ata që e dogjën Xhaminë e Prilepit. Kështu thoshin “strategët maqdonas të luftës”, të cilët, ia mësynë rrënimin të xhamive me arsyetim se po shërbejnë si bunkerë për seperatistët shqiptarë? Shaqir Fetai me këtë deklaratë dëshiron t’i justifikojë të gjitha sulmet që janë bërë mbi xhami nga ushtria dhe policia maqedonase. Ky është nënteksti i deklaratës së Shaqir gllupit. Shaqir Fetai tërë këtë “justifikim sllav” mundohet ta arsyetojë duke manipuluar se, kështu po e shpjeguaka islami, kështu e paska praktikuar edhe Muhamedi a. s., duke i konceptuar xhamitë si “parlament”, si “shtabe luftime”, si “bunkerë”, si “vatra të diturisë” etj! Shaqir Fetai duhet të dijë se, ky koncept për xhaminë ka qenë në fillet e islamit, atëherë kur nuk ka pasur as parlament, as shtabe luftarake, as shkolla, as universitete dhe asgjë! Sot, në botën islame xhamitë vlejné ekskluzivisht për ibadete, sepse, kanë ndër parlamentet më të bukura në botë, kanë bunkerë e shtabe luftarake ndër më të sofistikuarat në botë, kanë universitete e fakultete nga më grandiozet në botë. Nëse nisemi nga logjika e Shaqir Fetait, xhamitë sot shërbejnë edhe si qendra për rekrutim nëpër shërbime intelektuale të huaja! Turp! Alamet alimi, që flet me zë shejtani, turp të mendojë se xhamitë tona paskan shërbyer përgjithçka dhe, askund nuk na dalin në rolin e tyre jetik për ta zhvilluar dhe për ta kultivuar fenë islame! Sepse, Shaqir Fetai nuk e ka këtë hall; halli i tij është se si të rehabilitohet, si të shpërfaqet

në patriot dhe ta kamuflojë disi pseudonimin e vet serbo-policor ORAO!

Pastaj, kur është në pyetje donimi, donacioni, dhënia, Shaqir Fetai thotë se jep vetëm ai që ka iman, sepse, imani jep! A jep miq e shokë imani! Thjesht, a spiunohet me iman? Shaqir Fetai mendon se ka iman edhe pse spiunoi shokë të fakultetit? Manipulator i fëlliqtë!

Aq sa do të kontribuojmë në këtë botë për një xhami, aq pallate do të kemi në botën tjetër, thotë Shaqir Fetai. A thua, sa pallate i ka siguruar Shaqir Fetai për botën tjetër?! Apo, nuk i duhen pallatet, i duhen bodrumet e strehat ku zhvillohet aktiviteti i spiunazhit, sepse, këtë detyrë di ta bëjë më së miri Shaqir Fetai i cili mendon se, edhe në botën tjetër do të vazhdojë me këtë detyrë por në forma të tjera, ashtu siç u mundua të spiunojë në këtë event përmes formës së nxjerrjes në pah të “patriotizmit” të vet! Shaqir Fetai patriot? Mësa mundet të dalë burrë “Martinoviqi i Kllokotit” i cili shishet e birrave i zbraste me b...

Qershia e Stanko Dragoviqit mbi tortën e Shaqir Fetait

Shaqir Fetai e mbyllë fjalimin e vet me plotë patetizëm, duke u mburrur me datën 6 qershor, sepse përkon me çlirimin e Mateqit (por nuk e zë në goje armikun nga i cili u çliruam), për të cilën ranë dëshmorë e që familjarët duhet të ndjehen krenar. Po sikur ata dëshmorë të ishin gjallë, çka mendon Shaqir Fetai, a do ta linin sojin e tij të futet në Mateq? Dëshmorët dhe spiunët janë si gasi dhe fija e shkrepës! Shaqir Fetai thërret që gjithnjë kur ta dojë nevoja të jemi të gatshëm si mateqasit, t'i kemi inspirim shqiptarët e Likovës dhe t'i dalim zot vatanit! Po Shaqir Fetai, çka ka bërë kur këta shqiptarë luftonin më vitin 2001 kundër forcave militare e paramilitare maqedonase, serbe, ruse etj! Ç'bënte Shaqir Fetai kur shqiptarët luftonin kundër një pushteti maqedonas i cili shqiptarët ishte mësuar t'i shikonte si qytetarë të kotë!

Çka ka pasur të bëjë Shaqir Fetai përveçse të spiunojë!

Jo rastësisht, një prej komandantëve më të spikatur të të gjitha luftërave të fundit të shqiptarëve, një prej komandantëve dhe strategëve më të përgatitur dhe më patriot, komandant Tahir Sinani, bie dëshmor në territorin e Myftinisë së Gostivarit! Gjeneral Tahir Sinani organizoi shumë aksione jetike për UÇK-në, drejtori

shumë luftëra, inspiroi shumë fitore, deri në çlirim të Kosovës, dhe në fund, trimi i kombi, i mbylli sytë mu në territorin e Myftinisë së Gostivarit, të këtij qyteti ku vepronte edhe antishqiptari më i madh i të gjitha kohërave, Temelko Boshkovski, me të cilin, në miqësi të ngushtë qenë, pa dyshim, edhe Shaqir Fetai me vjehrrin e vet që ishte “hoxhë” xhamie, dhe i cili e kaliti Shaqir Fetain me këtë “personalitet”!

Shaqir Fetai, për hirë të gjeneratave të ardhshme nuk është mirë t'i cungojë faktet, t'iu bishtërojë fakteve, sepse, nesër do të keqinterpretohen ashtu siç dëshiron sot Shaqir Fetai. I paska dhimbsur zemra kur e paska parë minaret e rrënuar të Xhamisë së Mateçit! Duhet të tregojë se kush e rrënoi, me çka e rrënuan, me çfarë sebepe e rrënuan “qafirët”. Sepse, kështu si informacion i cunguar, del puna që vetë banorët e Mateçit e paskan rrënuar dikur moti një xhami, se këta banorë vetë po ndërtuakan dhe vetë po rrënuakan xhami! Gjysëm ore “ligjeratë patriotike”, çlirim e fitore, rrënim e bombardime, por askund nuk e përmend fjalën “polici dhe ushtri maqedonase”, e cila trishtohej tek shihte të rrënuar minaren! Dhe, ja, për inat të tyre, sot në këtë trevë na qenkan ndërtuar 1,2,3,4 xhami! Shaqir Fetai siguron se shqiptarët ndërtojnë xhami për inat të “shkijeve” e jo se u duhen për ibadet, për lutje, e për madhërim të emrit të Zotit të Madh. Ky është mynafiku, snobi, hipokriti, demagogu dhe “patrioti” me bateri, Shaqir Fetai!/Politesa/07.06.2021

Shaqir Fetai ka nisur t'i rreje edhe ndërkombëtarët

Shaqir Fetain e paska vizituar Këshilltari i ri për çështje fetare në Ambasadën e Republikës së Turqisë në Shkup z. Mustafa Mesten, të cilin, si i pafytyrë që është, e paska kripur me rrena! Ka folur aq budallallëqe sa, turku pa dyshim që qenka ndarë prej tij i dëshpëruar sa më s'ka!

Në Maqedoni po u praktikuoja islami i trashëguar gjatë sundimit osman gjashtëshekullor! Askund në botë kjo Perandori nuk ka sunduar gjashtë shekuj! Në Ballkan dhe, te ne, është prezent tash e gjashtë shekuj feja islame, që i bie, pesë shekuj gjatë sundimit Osman dhe tash e një shekull nga pavarësimi prej kësaj ish-Perandorie!

Rrenë tjetër është se në Maqedoni praktikohet “islami i bazuar në sektin Hanefi”, sepse, o dudukë, mez'hebi Hanefi nuk është sekt por Shkollë Juridike Islame! Për këtë gabim fatal, të pafalshëm, do të duhej të jepnin llogari që nga tekstshkruesi e deri te vetë Shaqir Fetai, sepse, nuk ia kanë fajin ata që nuk dinë të shkruajnë, por fajin e ka vetë Shaqir Fetai që angazhon njerëz analfabetë që nuk dinë ta dallojnë sektin prej mez'hebit! T'i thuhet Mez'hebit Hanefi sekt, dhe për këtë të mos përgjigjet askush, kjo flet se Shaqir Fetai tashmë, pas shkatërrimit të BFI-së, i ka shpallur luftë edhe islamit të këtij nënqielli! Reisul Ulema pajtohet me konstatimin “sekti Hanefi”!!! Hapu tok, e të fundosemi nga turpi! Në faqen zyrtare të BFI-së e kemi lajmin ku flitet për “sektin Hanefi”. Një shtyllë e Islamit te Shaqir Fetai konsiderohet “sekt”, sepse, BFI-në e ka

mbushur me “sektashë”, të cilët i mban si “skyfterë të ndonjë metaliku nga bota arabe”!

Në fillimet e “demokracionit” siç thotë Shaqir Fetai, në Maqedoninë e Veriut paskan tentuar të futen llj-lloj grupacionesh dhe të veprojnë nën petkun islam por, ja që nuk i paska lejuar të gjejnë fushë veprimi Bashkësia Fetare Islame! Shaqir Fetai, jo që nuk lë njeri që ta kontaktojnë Sulejman ef. Rexhepin por, nuk denjon as vetë që t’ia zë ngoje emrin!

Gënjënë kur thotë se BFI-ja nuk i lejoi të veprojnë grupacionet! E vërteta është se, Shaqir Fetai është fërkuar shumë fort me këta grupacione, por, luftëtari i paepur kundër sekteve e propagandave sektariane ka qenë vetëm ish-Reisul Ulema Haxhi Sulejman ef. Rexhepi, i cili, në asnjë mënyrë nuk ka pranuar që elementë të tillë të depërtojnë në Maqedoni.

Dihen shkrimet e Sulejman Rexhepit, dihen reagimet e tij zyrtare, dihen protestat e tij ndër qarqet diplomatike, dihen ankesat e tij nëpër kongrese e konferenca ndërkombëtare ku, madje edhe me tone kërcënuese ua ka tërhequr vërejtjen të gjithë elementeve që mos të tentojnë të futen në Maqedoninë e Veriut dhe të veprojnë nën petkun e islamit, sepse nuk do të mbajë përgjegjësi as për jetën dhe as për veprimtarinë e tyre të dyshimtë.

Shaqir Fetai rrenë kur i thotë vëllait turk se, edhe ai do të angazhohet që të vazhdojë fryma e “sektit” Hanefi! Sapo u instalua nga pushteti aktual maqednas në krye të BFI-së, u regjistruan me dhjetra bashkësi të dyshimta si dhe grupe religjioze të pakuptimta që po veprojnë nën petkun islam! Madje ua ka zyrtarizuar edhe “selitë”, faltoret, “xhematet”...

Shaqir Fetai e paska keqkuptuar fjalorin diplomatik të z. Mesten, diplomatit turk, i cili i paska thënë se “ai ka dëgjuar vetëm gjëra të këndshme për Reisul Ulemanë nga paraardhësit e tij!” Dhe, këtë lavdëratë, i mjeri Shaqir Fetai, ia paska taksur vetes! Pararendësit e këtij diplomati turk kanë pasur punë me H. Sulejman ef.

Rexhepin dhe, ky ka qenë përfaqësues i BFI-së dhe i myslimanëve të vendit para botës islame, para mediave të kësaj bote si dhe para diplomatëve nga kjo botë e gjetiu, dhe jo turlifarë leshperi, hajni e krimineli që bashkëpunojnë me Shaqir Fetain (për shembull, Mustafa Dauti)! Pararendësit e këtij diplomati, hiç mushavirin e fundit, që të gjithë kanë përcjellë fjal miradie për njeriun me të cilin kanë bashkëpunuar, pra, me H. Sulejman ef. Rexhepin dhe, kur e ka theksuar këtë fjali atasheu aktual turk, Shaqir Fetai është

dashur të jetë më korrekt, t'ia nxë emrin ngoje dhe të shpreh mburrje se ka qenë bashkëpunëtorë i ngushtë i Reisul Ulemasë për të cilin kanë folur gjëra të këndshme diplomatët turq, pararendësit e këtij aktualit!

Shaqir Fetai hala nuk e ka bërë më të voglin veprim që t'i fascinojë ndërkombëtarët, ndërsa i ka befasuar me treadhëtinë dhe komplotin që ia bëri ish-reisit të vet!

Shaqir Fetai hala sillet si qura në mjegull, hala nuk di se cilat janë veprimet prioritare që i duhen BFI-së, me të cilat do të ndaheshin të kënaqur edhe ndërkombëtarët.

Po, Shaqir Fetai deri më sot ka bërë qindra budallallëqe, ka rrejtur aq shumë, vazhdon të rrejë me intensitet edhe më të shtuar sa që, ka nisur të ndjehet si qyqe e mjerë! Ky është perceptimi i përgjithshëm për Shaqir Fetain – qyqe e mjerë!/Levizja Myslimane për Reforma në BFI/1KlikLarg/08.06.2021

Është tmerrues qëndrimi i Shaqir Fetait mbi Medhhebin Hanefij

Është tmerruese neglizhenca e Shaqir Fetait që, edhe përkundër vërejtjeve të oponencës së tij, Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI, nuk ka ndërmarrë masa që ta përmirësojë qëndrimin “zyrtar” të vetin dhe Medhhebin Hanefij mos ta trajtojë si “sekt”! Apo, ky është misioni i Shaqir Fetait, që të përpiqet ta bëjë islamin “përslesh”! Myslimanët e vendit kurrë nuk do ta pranojnë këtë angazhim të Shaqir Fetait, është vetëm çështje kohe kur do t’ia bëjnë përslesh hundët. Tallja me Medhhebin Hanefij është e patolerushme

Definicioni se Medhhebi Hanefij është “sekt” është akt i barasvlefshëm me përpjekjet ofenduese për ta paraqitur Pejgamberin a.s. në karikaturë. Një përpjekje e tillë ka dridhur mbarë botën!

Shaqir Fetai, reisi i dhunshëm në BFI (në kuptimin e instalimit të dhunshëm), ka disa ditë që ka pasur mysafir myshvirin e ri të ambasadës së Turqisë në Shkup, të cilin e ka keqinformuar se në vendin tonë praktikohet islami i perandorisë gjshatëshekullore

Osmane, bazuar në “sektin” Hanëfij! Ose është keqinformim i përgjithshëm ose është injorancë!

Është rrenë e kulluar, është manipulim i pastër, është “zyrtarizim” i sektirizimit të islamit në Maqedoninë e Veriut nga ana e Shaqir Fetait. Tani po vërtetohet se, jo rastësisht, në kohën kur u instalua nga pushteti aktual maqedonas Shaqir Fetai, nisën të lulëzojnë “bashkësi fetare” të reja dhe grupe religjioze që do të funksionojnë në emër të islamit ndër ne.

Shaqir Fetai është i bindur se te ne funksionon “sekti Hanefi”, ndryshe, do të intervenonte dhe do ta korrigjonte deri më tani në faqen zyrtare të BFI-së, se islami në Maqedoni bazohet në “sektin Hanefi”.

Ky më nuk është llapsuz, ky më nuk është gabim shkrimi, as gabim teknik, por, është qëndrim i Shaqir Fetait, ndonëse Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI, pra, oponenca e saj, e urdhëroi që ta ndryshojë dhe ta bëjë Medhhebi Haniefij, ashtu siç duhet të jetë! Ne bazë të islamit që tradicionalisht është kultivuar në këtë nënqiell dhe në trojet ballkanike, përgjithësisht pra, në viset etnike shqiptare-myslimane, në bazë të dokumentave arkivore shekullore, në bazë të Kushtetutës së BFI-së, Neni 1, paragrafi katër që thotë: “Në zbatimin e detyrave islame, në fushën e ibadeteve, BFI aplikon Shkollën Juridike Hanefite”, ne jemi të bindur se në këtë truall funksionon Medhehbi Hanefi, dhe jo “sekti Hanefij”!

Shtrojmë pyetje se, nga çfarë shkolle ka dalur Shaqir Fetai? A ka profesorë, e ka ulema në këtë truall, apo, të gjithë janë të shantazhuar nga Shaqir Fetai! Çka flet shantazhi i përgjithshëm? Natyrisht, vetëmse mjerim, katastrofë, njollosje të mbarë ulemasë, e cila tashmë ka shkjarë nga rruga e pasardhësve myslimanë të devotshëm të Pejgamberit a.s.

Shaqir Fetai është dëshmuar si shkelës i pamëshirshëm i Kushtetutës së BFI-së, akt ky juridik që për bazë ka Kurnain e Madhërishëm si dhe Sunetin e Pejgamerit a.s.; ne e dimë që Shaqir Fetai do të ngelë përjetë shkelësi absolut i të gjitha vendimeve dhe i të gjitha sjelljeve humane të kultivuara me decenie në BFI, por se do të shkojë kaq larg dhe do ta mohojë paragrafin katër të Nenit 1

të Kushtetutës së BFI-së, për këtë as që na ka marrur mendja!
Është për t'u befasuar edhe nga mosreagimi i ulemasë së vendit, të cilët për "reis" e kanë Shaqir Fetain, është për t'u shqetësuar deri në çmendi nga heshtja e tyre. Ku janë ata fetvaxhinjë, ku janë ata mualimë, "muderrizë", ata vaizë, që gojën e kanë plotë islam, ndërsa tolerojnë që t'iu njolloset Medhhebi!

Perëndimorët dinë që në Maqedoninë e Veriut si dhe ndër mbarë kombin shqiptar praktikohet në 99.9 për qind Medhhebit Hanefi, por, se do të dalë një manjak dhe këtë Medhhebi do ta trajtojë si "sekt" kjo i ka ndodhur vetëm Shaqir Fetait.

Do të ishte mirë që sa më parë ta lënë mënjanë inatin për faktin që është urdhëruar nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI të RMV-së dhe, ta mënjanojë nga faqja zyrtare e BFI-së gafën ku ky Mehdebi trajtohet si "sekt"! Ndërsa me këtë tendencë të Shaqir Fetait, tashmë Lëvizja ka informuar mbar opinionoin e gjërë të botës myslimane të Medhhebit Hanefi.

Shaqir Fetai është dashur të falënderojë dhe ta festojë këtë vërejtje të Lëvizje Myslimane për Reforma dhe jo të mbajë inat dhe qëllimisht, edhe më tej, ta trajtojë Medhhebin Hanefi si "sekt"! Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI në RMV i fton të gjithë intelektualët myslimanë të vendit, sidomos, profesorët, hoxhallarët, që të ushtrojnë trysni dhe ta korrigojnë këtë gafë të pafalshme, ndryshe, nga java tjetër Këshilli do të jetë e detyruar në aktivtete më të forta dhe më konkrete!

Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI në RMV/

Shaban Aziri, kordinator

Eset Shaqiri, zv/kordinator

Mirdi Brao, zv/kordinator

/1KlikLarg/10.08.2021

Shaqir Fetai në rolin e “viktimës” së pushtetit që e instaloi në krye të BFI-së

Jo një herë është konstatuar se, Shaqir Fetai vuan nga kompleksi i më të madhit, më të ndikueshmit dhe më të veçantit! Ndërsa nuk vlenë sa një metalik teneqeje! Është më i padituri, më i ligu, në aspekt kombëtar dhe fetar, si dhe më hipokriti

Nga Ibrahim Osmani

Shaqir Fetai, këto ditë paska takuar përfaqësues nga Meshihati i BFI-së të Serbisë, i cili vepron nën ombrellën e Rijasetit të Sarajevës.

Arsyeja e kësaj vizite është e pashpjegueshme, madje edhe nga vetë delegacioni prej Serbisë, si dhe përfaqësues nga institucionet fetare islame të Preshevës.

Nga pala mysafire, thjesht, janë arsyetuar se, kemi pasur një ftesë nga “reisi” Shaqir Fetai për ta vizituar “Rijasetin” e tij dhe, kaq. “Shpresojmë që të nisim bashkëpunimin në mes të institucioneve

tona fetare”, ka thënë një prej pjesëtarëve të delegacionit nga Serbia!

Shaqir Fetai ka theksuar se “biseduam për problemet me të cilat përballet të dyja bashkësitë fetare dhe shkëmbyem eksperiencat tona në tejkalimin e pengesave dhe udhëheqjen e bashkësive islame përkatëse.”

Vetëm lexojeni me kujdes këtë fjali të demagogut të tipit të Shaqir Fetait!

E para: cilat janë ato probleme me të cilat përballet “rijaseti” i tij! Më herët, kur ishte në krye të Rijasetit H. Sulejman ef. Rexhepi, kurrë nuk ia përtonte që t’i theksojë një nga një problemet, të cilat kryesisht vinin nga politikat ditore të qeverive maqedonase! Shaqir Fetai tani nuk ka probleme nga kjo qeveri, ndonëse çdo ditë ia regjistrojnë nga një “bashkësi fetare, ia marrin nga një xhami duke e shndërruar në “muze”, në “nevojtoare publike”; në lagjen Aerodrom i ke dhjetra kisha bashkëkohore, ndërsa një kilometër më tej, në lagjen shqiptare Lisiçe nuk lejohet ndërtimi i një xhamie; moskthimi i pronave të vakëfit, apo, mos vlerësimi real i pronave me statut politik “pronë e përbashkët” etj. etj.

E dyta: Shkëmbyem eksperiencat tona!!! Po çfarë eksperience na paska Shaqir Fetai në krye të “rijasetit” përveçse ato të pritjeve dhe përcjelljeve të “delegacioneve” që i fton për t’ia uruar detyrën e re të dhuruar nga pushteti maqedonas dhe për ta përshëndetur e për t’i dëshiruar jetë të gjatë e shumë suksese! Cilin aktivitet të rëndësishëm ua ofron si “eksperiencë” palës tjetër, e cila, duket të jetë shumëfish më e sinqertë, më e devotshme, më e organizuar se sa Shaqir Fetai! Shaqir Fetai do të ketë pasur mudësinë t’ua ofrojë vetëm eksperiencën e tradhëtisë si dhe të komplotit, eksperincën e kapjes së pushtetit të një Institucioni fetar për të cilën nuk është i denjë as në rolin e “portirit”! Mbase nuk u duhet eksperiencia e Shaqir Fetait në shkeljet e Kushtetutës së BFI-së sa herë t’i kujtohet atij! Krejt në fund, këta përfaqësues të këtij Meshihati, nuk kanë nevojë për kurrfarë eksperience të Shaqir Fetait, sepse, ata e kanë eksperiencën e “kibles” së tyre, Rijasetit të Sarajevës! Ata, mund t’i ofrojnë eksperiencë Shaqir Fetait, se si të kalojë në Meshihat dhe t’i drejtohet asaj “kible” të Sarajevës, ku Shaqir Fetai ka filluar nga eksperiencat më të turpshme për njerëzimin – ndjekjen policore të shokëve të studimit! Me Shaqir Fetain mundet që BFI-ja e RMV-së të bëhet pa kurrfarë problemi “meshihat” i Rijasetit të Sarajevës, siç e pranuan këtë “kible”, disa “hoxhallarë”

të Luginës së Preshevës, me pretekstin se nuk dëshirojnë ta njohin Rijasetin e Serbisë! Po ç'lidhje kanë me Rijasetin e Bosnjës? Pse nuk e njohin "rijasetin" e Kosovës, të Maqedoonisë, të Shqipërisë, apo, pse nuk veprojnë të pavarur, por i bëhen "tabi" Rijasetit të Sarajevës! Një eksperiencë e këtillë do të ishte shumë e dëshirueshme nga ana e Shaqir Fetait dhe ky lutet që kjo të bëhet realitet, sepse, të paktën, do të lehtësohej dukshëm nga problemet financiare. Ky nuk është mësuar të mbledhë e të menaxhojë, por, të vjedhë e të zhvasë!

E treta: "Në tejkalinin e pengesave në udhëheqjen e bashkësive islame përkatëse"?! Këtë problem e ka vetëm Shaqir Fetai dhe, këtë problem kurrë nuk do ta mund ta tejkalojë, nuk do ta shohë asnjëherë atë film të "udhëheqjes së rehatshme të BFI-së", sepse, e ka kapur me tradhëti, me pa meritë dhe duke i rrejtur bashkëpunëtorët e vet. Për këtë pisllek Shaqir Fetai është shumë i vetëdëshëm, prandaj edhe e ka brenjë se si ta udhëheqë sa më lehtë e pa pengesa këtë Institucion ku u instalua si "projekt kic" falë pushtetit aktual maqedonas, i cili nuk ka kurrfarë pikëtakimi me islamin. Duke i shërbyer këtij pushteti, Shaqir Fetai i humbë pikëtakimet me realitetin dhe, këtu është ajo pengesa kryesore që atij ia ngatërron këmbët dhe, vetëm pritët kur të bie hyndë e buzë e të përsheshet si pijanec i taposur. Shaqir Fetai është shumë i vetëdëshëm se, ashtu siç erdhi ashtu edhe do të ikë!

Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Rijaseti i Bashkësisë Islame të Serbisë më 22 tetor, 2019, në selinë e Rijasetit të BFI në Shkup, kanë nënshkruar Memorandumin e bashkëpunimit. Në emër të BFI të RMV Memorandumin e ka nënshkruar Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi, Kryetar i BFI të RMV, ndërsa në emër të Rijasetit të BIS, Reis'ul-Ulema h. Sead ef. Nasufoviq. Memorandumi ka një hark kohor realizimi dhjetorin e vitit 2021.

Shaqir Fetai pa e përmbyllur bashkëpunimin me Rijasetin e Serbisë, pa i njoftuar se më nuk do të bashkupunoj me ta, njofton se do të bashkëpunon me një bashkësi tjetër islame të Serbisë! Dhe, çka tash, hajde të pijmë nga një kafe, më uroni "që jam zgjedhur reis" dhe, ikni! Mjafton të bëhet një faqe lajmë i mbushur me emrat e shoqëruesve të "kryeparëve" si dhe 25 fotografive, ndërsa dy fjali të dëshmojnë se ka gatishmëri për "shkëmbim të eksperiencave"!/Lajme7/11.06.2021

Sot, e vetmja sfidë e BFI-së është Shaqir Fetai

Shaqir Fetai na infomon se qenka nisur për në Zvicër, te shqiptarët e përmalluar, bashkë me “drejtorin e sektorit për diasporë”, Dr. Selver Xhemailin, si dhe me “kryetarin e OH Hilal”, Fadil Ramadanin. Ai që e kishte fotografuar këtë treshen famoze, paska qenë shefi i kabinetit të “rreisit”. Dhe, nisi axhendën

Nga Sabit Ibrahim

Në një shkrim të titullur LUTJA E NJË HIPOKRITI, të botuar më 22 korrik të vitit 2020, veç të tjerash pata shkruar se si një ditë, Shaqir Fetai, edhe lutjet do t'i llogarisë si aktivitet të tij profesional, madje edhe frymë kur do të marrë do të na informojë se mori frymë, thuase dikujt i plas b... nëse merr apo jo frymë Shaqir Fetai! “Sot u fala në këtë xhami...”, “Sot e fala xhumanë...”, “Sot u luta kështu...” – janë informacione të kota, të poshtra, që vijnë nga një hipokrit, nga një mynafik, nga një i prishur në shpirt. Ajo që është obligim jetik nuk komunikohet! Për shembull, “Sot morra frymë”, pata shkruar atëbotë!

Dhe, sot, u konfirmua ky vlerësim i pagabueshëm për Shaqir Fetain e shkretë! Ai sapo paska mbërritur në Zvicër, axhendën e vet e paska filluar me faljen e namazit të Xhumasë. Vetëm një idiot

mund ta llogarisë axhendë (aktivitet zyrtar) faljen e Xhumasë! Ky ishte titulli i lajmit “famos” që flet për shëtitjet e kota të Shaqir Fetait me honxho bonxhot e vet.

Shaqir Fetai, i bllokuar në të gjitha anët, i marginalizuar si një qefli që vdes për urime dhe përshendetje, ka lutur që ta ftojë, që t’ia mbulojnë shpenzime, edhe pse prej arkës së BFI-së ka nxjerrë para të majme për shpenzime e për mëditje që duhen për këtë udhëtim pa kurrfarë interesi për BFI-në.

Shaqir Fetait i ka shkuar pak mendja që të tallet edhe me mërgimtarët e shkretë që, nga përmallimi, edhe viçat e katundit me iu shku i pranojnë si “pjesëtarë të familjes”! Le të na thotë Shaqir Fetai kush është shoqëruesi i tij, Fadil Ramadani! Zona e Sarajit e njeh si bastorexhi, që rri nëpër vende ku degradojnë madje edhe teologun më të pjekur! Për më tepër, le të pyetet Sulejman ef. Rexhepi se kush është ky farë “alamet” personaliteti! Ne jse, le të tregojë Shaqir Fetai se cilat ishin të arriturat e Fadil Ramadani sa ishte kryetar i Kuvendit të BFI-së? Çka bëri? Sa i mbrojti interesat e BFI-së? Me çfarë përcmimi e vlerësonte Shaqir Fetain! Po ky, Shaqir Fetai, si e bëri “kryetar të OH HILAL”! E para, le të sqarojë a është Organizatë apo Fondacion! A ka Kuvend kjo “Organizatë humanitare”? A ka Statut kjo Organizatë Humanitare! Çka thotë ky statut, kush e zgjedh kryetarin e Hilalit, si zgjidhet ai! Apo, emërohet drejtpërdrejt nga Shaqir Fetai, si ekspert i shkeljeve të të gjitha akteve normative të BFI-së! Si ua prezanton për kryetar të organizatës humanitare njeriun të cilin e ka përzgjedhur dhe e ka emëruar vetë! “Aktiviteti i tij humanitare” përgjatë Muajit të Ramazanit ka qenë për ibret, me rezultate të denja për një hajn dhe për një të pandershëm, që ka mbajtur po atë “linjë humanitare” të pararendësit të tij, te i cili Shaqir Fetai mori praktikën e vjedhjes së ndihmave humanitare!

Me çfarë projekti humanitar do t’ju prezantohet “kryetari” i Hilalit mërgimtarëve tanë! Cili do të jetë motivi i paraqitjes së tij para njerëzve të përmalluar? T’i prekë në shpirt, të manipulojë me përmallimin e tyre dhe, t’ua zhvasë ndonjë frang? Ky është synimi i Shaqir Fetait?

Po atë tjetrin? Drejtorin e sektorit për diasporë? Ç’ne ky sektor? Për ta kontrolluar diasporën? Për ta aktivizuar diasporën? Për ta motivuar në aktivitete fetare diasporën? Për t’ua mbajtur gjallë frymën islame diasporës? Për të organizuar aktivitete të përbashkëta me diasporën? Apo, thjesht, për ta zhvatur diasporën!

Cilat janë obligimet, deyrimet fetare, kombëtare, juridike, ligjore të diasporës ndaj këtij farë sektori manipulativ? Ato shoqata islamike në Zvicër e në Perëndim i nënshtrohen ligjeve të vendit, u nënshtrohen rregullave juridike të shtetit ku veprojnë dhe, as që ka tagër mbi ta ndonjë sektor i “mëmëdheut”! Sektor për manipulim të dyfishtë: të manipulohet popullata autoktone se ne, si BFI, kujdesemi për diasporën tonë dhe, të manipulohet mundësisht, diaspora jonë që, ne, si BFI, mund edhe t’ju detyrojmë në pagimin e taksave fetare, por, më mirë është që të jepni vetë, pa evidencë, aq sa ua do shpirti ju, e sa na mbanë xhepi ne! Kujt t’i jepet? Kush të ndihmohet? Njeriu që në krye të BFI-së vjen si kiç-instalacion nga pushteti maqedonas! Dhe ky mendon se do ta manipulojë diasporën dhe do t’ia krijojnë një atmosferë që ky të përjetojë orgazëm?! Shaqir Fetai mund t’i manipulojë do vendasë të vet, do ish-nxënës të vet, apo, disa ish-medresantë që mallin për këtë vatër mësimore e kanë të pashuar përjetë! Me këtë përmallim manipulon Shaqir Fetai, u imponohet njerëzve si “reis” i cili erdhi me ndihmën e policisë dhe të ushtrisë maqedonase (ditën kur është votuar ai në oborr e brenda BFI-së ka pasur më tepër policë maqedonase se sa votues), i cili del në skenë për të përbaltur një traditë të tërë dhe një histori të gjatë të zgjedhjeve apo emërtimeve në krye të BFI-së e të orrganeve të saj, duke vazhduar pastaj me shkeljet e të gjitha normave juridike të shenjta si për BFI-në ashtu edhe për myslimanët e vendit që e duan jetën fetare institucionale. Shaqir Fetai kësaj “jete fetare” ia ka dhënë vulën e vet dhe kjo do të organizohet vetëm sipas qejfeve të tij, që në fakt janë direktiva të nëntokës së shërbimeve sekrete të huaja.

Shaqir Fetait nuk i ha palla për fenë islame. A thua, çfarë përgjigje do t’i japë mërgatës sonë Shaqir Fetai kur do ta pyesin se Medhhebi Hanefij është Shkollë Juridike Islame apo sekt, siç e llogarit Shaqir Fetai në web faqen e “Bashkësisë Fetare Islame” të veten, përkundër vërejtjeve publike që ia ka bërë oponenca e tij! Shaqir Fetai, demagogu i paparë, hipokriti i llojit të vet, do të mundohet t’u shitet si vlerë mërgimtarëve, do të mundohet të pallamudë “fjalime shkencore” para tyre, do ta luajë viktimën, do ta luajë “trimin” që do të triumfojë mbi të gjitha sfidat me të cilat po përballet BFI-ja, por ama, kurrë nuk do t’ju shpjegojë mërgimtarëve se pse pikërisht Shaqir Fetai sot është sfida më e madhe e Bashkësisë Fetare Islame të myslimanëve të RMV-së./ 1KlikLarg/12.06.2021

Ku ta gjejë turpin Shaqir Fetai?!

Fjala “përrurim” do të thotë inagurim, apo, ceremoni me rastin e fillimit të një vepre, ose, me rastin e fillimit të punës së veprës së mbaruar (një fabrikë, një urë, një qendër tregëtare, një xhami...) Personi që këmbëngulë të bëjë përrurimin në çastin kur futet brenda asaj vepre, ai ose është i çmendur, ose është i kompleksuar, ose është manjak, ose ka mision të caktuar sabotimi. Një person i tillë, duhet të përndiqet e të gjuhët me gurë ngjashëm si “shejtanat në Haxh”

Nga Arslan Osmani

Më 15 shtator të vitit 2018, në Sulgen të Zvicrës, lopatën e parë në gurin themeltar të Xhamisë Buhara e hodhi ish-reisul ulema i BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi, i cili, në këtë përrurim shoqërohej nga myftiu i Gostivarit, Shaqir ef. Fetai, nga myftiu i Tetovës, Dr. Qani ef. Nesimi, nga përgjegjësi për diasporë pranë BFI-së, Dr. Selver Xhemaili si dhe nga shefi i atëhershëm i kabinetit, Muzemil Osmani! Pra, ky delegacion nga BFI-ja, më këtë datë të para tre viteve, përruroi fillimin e punëve të ndërtimit të xhamisë së re e cila do të quhej Xhamia Buhara! Në mesin e një numri të konsiderueshëm xhematlinjësh nga ky vend dhe nga qendrat e tjera zvicrane dhe më gjërë, prezent ishin edhe përfaqësues nga

Bashkësia Islame e Kosovës, nga Bashkësia Islame e Luginës së Preshevës si dhe nga viset e tjera etnike. Pa dyshim, ceremonia u nderua edhe nga përfaqësues të pushtetit lokal zviceran.

Para të pranishmëve fjalë rasti mbajti Kryetari i Bashkësisë Islame, H. Sulejman ef. Rexhepi, i cili vëllezërve nga diaspora iu drejtua me një fjalim joformal, me shumë këshilla e mesazhe të fuqishme që kishin të bëjnë kryesisht me ruajtjen e trungut fetar e kombëtar, me integrim në shoqërinë zvicerane por edhe me ruajtjen përjetë të mallit për vendlindje e për artdhe. Tutje, efendi Rexhepi i ka kujtuar të pranishmit për të qenurit i sinqertë në raport me ata që të ofrojnë paqe e bashkëjetesë, por edhe për të qenë syçelë përballë munafikëve, hipokritëve të cilët nuk kanë rol tjetër përveçse të përçajnë dhe ta dezorientojnë kombin tonë por edhe shoqërinë myslimane në përgjithësi. “Shtëpitë e Zotit janë tempuj që thërrasin në unitet, që e ruajnë unitetin e një xhemati, të një populli. Vetëm në unitet ne mund të jemi më të fortë dhe të përballemi me çfarëdo lloj sfide që përpiqet të na dëmtojë si komb. Në parimet e Sheriatit Islam ka një rregull: aty ku është shumica aty sillet vendimi! Nëpër xhamitë tona gjithkund, pra edhe në diasporë, predikohet islami human, islami i tolerancës, islami i paqes, ju këtu e luftoni çdo gjë të egër dhe të shëmtuar për islamin! Pra, dhuna, esktrimizmi e radikalizmi gjithmonë kanë qenë dukuri të huaja, që nuk i përkasin as natyrës së islamit por as natyrës së shqiptarit dhe, përgjithësisht, myslimanëve. Ne nëse nuk jemi tolerantë, nëse nuk jemi për bashkëjetesë, nëse nuk jemi për solidarizim e ndihmë ndërnjerëzore, atëherë nuk jemi myslimanë! Shqiptarët në Zvicër, që kur janë dyndur të parët tanë në këtë shtet e deri më sot, gjithnjë kanë hasur në mirëkuptim prandaj, përjetësisht duhet të jemi falënderues si ndaj shoqërisë zvicerane ashtu edhe ndaj Shtetit të Zvicrës, i cili me kulturën e vet demokratike gjithmonë ka qenë i barabart për të gjithë qytetarët e vet, si në sferën politike ashtu edhe në atë fetare. Ky shtet kurrë nuk flet për vetëveten, nuk mburret, por, me demokracinë e vet që ua servirë qytetarëve, me sjelljen e vet ndaj nesh, ja pra, na detyron që ne të flasim fjalë miradie për këtë shtet dhe, kjo është forca e këtij shteti demokratik të cilin në çdo hap tonin duhet ta falënderojmë për gjithçka që ka bërë për ne si shqiptarë dhe si myslimanë. Nuk duhet të harrojmë vlerat tona si popull tolerant, që e kultivojmë tolerancën dhe bashkëjetesën tonë ndërfetare, pra, askënd kurrë nuk e dëmtojmë, askujt të keqen

nuk ia mendojmë, por ama, jemi edhe një popull që gjithashtu nuk e durojmë diskriminimin, keqtrajtimin dhe manipulimin. Prandaj, me vlerat tona që i kemi, të dashur bashkatdhetarë, ju ftoj që të integrohemi fuqishëm në shoqërinë zvicerane. Këtë nuk duhet ta kuptojmë si reflektim që vie për shkak të ligjeve e rregullave zvicerane, por, le ta kuptojmë si normë islame, e cila e preferon integrimin! Ju lutem, nuk dua që ju të gaboni dhe integrimin ta kuptoni si asimilim! Unë ju ftoj fuqishëm në integrim por, asimilimi i asnjërit nga ju nuk do të më bënte të lumtur! Unë një jetë të tërë e kalova nëpër botë por, kurrë nuk kam lejuar që të më njollosë asimilimi. Ja, jam krenar që jam shqiptar, jam krenar që jam mysliman. Ky është vullneti i Zotit dhe, kushdo që i kundërvihet këtij vullneti do me thënë që ka problem me Krijuesin e Gjithësisë. Ne, jemi popull shumë paqedashës dhe tepër të gatshëm për bashkëjetesë! Fatmirësisht, këtë vlerë na e ka kuptuar Zvicra, tërë Europa, por edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, ka thënë veç të tjerash Reisul Ulema i BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi, me rastin e përrurimit të hedhjes së gurit themeltar të Xhamisë Buhara në Sulgen të Zvicrës!

Vlenë të theksohet se, pas këtij fjalimi dhe pas apelit drejtuar myslimanëve shqiptarë në Zvicër për ta ndërtuar këtë Xhami, brenda mbrëmjes ndodhi ajo që nuk ishte parë kurrë në historinë e grumbullimit të mjeteve financiare: u grumbulluan 1.184.000 frankë zviceran!

A nuk i di këto fakte mynafiku Shaqir Fetai?

Më 22 mars të vitit 2021, imami i Xhamisë, Ahmet Mehmeti, fali me xhemat namazin e parë në këtë Xhami, me ç’rast edhe mund të thuhet se zyrtarisht u përrurua fillimi i punës së kësaj Xhamie.

A nuk e di këtë fakt hipokriti Shaqir Fetai?

Pse atëherë shkeljen në këtë xhami Shaqir Fetai e interpreton si “përrurim të punës së kësaj Xhamie”? Do me thënë se, deri në këtë moment kjo Xhami nuk ka punuar? Po ata myslimanë që janë falur e lutur? Shaqir Fetai e bën edhe këtë gjë: e mohon tërë islamit që ka ekzistuar para se ai ta vjedhë postin e Reisul Ulemasë! Për Shaqir Fetain nuk ka pasur më parë islam, prandaj dhe, me aq lehtësi ai Medhhebin Hanefi e quan “sekt”? Tash e tutje vetëm “medhhebi Fetai” duhet të llogaritet islam, ndryshe, kurrë nuk do t’i mbulohet aktiviteti i tij prej spiuni të UDB-së nën komandën e oficerit serb Stanko Dragoviqit.

Dhe, shikuar nga ky kënd, a nuk është tradhëti pranimi i

mirënjohjeve prej Shaqir Fetait?

Të pranoshë mirënjohje prej Shaqir Fetait do të thotë t'ia bëshë hallall tradhëtinë!

Të pranoshë mirënjohje prej Shaqir Fetait do të thotë t'ia bëshë hallall komplotin që e realizoi mbi BFI-në sipas skenarit të shërbimeve sekrete si dhe të pushtetit aktual maqedonas i cili kurrë nuk ka pasur ndonjë simpati për shqiptarët dhe për islamin. Të pranoshë mirënjohje prej Shaqir Fetait do të thotë t'ia pranoshë aktin e shndërrimit të xhamisë në kishë e në muze!

T'ia pranoshë mirënjohjen Shaqir Fetait është bashkëpjesëmarrje me sojin e tij në urinim prapa gërmadhëve të Xhamisë së djegur në Prilep!

T'ia pranoshë mirënjohjen Shaqir Fetait është t'ia falësh aktet armiqësore që i kryen mbi vlerat kombëtare, siç ishte rasti i fundit i prishjes së murit të Xhamisë së Dibrës, mur ky që i kishte 100 dritare dhe që u përrua me rastin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

Analistëve u duhet vetëm 5 minuta përqëndrim për të gjetur analogji, veprime të ngjashme përmbajtësore, skenare të përbashkëta, logjikë identike me Vuçiqin e Serbisë që ky i ka në raport me shqiptarët dhe Kosovën. Është i brumosur me këtë mentalitet. Vetëm pesë minuta reflektim dhe, sakaq do të konstatohet se çdo veprim i tyre ka të njëjtin burim që degëzohet njëri në ortodoksi e tjetri në sekt që vepron në emër të islamit./Kombetare/14.06.2021

Premtimet e mashtruesit

Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI

“Ata që nuk besojnë, janë të joshur nga jeta e kësaj bote, prandaj tallen me besimtarët.” (El Bekare, 212)

“Ai (djalli) u premtonte atyre dhe i josh me shpresa, por ato që premtonte djalli, janë vetëm mashtrime.” (En Nisa, 120)

“Me të vërtetë, djalli është armik për ju, andaj vështrojeni si armik! Ai vetëm i josh ithtarët e vet, që të bëhen shokë të zjarrit të përflakur.” (El Fatir, 6)

Shaqir Fetai, i shoqëruar nga honxho bonxhot e vetë, paska përfunduar “vizitën me sukses nëpër qendrat islame shqiptare në Zvicër! Hipokriti, Shaqir Fetai, nënvizon se “paska përfunduar me sukses”!

Po në çka konsiston ky sukses i tij! Çka bëri ai, çka përfitoi Komuniteti Shqiptar Mysliman i Zvicrës prej kësaj vizite të Shaqir Fetait? Çka llogaritë “sukses” nga një vizitë Shaqir Fetai? Qenka mahnitur nga respekti dhe nderi i madh që ia paskan bërë. Shqiptarët gjithnjë janë dhe kanë qenë me respekt e nderime të mëdha, madje edhe për armikun më të madh nëse u ka hyrë përtej

pragut të odës! Pra, Shaqir Fetai paska pritur krejt diçka tjetër! Ka pritur dëbim, siç e meriton, ka pritur ndonjë tëkërlitje të shallit nga shpulla e diasporës, ka pritur ndonjë injorim, por jo, djalli di si të veprojë? A do t'i shkojë kungulli mbi ujë? Shumë shpejt “do të krijohet opinioni” edhe për Shaqir Fetain dhe, askush nuk do të ketë nevojë për arsyetime nëse ia “ngulë” thikën pas shpine. Sepse, në këtë botë, çfarë do të veproshë atë do ta gjeshë!

Dhe, pasi përshëndetet me ta, ai në fb-un e vet ju çon selam: “Shfrytëzoj rastin të shpreh mirënjohjen time të sinqertë për Kryetarin e Komunitetit Musliman Shqiptar në Zvicër Hfz. Mehas ef. Alija për organizimin dhe koordinimin e qëndrimit tonë disaditësh në Zvicër dhe në formë të veçantë për të gjithë bashkatdhetarët për respektin e pashoq dhe nderin e madh. E them me plot bindje dhe përgjegjësi, Bashkësia Fetare Islame është shtëpia juaj dhe do jetë në shërbim të KMSHz dhe bashkatdhetarëve tanë për çdo gjë që nevojitet.”

Askush nuk i beson këtyre premtimeve prej djalli, sepse, që të gjithë e dinë se:

- nuk ka pasur njeri në botë që e ka mburrur aq shumë Shaqir Fetain sa e ka bërë këtë Reisi i tij, Sulejman ef. Rexhepi;
- askush si Sulejman Rexhepi nuk e ka imponuar Shaqir Fetain në mexhlis si “vlerë”;
- askush respekt e nder më të madh se sa Sulejman Rexhepi nuk i ka bërë Shaqir Fetait, me vetë faktin që e ka avancuar në karrierë, deri në myfti;
- askush si Sulejman Rexhepi nuk ia ka mbuluar Shaqir Fetait injorancë, hipokrizinë dhe shpirtprishuninë;
- askush Shaqir Fetain nuk e ka mikluar dhe nuk e ka përgëdhelur më shumë se Reisi i tij Sulejman ef. Rexhepi;
- askush, madje as babai i vetë, askush bre, nuk ka bërë aq shumë për Shaqir Fetain se sa Reisi i tij Sulejman ef. Rexhepi;
- askush Shaqir Fetait nuk do t'ia përgatitë respektin dhe qëndrimin ndër xhemat më shumë se Sulejman ef. Rexhepi...

Për këtë sjellje njerëzore të Sulejman ef. Rexhepit ndaj djallit, ai gjithnjë ka pasur “të siguruar” premtime për përkrahje, respekt e besnikëri deri në frymën e fundit si dhe lojalitet të paluhatshëm nga Shaqir Fetai!

Dhe, çka fitoi në fund Sulejman ef. Rexhepi! Kush doli Shaqir Fetai për Sulejman ef. Rexhepin? Doli tradhëtari i padiskutueshëm, gaca e mbuluar, doli bashkëpunëtori i të gjitha shërbimeve të huaja kundër Sulejman ef. Rexhepit, doli i pabesi dhe i pafytyri më i madh që e paska pasur rreth tre decenie krah të djathtë!

Ky falënderim i Shaqir Fetait vjen për udhëheqësit e KSHZ pasi është bindur se ndikimi, kompetencat dh forca mbi ta është zero; pasi e ka parë që nuk mund t’i shantazhojë me asgjë pasi është bindur se ata kanë qendrat e veta ndaj të cilave, si drejtues, kanë obligime dhe detyrime të veçanta dhe se, nevojat e Shaqir Fetait nuk u bëjnë përshtypje aspak!

Shaqir Fetai thotë: “Më mirë t’i josh ithtarët e mi, që të më bëhen shokë të zjarrit të përflakur, se sa të më braktisin duke ecur rrugës së tyre të ndritshme”!

Si thotë Shaqir Fetai në fund të “mesazhit” të tij?! “E them me plot bindje dhe përgjegjësi, Bashkësia Fetare Islame është shtëpia juaj dhe do jetë në shërbim të KMSHz dhe bashkatdhetarëve tanë për çdo gjë që nevojitet.”

Kurse ajeti 22 i Sures Ibrahim, për premtimet e mashtruesit, thotë: **“Dhe, kur të marrë fund puna, djalli do të thotë: “Vërtet, Allahu ju bëri një premtim të vërtetë. Edhe unë ju premtova, por ju mashtrova. Unë nuk kam pasur kurrfarë pushteti mbi ju. Unë thjesht ju thirra e ju m’u përgjigjët. Prandaj, mos më qortoni mua, por qortoni veten! Unë nuk jam shpëtimtari juaj e as ju nuk jeni shpëtimtarët e mi”!** /1KlikLarg/15.06.2021

Shaqir Fetait i shkuan veshët zhag për toke

Shaqir Fetai, sakaq, me përmirësimin e gabimit trashanik, duke e korigjuar sintagmën “sekti Hanefi” me Shkolla Juridike Hanefi, jep shenja se e ka kuptuar “gjuhën diplomatike” që e përdorën kësaj radhe parijsa e tërë fetare e Turqisë. Zatën, po dëshmohet se Shaqir Fetai nuk kupton pa ia tërhequr veshët sikurse gomarit inatçorë

Në fund të javës së parë të muajit qershor, Shaqir Fetai, i ashtuquajhuri dhe i vetëshpalluri “reis”, (edhe atë falë mbështetjes politike të pushtetit aktual maqedonas), në zyrën e uzurpuar priti një delegacion turk më në krye atasheun për çështje fetare pranë Ambasadës turke në Shkup, z. Mustafa Mesten.

Shaqir Fetai, hipokriti i pashembull ndër botën myslimane, shfrytrëzoi këtë rast dhe e promovoi idenë e tij të pistë e të mëkatshëm. Për ditë me radhë në lajmin e publikur në web faqen e BFI-së dhe nëpër rrjetet sociale ia mbajti emrin atasheut turk, të cilit i paska kumtuar faktin se “Bashkësia Fetare Islame dhe zyrtarët fetarë praktikojnë Islamin e trashëguar gjatë gjashtë shekujve të sundimit Osman, bazuar në sektin Hanefij!” Natyrisht, mosreagimi i këtij atasheu për këtë gënjeshtëri dhe për këtë

ofendim, ka brengosur dhe ka irituar parinë fetare islame të Turqisë, pasi që, mbarë bota turko është informuar me këtë promovim të pistë të Shaqirt Fetait në prezencë të atasheut turk! I menjëhershëm ka qenë reagimi i oponentëve të Shaqir Fetait, Lëvizjes Myslimane për Reforma pranë BFI-së dhe, shërbimet e Shaqir Fetait, kanë zgjedhur trukun e “mashtimit optik”! Kanë përmirësuar gabimin trashanik vetëm në fb-uk e BFI-së, ndërsa jo edhe në faqen zyrtare të BFI-së! Pas kësaj, Lëvizja Myslimane për Reforma ka alarmuar mbarë botën islame për synimet djallëzore të Shaqir Fetait! Jo vetëm djallëzore por edhe ofenduese, sepse Shaqir Fetai gënjenë para turqëve duke thënë se “BFI-ja dhe zyrtarët fetar praktikojnë islamin e trashëguar gjatë gjashtë shekujve të Perandorisë Osmane, bazuar në sektin Hanefij”! Vetëm BFI-ja dhe zyrtarët fetar, ë? Po myslimanët e vendit këtu çka praktikojnë, çfarë feje, çfarë secti?! Kë ofendon Shaqir Fetai i paedukatë! Si tallet me jetëgjatësinë e Perandorisë Osmane nga e cila e paskemi marrur islamin bazuar në “sektin Hanefij”! Dhe, Shaqir Fetai ka menduar se ky ofendim dhe kjo djallëzi do t’i shitet pa u vërejtur dhe me këtë do t’ia taksojë këtë sukses shërbimeve sekrete të huaja.

Po ashtu, dy ditë pas kësaj deklaratë fatale, Shaqir Fetai bën gabimin e dytë të radhës! Pranon në takim një delegacion “fetar” nga Serbia, më në krye dr. Mevlud Dudiçin! Kush është ky? Ky, pra, efendi Dudiçi, më dhjet shkurt të vitit 2015, në cilsinë e kryesuesit të ashkësisë Islame në Serbi do të takohet me ish kryetarit e KMSH-së, Skënder Bruçën, i cili, për shkak të qëndrimeve të tij gjyleniste do të bëhet “kurban” në interes të përforcimit të politikave frytdhënëse ndërmjet shtetit shqiptar dhe atij turk.

Një muaj e dy javë pas këtij takimi, konkretisht më 23 mars të vitit 2015, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, nën patronatin e ish-kryetarit Skënder Bruçaj, do të organizojë një takim ndërkombëtar ku do të bëjë përpjekje të promovohen “filozofia dhe vlerat” e Fetulla Gjylenit!

Po në këtë datë, në Stamboll, nën Patronatin e Dijanetit të Turqisë do të organizohet një takim ndërkombëtar i liderëve fetar të Ballkanit, Evropës dhe të mbarë botës arabe. Këtë konferencë ndërkombëtare do ta përcjellin edhe liderët fetarë shqiptarë, ndërsa do të mungojë vetëm Skënder Bruçaj, i cili, do të mirëpresë

dhe do të organizojë konferencë në dy sesione, më temën “Islami dhe Paqja Globale”!

Në sesionin e parë të moderuar nga nënkryetari i Komunitetit Mysliman z. Ali Zaimi, do të trajtohen temat: “Qëndrimi i Islamit ndaj dhunës dhe terrorit”, Prof. dr. Ihsan Yilmaz; “Islami dhe paqja globale – origjina praktika dhe rrugëdalja”, Prof. As. dr. Ahmet Ecirli; Strategjia e Islamit në ndërtimin e paqes në botë – duke pasur si referencë mendimin e Fethullah Gylen”, Prof. dr. Mohamad Sharkawi; “Dialogu ndërfaqësor, rruga drejt paqes”, Prof. dr. Ambrogio Bongiovani.

Ndërsa në sesionin e dytë të moderuar nga rektori i Universitetit Bedër, Dr. Ferdinand Gjana, do të trajtohen temat: “Respekti ndaj të shenjtës dhe qëndrimi kundrejt mosrespektimit të së shenjtës nën dritën e Kuranit dhe traditës profetike”, Dr. Atakan Derelioglu; “Përfshirja që i bën Islami feve të ndryshme dhe diversitetit të qytetërimeve”, Prof. dr. Sherif Hatim Avni; “Toleranca fetare shqiptare – si vlerë historike dhe virtyt i Republikës Demokratike”, Prof. dr. Gjergj Sinani.

Ndërsa në seancën speciale të moderuar nga Kryetari i Komunitetit Mysliman z. Skender Bruçaj, referuan Resul Rexhepi sekretar i kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Mevlud Dudiç, Kryetar i Bashkësisë Islame në Serbi, Hajrudin Mujkanoviç, përfaqësues nga Bashkësia Islame e Kroacisë!

Këtu edhe do të fillojnë krajetat e kryesisë së kësaj periudhe të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, deri në dorëheqjen e Skënder ef. Bruçajt! Ndërsa me grupin “gjylenist” të Dr. Mevlud Dudiçit turqët nuk u morën shumë, sepse wë moti e kanë të izoluar tërësisht!

Pikërisht këtë Dudiç e priti i ekzaltuar Shaqir Fetai dhe, natyrisht, turqit, do të reagojnë menjëherë, sepse, dy gafe të njëpasnjëshme të Shaqir Fetait do t’i hapnin rrugë edhe gafës së tretë edhe më fatale për myslimanët e Maqedonisë.

Pikërisht për këtë gafe është folur dhe i është tërhequr vërejtja Shaqir Fetait nga delegacioni i parisë fetare të Dijanetit të Turqisë. Shaqir Fetai rrenë kur thotë se u morëm veshë për realizimin e disa projekteve! Nuk është delegacion minor që nuk kërkon publikimin me pompozitet të projekteve. Shaqir Fetai nuk e tha konkretisht asnjë projekt, sepse, në fakt, kanë ardhur vetëm sa për t’ia tërhequr veshët e të ndalojë me talljet në dëm të islamit dhe të myslimanëve të vendit. Shaqir Fetai, sakaq, me përmirësimin e

gabimit trashanik duke e korrigjuar sintagmën “sekti Hanefi” me Shkolla Juridike Hanefi, jep shenja se e ka kuptuar “gjuhën diplomatike” që e përdorën kësaj radhe parijsë e tërë fetare e Turqisë. Zatën, po dëshmohej se Shaqir Fetaj nuk kupton pa ia tërhequr veshët për toke, sikurse gomarit inatçorë./ 1KlikLarg/17.06.2021

Lehtësia e papërbalueshme e hipokrizisë së Shaqir Fetajit

Nuk është shumë me rëndësi se kush e zgjedh, kush janë ata që zgjedhin; nuk janë me rëndësi vlerat njerëzore të atyreve që zgjedhin, as afiniteti i tyre për të vlerësuar se kë po zgjedhin për prijës – me rëndësi për hipokritin është që të prijë, që të jetë i pari, që të ketë të nënshtruar, që të ketë mohues për miq! Hipokriti do të kënaqet vetëm kur **“do t’i japë Allahut dëshmi të qarta kundër vetëvetes.”**(En Nisa’, 144)

Kurani Famëllartë garanton se fundi i Xhehenemit është i rezervuar për hipokritët, si dhe për shoqëruesit e tyre! Ç’trishtim i madh për hipokritët dhe për miqtë e tij – në këtë botë kanë një zemër me shumë sëmundje, të cilat ua shton edhe më shumë Allahu, ndërsa në botën tjetër e kanë të siguruar fundin e Xhehenemit.

Fatkeqësisht **“ata i pret një dënim i dhembshëm për shkak të hipokrizisë së tyre”**, (El Bekare, 10).

Si të dallohet hipokriti prej besimtarit, i keqi prej të mirit, i damkosuri prej të pastrit, i pabesi prej të devotshmit, spiuni pej

kombëtarit? Merreni për model Shaqir Fetain dhe, do të jeni të shpëtuar! Merreni vetëm si model, pa ia dëgjuar kopallat, sepse pastaj përfundoni në po atë rrugë të gabuar!

Shaqir Fetai si Druzhe Tito

Shaqir Fetai, si hipokrit i pashoq në këtë nënqiell, jo vetëm thotë, por edhe urdhëron, madje edhe kërcënon! Të gjithë ata që shkojnë me palën tjetër, me “luftëtarët” që e luftojnë zullimin, padrejtësinë, vjedhjen, zhvatjen, që e luftojnë shkeljen e Kushtetutës së BFI-së që për frymë veprimi ka Kuranin e Shenjtë si dhe Hadithet e Pejgamberit a.s., pra, të gjithë këta i kërcënon me largim nga puna, duke ju thënë **“rrini me ne, sepse me ne as nuk vdisni, as nuk vriteni”** (Ali Imran, 144). Hipokriti, duke mos e duruar një pikëllim të tillë, e shton vigjilencën e vet, duke tentuar që ta luaj “Zotin”, të jetë ai “mbikëqyrësi”, të mos i dalë asgjë kontrollit që do ta kthente situatën nga e mbara. Sepse, kur të kthehet situata nga e mbara, hipokriti e prek fundin e Xhehenemit!

Një dhjetë ditësh përplotë me cirkuziadë e Shaqir Fetait! Ia mundësoi Zoti që ta dëshmojë hipokrizinë e vet, që t’i japë Allahut Fuqiplotë dëshmi të bollshme kundër vetëvetes! Gjithandej gënjeshtër, gjithandej vetëlavdërime, gjithandej, rrahje gjoksi, gjithandej mohim i së vërtetës, gjithandej duke lozur rolin e viktimës si dhe frymëmarrje duke personalizuar çdo sukses nga e kaluara ku ai nuk ka qenë veçse një qenie e dobët që ka vegjetuar, ngjashëm si mushkonjat mbi pleh!

Hipokriti, nga nevoja e flaktë për t’u dëshmuar si “vlerë”, i shpallë luftë edhe Zotit Fuqiplotë, i cili është Garantues i së vërtetës, i së mirës, i së mbarës, i drejtësisë, i unitetit përmes miqësisë, i mallkimit të tradhëtisë, të spiunimit, të hajnit!

Hipokriti, soji i Shaqir Fetait, ka nevojë që ta imitojë “Druzhe Titon”, t’i krijohet atmosferë madhështore, ta presin me lule, ta presin pionerët dhe jo vegjëlta, sepse, në mesin e vegjëlta mund të dalë edhe dikush që të pështynë në ballë, prandaj, urdhëron që të pritët me fëmijë, të manipulojë me ta duke kërkuar prej tyre që ta madhërojnë, ta duartrokin, ta presin me lule, ta vështrojnë si “zotin”, t’i zbrazë të gjitha mektebet dhe talebet t’i nxjerrë në trotualet e pritjes. E, pse hipokriti i sojit të Shaqir Fetait, dekorimin e mizanskenës, skenografinë, nuk mund ta paramendojë pa fëmijë të vegjël? Sepse, vetëm ata mund t’i manipulojë, pa llogaritur se kjo është e dënueshme me ligj, e palejueshme, e patolerueshme,

nuk ia ka ngenë ligjit, sepse e bën vetë, sepse ligji është me të, sepse ai vetëm duhet të jetë kundër asaj të cilën e urren ligjbërësi (kundër fesë islame)! I nxjerr fëmijët, mundësisht sa më shumë vajza, sepse kjo qenie e brishtë, është vetë lulja më e bukur e botës, e mrekullon skenografinë, ndaj duhet të jetë në pritje (nuk ju duket ky “virtyt” si i pedofilëve)!

Udbashët në pritje të delegacionit

Delegacioni turk ishte, pa dyshim, me ajkën e intelegjencies teologjike turke, secili më i zoti se tjetri, ndërsa u pritën nga dudukët e llojit të Shaqir Fetait si dhe nga honxho bonxhot e tij! Me kë e priti Shaqir Fetai këtë delegacion! A i tregoi delegacionit turk se të gjithë janë puthadorë, sahanëlëpirës, që kanë vjedhur sa kanë mundur, që akoma presin “kurbanë” që të vjedhin! A u tregoi turqëve Shaqir Fetai se, honxho bonxhot e tij marrin rroga, dhe nuk kundërshtojnë, nga shitja e vakëfit, nga tjetërsimi i vakëfit, nga bonot në vlerë që jepen për sigurim të vakëfit? Nuk i tregoi se në mesin e tyre ka zinaxhinjë, ka bixhozxhinjë, ka të falsifikuar, me tituj të blerë “shkencor”, me diploma të blera, të falsikuara; ka nga ata që i shajnë turqët, ka nga ata që e kanë sharë në prani të Shaqir Fetait, Presidentin Turk, z. Erdogan! A i tregoi se ka edhe gylenistë, titistë, marksistë, satrapë, piratë, sektashë, udbashë, të gjithë nën xhybe e nën shall! Pash besën a i tregoi se si ua vjedhin ndihmat humanitare që për çdo vite e çdo Ramazan turqët vëllezër ua dedikojnë myslimanëve të varfër në Maqedoninë e Veriut! A u tha turqëve që mos të investojnë për momentin për nevoja të BFI-së, sepse ky Institucion është i politizuar deri në gabzher dhe i bledëizuar deri në qykë!

“Shumë xhami të reja të Periudhës Osmane”

“Shaqir Fetai i priu” gjithkund (madje edhe në wc) delegacionin turk! Ky është më i madhi, më i dijsلمي, më i bukuri, më i miri, më trimi, sepse vetëm ky soj mund të prijë, të tjerët vetëmsa mund ta ndjekin, ta pasojnë! Tani, Shaqir Fetai, kokrra e injorantit, i prinë delegacionit turk, që përfaqsojnë një shtet me nja 10 milion intelektualë të kalibrit më të lartë, një shtet me qindra universitete private e publike, një shtet me miliona teologë secili më kapacitet se Shaqir Fetai! Dhe, ky plesht, ky morr i p... do t'i prijë dikujt?! Paramendoni sikur delegacioni turk të kërkote që të vizitojnë shtëpinë e Shaqir Fetait në Çegran! E dini se si do ta bënë këtë lajm?! Shaqir Fetai i priu vizitës së delegacionit turk në shtëpi të

vet!!! Këtu tashmë bien të gjitha maskat e hipokritit, pavarësisht se kush e demaskon!

Ishte më i madhi i ulemasë, prijësi i intelegjencies turke në rrafshin teologjik dhe, Shaqir Fetai nuk arriti që t'ia tubojë “hoxhallarët e vet”, “prtofesorët e vet”, në një sallë të madhe, në xhaminë më të madhe të vendit, për ta ndjekur ndonjë ligjeratë të mysafirit vëlla turk, për të përcjellë mesazhe të vyera e të dobishme!

Shaqir Fetai nuk arriti që t'i tubojë të gjithë organet e veta dhe të ulen në një sallë me delegacionin më të lartë turk dhe t'i shpalosnin të gjitha projektet jetik për myslimanët e vendit dhe për zhvillimin e jetës fetare islame në vend!

Shaqir Fetai, në mungesë të personalitetit dhe të autoritetit të vet, në mungesë të vizionit dhe të programit konkret, në mungesë të platformës dhe të projekteve konkrete, nuk arriti që delegacionin më të lartë turk ta takonte me “digasterin” qeveritar për fe dhe grupe religjioze, bashkartisht të ngrisinin zërin kundër padrejtësive që u bëhen myslimanëve si dhe islamit në vend!

Hipokriti Shaqir Fetai mburrej me projektin e huaj, siç ishte “Xhamia e Tophanes”, ndërsa nuk diti t'i përgjigjet pyetjeve të prijësit të delegacionin turk se a është marrë mendim i komunitetit, a është marrë pëlqimi i tyre, a është marrur kërkesa e tyre për një Xhami të tillë gjigante në një hapësirë miniaturale, ku as mizat nuk mund të marrin frymë! Ka qenë kërkesë e banorëve të kësaj lagje apo ka qenë “projekt politik” në këtë hapësirë me xhami më të madhe në vend e me parking për nja dhjetë bicikleta?! Nuk pati as përgjigje për vonesën kaq të madhe të ndërtimit të këtij objekti, por ia la fajin Koronavirusit, thuase gjatë kësaj kohe nuk janë ndërtuar me qindra godina në Maqedoninë e Veriut.

Hipokriti i llojit të Shaqir Fetait mundohet të manipulojë duke thënë se “mysafirët nga turqia u mrekulluan kur panë përgjatë rrugës Shkup-Tetovë-Gostivar-Kërçovë-Ohër, xhami të vjetra e të reja të periudhës Osmane!” Xhami të reja të periudhës Osmane??? Në këtë relacion gjithçka mund të shohësh përveçse xhamive të vjetra të Periudhës Osmane!

Minarja nuk futet në thes

Pse Shaqir Fetai nuk e mori delegacionin e lartë turk dhe nuk e çoi te vendi i Burmalit Xhamisë, t'u tregojë se çka po bëhet aty, në atë vend ku dikur ishte xhamia më e bukur e Periudhës Osmane?

Pse Shaqir Fetai delegacionin turk nuk e çoi te Xhamia e Prilepit,

një prej më të bukurave të Periudhës Osmane dhe ta shikojnë se si Shaqir Fetai e mbanë si “wc publike” për të gjithë ata që e urrejnë islamin në këtë nënqiell!

Pse Shaqir Fetai nuk e mori delegacionin turk dhe ta çonte pak në Manastir, te Jeni Xhamia, nga më madhështoret e Priudhës Osmane dhe ta shikonin se si Shaqir Fetai po ia falë Kishës e këta po e shndërrojnë në muze, në institucion nacional maqedonas?!

Pse Shaqir Fetai nuk e dërgoi delegacionin turk në Shtip, që ta shikojnë se si njëra prej xhamive më të vjetra në Ballkan është shndërruar në Kishë e që hapet vetëm për “Ilinden” sa për të ndezur qirinj!

Delegacioni turk kësaj radhe ishte “pa protokol”, ishte nën “hyqmin” e Shaqir Fetait i cili iu priu aty ku deshti vetë!

Delegacioni turk veprroi kështu vetëm sa për ta testuar hipokrizinë e Shaqir Fetait, sa për t’i matur përmasat e kësaj hipokrizie që nuk i gjenë në asnjë skaj të botës, sa për ta peshuar përgjegjësinë e Shaqir Fetait, të cilën tërësisht e ka këmbyer me hipokrizinë e banorit të fundit të Xhehenemit! Ky raport do të përfundojë në arkivin e Dijanetit turk, sepse, ata, nuk kanë ardhur për të parë se ku mund të investojnë, nuk kanë ardhur që të hulumtojnë terren për projektet e tyre por, ata kanë pritur vizione, përgjegjësi dhe interes të ulemasë së Maqedonisë së Veriut.

Erdhën, panë, ikën! Me gjasë, nuk hasën në asnjë ulema, por, vetëm në puthadorë dhe në hipokritë unikatë në hapësirat ballkanike! Të bëhesh mik e bashkëpunëtor i Shaqir Fetait nuk ka mëkat më të madh, sepse i jepet jetë tradhëtisë, spiunimit, pabesisë, hipokrizisë.../Lajme7/08.06.2021

Shaqir Fetai vizitoi pjesën perëndimore të Maqedonisë së Veriut

Pas një “vizite historike”, të cilës i priu “reisi” Shaqir Fetai, më në fund kemi një “fotoreportazh”! Një fjali, shumë informacione mbi shumë më shumë budallallëqe të ndodhura nga një “rijaset” që është tërësisht në aut

Nga Alban Qamili

Këto ditë kam qenë vizitorë i shpeshtë i web faqes së Bashkësisë Fetare Islame të Shaqir Fetait, nga kërshërija për ta përcjellë “turin turistik” të Kryetarit për Çështje Fetare (Dijanet) të Turqisë, Ali Erbash, me bashkëpunëtorët e tij, pasi që mbi këtë vizitë agjencioni turk për informim “Anadolu Agency, informoi vetëm njëherë, vetëm ditën e parë të takimit të Shaqir Fetait dhe z. Erbash.

Maskarallëk! Turp! Mjer Instiitucioni ku ka batërdisur, ku ka përfunduar. Tërësisht në duart e injorantëve, të hipokritëve dhe të

amatorëve të një shoqate entuziastësh. Shaqir Fetai, duke dashur të tregohet mikërpitës i mirë, duke dashur të tregohet si shumë i rëndësishëm në vend, duke dashur të përdiftohet si tepër i rëndësishëm, harron se e ka informuar botën se e “kanë zgjedhur reis” dhe se, ai tashmë nuk është në rolin e ciceronit që t’i presë mysafirët dhe t’i shoqërojë deri në ikje të tyre, në çdo vrimë e në çdo skutë! Sepse, paralizohet puna, paralizohen aktivitetet, paralizohet axhenda e bazuar në një plan aksional, apo, ku i merr vesh këto punë Shaqir Fetai, ky posllushnik që kur u bë me “imenden” që i përket ORAO-s!

Shaqir Fetai me dy këmbë ka hyrë në historinë e BFI-së

E fundit që më ra në sy, në navigimin nëpër web faqen e BFI-së së Shaqir Fetait, ishte një titull “Fotoreportazh nga vizita historike e kryetarit të Dijanetit në vendin tonë”! A e dinë bilemzat e BFI-së së Shaqir Fetait se çka do të thotë “fotoreportazh”! Si shkruhet, si bëhet, si përgatitet fotoreportazhi! A është gazetari apo album përkujtese?! ”Fotoreportazh” me 130 fotografi, pa kurrfarë teksti shoqërues letrar apo gazetaresk! Fotoalbumi është fotoalbum kurse Fotoreportazhi është zhanër gazetaresk që ka mënyrën e vet se si përgatitet!

Po mirë, a e dinë këta honxho bonxhot e Shaqir Fetait se kujt i thonë “Vizitë historike”? Kur e merr një vizitë epitelin “historike”? Kur një vizitë e merr karakterin e “historikës”? Kur një ngjarje bëhet madhështore duke i marrur përmasat e të gjitha ngjarjeve historike! Apo, ia kanë futur kot, vetëm sa për ta bërë “historik Shaqir Fetain”? Shaqir Fetai ka hyrë në historinë e BFI-së për shumë ngjarje, nuk ka nevojë që të ndodhë një vizitë i një delegacioni të huaj! Shaqir Fetai tashmë është “historik”, sepse, është i pari dhe i vetmi që ka ardhur në krye të BFI-së i instaluar nga një pushtet politik i cili nuk ka lidhje me islamin; Shaqir Fetai tashmë është “historik”, sepse vjen në krye të BFI-së pas një tradhëtie dhe një komploti historik, të pandodhur më parë, askund në rajon e më gjërë; Shaqir Fetai tashmë është “historik” sepse është unik, i pashembullt e i papërsëritshëm në shkeljen e të gjitha akteve normative të BFI-së gjatë instalimit të vet në krye të BFI-së! Jasht këtyre “ngjarjeve historike”, çdo ngjarje tjetër Shaqir Fetain e shpërftyron në karikaturë të shpifur!

Shaqir Fetai si “lajm”

Përcillni këta tituj: “VIZITA E KREUT TË BFI DHE DIJANETIT NË TETOVË”, “REISUL ULEMA DHE KRYETARI I DIJANETIT VIZITUAN STRUGËN”, “VIZITA E KRYETARIT TË BFI DHE DIJANETIT NË OHËR”, “REISUL ULEMA I PRIN VIZITËS TË KRYETARIT TË DIJANETIT NË MYFTININË E GOSTIVARIT”, “REISUL ULEMA DHE KRYETARI I DIJANETIT VIZITOJNË INSTITUCIONET EDUKATIVO ARSIMORE TË BFI”, “REISUL ULEMA H. HFZ. SHAQIR EF. FETAI PRITI KRYETARIN E DIJANETIT PROF. DR. ALI ERBASH”...

Sipas këtyre titujve idiotikë, lajm përbën Shaqir Fetai, i cili, i shoqëruar nga Kryetari i Dijanetit, paska dalur në vizitë nëpë pjesën perëndimore të Maqedonisë së Veriut! Del puna që, Shaqir Fetai, paska pasur një axhendë të cilën mezi paska pritur që të vie z. Erbash për ta realizuar! Kurse interesimi i Kryetarit të Dijanetit për t’u njohtuar me situatat e ndryshme nëpër të cilat po kalojnë myftinitë e vendit, pas puçit klasik të ushtruar në BFI, del në planë të dytë, del fare i parëndësishëm, nuk përbën lajm, sepse, lajm përbën “lëvizshmëria” e Shaqir Fetait nën shoqërimin e Kryetarit të Dijanetit!

Po, mund të thuhet se kjo vizitë ishte historike pikërisht për shkak të budallallëqeve të Shaqir Fetait, i cili, deri në palcë është i frikësuar, i cili përjetë nuk u zë besë organeve të veta, të cilat tashmë kanë eksperiencën e tradhëtisë, i cili, ua njeh kapacitetet hipokrite, “intelegjente” dhe tradhëtuese, prandaj, asnjë vizitorë nuk mund të takohet sy më sy me ta pa qenë prezent aty edhe vetë Shaqir Fetai! Ai, edhe përkundër prezencës së tij në çdo “skutë”, është i zhgënjyer se nga fakti se ish-reisi i tij, H. Sulejman ef.

Rexhepi, është njohtuar në hollësi me të gjitha ndodhitë përtej asaj që ka informuar “shërbimi” i Shaqir Fetait, edhe pse, kësaj radhe, njerëzit e Sulejman ef. Rexhepit i ka mbajtur sa më larg mysafirëve, jashtë “komisionit” pritës dhe shoqërues!

Shkon Putini në Amerikë, pritet nga Bajdeni dhe, pas takimit prej gjysëm ore apo prej një ore, është i lirë në realizimin e axhendës së vet, të dalur nga harmonizimi i protokolove ndërshtetërore. Putini mund ta vizitojë krejt Amerikën dhe, gjithkund pritet, eventualisht, nga guvernatorët dhe, gjithandej shoqërohet nga ekipi special i caktuar për realizimin e një vizite zyrtare. Bajdeni nuk lëviz nga zyrja, sepse ka punët drejtuese të shtetit, të cilat nuk guxojnë të

ngecin për asnjë sekond, qoftë kjo edhe për hirë (hatër) të Putinit. E bëmë këtë digresion sa për t'ia përkujtuar Shaqir Fetait se, me këtë rast, e paska dhier fare punën! Para delegacionit të lartë fetar turk, qenka treguar me aspak besim në bashkëpunëtorët e vet, qenka treguar përtac në punët drejtuese, qenka treguar pa njohuritë elementare të protokoleve dhe të axhendave të një vizite zyrtare, qenka treguar i paedukatë dhe pa kurrfarë respekti për pagën që e merr prej djersës së myslimanëve të vendit. Delegacionit fetar shtetëror turk është dashur t'i imponohet pak axhendë edhe nga problematikat tona të vendit dhe të dërgohet edhe në pjesën Lindore të Maqedonisë së Veriut për ta parë gjendjen e mjerueshme të pjesëtarëve të islamit si dhe të objekteve fetare islame, dhe jo për ta shëtitur në pjesët që paraqesin mrekullira të llojit të vet! Sepse, vendi prej nga vie ky delegacion ka aq shumë mrekullira islame sa, vështirë të gjendet një mbi mesataren që gjenden në Shtetit Turke! Ata sikur kishin ardhur për ta ndihmuar islamit dhe BFI-në! Xhamia e Larme, ajo në Ohër, në Strugë, në Gostivar e në Kërçovë, nuk kanë nevojë për ndihmë turke, sepse janë në gjendje shumë të mirë dhe pa kurrfarë problemi të natyrave politike, me “mëlmesa” të radikalizmit dhe ekstremizmit antiislam! Apo, edhe kjo dukuri Shaqir Fetait i duket “mrekulli e llojit të vet”!

Ku mbeti hajni i punëve të jashtme dhe i organeve të brendshme

Shaqir Fetai me shumë pompozitet flet se në kuadër të BFI-së ka bërë “reformë” duke e hapur një tezgë të cilën ai e quan “sektor për mardhënënie me jashtë (OSBE, NATO, BE) dhe me organet e brendshme” (organe të brendshme mund të jenë edhe mëlçia, zorra e trashë, pankreasi, bolet etj.)!

Pra, Shaqir Fetai ka një “ministër për punë të jashtme”, i cili dikur ishte kryeytar i vetëshpallur i OH HILAL të cilën e zhvati dhe e vodhi deri në palcë. Tani vetëm e spostoi dhe, Mustafa Dautin, na e bëri drejtor të “sektorit për punë të jashtme dhe për organe të brendshme”! Po ky farë “drejtori” pse nuk ishte në ballë të delegacionit, pse askund nuk i priu delegacionit, pse askund nuk e shoqëroi delegacionin, pse tërë ky aktivitet ishte jashtë axhendës së tij të punëve të jashtme! Apo, me mizën nën kapuç, Mustafa Dauti

nuk ka fytyrë t'ju dalë përpara turqëve. Po çka nëse i kishin kërkuar raporte, apo arsye pse nuk ka dorëzuar asnjë raport për asnjë ndihmë që ka ardhur nga Turqia e që i është lënë si amanet për myslimanët e varfër të Maqedonisë së Veriut!

E di Mustafë Dauti që është shpallur nga ana e turqëve si armik i ndihmave humanitare, ndaj dhe nuk ka fytyrë që t'ju dalë përpara. Këtë punë e di edhe Shaqir Fetai, ndaj dhe nuk ua nxjerr në pritje, si “ministër i jashtëm”! Me këtë gjest, edhe vetë Shaqir Fetai pranon se në mesin e bashkëpunëtorëve të vet ka njerëz të dyshimtë, të korrumpuar, të komprometuar, plehëra! Dhe, me tërë këtë bagazh bërrologjesh Shaqir Fetai pret dhe shpreson në ndihma nga jashtë, shpreson në një perspektivë të mbarë të jetës fetare islame të drejtuar prej tij? Edhe hipokrit edhe mysliman? Këtë nuk e pranon Zoti Fuqplotë! Hipokritët janë pa shpresa, janë pa perspektivë, janë lehtësisht të lakuriqësuar, djallëzia e tyre është tepër transparente, kështu që, nëse i bëjnë qejf vetes, të paktën, mos të mendojnë se këto llokuma i hanë edhe myslimanët e vendit! Në këtë botë, Zoti i Madhërishëm, ia ka caktuar “vendin historik” Shaqir Fetait – në margjina të faqeve të historisë së zezë të shqiptarëve dhe të myslimanëve të vendit, kurse, për në botën tjetër, me aq sa kam njohuri nga Kurani, vendi i tij është fundi i Xhehenemit, nëse nuk pranon që të pendohet për hirë të Allahut Mëshirëplotë dhe të kthehet në rrugën e drejtë!

Nuk do të mund të gjendet asnjë delegacion nga asnjë cep i botës që do të mund ta shpëtojë nga ndëshkimi i Zotit Fuqplotë! Edhe “hafëz” edhe hipokrit?! Mëkat nga mëkatet më të mëdhenj!/Kombetare/19.06.2021

A mbushet ujë me sitë

Njëqind mijë marifete po i bëjnë dhe, assesi nuk po kuptojnë se, lideri nuk bëhet, ai lindë, me yllin e vet, ai që ec drejt asaj rruge që ia ka përcaktuar Zoti. Një lider që ka ecur rrugëve të UDB-së, ai përfundon spiun, pavarësisht përgatitjeve profesionale, pavarësisht mirënjohjeve që do t'i marrë në jetë si rrjedhojë e intervenimeve të oficerëve të UDB-së për ta imponuar bashkëpunëtorin e tyre

Nga Osman Bekteshi, Preshevë

Këtu, në Preshevë, patëm një manifestim me rastin e përcjelljes së gjeneratës 2017/2021, të medresantëve të Preshevës, mbajtur në Shtëpinë e Kulturës “Abdulla Krashnica”! Organizimi ishte i denjë për t’u shënuar, pa dyshim, nga të gjitha mediat kombëtare. Dhe u shënuar në shumë media, por, ajo që nuk po e kuptoj ishte publikimi i këtij aktiviteti në fb-un zyrtar të Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut.

Aty e pashë edhe një informacion të kotë! Nuk i ka hije kjo një Institucioni serioz, nuk di kush ua organizon piarin por, ata duhet të dinë se çka është aktiviteti, çka është informacioni i përgjithshëm, ku botohet njëri e ku tjetri! E paskan publikuar faqen zyrtare të Dijanetit ku paskan shkruar për vizitën e Kryetarit të Dijanetit në Bullgari, në Shkup e tash edhe në Kosovë. Natyrisht që do të shkruajnë, sepse vizita është aktiviteti i Dijanetit,

dhe jo aktivitet, bie fjala i BFI-së. Pritja është obligim, madje mund të jetë edhe detyrim, në raste të caktuara, por assesi nuk është aktivitet!

Tjetër, aty i pashë edhe do ngushëllime, do urime, do përkujtime! Të gjitha këto në faqen zyrtare të BFI-së? Edhe këto i llogarisin për aktivitete? Sepse, në faqen zyrtare publikohen aktivitetet, njohtimet dhe lajmërimet që kanë të bëjnë ekskluzivisht me Institucionin. Ndjenat personale, emocionet, përshtypjet, dhimbjet – të gjitha këto le t'i publikjë Shaqir Fetai në fb-un e vet dhe jo në faqet oficiale të BFI-së, sepse, do të bëheni lëndë e kritikës nëpër punimet shkencore të personave që merren me shkencën e komunikologisë, me piarin e me mediat! Ju qenkëshit bërë model më qesharak që kam hasur ndonjëherë nëpër rrjetet sociale dhe nëpër poralet shqiptare!

T'i kthehemi manifestimit! Mbrëmë shumë preshevarë u ndjenë krenarë, shumë prindër u nderuan nga fëmijët e tyre, u respektuan nga Bashkësia Islame e Preshevës, me këtë manifestim për fëmijët që mbaruan medresenë! Me këtë rast pati edhe mysafirë, nga Shkupi e njoha prof. Jusuf Zimerin, thanë që paska qenë edhe një tjetër, kumanovar, por, sikur nuk u ndje shumë, e pashë për një moment edhe në skenë por, nuk ia mësova emrin! Dhe, natyrisht që kjo vizitë është dashur të shënohet te fb-i profesor Jusufit, sepse, sado pak vizita e tij në Preshevë është aktivitet i tij personal!

Për t'u bërë puna berbat, për t'u dhjerë fare, ishte momenti kur organizatori kishte vendosur t'i japë një mirënjohje Shaqir Fetait, për të cilin tashmë krejt bota e di se ka qenë bashkëpunëtorë i oficerit të UDB-së, Stonko Dragoviqit, nën pseudonimin policor ORAO (shih linqet:

<https://almakos.com/dokument-bashkepunetor-i-cilit-sherbim-eshte-kreu-i-bfi-se/>,

<https://fol.mk/bashkepunetor-i-cilit-sherbim-eshte-kreu-i-bfi-sedokument/>

<https://kohanews.com/opinione/dokument-bashkepunetor-i-cilit-sherbim-eshte-kreu-i-bfi-se/>

Pse këtë mirënjohje? Sepse disa ditë më parë tek ai ishte udbashi tjetër, Mevludin ef. Dudiqi, i cili mbase edhe ia ka premtuar një mirënjohje, në shenjë të kontributit të Shaqir Fetait për Medresenë e Preshevës!!! Dhe kështu u nda kjo mirënjohje – në shenjë mirënjohje për kontributin e Shaqir Fetait për Preshevë! Shaqir Fetai as që e di se kah i bie Presheva! Dhe as mos të niset në Preshevë se nuk do të gjejë trajtimin më të madh se të një qeni të zgjebosur!

Me mirënjohje fallce, me mirënjohje të kurdisura e të porositura, nuk mund të mbulohet aktiviteti prej spiuni! Lider lind kurse spiun bëhesh. Shaqir Fetain nuk e ka lindur Zoti “lider”, ndërsa rrugës për zhvillim islam personal, ai zgjodhi edhe një rrugicë që përfundon në UDB. Këtu merr fund aktiviteti i tij fetar islam. Çdo përpjekje e tij për t’u dëshmuar si hoxhë, si hafiz, si lider, ai në fakt mundohet të përçojë mesazhin se, ja, nuk është keq që të jeshë udbash, sepse, ky mund të shpaguhet në fund nga UDB-ja! Mund të bëhesh edhe “reis”!!!

Nuk e kam të qartë kush i manipuloi organizatorët që kishin ndarë mendjen t’i japin mirënjohje Shaqir Fetait, për të cilin, në krejt Preshevën i bëhet fjala si për një udbash. Kontributi i tij për medresenë e Preshevës është zero. Prandaj, udbashët le t’i mbajnë duart sa më larg institucioneve fetare të Preshevës dhe mos t’i ndotin ato duke defiluar udbashët poshtë-lafhtë, sepse, ka përfunduar koha e tyre! Janë jashtëzakonisht të lexueshëm dhe të lakuriqësuar tashmë deri në palcë! Uji nuk mbahet në sitë, as dielli nuk zihet me shosh. Kot e kanë udbashët!/Kombetare/21.06.2021

Bujrum në “odë” të Shaqir Fetait

Me pritje e përcjellje Shaqir Fetai nuk mund ta maskojë të kaluarën e vet të zyrtë; me pritje e përcjellje Shaqir Fetai nuk mund të dëshmojë se sa i dashur që është për miletin; me pritje e përcjellje Shaqir Fetai nuk mund të demonstrojë aftësinë, shkathtësinë, urtësinë, e as “leadershipin” e vet që i ka me deficit falimentues; me pritje e përcjellje Shaqir Fetai mund të na përçojë isharete se sa i kompleksuar që është, madje me komplekse, fatkeqësisht, të pashërueshme, ilet ky që i ka hyrë qysh si student kur filloi të përgatisë raporte policore për shokët e vet të studimit

Nga Vesel Qamili

Kishte qenë një “mixhë”, i cili, në kohët rankoviqiane ishte futur në ujërat e turbullta të UDB-së serbe. Kishte marrur detyrë që të kontaktojë sa më shumë njerëz, katundarë dhe, për të gjithë të raportojë! Ky mixha e kishte pasur një nip dhe i thotë që, tërë ditës të rrijë te dera e oborrit dhe të gjithë kalimtarëve të rastit t’u thoshte “bujrum në odë të mixhës”! Bujrum, bujrum, bujrum një ditë, bujrum një ditë, u bënë si tepër shumë “bujruma”! Iku pranvera, iku dhe vera, vjeshta e erdhi dimri i acartë! Gratë e shtëpisë vendosën që t’i hynë mixhës në odë dhe ta bëjnë për pesë lekë! I vajtën në odë dhe ia numëruan të gjitha:

“Ti po thërret njerëz në odë, po kërkon dreka e darka, me ju pjekë kafe e përpeç, po kërkon kunguj e hutina, po kërkon patate të pjekura e grunë të zier! Po ti po harron se të gjitha arat këtë vit i le djerrina, i le pa punuar, nuk mbolle as grunë, as misër, as zahire nuk ka në shtëpi, e çallëmin në kupë të qiellit”, iu ankuan gratë. Mixha ju tha grave: “Që nga momenti kur ngela pa fytyrë, nuk më intereson shtëpia. Fytyra më iku, tash po e ruaj bythën!”

Shaqir Fetai nuk mund ta ruajë fytyrën e patrajtë! I ka ikur motiii! Me pritje-përcjellje vetëm sa po e dëmton Bashkësinë Islame, vetëm sa po e dëmton buxhetin dhe perspektivën e saj. Sepse, pritje-përcjelljet e kota janë humbje e kohës kot e kot! I paska pritur një grup mjekësh nga Turqia të cilët “paskan pasur qejf të njohtohen me Shaqir Fetain”! Qejf i madh! Cili është ai qejf që të njohtohesh me Shaqir Fetain? Çfarë bereqeti është ky farë “reisi”! Cila qenka fama e tij që të keshë qejf ta njohtoshë? Po pse ta shprehin këtë qejf! Kush ju foli për Shaqir Fetain që ia paskan shtuar qejfin për t’u njohtuar! Mjekët kanë qejf të njohtojn e të rrinë vetëm me persona profesionalë përkatës: mjeku me mjekun, mekaniku me mekanikun, spiuni me spiunin...

A ka më turp se sa të bëshë informatë se “reisi e priti vëllain e nëpunësit të vet”! Madje paska qenë aq shumë i njohur sa i paska themeluar të gjitha qendrat islamike në Perëndim. Ndërsa kurrë askush nuk ia ka bërë llafin! Nëse paska qenë kaq faktor i rëndësishëm ai duhet të jetë i sigurtë që ka ardhur ta vizitojë përcjellësin-spiunin e vet të dikurshëm për të cilin ka raportuar kthinave të Temellko Boshkovskit!

Turpi arrinë pikun kur të raportoshë se e pate në vizitë shokun tënd. Ku është këtu aktiviteti? Ku është këtu lajmi? Ku është këtu dinamika e veprimit institucional! Thjesht u takuan një “reis” dhe një “oponent” i tij që ka një qendër islamike, për të cilën çdo vit mbledh fitra e zeqat, duke i ndërhyrë buxhetit të Medresesë ku dikur ishte drejtor!

P.s.

Zoti e shpërbleftë me xhenet Mulla Mahmud Asllanin! Në punën e vet ishte GJENERAL sepse nxorri një ushtri të tërë hafizlerësh! I dashur, i respektuar e i nderuar prej popullit, por jo dhe prej Institucionit të BFI-së! Çka bëri ky Institucion për Mulla Mahmud Asllanin! Mos ia krijoi INSTITUCIONIN për së gjalli? Mos ia krijoi kushtet e nevojshme? Mos e ndihmoi materialisht, moralisht, shpirtërisht? Mos e lartësoi emrin e tij me emërtim të ndonjë rruge,

të ndonjë institucioni, të ndonjë parku nacional! Mos e nderoi me ndonjë titull nderi, me ndonjë titull akademik! Mos e ndihmoi në përgatitjen e ndonjë doracaku mbi metodologjinë dhe mjeshtrinë e nxjerrjes së hafëzlerëve të rinj!

Në një tekst ngushëllues të Shaqir Fetait, lexohet edhe kjo fjali: “Isha krenar”! Sigurisht dëshiron të thotë se ishte krenar me Mulla Mahmudin! Por sa ishte krenar ai me një “hafiz” bashkëpunëtor i UDB-së?!

Të të ngushëllojë udbashi është më rënd se plumbi në ballë, prandaj, bën mirë Shaqir Fetai që mos ta aktrojë të alivanosurin nga dhimbja e një humbje të madhe, sepse, Shaqir Fetat kurrë nuk i ka hëngër b... për hoxhallarët, teologët, hafizlerët! Këtë e ka dëshmuar edhe që nga momenti kur i vë në shërbim të lojës së luajtur nga shërbimet sekrete për ta tadhëtuar dhe për t’i bërë komplot njeriut që më së shumti ka merita për të kaluarën jo shumë të largët të lavdishme të Bashkësisë Fetare Islame në RMV! Shaqir Fetai është bërë për t’u ngushëlluar dhe jo për të publikuar ngushëllimet e veta bajate.

Sot Shaqir Fetai është dashur që mos të zhvillojë kurrfarë aktiviiteti, kurrfarë duaje hifzi apo hatmeje. Është dashur t’i tubojë të gjithë hafizlerët e Mulla Mahmudit, madje edhe më gjërë dhe, për shpirt të tij të këndonin disa hatme! Asnjë aktivitet, asnjë sukses madhështor i Shaqir Fetait nuk mund të matet me humbjen kaq të madhe që e patën sot myslimanët e Maqedonisë së Veriut, humbën Gjeneralin hafëzlerëve të vendit! / 1KlikLarg/22.06.2021

Gjarpëri duhet goditur në kokë

Shaqir Fetai ka nisur të sillet si ai... dhe gomari! Sa t'i lëmshë aq më shumë ngrisin kokën! Tani më që janë në prag zgjedhjet lokale, Shaqir Fetai e ka të garantuar tërë përkrahjen ligjore, mbështetjen partiake dhe simpatinë e pushtetit, vetëm të sigurojë vota, të kordinojë aktivitetet fetare me ato partiaket! Halli është që Shaqir Fetai nuk ka as aktivitete, as që di të kordinohet dhe as që mund të sjellë qoftë edhe njëqind vota! Nuk e bën hesap askush! Taksirati ta marrë më qafë BDI-në dhe LSDM-në (edhe Besën)

Nga Vedat Sulejmani

Shaqir Fetait po ia merr mendja se po i vijnë pesë minutat e tij! Tani pushteti aktual, në veçanti partia që e instaloi në krye të BFI-së (BDI), do t'i gjunjëzohet dhe do t'ia kërkojë ndihmën e fitores! Nëse Shaqir Fetai ka mbetur që t'ua sigurojë fitoren ndonjë partie, atëherë, është shumë më mirë, madje edhe sepas i madh që, automatikisht të zhduken nga skena politike, sepse, përjetë do ta mbajnë nishanin e partisë së formuar dhe të përkrahur nga UDB-ja!

Kur të kërcënon pisi

Studentët e Universitetit të Tetovës, përkatësisht, të Fakultetit Juridik, paskan kryer një hulumtim, rezultatet e të cilit i paskësh prezantuar profesiroi i nderuar Dr. Bashkim Selmani! Studentët paskan hasur edhe në anketues të cilët kanë dhënë përgjigje se janë rjepur nga BFI-ja, gjegjësisht nga Ndërmarrja e saj për shërbime mortore, Er Rrahatu, me rastin e shërbimeve që i kanë kryer për të vdekurit nga Koronavirusi! Ndonëse ligji i paskësh obliguar t'i kryejnë shërbimet pa kurfarë pagese, BFI-ja dhe ndërmarrje të ndryshme mortore i paskëshin dyfishuar çmimet!

Akoma pa e hulumtuar mirë rastin BFI-ja, akoma pa i marrur në pyetje “shërbyesit” e Er Rrahatuse, akoma pa i marrur përgjigjet e anketave të studentëve, i kërcënohen profesorit të nderuar, Dr. Bashkim Selmanit, duke i kërkuar ose ta demantojë ose BFI-ja të drejtën e vet do ta kërkojë në rrugën ligjore, dmth do ta padisë. Ja edhe një rast për përfituesit e mjegullës , “ratni profiteri”, të cilët mezi presin ngritje të procedurave gjyqësore për t'u pasuruar vetë, për ta rjepur arkën e BFI-së, paratë e fitrit, sepse, çdo seancë gjyqësore paguhet, çdo dalje e avokatit nga dera e shtëpisë së vet paguhet majmë dhe, avokatët e tillë mezi presin të gjejnë “sekserë” që do t'ua përgatisin terrenin për procese gjyqësore. Ja një temë për studentët e profesor Bashkim Selmanit: pse BFI-ja ka procese më të shumta në Gjykata, sa para kanë shpenzuar deri më tani dhe sa lëndë kanë fituar deri më tani! Si është e mundur që të shpifet vetëm për BFI-në që këta pastaj të ngrisin procedura gjyqësore!

Shaqir Fetai t'i kërkojë falje publike Dr. Prof. Bashkim Selmanit

Shaqir Fetai duhet të dijë se, në opinion flitet për matrapazllëqe të tmerrshme që i bëjnë “shërbyesit” e Er Rrahatuse dhe, asnjëri deri më sot opinionin i gjërë nuk ka folur qoftë një fjalë më të vogël për profersorin e nderuar të Universitetit të Tetovës! Nuk mundet që Shaqir Fetai t'i ketë engjëj nëpunësit e vet, ndërsa “djalli” na qenka Prof. Bashkim Selmani! Turp!

Edhe diçka? Çka i duhet Rijasetit ky “organ” meqë “drejtori” i saj është anëtarë Rijaseti! Pse në çdo qytet, përkatësisht, Myftini, ka Ndërmarrje për shërbime mortore, kurse vetëm në Shkup ka Rijaseti dhe jo Myftinia e Shkupit! Në rastin konkret po del puna se kjo “ndërmarrje” po punon për xhepin e dikujt në Rijaset, ndërsa

sikur të ishte ndërmarrje e Myftinisë do të ishte në shërbim të besimtarëve dhe myftinia tërthorazi do të kishte evidencë për numrin e të vdekurve brenda xhemateve të veta! Apo edhe për këtë vjedhje fajin e ka Profesor Bashkim Selmani! Të paditet një profesor i nderuar nga një udbash i pacipë, ky po që është kulmi i idiotësisë! Nga ky qorrsokak Shaqir Fetai mund të dalë vetëm nëse do të kërkont falje publike ndaj profesorit duke ia forcuar këtë falje publike me dëshminë e masave ndëshkuese ndaj të pafytyrëve që mundohen ta nxijnë një profesor duk i mbrojtur spiunët që hasen nëpër dosjet e politikanëve tanë patriotë.

Magjistricat në “log të burrnisë”

Cila është iniciativa, cila është ideja, apo, cili është roli, ndikimi, cili është kontributi, qoftë edhe virtual, i Qenan Ismailit, këtij farë myftiu bre, që “doktoron” në turizëm, apo në llojet dhe në përgatitjet e peshkut! Po i Shaqir Fetait? Çka e lidhë Shaqir Fetain me xhaminë e vjetër të Arnaqisë! Cila nostalgji e ka prekur atë farë “kryetarin” e OH Hilal, Fadil Ramadanin, apo, ç’kujtime dhe ç’nevojë ka Fejsall Kadriu, i mendermethëshmi “kryetar” i Kuvendit të BFI-së! Këta absolutisht nuk i lidhë asgjë me xhaminë e vjetër të këtij Fshati, kurse Kryetarin e Sarajit, Blerim Bexhetin, po, e lidhin, zgjedhjet a ardhshme lokale dhe, tashmë është koha që në sa më shumë aktivitete të BFI-së të prezantojë dhe të promovohet si kandidat i sërishëm i BDI-së për këtë Komunë. Pra, të gjithë këta emra që u nënvizuan më sipër janë në shërbim të Blerim Bexhetit, i cili, nuk i ka hyrë kot e kot punës që ta qetësojë Sulejman Rexhepin pasi që këta hafije ia bënë komplotin, duke ia ngulur thikën pas shpine. Njohësit e mirë të këtyre personaliteteve të diskutueshëm, përfshirë këtu edhe Sabahudin Mahmutin, i lidhë vetëm një gjë! Çuditërisht i lidhë vetëm një gjë që tashmë është i kodifikuar në gjakun e tyre dhe, si i tillë le të ngelë “misterioz” për opinionin e gjërë, por, i zbërthyeshëm për ata që i njohin këta persona që manipulojnë në emër të xhamive!

Katundi që ka nevojë për xhami, formon këshillin iniciativ, formon këshillin e tubimit të ndihmave vullnetare, formon komisionin e mbikëqyrjes së punëve dhe, nuk ka nevojë për pompozitet, as për reklama, as për piar politik, sepse, xhamitë shërbëjnë për t’iu lutur të Madhit Zot.

Shaqir Fetai dhe xhamitë si dhelpira dhe kurthet

Kurse Shaqir Fetai thotë: “Xhamitë i ndërtojnë, meremetojnë, mirëmbajnë, vetëm ata që e kanë imanin e paluhatshtëm në Allahun Fuqplotë”! Ky konstatim ia pamohueshëm, sa herë që del nga goja e Shaqir Fetait, del si jargë e hipokritit! Ta thotë këtë Shaqir Fetai, është ngjashëm sikur peshku në fund të detit të thotë “ma shtroni sofrën se kam uri”!

Dihet se cili është raporti i Shaqir Fetait me xhamitë! Shaqir Fetai mendon se islami ka nisur që kur ai u instalua në krye të BFI-së dhe, në tre deceniet e fundit sa ka shërbyer në BFI, ka qenë në periudhën e xhahilijetit!

Cili është reagimi i Shaqir Fetait, si teolog, për vënien e kryqave në objektet sakrale të ngritura përsëri xhamive nëpër qendra të mëdha e që kanë shërbyer për ta shënuar kohën e namazeve!

Cili ka qenë reagimi personal i Shaqir Fetait, si teolog, për kryqin e milineumit në Vodno!

Cili ka qenë reagimi personal i Shaqir Fetait për rrënimin në themel të xhamisë në Orahovec në rrethinën e Koçanit!

Cili ka qenë reagimi personal i Shaqir Fetait, si teolog, si profesor medreseje, si myfti, si anëtarë Rijaseti, për djegien e xhamisë në Prilep më vitin 2001!

Cili ka qenë angazhimi disident i Shaqir Fetait në rikthimin e Burmalit Xhamisë në vendin e vet të mëparshëm!

Cili është reagimi i Shaqir Fetait, “si reis”, i kapjes së Jeni Xhamisë, i shndërrimit të saj në Kishë dhe tashmë në institucion nacional maqedonas, në “muze”!

Cili është reagimi i Shaqir Fetait, si “kryesori” në BFI për uzurpimin e Xhamisë së Usamedin Pashës në Shtip dhe shndërrimin e saj në kishë!

Cili është roli i Shaqir Fetait në shembjen e Avllisë me 100 dritare, të Xhamisë në Dibër, e cila u inagurua me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë të Shtetit Shqiptar!

Ndërtimi i Xhamive, që nga gurëthemeli, që nga ajo pikë gjaku e kurbanit që derdhet në themel, e deri në përfundim të saj, është meritë e këshillit iniciativ, e këshillave të tjerë ndihmës të katundit si dhe e mbarë katundarëve të vendit dhe të rethinës, madje edhe e mërgimtarëve dhe, eventualisht, e shqiptarëve nga Turqia! Shaqir Fetai nuk e jep asnjë cent nga xhepi i vet, nuk e vë asnjë tullë në murin e xhamisë, sikundër as edhe shoqëruesit e tij, kështu që, asnjëri nuk ka nevojë të pajiset me “merita” inekzistente! Është turp, është mëkat! Të dhishë edhe në atë parti politike që paska nevojë për sigurim të votave nga Shaqir Fetai e nga Qenan Ismaili. Nëse është parti udbashësh po, ndërsa nëse është parti kombëtare, atëherë le të dalë me platformë e cila duhet t’i përndjekë, madje, edhe udbashët, dhe jo ta presë ndihmën për senërtim prej udbashëve! /Lajme7/24.06.2021/

Si i vjedh hoxhallarët Shaqir Fetai

Me paratë e hoxhallarëve të Maqedoniosë së Veriut, Shaqir Fetai do të bëjë qejf, do t'ua rrisë rrogën atyreve që do ai dhe, do t'i ndëshkojë të gjithë ata hoxhallarë që ai i kategorizon si “hoxhallarë të Mulla Sulës” dhe “hoxhallarë të Afrim Tahirit”! Për të tillët nuk ka rroga nga “buxheti social” i rialokuar i Qeverisë

Nga Halit Hasani

Një vit e gjysëm më parë, bota u përball me një tragjedi të tmerrshme! Shpërtheu një pandemi nga një virus i panjohur më herët, Covid 19. Mori miliona jetë, u infektuan dhe u tmerruan miliona të tjerë! Tani jemi në fazën e “tranzicionit”, në etapën postkovidiane, ndërsa bota po i gëzohet vaksinimit masiv. Brenda një viti u zbulua vakcina, ndonëse në variante të ndryshme. Deri te ky vaksinim masiv, i vetmi “ilaç” ishte mbajtja e distancës fizike, maska dhe shpëlarja apo dezinfektimi i duarve.

Natyrisht, kjo masë mbrojtëse, ndikoi në ndryshimin e sistemit të të jetuarit, të të vepruarit e të të punuarit! Edhe puna dhe veprimet profesionale bëheshin nga distanca, edhe mësim, madje edhe lutjet! U mbyllën të gjitha faltoret, të të gjitha komuniteteve fetare ku lutjet kryheshin në grupe.

Shteti, qeveritë e shteteve të ndryshme, ndërmorën masa finansiare për t'i dalur në ndihmë biznesit por edhe punëtorëve. Në këtë periudhë, doli edhe një kërkesë shumë humane e ish-reisul ulemasë së BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepit! Ai insistont që nën nëpunës të përfshiheshin edhe hoxhallarët të cilët shërbejnë nëpër xhami e që ishin mbyllur me kërkesë të komisionit qeveritar për shëndetësi.

Ndihmoheshin ndërmarrjet e vogla, të mesme e të mëdha, ndihmohej turizmi, ndihmoheshin organizatat e ndryshme, ndihmohej biznesi dhe projektet e ndryshme. Qeveria bëri disa herë rialokimin të buxhetit vetëm e vetëm që sado pak ta zbusë krizën e shkaktuar nga pandemia e Kovid 19-tës.

Natyrisht, pas insitimit permanent dhe publik, pas shumë takimeve të Sulejman ef. Rexhepit me qeveritarë të ndryshëm, qeveria vendosi që në kategorinë e subjekteve që do të ndihmohen finansiarisht, me nga një rrogë mesatare, prej 14 mij denarëve, të jenë edhe hoxhallarët, pra, imamlerët, vaizët, myezinët, mualimët, do të përfshihen në kategorinë e përfituesve të ndihmave të qeverisë. Kurse Qeveria, kush e di se pse, kurrë nuk tregoi publikisht se edhe teologët e vendit janë kategorizuar si çdo shtresë që duhet t'i prekë ndihma sociale e buxhetit të shtetit.

Do të ndodhë puçi dhe komploti në BFI, do të largohet Sulejman ef. Rexhepi, kurse vendimi i qeverisë do t'i nënshtrohet kërkesës këmbëngulëse të efendi Rexhepit! Vetë, Shaqir Fetai, do të dëshmojë publikisht se, deri më sot, Qeveria e Maqedonisë së Veriut, e ka ndihmuar BFI-në pesë herë. Do me thënë, po kaq herë janë ndihmuar edhe bizneset, ndërmarrjet, organizatat, nëpunësit, turistët, personat e kulturës, shkurt, të gjithë ata veprimtaria e të cilëve u prek nga pandemia.

Në këtë veprimtari të Qeverisë, ku demonstronhet sinqeriteti në zbatim të vendimeve, i pasinqertë del vetëm Shaqir Fetai. Ai

pranon se po ndihmohet nga Qeveria por, nuk po tregon se ajo ndihmë është në rroga për nëpunësit e mbi 700 xhamive që u mbyllën për muaj të tërë për shkak të pandemisë. Ky farë matrapazi nuk e tha asnjë fjalë falënderimi për efendi Rexhepin i cili arriti që me këmbënguljen e tij prej lideri të papërkulur t'ua sigurojë hoxhallarëve rrogat për aq kohë sa u mbyllën xhamitë.

Ç'bëri Shaqir Fetai me këtë buxhet të rialokuar për BFI-në me destinacion të qartë – rroga për imamlerët, për hoxhallarët! Cilit hoxhë i dha rrogë nga kjo ndihmë?

Shum fakte flasin se Shaqir Fetai e luajti një lojë shumë të rrezikshme, shumë të poshtër dhe shumë të ulët, përmes të cilës mundohe t'ua ulë dhe t'ua nëpërkëmbë dinjitetin hoxhallarëve. Shaqir Fetai tashmë hoxhallarët i ka të kategorizuar në “hoxhallarë të Mulla Sulës”, në “hoxhallarë të Afrim Tahirit” dhe në “hoxhallarë të Shaqir Fetait”, të cilët, ndonëse nuk janë as 10 për qind, pikërisht ky grup hoxhallarësh arriti që ta gëzjë ndihmën e qeverisë aktuale, kurse “hoxhallarët e pa bindur”, nuk e gëzuan ndihmën! Se si do të raportojë, cili do të jetë raporti narrativ e cili raporti financiar i Shaqir Fetait deri te Qeveria, kjo ngelë të shihet më vonë por, e vërteta e vetme është se, nga ato ndihma qeveritare rroga mori një grup i vogël hoxhallarësh, kurse pjesa tjetër e buxhetit u shpenzua për udhëtime, për shëtitje të b..., për përgatitje e përzgjedhje të dekoratave e të mirënjohjeve si dhurata prej “reisit”, si dhe për mëditje të Shaqir Fetait dhe të të dëgjueshmëve të tij!

Me paratë e hoxhallarëve të Maqedoniosë së Veriut, Shaqir Fetai do të bëjë qejf, do t'ua rrisë rrogën atyreve që do ai dhe, do t'i ndëshkojë të gjithë ata hoxhallarë që ai i kategorizon si “hoxhallarë të Mulla Sulës” dhe “hoxhallarë të Afrim Tahirit”! Për të tillët nuk ka rroga nga buxheti i rialokuar i Qeverisë!

Kjo padrejtësi do të jetë “kafshatë e përditshme” për hoxhallarët e vendit përderisa ata do ta durojnë pisllekun e Shaqir Fetait, përderisa ata nuk do të rrebelohen dhe nuk do t'ia kërkojnë deri në cent të fundit atë që u takon atyre për shërbimet fetare që i kryejnë. Po çfarë shërbimi fetar kryen Shaqir Fetai me honxho bonxhot e vetë ndërkohë që paguhet “debello”, aq trash sa, nuk ka sevap që mund t'ia marrë anën dhe ta ngris tasin e haramit në terezinë që mat veprat e mira dhe të këqiat!

Vërtetë, për këtë periudhë sa Shaqir Fetaj gjendet i instaluar nga qeveria aktuale maqedonase në krye të BFI-së, cila vepër e tij mund të llogaritet e mirë?! Asnjë, sepse, vetë ai është harami më i trishtë që i ka ndodhur BFI-së!/Fakte/26.06.2021/

Të jeshë “i sinqertë” në vjedhje

Shaqir Fetai mund të krahasohet me atë hajn i cili, vjen te dera, i bie ziles, del zonja plakë të cilës i thotë: e dashur, jam hajn, erdha t’ju plaçkis, ju lutem, më leni rahat të vjedh dhe të dalë qetë, pa dhunë e përdhunim! Do të kaloni lehtë edhe ju edhe unë

Nga Saqip Sinani

Shaqir Fetai ka lëshuar një apel nën moton “DHURO KURBANIN TËND NË MEDRESENË ISA BEU”! Vjedhje tipike e hajnave të qetë dhe shumë të frikshëm, të atyre hajnave që, në rastë se u del përpara, ata, për plaçkën e vet, janë në gjendje të ta vjedhin edhe jetën! Do me thënë – hajn kriminel!

Nën këtë moto, shtohet teksti hipokrit i Shaqir Fetait: na i sillni nga 120 euro se ne ua blejmë kurbanin dhe ua therrim për nevojat e medresesë, pjesa tjetër u dhurohet nevojtarëve!

A e di Shaqir Fetai se sa është ajo nevojë e Medresesë Isa Beu për mish? Sa është nevoja e fukarave në vend për mish!

Sa mish u tubua vjet për mensën e Medresesë Isa Beu, ku shkoi ai mish, sa u shpenzua nga nxënësit!

Pse tallet Shaqir Fetai me kurbanët e myslimanëve të vendit. Çka do të bënte Shaqir Fetai sikur sivjet myslimanët të organizuar t'ia dorëzonin në Medrese nja 10 mij kurba të gjallë? Unë dua ta dhuroj kurbanin tim ekskluzivisht për nxënësit e Medresesë, atëherë, pse të shkojë mishi im te dikush tjetër! Pse të specifikohet për “Medresenë Isa Beu” dhe të përfundojë madje edhe te ata që do ta përdorin “meze me raki”! A na garanton Shaqir Fetai se nuk ka në BFI njeri i cili në emër të gazetarëve të Maqedonisë, i çon në shtëpi nga 100 pako me nga 10 kg mish kurban! Pastaj, a po kërkojmë kurba për Medrese apo për gazetarë (ekskluzivisht për ata gazetarë që vihen në shërbim të hajnisë, dilentantizmit dhe hipokrizisë së Shaqir Fetait!)

A ka raportuar Shaqir Fetai se sa para u mblodhën në Rijaset, sa nëpër myftini dhe sa në Medrese! Po pse ato para të mblidhen në Rijaset, po pse nëpër Myftini, kur, apeli është DHURO KURBANIN TËND NË MEDRESENË ISA BEU!

Vjedhje sipas rregullores

Hajni e pastër, tallje me kurba të myslimanëve, zhvatje e djersës së të devotshmëve! Çdo tubim pa transparencë është vjedhje e pastër, është krim, vepër penale, pa dyshim!

Tubojnë myfninitë, pastaj ato sa të duan paraqesin në Rijaset!

Të gjithë myslimanët e vendit e dinë se Medresja ka nevoja të shumta, përveç mishit. Le të tregojnë se sa para do të ngelë nga secili kurban i paguar, le të tregojnë se si do të shpenzohen ato para të mbetura. Le të jenë edhe transparent në tubimin e mjeteve për kurbanë të paguar. Le ta cektojnë një tavan të nevojave, medresja ka nevojë brenda një viti për 20 ton mish, dhe, kur të mbushet kjo kuotë do të ishte shumë korrekte dhe normale, shumë humane dhe islamikisht në rregull që t'ju thuhet myslimanëve se, kurbanit i tyre do të shkojë për fukara, sepse, nevojat e Medresesë u përmbushën!

“Fondi i zi” i Shaqir Fetait

A janë haram ato para që vidhen prej myslimanëve në emër të Kurbanit? Çka i duhen paratë haram Shaqir Fetait? Paraja haram

është para e “fondit të zi”, një fondi nga i cili paguhen njerëzit haram, njerëzit e kotë, ata që nuk kanë kurrfarë lidhje as me fe e as me njerzillëk! Fond i zi që sigurohet nga paratë e kurbanit, nga fitri e zeqati! Turp e trishtim!

Shaqir Fetai paguan njerëz, madje edhe “funksionarë të BFI-së” të cilët kurrë nuk shkojnë në punë, ndërsa nuk guxon të ndërmarrë masa disiplinore kundër tyre, sepse, menjëherë do të hidhërohen shërbimet që e instaluan në krye të BFI-së, si dhe të tjerët që mund t’ia shpalosin të gjitha të bëmat idiotike e të pista që i ka kryer përgjatë këtyre tridhjetë viteve të karrierës së tij të diskutueshme.

Shaqir Fetai ka punësuar njeri, madje me rrogë të majme, puna e të cilit është që t’i përcjellë “llajkat”, të shikojë se kush nga nëpunësit e BFI-së u jep “llajka” shkrimeve kritike dhe me qëndrime opozitare nëpër dhjetra portale, të cilat po e lakuriqësojnë deri në palcë Shaqir Fetain! I shkreti mendon se, kështu më lehtë do t’i gjuajë të gjithë ata që janë “me ne” dhe “me ata”! I shkreti, nuk e ka idenë se shkrimet nuk bëhen për “llajke”, shkrimet janë informacion, informacioni lexohet dhe “arkivohet” në tru, dhe, për këtë gjë, nuk ka nevojë as edhe për një “llajk”! Shkrimet lexohen, krijojnë opinion, e animojnë opinionin dhe e mbajnë në vijën e duhur, në rastin konkret, e mbajnë në rrugën islame! Në mesin e nëpunësve të BFI-së, ditën që nuk ka shkrime kritike, i kap një shqetësim, një hidhërim, një dëshpërim se pse sot nuk ka shkrim që e zbërthen Shaqir Fetain!

Është jashtë çdo norme islame punësimi i spiunëve, i “llajkaxhinjëve”, punësimi i hajnave, zinaxhinjëve, pisave, bixhozxinjëve, matrapazëve, tradhëtarëve, udbashëve! A ka më trishtim se krejt udbashët të ngriten në këmbë dhe të hedhin gurthemel të një xhamie të vjetër, me një të kaluar përplotë thashetheme që devalvojnë moralin, njerzillëkun, intelegjencien?!

Pse heshtin dëmtuesit e jetës institucionale islame

Shaqir Fetai e ka vjedhë kurbanin, pa dyshim, kështu që, nuk i ka fare hije që të dalë e të bëjë apel për pagim të kurbanit, sepse, automatikisht nënkupton se po hapet oreksi i tij i vjedhjes.

Shaqir Fetai e vjedh edhe diasporën, sepse, pa vetëdije shndërrohet në mekanizëm të shpëlarjes së parave të vjedhura nga ata që tubojnë “kurbanë”! Marrëveshja është “kaq për ju, dhe ju ta heshtni pjesën tjetër, të cilën do t’ua shpërndajmë shoqatave të ndryshme humanitare”!

Kur bie fjala te këto “shoqata humanitare”, pse Shaqir Fetai nuk i kërkon, për shembull, Qenan Ismailit, të dalë ai publikisht dhe të thotë “myslimanë, jepni vetëm për medresenë dhe jo për “shoqata” të tjera të themeluara për ta dëmtuar BFI-në”! Pse nuk del Irsal Jakupi, sekretari i Shaqir Fetait, i cili, punësimin në BFI e kishte të kushtëzuar me mbylljen e FRI-se në Gostivar! Pse nuk del ky farë sekretarice e të apelojë që kurbanit të dhurohet vetëm për Medresenë dhe jo për shoqatat e tjera! Po ai shefi i kabineti të Shaquas, pse ai nuk del e të bërtasë me sa zë që ka “dajo, mjaft e dëmtove Medresenë duke mbledhur kurbanë për Forumin rinor mysliman”! Pse nuk e shfrytëzoi Sabahudin Mahmutin gjatë “takimit epik” që e pati me të dhe të kërkonte prej tij që të apelonte që kurbanët të dhurohen vetëm për Medresenë Isa Beu dhe jo edhe për “qendrën e tij”!

Dilemë për një debat publik

Fatkeqësisht, sivjet nga diaspora më shumë fitra e zeqate kanë përfunduar në duart e “shoqatave myslimane” në vend të cilat funksionojnë absolutisht për vete dhe në dëm të BFI-së, se sa që u dhanë për zhvillimin e jetës institucionale fetare islame në Maqedoninë e Veriut. Po kështu do të jetë puna edhe me Kurbanët dhe, këtë e di Shaqir Fetai, këtë e toleron Shaqir Fetai, këtë e stimulon Shaqir Fetai, sepse, të tillët i ka brenda, bashkëpunon me ta, me këta thurrë plane për të ardhmen personale, sepse, e di që shumë shpejt do t’i duhet t’i mbledhë plaçkat. Dhe ai dëshiron që plaçkat e tij të jenë të kushtueshme dhe kjo arrihet vetëm me paratë e vjedhura.

Shaqir Fetai fenë islame në Maqedoninë e Veriut e ka shndërruar në “sekt” dhe, jo rastësisht ai nënvizon se ne kultivojmë islamin e “sektit Hanefi”! Islami nuk e duron zhvillimin e vet mbi baza të “misteriozitetit”, sikurse sektet e ndryshme, nuk e duron zhvillimin e vet në fshehtësira të denja për botën mafioze, për kriminelët! Islami e do, e preferon dhe e urdhëron transparencën. Islami në zhvillim nuk e do zhurmën, e do planifikimin, paraprakisht të

hedhur në debat, e do mendimin e gjërë, e do depërtimin e informacionit në çdo cep të botës.

Ka ardhur koha që të dëshmojmë se ISLAM do të thotë planifikim, debat, transparencë dhe gjithëpërfshirje! Në “rijasetin” e Shaqir Fetait, në stafin e bashkëpunëtorëve të tij, mund të ketë gjithçka por, vetëm islam jo! Prandaj, a është veprim islam dhurimi i kurbanit për ata që e devalvojnë islamin?

Le të jetë kjo dilemë për një debat publik!/Lajme7/28.06.2021

Shaqir Fetai vuan nga miopia

Me rastin e përfundimit të vitit akademik 2020/21, Medreseja ISA BEU në Shkup u vizitua nga kryehipokriti i hipokritëve të vegjël e të papërfillshëm, pra, nga Shaqir Fetai, i cili si një snob analfabet do të deklarojë: “Kemi punuar bashkërisht për Medresenë, kemi punuar që të prodhojmë kuadro të denja që ta përfaqësojnë me dinjitet këtë nënqiell, e që të jenë konkurrent ndaj gjitha vatrat e dijës dhe me të drejtë mund të konstatojmë se, uniteti ynë është garanci se mund ti tejkalojmë të gjitha barrierat që na dalin përpara drejt avancimit të jetës sonë fetare islame”!!! Dikush kesaj deklaratë prej injoranti të një specie më vete i kishte thënë: “ishte porosia e Reisul Ulemasë H. Hfz. Shaqir ef. Fetai, të hënë më 29.06.2021, drejtuar stafit të Medresesë Isa Beu, në mbledhjen e mbajtur nga Këshilli Edukativo-Arsimor i Medresesë Isa Beu në Shkup, për vlerësimin e vitit shkollor 2020/21”.

Në këtë përçapje fëmijërore ku janë notat e mesazhit? Ku është këtu mesazhi? Pse të pafytyrët apo injorantët mundohen të tallen me opinionin e gjërë, duke u munduar që udbashin ta paraqesin si te urtë, me plotë porosira! Ishin vetëm deklaratë që thuhën në vendin dhe momentin e panevojshëm, që thuhën për vetëmburrje

dhe për të larë m. me sh. Shaqir Fetai “vlerë të këtij nënqielli” i llogaritë edhe ata dhjetra medresantë që u shkolluan në Medrese, me paratë e popullit, nga “profesorë të devotshëm” e që përfunduan nëpër shërbime sekrete policore. Cili qe hajri i tyre për këtë popullatë, për këta profesorë, për këtë Medrese. Apo, Shaqir Fetai i konsideron vlerë meqe e ndoqën pikërisht po atë rrugë spiunazhi që e kishte ndjekur edhe vetë ai.

Për cilin unitet flet Shaqir Fetai! Apo flet për atë unitet të popullatës në heqjen dorë kolektive nga BFI-ja e Shaqir Fetait, duke e injoruar tërësisht dhe duke mos u marrur as me Institucionin e as me Shaqir Fetain. I shkreti mendon se ky qendrim unik i opinionit të gjërë është solidarizim me puçin dhe komplotin e tij duke e politizuar BFI-në deri në përmasa të digasterit qeveritar të pushtetit aktual maqedonas.

Krenohet duke u krrekosur si gjeldet me faktin se Medreseja e paska mbyllur me shume sukses vitin akademik 2020/21! Çka nënkupton Shaqir Fetai me sukses?! Ku i pa ato suksese Shaqir Fetai! Shaqir Fetai sukses e llogarit faktin që në Medrese nuk u sëmure asnjë nga Koronavirusi! Po suksese të tjera?! Le ta numerojë Shaqir Fetai vetëm një sukses! Mos dolen talente të reja që tronditën botën për të mirë, apo, që ia shtuan famën Medresesë dhe, përgjithësisht, komunitetit tonë! Mos pati ndonjë të arritur inovative, ndonjë sukses vendor ose ndërkombëtar! Çdo vit akademik paraprak, pra, para se të instalohej Shaqir Fetai, ka qene më i suksesshëm se ky vit për të cilin mburret kot e kot Shaqir Fetai.

Pastaj, cili audit, cili organ rregullator, cili komision i pavarur, vlerësoi se, vërtet, sivjet Medeseja Isa Beu e përfundoi me sukses vitin!

Po kush e nxori këtë konstatim nga rrotullamja e b...? Shkolla e Mesme Islame “Medreseja Isa Beu” vitin shkollor 2020/2021 e përfundoi me sukses. Këtë e vlerësoi Këshilli Edukativo-Arsimor i Medresesë Isa Beu në Shkup në mbledhjen e mbajtur në lokalet e Medresesë në Shkup, “ku kanë marrë pjesë Drejtori i Medresesë prof. Ibrahim ef. Idrizi, Sekretari i Medresesë Mr. Lutfi Nexhipi, Udhëheqësi i sektorit për marrëdhënie me Botën Arabe H. Ismet ef. Ademi.” Pa shiko pa shiko kush paska vlerësuar mbi sukseset e Medresesë Isa Beu!!! Individët më të dështuar në karrierë e në shoqëri. Profesorët raportojnë para tre spiunave dhe një “oficeri” të tyre!

Nuk ka lëshime! Nuk ka konstatime! Nuk ka sugjerime! Nuk ka as propozime për vitin e ardhshëm akademik. Nuk ka as premtime se kjo gjeneratë do të arrijë të regjistrohet nëpër fakultete të Universiteteve të Vendlit për arsimim superior. Të paktën t'u premttohej se do ta zgjidhin regjistrimin e tyre në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup.

Dhe, kulmi i suksesit duket të jetë ky që manifestohet nga "optimizmi fiktiv" i Anëtarëve të Këshillit Edukativo-Arsimor të Medresesë Isa Beu të cilët "janë shprehur optimistë për punën në vijim të medresesë". Kjo shprehje idiotike nënkupton se kanë mundur të shprehen edhe pesimistë! A ka qëndrime të tilla diku në botë, në një shkollë profesionale fetare? Kështu mund të shprehen vetëm të hendikepuarit në sinqeritet dhe besueshmëri në raport me popullatën. Turp! / 1KlikLarg/30.06.2021 /

Rroftë Shaqir Fetai

Në protesta normale, meqë ka pakënaqësi të shumta, tërë popullata do të bërtiste “POSHTË SHAQIR FETAI”! Për t’i bërë ballë oponentit të miletit, Shaqir Fetai na qenka vaksinuar! Tani të gjithë do të bërtasin – RROFTË SHAQIR FETAI, sa për t’ia dhënë një flad b...

Nga Ilmi Jakupi

Eu sa rahat ka rënë populli! E kishte dert të madh – po na infektohet “reisi” dhe po e ha dreqi e po ik! Jaaaa, tani, prej momentin kur u vaksinua, madje në prezencë të tre dëshmitarëve: Irsal Jakupit, Abedin Imerit dhe Ismet Ademit (të gjitha këta himetqarë të Shaqir Fetait), tani popullata është më e qetë. Po fle më rehat, zbathur, mendjen top! Sa mirë që u vaksinua. Rroftë Shaqir Fetai që u vaksinua dhe që e rehatoi popullatën, dhe bëfshin hajër këta që i treguan popullatës: o millet, o millet, u vaksinua Shaqir Fetai! Që nga ky moment, mileti ia futi gjumit dhe tani më është rehat, uh, se desh i plasi b... a do ta marrë “reisi” vaksinën apo jo!

Populli e kaloi një natë të qetë, një natë me ploë gjumë por, sapo u zgjua, menjëherë filluan “fluturat e barkut”! “Reisi” mirë që u

vaksinua, por, pse jo në Tetovë, pse jo në Gostivar, pse jo në Strugë, apo në Shkup, por, në Kumanovë! Çka ka në Kumanovë? Shaqir Feti nuk është banor i Kumanovës, nuk jeton as përkohësisht aty, madje nuk është i evidentuar në asnjë shtrëpi shëndetësore, nuk e ka as mjekun amë! Po ç'kërkoj Shaqir Fetai në Kuamanovë? Çka ka aty!

Në Kumanovë është kufiri që ndanë Maqedoninë me Serbinë, pra, Kumanova e ka shumë afër Serbinë, Vranjën, ku janë vaksinuar mijëra maqedonasë që veten e ndjejnë më serbë se maqedonasë, që më tepër i besojnë pushtetit serb se pushtetit maqedonas, ku ndjejnë siguri më të madhe në duart e mjekëve serbë se sa të atyreve maqedonasë. Fundja, në Serbi mund të jetojnë edhe soji i Stanko Dragoviqit, oficerit të UDB-së, nxënës i të cilit ishte Shaqir Fetai.

Po ndiqen oficerët e UDB-së, ja, ai i Baton Haxhiut, Stanishiqi u dënua me 12 vite burg, mund të dënohet edhe ky i Shaqir Fetait dhe, vaksinimi pranë kufirit me Serbinë mund të jetë si pretekst për t'u takuar e përshëndetur me oficerin, apo, si një alkimi që flet për një sinergji të pakontestueshme në mes këtyre dy "breqeteve"! Vërtet, pse nuk ka besim Shaqir Fetai për t'u vaksinuar te mjekët e vet në Gostivar? Pse frikësohet prej mjekëve shqiptar të Tetovës, të Strugës, të Shkupit? Prej nga këtë besim të plotë prej mjekëve të Kumanovës. Kush ia dha këtë garancë se mjekët e Kuamanovës do të jenë të besueshmit e Shaqir Fetait! Prej nga atë fuqi këta garantues të Shaqir Fetait. A nuk janë këta bijtë e po atyre "garantuesve" të mjekut kriminel kumanovar i cili kah fundi i viteve tetëdhjeta të shekullit të kaluar vrau me qindra bebe në lindje e sipër, përtvëloi me qindra nëna të reja! Çka po flas dhe unë!!! Shaqir Fetai ishalla nuk ka shkuar të lindë, Shaqir Fetai nuk mund të lindë bebe, ai ka shkuar vetëm të marrë një vaksinë prej njerëzve të besueshëm, të cilët mbase i kanë ardhur edhe nga Serbia. Tani, kur të vinë nga Serbia është e udhës që edhe ti t'ia gjeshë një terren sa më të afërt, që mos të udhëtojnë gjatë e gjatë! Shërbimi kryhet me shërbim!

Dhe u bë mirë që shkoi në Kumanovë se, mjekët atje, në raport me shqiptarët janë shumë nervozë, fare nuk mund t'i durojnë shqiptarët, sapa t'i shohin shqiptarët menjëherë u bie një zymtësi, një këputje, një nervozë e pashpjegueshme. Nuk i durojnë shqiptarët dhe, pikë! Ndërsa Shaqir Fetai, me humorin e tij, i ka shkukur së qeshuri. Mjekët maqedonasë të Kumanovës u derdhën

së qeshuri nga deklaratata e Shaqir Fetait.

Po pse? ç'pallamudi Shaqir Fetai? O kur tha se “gjithë hoxhallarët e vendit qëndruan në vijën e parë të frontit, të cilët edhe në momentet më të vështira në të cilat kaluam këto dy vite që po lamë pas, qëndruan pranë besimtarëve dhe me sakrificë e përkushtim u shërbyen atyre.” Kqyreni bre si flet? Si me qenë fjala për infermierë e për mjekë, për bakterologë e për infektologë, e jo për hoxhallarë. Epo, më rrenc, më dallavrxhi, më i paskrupullt se Shaqir Fetai nuk bën më nëna! Lopa, po!

Sido qoftë, Shaqir Fetai u vaksinua dhe, bëri mirë. Tani populli është më i qetë! Pak u shqetësua nga situata post-vaksinë por, e duroi disi. Këta të shërbimit të Shaqir Fetait lajmëruan se, Shaqir Fetai paska pasur paaaak temperaturë, e paska marrur një paracetamol, paska vënë në krah disa fasho me acid borik, çorapet i paska njomur me raki, dy-tri herë natën paska dalur dhe e paska bërë çishin, nga një pikë e nga një pikë, paska pirë edhe një lugë sirupë vitaminoze dhe, elhamdulillah, sot qenka top fare! Prandaj mileti është kaq i qetë! Dhe shumë i lumtur që Zoti ia bëri munasip që vaksinën ta marrë në Kumanovë, aty sa më pranë Serbisë, sepse, Serbia nuk i harron “fëmijët” e vet! Kot nuk thotë: “aty ku është një varr serbi (apo një varr i shërbëtorëve serbë) aty është Serbi”!

Në Kumanovë ka mjaft serbë, por edhe mjaft garanci për Shaqir Fetain se do ta marrë vaksinën hakikat, ususi për Kovid19! Sa rahat që ndjehet populli pas këtij lajmi të publikuar në faqen zyrtare të BFI-së por edhe në fb-un e këtij farë fuksi! / 1KlikLarg/01.07.2021

Shaqir Fetai mbahet “peng” në Medresenë ISA BEU

Vetëm me ndihmën e policisë shtetërore, të cilën e ka kërkuar drejtori i Medresesë Isa Beu, Ibrahim Idrizi, është bërë e mundshme nxjerrja jashtë e Shaqir Fetait, “reisit” të instaluar në krye të BFI-së nga pushteti aktual, i cili për dy orë është mbajtur “peng” nga punëtorët dhe stafi akademik i kësaj shkolle të mesme profesionale

Këto ditë, me rastin e mbylljes së vitit akademik 2020/2021, në Medresenë Isa Beu të Shkupit ka prezantuar edhe Shaqir Fetai me disa bashkëpunëtorë të vetë. Fatkeqësisht, prezenca e tij ka irituar disa punëtorë e profesorë nga stafi akademik, të cilët janë ndjerë të provokuar nga përfshirja e tij në këtë event.

Eeventi në fjalë ka marrur rrjedhë krejt tjetër sapo është futur brenda “reisi” i instaluar dhunshëm në krye të BFI-së, me ç’rast, të punësuarit në këtë Medrese kanë insistuar që të zhvillojnë debat mbi shumë çështje, mbi shumë premtime e gënjeshtër që u janë ofruar si “program” dhe si premtime të cilat do t’i zgjidhin të gjitha problemet e Medresesë.

Një numër nga të punësuarit në Medrese, haptazi kanë shprehur revoltë kundër prezantimit të tij si “reis” i cili nuk përfaqëson askend përveçse interesat partiako-politike të segmenteve të caktuar të pushtetit aktual. Profesorët nuk kanë dashur të dëgjojnë asnjë fjalë, asnjë premtim, asnjë gënjeshtër nga njeriu i

cili në mënyrë permanente shkelë Kushtetutën e BFI-së si dhe të gjitha aktet e mundshme normative që janë pjesë e funksionimit institucional të BFI-së.

Në momentin kur disa punëtorë kanë mbyllur derën e Medresesë me çelës dhe kanë kërkuar që të dëgjojnë zgjidhje nga ana e Shaqir Fetait për shumë probleme që janë akumuluar në këtë shkollë të mesme profesionale, Shaqir Fetai është ndjerë i rrezikuar dhe ka kërkuar nga drejtoria që të kërkojnë ndihmë nga policia e shtetit. Dy orë më vonë, falë intervenimit të policisë së shtetit, është mundësuar nxjerrja e Shaqir Fetait jashtë ambientit të Medresesë. Të punësuarit në këtë Medrese tani më kanë filluar haptazi ta refuzojnë dhe mos ta njohin për drejtor Ibrahim Idrizin, i cili, në rastin konkret, në vend se t'i mbrojë interesat e punëtorëve dhe arsimtarëve të Medresesë, ai është pozicionuar në mbrojtje të interesave të Shaqir Fetait. Të punësuarit ndaj Shaqir Fetait kanë pasur vetëm një kërkesë: të dinë se kur do ta akreditojë medresenë dhe se a do të ndodhë që në këtë vit akademik t'i dëbojnë apo edhe mos t'i pranojnë nëpër fakultete shtetërore medresantët e kësaj shkolle!

Ka kohë që po flitet se situata në këtë shkollë të mesme profesionale aspak nuk është e volitshme dhe se shumë shpejt pritet eskalim i ndonjë ngjarje të padëshirueshme. Gjesti i drejtorit aparatçik tashmë i ka revoltuar edhe më shumë të punësuarit dhe, situata do të përkeqësohet dhe nuk do të ketë qetësim deri në ndërrim të drejtorit, ndërsa këtë ndërrim nuk do të guxojë ta bëjë Shaqir Fetai, sepse, stafi akademik i Medresesë i paskan thënë Shaqir Fetait se nuk do të respektojnë asnjë vendim që do të vie nga ai si person i cili nuk njeh Kushtetutën e BFI-së dhe që është instaluar në krye të BFI-së në kundërshtim me tërë rregullativën e këtij Institucioni./Lajme7/03.07.2021

Bredhje nëpër injorancën e Shaqir Fetait

Shaqir Fetai, duke qenë i kompleksuar deri në veshë si dhe, duke qenë injorant deri në maje të kokës, i lejon vetes të imputojë gjëra iracionale, të paqenme, gjëra përmes të cilave mundohet t'i japë peshë vetes, mundohet që ta kamuflojë injorancën e vet. Por, injoranti, në çfarëdo vartianti e situatë, ngelë gjithnjë injorant

Nga Valmir Idrizi

1. Shaqir Fetai i paska shkruar një telegram urimi ambasadores së SHBA-ve në Shkup, përmes të cilit ia paska uruar 4 Korrikun, Ditën e Pavarësisë të Shtetit Amerikan. Veç të tjerash, Shaqir Fetai, duke e shkruar këtë telegram urimi, sakaq vetja i duket Amerikë, i duket President Amerikan, i duket vetja si kryetar i OKB-së, i duket vetja si kryetar i Maqedonisë së Veriut, i duket vetja si kryetari rus, Putin dhe, i jep të drejtë vetes që t'i thotë Ekselencës së Saj, zonjës ambasadore, "... janë parimet që na bëjnë partnerë në rrugëtimin tonë të përbashkët drejt ardhmërisë

duke i shndërruar ato vlera si primare për shoqërinë tonë"! Shaqir Fetai partner amerikan? Shaqir Fetai si një "lider" që është në gjendje të prodhojë parime identike amerikane, angazhime identike amerikane, që e "bëjnë partner në rrugëtimin e përbashkët"?!

Le ta zbresim me këmbë në tokë Shaqir Fetain dhe le t'i themi se parim i tij është shkelja permanente e Kushtetutës së BFI-së! T'i themi që parim i tij është tradhëtia, lënia në gjysëm të rrugës së projekteve për të cilat ai është angazhuar rreth tri dekada! T'i themi që parim i tij është nëpërkëmbja e dinjitetit të njeriut, sipas porosive të shërbimeve antihumane! Në të gjitha këta angazhime të Shaqir Fetait me këmbë në tokë, Amerika nuk gjenë asnjë puqje dhe, as që i llogaritë të tillët për partner. Prandaj, Shaqir Fetai bën mirë që në "urimet dhe përshëndetjet" e tij të jetë sa më shumë me këmbë në tokë, duke mos u treguar më amerikan se amerikanët, sepse, dihet se nga cila shkollë vie! Vjen nga ajo shkollë të cilit, megjithatë, amerikanët, më vitin 1999 e bombarduan, duke ia çuar pondlat në hava!

2. Shaqir Fetai, në promovimin e një hafizi, mbiemrin e të cilit e ngatëroi që nga fillimi e deri në fund (duke i thënë Betim Aziri, në vend të Betim Izairi – Zoti e shpërbleftë me të gjitha të mirat e Tij hafiz Betimin), para tërë asaj ulemaje të respektuar, e shtrembëroi ajetin kuranor, kurse në shenjë pohimi, Myftiu i Tetovës, Qani Nesimi, vetëm sa e tundte kokën, në shenjë miratimi të tërë asaj që e thoshte ky farë injoranti dhe mëkatari!

Shaqir Fetai i hyri dialogut të Zotit me melaqet në çastin kur e paska krijuar njeriun. Për këtë moment, ajeti 30 i sures El Bekare, thotë: "Kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë do të krijoj një mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë", ata thanë: "A do të vësh atje dikë që do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak në të, ndërkohë që Ne të madhërojmë, të lavdërojmë dhe të lartësojmë ashtu si të takon Ty?!" Ai tha: "Unë di atë që ju nuk e dini".

E çka thotë Shaqir Fetai deri sa ia vërteton Qani Nesimi me të luhatur të kokës në shenjë vërtetësie?! Shaqir Fetai thotë: "Je mëkatësi im në tokë"! Pra, Zoti i paska thënë njeriut "je mëkatësi im në tokë"! Subhanallah, subhanallah! Asnjë prej ish-myftilerëve, prej hoxhallarëve më të vjetër, nuk e korrigjoi, asnjëri nuk ia tërhoqi vërejtjen, asnjëri nuk i tha "o Shaqir Fetai, o shejtan birë

shejtani, Zoti njeriun e bëri mëkëmbës të vetin, dhe jo mëkatës të vetin! E tundën kokën për këtë fjali “të urtë” që e tha “reisi” i tyre, tallësi publik me vlerat islame, hipokriti që injorancën e vet e shet për intelektualitet! Kjo mund të arrihet vetëm në mesin e injorancës. Aty ku ka dy kokrra tru, ku ka qenie normale e të devotshëm, do t’ia digjte ndonjë shpullë Shaqir Fetait dhe shallin tëkërlek do t’ia çonte nëpër dysheme të xhamisë.

3. Paramendoni se deri ku ka arritur idhujtaria! Deri ku ka arritur sëmundja shpirtërore për idhujtari! Deri ku ka arritur ndërgjegjësimi i Shaqir Fetait se, megjithatë, ai është idhulli që duhet të japë leje apo të marrë lejen! Kësaj radhe, sekretaricës se vet, i paska dhënë leje të shkojë për doktoraturë. Ky i ka kërkuar leje, ndërsa Shaqir Fetai ia paska miratuar! Do me thënë, në BFI, pa mirtimin, pa pëlqimin, pa lejen e Shaqir Fetait, t’i nuk mund të bëshë as karrierë intelektuale dhe, nuk mund ta bëshë madje asnjë pordhë. A ka gjë më të turpshme se të publikoshë një lajm të tillë që nuk flet për asgjë tjetër përveçse për idhujtarinë e Shaqir Fetait.

Fillimisht, sekretarica e tij, Evzal Sinani, është dashur të kërkojë leje për ta ndërprerë marrëdhënien e punës, pastaj t’ia pranojë këtë kërkesë Shaqir Fetai dhe, në fund, po Shaqir Fetai t’ia miratojë nijetin për të vazhduar akademizimin e vet personal, i cili, në asnjë xhep nuk i hy Shaqir Fetait. Fillimisht, ai është dashur të dalë nga ai vend pune pa pompozitet, i turpëruar dhe, pa treguar arsytet, sepse arsyet janë tepër shumë banale! Ai nuk erdhi sipas sitematizimit të vendit të punës i cili parasheh tri vite përvojë pune! Ai pranoi të bëhet “shef” i një dhunuesi të parimeve dhe të Kushtetutës, të bëhet “shef” i një bashkëpunëtori udbash, të bëhet “shef” i një tradhëtari dhe puçisti të pashembullt në historinë e BFI-së, të bëhet “shef kabinet” i një “reisi” të instaluar nga paria politiko-partiake e pushtetit aktual maqedonas, pasi kreu me sukses një komplot kundër “babait të vet shpirtëror” të cilin tridhjtë vite për “baba” ua kishte imponuar mbarë gostivarasëve me rrethinë.

Lajmi thotë: “Reisul Ulema e falënderoi përzemërsisht Evzal ef. Sinanin, për gjithë angazhimin e tij, punën e pakursyer e cila ka lënë gjurmë dhe sakrificën sidomos gjatë këtyre 7 muajve sa ka qenë në funksion!” A ka tallje më të madhe se kjo për doktorin e

ardhshëm! Për shtatë muaj “shefi” na paska lënë gjurmë dhe sakrafica të pashlyeshme në BFI! Po cilët na qenkan këto! Gjurmë e sakrificave të hajrit për 30 vite nuk ka lënë Shaqir Fetai në BFI, kurse paska lënë për shtatë maj “shefi” i tij!

Dhe, kqyrni putizmin e Shaqir Fetait, shikojeni injorancën e tij prej idhujtari, ndiqeni hipokrizinë e tij prej majmuni – i paska mbledhur udhëheqësit e shërbimeve profesionale (pas vërejtjes së Lëvizjes Myslimane për Reforma nuk u thotë më “drejtori” por “shërbime profesionale”) dhe, pas një debati e diskutimi të gjërë, më në fund, i paska dhënë leje Evzal Sinanit, që të niset “rrugëtimit” të tij për doktoranturë!

Dhe, qershia mbi tortë! Ky është koncepti i së ardhmes së BFI-së për Shaqir Fetain, ja, ky, në këtë deklaratë të tij: “Sado që do të dëshiroja që Hfz. Evzali ta japi kontributin e tij në kuadër të Bashkësisë Fetare Islame, e mbështes atë plotësisht në vendimin që të vazhdojë me kërkimin e dijes, sepse dija është rruga e ngritjes së gradëve në parajsë dhe se dija është trashëgimia e profetëve”.

Në momentin kur një teolog vendos të avancojë në shkencë, në momentin kur vendos që të arrijë tituj shkencor, ai më pushon së qenuri kontribues në BFI, sepse, në BFI mund të kontribuojnë vetëm injorantët, debillët dhe soji i Shaqir Fetait. Prandaj në BFI-në e Shaqir Fetait 90 për qind e nëpunësve janë me shkollim artificial, me diploma falco e me tituj të blerë.

E vërteta e kësaj ikje po përfolet kuluareve të teologëve të Gostivarit. Evzal Sinani është ndërgjegjësuar, ka informatë se në BFI do të bëhet puna edhe më keq, edhe më llugë, është bindur se Institucioni nuk bëhet sipas pikëpamjeve retrogarde të Shaqir Fetait, ka filluar të ndjehet i poshtëruar e i turpëruar, prandaj dhe, ka zgjedhur që sa më parë të ik nga aty dhe t’i qaset kontributit në vetëvete që një ditë të jetë më i kthjellët, më racional dhe më kontribues për të mirën e përgjithshme të shoqërisë sonë myslimane. Ruga se kah po ec BFI-ja, mënyra se si po menaxhohet me BFI-në, nëpunësit e BFI-së me lloj-lloj karakteresh që janë miliona kilometra larg karakterit të hoxhës së mirëfilltë, e kanë motivuar këtë të ri që të ndërgjegjësohet dhe të ik një orë e më parë nga të qenurit “funksionar” i “kabinetit të idhujtarit”!

Shaqir Fetai mosfunksionimit të BFI-së, problemeve të shumta që sa nuk kanë shpërthyer fuqishëm, injorancës së tij në menaxhim të Insitutcionit, po mundohet ti japë karakter akademik, ta akademizojë tërë situatën dhe, t'i ftojë akademikët të marrin lakmi në BFI-në e tij! Sepse, prap sipas Shaqir Fetait, ai e paska fare të lehtë drejtimin e Institucionit. Këtë formulë ua jep edhe shokëve të vet: “Mjafton të ktheheni te Pejgamberi s.a.v.s. dhe të mësoni se si ai drejtonte me institucione”! Shtrohet pyetja: Shejtani a mund ta ketë lakmi Pejgamberin s.a.v.s. A mund t'i ketë një shejtan sukseset e Pejgamberit s.a.v.s. Veperimet e derisotsme lidershipe të Shaqir Fetait dëshmojnë se kemi të bëjmë me një shejtan tipik në surrat njeriu!/Debat/03.07.2021

E vërteta nuk ngulfatet nga asnjë kataklizëm

(Dy fjalë për botimin elektronik të librit TRADHËTIA DHE KOMPLOTI I SHAQIR FETAIT NË KOHË PANDEMI, botuar nga Korporata për Produksion, Informim dhe Botim, “1kliklarg”, Tiranë, 2021)

Të përmbledhura nën titullin TRADHËTIA DHE KOMPLOTI I SHAQIR FETAIT NË KOHË PANDEMI, mbi 220 njësi shkrimi, të natyrave të ndryshme: opinione, intervista, reagime, analiza, komente, deklaratat etj, të publikuara në mbi 36 portale gjithëkombëtare, sapo u botuan edhe në formë elektronike. Ashtu siç premtoi Korporata për Produksion, Informim dhe Botim “1kliklarg”, se pas shitjes dhe shpërndarjes së tirazhit nga botimi i parë do të publikohet libri edhe në formë elektronike, ashtu edhe ndodhi! Tani më lexuesit e gjërë e kanë mundësinë për ta zbritur botimin dhe për ta lexuar, njësi për njësi, sidomos në këtë kohë vere, gjatë ditëve të pushimit.

Libri ngërthen në vete publikimet e dala në opinion brenda një viti, respektivisht nga 27 maji i vitit 2020 deri më 26 maj të vitit 2021, e që i dedikohen që të gjitha Shaqir Fetait, i cili, pas një puçi dhe komploti spektakular, arriti që, falë ndihmës nga pushteti aktual

maqedonas, të instalohet në krye të BFI-së me qëllim që t'i pengojë proceset e parapara për një reformë të thellë e gjithëpërfshirëse të Institucionit në fjalë.

Veprimi i Shaqir Fetait me bashkëpunëtorë të vet, Institucionin e Bashkësisë Fetare Islame në RMV e kanë shndërruar në një magaze ku deponohen pikëpamjet e deplasuara, mendimet negative si dhe idetë retrogarde për sa i përket BFI-së, perspektivës së saj si dhe jetës fetare islame në vend.

Shkrimet e publikuara dhe të grumbulluara nën këtë titull në fakt përcjellin në kontinuitet, në përditshmëri, çdo veprim hipokrit dhe të rrezikshëm të Shaqir Fetait si dhe të bashkëpunëtorëve të tij.

Libri është si një arkiv më vete, që flet për një tentativë e cila gjithësesi që do të dështojë por që synon lëndimin dhe “trullosjen” e jetës fetare islame institucionale në vend.

Një pjesë bukur e madhe e librit i kushtohet veprimeve antiinstitucionale, antikushtetuese dhe pro-politikave qeveritare të Shaqir Fetait, i cili, lojën e fillon duke akuzuar se pararendësi i tij paskësh shkelur nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së, ndërkohë që, vetë ai, brenda një periudhe fare të shkurtër, do të shkelë 58 nene të Kushtetutës së BFI-së.

Botimi do të shërbejë si literaturë bazë për të gjithë ata studiues që një ditë do të vendosin të shkruajnë për një periudhë të caktuar nga e kaluara e BFI-së, periudhë kjo që do të përceptohet, pa fije dyshimi, si më e zymta dhe më tragjika në historinë e Institucionit të BFI në RMV.

Qëndrimet e “institucionit” (sidomos kur ai është i politizuar) gjithnjë kanë qenë, janë dhe do të jenë shumë irelevante në krahasim me qëndrimet e opinionit, të cilat zakonisht merren si bazë dhe si fakte relevante.

Libri, qoftë si botim fizik, qoftë ky si botim elektronik, **TRADHËTIA DHE KOMPLOTI I SHAQIR FETAIT NË KOHË PANDEMIE**, do të jetë, pa dyshim, ndër librat burimorë dhe më i cituar në hulumtimet e ardhshme për të kaluarën e zymtë të BFI-së! Sepse, botimi fakton me ditë e me data ndodhitë nga më të ndryshmet rreth dhe brenda BFI-së, që kur pushteti maqedonas do ta

instalojë marionetën e vet, Shaqir Fetain, në krye të BFI-së.
/1KlikLarg/05.07.2021/

**TRADHËTIA DHE KOMPLOTI I SHAQIR FETAIT NË KOHË
PANDEMIE**

Pallavrat e Shaqir Fetait dhe reagimi “ekstrem” i medresantëve

Në Medresenë Isa Beu të Shkupit qenka organizuar ceremonia e ndarjes së diplomave për maturantët e këtij viti akademik. Ceremonia si kjo, tashmë janë tejkaluar në botën e qytetërar, nuk ka më shpërndarje të diplomave me ceremoni, sepse ato merren edhe në mënyrë elektronike, hiç pa ua parë surratin drejtorisë dhe profesorëve, madje edhe e tërheqin si dokument vetë në rast se ju duhet për regjistrim sipëror të shkollimit, duke iu shmangur korrupsionit të mundshëm

Nga Shukri Memishi

Nëpër shkolla të specializuara, që prodhojnë kuadër deficitar të inovacionit, ku del gjenerata e parë, e dytë, e tretë (më tej kalon në normalitet), mund edhe të ndodhë që të shpërndahen në mënyrë ceremoniale diplomat, por ama, të ndodhë kjo, për shembull, në Medresenë e Isa Beut, me një staf akademikë të dyshimtë, amatorë, puthadorë, që nuk kanë nxjerrë deri më sot një shkencëtarë të mirëfilltë, një penë që ka lënë gjurmë, një akademik

fjala e të cilit peshon deri në vendim të prerë, është sa qesharake, aq edhe e kotë.

Për më tepër, kjo ceremoni e tillë bëhet e kotë me vetë prezencën e “reisit”! Cili është kontributi i “reisit” në nxjerrjen e kësaj gjenerate? Cili është kontributi i “reisit” në avancimi e pozitës së kuadrit arsimor, në ngritjen e kuadrit arsimor, në pasurimin e këtij kuadri me të tjerë që janë deficitar në stafin akademik? Pa dyshim, vallai-bilahi, pasha të Madhin Zot, kontributi i pastruesve, i rojeve, i edukatorëve është shumëfish më i madh se i Shaqir Fetait. Prandaj, pse të mos respektohet e nderohet një pastrues, duke ia dhënë mundësinë që të merret ngryk me medresantët, t’ua shpërndajë diplomat pastruesi, apo roja, nëse jo kujdestari apo drejtori i shkollës, por, kjo i lihet në dorë Shaqir Fetait. Vetëm sa për t’ia krijuar mundësinë që të thotë “ja, ja, sa aktiv jam! Ja, ja, si e menaxhoj BFI-në”...

Shaqir Fetai me prezencën e vet e ofendon Medresenë, e gënjen Medresenë, tallet me Medresenë, luan guxhas me maturantët, me stafin e Medresesë, me drejtorinë!

Ia nis fjalimit thuase ky ka shpërndarë me vite e vite diploma dhe, e ka këtë merakun më të madh në botë. Thotë kodoshi: “Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut me organet e saja në tërë territorin e saj kanë manifestime të shumta dhe më pyesin cili solemnitët është më i bukur, ku ndjen gëzimin më të madh, ku ndjehet lumturia më e madhe. Cili manifestim është ai? Pa fije dyshimi, pa fije hamendje, solemniteti më i lartë dhe më i gëzuar është ky moment, kur ndahen diplomat e gjeneratës së Medresesë Isa Beu këtu në Qendër dhe në tërë territorin e Maqedonisë...”

BFI-ja dhe organet e saj po e pyetkan Shaqir Fetain se cili manifestim i shkakton kënaqësi më të madhe? As BFI-ja dhe as organet e saj nuk mund të flasin e as të shtrojnë pyetje! Nëse mendon në mënyrë të tërthortë për Myftilerët, atëherë, i tërhiqet vërejtja që mos të tallet dhe të mos manipulojë, sepse myftinjtë nuk janë organe! Myftinjtë janë drejtues me organet e Myftinive. Pra, Myftinitë janë organe dhe jo myftilerët!

Kur e paska shijuar këtë moment Shaqir Fetai që ta ndjejë si çastin më të lumtur të tij shpërndarjen e diplomave?! Pastaj, lëre prezencën e tij prej fuksi, por, me çfarë mesazhi iu drejtua maturantëve? Mos pati ndonjë lajm të gëzueshëm për ta! A ka lajm më të mirë se sa t'u thoshte, madje t'u garantonte se nga ky vit akademik do të mund të regjistrohen 170 maturantët e Medresesë, ku të kanë qejfin, në cilëndo fakultet të universiteteve të vendit. Jo, tha që, po bëka përpjekje me strukturat partiake dhe aq, ndërsa nuk tha që, “më falni por, partitë politike nuk po ma rrasin”, sepse kanë të tjera probleme, brenga e pengje!

Shaqir Fetai erdhi që t'u thotë maturantëve që të ikni nëpër Evropë e Amerikë se, vetëm atje do të keni mundësi të shihni se sa “e maaadhe është Medresja jonë”, t'ju thotë myslimanëve të vendit se me fitrat e tyre Medresja ka përgatitur kuadër për shtet, ka nxjerre ministra, zv/ministra, sekretarë, madje inspektorë të fushave të ndryshme, që i bie nëpunës të ish-UDB-së, DBK-së së sotshme, kurse, stafit akademik, të cilët e mbajtën peng dy orë brenda Medresesë, një javë më parë, ju tha se kur dua vi e kur dua dal, sepse kam policinë e shtetit pas vetes!

Kjo ishte arsyeja e pistë e prezencës së Shaqir Fetait në këtë ceremoni qesharake, ndërsa, medresantët janë ndjerë tepër të fyer që nuk patën rastin që diplomat t'i marri prej kujdestarëve të klasës, apo prej drejtorisë së Medresesë, me qëllim të përshëndetjeve për herë të fundit me ata, brengën dhe përkujdesin e të cilëve e ndjenë çdo ditë gjatë shkollimit të tyre të mesëm.

Një numër i konsiderueshëm i medresantëve janë ndjerë të fyer që prej udbashit (ORAO) ta marrin diplomën, prandaj, në shenjë revolte kanë shprehur gatishmërinë që t'i djegin, t'i shpallin të pavlefshme, duke kërkuar nga drejtorja që sa më parë t'ua bëjnë gati diplomat e tjera. Deri në këtë çast numri i atyreve që do ta djegë diplomën e dhuruar prej Shaqir Fetait ka shkuar në 37 maturantë, me tendencë që të rriten sa më shumë.

Derisa maturantëve të Medresesë prezenca e Shaqir Fetait nuk u ka shkaktuar kurrfarë kënaqësie, përkundrazi, ofendim e nënçmim, Shaqir Fetai ka ndjerë kënaqësi në prezantimin e këtij kallaballëku, sepse, sa më kallaballëk, aq më lehtë del ndonjë informatë. Prandaj, rraset Shaqir Fetai, e deshti dikush apo jo,

sepse, këtij i duhet informata! Për Shaqir Fetain, informatë paraqet edhe fakti që e kanë dëgjuar nja 170 nxënës si dhe nja dhjetra profesorë, do me thënë, mileti ka nisur ta pranojë fuksin e Stanko Dragoviqit. Çfarë degradimi për këtë Medrese, e cila, sipas puthaduarësit të Shaqir Fetait, Ibrahim Idrizit, po na funksionuaka tash e 545 vite.

Krejt në fund, nxënësit e gjeneratës Shaqir Feta i paska shpërblyer me regjistrim falas në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup! Pse rrenë Shaqir Fetai! E vërteta është që ata nuk regjistrohën falas, por, shkollimi i tyre mbulohet nga buxheti i Bashkësisë Fetare Islame! Së këndejmi, kë e ka pyetur për një shpërblim të tillë Shaqir Fetai? Me cilin organ u konsultua! Me çfarë vendimi erdhi deri te ky “shpërblim”! Është dashur të lexohet vendimi i sjellë në mbledhjen e mbajtur nga organi më i lartë, i cili vendosi që t’i mbulojë shpenzimet e shkollimit për iks nxënësat! Ky rregull nuk do t’i pëlqente Shaqir Fetait, sepse, do ta pamundësonte Shaqir Fetain për të gënjyer, ndërsa ai pa gënjyer në çdo dytën fjali e ka të pamundur! Plus që vendimi do t’ia zerronte mundësinë e vetëlavdërimit! Shaqir Fetai mund të rrijë pa iman por jo dhe pa vetëlavdërim! /Kombetare/06.07.2021

Nevoja e Shaqir Fetait për vetëaktualizim dhe vetëvlerësim

Rreth sindromës psikopatike të Shaqir Fetait, më së miri flet teoria e klerarkisë së nevojave, të cilën në mënyrë të përkryer e definoi psikologu i shquar amerikan, Abraham Harold Maslov (1908-1970). Sipas kësaj teorie, individ, pas plotësimit të nevojës për ushqim, për siguri, fillon dhe e tejkalon stadën e të qenurit specie e ngjashme me kafshët dhe, nisë dhe e ndjenë nevojën për vetëaktualizim dhe, më në fund, për vetëvlerësim

Nga Qazim Osmani, psikolog

Shpesh më kanë rënë në sy disa tituj brengosës, sepse, më shumë flasin për një pacient kandidat për psikiatër se sa për një “lider” të shëndoshë fizikisht dhe mendërisht. Bëhet fjalë për titujt e tipit, “filani e vizitoi reisul ulemanë”, “fishmeni e vizitoi reisul ulemanë” për të ardhur deri te dy titujt e fundit: “Profesorë nga Universiteti i Stambollit vizitojnë Reisul Ulemanë” dhe, “Delegacioni i Forumit Mysliman Evropian vizituan Reisul ulemanë”!

Kjo dukuri flet për mohimin e tërësishëm, për minimizimin e skajshëm, për anashkalimin total, për vetminë e madhe, që i ndjenë një “lider”, i cili, për më tepër, është shumë i vetëdëshëm se këto sjellje refuzuese janë rezultat i reaksionit kundër mënyrës se

si vetëshpallet “lider” individi i papërgjegjshëm dhe karrierist i marrosun.

Shaqir Fetai është shumë i vetëdisëm se ai, pas publikimit të dokumentit ku del se ka qenë bashkëpunëtorë i UDB-së, nën udhëheqjen e oficerit serb, Stanko Dragoviqit (mbase familjar i ngushtë i lojtarit të reprezentacionit austriak, me mbiemrin Dragoviq!!!), pas instalimit të tij nga pushteti aktual maqedonas në krye të BFI-së, pas atij puçi dhe komploti që ia bëri “babait të vet shpirtëror”, ai deri në frymën e vet të fundit do të ngelë i paaktualizuar dhe i pavlerësuar. Këtë të vërtetë, ai do të mundohet ta kamuflojë disi, përmes vetëaktualizimit dhe vetëvlerësimit.

Ky është mekanizmi mbrojtës i karrieristëve të marrosur, sepse, kjo specie nuk dorëzohet deri në fund, meqë i ka rënë not llucës, ai do të dalë disi në breg, qoftë edhe i tëri i bajgosur duke kundërmuar në acide ngulfatëse.

Shaqir Fetai, një periudhë i luste njerëzit që t’i shkojnë në kabinet dhe, me të gjithë dilte në foto të cilat i publikonte me diçitura “pasi na e uroi detyrën e re, na dëshiroi edhe suksese dhe shëndet në jetë”! Për veten e vet flet në shumës. Vetën e vet e quan “ne”, sepse, është shumë i ndërgjegjshëm se, si vetë, si tek, nuk vlenë asgjë, nuk e bën hesap askush, prandaj, duhet të dalë në shumës, “ne”, “na e uroi”, “na i tha”, “na përshëndeti”... Jo që është sjellje jashtë çdo modestie, por, mbi të gjitha, është fenomen psikiatrik!

Nën këto rrethana izoluese dhe, tërësisht injoruese, Shaqir Fetai ka nevojë për vetëaktualizim dhe për vetëvlerësim! Do me thënë, e vlerëson aq shumë vetëveten sa, i duket vetja si personalitet më i njohur në botë, prandaj dhe vijnë për ta takuar “reisin”! Duke e takuar “reisin” ai zbrazet nga nevoja për vetëaktualizim!

Askush nuk na qenkan ata akademikë, ata profesorë të Universitetit të Stambollit, ata qenkan vetëm simpatizantë dhe adhurues të Shaqir Fetait, të cilët, marrin udhë enkas për ta takuar “reisul ulemanë”, këtë “personalitet me famë botërore”, ndonëse nuk e njeh dhe nuk e do vetë Çegrani i tij! Nuk i bëhet aspak vonë se me këtë sjellje psikopatike Shaqir Fetai ofendon akademikë, profesorë me integritet dhe me personalitet të lartë. Ata shprehin edhe dëshirën (pra, jo nevojën) për të qëndruar për disa

minuta në Bashkësinë Fetare Islame ku do të priten nga “reisi”! Kjo është e vërteta! Vizitohet vendi, institucioni, qendra, etj, ndërsa delegacioni, vizitorët, priten nga të autorizuar, nga të zgjedhur, të emëruar etj. Pa dyshim, delegacioni, apo personaliteti mund ta vizitojë edhe “reisin” por, kjo vizitë patjetër që duhet të realizohet në shtëpi të “reisit”, në pallatin e tij, në sarajet e tij! A ka kuptim të thuhet e të shkruhet: “Delegacioni i NATO-s u nis për vizitë te kryeministri”!

E pra, është e turpshme, është poshtëruese, është shumë e ulët, diletanteske dhe gjest shumë shtazarak në kuptimin e ngushtë të fjalës, të thuhet se “Delegacioni i Forumit Mysliman Evropian vizituan reisul ulemanë”, të cilin kurrë nuk e kanë parë, kurrë nuk kanë dëgjuar për të, nuk kanë pasur kurrfarë informacioni, nuk e dinë se kush është ky farë Shaqir Fetai dhe, përkundër tërë kësaj, ata, si qorrnema, nisen për ta vizituar Shaqir Fetain! Po pse nuk i shkuan në shtëpi, pse nuk i priti në shtëpi të vet Shaqir Fetai? Sepse, delegacionet e kësaj natyre vizitojnë BASHKËSINË FETARE ISLAME ku priten nga filan instalacioni!

Nisur nga titulli, të gjithë delegacionet dhe vizitortët, kur do të kthehen në vendin e vet, do të duhet të japin përgjegjësi se pse e kanë vizituar një person për të cilin kurrë nuk kanë dëgjuar më parë, kurse janë nisur dhe kanë marrë leje për të vizituar institucionin ku rastësisht na u gjend një Shaqir Feta që vdes për vetëaktualizim dhe vetëvlerësim.

Kjo kierarki nevojash është vetëm edhe një shkallë larg shizofrenisë së rëndë. Drejt kësaj diagnoze po hapëron qetë dhe sigurtë Shaqir Fetai. Këtë po e dëshmojnë të gjitha sjelljet dhe verimet e tij! Zoti hajrin!/ 1KlikLarg/08.07.2021

Kur të plasë cipa e moralit

Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI

Shaqir Fetai paska thirrur mbledhje të “rijasetit” të tij dhe paskan kaluar shumë mirë, madje gjithçka paska rrjedhur si në vaj. Sidomos, raporti i të ashtuquajturit “reis”, i paska lënë pa tekst të pranishmit, sepse qenkan njohtuar për “pritjet madhështore” që ia paskan bërë Shaqir Fetait nëpër qendra të ndryshme! Dhe këto “pritje madhështore”, Shaqir Fetai i raporton si “aktivitete” të tij personale! Epo kur të plasë cipa e moralit nuk di se çfarë bën!

Do me thënë, këtë mbledhje e paska konvokuar Shaqir Fetai në cilësinë e “reisit”, edhe atë, bazuar në nenin 43 të Kushtetutës! Këtë obligim të reisit e kemi në nenin 44 të Kushtetutës origjinale, të deponuar në Gjykatën përkatëse në Shkup, ndërsa Shaqir Fetai mund të ketë edhe ndonjë “kushtetutë” paralele për nevojat e veta.

Pra, ky obligim qenka i reisit, a! Po në çfarë cilësie i tuboi Shaqir Fetai në Gostivar “rijasetin” e tij të diskutueshëm, më 27 maj të viti 2020, kur edhe i bëri puç dhe komplot ish-reisul ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepit!

Çka do të bente Shaqir Fetai nëse anëtarët e “rijasetit” të tij në këtë mbledhje do të sillnin vendime të ndryshme, vendime që nuk janë në përputhje as me rregulloret dhe as me Kushtetutën e BFI-së? Natyrisht që do t'i refuzonte Shaqir Fetai, sepse këtë të drejtë e

paska reisi sipas Kushtetutës, a! Po sikur H. Sulejman ef. Rexhepi mos t'i pranonte vendimet politike të diktuara nga qarqet nëntokësore antiislame që i citoi Shaqir Fetai para opinionit, çka do të bente Shaqir Fetai? Do të duhej që, bishtin nën shalë dhe të ikte duke kuisur, ë!

Shaqir Fetait nuk i ka hije kjo lojë e ndytë! Nuk i ka hije të konvokojë mbledhje të rijaseit, sepse, tërë bota e di se si u instalua në krye të BFI-së! Apo, ndoshta Shaqir Fetai mendon se është harruar ai komplot i ndyrë, apo mendon se gjithçka po shkon si në vaj ndaj dhe do ta falin besimtarët, apo ndoshta mendon se nuk kanë ku të shkojnë besimtarët, duan s'duan, Shaqir Fetai është "reis"?

Shaqir Fetai përjetë, në çdo faqe të historisë së ardhshme të BFI-së, do të ngelë puçisti dhe komplotisti më i keq që mund të ekzistojë në fytyrë të tokës!

Shaqir Fetai nuk ka se çka manipulon me financat e mjerushme të BFI-së, sepse, tashmë krejt bota e di se ai financohet nga pushteti maqedonas aktual, LSDM-BDI, i cili deri më sot BFI-në e ka përfshirë në gjashtë paketa sociale dhe, pikërisht këto paketa sociale të pushtetit maqedonas ia kanë "stabilizuar" buxhetin, dhe jo se kjo është rezultat i fitrave dhe zeqatit të suksesshëm. Analizat e sakta, bazuar në faktet burimore, flasin që Shaqir Fetai me kulubin e vet ka humbur besueshmëri të madhe ndër xhematin e vendit, ndaj dhe i pa besë nuk mund të ndihmohet e të financohet. Mbi 62 për qind fitrat dhe zeqati i vitit 2021 janë më dobët se në vitin 2018!

Qendrat islamike në diasporë nuk funksionojnë dhe nuk janë në shërbim të Shaqir Fetait, mos të gënjejë ky farë "reisi", sepse, qendrat islamike të diasporës sonë kanë shpenzimet e veta dhe, çdo e hyrë nga myslimanët e diasporës u shërben për nevojat e qendrave, të cilat kanë shpenzime ne rrymë, ujë, në pagesa të ndryshme, në organizime të jetës fetare islame etj.

Edhe një gjë! Një ditë, madje edhe në frymën e fundit të jetës së vet, që të gjithë do të paditen në gjyq, për vjedhjen e vakëfit, për keqpërdorimin e letrave me vlerë që jepen në formë të

denacionalizimit të vakëfit. Të gjithë ata që i kanë shpenzuar në rroga, në mëditje e në honorare, do të paditen, pa mëshirë dhe pa kompromis! Kjo vërejtje le të shkojë edhe në adresë të Shaqir Fetait!

Shaqir Fetai mendon se është etabluar mirë në “pushtetin” e BFI-së dhe, për ta shtrirë sa më gjërë pushtetin e vet, për ta kapur në çdo sferë BFI-në, ai tashmë inicon zgjedhje kolektive shumë të vonshme, që nga mexhlisi i xhamive! I duhet urgjentisht kjo kapje e BFI-së, të cilën, sa më fort duhet ta vë, në prag të zgjedhjeve të përgjithshme, në shërbim të partive politike që e sollën në pushtet!

Ky gjest i Shaqir Fetait do të jetë provokim i hapur ndaj myslimanëve të vendit dhe, është mirë që të alarmohen të gjitha strukturat e vendit dhe ato ndërkombëtarë që funksionojnë në vend se, mund të vie deri te një destabilizim i panevojshëm dhe deri te një radikalizim i brendshëm i cili mund të ketë pasoja të paparashikueshme. Sepse, askush nuk do të durojë që të manipulohet prej Shaqir Fetait dhe të vihet në shërbim të pushteteve të ndryshme partiako-politike! Për dallim prej Shaqir Fetait, xhemati ynë i gjërë ka dinjitet dhe meriton të respektohet dhe jo të manipulohet./Kombetare/09.07.2021

Cinizmi i Shaqir Fetait

**Fjalori i Gjuhës Shqipe, fjalën cinik e shpjegon kështu:
“(Njeriu) Që mban qëndrim përbuzës e tallës kundrejt normave të moralit të shoqërisë, dhe kundrejt çdo gjëje që është pranuar e që nderohet nga të tjerët; që shpreh cinizëm, mospërfillës, përbuzës, i vrazhdë e i pacipë. I këtillë është Shaqir Fetai. Ja se pse –**

Nga Omer Ismaili

Nëse navigon në facebook-un e Shaqir Fetait, veç të tjerash, do të hasësh edhe në një fotografi me diçiturën: “U nderova me vizitën e z. Feti Isenit, Esnaf i Çarshisë, dhe nipit të tij, hoxhës së shquar, Dr. Abdulkerim ef. Iseni, profesor në SHMI “Medreseja Isa Beu”, që kishin ardhur për të na uruar përgjegjësinë e re.”

I pyeta disa miq e shokë që i kam në Shkup, si nga mesi i esnafit ashtu edhe nga mesi i hoxhallarëve, askush nuk i njihte. Kurrë nuk kishin dëgjuar për këta dy emra dhe, as që dihet se pse e kishin vizituar Shaqir Fetain!

Çarshia është e madhe, por, Medresja e vogël, për nga kuptimi familjar, që duhet të njihen të gjithë në mes vete! U gëzova që aty po ligjëruaka një doktor shkence. Fort më erdhi mirë, edhe pse nuk po dihet se i cilës shkencë është doktor “hoxha i shquar”, siç thotë Shaqir Feail!

Por, shtrohet pyetja se si sillet tetë muaj më vonë Shaqir Fetai me këtë “hoxhë të shquar”, me këtë doktor shkence dhe profesor i nderuar në Medresenë e Isa Beut? Sjellja e Shaqir Fetait dëshmon se atij nuk i ha palla për shkencë, as për nxënësit e Medresesë, as për “hoxhallarët e shquar”! Shaqir Fetai e ka dert vetëm vetëveten dhe askë tjetër!

Në vend se ta avancojë doktorin në fjalë, në vend se ta punësojë në Fakultetin e Shkencave Islame, ai e rrëmben për vete, sepse ai mendon se në Medrese duhet të ligjërojë llumi i “profesorëve”, po ashtu edhe në FSHI! Doktor Abdulkerimi vendin e vet e ka në mesin e kolegëve në FSHI e jo të punësohet në rolin e sekretarësh!

Shaqir Fetai, këto ditë ngeli pa shef të kabinetit dhe, në kërkim e sipër, e paska gjetur këtë doktor shkence! A nuk është ky cinizëm i llojit të vet. A nuk di ta prodhojë këtë cinizëm vetëm ciniku Shaqir Fetai, i cili, me shumë ëndje ka qejf të tallet dhe të përbuzë personalitete, autoritete me integritet të plotë, sepse, ky është roli i fuksave!

Medresja ka ngelur pa një doktor shkence, sepse Shaqir Fetai ka mbajtur llogari që kabineti i tij të jetë me një shef doktor! Po a e di Shaqir Fetai se çka do të thotë “shef kabineti”? Në fakt, cili është koncepti i Shaqir Fetait për “shëfin e kabinetit”? E ftoj publikisht që të dalë e të më shpjegoj se, në pikëpamjet e tij, cili është roli i shefit të kabinetit, çka parasheh për të sistematizimi i punës, cilët janë detyrat, obligimet, kompetencat e shefit të kabinetit. Apo, Shaqir Fetai mendon se, shef i kabinetit do të thotë “sekretarësh” që mbanë llogari për lidhjet telefonike!

A nuk është cinizëm i paskrupullt ky i Shaqir Fetait? Shaqir Fetai, puçisti dhe komplotisti, injoranti e i dobëti, të angazhojë për shef të kabinetit të tij person që ka titullin e doktorit të shkencës?!

Shaqir Fetai, me pas qenë vetëm pak shpirtmirë, edhe nëse ka pasur interveime partiake, nuk do të duhej të pranonte që për shf të vetin të ketë një doktor shkence, sepse ky e ka vendin në institucionin ku bëhet shkencë, në vatrat mësimore, t'i mësojë nxënësit dhe studentët, e jo të drejtojë qime arabi me Shaqir Fetain cinik e injorant.

Me cinizëm nuk përfitohe asgjë, përveçse urrejtja e shoqërisë! / 1KlikLarg / 10.07.2021

Rrenat e Shaqir Fetait po i kushtojnë shtrenjtë BFI-së

Shaqir Fetai na u paraqit nga Kërçova, pa iu dridhur qerpiku në interpretimin e rrenave të tij bajate. Edhe me shall edhe rrencak – turp i madh! Shaqir Fetai mendon se gjithçka në BFI fillon me te, se edhe islami në Maqedoni fillon që kur ai u instalua në krye të BFI-së nga shërbimet antiislame të qarqeve politike të pushtetit aktual maqedonas.

Shaqir Fetai, meqë vetë është jeshil, meqë vetë vie nga partia e jeshiltë, na thotë se sot Myftinia e Kërçovës e paska marrur “pazarin e jeshiltë”! Mbase mendon me logjikën e atyreve që u ka shërbyer tërë jetës, me sintaksën e atyreve padronëve që e ka të instaluar në tru, të cilët, pazarit të fruta-perimeve i thonë “zelen pazar”!

Derisa kryetari i Kërçovës mundohet të jetë më i sinqertë se Shaqir Fetai, derisa kryetari Fatmir Dehari e pranon se procesi i kthimit të pazarit të fruta-perimeve në pronësi të Myftinisë së Kërçovës, daton qysh herët, madje për këtë ka një meritë të posaçme “ish-kryetari i BFI-së”, tash i ndjerë, (aludon në ish-myftiun Murat ef. Useini), megjithatë, zotëri Dehari nuk e fsheh një të vërtetë: ky proces ka filluar dhe është kryer në kohën e H. Sulejman ef. Rexhepit, të cilin e kanë shërbyer që nga Ali Ahmeti e deri te portiri i BDI-së, dhe në kohën e Murat Useinit, kohë kjo kur Shaqir Fetai ka thurrur plane e projekte për komplotin dhe për realizimin e pritshmërive të udbashëve si serbë ashtu edhe maqedonasë.

Shaqir Fetai para kamerave këtë meritë ia pranon vetëm Murat ef. Useinit, por, rrenë, si pis i keq, kur thotë se, falë myftiut aktual (emri i të cilit nuk na kujtohet as ne por as myslimanëve të vendit)

falë angazhimit të tij madhor, na qenka kthyer “pazari i gjelbërt” në pronësi të vakëfit të Myftinisë së Kërçovës!

Po kur u bë ky farë myftiu kaq pehlivan! Kush na qenka ky që kaq shpejt, brenda muajit kthen në pronësi prona të cilat tash e 30 vite nuk po ia arrinë t’i kthejë BFI-ja!

Shaqir Fetai duhet një herë në jetë të dëshmohet se është burrë dhe se nuk është i “ylbertë”! Të pranojë se, vendimi për kthimin e kësaj prone është i prerë shumë më herët dhe se tek sot ekzekutohet! Më se dy-tri vite vendimi ka qenë në të mirë të Myftinisë së Kërçovës por, qëllimisht është zvarritur rikthimi. Mbase është dashur të arrihet marrëveshja në mes të Komunës së Kërçovës dhe Shaqir Fetait që mos të paditet në gjyq Komuna dhe mos t’i kërkohet dëmshpërblimi, për shfrytëzim të paligjshëm të pronës së huaj!

Pra, Shaqir Fetai nuk ka kthyer pronë, prona ka qenë e kthyer qysh më herët, Shaqir Fetai ka falur borxhe duke e dëmtuar vakëfin e Myftinisë së Kërçovës dhe të mbarë BFI-së.

Rrenat e Shaqir Fetait po i kushtojnë shtrenjtë BFI-së. Por, Shaqir Fetai nuk e ka dert BFI-në, as se sa dëmtohet ajo, Shaqir Feti e ka dert vetëm lojalitetin e skajshëm ndaj partisë që e ka instaluar dhe që kërkon ta mbajnë sa më gjatë të instaluar. Shumë shpejt partia instaluese do të kuptojë se sa shtrenjtë do t’ju kushtojë ky fuks!

Sa i përket Kryetarit të Kërçovës, ky de për të cilin u dyndën shqiptarët nga katër anët e botës për t’ia sigurur postin KRYETAR i parë shqiptar i Kërçovës, këtij komandanti të respektuar të UÇK-së, këtij luftëtari legjendar – a i ka hije këtij që të takohet me nxënësin e udbashit Stanko Dragoviqit? I ka hije që këtij farë udbashi t’ia rrisë aksionet në dëm të vetes? Mbase mendon se, duke e bërë këtë gjest në të mirë të BFI-së, do të sigurohet ndonjë plus votë për në zgjedhjet e pritshme! Atij i ka pasur hije që t’ia kthejë Myftiut të Kërçovës, pa lejuar që të takohet me ORAO-n, sepse, nuk ka se çka takohet e çka pret të mira Fatmir Dehari prej një udbashi të sojit të Shaqir Fetait. Me ORAO-n humb shumë, sinqerisht! /Lajme7/09.07.2021

Shaqir Fetai e ka një siklet

I vetëdëshëm se nuk e njeh askush, i vetëdëshëm se edhe ata që e njohin, e njohin nga prezantimi me fjalë të mëdha që ia ka bërë ish-babai i tij shpirtëror, H. Sulejman ef. Rexhepi dhe, në këtë siklet, si atëherë ta prezantojë vetëveten! Kush është Shaqir Fetai që po na flet nga minberi gjatë ditëve të xhuma? Reisi? Si erdhi deri aty? Kush e bëri? Kush është ky more që po na drejtohet si dhelpira nën çallmë

Nga Milaim Memishi

Këtë xhuma, Shaqir Fetai e fali në Xhaminë e Sheh Selimit, në Kërçovë! Xhematit të kësaj xhamie iu drejtua edhe me hutben e përzier me elemente politike, me vetëlavdërim, me rrena, me trillime, me shpalosje të të vërtetave nga të cilat ai skuqet e bëhet gjyvezi; e kap një siklet nga i cili del vetëm duke u ngushëlluar me faktin që xhemati nuk di asgjë nga të vërtetat, prandaj edhe nëse e gënjen nuk bën ndonjë mëkat! Kjo është logjika e Shaqir Fetait!

Shaqir Fetai nuk e di formatin e vetëprezantimit, nuk e di metodologjinë e qasjes në fjalim, nuk e di strukturën e fjalimeve bashkëkohore, nuk i di elementët kryesore që duhet t'i ngërthejë një fjalim, një prezantim i një teme para një auditoriumi. Shaqir Fetai hala mendon se fjalim do të thotë të shpërndashë mjegull, të shpërndashë entuziazëm të rrejshëm, të pallamudish kot e kot.

Kush e ka njohur nga xhemati në Xhaminë e Sheh Selimit? Kush e ka parë ndonjëherë, apo, ata që e kanë parë, në krah të djathtë të të cilit personalitet e kanë parë, ata që kujtohen që e kanë parë,

fjalët e cilit njeri tingëllojnë në veshin e tij e që i ka dëgjuar gjatë prezantimeve lavdëruese kudo që e ka marrur me vete! Vë bast që xhemati i kësaj xhamie nuk e dinë se ku i bie Çegrani e jo më të njohin ndonjë munafik nga Çegrani!

Shaqir Fetait i mjafton ajo që kanë marrur vesh së po vie “reisi” që ai pastaj të jetë i qetë dhe të futet drejt e në temë, për të thënë atë që ka për ta hedhur si gënjeshtër, apo si kopalla të hipokritit.

Fjalimet bashkëkohore, para audotiriumeve, për hirë të respektit, secili që do të drejtohet, qoftë ai edhe akademiku më i njohur, shkrimtari më i njohur, mjeku, shkencëtari, astronauti, kirurgu, kozmonauti më i njohur në botë, të cilët do të njiheshin nga i madh e i vogël në botë, fillimisht do të prezantohej me emër e mbiemër, pastaj do ta tregonte fejlën nga vjen dhe, së fundmi do të fliste për karrierën e vet, për të arriturat e veta jetësore si dhe për planet të cilat, natyrisht, do ta avansonin edhe më tej, jo personalisht atë, por mbarë shoqërinë! Ky është kyptimi i paraqitjes para cilitdo audotirium bashkëkohor!

E pra, si të paraqitet Shaqir Fetai? Çka t’iu thotë xhematit, kush është ai? Me çka e meritoi atë post në emër të të cilit paraqitet! Si u bë që u instalua në krye të BFI-së? Cilat janë të arriturat e tij në të kaluarën që e paskan ndriçuar BFI-në, e cila, paska vendosur që të drejtohet pikërisht prej këtij! Si t’iu thotë xhematit se, jam unë ai që ia futa thikë pas shpine ish-Reisul Ulemasë, si t’iu thotë që jam unë ai që e hodha prej minares poshte dhe që ia zura vendin ish-reisit! Si t’i numërojë të arriturat e BFI-së kur ato do t’i taksoheshin të gjitha Sulejman ef. Rexhepit! Si t’i thotë planet kur ai të vetmin plan e kishte që ta realizojë kërkesën e nëntokës antiislame në raport me BFI-në! Ai plan tjetër nuk pati, prandaj, si t’ua thotë planet për perspektivë!

Shaqir Fetai ngjitet në mimber dhe sakaq ia krisë një ajeti kuanor, të cilin pastaj e bën tërkuzë në thes! Në kontekst të asaj që e citon, qoftë si ajet qoftë si hadith, Shaqir Fetai gjithnjë mundohet ta fusë vetëveten si personazh, ta kahasojë veten me personazhet apo me aludimet e shenjta. Sepse, është shumë i vetëdëshëm për mëkatet që i ka, prandaj, mundohet ta gënjejë edhe vetëveten!

Në hutben e fundit, ai mbajti një fjalim politik, ishte në elementin e organizatorit të fushatës partiake të kryetarit aktual të Kërçovës, të cilin madje e përmendi edhe në minber!

Për Shaqir Fetain lajm përbënë fakti që “në prezencë të tij” u nënshkrua pranim-dorëzimi i “pazarit të gjelbër”! Ngjarjet e tjera dytësore që përcjell ky lajm janë përplotë trillime, rrena dhe hipokrizi e Shaqir Fetait. Lajmi është : “në prezencën time u nënshkrua”! Kurse prezenca e tij është baraz me zeron, kudoqoftë dhe kudo ku ndodhet ai!

Ai pastaj, të kaluarën e vet prej hajni dhe prej pisi, prej zhvatësi të vakëfit e prej keqpërdoruesit të vakëfit, mundohet të shpërfaqet në të devotshëm! Thotë që me kthimin e këtij vakëfi në Myftininë e Kërçovës qenkan çelur fytyrat e atyre që pronat e veta i kanë lënë për të mirën e islamit!

Po vetë Shaqir Fetai, çka ka bërë dhe çka po bën me vakëfin? Pse lejoi që ky vakëf të shfrytëzohet mbi tri vite nga një pronar i paligjshëm ndërsa në fund nuk i kërkohet dëmshpëblimi! Mendon Shaqir Fetai se ata që i kanë lënë pronat e veta vakëf, do t’ia falin këtë hile? Çka ndodhi me vakëfin në malin e Gazibabës?

Po “Ibni Pajko” a nuk është vakëf?

Po bonat në vlerë a nuk janë formë e vakëfit?

Po qendra tregëtare të cilën do ta ndërtonte Banka Islamike për Zhvillim me nijetin që tërë ai objekt t’i lihej vakëf Gostivarit, pse e dështoi ky farë hipokriti, a nuk do të bëhej edhe kjo qendër vakëf?

Po ish-objekti i Myftinisë së Shkupit a nuk është vakëf?

Vërtet cilën pronë e ktheu Shaqir Fetai që kur u instalua në krye të BFI-së, pa i përvetësuar ato që janë meritë e personaliteteve të BFI-së që decenie kanë ngritur iniciativa, kanë prezantuar nëpër gjyqe e gjykime duke i mbrojtur interesat e BFI-së, kanë finansuar përgatitjen e qindra dokumentave, kanë bërë hartëzimin e vakëfit të Shkupit, kanë kontribuar edhe me autoritetin dhe personalitetin e tyre, si në rastin e hapësirës së ish-Komunalecit!

A nuk është vakëf hapësira e ish-Komunalecit ku po ndërtohet diçka ndërsa myslimanët e vendit, sikundër edhe organet e BFI-së, nuk dinë asgjë se çka po bëhet aty!

Finalizimi i çështjeve nuk është meritë e Shaqir Fetait, sepse, megjithatë, ky nuk ka kurrfarë merite në BFI, thjesht, ka qenë maune, “shleper”, që tërë jetës është tërhequr nga shoferi profesionist. Ky është i pamërituar edhe për vendin, postin, ku është instaluar nga pushteti aktual maqedonas. Ky mund të lavdërohet, me meritat e huaja, megjithatë, siç thotë një katundar i tij sa herë që flitet për Shaqir Fetain –

“Gomarit nuk i ka hije shala! Gomari është për samar ngarkur me dru”!

Këtë fakt e di edhe Shaqir Fetai! Ky fakt po e sikletosë së tepërmi Shaqir Fetain, alias, ORAO-n!/ 1KlikLarg/10.07.2021

Zero identitet fetar e kombëtar i Shaqir Fetait

Në jetën e Shaqir Fetait kanë ndodhur ngjarje interesante që sot manifestohen si komplekse të tmerrshme të tij. Ai sot, në rrafshin fetar ndjehet hipokrit, tradhëtar, i pamërituar, mynafik e shumë i keq, në rrafshin kombëtar ndjehet pa identitet, sepse, atë e ka shitur që moti, qysh si student

Nga Berat Rrahmani

Shaqir Fetai, në facebook-un e vet kësaj radhe na i kishte publikuar nja dy diçitura të cilat ai i përkthen si lajme mbi aktivitetin e tij! Në fakt, asnjëra dhe as tjetra nuk përbën kurrfarë aktiviteti të Shaqir Fetait, nuk e përfshijnë atë në ngjarje, madje as që i aktualizon ngjarjet, thjesht, nxjerr ca diçitura sa për ta shuar dhembjen e shpirtit që e ka, sa për të kamufluar injorancën dhe pasivitetin absolut të tij, sa për të fshehur atë bishën e tmerrshme që fle brenda tij, natyrisht, pas shumë aktiviteteve tradhëtuese që i ka kryer, si në kohën deri sa ka qenë student (i porositur nga udha serbe për t'i përcjellë studentët shqiptar por dhe të tjerët), pastaj si “teolog” nën influencën e baballëkut të vet duk kaluar në mik të ngushtë i antishqiptarit më të madh që ka pasur ndonjëherë rrafshi i Pollogut, Temellko Boshkovski dhe, së fundmi, duke u trimëruar me përkrahjen “e merituar” nga pushteti aktual maqedonas. Natyrisht, përgjatë tërë këtij angazhmani ka pasur edhe moralisht viktima mbi të cilët Shaqir Fetai ka shkelur si kalë i harbuar.

I gjendur nën këtë trysni psikike, ai mundohet të aktrojë, të imponohet si i pafajshëm, si shpirtmirë, si i devotshëm. Por, ata që e njohin, për të flasin si për më të keqin e të këqinjëve, i cili, mund të vegjetojë vetëm në mesin e të këqinjëve, pisëve, kopukëve.

Në Strugë Shaqir Fetai zhvishet cupllak

Shkon Shaqir Fetai në Strugë, për ta theksuar emrin dhe mbiemrin e hafëzit më të ri të Strugës! Dhe ky nuk përbën sukses, nuk përbën sukses as mësuesi i tij shpirtëror, të cilit as që ia përmendë emrin, për të përbën sukses, aktivitet, lajm, madhërimi i Mr. Salim Sulejmanit! Se çfarë merite ka ky në shkencë, se çfarë punimesh shkencore ka publikuar, se cila është pesha e tij intelektuale në Strugë dhe më gjërë, kjo fare nuk i intereson Shaqir Fetait. Për këtë dylber është me rëndësi të tregohet se sa i suksesshëm na qenka Salim Sulejmani si “magjistër”!

Shaqir Fetai shkruan: “Sot, mbas shumë decenieve, u promovua hafizi i ri Arijeton Zeqiri nga Struga”, që, sipas kësaj që ka shkruar Shaqir Fetai i bie që hafëz Arijetoni, më në fund, pasi u mundua decenie e decenie, më në fund doli hafëz! Nëse dëshiron të thotë se është dashur të kalojnë decenie e decenie deri sa të dalë një hafiz në Strugë, atëherë, ku është këtu suksezi i Shaqir Fetait, i cili me decenie ka qenë anëtarë Rijaseti? Po ku është këtu aktiviteti dhe kontributi fetar i “magjistrin” i cili, edhe pse injorant, dibidyz, ka qenë anëtarë i Rijasetit. Pse nuk ka pasur deri tani hafëz të ri nga Struga! Çka ka bërë kjo Myftini, si e organizon jetën fetare islame kjo Myftini! Medresja është meritë e hafizllëkut të Arijetonit e jo Myftinia e Strugës, aq më pak bilmez Salimi.

Na tregon Shaqir Fetai dhe na thotë: “organizuar nga Muftinia e Strugës në krye me Muftiun Mr. Salim ef. Sulejmanin.” Do me thënë, nuk është lajm hëfëzi i ri, nuk është ngjarje madhështore procesi nëpër të cilin kaloi hafëzi i ri, nuk është për t’u mburrur deri në kupë të qiellit hoxha që e nxori hafëzin e ri, por, ngjarje përbën “organizimi i përrurimit nga Mr. Salim Sulejmani”! Ndërsa tërë bota e di se mr. Salim Sulejmani është vetëm një bashkëtradhëtarë i Shaqir Fetit, i cili iu bashkua në tradhëtinë më të tmerrshme në historinë e BFI-së – në puçin dhe komplotin e organizuar kundër njeriut që ia dha titullin “myfti”, kundër Sulejman Rexhepit. Tani Shaqir Fetai, i frikësuar se “magjistri” po e tradhëton këtë dhe po i kthehet Sulejman ef. Rexhepit, nisë dhe

na e imponon Salimin si një prej kontribuesve më të paarritshëm në zhvillimin e jetës fetare islame në këtë vend! Kështu mendon vetëm hipokriti, mëkatari, ai që ka presion të papërballueshëm në shpirt e në psikikë! Çka sikur Shaqir Fetai ta kishte kundërkandidat edhe Shaban Sulejmanin, dekanin e FShI-së? Të jetë i sigurtë që nuk do ta kishte votën e Salim Sulejmanit, i cili, me Shaban Sulejmanin, përveçse që kanë lidhje partiake, e kane edhe një linjë speciale e cila do ta detyronte Salim Sulejmanin t'ia jepte votën Shaban Sulejmanit. Ketë shkarje të mundshme e kupton edhe Shaqir Fetai, prandaj mundohet ta mbaje sa më pranë vetes duke e lavdëruar. Mbase edhe nga dëshira e flaktë për ta pasur edhe ky atë lidhje të veçante me Salim Sulejmanin siç e ka ky me Shaban Sulejmanin!

Shaqir Fetai të gjitha kontributet e myslimanëve të Strugës, ia atribuon si merita ekskluzive si dhe si “krijime”, apo ndërtime ekskluzive të Salim Sulejmanit. Nisur nga ky mentalitet ofendues, mohues dhe minimizues, Shaqir Fetai në diçiturën e vet do të shkruajë edhe këtë pasus ku i radhitë “sukseset” e “myftiut: “Ishte një gëzim i madh i besimtarëve, e në veçanti Muftiut të Strugës, i cili pas ndërtimit të Xhamisë Qëndrore, Selisë së Muftinisë, Xhaminë e bukur- Simbol i arkitekturës në Strugë “Xhamia e Lulishtes”, hafizi i parë shënon edhe një sukses të radhës të Mr. Salim ef Sulejmanit dhe Muftinisë që udhëheq!”! A durohet ky ofendim! Po pse kaq lavdërata ia shpreh Salim Sulejmanit, për të cilin dihen të gjitha veprimet e tij (nëse do edhe ia numërojmë)! Apo, sepse i duhet, druan se do t'i ikë, edhe pse është shumë i vetëdëshëm se do t'i ikë shumë shpejt, sepse, talljet e pista të Shaqir Fetait nuk durohen. Edhe vetë Salim Sulejmani është shprehur se Shaqir Fetai ka lavdëruar së tepërmi, e ka turpëruar, e ka tallur para myslimanëve të Strugës!

Karasevdaliu, i pasionuari në dylbverizëm, Shaqir Fetai, diçiturën e vet e përfundon m :” Ishte një organizimi i bukur dhe pritje e ngrohtë vëllazërore.! Do me thënë, një organizim i denjë dhe një pritje madhështore për Shaqir Fetain në Strugë! Ky është lajmi, tjetra që ndodhë është vetm “pasoje e lajmeve mbi Shaqir Fetain”! Nuk është kjo krizë mendore e shpirtërore e këtij farë instalacioni të pushtetit maqedonas në krye të BFI-së, a?

Shaqir Fetai i ka “shitur drunjtë” qysh më vitin 1984

Diçitura e dytë, në fak, është imitim partiak i disa funksionarëve të BDI-së, të cilët, për sens politik, publikojnë “epitafe”, “diçitura”, “mbishkrime” rreth asaj që ishte shumë aktuale këto ditë, mbi Masakrën e Srebrerincës! Natyrisht, këta Funksionarë, herë pas here publikojnë edhe ndonjë diçiturë kombëtare, ndonjë madhështim, apo përkujtim të ndonjë ngjarje!

Në këtë vazhdë, që mos të ngelë prapa funksionarëve të BDI-së, edhe Shaqir Fetai e përkujton me dhimbje Masakrën e Srebrenicës! Me pas qenë origjinal, i vetëvetes, me dhembje në shpirt këtë ngjarje Shaqir Fetai do ta përkujtonte duke organizuar, për shembull, në tërë territorin e Maqedonisë së Veriut, Hutbe mbi këtë masakër! Apo, në të gjitha xhamitë, ku mundësojnë kushtet kadrovike dhe numri i xhematit, do të organizonte hatme për shpirtërat e masakruar në këtë ngjarje të tmerrshme! Do të organizonte edhe tribuna nëpër xhami, në media, thjesht, do t’ua kushtonte këtë ditë myslimanëve të Bosnjë-Hercegovinës! Natyrisht, që tërë kjo punë i duket hangari Shaqir Fetait, prandaj, ai vepron aty ku mund të përfitojë, në qëndrimet partiake të BDI-së! I kopjon, duke u përcjellë mesazh të tipit “hej, edhe unë jam me ju, vëmendje edhe te unë”!

Le t’ia përkujtojmë Shaqir Fetait këtu edhe disa ngjarje të tjera, po kaq të tmerrshme, që u ka ndodhur shqiptarëve të Kosovës dy decenie më parë!

- 5, 6, 7 Mars 1998 – ku forcat paramilitare serbe hynë në fshatin Prekaz dhe vrasin e masakrojnë 56 anëtarë të lagjes Jashari, mesin e tyre vritet edhe legjenda e kombit Adem Jashari;
- Me 15 janar të viti 1999 forca paramilitare serbe hyn në fshatin Reçak ku bënë kërdi duke vrarë, prerë, e masakruar mbi 70 persona nga ky fshat;
- Me 28 mars 1999 forca të armatosura serbe hynë në fshatin Izbicë të Komunës së Skenderajt, ku kryejnë masakër të tmerrshme mbi dhejtra shqiptarë, duke mos lënë anash fëmijë, gra e pleq;
- Po kaq e tmerrshme ishte edhe Masakra e Rezallës, ndodhur më 5 prill i viti 1999, me çrast u masakruan nga hordhitë serbe mbi dhjetra fëmijë, gra e pleq;

- Në qershor të vitit 1999, hordhitë barbare serbe do të kryejnë një prej masakrave më të tmerrshme dhe të paparë anekënd botës! Në shenjë hakmarrjeje kundër bombardimeve të NATO-s, serbët do të kryejnë masakër mbi dhjetra të burgosurit shqiptar në Burgun e Dubravës;
- Më 25,26,27 mars 1999, në fshatin Krushë të Madhe, në Rahovecit, çetnikët serbë kryen një prej masakrave më të tmerrshme që u ka ndodhur njerëzimit. Tërë katundi ngeli vetëm në gra, serbët u përkujdesën që t'i vrasin e therrin të gjithë burrat, madje çdo gjë të gjinisë mashkull;
- Më 2 maj të vitit 1999, bandat serbe në Studime të Vushtrrisë vranë mbi 140 shqiptarë, burra e gra, pleq e fëmijë.

A di ndonjë shqiptarë i Maqedonisë së Veriut të na thotë në mos ka dëguar për përkujtimin e këtyre ngjarjeve, të këtyre datave, nga ana e Shaqir Fetait dhe myftilerëve të tij! A nuk bën që të organizohet ndonjë event fetar (qoftë një hatme në nivel të shtetit) për secilën datë veç e veç, me çrast do të përkujtoheshin krimet gjenocidale të tërë serbëve që i ushtruan mbi shqiptarët e Kosovës! Apo, rreth këtyre datave nuk guxon të fërkohet Shaqir Fetai, sepse menjëherë do ta “tërmekin” udbashët e Serbisë, punëdhënësit e vërtetë të tij!

Në bazë të një dokumenti nga dosja policore serbe, që mbanë datën 10. 09. 1984, Shaqir Fetai që nga kjo kohë “i ka shitur drunjtë”, i ka larë duart nga kombëtarizma! Kurse në fetarizëm është dëshmuar si një prej hipokritëve dhe mynafikëve të paparë në këta treva dhe më gjërë!

Kjo dëshmon për zero identitet fetar e kombëtar të Shaqir Fetait./1KlikLarg/13.07.2021

Strategji e re takimesh e Shaqir Fetait

Shaqir Fetai deri më sot, shquhet si “mjeshtër” i takimeve me lloj-lloj individi, me turlifarë mahluki, vetëm e vetëm të ketë mundësi që të shesë kopalla, ndësa si kundërshtëpërbllim, të flladitet me urimet dhe përshëndetjet e atyre që i takon! Po pse kjo dëshirë kaq e madhe për të takuar njerëz të ndryshëm?! Kur iu shfaq kjo sëmundje psikike? Natyrisht, me publikimin e dokumentit ku ai shihet se si spiunon në UDB-në serbe, nën pseudonimin ORAO, ai e ndjeu se i ikën të gjithë njerëzit! U lëshua pas strategjive të takimeve, duke ftuar njerëz dhe duke i manipuluar, ttrak një foto dhe, menjëherë lajm! Tani do t’i takojë gjeneratat e Medresesë Isa Beu”

Nga Blerim S. Bexheti

Më herët ishte më e vështirë, ishte përpjekje, shtëpi më shtëpi, që të ftohen të gjithë shokët e gjeneratës në një takim të madh të gjeneratës së iks vitit shkollor! Tani është më lehtë, përmes rrjeteve sociale, brenda natës po merren vesh. Natyrisht, organizatori përpigjet në maksimum që të sigurojë sa më shumë pjesëmarrës nga gjenerata, të paguajnë një shumë simbolike, sa për të organizuar një takim gjenerate e për ta zbardhur një natë nëpër restorante të ndryshme, duke evokuar kujtime mes miqësh e shokësh të dikurshëm! Takime të tilla organizojnë gjithandej! Natyrisht, do t’i ftojnë edhe kujdestarët e klasave të gjeneratës, prej të cilëve, dikush nuk prezanton se tashmë ka vdekur, dikush nuk e ka princip t’i kthehet të kaluarës, dikush nuk ka kohë dhe, kështu, nëse prezantojnë një-dy kujdestarë klasash!

Ndërsa, këto ditë, në Medresen Isa Beu ndodhi një tjetër “takim”, i cili, më tepër t’i përkujton takimet e kurdisura nga pushtetet totalitariste, se sa takimet e singerta.

Gjenerata e pestë e nxënësve të Medresesë, qenkan “dyndur nga katër anët e botës” dhe realizuan një takim me stafin arsimor dhe me drejtorin e Medresesë Isa Beu, Ibrahim Idizin, i cili, natyrisht që është vënë në shërbim të korigjimit të imazhit të Shaqir Fetait, bashkëpunëtorit të UDB-së që viteve ’80 paska spiunuar studentë shqiptarë dhe jo vetëm, në këtë shërbim famëkeq antishqiptar! Në këtë “aktivitet”, mbase fshihet sekreti i kësaj dëshire kaq të flaktë i Ibrahim Idrizit për t’i shërbyer verbërisht Shaqir Fetait! Nejse, është zgjedhje e tij personale, por, a po e sheh drejtori në fjalë se është shndërruar në lolo, në vegël realizuese të intrigave e të rrenave të Shaqir Fetait!

Nga fotot që i sheh njeriu, sakaq e krijon përshtypjen se Medresja ishte shndërruar në çerdhe udbashësh e jo në vatër e diturisë ku dikur ka mësuar edhe gjenerata e pestë!

Qenkan dyndyr nga katër anët e botës!!! Po sa nxënës kanë pasur ato dy paralele të kësaj gjenerate! Mbi shtatëdhjetë po një her! Apo, vetëm 10-15-20! Ose, kaq i gjeti drejtoi në bashkëpunim me Shaqir Fetain sa për të organizuar një takim që do të jetë në funksion të përmirësimit të imazhit të fuksit, Shaqir Fetait!

Si ndodhi që të thyen “ligjet”, principet e “takimit të gjeneratave”, si ndodhi që, sakaq, na paraqitet një “gjeneratë” që do të shprehte dëshirë të takohet jo mes vete por, me stafin arsimor, me drejtorin e shkollës dhe, për më tepër, me “reisin”, për të cilin që të gjithë janë të bindur se është instalacion i pushtetit maqedonas në krye të BFI-së!

Fare në fund, lajm përbënë edhe emocioni i ish-nxënësve kur i paskan vizituar bangat e klasës ku kanë mësuar, krevatat ku kanë fjetur, pirujt, lugët, thikat me të cilat kanë hëngër, profesorët me të cilët janë tallur duke i quajtur me nofka të ndryshme, jo “bythlepuri”, jo “buzëpele”, jo “xhuxhi”, e me lloj-lloj nofkash!

A ju kujtohet Rankoviqi si tallej me shqiptarët që i kishte bashkëpunëtorë të vet?! Sa herë që dilte në gjyeti për të gjuajtur ndonjë derr, i detyronte bashkëpunëtorët e vet shqiptarë që të lehnin si zagarë dhe t'ia drejtojnë derrat kah pushka e tij! Shumë shpejt disa sahanëlëpirësa do të kuptojnë se Shaqir Fetai ia ka ënda që ta aktrojë Rankoviqin dhe bashkëpunëtorët e tij t'i çojë që të lehin e t'ia sjellin viktimën para këmbëve! Kaq shpirt ka Shaqir Fetai, por, edhe kaq tru kanë bashkëpunëtorët e tij! /1KlikLarg/13.07.2021

Libri

**TRADHËTIA DHE KOMPLOTI I SHAQIR FETAIT NË KOHË
PANDEMIE**

Profili psikologjik i Shaqir Fetait

Pas botimit të librit (botim fizik dhe elektronik) “TRADHËTIA DHE KOMPLOTI I SHAQIR FETAIT NË KOHË PANDEMIE”, nga Korporata për Produksion, Informim dhe Botim, “1kliklarg.com”, disa lëndë që trajtojnë fenomene psikiatrike nëpër Universitetet e Shqipërisë, kanë vendosur që ta përdorin si literaturë bazë për gjetjen e profileve psikike për personat e ndryshëm që preken nga çrregullimet psikike, paranoja, prej të cilës është konstatuar se vuan edhe Shaqir Fetait, i njohur si instalacion klasik i pushtetit aktual maqedonas në krye të Bashkësisë Fetare Islame në RMV

Nga Dr. Justiniana Shore, psikologe, Tiranë

Një grup mjekësh shqiptarë (dy nga Shqipëria, një nga Kosova e një nga Maqedonia e Veriut) kanë kryer një profil psikologjik të Shaqir Fetait, bazuar në shkrimet e publikuara përgjatë një viti e gjysëm në mediat e vendit dhe në atë ndërkombëtar, dhe të përmbledhura në librin me titull “Tradhëtia dhe komploti i Shaqir Fetait në kohë pandemie”, i cili u botua me rastin e një vjetorit të puçit klasik dhe komplotit të organizuar nga ish-myftiu i Gostivarit, Shaqir Fetait. Pra, libri në fjalë ngërthen vetëm materien e botuar përgjatë një viti dhe botohet nga Korporata për produksion, informim dhe botim “1kliklarg” me seli në Tiranë. Vlenë të theksohet se, në rastin e Shaqir Fetait, të gjithë mjekët-psikologët kanë dhënë të njëjtën diagnozë: ÇRREGULLIM PARANOID I PERSONALITETIT.

Paranojaku “vigjilent” në mbështetje të paranojës së vet

Teksti i më poshtëm është fragmente nga një raport më i gjatë profesional, shkencor dhe i mbështetur në literaturën përkatëse e që

shërben si modul për ndërtimin e një profili psikik bazuar në ato të dhëna që i gjejmë rreth një personi.

Për të pasur një ide më profesionale dhe për të mos krijuar keqkuptime këta mjekë-psikologë iu referuan tekstit diagnostik profesional DSM4-TR (The Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders 2000.)

Psikiatri shqiptar (Petro Z.) thekson se ka një diagnozë në psikiatri dhe në psikologji klinike, që quhet çrregullimi paranoid i personalitetit, i cili diagnostikohet kur tiparet e personalitetit bëhen të dukshme dhe të pandryshueshme, të keqpërshtatura me njerëzit dhe ambientin përreth dhe që shkaktojnë dëmtime të rëndësishme të funksionimit, thuajse në të gjitha fushat e aktiviteteve të jetës së përditshme. Sipas këtij psikiatri shqiptar, personat që vuajnë nga ky çrregullim nuk janë aspak të vetëdijshëm për humbjen e sensit të vetëvetes në raport me të tjerët. Për këtë arsye kurrë nuk kërkojnë mjekim mendor, por imponohen si të gjithëdijshëm, të çiltër, të devotshëm!

Tutje, vazhdon psikiatri shqiptar, nëse i referohemi manualit diagnostik më bashkëkohor të sëmundjeve mendore në përdorim nga klinikistët psikiatër dhe psikologët klinikë, (DSM4-TR 2000) për t'u plotësuar kriteret për diagnostifikimin e këtij çrregullimi, nevojitet mbi të gjitha, këto katër simptome, të cilat, fatkeqësisht, në bazë të shkrimeve të publikuara, në bazë të paraqitjeve të pakta publike, që të gjitha vërehen te Shaqir Fetaj, i vetëquajturi “reis”, apo “kryetar”:

1. Mosbesim dhe dyshim i theksuar dhe i pajustificuar ndaj të tjerëve; dyshime se të tjerët e shfrytëzojnë, e dëmtojnë, e mashtrojnë. Personi që vuan nga ky çrregullim dyshon rreth besnikërisë së të tjerëve, dyshon te bashkëpunëtorët e vet se po ia keqpërdorin informacionet dhe mundohet të zhdukë apo të pengojë hemarrogjinë e informacioneve nga brenda jashtë Institucionit. Bëhet mosbe sues ndaj të gjithëve, për ta provuar të kundërtën, prej të gjithëve kërkon lojalitet dhe nënshtrim!

2. Pacienti vazhdimisht shfaq armiqësi të dukshme ndaj mendimit kundër, ndaj një këshille reformuese dhe, në kokën e tij nuhat organizime destabilizimi, përçarjesh e sulmesh, që vetëm ai (Shaqir

Fetai) i përcepton si të tilla por që askush nga masa nuk i vërenë ato!

3. Paranoidi është i gatshëm të reagojë në çdo çast dhe, në çdo reagim të tij shpërthen nga një skandal, pa përfillur dëmin që mund t'i shkaktojë institucionit që drejton.

4. Personi paranoid (në rasti konkret, Shaqir Fetai), gjithnjë është në lartësinë e “vigjilencës” për ta mbështetur paranojën e vet! Për ta kamufluar para të tjerëve këtë paranojë, ai shpesh duket si adhurues i dramës (meqë paska qenë edhe aktor), i futbollit (meqë paska luajtur edhe futboll), i atyre aktiviteteve që përcillen me duartrokitje frenetike. Paranoidët gjithnjë kanë nevojë për vendime të pavarura nga rrethanat si dhe parreshtur janë në hulumtim të “tradhëtive të mundshme të të tjerëve”! Të gjithë ata që e hetojnë se është paranoid i shpall për “armik” dhe i dëbon nga rrethi i vet. Sjellje kjo tipike e Shaqir Fetait dhe, një tip i tillë paranoid frikësohet prej bashkëpunëtorëve të vet që janë pa kurajo, kompleksivë, imoralë e që i nënshtrohen lehtësisht personalitetit autoritar! Shaqir Fetai, me kërkesën e vet paraojake që gjithçka të vegjetojë rreth tij në fakt i torturon bashkëpunëtorët e vet, dhe, njëkohësisht, u friksohet sepse, në ndërdijen e tij ekziston indje e paluhatshme se ata, sapo të ndeshen me një personalitet tjetër më autoritativ, mund ta tradhëtojnë Shaqir Fetain (sepse thellë në vete e vuan pabesinë, spiunazhin dhe tradhëtinë e vet).

Psikiatri shqiptar në vazhdim citon një pej studiuesve më të shquar në botë të personalitetit (Cameron) i cili nënvizon se: “asgjë nuk i shpëton kontrollit të paranoidëve, sepse ata fare nuk e marrin në konsideratë rëndësinë e realitetit koncensual social. Paranoidët shpikin një “pseudokomunitet” të tyre social”. Informacionet e bollshme që dalin nga këto shkrime për Shaqir Fetain, dëshmojnë se ai gjatë tërë jetës është në kërkim të këtij “pseudokomuniteti”, sepse vetëm aty mund të jetë vetëvetja, jasht këtij “pseudokomuniteti” ai ndjehet “viktimë e armiqve” të konstruktuar vetëm në mendjen e tij paranoide dhe në shpirtin e tij me emocione të çregulluara që e çojnë gjithnjë në ekstremet e ankthit, trishtimit, tërbimit, zemërimit dhe të palogjikshmes! Të gjithë ata që do t'i përcjellin deklaratat pubike të Shaqir Fetait do të vërejnë se kemi të bëjmë me një absolutisht “personalitet të

palogjikshëm”, përfundon pjesën e vet të studimit, psikiatri shqiptar, z. Petro Z.

Karriera e paranoidit

Ndërkaq, në pjesën e vet të studimit, profesori shqiptar, psikologu Abdyl K., thekson se, koncepti i psikopatisë (emërtimi i vjetër i dagnozës së paranoidit), në praktikën klinike përdoret për të treguar tendenca apo mënyra sjellje të papranueshme në drejtim të cënimit të të drejtave të të tjerëve. Këto sjellje vërehen me bollëk te pacienti virtual i përdorur këtu për studim (Shaqir Fetai).

Studiuesit Milon dhe Devis, për këta tipa si Shaqir Fetai, japin këtë definicion: “Kanë egoizmin, pavarësinë, mashtrimin, gënjeshtren, impulsivitetin dhe tendencën për t’i trajtuar të tjerët si objekte, si dhe indiferencën e skajshme ndaj dëmit që iu shkaktojnë të tjerëve”! Dëmin epik (tradhëti, komplot dhe praktikë për shkelje kushtetutare) që Shaqir Fetai ia shkakton Institucionit të BFI-së dhe, përgjithësisht, komunitetit mysliman në RMV, vetëm ai nuk e vërenë (ose kjo ia shkakton kulmin e kënaqësisë)!

Profesor Abdyl vazhdon tutje duke theksuar se, paranoidët njihen për dyshimin e tyre dhe bindjen se janë gjithnjë objekt sulmi dhe përndjekje, jo rallëherë ata mund të arrijnë suksese dhe të bëjnë karrierë të paimagjinueshme, sepse i mbështeten një mekanizmi të gjithëpushtetshëm, qoftë kjo parti apo “komunitet kriminelësh”, dhe kjo pastaj i shndërron në diktator të egër.

Në bazë të shkrimeve të publikuara e të përmbledhura në këtë libër, të cilët e zbërthejnë karakterin dhe fenomenin e Shaqir Fetait, vërejmë se kemi të bëjmë me një personalitet paranoid i cili insiston me nervozizëm e me kryeneçësi në sa më shumë pavarësi dhe pushtet, të mos kontrollohet nga askush, t’i pranohen të gjitha veprimet johumane, të respektohet si person mjaft i ndjeshëm ndaj pushtetit, autoritetit dhe dominimit. Ky është, veç të tjerash, edhe definicioni i studiuesve Oldham dhe Morris mbi paranoidin tipik si Shaqir Fetai, përfundon pjesën e vet të studimit, profesor Abdyl.

Doktor Ibush N. , psikiatër në një spital privat në Kosovë, në studimin e vet mbi profilin psikologjik të Shaqir Fetait, sjell në vëmendje edhe një sërë problemesh që i karakterizon paranoidët që

kanë jetuar edhe pushtete të ndryshme me afinitete armiqësore ndaj qenies shqiptare. Veç kësaj, personat publikë, por edhe ata që kanë pasur fatin të jenë në poste drejtuese, përfshirë këtu edhe Shaqir Fetain, “reisin” e Maqedonisë së Veriut, tashmë me tapinë e bashkëpunëtori të UDB-së, të publikuar në shumë media të vendit dhe botëror, pra, profili psikologjik i personave të këtillë do të ravijëzohej nga këto pika: 1. Stabiliteti mendor; 2. Frika nga autoritetet politike dhe të drejtësisë; 3. Stabiliteti financiar; 4. Dëshira për të shtuar mirëqenien financiare në çdo mënyrë Shaqir Fetai kërkon të paktën dy vjet të jetë “reis”, të pensionohet me këtë titull, sepse pensionin do ta ketë më të lartë!!!); 5. Dashuria/besnikëria ndaj shoqërisë pushtetit dhe shtetit; 6. Marrëdhëniet personale ndaj shokëve ose bashkëpunëtorëve; 7. Lakmia për gjëra për t’u vizituar sa për t’ia shprehur një urim apo një përshëndetje, por edhe imponimi i vetes si i “devotshëm” karshi të tjerëve; 8. Frika nga fuqia e autoriteteve që kanë mundësi të përdorin dhunë ose shantazhim; 9. Shkalla e moralit; 10. Kapaciteti për hakmarrje ndaj një personi të ngushtë nga frika e kapacitetit të atij personi për t’ia kapur dobësitë e numëruara më sipër.

Pra, Shaqir Fetai nuk është trim, por, reagimet e tij të zhurmshme bëhen zakonisht kur ai nuhat se dikush po merret me dobësitë e tij karkteristike për paranoidin. Nga periudha e UDB-së institucione të caktuara shtetërore kanë trashëguar profilin psikologjik të Shaqir Fetait dhe, pa asnjë dyshim sot ia përdorin për shantazhime të ndryshme. Prandaj “liderët” e këtillë janë të dëmshëm për shoqërinë shqiptare, prandaj sa më parë duhet të shporren nga pozitat kyçe në shoqëri.

Paranoidi Shaqir Fetai nga dhuna (shantazhimi se do të nxirret para drejtësie dhe se do të kalbet burgjeve maqedonase për veprimet e veta antikushtetuese gjatë instalimit të tij në krye të BFI-së dhe për një sërë veprimesh kriminale në raport me vakëfin dhe gjatë kohës sa ka qenë myfti e anëtarë Rijaseti);

Frika nga UDB-ja (do t’ia publikojnë dosjen e tij policore përmes së cilës do të dëshmohej se ai ishte agjent aktiv i UDB-së, prandaj dhe ishte insistuesi më i madh te Sulejman ef. Rexhepi për ta bindur që të pozicionohet kundër lustrimit të teologëve në Maqedoninë e Veriut);

Frika nga drejtësia që mund të dëshmojë për korrupsion, krim dhe vjedhje të organizuar (gjë që mund të çojë deri në konfiskim të pronës së arritur në mënyrë të pandershme);

Frika se DBK-ja mund t'ia zbulojë qëndrimet ndaj elementeve luftarakë shqiptarë si dhe përfshirjen e tij dhe të familjarëve në spiunimin e elementeve patriotike shqitare;

Një sërë frikërash, dyshimesh dhe mosbesimesh e bëjnë Shaqir Fetain paranoid tipik dhe shumë të rrezikshëm.

Ajo çfarë është në gjendje të bëj Shaqir Fetai me këtë profil psikologjik as për së afërmi nuk është përfshirë në tërë atë opus shkrimesh të shtrirë në këtë libër si dhe në sërë media dhe në rrjete sociale. Prandaj largimi i tij nga skena publike sa është urgjencë historike e kombëtare aq më tepër është edhe obligim kombëtar, sepse, dëmi i tij prej paranoi kohëve të fundit ka prekur edhe nëpër strategji të rëndësishme dhe jetike kombëtare.

“Libri na e evokon të kaluarën, libri na e projekton dhe formëson të ardhmen”

Ndërsa psikologja nga Maqedonia e Veriut, në pjesën e punimit të vet bashkangjitur në raportin mbi profilin psikologjik të Sulejman Rexhepit, veç të tjerash thotë: “Simbioza e psikikës dhe trupit e përbën ekzistencën tonë, pasqyrën tonë dhe ekspresivitetin e kapaciteteve tona mendore si dhe veprat në raportet tona interpersonale me të jashtmen. Kjo është ndërgjegja jonë, procesi evolutiv fundamental përmes të cilit, falë aftësive psikofizike të dhuruara nga nëna natyrë, me kalimin e kohës personaliteti mbledh dhe ngrit brenda vetes arsimim, edukatë, njohuri, përvoja, norma sociale, morale, etike dhe shpirtërore. E tëra kjo vjen gjithnjë e më shumë duke u pjekur në rrethin ku jeton, në rrethin familjar dhe në atë që e rrethon”, thotë psikologja.

Ajashe O. nënvizon se këto janë ato normat kryesore që e formojnë arkitekturën psikike të një personaliteti, që e formojnë dhe ndërtojnë psiko-profilin e tij.

Psikologjia moderne, njohuritë mbi personalitetin e pjekur i mbindërton përmes njohurive mbi socialen që paraqet një

përmbledhje të proceseve mendore që i ngërthejnë interkacionet tona sociale gjatë kontakteve me të tjerët, me rrethin, me realitetin si dhe me projektimin e specifikës së qëllimeve, planeve, dëshirave, mendimeve, besimeve, emocioneve dhe veprimeve tona.

Kapaciteti i njohjes sociale në emër të intelegjencës emocionale, na udhëheq dhe drejton me sjelljen tonë sociale, me adaptimin tonë si një faktor shumë i rëndësishëm në pranimin por edhe në reagimin adekuat dhe real, apo në reagimin tonë joadekuat hysterik, në interkacionet tona të paparashikuara sociale.

Sot, konstaton psikologia Ajshe O. neuroshkenca e vërteton arkitekturën e psiko-profilin tonë, me njohuri të shumta që i kemi regjistruar në kujtesën tonë. Çështja është: kush e formon, kush e shton dhe kush e inkorporon pjekurinë intelektuale me brum mental dhe emocional në personalitetin tonë? Ekziston vetëm një përgjigje! Libri dhe rezervuari i begatë i njohurive. Libri na e evokon të kaluarën dhe kjo memorie na drejton me urtinë: libri na e projekton dhe formëson të ardhmen.

Nisur nga ky fakt, libri “Tradhetia dhe komploti i Shaqir Fetait në kohë pandemie” me synim për t’u pasuar edhe nga vëllimet e tjera (deri sa të ikë Shaqir Fetai), na ofron aq shumë informacion mbi Shaqir Fetain, personin më kontravers në Maqedoninë e Veriut, sa, është fare e lehtë ndërtimi profesional i profilit psikologjik të tij. Në shkrime mbase mund të ketë ekzagjerime, porse faktet dhe argumentat janë të pamohueshme; të gjitha sjelljet dhe veprimet e deritanishme të Shaqir Fetait dëshmojnë se ky libër në fakt në mënyrë të përkryer pasqyron psikologjinë proplematike të portretit të Shaqir Fetait, përfundon psiklogia, Ajshe O./ 1KlikLarg/ 14.07.2021

Kështu foli Shaqir Fetai

Do të jetë një rubrikë e re në Portalin “kombetare.com”, rubrikë kjo që do të mbajë mbititullin “Kështu foli Shaqir Fetai”, intertekstualitet ky i nxjerrur nga “Kështu foli Zaratrusta” i Niçes! Rubrika do të jetë në vazhdime, 1, 2, 3, 4... Po çka foli Shaqir Fetai? Vetëm rrena, sepse përmes rrenave ai i shëron komplekset, duke i shëruar komplekset ai e mëton “devotshmërinë”! Po si të arrihet përmes rrenave deri te “devotshmëria”

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

Çka është devotshmëria fallse, nëse jo hipokrizi? Çka është mburrja fallse nëse jo megalomani? Çka është rrena origjinale nëse jo fryma jetike e Shaqir Fetait!

Janë të rallë ata njerëz, si Shaqir Fetai, që shquhen nga këto tri sifate! Me tradhëti e me komplot, i instaluar nga pushteti aktual maqedonas, duke shkelur si triumfalistë mbi parimet islame dhe mbi Kushtetutën e BFI-së, i shpërfytyruar në një rrencak ortodoks, Shaqir Fetai mundohet si një “i devotshëm”, të shtiret ndër xhemat e ndër opinion me qëllim që ta blejë respektin dhe dhembshurinë e tyre! Djallëzitetë e veta mundohet që t’i mbulojë me sjellje prej

dylberi, duke harruar se, edhe dylberi është kushëri i djallit, ndërsa Zoti i Madh ka urdhëruar mbarë njerëzimin që të rrijnë sa më larg djallit!

Në Kosovë është një krah i manipuluar nga politikat antishqiptare serbe që po trumpetojnë se i paskan parë dy serbë tek sillen rreth burimeve të ujit të pishëm të deçanit! Pusetat e hapura, pa roje, pa polici e pa ushtri, pa shërbime sekrete e pa kufij, vijnë serbët dhe na “i helmojnë qytetarët e Deçanit”!

Në Kosovë është një biçim “komuniteti antiqeveritar” anti-Kurt, që mendon si Vuçiqi serb se, në Deçan ka helmime dhe kjo duhet të kuptohet si sprovë se Kosova nuk ka kapacitete shtetëndërtimi, ndaj dhe duhet të ulë kokën dhe ta lëshojë policinë dhe ushtrinë serbe që të vijnë e të na “bëjnë terbije”!

I këtij krahu është edhe Shaqir Fetai, natyrisht, si lojalistë i ndrikullave serbë që i dhanë emër të pavdekshëm ORAO! Edhe Shaqir Fetai si lojalistët proserbë mendon se në Deçan ka helmim masiv dhe, kjo duhet të merret si dëshmi se prej Kosovës nuk ka gjë!

Veçse Albin Kurti dhe mjeku Ilir Tolaj po thonë se bëhet fjalë për pandemi e përhapur nga ndonjë bakterie të cilës duhet t’i gjendet çerdhja! Përkundër këtij fakti të pamohueshëm, Shaqir Fetai këmbëngulë se në Deçan ka helmim dhe se, përkundër BIK-ut të Naim Tërnavës, BFI-ja e Shaqir Fetait na qenka me popullin e Deçanit! Shaqir Fetai, i padëshiruari i popullit të Çegranit na qenka me deçanlitë?! Shaqir Fetait ia hedh dikush një grusht miza dhe, pastaj, ky, si budalla vrapon pas tyre pasi i tha dikush se ky nuk i njeh viktimat dhe masakrat serbe në Kosovë por vetëm ato në Bosnjë dhe, sakaq, shkon e shpreh dhimbje për “popullatën e helmuar” të Deçanit! Me këtë ai dëshiron të gjuajë diçka! Tipik si “ORAO!

2.

Çka tha tjetër Shaqir Fetai! Phaaaa, nga shumë makina që janë shtuar në Gostivar, i është kujtuar se paskan nisur të vijnë gurbetçrët. Më shumë se gjysma e atyreve që kanë ardhur deri në kujtesë të Shaqir Fetait, janë kthyer mbrapa, sepse kanë punë të shkretët! Ndërsa pasi janë kthyer, i është kujtuar Shaqir Fetait që

të na sugjerojë që t'i presim mirë, t'ua hapim portat e oborreve, pastaj, Shaqir Fetai thotë që "t'ju japim kushte dhe hapësirë" dhe, në fund, t'i bekojë Zoti me të mira!

A është i vetëdëshëm se çka flet Shaqir Fetai, apo qejfi i tij i madh është që gjithnjë të pallamudë diçka "sensacionale"!

Shaqir Fetai thotë "t'ju japim kushte dhe hapësirë"! Mërgimtarët vijnë nëpër shtëpitë e tyre pallate, secila më e mirë se tjetra!

Mërgimtarët vijnë te familja e tyre! "T'ju japim kushte", ka kuptimin e, t'ju japim para, maikna, mjete të nevojshme për shfrenim absolut! Po ata vijnë me kartela bankare që gogësojnë prej valutave të tyre; vijnë me makinat nga më të mirat që i kanë produkt i punës së tyre të natëeditshme, shpërblim i mundit, djersës, gjakut të tyre. Si t'ua japim hapësirën përveçse duke u mbyllur në pëpër shtëpitë tona dhe gjithë hapësirën e zbrazët ta përjetojnë dhe gëzojnë mërgimtarët tanë! Po ata kanë ardhur të kënaqen me ne, vijnë të rrinë me ne, vijnë të ndajë gëzime e vuajtje me ne, ata nuk kanë nevojë as për kushtet tona, as për hapësirën tonë, por, thjesht, për ngrohtësinë tonë e cila mund të ndjehet vetëm duke u ngjeshur dhe duke përmbushur çdo hapësirë të zbazët, o Shaqir zeza!

Si more Zoti t'i bekojë me të mira! Zoti shpërblen me të mira, ndërsa kur bekon, në kuadër të bekimit të TIJ hy çdo e mirë, çdo e bukur, çdo e shenjtë. Uratës "Zoti të bekoftë", nuk i shtohet kurrfarë "mëlmese" tjetër, sepse jo që del qesharak, por, del edhe injorant, demagog dhe hipokrit!

E kundërta e kësaj urate është "Zoti të mallkoftë! A mund të themi "Zoti të mallkoftë me të këqia"! Jo, pra! Mund ta shprehë vetëm injoranti, demagogu, hipokriti dhe – Shaqir Fetai!

3.

Shaqir Fetait, nëse do t'i shkonte në zyrë Hasan Prishtina, apo Isë Boletini, apo Idriz Seferi, ky sakaq do ta madhëronte këtë takim me këta burra të dheut, me të cilët ai ka bashkëpunuar ngushtë në sferën fetare dhe kombëtare! Natyrisht, një tekst i tillë, këtyre tre burrave do t'ia lëkundte eshtrat në tokë!

Nëse do t'i vinte Fan Stilian Noli, apo edhe Migjeni, Shaqir Feti sakaq do të na tregonte se me këta intelektualë të lartë ka punuar

ngushtë në fushat e ndryshme të jetës fetare e kombëtare! Edhe këta dy do të fyheshin rëndë nga një rrenë e tillë!

Shaqir Fetai qenka vizituar nga një mik i tij i ngushtë, i kalibrit të lartë intelektual, Faton Hambara, nga Dibra, me të cilin paskan punuar shumë ngushtë në sferat fetare e kombëtare!

Pse fyhet Faton Hambara, ç'është kjo sëmundje e pistë e Shaqir Fetait për t'i njollosur personat e ndryshëm. Pa aspak dyshim, z. Faton edhe mund të ketë dhënë kontribut në çështjen kombëtare, por ama Shaqir Fetai, bashkëpunëtori i ngushtë i UDB-së, nxënës i oficerit të këtij shërbimi policor famëkeq serb, Stanko Dragoviqit, nuk ka shansë të ketë punuar për çështje kombëtare, sepse këtë ia ka pamundësuar i Madhi Zot. Prandaj, Shaqir Fetai, nga Dragoviqi, bëhet nxënës i Temellko Boshkovskit, si dhëndër i baballëkut të vet që më tepër e ka sajdisur Temellkon se sa Shaqir Fetain, i cili, më në fund, do të instalohet në krye të BFI-së nga shërbimet inteligjente maqedonase si dhe nga pushteti aktual maqedonas. Pa dyshim, në bazë të dokumentit policor serb, ky avansim karriere i Shaqir Fetait, vie si propozim dhe përkujdesje e udb-së serbe, i vetë oficerit serb të tij, Stanko Dragoviqit.

Tani, ky nxënës i Draogviquit bashkë me Faton Hambara paskan punuar në çështje kombëtare?! Këtu ka vetëm një të vërtetë – dëshira e Shaqir Fetait për ta komprometuar dhe fyer rëndë çdo patriot, madje edhe çdo fetar, sepse një fetar që ka humbur kohë qoftë edhe vetëm për një kafe me Shaqir Fetain, ai ka bërë mëkat! Mëkatari nuk mund të jetë fetarisht e kombëtarisht i lartësuar!

4.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/15.07.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (2)

Rreth çapitjeve amatoreske të Shaqir Fetait për të ndërtuar një tekst mbi çështjet aktuale, të përsëritshme çdo vjet, siç është Haxhi dhe Kurban Bajrami! Mbi metodologjinë e kompilimit si dhe të sjelljes së ajeteve kuranore dhe haditheve, Shaqir Fetai mundohet të dëshmojë “intelektualitetin” e vet prej folkloristi miop! Pjesa narrative, ku vie në shprehje mendimi personal, e zbërthen Shaqir Fetain si një “intelektual” pa fill, i palogjikshëm, libresk, pa logjikë dhe pa mendim të thellë e profesional

Nga Faik Shahinbejlliu

Shaqir Fetai është autor i një sërë shkrimesh, të cilat, kryesisht i ka të botuar në revistën e BFI-së, në “Hënën e Re”! Redaktorët asnjëherë me gjasë nuk janë marrur me shkrimet e tij, ashtu, siç i ka dërguar, ashtu edhe ia kanë botuar. Në fund, Shaqir Fetait ia ka pasur shumë qejfi që t’i mbledhë e t’i botojë në libra. I ka disa të tillë! Një shkrim si të gjitha “shkrimet” e tjerë të Shaqir Fetat, është edhe shkrimi të cilin Shaqir Fetai e boton në facebook-un e vet dhe që do t’ia “ekzaminojmë” pak në këtë recension!

Shaqir Fetai që të gjitha shkrimet i ka, si fillim, të paredaktuara! Nëse ia heqim shembujt që i sjell, e që kryesisht janë ajetet kuranore si dhe hadithet e Pejgamberit s.a.v.s., pra, nëse ia nxjerrim në një faqe vetëm pjesën narrative, atë pjesë që shpreh mendimin personal të Shaqir Fetait, këtu pastaj do të shihet se sa i

cekët është ai, se sa manipuator që është, se sa kompilator që është, sa libresk del, duke u shpërfaqur në mjeshtër të bartjes së asaj që e ka lexuar dhe që i është ngulitur në tru e që, tani, i pështjellohet, duke mos ditur nëse është mendimi i tij personal apo i ngulitur nga ndonjë shkrim që e ka lexuar më herët. Një gjë e tillë i ndodhë githkujtë por, profesionisti, intelektual i me një kulturë më të gjërë shkrimi, gjithnjë ato dilema i shtjellon në mënyrë sa më origjinale, duke sjellë, të paktën, mëlmesa nga mendimi i vet origjinal! Fatkeqësisht, Shaqir Fetai duket ashiqare që mendon serbisht (le të themi edhe, boshnjakisht, sepse vetëm këtë gjuhë të huaj di ai) ndërsa mundohet të shkruaj shqip!

Një redaktor i mirëfilltë, një profesionist i dëshmuar në njohjen e gjuhëve të shkrimit, sakaq do t'ia sakatoste shkrimin Shaqir Fetait! Poezia i jepet për redaktim vetëm poetit! Proza prozaorit! Shkrimet publicistike i jepen vetëm publicistit i cili e njeh gjuhën e reportazhit letrar e gazetaresk, e njeh gjuhën e intervistës, e njeh gjuhën e shkrimit analitik, gjuhën e komentit, të reflektimit, të esesë, të qasjes...

A ka "QASJE AKTUALE" ashtu siç ia vë mbitiullin shkrimit Shaqir Fetai? Që këtu vërejmë se kemi të bëjmë me një karasevdali që vdes për vetëaktualitet! Mund të flitet për "qasje kritike", për "qasje të ftohtë", për "qasje të drejtë", për "qasje tendencioze", për "qasje shkencore", për "qasje poetike" etj. por ama nuk ka kurfarë kuptimi "qasje aktuale"!

Një redaktor i mirëfilltë që do ta trajtonte profesionalisht shkrimin e Shaqir Fetait, këtij farë duduki që mëton të prezantohet si "kryetar i ulemasë", si "më i miri prej intelektualëve, si "kapaku i intelegjencies teologjike", gjithësesi që do t'ia eliminonte këto gafe, të cilat, Shaqir Fetait i duken si "mendime filozofike":

- ***Gjithmonë jam përpjekur t'i kuptoj festat në Islam duke ju qasur nga të gjitha aspektet...*** (Festa nuk do qasje, por, qasje mund t'i bëhet ngjarjeve me rëndësi të veçantë historike e shoqërore, të cilat përkujtohen, madhërohen, duke u festuar);
- ***(festat) janë inspirim i gjallë i të menduarit njerëzor...*** (një sintagmë e çoroditur, idiotike, e mjerë);
- ***Aktualiteti i tyre shtohet konform ngritjes së vetëdijes njerëzore...*** (kjo do me thënë, gjithnjë sipas Shaqir Fetait se,

aktualitetet vijnë varësisht nga vetëdija njerëzore! Çka flet ky injorant i shkretë?!);

- **Çdo popull në botë ka ngjarjet e veta të rëndësishme historike, të cilat kohë pas kohe i përkujton duke i festuar...** (Kohë pask kohe?! Ngjarjet përkujtohen dhe festohen secila në ditën e vet dhe jo kohë pas kohe. Një popull që i përkujton ngjarjet e veta kohë pas kohe, kjo dëshmon se ai popull i bën hizmet harresës kolektive dhe asimilimit të vet!);
- **Të gjitha këto ngjarje... u kushtohen ndjenjave fetare... duke forcuar dhe ngritur ndërgjegjen dhe vetëdijen ideologjike!** (Hajde komunist hajde! Kështu si Shaqir Fetai mund të mendojë vetëm një komunist i regjur dhe i papërmirësueshëm!);
- **pjesëtarët e besimit islam në mbarë botën dallohen me festat e tyre , të cilat luajnë rol të rëndësishët në aktivitetin e tyre progresiv dhe human...** (Festat luajnë rol në aktivitetet progresive?! Uh çfarë “fjalie brilante” e injorant Shaqir Fetait!)
- **për të cilët më së miri na njohton hadithi ...** (për ç’gjë flet hadithi... për ç’gjë më së miri mësojmë nga hadithi... Për këto festa flet edhe ky hadith... Për këtë konstatim bazohemi në këtë hadith... Pra, nga disa variante të mundshme të sintaksës në gjuhën shqipe, Shaqir Fetai zgjedh atë që aspak nuk është shqip! Sepse, ai mendon serbisht, ose, hajde, le të themi, boshnjakisht!);
- **festa e Kurban Bajramit bjen ndër festat më të rëndësishme, rëndësia e të cilës qëndron në përkujtimet të cilat janë të lidhura ngusht me tri ngjarje që sollën ngritjen më të lartë të vetëdijes njerëzore...** (Fjali e hartimit shkollor, nga nxënës mesatarë! Dhe, ky farë ish-profesori, me këtë “shqipe” i ka mësuar medresantët, të cilët, secili prej tyre, do ta thurte më mirë këtë fjali!);
- **Secila prej këtyre tri gjërave në mënyrë të pashterur paraqesin ide të larta humane...** (Jaaa, kërkojmë ndihmë nga ndonjë gjuhëtar mesatar që të na e shtjellojë këtë fjali të çoroditur e të na e sjellë në shqip!);
- **Në këto ditë të Festës së Kurban Bajramit për shembull, mori fund shpallja e Kur’anit Famëlartë...** (Kurban Bajrami diku festohet 3 e diku 5 ditë! Në cilët nga këto ditë

festa mori fund Shpallja e Kuranit?! A është i vetëdëshëm se
 çka shkruan Shaqir Fetai! Apo, kapaciteti i tij “inteletual” i
 lejon edhe “margaritarë” të tillë!);

- ***Ai (Kurani) është si një oqean...*** (T’ia kufizoshë Kuranit
 thellësin dhe gjërësinë deri në një oqean – kështu do të
 mendonte vetëm hipokriti. Mund të thuhet “Kurani është
 oqean”, por jo “si një oqean”!);
- ***(Haxhi) gjithmonë ka qenë preokupim kryesor i atyre të
 cilët e kanë pasur për obligim të vizitojnë shtëpinë e All-
 llahut...*** (Kjo fjali dëshmon se Shaqir Fetai, mendërisht, nuk
 është në tokë të bukës, ka shkëputje logjike! Haxhi nuk
 është “preukopim i atyreve që e kanë obligim” por, haxhi
 është obligim për të gjithë ata që kanë mundësi shëndetësore
 e financiare!);
- ***Të flasish për rëndësinë e vizitës së Haxhit nuk është
 lehtë për arsye se çdo detyrë apo obligim islam jep ide
 të shumta dhe njeriu merr prej tyre aq sa është në
 gjendje të thellohet në domethënien e tyre...*** (Një fjali
 amatore që shpreh cektësinë e mendimit i cili është ushqyer
 me nja dy-tre libra dhe që assesi nuk ia arrinë të piqet
 intelektualisht. I vetëaktualizuar, i vetëpëlqyer, i
 vetëmjaftueshmi, gjithnjë atë që e mendon e shkruajnë keq e
 më keq, sepse, i mungon teknika e shkrimit, aparati mendor
 i ka ngelur pa bateri, prandaj vetëm “vergljat” kot, pa
 kurrfarë efekti!);
- ***Ne do do të mundohemi të përkufizohemi... (Hajde fjali,
 hajde!*** Të kanë përkufizuar të tjerët ty o Shaqir Fetai, nuk ke
 për çfarë të mundohesh që ta përkufizoshë veten! Je i
 përkufizuar tashmë, madje edhe i dokumentuar e faktuar,
 prandaj, mos u mundo! Vetëpërkufizimi yt do të ishte vetëm
 një përpjekje hipokrite për të ikur nga definicioni i saktë për
 ty – tradhëtar e komplotist, ves ky që kur u kalite si ORAO!);
- ***Në të njejtën kohë haxh-xhi paraqet kongresin...*** (Haxhi
 nuk paraqet, haxhi shpreh, mund të përkufizohet si kongres,
 haxhi ngërthen në vete konceptin e një kongresi etj.);
- ***Pra, ai është kongres ku besimtarët duhet të ndërrojnë
 mendime, përvoja dhe dituri të ndryshme si psh.: bujki
 me bujkun, ekonomisti me ekonomistin, sociologu me
 sociologun, astronomi me astronomin, letrari me
 letrarin, psikologu me psikologun, teologu me teologun,***

etj., me qëllim të dhënies së kontributit më të madhë në të gjitha sferat e zhvillimit të përgjithshëm njerëzor...

(Këtë mendim mund ta ketë një intelektual i mirëfilltë? Këtë mendim mund ta ketë një njeri që pretendon se është “më i mençuri i më të mençurve”? Sipas Shaqir Fetait, haxhilerët nuk paskan kurrfarë pune përveçse ai që është bujk të kërkojë homologun e vet, ndonjë bujk, apo të gjithë bujqët, sociologu t’i kërkojë të gjithë sociologët, mjeku të gjithë mjekët, teologu të gjithë teologët e të kuvendojnë në mes vete, të lidhin kontrata! Sa të thjeshtë e sa të lezetshëm e paraqet haxhin Shaqir Fetai! Turp!);

- ***si dhe nëpër mes të vepruarit dhe të aktivizuarit fizikomendor...*** (Nuk ka fije dyshimi që kjo fjali rrjedh prej të menduarit serbisht, prej intelektit të ndërtuar mbi baza të sintaksave serbe. Prandaj dhe, nuk është aq me rëndësi se si shprehet, me rëndësi është se si mendohet. Ndërsa kjo fjali është menduar serbisht! Në shqip del me një sintaksë të çoroditur. Kështu mendon edhe një mik i idealit i Shaqir Fetait! Thotë: nuk janë të rëndësishme gabimet sintaksore, morfologjike, gramatikore, që janë me bollëk në këtë formular, por, me rëndësi është se në këtë formular gjendet gjuha shqipe!!! Hajde propagandë antishqipe, hajde! Kurse Shaqir Fetai e “lartëson” këtë mentalitet sllav!);
- ***kështu që përveç sakrificave mendore, fizike...*** (Sakrificë mendore?! Do të thotë që duhet të heqim një pjesë të trurit! Sakrificë fizike?! Do të thotë të thyejmë ndonjë krah, ndonjë këmbë të heqim ndonjë gjymtyrë, ndonjë vesh, ndonjë sy... Lexo Shaqir Fetai, lexo shumë, shumë, shumë! Për t’u mësuar të shkruash duhet të lexoshë sa më shumë dhe, gjatë atij leximi të jeshë i përqëndruar në atë që e lexon dhe, jo sipërfaqësisht, të lexoshë ndërsa mendimin ta keshë në tradhëti e komplot!);
- ***Qëllimi dhe rëndësia kryesore e çdo dispozite Islame është devotshmëria...*** (A e di Shaqir Fetai kuptimin e fjalës “qëllim”, po kuptimin e fjalës “rëndësi”, aq më tepër, a e di kuptimin e këtyre fjalëve për sa i përket dispozitave islame? Me gjasë, jo! Sepse po t’i dinte Shaqir Fetai nuk do t’i përdorte në këtë formë!);
- ***“nënshtrim i plotë i urdhërave të All-llahut xh.sh “... (hej, mosbesues! Nuk nënshtrohen urdhërat e Allahut xh.sh.***

Ne u nënshtrohemi urdhërave të Allahut xh.sh. Prandaj,
“nënshttrim i plotë ndaj urdhërave të Allahut xh.sh.!);

- ***Nga kjo del në shesh se njeriu nuk punonë për të ngrënë , por han për të jetuar...*** (filozofi e mbrapsht, e djallëzuar, antinjerëzore! Njeriu punon për të jetuar! Krijuesi ynë përmes punës e bëri që njeriu të dallojë nga kafsha! Shaqir filozofi që ia futë si kau pelës!);
- ***kështu që shkencat humane ende nuk janë në gjendje të definojnë njeriun dhe të japin zgjidhje për problemet e tij...*** (Çfarë kuazishkencëtari, çfarë kuazifilozofi, çfarë kuaziintelektuali, në fakt, çfarë dibiduzi e çfarë injoranti! Shumë mendim i thellë që paraqet vetëmse një “gropë skeptike” dhe asgjë tjetër!); Pastaj, tutje, Shaqir Fetai i qaset analizës së njerëzimit në botë, amoralitetit të tyre, pabesisë së tyre, prishunisë së tyre, padrejtësive për të jetuar si njeri, me dinjitet, mohimi i të drejtave të njeriut etj. etj.! Por ama, asnjë fjalë nuk e thotë për myslimanët në Maqedoninë e Veriut! A janë të diskriminuar, a janë të lirë, sa janë të lirë, sa myslimanët e këtij nënqielli jetojnë të lumtur, të gëzuar, nga kush udhëhiqen ata, çfarë reflekton pasqyra e udhëheqësve të tyre fetar e politik etj. etj. Nuk i hy kësaj pune Shaqir Fetai, sepse i duket se foli mjaft!

P.S.

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai në këtë pseudoshkrim? Kush e injoron Shaqir Fetain ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/17.07.2021

Kurbani si rast për manipulim dhe hajni në BFI

“Bashkësia Fetare Islame” e Shaqir Fetait nuk është korrekte dhe e ndershme në raport me popullatën myslimane në vend. I morën fitër, i morën zeqat, kanë apeluar që t’ia marrin myslimanëve edhe kurbanin, për Medrese! Apelojnë si të marrë, si i verbëri për sy, duke premtuar se pjesën tjetër BFI-ja do t’ua shpërndajë nevojtarëve të vendit

Kurbani është akt sakrifikimi që kryhet për Allah! **“*Namazi im, kurbanu im, jeta ime, vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botërave*”**. (El En’am, 196)

Praktikat tona të shëndetshme, na kanë imponuar që, neve, nëpër shtetet ku komunitetet myslimane janë juridikisht të diskriminuara, siç është edhe Maqedonia e Veriut, si komponent financiar për zhvillimin e jetës fetare islame si dhe për mirëmbajtjen e institucioneve islame, ta llogarisim edhe kurbanin e donuar, ose të paguar! Pra, të gjithë ata që nuk kanë kushte objektive (oborr, hapësirë etj.) për ta therrur kurbanin, e donojnë të gjallë në Medrese, ose e kryejnë pagesën për çmimin e kurbanit. Kjo “risi” tashmë është bërë praktikë ndër myslimanët tanë.

Por, medresantët tanë a hajnë vetëm mish kurbanit? A ju duhet atyre miell, krip, sheqer, vaj, vezë, margarin, mjalt, marmelatë, makarona, pasul, patate, karrota, lakra, spec, domate...

Natyrisht që u duhen! Asnjë nga këta produkte nuk është edhe aq lirë, le të themi sa gjysma e çmimit të kilogramit të mishit, ose edhe sa çereku, megjithatë, janë të kushtueshme dhe duhet t’u sigurohen nxënësve që vijojnë mësimin e rregullt në Medrese.

Në Maqedoninë e Veriut, sipas një statistike jozyrtare, jetojnë rreth 250 mijë familje myslimane, mesatarisht, nga katër anëtarë! Le të jenë 200 000 familje! Prej këtyre, nëse do të therrnin gjysma prej tyre kurbanë, do të dilnin 100 000 kurbanë, por, le të jetë çdo e katërta familje që therrë kurban, me çrast do të na dalin diku rreth 50 000 kurbanë. Edhe ky mund të jetë një numër shumë ambicioz, ndaj, le të mendohet se kurban therrin gjysma e këtyre çerek familjeve nga numri i përgjithshëm i familjeve myslimane të vendit. Do me thënë therrin, donohen, apo paguhen rreth 25 000 kurbanë, përjashtoj këtu pagesat e qindra kurbanëve që vijnë nga diaspra! Kjo do të duhej të ishte optimalja, nëse edhe besimtarët do të kishin besim në organet dhe insitucionet fetare islame në vend. Jo vetëm kjo, por nëse të gjithë do të angazhoheshin që kurbanët mos të shpërndahen por, që të gjitha të tubohen nga BFI-ja, mbase edhe do të arrihej ky numër.

Megjithatë, në Maqedoninë e Veriut funksionojnë me dhjetra organizata humanitare, me dhjetra shoqata dhe “bashkësi islame” si dhe grupe “religjioze” të cilat zhvillojnë aktivitete që edhe vetë ata të përfitojnë nga kurbanët e myslimanëve të Maqedonisë së Veriut. Le të themi se bëhet fjalë për përfitime morale dhe jo materiale, sepse, le të mendojmë se, asnjëri nuk e ndalë për vete kurbanin por zhvillon aktivitete humanitare, propagandë vetanake përmes mishit të kurbanit. Sepse u duhet pak “famë” ndër popullatë! Këtë e bën edhe Bashkësia Fetare Islame e Shaqir Fetait, e cila na del, herë si organizatë humanitare e herë si therrtore, organet dhe teologët brenda tyre na dalin, herë si hoxhallarë e herë si kasapë. Askush nuk kujdeset për dinjitetin e tyre! Madje, as vetë ata! Tani, në kuadër të Bashkësisë Islame ka lloj-lloj aktivisti i dëshmuar që nuk ia do të mirën BFI-së, fatkeqësisht janë edhe nëpër poste! Që nga “Rijaseti” i Shaqir Fetait e deri te organet më të vogla të BFI-së, veprojnë individë të cilët çojnë ujtë në mullirin e huaj!

Deri më sot, nuk e kemi dëgjuar, bie fjala, Qenan Ismailin, myftiun e Shkupit, ish-aktivist i denjë i OH “Kallirit të Mirësisë”, anëtar i Forumit Rinor Islam, të dalë e të thotë të kundërtën ngase ka vepruar më parë. Derisa sa ishte jashtë BFI-së ai ka apeluar që mos të dorëzohen kurbanët në BFI sepse i kanë haram, por të dorëzohen në Forumin Rinor, të dorzohen te “Kalliri” etj. Mirë ka bërë, përmes aktivitetit humanitar, ka “lartësuar” emrin e organizatave të veta ku ka vepruar. Por, si do të thotë sot? A do të

thotë sot, myslimanë të vendit, mos ia jepni kurbanin “Kallirit” dhe “Forumit”, sepse e keni haram, por, jepjani Medresesë!

Një apel të këtij lloji nuk e kemi dëgjuar nga “sekretari gjeneral” i BFI-së, i cili, deri sa ishte referent në Myftininë e Gostivarit, kontribuonte gjetkë, duke zhilluar propagandë kundër BFI-së! E njëjta i kërkohet edhe Qani Nesimit, Myftiut të Tetovës, i cili, deri më sot, nuk ka ngritur zërin për ta vetëdijësuar popullin e Tetovës që kurbanët mos t’i japin gjetkë, sepse e kanë haram, por ta japin vetëm në BFI dhe në Myftini si dhe në Medrese!

A guxon të dalë Abedin Imeri, myftiu i Kumanovës, dhe të thotë mos ia jepni kurbanët “bashkësisë islame” të Sadulla Bajramit, sepse ju shkojnë haram, por jepjani Medresesë sonë! Nuk e thotë, sepse i duhet kjo “bashkësi”!

Nuk ka dalur ta thotë këtë akoma as Shaqir Fetai! Ky hipokrit flet se “kurbanin e kemi emanet prej popullatës sonë që duhet ta shpërndajmë”, por, nuk apelon që mos të jepet gjetiu Kurbanit (sepse është haram) por të jepet në BFI apo në Medrese!

Kemi informata se të gjithë llojnë që kurbanët të treten nëpër organizata të ndryshme humanitare, madje kemi informata se që tani janë caktuar se cilës organizatë nga sa kurbanë t’u jepen që ata të menaxhojnë e të bëjnë aktivitet humanitar, sepse, u duhet heshtja e tyre, u duhet kënaqësia e tyre duke u shitur për mish kurbanit!

Në fund, edhe vetë BFI-ja insiston, me të gjithë organet e veta, që të shndërrohet në organizatë humanitare dhe t’ju konkurrojë shoqatave të ndryshe humanitare në vend! T’i bindë që sa e “fortë” është në humanitet! Po pse BFI-ja? Pse këtë aktivitet nuk ia lë “Hilalit” e cila duhet të dëshmohet te simotrat e veta në vend se, është më e fuqishmja, sepse është organizatë e popullit dhe jo e Shaqir Fetait!

Nuk i japin “Hilalit”, sepse kjo pseudoorganizatë është organizatë-individ! Vetëm një person, edhe atë i imponuar nga qarqet partiake të pushtetit aktual maqedonas! Nuk ka kryesi, nuk ka kuvend, nuk ka degë e nëndegë, nuk ka anëtarësi, nuk ka aktivistë, nuk ka program as projekt! Është tek një individ! Del puna që organizatën humanitare e ka Shaqir Fetai për shpëlarje parashë, sepse, ndryshe, e para që do të duhej të reformohej që në rrënj do të duhej të ishte Organizata Hmanitare “Hilal”, dhe jo punët e saj ta kryej BFI-ja me organet e veta, ndërsa rolin e aktivistëve ta kryejnë hoxhallarrët.

Do të ketë vjedhje të madhe, do të ketë mëkat të madh, duke blerë lloj-lloj kurbanësh (vitin e kaluar pati nga kafshët që edhe therrtoreve u vinte keq t'i therrin, të mbaruara fare!), duke mos blerë fare kurbanë, duke e shpërndarë pak në Medrese (ku nuk ka më shumë nevojë se sa 10-15 ton për një vit), do ta shpërndajnë nëpër shoqata të ndryshme, do të përgjaken edhe vetë pak, sa për të dëshmuar se “u lodhëm duke shpërndarë”, do të “përgjaken” duke vjedhur nga mishi e duke çuar në shtëpi (si çdo herë! Emra nuk do të përmendim!) dhe, tërë këtë, vetëm për të shpëlarë gjurmët e hajnisë, të vjedhjes, të zhvatjes!

Shoqëria civile është e përjashtuar nga pjesëmarrja nëpër komisionet e BFI-së që kanë të bëjnë me tubim të kurbanëve, me tubim të mjeteve materiale, me therrje të kurbanëve, me shpërndarje të kurbanëve, me përkujdesje për kushte higjienike, komision ky që ka të drejtë edhe ta stopojë shpërndarjen e mishit të prishur nga vapa!

Në emër të përfitimeve personale (që janë të shumta), në emër të humanitetit (që do të jetë sipërfaqësor dhe me plotë hajni), në emër të fesë dhe kushteve fetare, do të ishte mëkat që të helmohen fukaratë! Ka gjasë që të ndodhë kjo! Sepse, organizimi i aktivitetit humanitar është zero! Pa projekt e pa program! Pa listë fukarashë e pa adresa! Pa publikim të emrave të të gjithë atyreve që kanë paguar e që kanë donuar kurbanë!

Të gjitha këto mungesa krijojnë kushte për manipulim, për vjedhje, dhe për fshehje të gjurmëve të haramit, që do ta bëjë, po e njëjta ekipë e cila tashmë ka përvojë të gjatë në këtë krim, të cilën fatkeqësisht, edhe kësaj radhe do ta kryejnë në emër të fesë, pra, në emër të Allahut! E Allahu thotë: **“falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!”** (El-Keuther, 2)

*Këshilli për Mbrojtjen e kushtetutshmërisë së BFI në RMV
/Opinione/ 18.07.2021*

Shaqir Fetai me mision – të hapë filiale të UDB-së në diasporën tonë

Pa kaluar akoma dy muaj, dolën sheshit të palarat e Shaqir Fetait në diasporë. Pritet skandal i madh dhe, revoltë gjithëpopullore, sepse tashmë me të madhe po flitet për misionin e Shaqir Fetait që e filloi kohë më parë në disa qytete të Zvicrës, ku diaspora jonë ka qendrat e veta islame

Këto ditë, Shaqir Fetai, instalacioni i pushteti aktual maqedonas në krye të BFI-së, paska raportuar para anëtarëve të “rijasetit” të tij, i cili, pa dyshim që mbetet ilegjitim deri në ditët e Kijametit, rreth vizitës së tij që e pati kohë më parë në disa qendra të Zvicrës, aty ku diaspora jonë tashmë ka ngritur qendrat e veta islame. I shoqëruar nga imami i xhamisë “El-Hidaje”, në St. Gallen dhe, njëherësh edhe kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër, ka qëndruar në disa qendra ku banojnë e veprojnë edhe një numër i madh i mërgimtarëve tanë, si në: Sulgen, në St. Gallen, në Luzern, Cyrih, në Frauenfeld etj. Natyrisht që, nuk ka raportuar për misionin e tij të saktë, e që paska qenë të përgatisë terren për t’i instaluar njerëzit e vet, ata që ia sugjerojnë nga nëntoka dhe, nuk ka raportuar as për faktin që është bojkotuar masovikisht. Rreth kësaj vizite të turpshme të Shaqir Fetait, na kanë shkruar një grup imamësh dhe këshilltarësh xhamish të këtyre qendrave, duke na treguar arsyen e bojkotimit të xhematit që ia kanë shprehur Shaqir Fetait! Ka pasur xhami ku Shaqir Fetai është pritur prej disa aktivistëve që paskan qenë nën trysninë e disa personave të cilat as që kanë ditur se cila është loja e vërtetë që fshihet pas kësaj vizite që i ka zënë që të gjithë në befasi! Askush nuk ka pasur informacion se cili është qëllimi dhe çka synohet me këtë vizitë “zyrtare”, në një periudhë kur nuk ka pasur kurrfarë aktiviteti fetar!

Grupi i imamëve dhe i aktivistëve të xhamive që na kanë shkruar hedhin dyshime se, Shaqir Fetai ka pasur mision që të hapë filiale të UDB-së edhe në qendrat islame të diasporës në Zvicër. Ata këtë e lidhin me terrenin që janë munduar ta përgatisin bashkarisht Shaqir Fetai e Mehas Alija, duke nxjerrë në pension imamë të dashur për xhematin e Zvirës dhe duke u përgatitur që t'i zëvendësojnë me njerëz të Shaqir Fetait, të cilët, pa dyshim që janë të padëshirueshëm për xhematin e diasporës sonë. Ata thonë se, do të shpërthejnë skandale të njëpasnjëshme, me përmasa të paparashikueshme. Shaqir Fetait i është tërhequr vëretja për këto pasoja, por ai as që ka denjuar të shpreh më të voglin shqetësim. Insistimi i tij është që nëpër vendet kyçe të qendrave tona të instalojë njerëz të vet, kurse askush nuk e kupton se pse ky insistim i tij kaq këmbëngulës.

“Ne e dimë se kush është Shaqir Fetai, tashmë kemi informata të sakta dhe burimore. Kush këmbëngulë që të ketë gjithandej “njerëz të vetë” nëse jo personi që ka mision të shërbimeve sekrete. Deri më sot asnjë kyetar i komuniteteve tona në rajon nuk ka insistuar në ndërrimin e imamëve apo të aktivistëve të qendrave tona me njerëz të vetë. Një shërbim të tillë kurë nuk e ka kërkuar as kryetari i komunitetit mysliman të Kosovës, as ai i Shqipërisë, por as ish-reisi i Maqedonisë, H. Sulejman ef. Rexhepi. Këtë lojë dëshiron ta luajë Shaqir Fetai. Por nuk e kuptojmë se pse kësaj “kënge” të pistë ison ia mbanë ky “kryetari” ynë, Mehas Alia! E kemi diskutuar qysh kur ka nisur të qarkullojë dokumenti i UDB-së që flet qartë se në cilët ujëra noton Shaqir Fetai! Madje ka pasur qëndrime që të bojkotohet rreptësisht, kurse tash në bisht të Shaqir Fetait i qëndron edhe Mehas Alija”, na shkruajnë disa imamë dhe aktivistë të qendrave islame të Zvicrës!

Pa dyshim që Shaqir Fetai, sipas letrës më të gjatë që na ka arritur në inbox, e synon përçarjen e diasporës sonë, insistimi i tij që të instalojë njerëz të vetë nëpër xhamitë e qendrave islame në diasporë, flet se, Shaqir Fetait i duhen vegla, marioneta edhe në diasporë!

Fill pas kësaj vizite Shaqir Fetai ka qëndruar edhe në Strugë ku ka thurrur elozhe të pakuptimta, ka thurrur epitete idiotike për të ashtuquajturin Myfti i Stugës, Salim Sulejmanin, i cili del që ka lidhje të afërt me Mehas Alijën, ndërsa ky ka marrur porosinë e Shaqir Fetait që ta çojë deri në fund kërkesën e tij: t'ia pastrojë terrenin për të instaluar “shpiunqiça” të Shaqir Fetait nëpër

xhamitë e diasporës.

Krytari i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër duhet të ketë shumë kujdes që mos të bie në këtë grackë dhe të kalojë, prej një hoxhe klasik, në nxënës klasik i bashkëpunëtorit profesionist të Stanko Dragoviqit, oficerit të UDB-së serbe i cili personalisht e ka përgatitur për “karrierë të mistershme” Shaqir Fetain.

Letra e imamëve dhe aktivistëve të qendrave islame të shqiptarëve në Zvicër, përfundon me: “Vëllezër të dashur, ju lutemi, publikojeni letrën tonë, angazhohuni edhe ju të parandaljmë këtë lojë të rrezikshme të Shaqir Fetait, e cila do të shkaktojë skandale dhe pasoja afatgjate të paparashikueshme. Në emër të fesë islame dhe për hirë të Allahut, e kemi borxh që ta stopojmë djallëzinë e turpshme të Shaqir Fetait. Ta dëbojmë djallin nga mesi ynë, sa nuk është bërë vonë”, përfundon letra e bashkëatdhetarëve tanë që drejtojnë dhe përkujdesen për xhamitë në vendbanimeve të tyre./Kombetare/21.07.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (3)

Tashmë është konstatim i faktuar se, sa herë që flet Shaqir Fetai, ai gënjenë! Shaqir Fetai me mish e me shpirt është i dhënur pas përvetësimit, pas personalizimit të gjërave, ai mendon se, gjithçka që i përket islamit, i përket edhe atij personalisht. Megjithatë, Zoti na ka dhënë mend që të kuptojmë se, islamit i përket devotshmëria kurse Shaqir Fetait hipokrizia. Edhe kameleoni do t'ia kishte zili Shaqir Fetait. Sa keq

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

Shaqir Fetai paska marur mundin që t'i drejtohet myslimanëve të vendit me një "mesazh" rreth festës së Kurban Bajramit. Siç e do rendi dhe tradita! I pari t'ju drejtohet ndjekësve të vet me një fjalim, apo me një tekst të përshpirtshëm, që dallon nga ligjeratat e përditshme, nga ato fjalimet rutinë.

Mesazhi i Shaqir Fetait më tepër përcillte shqetësimin e Shaqir Fetait se sa çastin solemn të shpirtit në prag të festës së madhe islame Kurban Bajramit. I shqetësuar (sepse është i vetëdëshëm) se është në hipotekë të madhe te mbarë popullata myslimane, se iu imponua popullatës si instalacion i pushtetit aktual antiislamist, se e tradhëtoi këtë popullatë duke pranuar që t'i nënshtrohet karrierës së vet të dyshimtë e të pistë, Shaqir Fetai zgjedh që të jetë skollistik, të jetë "më për toke", mos të përdorë shumë mëlmesa shpirtërore personale, që janë ekskluzivitet i çasteve festive, por të çapitet që të dëshmojë se sa "i thellë është" në mendimet islame.

Prandaj Shaqir Fetai nuk ka nevojë për shërbime profesionale, sepse i duhet t'iu ikë teksteve dhe stilit të shkrimit që i përket enkas teksteve apo fjalimeve dedikuar një feste të shenjtë. Përshkrimi i rregullave, i normave, i ngjarjeve, bazuar në motivet libreske, nuk është mesazh me të cilën i drejtohem popullit në raste festash. Mesazhi është esenca e urimit të cilin ia drejton opinionit që ka festë, që gëzon, që lumturohet, që ndjehet madhështor dhe krenar që i përket asaj popullate që e feston ngjarjen e shenjtë! Mesazhi nuk është tekst shkollor që ia drejton nxënësve për t'i njohtuar për ngjarjen përmes disa informacioneve bazike. Mesazhi është porosi e atij që e përcjell, bazuar në porositë që dalin nga ngjarja, nga akti, nga shembëlltyra dhe shembëllimi i aktit që lartëson njeriun deri në përrulje të sinqertë dhe me plotë bindje para Krijuesit të Gjithsisë. Ky mesazh duhet të jetë i natyrës së festës, duhet ta përmbajë natyrën e festës, duhet të reflektojë natyrë festive. Mesazhi nuk është si një garë mes nxënësish lidhur me njohuritë rreth ngjarjes festive, por nuk është as hartim shkollor për t'ia dëshmuar mësuesit afinitetet që i ka për lëndën përkatëse.

Me mesazhin e vet Shaqir Fetai ishte në mes të çapitjeve për ta dëshmuar këtë afinitet si dhe drojes nga e kaluara e tij e pistë e cila ia zbërthen çapitjen për ta kamufluar tradhëtinë dhe hiporkizinë me “njohuri të thella” islame!

2.

Shaqir Fetai festat fetare, përfshirë këtu Festën e Kurban Bajramit, i percepton si të jenë ditëlindja e tij! Edhe urimet institucionale ai i shet si urime për ditëlindjen e tij, i përvetëson dhe i personalizon deri në idiotizëm!

Kryeministri, apo kryetari i shtetit, apo kryetari i komisionit për bëshkësitë fetare dhe grupet religjioze, apo edhe, kryetari i kuvendit, ia paskan uruar Shaqir Fetait Festën e Kurban Bajramit!!! Tash e tutje këta Institucione shtetërore duhet ta ndërrojnë formatin e teksteve të tilla me të vetmin qëllim për t'ia bërë me dije se, këta Institucione përmes Shaqir Fetait ua urojnë edhe organeve, institucioneve të Bashkësisë Islame që e ka uzurpuar si dhe mbarë popullit mysliman i cili nuk ia çokë fare

Shaqir Fetait!

Dale pak dale! Po pse liderët e partive shqiptare si dhe ata të bllokut mysliman nuk e uruan Shaqir Fetain? Pse e paskan uruar vetëm ata që e instaluan dhe që e përmbajnë në krye të BFI-së! Apo, mbase edhe liderët e tjerë e kanë uruar por që Shaqir Fetai nuk i llogaritë fare ata! I ka urimet e Institucioneve kyçe të shtetit? Kjo ka rëndësi! Urimet e tjera, pastaj, vetëm sa mund t'i zvetënojnë urimin e Pendarovskit, Zajevit, Dragoviçit etj.

Në krejt botën është praktikë që Institucionet më të larta shtetërore t'i drejtohen të parit të fesë, të partisë, të një organizate etj. dhe t'i shprehin urimet e veta më të përzemërta, por që detyrë dhe obligim protokolar e këtyrë të parëve është që këto urim t'i përcjellin deri te besimtarët, deri te aktivistët e partisë, të organizatës, të shoqatës etj. Ç'shtë e vërteta, kjo ka ndodhur edhe me këto urim institucionale shtetërore! Madje edhe i kanë publikuar urimet, të cila fillojnë, përafësisht kështu: "kam kënaqësin që ju, myftinive, intitucioneve fetare si dhe mbarë myslimanëve të vendit, t'ua uroj Festën e Kurban Bajramit..." kurse Shaqir Fetai i shënon si "Kryeministri ia uroi festën e Kurban Bajramit reisul ulemasë Shaqir Fetait..."

Urimi është komunikim intern, në mes të dy personave! Nëse urimi përfshinë grup, komunitet, popullatë, atëherë po që do të botohet, por, nëse i drejtohet vetëm individit, "reisul ulemas", atëherë kjo është çështje private dhe nuk ka sens të botohet. Është idiotizëm! Vetëm Shaqir Fetai e bën për mburrje! I personalizon urimet sa për t'u mburrur para opinionit e sa për t'u thënë: "nuk më duhet përkrahja e juaj, më urreni sa të doni, unë kam me vete kryetarin e shtetit, kryeministrin, kryetarin e kuvendit"... Epo kështu mendon vetëm ai që është shabllon i pistë i hipokritit të përkryer!

Në këtë periudhë kur institucionet shtetërore kanë një sjellje jonjerëzore ndaj Institucionit fetar dhe kur, urimet e tyre festive shprehin ashiqare përpjekjen hipokrite për ta kamufluar çdo padrejtësi që i bëhet komunitetit mysliman të vendit, është turp dhe paftyresi që të shprehësh mburrje se të paskan uruar krerët e këtyre institucioneve! Arkivoi ato dhe, hesht. Heshtja flet më shumë! Arkivi i BFI-së është përplotë me të tilla urime nga krerët e institucioneve më të larta shtetërore, por që nuk janë bërë publike, sepse, realisht, në raport me padrejtësitë që janë ushtruar ndaj BFI-së, ky Institucion nuk ka pasur nevojë për "urime" të tilla, kurse opinionin nuk është lodhur me të tilla hipokrizishë. Shaqir

Fetai ka shumë nevojë që të tregojë se sa shumë e uruan krerët e shtetit, ndonëse asnjë lider, asnjë personalitet politik, asnjë personalitet kombëtar e fetar, nuk ia paska uruar Shaqir Fetait Kurban Bajramin. Ndjesë! Ndoshta e kanë uruar por, ja që nuk janë të rangut të dy-tre drejtuesve të institucioneve shtetërore dhe, si të tillë, nuk i prekin sferat e interesiit personal të Shaqir Fetait. Edhe kameleoni ia ka zili Shaqir Fetait!

3.

Një grup aktivistësh humanitarë, nga Turqia, në përbërje të të cilëve paska edhe aktorë e repistë turq, e paskan vizituar Shaqir Fetain! Të gjithë këta, kanë ardhur nga Turqia që të bëjnë aktivitete, mundësisht ta “institucionalizojnë” aktivitetin e vet duke u pranuar nëpër institucione të ndryshme, kurse vetëm Shaqir Fetai e shënon si aktivitet të vetin personal! Vizitat rutinore, të paqëllimta, të padobishme, që nuk janë në interes të BFI-së, nuk ka se çka shënohen si “aktivitet”!

Aktiviteti humanitar i këtij grupi turqësh, përfshirë këtu edhe atasheun kulturor të ambasadës turke, sa është human aq është edhe biznes-aktivitet që shkon në interes të ndonjë orgnizate turke! Natyrisht, munda i tyre human do të shpërblehet dhe u shpërbleftë prej Allahut Mëshirëplotë. Ata, vijnë në këto hapësira për të therur dhe për të dhuruar kurbanë të paguar nga popullata turke e Turqisë, sepse këtu kurbanët janë më lirë. Kështu që, edhe organizata fiton por edhe ushtrohet një aktivitet shumë i fuqishëm human. Zoti i shpërbleftë! Por, në tërë këtë aktivitet të turqëve, ç’punë ka Shaqir Fetai, apo edhe ai e ndjenë përfitimin e vet, sepse, ndryshe nuk ka se çka e regjistron si aktivitet një punë që fare nuk është e tij!

Apo, të dëshmojmë se sa shumë artistë e repistë të Turqisë e duan dhe e respektojnë Shaqir Fetain, i cili, për turqët nuk paraqet asgjë më shumë se sa një ikër e peshkut levrek të Detit Marmaris!

4.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/22.07.2021

Shaqir Fetai nepotizmin e shtrinë edhe në diasporë

Me njerëz të dyshimtë, me dosje të trashë si në vendlindje, ashtu edhe në diasporë, me njerëz të të njëjtës linjë si të Shaqir Fetait në rolin e ORAO-s së oficerit të UDB-së, me ndikimin e tij për t'i bërë madje edhe kryetarë të xhamive, me premtim të ndihmës nga ana e Mehas Alisë, Shaqir Fetai e nis aventurën e shtrirjes së nepotizmit edhe në diasporë

Na ka ardhur një letër në inbox lidhur me shkrimin me titull “Shaqir Fetai me mision – të hapë filiale të UDB-së në diasporën tonë”, editorial ky i portalit “Lajme7”, letër e cila del si rezultat i nxitjeve telefonike të Shaqir Fetait me ndonjë brythyer të cilin e ka mësuar se si të reagojë, por që del tepër bllof i ulët. Ashtu duhet, siç thotë edhe “mërgimtari”, në xhamitë e diasporës ka edhe këshilla të xhamive, të cilët vendosin se kë do ta nxjerrin në pension, të cilët vendosin të hapin konkurs dhe, vetëm sipas kriterëve të parapara nga ana e tyre, mund të punësohet donjë hoxhë i ri! Por, ja që kësaj radhe nuk po del puna të jetë sipas kësaj logjike, sepse, kemi të bëjmë me njeri që është “ekspert” i shkeljeve kushtetuese, i rregulloreve dhe i të gjitha normave juridiko-humane, pavarësisht se ku hartohen e ku përpilohen ato. Për Shaqir Fetain nuk vlen asnjë parim që është konform parimeve islame, sepse ai tashmë është dëshmuar si antiislamisti më i madh i këtij nënqielli! Nejsë, fundja nuk po na brengosë fort reagimi i “mërgimtarit” të ndërsyer prej Shaqir Fetait. Po na intereson një gjë: a ka raportuar në “rijasetin” e vet Shaqir Fetai për të vërtetën se si ai e keqpërdorë buxhetin e BFI-së, paratë e fitrit dhe të zeqatit dhe, me një delegacion, sikur ta kishte nën menaxhim buxhetin e tërë

shtetëror, niset në Zvicër dhe, duke shpenzuar padhimbshëm nisë të përgatisë terrenin për punësimin e kushëririt të vet, Fesal Fetain, në xhaminë “Mesxhidi-Nur” të Frauenfeldit të Zvicrës. Pse këtë vizitë të diasporës Shaqir Fetai nuk e nisi në qendrat islamike të shqiptarëve në Itali, në Gjermani, në shtetet Skandinave, në Austri, në Amerikë etj, por, pikërisht vizitën përqëndroi ekskluzivisht në Zvicër! Dhe pse e përfundon pikërisht në Xhaminë, imami i së cilës përgatitet të dalë në pension dhe t’ia lëshojë vendin kushëririt të Shaqir Fetait!

BFI-ja, organet e saj, institucionet e saj, vlojnë, së tepërmi vlojnë nga nepotizmi. Nëpunësit e BFI-së gjithandej kanë punësuar djemë, gra, motra, vëllezër, kushërinj, nipa e mbesa. Madje këto punësime i di edhe Shaqir Fetai, janë punësuar në kohën e tij kur ka qenë për dy decenie e më shumë anëtarë i Rijasetit të BFI-së. Myslimanët e vendit japin nga kafshata e tyre për të marrë rrogë administrata e gjërë e BFI-së e cila përbëhet nga baba, nëna, halla, tezja, daja, djali, motra, vëllai, kushëri, nipi, mbesa etj. Dhe tash, po ky Shaqir Fetah e shtrinë këtë dukuri të shëmtuar përtej kufijve, duke e provuar me xhaminë e Frauenfeldit të Zvicrës.

Këtë rast do ta mbajmë nën vëzhgim, ndërsa shumë shpejtë do të shkruajmë edhe për një skandal që lidhet me këtë xhami e që cënon rënd interesat kombëtare të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut!/Lajme7/24.07.2021

Shaqir Fetai me rrena ia ka mësyer “xhenetit”

A paraqesin unitet dhe besueshmëri të përgjithshme ndaj BFI-së rrenat e Shaqir Fetait! I përdori njëmijë truqe, vetëm e vetëm të dëshmohet si “i suksesshëm”! I paska therrur rreth 6700 kurbona!!! Po, diaspora jonë nuk ka se ku t’i therrë në perëndim, ndaj detyrohen që një numër sysh t’i paguajnë në BFI (shumëfish më tepër nëpër Organizatat humanitare të ndryshe), mbi 3000 prej tyre, po ashtu, 2-3 mij kurbanë janë paguar edhe nga Turqia, sepse blerja dhe therrja këtu është më e lirë

Myslimanët e Maqedonisë së Veriut edhe një herë praktikisht e vërtetuan se nuk kanë pikën e besimit në Bashkësinë Fetare Islame të Shaqir Fetait! Ky besim ka një rënie drastike, sidomos që kur në krye të saj u instalua nga politika aktuale maqedonase, Shaqir Fetai, personi që karrierën e vet e ka ndërtuar në veprimtarinë e spiunazhit në UDB-së!

Jo më shumë se 1-2 mij myslimanë të vendit kanë paguar kurbanë që të therrren përmes “kasapnicave” të Shaqir Fetait! Në mënyrë plebishitare e kanë bojkotuar, për më tepër, edhe për faktin që BFI-ja nuk ka pranuar që të mbledhë lëkura kurboni, të cilat, myslimanët, me lotë në sy i kanë hedhur nëpër kontenjere. Janë parë, madje edhe janë fotografuar duke derdhur lotë e duke shtrënguar kokën nga tmerrri i lëkurave të hedhura, sepse, janë mësuar që këtë sadaka ta lënë në oborr të BFI-së dhe të organeve të këtij Institucioni dhe jo ta hedhin kontenjerave, të cilat pastaj zhag nëpër rrugë i kanë tërhequr qentë endacakë. Këta mijëra lëkura të hedhura në kontenjerë, këta tonelata e tonelata lëkura,

dëshmojnë se, megjithatë, myslimanët i kanë therrur kurbanët nëpër oborret e tyre, nëpër livadhe, nëpër ara, dhe mishin e kanë shpërndarë sipas rregullave islame.

Oborri i Medresesë kurrë nuk ka qenë më i mjerë se sivjet! Gjithnjë në oborr kanë vluar dhentë e donuar për kurbanë, kurse, sivjet, ky oborr ishte i shkretë! Mezi nja 10-15 dhenë dëshmonin se edhe në këtë vatër arsimore u donuan disa kurbanë!

Nuk është ky problemi! Le të bëjë petulla në ujë sa të dojë Shaqir Fetai! Le ta fryej sa të dojë numërin e kurbanëve për të dalur më i suksesshëm se “ish-reisi”, megjithatë, një është e vërtetë: Shaqir Fetait edhe praktikisht iu dëshmuua se myslimanët e vendit e bojkotojnë dhe nuk e pranojnë si instalacion të pushtetit maqedonas. Pikë!

A paraqet sukses numri prej 6700 kurbanëve? Madje, a është shifër e saktë, sepse 6700 kurba për të vetmin Istitucion që përkujdeset për zhvillimin e jetës islame për rreth 1 milion myslimanëve të vendit, është shumë pak dhe dështim total! Si është e mundur që nga shtatëqind xhamite, nga shtatëqind imamët e tyre, nga 700 kryetarët e këshillit të xhamive të mbledhen 7000 kurbane, ndërsa vetëm një imam, gjegjësisht, vetëm një kryetar këshilli i një Xhamie (nuk po i themi emrin se të BFI-së menjëherë marrin masa), ka pranuar pagesa për 750 kurbanë, që janë therur dhe janë incizuar veç e veç therrjet duke ua përmendur emrat e secilit që ka paguar, dhe duke ua nisur secilit, veç e veç, inçizimet e therrjes së kurbanëve!

Dyshohet se numri prej 6700 kurbanëve sa i paraqet Shaqir Fetai është edhe më i madh por – duhet diçka të vidhet! Nëse jo, le të botohen të gjitha emrat dhe mbiemrat e donatorëve të kurbanëve në BFI-në e Shaqir Fetait! Nga ana tjetër, me përfitimin që kanë ngelur nga ky numër i kurbanëve nuk do të mund të paguhen as honoraret e anëtarëve të komisionit qendror dhe atyre lokal, therrtoret, ngritoret, frigoriferët, kasapët, najllonat ku (mjerueshëm) “paktohet” mishi! Atëherë, pse kjo vetëmburrje dhe krenari prej hipokriti?!

Nejse pra, është një tjetër rrenë e Shaqir Fetait e cila duhet të provokojë padi penale por edhe mllëfin e mbarë myslimanëve të vendit!

Ditën e therrjes së kurbanëve në një prej “kasapnicave”, paskan pasur edhe inspektorë nga Komisioni Qendror i Kurbanave dhe nga Agjencia për ushqim dhe veterinari! Shërbimet profesionale të Shaqir Fetait, përplotë me injoracë, me hipokrizi por edhe me djallëzi, thonë: “Këtë vit për herë të parë, Komisioni Qendror i Kurbanave ka pranuar edhe një kërkesë që një grup profesorësh universitar nga Fakulteti i Veterinarisë të Universitetit Shën Kirili dhe Metodi, të bëjnë kërkime shkencore mbi sigurinë e mishit të kafshëve të therura. Pas marrjes së rezultateve, mishi i kurbanëve ka rezultuar i sigurt për konsum dhe ka nisur shparndarja i tij.” Dikush tha që ky farë “reisi” i instaluar as ujin nuk e pi pa i thënë institucionet shetërore “pi”, madje “merr fryme”!

Sido qoftë, në këtë “informatë” fshihet një kleçkë e cila hedh akuza të drejtëpërdrejta kundër ish-reisit H. Sulejman ef. Rexhepi! Nga kjo akuzë, fatamirësisht, nuk mund të amnistohet as Shaqir Fetai, si anëtarë i ish-Rijasetit! Të gjithë paskan qenë shpirtprishur dhe helmues masivë?!

Për herë të parë qenka kontrolluar mishi! Po në të kaluarën, çfarë mishi kanë konsumuar myslimanët e vendit, sidomos ata që janë “daravitur” me mish kurban nga BFI-ja, gjegjësisht, nga “Hilali”! A ka qenë ai mish i kontrolluar! Si mund të thuhet madje, si guxohet me kaq bindje të thuhet se, sivjet, për herë të parë qenka kontrolluar mishi dhe se qenka shpërndarë vetëm pasi janë marrur rezultatet nga Agjencia për ushqim dhe veterinari!

Kjo akuzë e “tërthortë” nënkupton se në BFI duhet të nisin përgatitjet për padi kundër atyre që vite më parë kanë shpërndarë mish të painspektuar, të paverifikuar dhe të palejueshëm! Duhet të përgjigjet Shaqir Fetai për vitin e kaluar dhe ish-reisi dhe tërë anëtarët e Rijasetit për vitet e mëparshme, sepse, ky konstatim i “shërbimeve profesionale” të Shaqir Fetait paraqet një skandal, një veprim antihuman me përmasa të krimit ndaj njerëzimit!

Nëse nuk e dokumentojnë këtë tmerr këta të BFI-së së Shaqir Fetait dhe, nëse nuk është e vëtetë kjo se “sivjet për herë të parë inspektohet mishi i kurbanëve”, atëherë, me plotë të drejtë H. Sulejman ef. Rexhepi duhet të ngrisë padi për shpifje dhe për nxitje të urrejtjes fetare! Ky duhet të jetë edhe obligim moral e njerëzor i efendi Rexhepit, sepse, duhet t’i rehatojë të gjithë myslimanët e vendit, duke i bindur se, për këto tre decenie, që kur BFI-ja ndanë me të madhe mish kurban, gjithnjë ka qenë i kontrolluar dhe i lejuar për konsumim nga ana e institucioneve përkatëse shtetërore.

Nuk mundet që çdo gjë islame në këtë nënqiell të jetë “për herë të parë”, dhe t’i përshkruhet si meritë shtetit të Shaqir Fetait. Shaqir Fetai me rrena ia ka mësyer “xhenetit”, por vështirë se do të arrijë deri në sterrnishtat e para të Çegranit!/ 1KlikLarg/24.07.2021

Zbërthimi i autoritetit falco

(Edhe diçka rreth shkrimit me titull “SHAQIR FETAI ME RRENA IA KA MËSYER “XHENETIT””, të botuar në disa portale kombëtare, e që kishte të bëjë rreth kurbanëve të sivjemë)

Nga Masar Livareka

Më bëri përshtypje një fakt në këtë shkrim! Me të drejtë shkrimi fliste për bojkotimin e Shaqir Fetait nga ana e myslimanëve të vendit. Qindra e mijëra të tillë nuk i janë përgjigjur apelit të Shaqir Fetait si dhe propagandës së tij për donim të kurbanëve në Medrese, ndërsa vetëm ata që nuk kanë pasur mundësi kah t'i mbajnë ne therrjen e kurbanëve si dhe donatorë të huaj që kanë paguar, i kanë dalur në “susret” Shaqir Fetait! BFI-në e Shaqir Fetait masovikisht e kanë bojkotuar myslimanët e vendit! Megjithatë, nga kjo situatë mund të nxirret Shaqir Fetai dhe, edhe më tej të vazhdojë me “autoritetin” e vet falco! Këtë “autoritet” ia zbërthen dhe e lakuriqëson atë komplet prej gënjeshtreve vetëm një fakt tjetër shumë interesant!

Është fakt i pamohueshëm se, Shaqir Fetain, këtë farë burri në dimija grashë, e kanë bojkotuar, jo populli por, vetë nëpunësit e BFI-së, nxënësit e Medreses, studentët etj.! Sikur mos të bojkotohej nga kjo “strukturë”, nuk do të kishte nevojë për aq shumë reklama, të derdhte para të majme duke reklamuar se, BFI-

ja tubon kurbanë të dhuruar donacion nga myslimanët e vendit dhe më gjërë!

Apeli i tyre ishte: të donohet për nxënësit e Medresesë, për nevojat e kësaj vatre arsimore. Shumë mirë! Me nja 10-15 ton, që i bie rreth 1000-1500 kurbanë mjaftojnë për nevojat e restorantit të kësaj Medrese, ku ushqehen medresantët tanë! Çka ka nevojë që BFI-ja të dëshmojë të paktën një herë në vit se është edhe Institucion që e kultivon humanitetin! Me humanitet të huaj të bëshë humanizëm?! Vetë kurbanë i donuar në BFI, përveç simbol sakrifice për të Madhin Zot, është edhe humanitet i donatorëve myslimanë! Çka ka nevojë që, BFI-ja ta vjedhë këtë humanitet dhe ta prezantojë si të veten? Po pse këtë nevojë ta ketë BFI-ja, kur, ky Institucion mision ka zhvillimin e jetës fetare, kurse ka edhe organe dhe institucione të veta që mund ta kryejnë këtë aktivitet human, pa u involvuar hajnat e BFI-së!

Le t'i kthehemi konstatimit tim se ky Institucion i Shaqir Fetait që po mbahet në këmbë të qelqta, po bojkotohet nga vetë të punësuarit, nëpunësit, nxënësit dhe studentët e vet!

Medresetë kanë rreth 700 nxënës, por edhe FSHI ka nja 200 studentë! Në këto dy vatra arsimore punojnë nja 70 profesorë, edukatorë e personel tjetër teknik! Vetëm këta, si dhe baballarët e këtyre nxënësve dhe studentëve arrijnë numrin 1000! Po sikur t'u kërkohej që të therrin edhe për gratë, nënat, e tyre! Kjo do ta dyfishonte këtë numër! Secili prej tyre do të duhej të ndikonte, të paktën edhe për 1, 2, 3 kurbanë, tek vëllezërit, motrat apo dhëndurtë, axhallarët, dajallarët, miqasia etj, dhe, sikur të gjithë të dononin nga një kurban, ky numër do të shkonte në 4-5 mijë kurbanë! Trembëdhjetë myfti, mesatarja me nga 4 nëpunës, bëjnë 50 plus dhe gratë e tyre, bëjnë 100! BFI-ja thotë se i ka të punësuar mbi 20-30 persona administratë plus secili me gra, ja dhe nja 50 kurbanë! BFI-ja e Shaqir Fetait thotë se i ka të punësuar edhe nja 1200 hoxhallarë (imamë, vaizë, mualimë, muezinë etj.)!

Ja pra, sikur të ishin të gjithë parimorë, sikur të ishin të gjithë nën "autoritetin" e Shaqir Fetait, sikur të gjithë këta ta kishin brengë Medresenë, sikur të gjithë këta të ishin "model i Shaqir Fetait" për unitetin rreh "autoritetit" të tij dhe të bashkëpunëtorëve të tij hajna, me siguri që vetëm nga këta njerëz të lidhur ngushtë për Medresenë si dhe për FSHI-në, do të mblidhte mbi 7-8 mijë kurba dhe nuk do të kishte nevojë që të rrugavet poshtë e lartë

duke kërkuar ndër mysliman, lëmoshë, të paktën, nga një kurban! Autoriteti i mirëfilltë do të kërkonte, madje do t'ua kërkonte me insistim dhe pa tolerancë, të gjithë këtyre “ushtarëve” të BFI-së që të donojnë kurbanë dhe, kësisoj, do të kishim një sasi të konsiderueshëm mishi, të cilin, vetë të punësuarit e BFI-së si dhe nxënësit dhe studentët, gjegjësisht, familjarët e tyre, donojnë kurbanë për të varfërit e vendit! Pra, nxënësit, medresantët, profesorët, nëpunsit fetarë, hoxhallarrët e vendit, që të gjithë do të dononin mish për të varfërit e vendit! Ky aksion ka kuptim dhe, nuk ka kuptim që t'ua mbledhësh kurbanët myslimanëve të vendit që t'i të bëshë humanitet!

Ashtu siç e kanë bërë praktikë që kandidatët për haxh, veç të tjerash, duhet të paguajnë edhe kurbanin që do t'u therret gjatë haxhillëkut, ashtu mund t'ua bëjnë praktikë edhe të gjithë të punësuarve, nxënësve, studentëve, profesorëve, hoxhallarëve etj. që, për çdo Kurban Bajram, të dhurojnë nga një-dy kurba e më shumë, me qëllim që në emër të tyre të sigurohet edhe mishi për nevojat e Medresesë, por edhe të zhvillohet humanitet konkret i njerëzve të BFI-së!

A mund ta bëjë këtë Shaqir Fetai?! Jo për shtatëqind mijë bajrama, jo, sepse, është i padëshirueshëm, sepse është i instalirët, pa kurrfarë autoriteti dhe personaliteti, pa kurrarë kontributi konkret dhe pa kurrfarë merite. E vetmja meritë e tij është pozicionimi njëherazi në disa parti të pushtetit maqedonas! Shaqir Fetai mund të jetë ndonjë farë “alimi”, siç pretendon ai, por ama, i mungon gjëja kryesore e lidërsipit: nuk ka karizëm, nuk ka integritet, nuk çon peshë fjala e tij, nuk ka të kaluar të begatë kombëtar e fetar. Nëse UDB-ja amnistohet me kohë, nuk mund të harrohen veprimet e kësaj strukture policore serbe, fund e krye antishqiptare! Edhe udbash edhe lider?! Askujt nuk i ka shkuar për dore deri më sot! Si rrjedhojë e këtij fakti, bojkotohet masovikisht Shaqir Fetai i cili, për këtë bojkot është shumë i vetëdëshëm, prandaj nuk futet “therrave” por rri aty ku i kanë thënë dhe e kryen atë mision që ia kanë dhënë!

Përkrahje për këtë mision, për momentin ka plotë, nga bashkëpunëtorët e vet, sepse të gjithë i ka të zgjedhur nga taborri i vet shpirtëror! / 1KlikLarg/25.07.2021

Cili është morali i hipokritit

Shaqir Fetai edhe një herë dëshmoi se është kallëpi i hipokrizisë! I turpëruar nga teksti i “ngushëllimit” me rastin e tragjedisë që ndodhi në Sllavonksi Brod të Kroacisë, ku u rrokullis autobus i kosovar me ç’rast vdiqën 10 shqiptarë dhe mbi 30 të tjerë u lënduan, e që është publikuar në facebook-un zyrtar të BFI-së, ku shkrimet e natyrave të urimit e të ngushëllimit do të duhet të mbajnë firmën e Shaqir Fetait, pesë orë më vonë, ai do të publikojë një tekst ngushëllues “më të logjikshëm” në facebook-un e vet! Ky gjest prej hipokriti, a e amnistion prej diletantizmit që luhet nga ai e në emër të tij, si dhe në terren të tij?! Natyrisht që jo! Sepse, Shaqir Fetai mbanë përgjegjësi edhe për çdo fjalë që publikohet në faqet zyrtare të BFI-së, sidomos në fjalët që shprehin urim, përgëzim, apo ngushëllim!

Shaqir Feta, i pa kënaqur nga ai tekst përplotë injorancë por edhe i pafuqishëm për të ndërmarrë masa për ta larguar “tekstin humoristik” si dhe masa kundër tekstshkruesit analfabet si dhe kundër atyreve që janë përgjegjës të faqeve zyrtare të BFI-së e që, në asnjë mënyrë nuk guxojnë me injorancën e tyre ta poshtrojnë aq keq BFI-në, shkon dhe në njëfarë forme mundohet të distancohet nga ai tekst, duke dalur me ngushëllim personal në facebook-kun e vet!

Shaqir Fetai harron se personalisht mund të pallamundë çfarë të dojë, mund të shpërftyrohet në llapanguzë e në fillorist, por ama, në faqet zyrtare ku komunikohet çdo ditë aktiviteti, puna dhe fjala e tij, duhet të shfaqet në nivelin më të lartë të mundshëm të profesionalizmit. Sepse, kështu dëshmohet përkushtimi, profesionalizmi si dhe respekti ndaj fjalës së shkruar me të cilën i drejtohet një auditoriumi më të gjërë, përtej kufijve zyrtar të këtij vendi! Me “tekst ngushëllues” si ai i publikuar në facebook-un zyrtar të BFI-së, veçsa dëshmohet amatorizmi, diletantizmi dhe hipokrizia e Shaqir Fetait me bashkëpunëtorët e vet injorantë. Shaqir Fetait i kanë kërkuar shumë njerëz, një komunitet i tërë që,

sa më parë të urdhërojë që ai tekst ngushëllues që ka dalur në emër të BFI-së të fshihet dhe të postohet në faqen personale të injorantit që e ka shkruar. Por, Shaqir Fetait, duke i dalur dardha me bisht, duke i ardhur inat se pse është vërejtur ky idiotizëm, për inat të komunitetit, shkon dhe shpreh ngushëllim personal, në emër të Shaqir Fetait-Orao-s, në facebookun e vet, gjë të cilën nuk ia kërkon dhe nuk ia oblogon asgjë dhe askush! Por ama, nëse vendos të manipuloshë ne emër të BFI-së dhe ta keqpërdorësh faqen zyrtare të Institucionit, të paktën duhet të dalësh më dinjitoz dhe më reprezentatues! Kështu si ka dalur “teksti ngushëllues”, në fakt flet më shumë për moralin e hipokritit, për dyftyrësinë e Shaqir Fetait!

Të hënën ditë zie në Kosovë, e Shaqir Fetai mundohet të dalë “faqebardhë”! Po fytyra e Bashkësisë Fetare Islame?!?

Ky Institucion ka ngelur pa fytyrë që kur në krye të tij u instalua Shaqir Fetai i pafytyrë nga pushteti aktual maqedonas. Jo vetëm turp por edhe mjerim!/Lajme7/26.07.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (4)

Çka paska folur kësaj radhe Shaqir Fetai? Veçse është përpushur të lajë m... me sh... Asgjë tjetër! Si çdo herë, edhe kësaj radhe është ndjerë i respektuar nga vizita e antishqiptarëve, njerëzve të dyshimtë, me të kaluar hiç më të mirë se të veten! I kompleksuar se në kohën e tij nuk ia ka çukur askush, askush nuk i ka dhënë qoftë një mirënjohje formale, tani, macasi-kucasi janë pajisur me “mirënjohjet” e Shaqir Fetait, të cilat ai i përkthen në çertifikatë udbye

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

Bijat e arta të kombit i përruron një udbash?! A ka më hipokrizi se kjo! A ka gjë më të poshtër se kjo! A ka ofendim më të madh se sa Shaqir Fetai t'i përrurojë Distria Krasniqin dhe Nora Gjakovën për medaljet e tyre të arta në Olimpiadën e sivjemë! Demeke, unë si “rreis” ju uroj se, kur kam qenë myfti nuk kam mundur se më është dukur vetja si shumë i vogël! Tash jam rritur!!! Pirdhu bre, injorant, fuks! Këto ia zbardhën fytyrën kombit shqiptar, po sa ia ke zbardhur ti o Shaqir Fetai, gjithandej po të shqepen fletët nga dosjet e UDB-së ku ti na del goxha “xhudist” dhe, si i sukseshëm ke pasur pseudonimin ORAO dhe, ja ku je shpërblyer me postin “reis” si rezultat i pehlivanllëkut tënd në spiunim! Tani, vërtet a ka më baltosje, më ofendim, më sharje të fëlliqtë se sa të të urojë Shaqir Fetai! Pis mahluk!

2.

“Reisul Ulema priti teologun e njohur nga Gjermania”! Për herë të parë dëgjuakam për këtë teolog! O a ka birë nane që del e që na flet ndonjë gjë të bukur e të mirë për këtë teolog! A bëhet fjalë për atë Benjamin Idrizi, i cili sa ka vegjetuar në Shkup është deklaruar turk dhe se nuk i ka pasur punët mirë me shqiptari? A bëhet fjalë për atë Bunjamin Idrizi, të cilin, më vitin 2007 Bashkësia Fetare Islame e refuzoi atë duke e fshirë nga lista e pjesëmarrësve në Konferencën e parë botërore ndërkonfesionale organizuar nga Ministria e Kulturës dhe mbajtur në Ohër! BFI e refuzoi ngase atë deshti ta imponojë si pjesëmarrës nga “bota myslimane” ambasadori maqedonas (i VMRO-së) në Gjermani! A bëhet fjalë bre për të njëjtin Bunjamin Idrizi i cili zhvati qindra mijëra euro të donuara nga Sharika për ndërtimin e Xhamisë së Dyqanxhikut, aktivitet ky që u përdor për shpëlarje parashë nga disa persona e organizata turqësh shumë të afërt me këtë farë “hoxhe” (vërtet ku e kreu ky Medresenë, sepse atë në Shkup e braktisi, iku! Po fakultetin? Ku e bleu diplomën, sepse nuk rezulton në asnjë fakultet teologjik në botën islame ku ky ka mbaruar i rregullt! A është po i njëjti Bunjamin Idrizi për të cilin dikur gazetate gjermane flisnin për një gënjeshtar të pacipë, për një “prevarant” e manipulator, shkrime që ilustroheshin me fotografi ku paraqitej karikaturë me hundën e madhe si të Pinokios! A bëhet fjalë more për të njëjtin Bunjamin i cili donacionet e huaja i ka orientuar në ndërtimin e xhamisë për boshnjakë! Po pse ka ikur nga rrethi i shqiptarëve?

Shaqir Fetai, duke e gjetur edhe një si vetja, e pranon dhe i jep “dekoracion” në formë të mirënjohjes! I ka me bollëk! Për inatë të së kaluarës së vet e cila nuk ia siguroi asnjë mirënjohje, tani ka vendosur t’u japë të gjithëve që shkojnë te ai me pi çaj dhe që ia krijojnë mundësinë për një foto të përbashkët të cilës do t’ia vë diçiturën “erdhi të ma urojë detyrën e re dhe të më dëshirojë shëndet e suksese”! Je i garantuar në dështim, o fuks, sepse nuk mundet që, edhe teolog edhe fuks! Zoti nuk thotë ashtu siç mendon Shaqir Fetai!

Shaqir Fetai thotë: “Fillimisht Reisul Ulemaja i dëshiroi mirësearchje në vendlindje mysafirit...”! Si more mysafir në vendlindje të vet! Apo ndoshta e njeh si të konvertuar në boshnjak, në turk, apo sëfundmi, në gjerman dhe, si i tillë, natyrisht që do të jetë mysafir në vendlindje të vet! Çka nuk di Shaqir Fetai? Gjithçka që ka të bëjë me llapanguzën!

3.

U shkruajt shumë, madje i gjithë opinionioni u tall, saqë tashmë kanë nisur edhe barcaletat rreth “ngushëllimit eseistik” që e kishte shprehur Shaqir Fetai me rastin e aksidentit tragjik që i ndodhi autobusit plotë me shqiptarë që po vinin nga Frankfurti i Gjermanisë për në Kosovë! U kërkua nga Shaqir Fetai që të japë urdhër dhe shërbimet e tij “profesionale” ta heqin atë “ngushëllim” idiotik dhe të mbanin përgjegjësi, sepse e kishin botuar në facebook-un zyrtar të BFI-së.

Përkundër kësaj, Shaqir Fetai zgjodhi rrugën e injorimit të rastit si dhe të kërkesave të opinionit të gjërë të vendit! Nuk e largoi “ngushëllimin” idiotik, dhe me këtë deshti të na thotë se nuk mbanë përgjegjësi për gjërat që botohen në faqen zyrtare të BFI-së! Pra, distancohet nga Institucioni, kurse si valide e pranon vetëm atë që e nisë me emër të vet! Madje edhe na e fotografon dhe e publikon “telegramin e ngushëllimit”! Edhe dhentë në vend edhe ujku i ngopur, a?

Nga ana tjetër, nuk ia kanë “tejt” as shërbimet e veta profesionale, sepse, gjatë “transkriptimit” të tekstit të botuar si foto, “shërbimet profesionale” nuk i qëndrojnë korrekt, por, botojnë atë që duan vetë. Pra, tjetër tekst na del në memorandumun e fotografuar, dhe tjetër tekst na del në “transkriptimin” e atij teksti në faqen zyrtare të BFI-së! Shaqir Fetai nuk kontrollon asgjë! Shaqir Fetai nuk pyetet për asgjë! Shaqir Fetain askush nuk e q... në rrush! Shaqir Fetai nuk çon kurrnjëfarë peshe në BFI. Për këtë është shumë i vetëdëshëm edhe Shaqir Ftai, prandaj, ka vendosur që të mbajë llogari vetëm për “imazhin-fytyrën” e vet, kurse, fytyra dhe imzhi i BFI-së u njollostë deri në përbaltje totale! Ky është Shaqir Fetai, alias, ORAO!

4.

“Kam nder të veçantë që të përcjelli mirënjohjet dhe respektin e veçantë të gjithë besimtarëve...”, thotë Shaqir Fetai! I përcjell mirënjohjet? A thua të kujt janë ato mirënjohje që i përcjell Shaqir Fetai? Apo, ky bilmez mbase ka dashur të thotë: “Kam nder të veçantë që t’i shpreh mirënjohjet e mia si dhe respektin tim për...” Epo, sintagma të tilla si ajo lartë mund të bluajë vetëm të menduarit shkinisht dhe logjika sllave!

Shaqir Fetai “u përcjell” mirënjohje të gjithë atyreve që paskan donuar kurbanë për Medresantët e Medresesë Isa Beu! Po kush janë ata që e donuan për këtë Vatër Arsimore? Pse ata nuk përmenden me emër e mbiemër!

A e di Shaqir Fetai se, nga ajo Vatër Arsimore deri më sot kanë dalur mbi 4000 medresantë. Plus që aktualisht vijojnë mësimet mbi 700 nxënës! Futi këtu edhe studentët, profesorët, personelin teknik dhe, ja, u mblodhën 6700 kurbanë aq sa iu paskan “përgjigjur” apelit të Shaqir Fetait, i cili, më shumë ka shpenzuar për reklama e për komisione lokale e qendrore, se sa ka fituar nga donimi i këtyre kurbanëve. Plus që janë vjedhur me llopatë, me kaci, biroo! Me të vërtetë, pse ky numër nxënësish, studentësh e personel arsimor e teknik i këtyre vatrave nuk paraqitet publikisht për donim dhe t’i shpëtojë këta, Shaquan me banditët e vetë, që të shndërrohen në rolin e lypsarëve me të vetmin qëllim që të kenë se çka të vjedhin! Ja pra e vërteta: Shaqir Fetai masovikisht është bojkotuar nga të gjithë ata që kanë kaluar nga kjo Medrese e Fakulteti, si dhe nga ata që ushqehen nga këto vatra arsimore! Të gjithë këta tashmë janë dëshmitarë të gjallë dhe janë lodhur duke e vëzhguar çiftin e Shaqir Fetait se si vjedhin nga djersa e myslimanëve të vendit, qoftë si fitër, si zeqat, si haxh apo si kurban! Dhe, këtë krim, Shaqir Fetai mundohet që ta “kamuflojë” me qëndrimin për të cilin ai mendon se e nxjerr “transparent”, duke shprehur falënderime për ata që dhuruan kurbanin e tyre, i cili, më se 70 për qind përfundon nëpër frigoriferët e “nëpunësve” të përgëdhelur të Shaqir Fetait, përfundon nëpër xhepa të tyre (paratë, sepse kurbanët nuk therren fare!) dhe një pjesë shpërndahet për të varfërit që thirren me telefonë! Ata të varfër që nuk kanë telefonë, ata le t’i bien fyellit!

Fare në fund, Shaqir Feta derdhë lumë hipokrizinë e vet: “Lus Allahun Fuqiplotë që t’i pranojë veprat tona, kurbanët tonë dhe angazhimet tona duke lëshuar shpërblimet e Tija të pakufishme.” Për cilët “kurbanë tona” e ka fjalën Shaqir Fetai?! Të të punësuarve në BFI? Të atyreve në Medrese? Të imamëve, myftive?! Ata kurbanë janë të myslimanëve, o duduk, që ua kanë donuar juve! Kurse, thua ti se Zoti do t’ju shpërblejë për angazhimet dhe veprat e juaja?! Hajninë dhe manipulimet t’i shpërblejë Zoti? Mbase ua shpërblejnë “zotërat” si Lati, Uzati dhe Menati! I Madhi Zot ka hequr dorë nga ju! Kot luteni t’ju bekojë, kur Ai tashmë ju ka mallkuar! Duhet të jetë mallkim i rëndë, sepse, të pranoshë që të

“drejtohesh” nga hajnat, nga tradhëtarët, nga pista, nga spiunët, nga udbashët – ky po që është mallkim i Zotit!

5.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/27.07.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (5)

Tani, me këtë të “folur”, kush kë e nguli: Shaqir Fetai Talat Xhaferrin, apo Talat Xhaferrin Shaqir Fetain. Ndërsa që të dy u takuan, madje patën takim eksitues dhe këmbim eksperiencash, me përfaqësuesin e DUMA-s ruse dhe me më të dashurin prej myslimanëve marionetë të Putinit! Çka u diskutua? Çka u morën vesh? Nuk e thonë këtë por i bëjnë trysni TetovaSot-it dhe e detyrojnë ta heq shkrimin e Ilir Ramadanit. Pason reagimi i Kuvendit ndaj Ilir Ramadanit, kurse nuk i reagojnë Radio Evropës së Lirë të cilat u bazuan Ilir Ramadanit për shkrimin e vet gazetaresk. Me rusin qenka takuar kryetari i Serbisë, Ivanovi, pse jo dhe Talati

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

Shaqir Fetai na e paska takuar të ashtuquajturin myfti i Shtipit, Nasir Rexhepin nga Tetova (kohëve të fundit disi shumë shpesh po e takon këtë “myfti”!!!), si dhe, bashkë me të, edhe kordinatorin e Shoqatës “Hudai Vakëf”, njëfarë Ahmet Lokçe! Me të dy Shaqir Fetai paska folur për bashkëpunim në të ardhmen (!!!) Shaqir Fetai shpreson shumë fort se ky takim do jetë aq fillestar drejt një bashkëpunimi të gjërë! Ai thotë: “Mbet që bashkëpunimi të filloi hapat konkret për të gjithë muslimanët e vendit dhe më gjërë”!

Tani nuk dihet se me kë Shaqir Fetai do ta nisë bashkëpunimin? Me Myftininë e Shtipit? Pse a nuk ka pasur bashkëpunim deri më sot ë, na u paska dashur vetëm një takim zyrtar që të nisë bashkëpunimi? Apo e mendon Shaqir Fetai se, takimi me këtë farë Lokçen ia paska krijuar mundësitë e një bashkëpunimi për të gjithë myslimanët e vendit dhe më gjërë!!! A është në vete Shaqir gungshi se çka shkruan e çka flet?! BFI-ja ka Organizatën e vet humanitare e cila duhet të takohet dhe të vë bashkëpunim me të gjitha simotrat humanitare që veprojnë në këtë vend! Çka ka nevojë Shaqir Fetai t'ia institucionalizojë aktivitetin humanitar një shoqate, gati-gati, të papërfillshme në vend?! Krisi ndonjë korrupsion apo, kjo do të ngelë në perspektivë?! Një gjë është më se e sigurtë! Nëse kjo organizatë është “pro-turke”, atëher, shumë shpejt Dijaneti i Turqisë do t'i kërkojë që t'ia kthejë shpinën Shaqir Fetait, sepse, këtij të fundit fort po ia kënda që të koketojë me “forume myslimane europiane”, që nuk është gjë tjetër përveçse dorë e zgjatur e politikave ruse të Putinit, e cila i shërben për t'ia bërë sa më të lehtë sendërtimin e interesave gjeopolitike ruse në rajon! Aleti më i përshtatshëm i këtij sendërtimi në vendion tonë me gjasë u ka dalur të jetë Shaqir Fetai dhe bashkëmendimtarët e tij që kanë hëngër në të njëjtën enë të servitur nga oficerët e UDB-së të llojit të Stanko Dragoviqit!

2.

Shaqir Fetai paska realizuar një takim me përfaqësues të organizimit të jetës fetare nga diaspora jonë, e shtrirë, kryesisht, nëpër vendet e Evropës Perëndimore.

Fillimisht, nisi t'i presë një nga një në kabinet, sepse, kështu ka mundësinë të fotografohet dhe të bëjë lajm! Por, kur e pa se këta përfaqësues nuk e kishin ndërmend që ta prinsin Shaqir Fetain deri sa t'i shterrojë të gjitha këto takime një nga një, atëherë, u detyrua që ta përsërisë traditën e “babait të vet shpirtëror”, H. Sulejman ef. Rexhepit, duke i takuar që të gjithë, grumbull, në Medresenë e Isa Beut!

Për ta bërë më të dallueshëm nga takimet e më parshëm, Shaqir Fetai kujdeset që takimi të jetë sa më zyrtar, të jetë “nën protokollin” e tij, dhe te realizohet ashtu siç ka qejf ai, duke ia garantuar vetës rritjen e adrenalinës së një “reisi” të instaluar nga politikant maqedonase antikombëtare dhe antiislame, në krye të

BFI-së së kapur nga segmente të caktuar të shtetit!

Shaqir Fetai, edhe një herë dëshmoi se, si ai gjeli që i mbyllë sytë kur këndon, sepse e di këngën përmendësh, edhe ky, symbyllurazi nisi t'ua shqepë, që të gjithëve, nga një mirënjohje! Nga një copë letër, e cila nuk vlenë as si letër higjienike, sepse, një ditë, kur do të ndërgegjësohen, që të gjithë do të turpërohen nga “mirënjohjet” që mbajnë në shkrimin e fuksit Shaqir Fetai.

Shaqir Fetai u paska dhënë mirënjohje me motivacion që t'i cysë sa më shumë që të kontribuojnë në zhvillimin e jetës fetare islame në diasporë! Një gjë e tillë është obligim dhe detyrim i shenjtë, që duhet ta kryejë secili pjesëtar i islamit në Evropë, pa pasur nevojë fare që të frymëzohen nga Shaqir Fetai. Kurse, sekretarit(icës) së vet i kishte thënë se, me këto “hajmali magjistari” që do t'i mbajnë si naivë nëpër komodinat e televizorëve, për t'u mburrur para anëtarëve të familjes se ia vlejti që morën vendim të vijnë në “atdhe” për pushime meqë u “nagraduan” me mirënjohje nga Shaqir Fetai, në fakt, do të detyrohen avash-avash që të pajtohen me të vërtetën se kush është “reisi” i tyre! Vetëm një mendje e sëmurë si ajo e Shaqir Fetait mund ta bluajë këtë hipokrizi dhe këtë idiotësi!

3.

“Doja të respektoj fshatin...”, “doja të respektoj myftiun e nderuar i cili tashmë i jep një frymë të re jetës fetare islame, me një strategji të veçantë e largpamëse”, “doja t'i respektoj fëmijët”, “më se tepërmi doja të respektoj imamin e fshatit për të cilin më vijnë me vite e vite informata se është fanatik i mësim-besimit islam”, “këtë përkahje nuk dojshim ta bëjmë të vogël, dojshim t'i japim peshë”, “Dhe këtu jemi bashkë me personatetet më të johura dhe më eminente të Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut”, “Myftiun e një mytinie të largët, e cila, me ardhjen e këtij myftiu veçmë është bërë shumë e njohur, myftiun Salim Sulejmani”, “me ne është edhe sekretari gjeneral i Bashkësisë Fetare islame, profesor Irsal Zendeli”!

Këto sintagma idiotike, këto fjali injorantësh, kjo injorancë e pashembullt – të gjitha janë të Shaqir Fetait, nga një fjalim i tij prej 9 minutave, të mbajtur në Xhaminë e fshatit Dragomisht i Madh i Kërçovës, me rastin e dua hatmes së nxënësve të mektebit të kësaj xhamie.

Doja të respektoja, më së tepërmi ta respektoja imamin... Respekti është virtyt i çdo myslimani, deshti apo jo ai, ai gjithnjë duhet të respektojë! Edhe kjo një logjikë që del nga të menduarit sllavisht, sepse, në shqip do të duhej të shprehej “dua të shpreh respektin tim për imamin, myftiun, nxënësit” etj!

Shaqir Fetai “e respekton” (inJORANTIN!) edhe myftiun aktual të Kërçovës, i cili “paska ardhur” në krye të kësaj Myftinie me një “strategji të veçantë e largpamëse”! Po i ndjeri, ish-Myftiu, Murat Hyseini, a nuk i jepte frymë kësaj Myftinie! E paska pas ngulfatur fare ë! U desht të vijë Shaqir Fetai, të bëjë një sërë manipulimesh, driblimesh, të premtojë e të premtojë, të manipulojë e të manipulojë dhe, më në fund, të sjellë “njeriun me vizion”! Po cila na ishte strategjia e Shaqir Fetait, ajo largamësi e tij?! UDB-a! Falë këtij shërbimi antishqiptar e antiislam, e cila nga mbeturina e pistë do të rigjenerohet në kode të veçanta, ndërsa sërish do të lëshojë rrënjë e do të rritet duke sjellë në pozita njerëzit e vet, të llojit të Shaqir Fetait.

Shaqir Fetai “e respekton” edhe imamin e fshatit, për të cilin thotë se “me vite e vite më vinin informacione se është fanatik i mësim-besimit”! Një informacion i tillë me vite e vite rreth fanatizmit të një personi në ligjërimin e mësim-besimit, i ka shkuar në vesh vetëm një udhëbashi! Ja si deshti Zoti i Madh dhe në mes të xhamisë e lakuriqësoi Shaqir Fetain duke e detyruar të tregojë se si “me vite e vite i kanë ardhur informacionet për një fanatik të mësim-besimit islam”! Ç’ju deshtën Shaqir Fetait këta informacione lidhur me imamin e fshatit? Ky kurrë nuk ka qenë përfaqësues i tij, imami kurrë nuk ka qenë pjesë e myftinisë së Gostivarit! Pastaj, pse pikërisht Shaqir Fetait t’i shkojnë informacione me vite të tëra për imamin e fshatit! Shaqir Fetai duhet të kuptojë se ka nisur të matufoset, se nuk po di më se çka po flet, se ka nisur të lakuriqësohet e të dalë në petkun e profesionit të tij të vërtetë antihuman!

Shaqir Fetai, i ekzaltuar nga suksesi i imanit të xhamisë, paska pasur dëshirë që t’i japë përkrahje imanit, por, paska zgjedhur që ajo përkrahje të mos jetë e vogël, por me peshë! Dhe, sipas Shaqir Fetait, këtë peshë ky takim do ta merrte vetëmse me prezencën e “personaliteteve më të njohura, më eminente” të Bashkësisë Fetare Islame në RMV! Po kujt u thotë Shaqir Fetai “personalitete eminente”! Bashkëpunëtorëve të vet, hajnave, të pamoralshmëve, spiunëve, tradhëtarëve! Kujt? Atyreve, bashkë me të cilët, një jetë

të tërë i kanë shërbyer ish-reisul ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepit dhe, në fund, e tradhëtuan, duke ia ngulur thikën pas shpine, ndonëse ia kishin hëngër bukën, ndonëse ia kishin përvetësuar shpirtin e zemrën! Po këta “personalitete”, të gjithë, përfshirë këtu edhe Shaqir Fetain, kryehipokritin, më së miri i njeh vetë Sulejman Rexhepi që i krijoi “personalitete”! Le të pyetet njëherë Sulejman ef. Rexhepi, se, ç’mendim ka për secilin veç e veç; cili është “personaiteti” i tyre. Ç’karakterë janë këta “personalitete”!

Shaqir Fetai ka “nderuar” edhe një myfti, i cili, me “ardhjen” në krye të një myftinie shumë të largët (!), këtë myftini e paska bërë shumë të njohur! E “nderon” Salim Sulejmanin, i cili, me mijëra truke, servilizma e spiunime, ka arritur ta shesë lojalitetin e vet te Sulejman ef. Rexhepi, ka arritur t’i dëshmojë se është marionetë e gjallë e tij dhe, ky, më në fund, e emëron “myfti”! E përshëndetë Salim Sulejmanin, prodhim krejt i huaj dhe, nuk e përshëndet strategun (H. Sulejman ef. Rexhepin), i cili, ja që paska pasur vizion dhe e ka emëruar Salim Sulejmanin për ta bërë të njohur Muftininë e Strugës!

A është kolegial një kontstaim i këtillë i pederaftë! Po puna kolosale e Mushteba efendi Shehut?! Puna jashtëzakonisht e madhe në profesionalizimin e këtij organi nga ana e ish-myftiut Prof. dr. Ferat efendi Polisi! Shaqir Fetain me këta dy të apostrofuar nuk e lidhë asgjë, kurse me “të dashurin” e tij e lidhë spiunimi, tradhëtia, hajnia!

Dhe, fare në fund, Shaqir Fetai dëshmon se ka nisur të matufoset! Nuk ndjehet më rehat! Nuk ndjehet më i sigurtë, madje as në ecje! Harami po i peshon mbi kokë e në shpirt! Tradhëtia që e zhvilloi kundër njeriut që më së shumti e ka respektuar, po ia ndrydhë damarët e gjakut dhe, për pasojë, po i atrifizohet truri! E përshëndet “sekretarin gjeneral” të BFI-së, Irsal Jakupin, por që “lartmadhnia” e tij ia ndryshon profesionin dhe mbiemrin në “profesor Zendeli”! Po kur na u bë profesor “Bagdatski llopov-i”!? Askush nuk reagoi kur ua ofendoi “sekretarin gjeneral”. Kush ishte ky “sekretar”, Irsal Jakupi apo profesor Irsal Zendeli! Një m...

4.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe

të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/30.07.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (6)

Pa dyshim që, sa herë që të marrë frymë Shaqir Fetai, ky instalacion i pistë i pushtetit maqedonas në krye të BFI-së, dëshmon se është një mashtrues ordiner. Të gjithë spiunët profesion të dytë e kanë mashtrimin. Të parin profesion e kanë të jenë sa më të sinqertë në spiunim tek oficerët e tyre, ndërsa të jenë sa më mashtrues te opinioni. Ndryshe, do të dekonspirohen! Së këndejmi, Shaqir Fetai mashtrimin e ka shpëtim nga zbulimi i tij se misionin e kujt e shtynë përpara

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

Vite më parë, gjatë një manifestimi të organizuar në Qafë, nga mërgimtarët e kësaj ane, ish-Reisul Ulemasë, H. Sulejman e Rexhepit, i lindë ideja për ndërtimin e një xhamie të re, pikërisht në këtë vendbanim historik, me famë, me legjenda e momente dramatike historike, por, pa njerëz! Në këtë vend, para njëqind e sa vitesh, serbët kryen një prej masakrave më barbare, kryen krim kundër njërëzimit, me ç'rast ekzekutuan dhjetra burra e fëmijë shqiptarë para grave, nënave, motrave të tyre, ndërkohë që, një trimneshë prej grupit të burrneshave të Qafës, Sulltana, me një palë gërshërë në dorë, i është hedhur ordhive serbe duke therrur kë ka kapur! Ekzekutohen të gjithë, ndërsa mbetet gjallë vetëm legjenda e Sulltanës!

Pikërisht, për këtë ngjarje historike, me qëllim që t'i bëhet karshillëk krimeve serbe dhe, t'i dëshmohet historisë se Qafa,

ashtu siç nuk pranoi të kolonizohet dhe të serbizohet me ardhacakë nga brendia e Serbisë së atëhershme mbretërore, ashtu edhe do të dëshmojë se këtu, do të ngritet një Shtëpi e Zotit, e cila do t'i ngrohë shpirtërat e të gjithë atyreve që u masakruan dhe iu nënshtruan planeve gjenocidale serbe.

Do të jetë ish-Reisul Ulema, Sulejman ef. Rexhepi, ai që do ta inicojë ndërtimin e xhamisë në Qafë, si dhe pikërisht ai do ta hedhë gurin themeltar! Gjatë kohës së ndërtimit të xhamisë, komplotistët dhe tradhëtarët do t'ia arrijnë planit antishqiptar dhe, duke shkelur parime islame, rregullore e Kushtetutë, duke shkelur edhe njerzillëk e moral, ia arrijnë ta largojnë efendi Rexhepin nga posti Reisul Ulema i BFI-së dhe, në krye të saj do të instalohet Shaqir Fetai, për të cilin sakaq do të publikohet një dokument i cili dëshmon për spiunazhin e Shaqir Fetait, që nga vitet e para të studimit në Sarajevë, me ç'rast ka pajisur udbashët me informacione për studentët shqiptar, sidomos për intelektuain e pashoq, Nexhat Ibrahimin, duke zbatuar instrukcionet dhe planet e Stanko Dragoiqit, oficerit të UDB-së.

Këto ditë Shaqir Fetai përuroi hapjen e kësaj Xhamie. Në fjalimin e tij përveç gënjeshtreve, pati edhe plotë frikë, pati eskivazhe, pati përpjekje për ta heshtur të kaluarën, pati momente kur dridhej për ta zbardhur të kaluarën e Qafës, nga ana tjetër, pati edhe nënçmim dhe plotë stil serb në ligjërim. Pa fije turpi Shaqir Fetai tha se ai qenka iniciatori për ndërtimin e kësaj xhamie! Po ai, krejt bota e dinë që, as frymë nuk merrte pa e pyetur Sulejman ef. Rexhepin!

Jo një herë Shaqir Fetai e përmendi Sulltanë, e përmendi Qafën legendare, e përmendi sakrificën e Sulltanës, e përmendi gjenocidin por, Shaqir Fetai, në asnjë moment nuk tregoi se kush i ka bërë këto krime, kush ishin ata gjenocidistët që masakruan këtë popullatë të fshatit me lartësi mbidetare mbi 1300 metra; në asnjë moment nuk guxoi ta përmendi fjalën "krim serb", "gjenocid serb", nuk foli për Qafën si sinonim të moralit dhe patriotizmit të saj përballë hordhive serbe. Në asnjë moment nuk e përmendi fjalën "serb" që lidhet me çdo gjë që ka ndodhur në këtë katund shqiptarësh.

Shaqir Fetai jo vetëm që frikësohej për ta zënë në gojë krimin dhe gjenocidin serb por, përpiqej me vetëdije të plotë që ta fshijë të kaluarën, të harrohet kjo ngjarje ku janë të inkriminuar ushtria mbretërore serbe, të mos shpalosen plagët e vjetra që do të

dëshmonin se serbët historikisht dhe në çdo vend kanë kryer gjenocid kundër shqiptarëve. Shaqir Fetai nuk guxon që ta njolloset popullin serb, sepse, pastaj vetë do të njolloset edhe me më shumë fakte spiunimi se sa në një faqe-dokument të publikuar kohë më parë. Pra, Shaqir Fetai ia mohon meritat Sulejman ef. Rexhepit për ndërtimin e kësaj xhamie, të cilën e nisi sa për t'i bërë karshillëk gjenocidit serb dhe, nga ana tjetër, përpiket që tash e tutje Qafa të mbahet në mend për “aktivitetin fetar” të Shaqir Fetait dhe jo për gjenocidin serb të ushtruar në këtë fshat malor. Historia jonë kombëtare është përplotë me emra të tradhëtarëve, kështu që, pa problem, do ta duronte edhe emrin e Shaqir Fetait!

2.

Shaqir Fetai paska marrë pjesë në një konferencë ku është debatuar rreth fetfasë në kohë digjitalizimi, respektivisht mbi temën “Institucionet e Fetvave në Epokën Digjitale”, të organizuar nga “Darul ifta” (Institucioni i Fetvave) që udhëhiqet nga Myftiu i Egjiptit Prof. Dr. Sheuki Ibrahim, nën patronazhin e Kryetarit të shtetit Abdulfetah Sisit.

Shërbimeve të veta “profesionale” si dhe disa “sektorëve”, ua paska lënë amanet që t’ia mbulojnë medialisht duke e paraqitur Shaqir Fetain si “qendër vëmendje”, mundësisht takimit t’ia japoin karakterin bilateral, edhe pse aty kanë marrur pjesë qindra delegacione nga mbi 85 vende të botës.

Këta delegacione pjesëmarrëse, paskan pasur njohuri të thella mbi Shaqir Fetain (!), aq të thella sa, sakaq unanimitisht qenkan përcaktuar ta nominojnë në takim të kryetari i Shtetit të Egjiptit. A është normal Shaqir Fetai a jo! Ia bën qejfn familjes së vet të ngushtë apo mundohet me u shpërfaq aq i madh para myslimanëve të vendit! Vetëm me vyrtyte morale matet njeriu, kurse udbashët kurrë nuk janë shquar me ndonjë veti të tillë! Veç kësaj, Shaqir Fetai paska arritur të realizojë takim me Myftiun e Kajros, edhe pse, te ai kanë qenë të gjithë pjesëmarrësit, në grup, ku ka qenë i përfshirë edhe Shaqir avdalli. Ky është protokoli i organizuesit dhe nuk është meritë, apo afinitet, apo shkathtësi e Shaqir Fetait! Kështu e parashihte protokoli i orgnizatorit dhe jo se Shaqir Fetai na ishte ndonjë “Gjorgj Bush”, apo, ndonjë “Bajden” dhe, tani, në margjina të një manifestimi, do të realizojë takime bilaterale me kryetarin e Ruisë, me kryetarin e Çeçenisë etj.

Kush mundohet që takimeve tradicionale t'u japë karakterin e takimeve bilaterale?! Vetëm një mashtrues ordiner, vetëm një person me biografi të pistë, vetëm një komplotist i tipit të Enver Hoxhës, i cili kap pushtetin, i vret të gjithë shokët dhe, meritat duhet t'i ngelin vetëm atij!

Po ç'ne në Kajro, në një konferencë ku diskutohet për fetfa, nuk merret apo nuk dërgohet kryetari i komisionit për fetfa pranë BFI-së, Jusuf Zimeri, por, merret një person i cili nuk ka lidhje as me fetfa dhe as me Kajro e as me Al Ah'zar, por, ka lidhje vetëm me spiunazhë arabe. I përputhë profesioni parësor – spiunazhi, tamam si Çimin me Stelën (dy personazhe anonimë që u bënë të njohur falë gatishmërisë së tyre për “dashni pornografik”)!

3.

Për hajër i qoftë “Ilindeni” Shaqir Fetait, ditë kjo kur në xhaminë e Shtipit, tashmë të uzurpuar nga kisha, ndizen qirinjtë për nderë të “Sveti Ilisë”! Pikërisht për këtë ditë kisha ka uzurpuar xhaminë, ndërsa Shaqir Fetai, instalacioni i pushtetit maqedonas, e madhëron këtë ditë me pjesëmarrjen edhe të delegacionit të BFI-së së uzurpuar prej tij, pas një komploti dhe puçi klasik! Të jeshë përkrahës dhe bashkëpunëtorë i Shaqir Fetait ka kosto! Kostoja është të heqësh dorë nga dinjiteti kombëtar dhe fetar dhe, t'i lëpihesh antiislamistëve dhe antishqiptarëve duke ua madhëruar festat e falsifikuara!

Këta të BDI-së, më në krye Ali Ahmetin dhe me atë që takon zyrtarisht dhe sipas protokolit të Parlamentit, mikun e ngushtë të Putinit, tashmë u bënë helaç, u bënë gaz i botës! Thonë, do të krijojmë shoqëri të përbashkët por ama diskriminimi shtetëror do të shprehet në mënyrë permanente kundër shqiptarëve dhe myslimanëve të Maqedonisë së Veriut. Këtë dikriminim tashmë e ka institucionalizuar Ali Ahmeti, ndërsa e ka shtrirë edhe mbi kurrizin e BFI-së.

Shaqir Fetai ka çu selam që, beshareta të tij të marrin pejsë bashkë me delegacionin e BDI-së në të gjitha “vendet dhe tokat e shenjta” ku do të ketë festë nga ky event kombëtar maqedonas. Dhe, ky delegacion duhet të prezantojë në emër të BFI-së dhe në emër të të gjithë myslimanëve të vendit! Është fjalë më gjithëpërfshirëse, sepse BDI-ja nuk ka pasur guxim që të thotë se po prezantojmë në emër të gjithë shqiptarëve! Shaqir Fetai a është

budalla apo i ka këmbët pa la! Si more në emër të të gjithë myslimanëve të vendit? Ai në “Meçkin Kamen” mund të prezantojë vetëm në emër të vetin, në emër të puçistëve dhe komplotistëve si dhe në shenjë falënderimi ndaj BDI-LSDM-së të cilët e instaluan në krye të BFI-së.

Shaqir Fetai, si ato femrat e përdala (si kurvat) iku nga Maqedonia e Veriut dhe në festën shtetërore maqedonase i çoi disa “të virgjëra” që edhe ato ta hanë pak b...

Nuk ka qenë hiç me rëndësi që të shkojë Shaqir Fetai në një event që nuk është i fahut të tij, në një vend gjuhën e të cilit Shaqir Fetai jo që nuk e flet por as nuk e kupton, në një event për ku ka BFI-ja plotë ekspertë, më të shkathët, më të përgatitur dhe shumë më dinjitoz se Shaqir Fetai.

Shaqir Fetai e kupton se çfarë turpërimi do të ishte për të që të jetë në “Meçkin Kamen”, ndaj, për t'i ikur këtij eventit shkon diku prej nga mund t'i rrezikohet karriera si të gjithë dështakëve dhe të pamerituarve.

Shaqir Fetai pa dyshim që u tall me zyrtarët e BDI-LSDM-së të cilët e instaluan në krye të BFI-së dhe, talljen edhe më të madhe ua bënë duke dërguar përfaqësues, njerëz që e kanë ndjerë avansimin e vet vetëm përmes hajnisë, tradhëtisë, spiunimit!

4.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/03.08.2021

Skandaloze paraqitja e Shaqir Fetait në Kajro në emër të myslimanëve të RMV-së

Shaqir Fetait nuk i shkoi në mend që në një konferencë përkatëse botërore të kërkojë një fetfa mbi rastin e vet përplotë me intriga, me puç e me komplot. Pse nuk e kërkoj? Sepse të gjithë përfaqësuesit e 85 shteteve nga bota do ta kishin pështyrë në fytyrë dhe do ta dëbonin duke e goditur shqelma b...

Nga Mevludin Haziri

Moti një herë, ishin nisur për në Turqi ish-Reisul Ulema, H. Suleman ef. Rexhepi dhe Shaqir Fetai. Kur ishin afruar te kalimi i doganës, kishte pasur kolonë të gjatë. Dalin policët turq dhe e tërheqin vetëm H. Sulejman ef. Rexhepin, meqë e kanë pasur emrin e tij si pjesëmarrës në konferencë, ndërkohë që mbrapa ngelë Shaqir Fetai. Ky, për ta arritur reisin e vet, bëhët kinse është i sëmurë dhe, duke e tërhequr këmbën zvarrë dhe duke folur “hasta, hasta”, sakaq kaloi te Reisi. Plotë buzagaz i thotë Reisit: “Haxhi rreis, nganjëherë me rrena hapen edhe dyertë e xhenetit”! Ky është Shaqir Fetai, ky, i bindur qind për qind se me rrena hapen edhe “dyert e xhenetit”! Prandaj, rrenën e ka aq për zemër, aq shumë ia do shpirti të rrejë e të “fantazojë” sa, thjesht, ndjenë se rritet pas çdo rrene!

Niset për në Kajro duke rrejtur, nga atje paraqitet duke rrejtur dhe, në fund, prezantimin para auditoriumit të gjërë e të çmueshëm e

bën përplotë rrena, duke menduar se të gjithë ata janë të një planeti tjetër dhe aspak të rëndësishëm dhe se, i rëndësishëm ngelë vetëm “rreisi” i BFI të RMV-së!

Fjalimi i tij para të pranishëmve ishte për ibret, për turp, ishte një fjalim sa qesharak aq edhe askund i përputhshëm me temën! Kurse lajmëron se, paramendoeni, prej të gjithë pjesëmarrësve ky na paska qenë i përzgjedhur për të mbajtur fjalim! A e kupton fjalën “i përzgjedhur” a jo! Çka mundohet t’i japë vetes peshë e rëndësi kur tërë bota e di se nëpër konferenca nuk ka përzgjedhje, ka vetëm paraqitje me temën, të cilën, parapraakisht e dorëzon vetëm si “abstrakt”, aq sa lejohet të lexohet nëpër të tilla evente. Fjalimi dhe paraqitja e Shaqir Fetait, pastaj edhe publikimi i fjalimit të tij, ishin përplotë censurë, përplotë rrena, amatorizëm dhe ahmakllëk! Turp të të prezantojë diku Shaqir Fetai, sepse është injorant i cili po e përjeton fazën e tretë të pubertetit me tërë takatin e vet në gojë që nuk bluan asgjë tjetër përveçse rrenave! Shaqir Fetai duhet të pajtohet me të metën e vet dhe, të kuptojë se, sa herë që e hapë gojën, ai vetëm rrenë, prandaj, duhet t’i angazhojë shërbimet e veta, t’ia përgatisin fjalimet, të dalë vetëm duke e lexuar atë të gatshmen, dhe jo të mundohet të paraqitet “intelektual”, sepse, fatkeqësisht, ai i tëri, me asht e me rrasht, është kokrra e injorantit.

Le ta përcjellim pak fjalimin e Shaqir Fetait, paralelisht, duke e dëgjuar se çka flet dhe çka shkruan në atë që është publikuar si “fjalim” i tij! E turpshme, skandaloze! Shaqir Fetai është aq shumë injorant sa, ai është i bindur se gjuhën arabe në Maqedoninë e Veriut nuk e di askush tjetër përveçse vetëm ai!

Tema boshe është fetfaja në epokën e digjitalizimit, ndërsa ky u mburret të pranishmëve se sa “i madh” që është, se si i ka 700 xhami, mbi 1000 hoxhallarë, me Medrese e me FSHI, ku çdo ditë ndahen fetfatë! A është normal se çka flet ky farë ahmakul! Aq poshtë e ulë peshën e fetfasë, saqë mendon se, çfarëdo që të flitet në xhami dhe nëpër institucione të tjera, gjithçka është fetva! Shaqir Fetai të lë përshtypjen se fare nuk e ka të qartë definicionin e fetfasë! Jo, ai e ka shumë të qartë por, në ndërdijen e tij rrjedh logjika se, fetfatë islame janë problematike, hapin debate e dilema, prandaj, të vetmet “fetfa” që vlejné janë vendimet e tij dhe të BFI-së së vet!

Shaqir Fetai është dashur para auditoriumit të gjërë, para asaj kaste prej ajkës së intelegjencies islame, të rrëfente se si u instalua

në krye të BFI-së, të tregonte fije për pe, për tradhëtinë e tij të gjatë, për momentin e komplotit, për shkeljen e të gjitha procedurave islame e neromative të BFI-së, deri në manipulimin dhe detyrimin e bashkëpunëtorëve të ish-reisul ulemasë, të pajtohen “unanimisht” (nën shantazhe të ndyta) që të vie në krye të BFI-së! Të tregojë se si këtë avancim karriere e pati të premtuar edhe nga oficerët e UDB-së të cilës i shërbeu familjarisht dhe denjësisht! Dhe, në fund, të kërkonte vendimin e kësaj ulemaje, të kërkonte t’i jepnin një fetfa, me qëllim që të ishte rehat me vetëveten!

Jo, Shaqir Fetai zgjodhi që t’ju tregojë të pranishmëve se sa “i madh” që është, edhe fizikisht edhe mendërisht!

Nisi të lexojë fjalimin e vet në gjuhën arabe. Nisi ta lexojë si një fillestar, me plotë gabime, por që nuk i vërente Shaqir Fetai, sepse ai nuk e njeh, nuk e kupton gjuhën arabe që t’i kapë gabimet e veta prej diletanti! Të pranishmit vetëm e vështronin me një nënqeshje dhe me një habi se si aq lehtë i kishte dhënë vetes të drejtën për t’u tallur me gjuhën e Kuranit, arabishten!

Që në hyrje të fjalisë, Shaqir Fetai vihet në shërbim të politikave shekullore serbe, antishqiptare e antimuslimane! E thekson sintagmën “myslimanët e mbetur” në këto anë! Çka do të thotë me këtë? Do të thotë se myslimanët ishin në ikje, meqë ishin ardhacakë dhe, “nga myslimanët e mbetur këtu”, me vigjilencë është aplikuar Medhhebi Hanefij! Sipas Shaqir Fetait dhe politikave shekullore serbe “myslimanët janë ardhacakë, të mbetur këtu”!!! Kur e bëri ky Shkollën Juridike Hanefite medhheb kur, një kohë të gjatë publikisht ka dëshmuar se ky nuk është medhheb por “sekt”!

Tutje, Shaqir Fetai i shkulë së qeshuri të pranishmit kur ua thot edhe këtë frazë përplot me idiotizma: “Fetvaja si një domosdoshmëri e Islamit daton që nga fillimi i Islamit në këto troje çdo her duke u ambientuar dhe pas parasysh nevojat dhe rrethanat e shoqërive islame në këto vise, sepse ajo është nevojë e patjetërsuar e sajë, në periudhat e ndryshme historike modus i fetvasë ka ndryshuar nga nevoja dhe rrethanat e zhvillimeve shoqërore dhe politike në këto vise.” Sipas kësaj fraze idiotike të Shaqir Fetait, fetfaja ka ndryshur varësisht nga nevojat dhe ambienti i shoqërive myslimane në Ballkan! Do me thënë se, ata që kanë dhënë fetfa, i kanë bishtëruar Kuranit, Sunnetit dhe mendimtarëve kompetente të kohës!? Fetfaja është konstatim që

bazohet në Kuran dhe në Sunetin e Pejamberit a.s., pavarësisht kohërave, rrethanave dhe, situatave!

Pastaj, “margaritar” tjetër i turpshëm i Shaqir Fetait është edhe pasusi i dytë i fjalimit të tij përplotë injorancë, e që thotë: “Nëse i referohemi historisë së re nga pavarësimi i Maqedonisë si shtet, kompetenca për të dhënë do të jetë ekskluziviteti i BFI-së që është e rregulluar me Kushtetutën e sajë duke përcaktuar mexhlisin e fetvasë të cilin e përbënin dijetarë më të mëdhenj në fushat islame dhe duke angazhuar edhe ekspert të lëmive të ndryshme në rolin e këshilltarëve.”

Në fetfatë e “BFI”-së asnjëherë nuk ka pasur nevojë për ekspertë nga fushat e ndryshme. Kjo rrenë e Shaqir Fetait dëshmon se ai kurrë nuk e ka ndjerë veten si nëpunës i BFI-së po si shërbëtorë i shërbimeve të ndryshme. Le ta tregojnë Shaqir Fetai vetëm një emër të një shkencëtari nga lëmenjtë e ndryshëm që paska marrur pjesë në dhënien e një fetfaje!

BFI-ja kurrë nuk ka dhënë fetfa, ka sjellë vendime organizative, juridike dhe ka formuar truptha të ndryshëm në format të komisioneve apo këshillave-mexhliseve! Një komision apo këshill i fundit, i formuar, është dhe ai i periudhës së fundit i ish-reisul ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepit, Këshilli për fetfa, i përbërë nga tre anëtarë “eminetë” të vendit! Deri më tani ky Këshill i ka dhënë 9 fetfa, edhe ato, kryesisht të bazuar në kapacitetin intelektual të anëtarëve të këtij këshilli! Prandaj, në mesin e myslimanëve të vendit e ke denjësisht të përhapur “na ka thënë hoxha” dhe jo, na ka thënë BFI! Lidhshmëria e xhematit me islamin ka qenë përmes hoxhës vendor dhe jo përmes institucionve fetare të cilat gjithnjë i ka përceptuar si “shtetërore”, ideologjike etj.!

Ky konstatim e përlligj edhe fjalinë pasuese të frazës së tretë të fjalimit të Shaqir Fetait, i cili, mburrjen e ndërton mbi strukturën e gënjeshtërës.

Në pasusin e katër të fjalimit të vet Shaqir Fetai e përgënjeshton vetëveten, përmes një konstatimi idiotik se, kinse, ndër ne, paskan dhënë fetfa turlifar shoqate të huaja që nuk ka qenë në të mirë të myslimanëve të atyshëm!

Intrigat e shoqatave të huaja, mendimet e mercenarëve të rrezikshëm, propozimet e manipulatorëve, sugjerimet e shpirtshiturve, në asnjë mënyrë nuk guxon të quhen “fetfa”

A ka shkencëtarë, albanolog, letrarë, kritik, mendimtarë në botën shqiptare i cili do të mund ta deshifronte këtë fjali sa idioike aq

edhe qesharake: “Zhvillimet e hovshme teknologjike na detyruan që edhe ne të lëvizim me rrjedhat bashkëkohore në çështjen e fetvasë duke ofruar mënyrën më të sofistikuar në aspektet teknologjike për të qenë në shërbim të islamit dhe myslimanëve të vendit tonë dhe ata që janë në mërgatë.”

Shaqir Fetai po na ofruaka mënyra më të sofisikuara në dhënien e fetfasë?! Çka i duhen fetfasë mënyrat e sofistikara? Vendimi që del nga burimet e veta islame nuk ka nevojë për sofistikime, e as për eskivime e dallavere që i bluan në mendje të pistë Shaqir Fetai!

Vazhdon Shaqir Fetai me idiotizmat e veta prej debilli, duke thënë: “Kam dëshirën që këtij organizimi kaq të madh dhe me vlerë shumë të rëndësishme për ne në këtë kohë të cilën e organizon dar el ifta të i dhurojë disa propozime dhe sugjerime.”(gjatë leximit në gjuhën arabe diçka e këtillë nuk thuhet! Ndoshta edhe është munduar të lexoj lidhur me këtë, por nuk merret vesh!)

Shaqir Fetai ka dëshirë që kësaj konference “t’ia dhurojë disa sugjerime e këshilla”! U bë ky! Injoranti i llojit të vet, i cili, profesionist mund të na dalë vetëm në spiunim, i jep sugjerime një prej qendrave botërore të fetfasë, siç është Kajro me Universitetin e vet më të famshëm në botën myslimane! Dhe, cila na qenka ai sugjerim dhe ajo këshillë e injorantit në fjalë? “Te organizohen konferenca të këtilla edhe më shpesh dhe me tema aktuale që të jemi në rrjedha të zhvillimeve bashkëkohore dhe të njoftuar me të arriturat e njeri tjetrit e që na i lehtëson funksionimi si një umet.”

Shaqir Fetai a ka nevojë për rrjete online apo për konferenca! Ka nevojë për një platformë të përbashkët botërore për fetfa, apo ka nevojë t’i shëtisë bythët puritane nëpër konferenca për të shitur dengla prej udbashi! Konferencat sot janë mënyra e fundi e përhapjes së informacionit! Në kohën e teknologjisë informacioni i shpejtë është i nevojshëm dhe jo konferencat! (Shaqir Fetai kur e tha këtë fjali, të gjithë pjesëmarrësit u qeshën dhe përshpëritën njëri me tjetrin si për një të sapo zbritur nga ndonjë planet! Po cili shkencëtarë apo linguist do të na e përkthente këtë fjali pasuese të Shaqir Fetait: “Të bëjmë unifikimin brenda të së mundurës në fetvatë për çështjet bashkëkohore në lëmi të ndryshme.”

Shaqir Fetai, në fund, e njollosoi edhe Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup, e minimizoi rolin dhe rëndësinë e tij, hudhi baltë e gurë, e nënçmoi deri në asgjë, duke kërkuar nga Shejhul Ez’heri ndihmë për profesionalizimin e kuadrit tonë në këtë Universitet!

Është e turpshme kjo kërkesë! Është idiotike! Shaqir Fetai vetëm sa mund t'ia kërkojë në një takim bilateral, kuotën prej dy-tre studentëve shpenzimet e të cilëve do t'i mbulonte vetë BFI-ja, deri në daljen e tyre kompetentë në fushë të caktuar, kuadër ky që në BFI llogaritet deficitar. Fetfaxhinjtë nuk mund të jetë deficitarë, sepse i paskemi me bollëk, tash e 600 vite ata na kanë shpërndarë fetfa, sipas pasusit të parë të fjalimit të Shaqir Fetait. Ndërsa fundi i fjalimit të Shaqir Fetait është plotë injorancë, pabesi, është naivitet, shkurtpamësi prej një xhahili! Zoti e udhëzoftë! Jo, ia theftë sa më shpejt qafën se na e nziu fytyrën, i poshtri! / 1KlikLarg/04.08.2021

Spiunët filimisht e vrasin frikën pastaj e luajnë rolin e avdallit

Sa herë që Shaqir Fetai do të zbërthehet si rrenc, si hipokrit, si mashtrues e manipulatorë, si udbash e si tradhëtarë, ai do ta injorojë këtë zbërthim të painjorueshëm duke dalur me ndonjë “urtësi” të tij sa për të treguar se është “intelektual i maaath(dh)” ose del në foto me ndonjë “personalitet kombëtar” sa për të treguar se është i “firmës patriotike”! A nuk është kjo karakteristikë e nëpunësve të shërbimit inteligjent (sidomos serb)

Nga Musa Aliu

Shaqir Fetai kishte marrur udhë, si një skuth, për në një event ndërkombëtar, për ç’gjë ai nuk e dinte se kështu kishte vendosur vetë Allahu Fuqiplotë që ta nxirrte në një log burrash e intelektualësh ku do ta lakuriqësonte deri në palcë dhe do ta nxirrte në pah afinitetin e tij për mashtrim, për rrena, për manipulim e matrapazllëqesh shejtanore.

Shaqir Fetai ishte e vetmja lolo e Konferencës së Kajros që e bëri për t’u qeshur Konferencën me injorancën e tij dhe me përpjekjet e djallëzuara për t’u dëshmuar si “reis” i të gjithë pjesëmarrësve në Konferencë.

Lajmet dhe informacionet që erdhën nga atje dëshmuar se Shaqir Fetai ishte personi më i urryer dhe më së shumti që ua ngjalli krupën të gjithë pjesëmarrësve. Madje pati edhe mendim për ta dëbuar nga Kongresi në çastin kur u mundua ta quajë Shtetin e Egjiptit si “shtet islamik”, por që, në moment të fundit konstatuan unanimisht që bëhet fjalë për një njeri injorant, të padalë dhe të instaluar në krye të institucionit fetar nga faktorë antiislamistë. Shaqir Fetai, si i padale, poston në fb-un e vet një diçiturë në

formë të reportazhit ku na e idealizon “Kajron shkencore me më shumë kultura”, vend të paparë dhe të pashkelur ndonjëhere nga Shaqir Fetai. Hedhë disa fjalë “letrare” sa për të krijuar përshtypjen se ai është “intelektual i maaath” dhe për ta “përmbytur” konstatimin e papërmbytshëm se ai është injorant, manipulator, tradhëtar e shumë i djallëzuar.

A ka nevojë për të tilla përpjekje djallëzore Shaqir Fetai? Natyrisht që jo, sepse në shërbimet intelektuale kërkohen njerëz “super inteligjent”, të aftë e të shkathët në spiunim. Kot nuk thirret ky shërbim “shërbimi inteligjent” dhe ai nuk mund të funksionojë me debillë e ahmakë!

Edhe në hajni duhet të jeshë “inteligjent”, edhe në rrena duhet të jeshë “filozof”, edhe në intriga duhet të jeshë “super i shkathët”, edhe në spiunim duhet të jeshë “maestro”! Pse a nuk i ka këto cilësi Shaqir Fetai, ë?

Pikërisht këto cilësi atë dhe sojin e tij në familjen e vet, e bëjnë që më shumë të jetë krenar se sa i turpëruar në sytë e fëmijëve të vet, të familjes së vet të ngushtë, të farefisit!

Pikërisht këto cilësi atë dhe sojin e tij në familjen e vet, e bëjnë që më shumë të jetë i lumtur e i gëzuar, se sa i turpëruar, i poshtëruar dhe i tmerruar nga fakti që krejt bota e di se ka qenë bashkëpunëtorë i shërbimit më antishqiptar në botë. Shaqir Fetai nuk ka “kryer” krim, ai ka spiunuar, ai nuk ka qenë kasap, por vetëm që e ka çuar prenë te kasapi!

Prandaj, edhe të parët, edhe baballëku, edhe kushërinjtë (Milaim Fetai) edhe krejt farefisi, më shumë reflektojnë lumturi se sa trishtim, sepse ndjehen shumë rehat për faktin që i kanë shërbyer dhe i shërbejnë “shërbimit inteligjent serb”. Përmes këtij “institucioni policor serb” Shaqir Fetai e mat “inteligjencën” e vet, e cila është prej brumi me tharm arrogance, injorance, hipokrizie, tradhëtie, spiunimi...

Dhe, tërë këtij tharmi, Shaqir Fetai mundohet t’i shtojë pak “mëlmesë patriotike” duke na treguar se Kajron po e shijon nën shoqërimin e Naim Tërnavës dhe nën “mrekullitë” që po ia shkaktuaka prezenca e personit (Ismet Ademi) që asgjë nuk ka të bëjë me shqiptari e me islam por që është i infiltuar i shërbimeve sekrete “arabe”! Mjer Naim Tërnavë në këtë sanduiç spiunësh. Do të ketë punë para AIK-ut, të paktën për të raportuar se në ç’valë spiunimi ishin Shaqir Fetai dhe bashkëpunëtorët e tij që shumë

kohë në Konferencë ka kaluar duke ndenjor me elementë të
dyshimtë! / 1KlikLarg/06.08.2021

Shaqir Fetait i është rrasur mendja se është ministër i Zaevit

Shaqir Fetai paska kryer një vizitë jo vetëm zyrtare por edhe vëllazërore në Ambasadën e Maqedonisë së Veriut, në Kajro! Pse zyrtare? Mos po mendon Shaqir Fetai se është ministër i punëve të jashtme, apo, ndonjë funksionar i lartë i shteteve arabe që paskësh kryer “vizitë zyrtare” në ambasadë

A ka qenë më e degraduar dhe më e tjetërsuar Bashkësia Fetare Islame se sa në këtë kohë që kur në krye të saj, pushteti aktual maqedonas, e instaloi fuksin, Shaqir Fetain!

Shaqir Fetai, duke ia ditur për nder, apo edhe për borxh, pushtetit aktual për atë që e vunë si hut në krye të BFI-së, ka nisur që BFI-në ta paraqesë si digaster të qeverisë, kurse veten, si pjesë përbërëse të kabinetit qeveritar të Zoran Zaevit. Shaqir Fetai shpesh sillet si funksionar partiak e shtetëror, meqë nuk mund ta identifikojë ndryshe veten përveçse militant partie, sepse, ndryshe, nuk e ka të sigurtë qëndrimin në BFI as edhe dy sekonda!

Ai e paska vizituar Ambasadën e Maqedonisë së Veriut në Kajro, (në fakt, e ka vizituar militantin e partisë ku aderon edhe vetë Shaqir Fetai) ku paska realizuar një vizitë “sa zyrtare aq edhe vëllazërore”! Cili faktor shtetëror apo botëror e dërgoi Shaqir Fetain për ta kryer këtë “vizitë zyrtare”?

Shaqir Fetai abuzon, është nëna e abuzimit, keqpërdor edhe besimin që ia kanë dhënë strukturat e caktuara shtetërore. Ai sillet

si padron, e keqpërdorë respektin partiak që ia shpreh ushtruesi i detyrës ambasador në Kajro, z. Xhevair Xhemaili! Nga fotot shihet se Shaqir Fetai e ka torturuar ambasadorin, e ka nënçmuar, e ka nënvleftësuar, i ka hyrë në zyre si një spiun i regjur dhe, duke ia matur zyren dhe duke ia ekzaminuar me një shikim prej spiuni, ai e përshkruan ushtruesin e detyrës ambasador, si diplomat i papërvojë, frikacak, i cili, këdo që e pranon në zyrë, i raporton hollësisht për tërë aktivitetin e vet prej diplomati!

Shaqir Fetai thotë: “U.D. Ambasadori e informoi Kryetarin e BFI hollësisht për punët që bënë, ndikimin e tij në ecurinë e punëve dhe, në të njëjtën kohë shprehu gatishmërinë e rezervë për të qenë në shërbim edhe për nevojat të BFI të RMV.”

A thua është e vërtetë kjo që ushtruesi i detyrës ambasador i ka raportuar Shaqir Fetait në hollësi për punën që e kryen?! Apo, për këtë raportim të detajuar meritë ka Shaqir Fetai i cili, si një fuks i regjur, ka arritur që t’ia nxjerrë të gjitha përgjigjet në të gjitha pyetjet që ia ka shtruar! Nëse ka ndodhur kjo – atëherë këtu merr fund diplomacia e z. Xhemaili, i cili, është dashur të dijë se, përballë ka një udbash të hershëm dhe jo ndonjë minisër përkatës të qeverisë maqedonase.

Pastaj, Shaqir Fetai ia nënçmon edhe shtetin të cilin e përfaqëson ai ushtrues detyre ambasador, sepse, duke e llogaritur veten si “shtet në shtet”, Shaqir Fetai thotë se ka marrur garanca se zotëri diplomat në fjalë, do të vihet edhe në shërbim të BFI-së, madje, “për të qenë pa rezervë në shërbim edhe për nevojat e BFI-së”! Nevojat e BFI-së në atë ambasadë mund të shprehen vetëm përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut, sepse, z. Xhevair Xhemaili në Egjipt dhe në “tërë Afrikën” përfaqëson shtetin e Maqedonisë së Veriut dhe nuk është aty që të jetë në shërbim të Shaqir Fetait, person ky kontravers e më i përfaqësuar me shërbimet e UDB-së se sa me pushtetin maqedonas apo edhe me partitë shqiptare në pushtet!

Shaqir Fetai na informon se, “gjatë takimit u bisedua edhe për punë tjera që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e ndërsjella, në veçanti për nevojat eventuale të studentëve nga Maqedonia e Veriut, që me kënaqësi ambasadori pranoi të jetë në shërbim të tyre”.

Shaqir Fetai edhe me këtë rast dëshmon se është idiot i llojit të veçantë, specie më vete, e lindur dhe rritur që ta dëmtojë çdo interes që i përket kombit dhe fesë! Me këtë informim, Shaqir Fetai,

në fakt vetëm sa i bën dëm dhe ia mbyllë karrierën një ambasadori shqiptar! Po si qenka pajtuar ambasadori i një shteti që të ketë marëdhënie të ndërsjellë me një institucion të shtetit të vet?! Shaqir Fetai ia ka futur kot, me të vetmin qëllim që t'i bëjë dëm personit i cili, në atë ambasadë, veç të tjerash, është edhe për t'i mbrojtur interesat, për t'i përfaqësuar qytetarët e vet dhe për të qenë në shërbim të qytetarëve të vet, pra, edhe të studentëve shqiptarë, fare pa ia premtuar këtë Shaqir Fetait! Fare në fund, nëse ky informacion është i vërtetë, atëherë duhet të konstatohet:

1. Shaqir Fetai mendon se personalisht është përfaqësues i një shteti, ndërsa institucioni që e ka uzurpuar është digaster i rëndësishëm qeveritar;
2. Shaqir Fetai e ka në gjak që t'i dëmtojë shqiptarët, së këndejmi, edhe këtë vizitë duhet interpretuar si përpjekje e tij prej spiuni për ta "ngulur" njeriun i cili ka mall për ta takuar një shqiptar, çfarëdo qoftë ai, dhe;
3. Shaqir Fetai dëshiron që t'i dëshmojë botës (sidomos "botës serbe") se, të gjithë institucionet e vendit janë të të njëjtit nivel siç është Shaqir Fetai, dudukë e ahmakë, i njëjti brum prej nga është gatuar edhe ky vetë! /Lajme7/06.08.2021

Shaqir Fetai si proces i mykut, kalbjes, prishjes

Të gjithë ata që bashkëunojnë me spiunin, ndonëse nuk do ta gëzojnë epitetin spiun, ata megjithatë, ngelin bashkëpunëtorë të spiunit. Dhe, kur ky bashkëpunim ushtrohet me vullnet dhe me vetëdije të plotë, atëherë, piqen të gjitha kushtet për t'u quajtur “ushtarë të djallit”! Mallkim i madh do të rëndojë mbi ta

Nga Valbon Osmani

Trembëdhjetë myftilerë, me operativët e tyre, madje edhe operativa dhe anëtarët e tjerë të Rijasetit, që të gjithë, zhvilluan dhe realizuan një prej tradhëtive dhe kompleteve të paregjistruar ndonjëherë në historikun e Bashkësisë Fetare Islame, komplot ky që do të ngelë vulë në fund të faqes së turpit të tyre.

“Myftiu” i Myftinisë së Shkupit – Qenan Ismaili,
“Myftiu” i Myftinisë së Tetovës – Qani Nesimi,
“Myftiu” i Muftinisë së Gostivarit – Shaqir Fetai,
“Myftiu” i Myftinisë së Kumanovës – Abedin Imeri,
“Myftiu” i Myftinisë së Dibrës – Reshat Kaçallniku,
“Myftiu” i Myftinisë së Kërçovës – Murat Hyseini,
“Myftiu” i Myftinisë së Strugës – Salim Sulejmani,
“Myftiu” i myftinisë së Ohrit – Samet Ajdari,
“Myftiu” i Myftinisë së Resnjës – Xhunejd Jashar,
“Myftiu” i Myftinisë së Manastirit – Amit Rasimoski,
“Myftiu” i Myftinisë së Shtipit – Nasir Rexhepi

“Myftiu” i Myftinisë së Velesit – Nejaz Murati,
“Myftiu” i Myftinisë së Prilepit – Shefket Imeri.

Pastaj, të ashtuquajturit “drejtorë të sektorëve”, nëpunës të ndryshëm, drejtorë të institucioneve të BFI-së, si:

– Ibrahim Idrizi,

– Shaban Sulejmani,

– Isral Jakupi,

– Qufli Osmani,

– Jusuf Zimeri,

– Rexhep Ziberi,

– Mustafa Dauti,

– Muhamer Veseli,

– Driton Dikena,

– Agron Vojnika,

– Selver Xhemaili,

– Ismet Ademi,

– Shaban Rahmani, si dhe disa anonimë të tjerë – të gjithë këta individë, me emra e mbiemra – të gjithë këta që luteshin madje të shërbejnë edhe si shuall të këpucëve të ish-reisit të tyre, H. Sulejman Rexhepi; të gjithë këta kanë kontribuar në zhvillimin e tradhëtisë dhe të komplotit të finalizuar më 27 maj të vitit 2020, duke ia ngulur thikën pas shpine ish-reisul ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepit dhe, duke u bërë gati për t’u futur verbërisht në vallen mortore që do ta drejtojë në ekzekutim Shaqir Fetai, i përzgjedhuri i strukturave të caktuara të pushtetit maqedonas për t’u instaluar, si udbash me tapi, në krye të BFI-së!

Të gjithë këta, ëndërr jetike e kishin që të dalin në fotografi me reisin e tyre, H. Sulejman ef. Rexhepin dhe, për një kënaqësi të tillë të papërshtueshme ishin në gjendje të presin edhe me orë të tëra, vetëm të sigurojnë një foto. Sot, të mjerët, ngaqë vuajnë nga ndërgjegja e tyre e papastër, i kanë fshirë të gjitha ato foto me H. Sulejman Rexhepin dhe, detyrohen që të manipuohen nga Shaqir Fetai dhe me të të kenë ndonjë fotografi të dhunshme!

Te gjithë këta, verbërisht pranuan që t'i shërbejnë djallit dhe të jenë protagonist të një tradhëtie dhe komploti të turpshëm! Të gjithë këta, dikush me detyrë, dikush të manipuluar, dikush të shantazhuar, e tradhëtuan njeriun, sepse kështu u erdhi urdhëri nga "Iart", nga dushmanët e shqiptarisë dhe të fesë islame. Meqë e hëngrën turpin me bukë, vendosën që deri në fund të jenë lojalistë ndaj asaj "dore" që po i përkundte në djepin e turpit, duke u premtuar rritje dhe zhvillim çfarë nuk e kishin imagjinuar ata! Të supozojmë se askush nuk e kishte ditur se në shërbim të kujt po viheshin pasi ia nguln thikën me tradhëti e me komplot H. Sulejman ef. Rexhepit! Vetëm një Myfti, i ndjeri Murat ef. Hyseini, e kishte ditur fare mirë se cila lojë po luhet dhe për pjesëmarrjen e tij në atë lojë ishte penduar me shpirt. Ai disa ditë para vdekjes kishte pranuar që të ulet dhe të pranojë, (madje të incizohet) duke e rrëfyer tërë skenarin: si erdhi deri te tubimi, kush i tuboi, nga kush erdhi urdhëri, pas kujt ishin urdhëruar që të rreshtoheshin etj. etj.

Të gjithë u rreshtuan pas Shaqir Fetait, sepse, e kishin urdhër, e kishin shantazhë, e kishin kërcënim – kush nuk do ta përkrahë Shaqir Fetain do të "lakuriqësohet"! Po pse Shaqir Fetain? Kush po e shtynte këtë hipokrit, kush kishte vendosur që ta instalojë në krye të BFI-së këtë injorant? Shërbimet sekrete kishin caktuar njeriun e vet pas të cilit të gjithë shpiunçët duhej të rreshtoheshin. "Patriotët" duhej të rreshtoheshin pas "kuadrit partiak"!

Pra, "kuadri partiak" i cili kishte futur kokën në parti sa për t'i lyer flokët me ngjyra të patriotizmit, ndonëse dikur kishte qenë udbash me asht e me rrasht, duke hapëruar gjurmëve të të parëve të vet si dhe të pjesëtarëve të familjes së vet, tani e tutje do të jetë "reis" i myslimanëve të Maqedonisë së Veriut!

Nuk vonoi shumë dhe në sipërfaqe dolën të gjitha mutnat e tij: hipokrit i pashoq, tradhëtar profesionist, komplotist i përkryer, injorant deri në veshë, manipulator-mjeshtër, matrapaz unikal,

avdall sa ta duash, ahmak deri në kupë të qiellit, spiun i regjur dhe madje edhe me tapi, i dokumentuar si bashkëpunëtor i UDB-së, nën pseudonimin ORAO, argat i oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviqit!

Të gjitha këto cilësi të Shaqir Fetait tashmë i njohin dhe i dinë të gjithë bashkëpunëtorët e tij të apostrofuuar më sipër! Pra, ata tashmë po e ndihmojnë spiunin, udbashin dhe jo “reisin”! Ata u luajtën dhe u tallën nga spiuni, Shaqir Fetai, të cilit, edhe më tej po i shërbejnë! Ata që i shërbejnë spiunit, ndonëse nuk mund të akuzohen si spiunë, megjithatë, nuk do t’i shpëtojnë epitetit “bashkëpunëtorë të spiunit”! Të jeshë bashkëpunëtor i spiunit do të thotë se janë pjekur të gjitha kushtet për të qenë “ushtar i djallit”! E tërë logjistika e kësaj “ushtrie” (hoxhallarët, teologët, profesorët, nxënësit, studentët) pa dyshim që do të jenë nën sqetullat e djallit!

Mbase edhe mund të falen dhe të amnistohen deri në momentin që nuk e kanë ditur, por ama, prej momentit që tashmë kjo dihet edhe zyrtarisht, nuk ka amnistim! Ka vetëm konstatim se, një strukturë e tërë, me vetëdije të plotë, me vullnet vetëmohues, pranojnë që të jenë në shërbim të djallit-spiunit të instaluar në krye të BFI-së nga struktura të caktuara politiko-shtetërore maqedonase, me të vetmin qëllim për ta etiketuar, për ta dëmtuar dhe për ta shkatërruar të vetmin Institucion fetar islam në vend – BASHKËSINË FETARE ISLAME në RMV!

Kujdes, keni të bëni punë me një hajn të përkryer, me një të poshtër që nuk i bëhet vonë nesër t’ju flijojë një nga një! Prishunia e tij le të zbërthehet edhe në variantin “më pak” të dhimbshëm: dihen se cilat kanë qenë aksionet financiare dhe të hyrat e Myftinisë së Gostivarit deri sa aty myfti ishte Shaqir Fetai! Ekzistojnë të arkivuar shifrat e të hyrave! As për së afërmi nuk mund të paraqiten si këto të sivjemë! Çka flet kjo, nëse jo për sabotimin e BFI-së nga ana e Shaqir Fetait! Çka flet kjo nëse jo për fshehjen e derdhjeve financiare që janë bërë në këtë Myftini e që kanë përfunduar në xhepat e Shaqir Fetait! Shaqir Fetai sa ka qenë Myfti e ka vjedhur BFI-në, i ka vjedhur gostivarasit, nuk i ka paraqitur financat e sakta në arkën qendrore. Për herë të parë, Gostivari i tejkalon të gjitha Myftinitë! Çka flet kjo? Cila është porosia e kësaj hajnie të Shaqir Fetait! Tashmë secila Myftini ka të drejtë që mos t’i derdhë të hyrat në kacën qendrore, por, t’i vjedhë ato, apo edhe t’i fshehë, meqë nuk është në krye të BFI-së!

Fundi i Shaqir Fetait do të jetë i trishtueshëm. Hiç më i mirë nuk do të jetë fundi edhe i bashkëpunëtorëve të tij të sotëm, të cilët, për një “pagë” pranojnë të kundrohen edhe si bashkëpunëtorë të udbashit. Avash-avash do të trashet spiunimi, ndërsa do të hiqet paga. Po si të hiqet etiketa “vegla të KGB-së”, meqë dora e Putinit tashmë ka prekur edhe supet e Shaqir Fetait!
Mos thuani se nuk ua kemi thënë!/ 1KlikLarg/08.08.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (7)

Çka mund të flasë një shpirtprishur, një tradhëtar, një udbash (udbashi si sinonim i shërbimeve të huaja antikombëtare e antifetare)? E folura e tij varet nga “respekti” që do t’ia bëjnë ata që e rrethojnë. Nëse bie “respekti”, shpirtprishuri do të flasë për gjëra “madhore kombëtare e fetare”, me qëllim të përfitimit të respektit sa më të madh. Nëse respekti është në nivel, atëherë motivi për tradhëti e spiunim është edhe më i madh

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

Shaqir Fetain e ka marrur shumë malli që të jetë në shërbim të reisul ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepin, e vun mungesën e tij. Shaqir Fetai ka nostalgji të tmerrshme për H. Sulejman ef. Rexhepin dhe për kohën e tij. Shaqir Fetai dshmoi se është sulo-nostalgjik!

Ditë më parë, Shaqir Fetai kishte organizuar një “kafe-event” kushtuar Hixhrit. Asgjë nuk kishte lëvizur nga ajo siç e ka konceptuar H. Sulejman ef. Rexhepi tash e decenie më parë. Program identik! Me këtë Shaqir Fetai nuk dëshmoi vetëm injorancën e tij, mungesën e ideve dhe të vizioneve, por, mbi të gjitha, e dëshmoi nostalgjinë shumë transparente për kohën e “babait të vet shpirtëror”! Me këtë program, në fakt, Shaqir Fetai sikur kishte dashur t’i kërkojë falje për tradhëtin dhe komplotin që ia bëri Sulejman ef. Rexhepit. Ja, i tha, asgjë nuk kam ndryshuar

nga koncepti programor të cilin e ke ngritur ti tash e decenie më parë!

Megjithatë, Shaqir Fetai sërish e tradhëtoi Sulejman ef. Rexhepin, madje edhe në këtë event, duke e organizuar atë, jo nëpër salla përkatëse koncentrale, por, mu në mes të oborrit të xhamisë! Vlerësimin të xhamive se dikur këto objekte kanë luajtur edhe rolin e shkollës, të parlamentit, të qeverisë, të kuvendit të burrave, Shaqir Fetai ia shtoi edhe vlerësimin se, tash e tutje, xhamitë mund të jenë edhe salla për koncerte, për rok-koncerte, mund të shërbejnë edhe si salla sportive, si ring boksi, mund të luhet brenda edhe baleti, basketboll, mund të shërbejnë edhe si objekte ku mund të organizojmë dasma, oborret e xhamive, në këtë kohë pandemie, mund të shërbejnë si hapësia të hapura për dasma e evente të ndryshme gëzimi që mund të përcillen me curla e tupane, me harmonika e gitare, me violina e mandolina, me defa e klarinete! Mjafton ta keni myftiun e xhamisë curlaxhi e tupanxhi të patejkalueshëm e merakli!

Shaqir Fetai, ky mik i bashkëuntorit të ngushtë të Putinit, ky injorant i cili Mes'hebin Hanefi e trajton si "sekt", ky farë matrapazi dhe manipulanti i pashoq, ky farë regjistruesi i shumë bashkësive sektariane, i grupeve religjioze dhe i "bashkësive fetare islame" të reja, ky farë degraduesi i epitetit MYFTI, duke emëruar tulfarë ahmaku e bilmezi për "myfti" – pra, ky farë instalacioni i pushtetit maqedonas, po dëshmon se është adhurues i flaktë i bidateve! Të fusësh grupe instrumentistësh në oborr të xhamisë, të mbash koncert, qoftë ky edhe fetar, i përcjellë me turlifarë instrumenti – a nuk është ky bidat i rëndë! Këtë bidat e provoi Shaqir Fetai, ndërsa nuk pati kurrfarë reagimi nga asnjë "hoxhë kritik", nga asnjë "kujdestar" i gabimeve të paqëllimta të teologëve, nuk pati asnjë fetfa nga "fetfaxhinjtë", madje një prej "fetfaxhinjëve" karikaturë, pranoi që në një atmosferë të tillë përplotë bidate edhe të dekorohet me dekoratën e inicuar nga H. Sulejman ef. Rexhepi, e që mbanë titullin "Myfti Vehbi Dibra"! Madhërohet emri gjigant i Myftiut Vehbi Dibra, nën duartrokitjen e "myftilerëve" totalisht injorantë, si ai i Shkupit, i Kumanovës, i Prilepit, Shtipit, i Velesit, i Resnjës, i Strugës, i Ohrit, i Manastirit etj! Këta "myftilerë" bashkëkohorë dhe Vehbi Dibra Myfti, që ka jetuar dhe vepruar në kohëra totalisht të egra për kombin dhe fenë tonë?! Shaqir Fetai e ka marak të tallet me personalitete dhe figura kombëtare e fetare, sepse vetë është i talluri i përjetshëm, lolo, palaço, pis kalama!

Pastaj “u ftua Kori i Bashkësisë Fetare Islame, nën udhëheqjen profesionale të Mr. Eljasa Asani”!!! A e di Shaqir Fetai se çka do të thotë “Kor institucional”? Si duket ai kor, si themelohet, si duhet të funksionojë? “Nën udhëheqjen profesionale”? Pse tallet Shaqir Fetai me aktivitetin profesional? Ku mund të jetë profesionist Eljasa Asani! Shaqir Fetai edhe për veten e vet mendon se është “hoxhë profesional”!

Vazhdon cirkusiada e Shaqir Fetait, vazhdon amatorizmi i tij prej diletanti që mundohet të na i paketojë si “gjëra profesionale”! “Në binë u ftua edhe themeluesi i korit të BFI, i cili ndër vite e ka udhëhequr Korin e BFI, ndërsa autoriteti dhe figura e tij janë shumë të njohur edhe në vend por edhe jashtë – Dr. Abas Jahja”! Mos rrej o i pafytyrë! BFI-ja nuk ka dhe nuk mund të ketë kor të vetin, sepse, si e para nuk di se çka është kori, çka do të thotë kori dhe, cilës fe i takon kori! BFI-ja mund të ketë grup profesionistësh të këndimit të ilahive, asherve, grup recitatorësh profesionistë. Abas Jahja na qenka figurë e njohër brenda e jashtë? Cila është kjo figurë? Cilat janë veprat e kësaj figure që e bëjnë aq të njohur brenda e jashtë? Opinioni brenda e neh si “këngëtarë” të cilit dikur ia kishte shumë ënda që në evente fetare t’i këndojë personalisht Sulejman ef. Rexhepit (sidomos “Put putuje Sulejman aga” etj.) Për këto këndime mund të shuqet si “figurë e njohur” brenda, ndërsa jashtë nuk ia çok askush, sepse nuk ka ndonjë kualitet aman-aman! Prandaj, pa rrena Shaqir Fetai!

Për fund, Shaqir Fetai nuk e lë edhe një herë pa e shprehur tërthorazi brengën dhe nostalgjinë për politikën serbe si pasojë e të cilave dikur paskan migruar mijëra e miliona popujt në rajon! Shaqir Fetai thotë: “Në trojet ku jetojmë dhe veprojmë porositë e hixhretit janë gjithë më aktuale kur dihet se decenieve të fundit nën ndikim e elaboreve të huaja dhe famëkeqe, si dhe nën ndikim e kushteve të vështira ekonomike, qindra mijë, mos të themi miliona njerëz të popujve të këtyre trevave u larguan nga vatani i tyre duke iu nënshtruar asimilimit të paparë fetar e kombëtar.”

Cilat ishin ato elabore të huaja? Pse Shaqir Fetai nuk i sulmon elaboretet serbe, sepse këtu nuk ka pasur “elabore të huaja” por ka pasur elabore serbe! Pse nuk i emërton këto elabore Shaqir Fetai! Natyrisht që nuk guxon nga UDB-ja ku aderon edhe sot e kësaj dite! Natyrisht që nuk guxon të thotë se këto elabore vranë, maskaruan dhe dëbuan me mijëra e miliona shqiptarë nga këto

troje ku jetojmë"! Shkak për ikje si shpëtim nga këta elaborete serbe, shkak për dëbim të shiptarëve nga politikat që vijnë si rrjedhojë e këtyre elaboreteve janë edhe soji i Shaqir Fetait! Asnjë elaboret serb nuk do të ishte i suksesshëm pa marioneta në serrat të Shaqir Fetait!

Pak politik partiake i duhet Shaqir Fetait, në prag të fushatës parazgjedhore. Shaqir Fetai kthimin e pronave (Kapan Han, Bezisten) e koncepton Hixhret! A ka gjë më të turpshme, më të fëlliqtë, më antiislame se sa ky konstatim i Shaqir Fetait! Hixhret i madh qenka edhe kontributi që po e jepkëka BFI-ja për tejkalimin dhe zbehjen e Koronavirusit Kovid 19! Këtë konstatim mund ta shqiptojë vetëm një pis, një matrapaz, një rrencak, një rimorkio e kalbur që tërhiqet nga një kabinë-kamion që është në grahmën e vet të fundit. Të tilla vlerësime mund të japë vetëm koka e kalbur, truri i pistë i një personi që nuk i ha palla për asgjë tjetër përveçse për vete! E vetë Shaqir Fetai, tashmë po dëshmon se është kokë e këmbë kundër fesë dhe institucionve fetare islame në vend, ndërsa sa i përket çështjes kombëtare, tashmë është e provuar se ai me shpirt ka qenë, është dhe do të jetë kundër! Në kohën kur u themelua çmimi "Myfti Vehbi Dibra", ishin paraparë edhe kriteret se kujt mund t'i jepet ky çmim mjaft prestigjioz! I jepet vetëm atij personaliteti i cili me veprimtarinë e vet jetësore ka lënë gjurmë në shoqërinë tonë; i jepet vetëm atij personi i cili në mënyrë permanente ka dhënë kontribute vetëmohuese për të mirën tonë të përgjithshme dhe, nuk i jepet një personi i cili paska shkruar vazhdimisht editoriale në "Hëna e Re", apo që paska arkivuar dokumente në fletoren e BFI-së, sepse, fundja, për këtë punë ai ka marrur rrogë (Qufli Osmani); nuk i jepet një personi që paskësh dhënë kontribut për ngritjen e një xhamie (për këtë jepet mirënjohje), sepse, jeta është e gjatë dhe mund të pasojë ndonjë veprim që i humb të gjitha sevapet! Meqë jemi te ky çmim, le të tregojë Shaqir Fetai se kur është më i sinqertë: atëherë kur e luftonte pa kompromis, duke e etiketuar si përçarës e tradhëtarë, si spiun e komplotist, hoxhën e nderua Neshat Xheladinin, apo sot, kur e vlerëson si hoxhë me pedigree të padiskutueshëm! Le ta gjejë një më meritore në Maqedoninë e Veriut, në rajon e Ballkan, më meritore për institucionalizimin e jetës fetare islame në RMV, për kthimin e pronave, për ngritjen e qindra xhamive, për meremetimin e të gjitha objekteve fetare të trashëgimisë kulturore, për sensibilizimin e opinionit botëror për

çështjet tona kombëtare e fetare, për avansimin e jetës fetare islame si dhe për autoritetin dhe integritetin e BFI-së, se sa Sulejman ef. Rexhepi, i cili, me gjasë, mëkatin më të madh e ka se pse na e “shiti” bajgën për lule – Shaqir Fetain për vlerë!

2.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/11.08.2021

Edhe një përpjekje prej skuthi e dështuar e Shaqir Fetait

Sekretari Gjeneral, dr. Mohamad bin Abdul Karim Al-Isa, në Maqedoninë e Veriut gjendet për t'i prezantuar politikat e kësaj Organizate botërore, angazhimet e saj si dhe përpjekjet e botës myslimane, të cilat konsistojnë në luftë kundër ekstremizmit dhe terrorizmit, bashkëjetesë dhe tolerancë fetare si dhe paqe anekënd botës! Dhe, për këto vlera njerëzore pa dyshim që duhet të diskutohet me organet më të larta dhe më kompetente shtetërore, kurse Bashkësia Fetare Islame vizitohet sa për të mos e anashkluar një organizatë myslimane në shtetin të cilin e viziton ekselencia e tij

Nga Mevlan Nallbani

Dy tre vite më parë, përgjatë dy takimeve me Sekretarin gjeneral të Ligës Botërore Myslimane – Rabita, dr. Mohamad bin Abdul Karim Al-Isa, ish-Reisul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, në të dy rastet, i kishte bërë ftesë ekselencës së tij, që të vijë dhe t'i vizitojë myslimanët e Maqedonisë së Veriut. Në takimin e fundit, z. Al Isa i kishte premtuar efendi Rexhepit se tashmë e ka futur në axhendën e vet edhe vizitën që do t'ia bëjë në një të ardhme të afërt Maqedonisë së Veriut. Kështu që, meritat i përkasin H. Sulejman ef. Rexhepit, edhe pse, i instaluari në krye të BFI-së, mynafiku dhe hipokriti, Shaqir Fetai, kërcen si zorra në prush duk u përpjekur

që ta bindë “botën” se mysafiri i lartë arab vjen këtu me ftesë të Shaqir Fetait në bashkëpunim me kabinetin e Kryetarit të Shtetit!

Shaqir Fetai dëshiron të përfitojë në mënyrë shumë naive ndonjë pikë nga kjo vizitë! Dëshiron të prezantohet:

– si shumë kooperativ me organet e shtetit (të atij shteti që akoma nuk e ka thënë asnjë fjalë për urrejtjen ortodokse kundër islamit në Maqedoninë e Veriut – uzurpimi i xhamve, i sahat kullave, përdhunimi i tyre me kryqe gjigante, djegia e xhamisë dhe moslejimi për ta rindërtuar, regjistrim të bashkësive paralele fetare islame, regjistrim dhe legalizim të radikalizmit fetar në emër të islamit etj.)

– si digaster i institucioneve shtetërore,

– si marionetë e politikave shtetërore të një shteti afetar,

Shaqir Fetai paraqitet tamam si ato plakat axhuze, të cilave nuk u intereson e djeshmja, duke thënë “askush s’te pyet si ke qenë por, si je”! Bën prezantimin e një Institucioni me organe të qenme e të paqenme, duke e rrejtur mysafirin e lartë, ndërsa të gjithë këto suksese gjigante i paraqet si të tij, të arritura për këtë vit sa gjendet i instaluar nga politikat antiislame në krye të BFI-së! Kush e bëri BFI-në me të gjitha ato të arritura e suksese që i numëron Shaqir Fetai pa asnjë fije skuqje në fytyrë?!

Pse rrenë Shaqir Fetai se Sekretari gjeneral i Ligës botërore myslimane e paska vizituar “reisul ulemanë”! “Reisul ulemanë” mund ta vizitojë në shtëpinë e tij, në Çegran, kurse në Çairska 52 çdo mysafir viziton BASHKËSINË FETARE ISLAME ku pritet me të gjitha nderimet dhe respektet nga anëtarët e Rijasetit të prirur nga reisul ulema!

Sekretari Gjeneral, dr. Mohamad bin Abdul Karim Al-Isa, në Maqedoninë e Veriut gjendet për t’i prezantuar politikat e kësaj Organizate botërore, angazhimet e saj si dhe përpjekjet e botës myslimane, të cilat konsistojnë në luftë kundër ekstremizmit dhe terrorizmit, bashkëjetesë dhe tolerancë fetare si dhe paqe anekënd botës! Dhe, për këto vlera njerëzore pa dyshim që duhet të diskutohet me organet më të larta dhe më kompetente shtetërore, kurse Bashkësia Fetare Islame vizitohet sa për të mos e anashkluar një organizatë myslimane në shtetin të cilin e viziton ekselencia e tij.

Shaqir Fetai aq shumë është dehur nga kjo vizitë e papritshme sa, u mbyt duke rrejtur e duke e prezantuar gabimisht e rrejshëm

mysafirin e larët nga Rabita! Ai nuk është “sekretar gjeneral i Botës islame”, porse, është “sekretar gjeneral i Ligës botërore myslimane”! Në atë organizatë aderojnë rreth 80-90 shtete, prej të cilëve a janë dy shtete islame a nuk janë! Shaqir Fetai qëllimisht tallet me mysafirin, sa për t’ia ironizuar organizatën prej nga vjen!

Sikur ta dinte mysafiri i lartë se ka ardhur në një shtet i cili, një vit më parë, kreu një puç klasik dhe një komplot të përkryer në rrënimin e BFI-së, duke e instaluar dhe duke e institucionalizuar shkeljet e Kushtetutës së BFI-së, ai nuk do të pranonte që të njolloset vetë si dhe Organizatë që e përfaqëson;

sikur ta dinte se ka ardhur në një shtet ku, partitë qeveritar (LSDM-BDI) kanë instaluar një udbash në krye të BFI-së me qëllim të degradimit të këtij Institucioni me traditë të paprekshme islame gjashtëshekullore – ai kurrë nuk do të vinte në këtë shtet;

sikur ta dite mysafiri i lartë nga RABITA se do të pritët nga një bashkëpunëtorë i UDB-së – shërbim sekret ky që ka pirë gjak me pambuk mbi trupat e myslimanëve të këtij nënqielli dhe më gjërë – vështirë se do të pranonte të takohej me Shaqir Fetain;

sikur mysafiri i lartë, dr. Mohamad bin Abdul Karim Al-Isa, ta dinte se do të hynte në një “seli” ku vlon korrupsioni, kurvëria, bixhozi, dallaveret, hajnia, matrapazllëqet, pislëqet, idiotizmat, analfabetizmi, ku do të pritët nga figura të dyshimta, nga “myftinjë” injorantë e diletantë, me diploma e tituj të blerë – për asnjë çmim nuk do të pranonte të vijë në këtë shtet!

Ai erdhi për t’u marrur vesh me këtë shtet rreth disa politikave globale për sa i përket synimeve të botës demokratike në ruajtjen e paqes dhe mirëqenies anekënd botës, kurse shteti ia la qëllimisht Shaqir Fetait, sa për ta bindur opinionin e brendshëm se, ja, nuk ka rëndësi nëse do të jeni shpiunë e bashkëpunëtorë të shërbimeve ku ju rekruton shteti, sepse shteti kujdeset që mos të ngelni pa “u respektuar” e pa “u nderuar”, pa “u përkrahur” e pa “u vizituar” nga isntanca më të larta botërore!

Shaqir Fetai u bë palë e kësaj politike që e nënçmon ekselencën e tij, dr. Mohamad bin Abdul Karim Al-Isa!

Allahu Fuqplotë thotë: “. Nuk është kështu si thoni ju! Ata që bëjnë vepra të këqija dhe mbulohen nga fajet e veta, do të jenë banorë të Zjarrit (të Xhehenemit), ku do të qëndrojnë përgjithmonë” (el Bekare, 81)/1KlikLarg/13.08.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (8)

E, çka mund të flasë Shaqir Fetai, i cili, sa herë që hap gojën dëshmon për injorancën e vet të skajshme, dëshmon për hipokrizinë e vet unikalë, dëshmon për afinitetet e veta prej loloje për t'iu lëpirë pushtetit si dhe për t'ia fërkuar vezët “partisë nënë”, e cila, e instaloi në “pushtet” që si profesionist t'ia mbajë iso-n në tradhëti, në korrupsion, në tallje me vlerat kombëtare e fetare! Shaqir Fetai nuk flet vetëm me gojë, ai flet edhe me trup, çdo lëvizje e tij trupore dëshmon sinergji kah ngjyrat e ylbërta

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

Shaqir Fetai tashmë ka dëshmuar dhjetra herë se, përjeton kënaqësi të veçantë në tallje me personalitetet e ndryshëm! Ai jeton për ta përjetuar një gram superioritet kundër çdo kujt! Është konstatuar për Shaqir Fetain se ky, vuan, përfundimisht, nga “Kompleksi i Napoleonit” – mickonja të ndjehet elefant! Nisur nga kjo cilësi e poshtër e Shaqir Fetait, e kemi edhe këtë titull “Reisul Ulemaja dhe Sekretari Gjeneral i RABITA-s u pritën nga Presidenti Pendarovski”! Këtë pritje dhe atë shtrim të drekës nuk e ka organizuar Pendarovski për hirë të Shaqir Fetait por, për nderë të Sekretarin Gjeneral të Ligës Botërore Islame (!!!), Dr. Muhammed

Abdulkerim El-Isa, të cilin, sipas Shaqir Fetait, e ka ftuar për vizitë zyrtare!

Lajmi është se Sekretari Gjeneral i Rabita-s u prit nga Presidenti i Shtetit të Maqedonisë së Veriut, (sepse presidenti Pendarovski mund të jetë edhe president i ndonjë korporate, i ndonjë bordi, i ndonjë organizate etj.) Pra, në këtë pritje zyrtare, mysafiri i lartë arab u shoqërua nga Shaqir Fetai (në rolin e fuksit, jo të përkthyesit, sepse nuk e di arabishten, as të nikoqirit, sepse nikoqir del të jetë Presidenti Pendarovski).

Shaqir Fetai bën mirë që të mos tallet me titullin e organizatës së cilës i prinë Dr. Muhammed Abdulkerim El-Isa. Ai nuk është Sekretar Gjeneral i Botës Islame por, ai është SEKRETAR GJENERAL I LIGËS BOTËRORE MYSLIMANE! Madje, mësohet nga burime të sigurta (kjo vërtetohet edhe nga njerëz brenda BFI-së) se, nga Organizata e RABITA-s tashmë kanë nisur reagim interne deri te BFI-ja, konkretisht, deri te “reisi”, i cili lutet që të ketë kujdes dhe mos t’ia deformat titullin Organizatës të cilën në Maqedoninë e Veriut për momentin është duke e përfaqësuar Dr. Muhammed Abdulkerim El-Isa! Organizata me renome botërore nuk është ndonjë “picimul” që mund t’i hajë kikirikat e papjekura të Shaqir Fetait, por, është organizatë që i del zot titullit të vet sipas të gjitha akteve normative mbi të cilat funksionon ajo! Rabita nuk është BFI e Shaqir Fetait ku ushtrohet tallja mbi kushtetutën, mbi rregulloret, mbi dinjitetin, mbi integritetin dhe me gjithçka që e degradon Institucionin e BFI-ë deri në hamam-servis partiak!

2.

Shaqir Fetai paska marrur pjesë në “PËRTEJ OHRIT”! A e di Shaqir Fetai se përtej Ohrit mund të ketë ose Tushemisht ose Strugë, mund të ketë edhe Pogradec dhe Prenjas! Nuk ka asgjë tjetër, ndërsa, “Përtej Marrëveshjes së Ohrit” ka vetëm tradhëti, krime, vjedhje, tallje me vlerat kombëtare e fetare! Produkt i kësaj tallje është edhe Shaqir Fetai si instalacion politik në krye të BFI-së!

Në një palo informatë të publikuar në rrjetet sociale të nivelit gebelsian të Shaqir Fetait, veç të tjerash thuhet edhe ky idiotizëm: “që në orët e para të mëngjesit, nëpërmjet rrjeteve sociale, Reisul Ulema H. Hfz. Shaqir ef. Fetai ua uroi këtë ditë të gjithë qytetarëve të RMV, duke e cilësuar Marrëveshjen Kornizë të Ohrit një ngjarje historike”!

Kush i tha Shaqir Fetait që ta shpreh këtë urim? Ku ishte Shaqir Fetai përgjatë këtyre 20 viteve që nuk e shprehu asnjë urim për këtë “Marrëveshje”? Kush e motivoi, çka e frymëzoi Shaqir Fetain që ta shprehë këtë uratë? Mbase nevoja e flaktë për ta shprehur paaak “kombtarizëm” përtej jetës së vet përplot me tradhëti, spiunim e komplotim!

Shaqir Fetai mendon se ky “urim” do ta bëjë sado pak “kombëtar”? A e ka lexuar ndonjëherë Shaqir Fetai këtë Marrëveshje? A e di se si u arrit, kush e shkroi Marrëveshjen, kush ishte cytës i kësaj Marrëveshje, kush ishte ofruesi i kësaj Marrëveshje? Kush ishte “Lehtësuesi Gri”? A e di Shaqir Fetai se pse u arrit kjo Marrëveshje, fare në fund, a e di Shaqir Fetai se çka fituan shqiptarët nga kjo Marrëveshje dhe çka fituan të tjerët!

A e di Shaqir Fetai se në Maqedoninë e Veriut vetëm nja 130 mij janë “militantë” të BDI-së, kurse nja 500-600 mij të tjerë janë oponentë të këtyre “militantëve”? A e di Shaqir Fetai se e ka vjedhur “të drejtën” për t’i përfaqësuar të gjithë myslimanët, pra, në veçanti edhe këta 500-600 mij shqiptarë myslimanë! Si guxon Shaqir gungshi që të poziconohet në mbrojtje të interesave të strukturave udhëheqëse të BDI-së dhe t’i “madhërojë” ata deri në “ngjarje historike pozitive”!

Guxon Shaqir Fetai, guxon, sepse është i kapur peng, sepse deri në fyt është në hipotekë të kësaj Partie dhe të këtij pushteti! Guxon Shaqir Fetai, guxon, sepse, në të kundërtën, nëse nuk ua luan vallen që ata e dëshirojnë, menjëherë ia fusin qepën!

Shaqir Fetai, duke u nisur nga pozitrat e fuksit, duke u nisur nga afërsia e tij me ata që e degradojnë këtë Marrëveshje derisa BDI po flinte gjumë shekullor, nisur nga fakti se këtë Marrëveshje Shaqir Fetai e koncepton si rolin e po të njëjtës hallkë siç e ka qeni i

çartur në qafë, ai e idealizon atë duke e quajtur “ngjarje historike” (edhe kësaj radhe nuk dihet se për cilin komunitet është “ngjarje historike”)!

Shaqir Fetai duhet të dijë një gjë dhe, këtë duhet ta mbajë vath në vesh! Me këtë Marrëveshje të cilën Shaqir Fetai e idealizon u arrit:

shqiptarët të quhen popull “20 %;

komunitetet e tjera përfituan duke u barazuar me shqiptarët, mbi gjakun e derdhur të shqiptarëve që ranë në altarin e lirisë;

gjuha shqipe, prej një gjuhe më të vjetër në Ballkan e ndër më të vjetrat në botë, u bë gjuhë institucionalisht e urryer në Maqedoninë e Veriut;

flamuri shqiptar pësoi dimensione ofenduese si dhe të drejtën për t’u valëvitur vetëm aty ku jeton një popull që quhet 20%;

kultura shqiptare u degradua deri në lëmoshë dhe mëshirë maqedonase;

kombi shqiptar zyrtarisht dhe institucionalisht përjetoj degradimin, përçmimin, nëpërkëmbjen, padrejtësinë dhe urrejtjen shtetërore, pa pasur në duar kurrfarë mekanizmi për t’u mbrojtur nga ky hov i bekuar edhe nga Partia ku aderon Shaqir Fetai!

Prandaj këtë Marrëveshje e injorojnë shumica absolute e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut! Madje, falë kësaj Marrëveshje u mundësua edhe puçi si dhe komploti klasik mbi BFI-në duke e kapur këtë Institucion islam dhe duke e degraduar atë deri në një bastion të hajnisë, krimit, spiunimit, të rrënimit të vlerave të përgjithshme, karakteristikë unike e myslimanëve të këtij nënqielli.

Shaqir Fetai tashmë BFI-në e ka shndërruar në një filiale zyrtare të BDI-së! Këtë fakt të pamohueshëm tashmë e dinë edhe faktori ndërkombëtar në vend, i cili, në asnjë mënyrë nuk po mund të pajtohet me faktin që bashkësia fetare të kapet nga pushteti dhe të degradojë deri në filiale, apo nëndegë të një partie!

Shaqir Fetai për Marrëveshjen e Ohrit thotë: “U bë model që hapi rrugët e mendimit konstruktiv për një rrugëtim drejt ngritjes së vetëdijes për të lëvizur në rrugën e popujve të mëdhenj”! A ka kuptim kjo fjali? Mësa ka kuptim nocioni “Shaqir Fetai”! Mut fjalia, mut nocioni. Gjithçka në p.s.

3.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike! Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/14.08.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (9)

Jo një herë është thënë se, sa herë që folë Shaqir Fetai, kijohet përshtypja se je duke dëgjuar pëllitje, shkarkimet e kanalizimve të ujërave të zezë. Ai flet, ndërsa ty të shkaktohet krupa, të vijnë të vjellat, të zë një diarre, të kapin nervat sa, thua, zot, më fal se, dua me ia mbushë gojën me kastraveca të egër. Të kapet një zgavër dhe mos të kutërbojë në cofinë

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

Për të qenë sa më aktual, i bajatshmi e me afat të skaduar, Shaqir Fetai, ky instalacion i pushtetit mqedonas në krye të BFI-së, mundohet që të kapë ndonjë temë, të cilat nuk do të jenë as të fahut të tij, as të “njohurive” të tij, por as që janë të rëndësishme, apo diçka që çojnë peshë! Thjesht, për Shaqir Fetain me rëndësi është të bëjë “bam”, ndërsa nuk ka rëndësi se kjo zhurmë a do të vie nga pistoletat lodër të fëmijëve, apo nga kërситjet e shapkave duke i përplasur në beton!

Të premtën e javës që e lamë pas, vetëm në Aeroportin e Shkupit kanë ateruar dhjetra aeroplanë plotë me bashkatdhetarë. Në kufirin Serbi-Maqedoni e Veriut, kanë kaluar mbi 50 autobusë si dhe mbi 3000 makia, prej të cilave shumica absolute kanë marrur udhë për në Kumanovë, për në Shkup, Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Strugë etj. Pra, vetëm të premtën kanë ardhur mbi 8-9 mijë bashkatdhetarë që vijnë t'i kalojnë pushimet e verës nëpër

vendlindjet e tyre dhe pranë farefisit. Qytetet shqiptare po mbushen edhe më tej me “mëgimtarët” tanë që po vijnë për pushim, ndërsa Shaqir Fetai po ndjenë se po zbrazet Gostivari ndaj dhe, të gjithë mëgimtarëve u uron kthim të mbarë. E postoi këtë diçiturë sa për të qenë aktual dhe sa për të krijuar perceptcion se tha diçkaa të mençur! A mund të thuhet ndonjë urti nga injoranti, sharlatani, snobi...

Por, kur t’ia lexoshë atë tekst fare të shkurtë, do të vësheshë dhjetra gabime gramatikore, sintaksore dhe logjike! Ja, lexojeni edhe vetë se çfarë shkruan ky farë instalacioni i pushtetit maqedonas, ky farë bilmesi që ia ka ënda të quhet “reis”! Shaqir Fetai, për shkak të injoracës së vet, shkruan: “Ngadalë, por me përmallim bashkatdhetarët tanë po kthehen në Europë, ku jetojnë dhe punojnë. Ishte një përmallje e përzemërt dhe e këndshme në atdheun e tyre. Na e sollën bukurinë e shijes, gëzimeve dhe i dhanë një kuptim të veçantë vatanit. Po, ja që duhet të kthehen përsëri, me mall dhe keqardhje. Urojmë rrugë të mbarë dhe shëndet të plotë. Allahu Fuqiplotë t’ju jep kënaqësi, jetë të gjatë dhe begati të panumërta. Zoti ju bekoft.”

Në pikun e sezonit turistik, Shaqir Fetait i duket se po kthehen gastrabajterët! Edhe atë “po kthehen me mall”! Kthimi nuk është me mall! Kthimet janë me kujtime të bukura, apo të trishta! Në kthim nuk ikë njeriu me përmallime! “Ishte një përmallje e përzemërt”, thotë avdalli! Qëndrimi i tyre në mesin e familjarëve, në mesin e farefisit, shokëve, bashkëqytetarëve, në vendlindjen e tyre, shkakton çmalljen, pra, ata çmallen këtu dhe nuk “përmallohen me përzemërsi”! Gurbetçari kur viziton familjen e vet, ai çmallet, kënaqet me ta, arrinë të shkarkohet nga një përmallim i rëndë dhe, kur të kthehet në vendin e vet ku jeton dhe punon, ai kthehet i çmallur dhe me shumë kujtime të bukura nga vizita që ia bën familjes, fisit, vendlindjes...

“Na e sollën bukurinë e shijes, gëzimeve dhe i dhanë një kuptim të veçantë vatanit.” Kjo fjali e thënë edhe në gjuhën amë të Shaqir Fetait, në serbishten e tij, prapë se prapë do të dilte qesharake! Kushdo që e lexon do të turpërohet nga instalacioni i pushtetit maqedon në krye të BFI-së! Si more na e sollën bukurinë e shijes?! Do me thënë deri sa nuk erdhën këta, ne ishim pa shije, nuk na hahej e nuk na pihej, me të ardhur gurbetçrët, ne na u hap gurmazi, na u zgjëruan zorrët dhe, o Zot, si hanim, tamam si të babzitur, pikërisht si Shaqir Fetai! Si more na e sollën gëzimin!

Gëzimi nuk sillet, por, shkaktohet, është ndjenjë që shkaktohet dhe jo që imponohet! Si more i paskan dhënë “kuptim të veçantë vatanit”?! Vatani i tyre është Shteti i Maqedonisë! Uh sikur ta die Shaqir Fetai se sa u lumturaa Maqedonia e Veriut me këta gurbetçarë, phaaa, u kënaq, u trullos, po si mori ky shtet kuptim tjetër nga gastrabajterët shqiptarë! Shteti u gëzua shumë, u kënaq, u shkri nga kënaqësia, sepse, i inkasoi prej mërgatës sonë që erdhën për pushime, nja 2-3 milion euro nga gjobat për shkak se gastrabajterët tanë donin të fluturonin me makinat e tyre nga gëzimi e kënaqësia që po çmallen me “vatanin” e tyre! Shaqir Fetai e ka hallin e vatanit të vet, Maqedonisë së Veriut, dhe jo të mërgimtarëve tanë, për të cilët, nuk e shprehu as më të voglin shqetësm, reagim, që nga pritjet e stërmundimshme dhe malltretimet nga policia dhe doganierët nëpër kufijtë tanë e deri te njëkja e tyre, si e shtrigave, për t’i zënë në rrjetin e radarëve policorë!

2.

Shaqir Fetai në profilin e vet të fb-ut kishte postuar një “brenjë” për riaktivizimin e sërishëm të pandemisë Kovid 19. Kjo brenjë e theksuar nga Shaqir Fetai, më shumë gjason në një “storie” humoristike, që zhvillohet nga një diletant dhe injorant i pashoq! “Autori” përdor një titull që më tepër ngjason në një “parullë” komuniste, në një frazë propagandistke, e afishuar nga funksionarët bukolikë të viseve të shtyra malore, të periudhës rankoviqiane (kopallat e Shaqir Fetait nuk vijnë nga periudha enveriste, por, nga ajo rankoviqiane, sepse, më të tilla literatura është ngjizur truri i Shaqir Fetait.) Më tej, Shaqir Fetai thotë: “Pas një zbehje të konsiderueshme të Covid 19 fatkeqësisht rreziku po shënon ngritje të dukshme dhe po rrezikon popullatën. Tani na duhet edhe një mobilizim i vetëdijes, angazhimit, kujdesit pastërtisë, respektimit të masave Anticovid 19, në veçanti apel tek organet e BFI – së dhe e nëpunësit fetar që të vazhdojnë me kujdesin e nivelit të lartë nëpër të gjitha xhamitë dhe objektet fetare me qëllim të mbrojtjes së shëndetit dhe jetës, në veçanti në këtë kohë të ritjes së numrit të infektuarëve dhe

vdekjeve të shpeshtuara. Këtë e kemi obligim fetar dhe moral për dalje nga kjo krizë që po përhapet me shpejtësi. Lutjet tona drejtuar të Madhit Zot le të jenë lehtësim dhe tejkalimi kësaj gjendje të krizës shëndetësore.”

Fjalja e prë e kësaj diçiture të Shaqir Fetait nuk është e denjë as për nxënësit e klasës së parë! Covid 19 asnjëherë nuk u zbeh dhe as që do të zbehet ndonjëherë, porse, u ulën shifrat e të prekurve apo të të sëmurëve nga kjo pandemi! “Rreziku po shënon ngritje të dukshme dhe po rrezikon popullatën!” Rreziku që rrezikon popullatën? Phu, injorant i pashoq, i kompleksuar deri në veshë! Ky është fati i snobit kur përpiqet të paraqitet si “intelektual i lartë”!

E ka një drekë të madhe, madje le ta marrë me vete edhe Shaqir Fetain, ai i cili na e shpjegon këtë fjali të këtij farë bilmezi: “Tani na duhet edhe një mobilizim i vetëdijes, (një mobilizim) i angazhimit, (një mobilizim) të kujdesit për pastërti, (një mobilizim) të respektimit të masave Antikovid 19!”

Antikovid 19?! Nga e shpiku ky sharllatan këtë lloj virusi?! Apo ndoshta dëshiron të thotë “masa kundër Covid 19”! Mobilizim apo ngritje të vetëdijes, a Shaqir Fetah?! Angazhimi nuk mobilizohet, por, shtohet, rritet nga të mobilizuarit për ta luftuar këtë pandemi! As kujdesi nuk mobilizohet, por, duhet të përkujdesemi që të jemi sa më të pastër! Më tutje, ky farë snobisti, i apelon organet e BFI-së si dhe nëpunësit e këtij Institucioni që edhe më tej “të jenë në nivel të lartë në mbrojtjen e shëndetit dhe jetës”! Fjali tipike e një snobi, e një sharllatani, e një bilmesi dhe avdalli të cilit nuk i gjindet shoqi askund! Ky edhe bakllavë kur të hajë të krijon përstyypjen se po ha m... Epo, si ndryshe ta “portretizojmë” Shaqir Fetain pasi të lexoni fjalinë e fundit të tij: “Lutjet tona drejtuar të Madhit Zot le të jenë lehtësim dhe tejkalimi kësaj gjendje të krizës shëndetësore.”! Do me thënë kriza qenka e gjendjes shëndetësore, apo, gjendja shëndetësore paska një krizë të cilën duhet ta tejkalojë disi! Kjo gjendje qenka e krijuar si pasojë e krizës shëndetësore! Kush e ka këtë krizë shëndetësore! Krizë mendore ka Shaqir Fetai, ndërsa për nga shëndeti duket si me qenë barsë!

3.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/16.08.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (10)

Shaqir Fetai nuk di çka është reforma, nuk di se si ta ngrisë një subjekt në të tjera nivele, si ta organizojë atë, si të jetë sa më larg politikave dhe partive, ai nuk di si t'ua kthejë dinjitetin hoxhallarëve, si të prodhojë hoxhallarë me integritet! Shaqir Fetai di të bëjë vetëm “një reformë”: të caktojë stafin e vet me “personalitete” të diskutueshëm, me diploma e tituj të blerë, di të nënshkruaj vendime për abolimin e vendimeve paraprakë të nëpunësve të punësuar qysh në kohën e H. Sulejman ef. Rexhepit.

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

A ju kujtohet kur në një pseudointervistë të kurdisur fill pas tradhëtisë dhe komplotit epik, Shaqir Fetai pat thënë: “Bashkësia Fetare Islame qanka e maaathe”! Njëzet vite myfti, në krye të një organi të BFI-së, nuk e paska ditur se sa e madhe është BFI-ja! Po pra, është oqean kurse brenda saj Shaqir Fetai është si një kokërr limontozi! Në oqean nuk vlejné truqet e hipokritit, as të spiunt, as të mynafikut, as të tradhëtarit, as të “devotshmit”, sepse, aty si kokërr limontozi tretesh fare, humbesh, nuk të vlen as noti, nuk të vlenë as barka, sepse për anije e “kroçere” duhet të jeshë superkapiten!

Prandaj Shaqir Fetai duket i përhumbur, duket sharlatan, duket snob, kokrrra e injorantit, mashë në duart e veshura me doreza, alet i ndryshkur që mund të këputet e të prishet në intervenimin e

parë! Shaqir Fetai në BFI u instalua me mision antiislam, ai vetë është antiislamist, sepse, po të ishte i sinqertë me vetëveten dhe të pranonte se është hipokrit e diletant i pashembullt, nuk do të pranonte të kryente shërbim antislamist përmes tradhëtisë dhe komplotit që i priu si i marrë. Shaqir Fetai pranoi instalimin nga segmentet e pushtetit që kurrë nuk ia kanë dashur të mirën BFI-së, për të vetmin qëllim që të arrijë e ta bëjë praktikë që në BFI kur t'i çohet hurit e konopit, të realizojë tradhëti dhe komplot. Shaqir Fetai nuk erdhi në krye të BFI-së si rrjedhojë e ndonjë transferimi të "pushtetit", sipas të gjitha parimeve dhe rregullave bazuar në islam, në Kuran, në Hadith, në Kushtetutën e BFI-së si dhe në tërë rregullativën e saj, por, ai erdhi si pasojë e një tradhëtie dhe komploti të cilës i priu vetë ai, nën direktivat e segmenteve të caktuara të pushtetit aktual.

Shaqir Fetai nuk di çka është reforma, nuk di se si ta ngrisë një institucion në të tjera nivele, si ta organizojë atë, si të jetë sa më larg politikave dhe partive, ai nuk di si t'ua kthejë dinjitetin hoxhallarëve, si të prodhojë hoxhallarë me integritet! Shaqir Fetai di të bëjë vetëm "një reformë": të caktojë stafin e vet me "personalitete" të diskutueshëm, me diploma e tituj të blerë, di të nënshkruaj vendime për abelimin e vendimeve paraprakë të nëpunësve të punësuar qysh në kohën e H. Sulejman ef. Rexhepit. Shaqir Fetai nuk dëshiron të ketë nëpunës që kanë në arkiv vendime të nënshkruar nga H. Sulejman ef. Rexhepi, prandaj i ndërron vendimet me vendime të reja sa për t'u thënë se, ju jeni kuadri im, jeni të punësuar nga unë, ndonëse në të njëjtat vendpune të caktuar vite më parë.

Shaqir Fetai është në hipotekë, por, është edhe barrë shumë e rëndë, madje edhe me rrezik eksplodimi në duart e atyreve që po e mbajnë!

Me shaqir Fetain as nuk garantohet fitorja, as nuk fitohet pushteti, por as nuk sigurohet kontrolli nga jashtë brenda BFI-së! Shaqir Fetai 30 vite ka nusëruar në BFI dhe kush nuk ia ka dëgjuar zërin. Shaqir Fetai është ekspert i rrenës, i vjedhjes, i tradhëtisë, dhe i pajisur me të gjitha cilësimet e një dhelpre plakë!

E mori më qafë, desh e nguli dhe e degradoi shumë keq një prej politikanëve më të spikatur shqipar, Kryetarin e Parlamentit të RMV-së, Talat Xhaferin, duke ia çuar në takim, mikun e ngushtë të Putinit, pro-rusin që paraqitet rrejshëm si kryetar i myslimanëve të Evropës, ngjashëm si udbashi, i mendermethënshmi Shaqir

Fetai, që fort ia ka qejfi të prezantohet si “kryetar i myslimanëve të Maqedonisë që lufton për iman e për vatan”!!!

Si reformë dhe sukses e prezanton “krthimin e pronës së nacionalizuar”! Ka shumë fakte që flasin se Shaqir Fetai shumë prona ka tjetërsuar, shumë bono në vlerë, në vend të vakëfit, i ka shterruar duke i përdorur për rroga, për mëditje, për honorare, për “mirënjohje e dekorata” si dhe për skena koncertesh të organizuar në xhami! Pronat eventuale nuk janë kthyer për ndonjë meritë të Shaqir Fetait, por, thjesht, sepse kështu parasheh ligji i miratuar në Parlamentin e RMV-së. Kur është miratuar ky ligj Shaqir Fetai as që ka ditur se çka shtë vakëfi! Nuk i ka interesuar, sepse ka qenë krimb në grrepin e Stanko Dragoviqit, oficerit të UDB-së serbe! Shaqir Fetai dhe të tjerët pa dyshim që do të përgjigjen penalisht nëse një ditë do të zbulohet se ai ka dhënë përqindje për kthimin e vakëfit, se e ka tjetërsuar vakëfin, se e ka falur vakëfin, se ka hequr dorë prej vakëfit (çka po ndodhë me vakëfin në truallin e ish-Komunalecit ku po ngritet kompleks pallatesh)!

2.

Shaqir Fetai nuk e di nocionin “leadership”, madje as që ka dëgjuar për këtë titull i cili merret me organizimin, menaxhimin, i cili garanton mirëqenie, suksese, prosperim, i cili arrinë maje të paarritshme suksesesh duke qenë në krye të një institucioni, të një organizate, të një subjekti, të një pushteti, të një shteti...

Shaqir Fetai nuk di se çka është aktivitet dhe çka është detyrim kushtetutar! Prandaj, thërret njerëz, organizon ture vizitorësh në BFI, thërret imamë për çaj sa për ta shtyer monotoninë e ditës, thërret aktivistësh të ndryshëm, vëtëm sa për t’u tallur me ta! Fundja, këto takime janë detyrime dhe ato nuk shënohen në asnjë hapësirë të rrjeteve sociale, nëpër mediat e infomimit, sepse, është detyrim kushtetutar i reisit që të takohet me teologë të vendit e të diasporës, me qëllim të organizimit të jetës fetare, të bartjes së kompetencave, të shtrirjes së obligimeve. Prandaj këto “vizita” nuk janë aktivitete, madje as që guxon të trajtohen e të publikohen si vizita. Reisi i BFI-së është për politika më të larta, si unifikues i popullit, si simbol i unitetit, ai rrallë duhet të takohet, shumë pak duhet të jetë prezent në opinion, por ai, kur të dalë para opinionit,

fjala e tij duhet të jetë e fundit, duhet të jetë motivuese, vendimtare, për gjithçka, fjala e tij duhet të jetë e pakthyeshme, e pathyeshme, qoftë edhe me përmbysje të sistemit! Ky është lideri fetar, e jo çajxhi që pret e përcjell turlifarë të udhi e të paudhi! Shaqir Fetai e ka në gjakë talljen. Prandaj i ikë politikave të larta, sepse e di veten që është bilmez deri në palcë. Ai tallet me të tjerët për përfitime të veta. Ai përfitim personal e llogarit edhe nëse rrenë për ata që e vizitojnë! Për shembull:

E priti filan fistekun, “si imam dhe aktivist në disa xhami të Zvicrës...”;

“Reisul ulema takoi kontribues të njohur të organizimit të jetës fetare (njëri paska qenë kordinator i DAP-it të Gostivarit, njëri afarist në Republikën Çeke dhe njëri aktivist i shquar!!!) Në fund, “reis” vlerësoi lartë “kontributin e gjithësecilit prej tyre në organizimin e jetës fetare”;

“Reisul Ulema priti profesorë të shquar nga Austria” (dy persona që kurrë nuk kemi dëgjuar për ta. Profesorë të shquar nëpër Univesitete të mirëfillta evropiane janë të njohur e të respektuar edhe në shtetet shqiptare. Për këta dy kurrë nuk është dëgjuar)! Madje njëri prej tyre na qenka edhe “organizator i jetës fetare në Austri”!

Shaqir Fetai na e paska takuar edhe “Nismëtarin e parë të organizimit të jetës fetar islame në Kopenhagë, jehona e të cilit u shtri edhe në Suedi, Norvegji dhe më gjërë”!

Çka dëshiron të arrijë me këto epitete e vlerësime fallce Shaqir Fetai! A është normale për një “reis” të pretendojë se ka takuar “organizatorin e jetës fetare në Austri”, pastaj, “nismëtarin e parë të organizimit të jetës fetare në shtetet skandinave”!

Me këto vlerësime Shaqir Fetai i ofendon mysafirët e respektuar, por, kjo nuk i interesin Shaqir Fetait, ai duhet t’i mburrë edhe me vlera që as në ëndërr nuk i kanë parë, sepse, Shaqir Fetain mund ta vizitojnë vetëm personalitete të tillë, duhet të jenë të parët në gjithçka, siç është edhe vetë Shaqir Fetai, komplotist, puçist e tradhetar i parë në BFI!

“Kësaj radhe për vizitë zyrtare e pata personalitetin e gjithëanshëm fetar dhe karizmatik, referentin e Gostivarit...”, thotë Shaqir Fetai në një diçiturë në fb-un e vet!

Personalitet të gjithanshëm fetar!!! Figurë karizmatike!!! Kurse e ka mbajtur referent-shërbëtor sa ka qenë myfti i tij! Çka nënkupton Shaqir Fetai me shprehjn “personalitet i gjithanshëm fetar”?! Pse

meqë qenka kaq “madhështor” nuk e emëroi myfti të Gostivarit? Po me “karizëm” çka nënkupton Shaqir Fetai. Mbase nuk është aq avdall sa me këtë shprehje të nënkuptojë “humorist”, apo “karikaturë”! Shaqir Fetai duhet të dijë se, meqë shqiptarët e Maqedonisë e paskan një “Personalitet të gjithëanshëm fetar” ai duhet të jetë REIS dhe jo një hipokrit, një mynafik, një avdall që na shitet aq fetar i ndershëm!

3.

Shaqir Fetai është i pafytyrë. Ai tashmë është i përfshirë kokë e këmbë në fushatën e “partisë mëmë” – BDI-së! Sëkëndejm, ai edhe ceremonitë e varimit, dhembjen e myslimanëve, i përdor si momente të volitshme për fushatë partiake!

Ai paska marrur pjesë në varrimin e një myslimani të devotshëm, të një filantropisti të mirë, i cili paska dhënë kontribut shumë të çmueshëm në nismën e projektit kombëtar – themelimin e Universitetit të Tetovës! Kjo më parë nuk është bërë publike! Mbase vetë merhumi nuk ka pasur dëshirë! Ia paska treguar këtë “sekret” Shaqir Fetait dhe ky, pastaj, si profesionist i rryer i thashethemeve, ia bëri publike këtë sekret, por ama pas vdekjes së Haxhi Bari Ganiut! Punë fuksi! Çdo herë do të shpalosen situata që vetëm këtij “ia paskan thënë”, vetëm këtij “ia paskan besuar”, vetëm “ky i di” por që, në fund, pas vdekjes së tyre, ky i publikon! Ne jse, po ku konsistoi fushata partiake këtu, në këtë ceremoni?! Shaqir Fetai tha se, H. Ganiu e paska ndihmuar shumë Universitetin e Tetovës, në krye të të cilit aktualisht është profesor Vullnet Ahmeti! Pse nënvizohet ky emër? Ç’hy në punë këtu, në ceremoninë e varimit, emri i Prof. Vullnet Ahmetit? Vetëm pse është kuadër dhe zgjedhje e BDI-së?

Shaqir Fetait përfundimisht duhet t’i gdhendet goja, t’i mësohet protokoli, t’i mësohet diplomacia, t’i mësohet teknika e shkrimit, mënyra e informimit, t’i mësohet njerzillëku dhe burrëria. Pastaj të lejohet të flasë! Kur të dalë në opinion, të gjithë të thonë “tha” dhe jo “foli” Shaqir Fetai!

4.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/19.08.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (11)

Sekretari gjeneral i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, këto ditë kishte pritur delegacione nga Italia, nga Gjermania, nga Shtetet Skandinave, nga Zvicra... Edhe, çka pastaj! Delegacione nga Italia, Gjermania, Zvicra, nga DAP-i i Gostivarit, ka pritur edhe Shaqir Fetai! Aty janë, në një rang, me një diferencë të vogël: Shaqir Fetai është edhe “reis” i përzgjedhur nga pushteti maqedonas me preferenca të UDB-së

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

Shaqir Fetai, instalacioni i pushtetit aktual maqedonas, në krye të BFI-së, paska pritur një delegacion nga Itala! Si dikur, në nëntor të motit 2012, kur Ismail Qemal bej Vlora, tre ditë para një akti historik dhe të shenjtë për shqiptarët, po priste delegacione nga Lushnja, nga Berati, Elbasani, Shkodra e tan Kosova. Atëherë këta delegacione shkonin tufë-tufë për t'i shprehur përkrahje vetëmohuese Njeriut më të madh të Kombit në rrugën e tij për ta shpallur Shqipërinë të Mëvetësishme. Kurse, sot, Shaqir Fetait i shkojnë për ta pirë një çaj, natyrisht, me ftesë të “reisit”, sepse, këtij i duhet: një, përkrahje sa më populiste me qëllim për ta “zvetënuar” epitetin spiun e udbash dhe, dy, për t'i hedhur krip syve të opinionit dhe për t'i thënë “ja, ja, sa më duan”! Vetëm Shaqir Fetai ka nevojë që ta duan, të gjithë të tjerët, në pozita të vjedhura si të Shaqir Fetait, do të kërkonin respekt e mirënjohje, të cilat, fatmirësisht, ky nuk i ka dhe nuk do t'i ketë kurrë. Shaqir Fetai, vizitat e këtilla i porositë me djallëzi! BFI-ja nuk mbahet me vizita, posti i reisit nuk është post për pritje e përcjell

fare të parëndësishme; BFI-ja nuk është çajto-re-pronë e Shaqir Fetait.

Shaqir Fetain nëse e kanë instaluar aty vetëm sa për të marrë një rrogë si çajxhi, është mirë që t'ia kujtojmë se, çajin dhe sheqerin duhet ta sjellë prej shtëpie dhe jo me fitra e zeqate të blejë “përkrahje populiste”!

Shaqir Fetai paska pritur delegacion prej Italie! Çfarë manjaku! Sa i jep peshë “rasteve të kurdisura” me qëllim që të shkaktojë “një iluzion”! Paskan biseduar tema si të “G7”! Ja, shiheni se çka pallamudë Shaqir Fetai: “Biseduam gjërë e gjatë për organizimin e bashkatdhetarëve tanë në Itali”! Shaqir Fetai na del këtu si lider mbarëshqiptar dhe angazhohet që t'i organizojë bashkatdhetarët, ndonëse nuk specifikon se në çka do t'i organizojë: në luftë, në terrorizëm, në hajni, në spiunim, në tradhëti... Pastaj, po ashtu, Shaqir Fetai, për t'i dhënë vetes peshën që nuk mund ta durojë as gomari, thotë: “Biseduam për marrëdhëniet e ngushta me Bashkësinë Fetare Islame të RMV në vendlindje. “! Të kujt ato marrëdhënie? Të pushtetit antiislam? Të qarqeve antikombëtare? Të UDB-së serbe? Kush ka marrëdhënie të ngushta me BFI-në? Apo, Itaia, a! Dhe e përmbyllë Shaqir gungshi: “Zoti i bekoft për punën e madhe që bëjnë në Itali dhe më gjërë.”! Mbase mendon për shqiptarët! Po ja që në mesin e tyre ka shqiptarë, madje myslimanë, që merren me prostitucion, me drogë, me krime, me vjedhje! Shaqir Fetai lutet edhe për bekimin e tyre, sepse, ku i dihet, Zoti sprovon, një Zot e di se në cilën nga këta grupe mund të përfundojë nesër Shaqir Fetai. Prandaj ky i bekon që të gjithë, me qëllim që të bëjë vend për vete, të pozicionohet, sepse, natyrisht që gjithnjë instalacion nuk do të rrijë! Instalacionet edhe si kryevepra, më së shumti në krye të vitit, demolohen, tërhiqen dhe, futen nëpr gazet e pluhurit e të harresës.

2.

“Shaqir Fetai takon delegacionin nga Gjermania”! Kështu fillon lajmi, ndonëse ky titull do të ishte korrekt vetëm nëse do të bëhej fjalë për delegacion që përfaqëson shtetin e Gjermanisë! Në momentin kur përmendet emri i shtetit, do me thënë që kemi të bëjmë me zyrtarë të atij shteti, me të deleguar nga institucionet

shtetërore të atij shteti! Ndërsa krejt tjetër është nëse thuhet se u takua me një delegacion shqiptarësh që punojë dhe veprojnë në Gjermani! Por, në këtë rast, Shaqir Fetai e di që nuk është ai i autorizuar që duhet të takojë delegacione shqiptare, prandaj, e ka më lehtë të sajojë, të manipulojë, të rrejë e të falcifikojë, sepse, mendon ai, kush i hy t'i analizojë të gjitha këto gjëra! Uh, çfarë informacioni shumë i rëndësishëm!!! Kjo vizitë qenka shumë e rëndësishme sepse po i përforcuaka marrëdhëniet me Diasporën! Gafa të tilla mund të bëjnë vetëm diletantët, injorantët, sharlatanët, analfabetet, dylberët e llojit të Shaqir Fetait! Megalomania e Shaqir Fetait është sa krejt universi! Prandaj ai nuk ka as turp, as frikë nga Zoti e as nuk i ikë mëkateve. Shaqir Fetai çdo ditë të lume e shfrytëzon për të hedhur edhe një hap shkallëve tatëpjetës së tmerrshme, sepse, realisht dhe shpirtërisht, ai e di se ku e ka vendin.

Shaqir Fetai e ka një ves: nuk mundet që të rrijë gjatë nën “mbretërinë e sekreteve”! Iu bë shumë gjatë nën pseudonimin ORAO, prandaj dhe vendosi që bashkëpunimin me strukturat antishqiptare dhe antiislame ta bëjë transparent që më 27 maj të vitit 2020!

Pa dyshim, edhe instalimin e vet në krye të BFI-së shumë shpejt do ta vetëzberthejë: kush e instaloi, pse, si, cili ishte plani, sa dhe me çfarë u pagua për ta ndihmuar demontimin e një strukture gjigante fetare e kombëtare të ngritur decenie e decenie, siç ishte BFI-ja para se ta dhjezë punën Shaqir Fetait!

Është edhe një veti skuthi kjo e Shaqir Fetait për t'i theksuar me emër e mbiemër personat që marrin pjesë në prritje të “delegacioneve”! Kurrë nuk thotë se “delegacionin e priti reisi me bashkëpunëtorët e vet”, porse, këta bashkëpunëtorë i përmend me emër e mbiemër! A e dini pse? Sepse Shaqir Fetai gabimin, fajësinë, krimin, dështimin, dëshiron t'ua taksojë edhe personave konkret, me emër e mbiemër, me qëllim të përfshirjes së një game më të madhe në fajësi dhe, jo vetëm “reisi”! Në një aktivitet sporadik, tercial, fare të parëndësishme, nuk përmenden edhe emrat e bashkëpunëtorëve, sepse është budallallëk që të pretendosh t'ia shtoshë peshën vetes me emra të huaj! Vlerat e tyre nuk i bëjnë kurrfarë nderi Shaqir Fetait, sepse, të gjithë bashkëpunëtorët e tij janë nga po ajo tajfë prej nga vjen edhe Shaqir Fetai, tajfa e bashkëpunëtorëve të ndryshëm të lloj-lloj shërbimeve!

3.

Shaqir Fetai është njeri i ligë, është njeri i perealizueshëm, i papërmbsur, njeri që një jetë të tërë e ka çuar nën hijen e më të mëdhenjëve, duke i shërbyer atyre, duke punuar vetëm për ata, në vepra të rënda, të këqia, të spiunazhit, të vjedhjes, të rrenës... Shaqir Fetai edhe në fatkeqësi mundohet ta promovojë veten si “njeri i rëndësishëm”! Sepse kurrë më parë nuk ka qenë, nuk është dhe nuk do të jetë i rëndësishëm. Këtë kompleks e mbanë vath në vesh! Mjerisht!

Paska adhur një delegacion nga Bashkësia Islame e Kosovës me qëllim që të përcjellin ngushëllimet e këtij Institucioni deri te familja e një të ndjerit! Dhe, përmes një teksti diletantesk, idiotik, të turpshëm, Shaqir Fetai mundohet që ta vjedhe këtë respekt (jo aktivitet!!!) të delegacionit nga BIK-u, dhe ta përkthejë si aktivitet personal! Ky është kulmi i idiotizmit! Shaqir Fetai shkruan: “Në prezencën tonë (të Shaqir Fetait!), si dhe H. Sabahudin ef Zendelit – Mufti i Gostivarit, Prof Dr Musa Musaut dhe Prof Rushdi ef Shabanit, Ahmet ef Sadrija në emër të Muftiut të Kosovës Naim ef Tërnavë dhe BIRK- ut i shprehën ngushllime të thella...”

Si ta kuptojmë këtë fjali?! Po të mos ishin këta “burra” prezent delegacioni nga BIK-u nuk do të shprehte ngushëllime?! Apo, delegacioni nga BIK-u i ka marrur këta “burra” si dëshmitarë që një ditë të dëshmojnë se delegacioni erdhi dhe i shprehu ngushëllimet e thella! Ose, këta janë aq të vetëdashuruar sa, nuk pranohet asgjë nëse nuk shprehet në prezencë të tyre!

Në prezencë të opinionit të vendit u dëshmuua se çfarë tradhëtari e çfarë komplotisti është Shaqir Fetai!

Në prezencë të krejt botës Shaqir Fetai u dëshmuua se është marionetë e huaj!

Në prezencë të krejt botës shqiptare u prezantua një dokument i cili vërteton se Shaqir Fetai, nën pseudonimin ORAO, i ka shërbyer oficerit serb të UDB-së, Stanko Dragoviqit!

Në prezencë të krejt botës Shaqir Fetai e ndërroi me të tjerë oficerin serb të UDB-së, i cili, mbase pikërisht për këtë fakt tradhëtie, në shenjë hakmarrje, do t’ia publikojë dokumentin kryesor dhe original, sa për ta komprometuar dhe për ta bërë të

papërdorshëm! Prandaj, gjithandej, prezenca e Shaqir Fetait sot është shumë e kotë, e bajatshme, neveritëse, pështirosëse!

4.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/24.08.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (12)

Shaqir Fetai do të pranonte që t'i vënë çfarëdo nofke vetëm e vetëm që ta shlyente disi vulën e UDB-së që e ka myhyr në ballë. Prandaj ai sillet si virusolog, si bakterolog, si biolog, si epidemiolog, si njohës i mirë i Koronavirusit Kovid 19. Ai pranon që ta mbajë edhe nofkën “gjinsekolog”, vetëm që të çlirohet prej epiteteve të merituar “tradhëtar”, “komplotist”, “hipokrit”, “munafik”...

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

Shaqir Fetai na e paska takuar një hoxhë të sapo punësuar në një nga xhamitë e Gostivarit. E paska udhëzuar si të veprojë, si ta ruajë famën e xhamisë (për hirë të Pejgamberit a.s.) dhe se, për këtë nuk paska kurrfarë dilemash, meqë hoxha në fjalë na qenka kuadër nga Medina!

A i ka hije Shaqir Fetait të flasë për xhaminë, si institucion fetar? Shaqir Fetai xhamitë i koncepton si zyre të mundshme dhe mjaftë funksionale të filialeve të UDB-së!

Cili është kontributi i Shaqir Fetait për xhamitë? Për kontributin e tij në UDB të paktën ekziston dhe qarkullon një faqe dokumenti! Po kontributi i tij i devotshëm në një xhami me çka do të dëshmohej? Sa herë që flet ai para një hoxhe, para një teologu për rolin dhe rëndësinë e xhamisë, në fakt ai vetëm sa shpërfaqet në një hipokrit të pashembullt, sepse, angazhimi i tij parësor ka qenë, është dhe do të jetë shërbimi për UDB-në serbe. Për këtë fakt dëshmojnë shumë momente, mbi të gjitha, dëshmon akti i tij më plastik në shkatërrimin e BFI-së duke e mbjellë praktikën e tradhëtisë, komplotimit dhe të puçit klasik!

Se Shhaqir Fetai ka pasur ndonjëherë raporte thjesht fetare me një

hoxhë apo me teologët – kjo kurrë nuk mund të dëshmohet, sepse, ai të gjitha takimet, bisedat, raportet miqësore me hoxhallarët e teologët i ka pasur në funksion të mirëinformimit të UDB-së! Shaqir Fetai edhe në këtë shërbim ka mësyer grada oficeri! Mbase i duhet t'ia përkujtojmë me emër dhe mbiemër njeriun të cilit i është lutur që që ta avansojnë me ndonjë shkallë a titull si bashkëpunëtorë i mirë dhe të lirohet nga nofka e thjeshtë “fuks”!

2.

Shaqir Fetai paska pasur në “zyren” e tij të uzurpuar një takim politik me një funksionar të BDI-së, partisë që ia fali spiunimin dhe e avancoi në “reis”! Dhe me të paskan folur se si ta mundin Kovid 19, paskan folur mbi angazhimet përkatëse në zbutjen dhe eliminimin e koronavirusit.

Çka e llogaritë veten Shaqir Fetai? Partner i Ministrisë së Shëndetësisë? Komision sivëlla i Komisionit shtetëror për kriza dhe emergjencë nga pandemitë?

Po si rrenë aq shumë për BFI-në dhe për vete se si angazhohen “profesionalisht” në tejkalimin e kësaj pandemie?

Po pse rrenë për masat që po i zbatuaka BFI-ja dhe, personalisht ai! A falet Shaqir Fetai në ndonjë xhami, për shembull, a e falë namazin e xhumasë? Jo brenda xhamisë, por, a është falur ndonjëherë Shaqir Fetai jashtë xhamive. Nëse po, atëherë sakaq do ta kapte veten në rrenë sa herë që të flasë për “angazhimin serioz” të BFI-së së tij në tejkalimin e kësaj situatë përmes “respektimit të masave antikovid”.

Respektimi i masave të vëna dhe të kërkuara nga organet gjegjëse shtetërore nuk do të thotë se me automatizëm je partner i këtyre organeve! Je vetëm një zbatues i rëndomtë, si të gjithë të tjerët, ndryshe, ta fusin gjobën që t'i hallakasin trutë!

Kontributi i BFI-së së Shaqir Fetait në tejkalimin e kësaj pandemie është zero! Angazhimi i saj është zero! Prandaj, Shaqir Fetai të mos rrejë dhe të mos vetëlavdërohet edhe më tej.

Punën e Shaqir Fetait si dhe të BFI-së së tij në tejkalimin e kësaj pandemie e kryejnë të gjithë qytetarët në Maqedoninë e Veriut, pa përjashtim! Sepse kjo është kërkesë e një seksioni profesional, me kompetenca dhe e ngritur nga vetë Qeveria e vendit, kërkesë kjo

që, kushdo që e refuzon mund të përgjigjet penalisht. Të gjithë ata që e zbatojnë, në fakt vetëm sa e kryejnë detyrën qytetare të caktuar nga një instancë shtetërore dhe, kaq! Nuk ka as partneritet por as vetëlavdërim për ndonjëfarë kontributi, ka vetëm zbatim të detyrave dhe urdhërave!

Shaqir Fetai nuk ka se çka frikësohet dhe t'i fshehë angazhimet e veta politike me "perden e humanitetit", sepse, tashmë nuk ka subjekt, nuk ka njeri, nuk ka foshnje e djepit që nuk e di se Shaqir Fetai është prodhim i dështuar politik, i panevojshëm dhe i mirë për skrap!

3.

Vështirë se kjo gjeneratë e filloristëve dhe, përgjithësisht e nxënësve, do të kenë një fillim të mbarë të vitit shkollor, sepse, janë të uruar nga njeriu më i mallkuar në Maqedoninë e Veriut, nga njeriu që më së paku ka të drejtë të flasë për dituri, për mësim, për shkollë. Sepse, vjen nga një shkollë (e UDB-së) që nuk i bën nder asnjë shqiptari, madje as një jeriu normal!

Një njeri, si Shaqir Fetai, që vatrën arsimore (Fakultetin në Sarajevë) e ka përdorur si mundësi për t'i kodoshuar miqtë?! Një Shaqir Fetai që vatrën mësimore si dhe diturinë e ka pasur të "bekuar" nga djajtë e zinj?

Një snob që diturinë dhe vatrën e arsimimit i ka pasur vetëm si kamuflazh të "shkathtësisë" së tij për të hyrë në "makineri" suxhuk e për të dalur spiun, tradhëtar, komplotist?!

A nuk konsideron vetë ai se, të bekohen filloristët nga një i poshtër, nga një i pist në karakter, nga një tradhëtar e komplotist, është vetëm një nënqeshje satirike e djallit!

Shaqir Fetai kurrë më parë nuk ka pasur postime të tilla, si teolog e si hoxhë! Sepse, thellë në ndërrijen e vet e ka pasur të qartë se, ai vetë, (pas kthimit nga Sarajeva!) nuk është as hoxhë e as teolog. Tani kur u lakuriqësua si i poshtër e i padenjë për epitetin njeri, ai mundohet që me urime, pritje e përcjellje, të "vishet" e të duket "normal"! Djalli nën xhybe e çallmë???

Kurrë!/Kombetare/01.09.2021

Shaqir Fetai dhe politikat ruse në rajon

Çka e lidhë Shaqir Fetain me politikat gjeostrategjike ruse në rajon! Kohë më parë, ai pati edhe një takim me një përfaqësues të partisë së Putinit në Duma, i cili opinionit të gjërë iu prezantua si kryetar i “komunitetit mysliman të Europës”! Shaqir Fetai ia arriti që këtë vizitë ta ngris në nivel shtetëror, duke e takuar edhe me kryeparlamentarin Talat Xhaferin, e ky me drejtues të Komunës së Tetovës

Nga Ilir Ramadani

Tash një vit më parë, në opinion, konkretisht, në lajmpress.org, të 6 korrikut të vitit 2020, u publikua një koment i njërit prej trimave të “Lagjes së Trimave”, Shek Hallaçi, i cili fliste për detyrimet e Shaqir Fetait që i kishte karshi rusëve e që konsistonin në angazhimin e tij dhe të të gjitha strukturave të BFI-së për të fituar BDI-ja dhe për t’u formuar koalicioni VMRO-BDI, koalicion ky që ishte më afër politikave serbe që diktoheshin nga qeveria ruse. Hallaçi thoshte se, nëse Shaqir Fetai nuk vihet institucionalisht në shërbim të këtyre politikave, do të përballet me fakte që do të dëshmojnë për bashkëpunimin e tij me UDB-në. “Shaqir Fetai, urdhërohet rasisht që të angazhohet fuqishëm në këtë fitore, ndryshe, nëse humbin, edhe Shaqir Fetai do të shkojë në rr.s.

Atëherë do të ketë gjasa që t'ia hapin dosjen policore të UDB-së dhe ta ndëshkojnë për dështim politik! Shaqir Fetai është shumë i vetëdëshëm për këtë gjë, prandaj dhe me aq lehtësi ka urdhëruar myftinjë e hoxhallarë që të agjitojnë natë e ditë për BDI-në që aq shumë i duhet Rusisë!”, shkruante Shek Hallaçi!

Ky koalicion nuk u arrit, as BDI-ja nuk arriti të fitojë në katundin e Shaqir Fetait, në Çegran! BDI-ja hyri në koalicion qeveritar me LSDM-në që shquhet si parti më properëndimore! Dy muaj pas vërejtjes së trimit të kombit, Shek Hallaçi, në opinion do të publikohet një dokument i UDB-së që do të paraqesë deklaratën e Shaqir Fetait, nën pseudonimin ORAO, dhënë para oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviqit!

Një vit më vonë pas komentit të botuar në lajmpress, më 7 korrik të vitit 2021, opinionit i gjërë do të informohet se Shaqir Fetai realizoi takim me, një prej bashkëpunëtorëve të ngushtë të Putinit, të kamufluar në “kryetar të forumit të myslimanëve të Evropës”! Le të bëjmë këtu një parantezë! Në korrik të vitit 2019, Kryeministri i Maqedonisë së Veriut e hëngër tunxh! U tall nga ana e dy humoristëve rusë. Konkretisht, përmes linjës fikse të Qeverisë dhe aplikacionit WhatsApp, Zaevi do të flasë me dy humorista rusë, Vladimir Kuznecov dhe Aleksej Stolarov, të cilët do t'i prezantohen, njëri si ish-presidenti i Ukrainës, Petro Poroshenko, dhe tjetri si Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. Zaevi do ta pranojë se u vu në lojë dhe, do t'i kërkojë falje publike opinionit të gjërë!

Më 7 korrik të këtij viti, “shërbimet profesionale” të Shaqir Fetait do të njohtojnë për një “pritje vëllazërore” që ua kishte organizuar “reisi” delegacionit të Forumit Mysliman Evropian me seli në Bruksel, të udhëhequr nga Kryetari i FME Abdul-Vahid Niyazov!

Se çka ka pasur nevojë Shaqir Fetai për ta pritur një delegacion shumë të dyshimtë si ky “nga Brukseli” këtë e di vetëm ai! Riaseti i Bosnjës e ka refuzuar kërkesën ruse për t'u takuar me këtë delegacion, duke e kundërshtuar kategorikisht një “organ evropian” për themelimin e së cilës as që është konsultuar dhe as që ka kontribuar.

Po kush është ky farë Abdul-Vahid Niyazov i cili paska këmbyer përvoja me Shaqir Fetain?

Sipas Radio Evropës së Lirë, drejtuesi i Forumit, Niyazov, kryeson gjithashtu Qendrën Kulturore Islamike të Moskës, një departament

publik i këshillit zyrtar të myftiut rus dhe gjithashtu organ i lidhur me Kremlinin. Në Federatën Ruse, Niyazov konsiderohet si bashkëpunëtor i afërt i presidentit rus, Vladimir Putin, i cili prej vitit 1999 e deri në vitin 2003, ka qenë përfaqësues i partisë së Putinit në Dumën ruse.

Për më tepër, Radio Evropa e Lirë publikon edhe një informacion i cili, më tepër përbën skandal se sa lajm! REL thotë se, delegacioni i Forumit Mysliman Evropian njoftoi se është takuar me nënkryetarin e parlamentit serb, Muamer Zukorliq, zëvendëskryeministrin e Malit të Zi, Dritan Abazović, kryetarin e Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, kryetarin e këshillit të qytetit të Sarajevës, Jasmin Ademović, si dhe në Sarajevë me Bakir Izetbegovićin, drejtues i Partisë së Veprimit Demokratik!

Këtu sillet edhe njohtimi i këtij Forumi, i cili thotë: “Talat Xhaferi dhe Bakir Izetbegović, paraprakisht janë pajtuar të bashkohen me Komitetin tonë Drejtues dhe Shejh Mustafa Ceriq, tashmë është anëtarësuar në Këshillin e Udhëzimeve Shpirtërore të Forumit. Vëllai i dashur Muamer Zukorliq është gjithashtu një anëtar i Këshillit tonë, të cilin ne planifikojmë ta përfshijmë në Bordin e FME-së, në takimi i ardhshëm në Lituani, dashtë Zoti. Padyshim, Forumi Mysliman Evropian tani po forcon pozicionin e tij në Ballkan”, thuhet në komunikatën e këtij forumi.

Radio Evropa e Lirë më herët ka njohtuar se, “Niyazov u pajtua me autoritetet në komunën e Tetovës, që në kuadër të shënimit të 70-vjetorit të udhëheqësit të parë çeçen Ahmad Kadyrov, të ngrihet një monument i miqësisë midis popujve të Ballkanit dhe Kaukazit. Radioja dhe televizioni çeçen thanë se një nga parqet e qytetit në Shkup, do të quhej “Parku i Miqësisë me emrin e Ahmad Kadyrov”-tha ai.

Pra, sipas këtij informacini që del nga shkrimi i publikuar në REL, shihet qartë se me këtë bashkëpunëtorë të ngushtë të Putinit qenka takuar edhe Talat Xhaferi si dhe, me gjasë, edhe Teuta Arifi! Padyshim, ky takim vie si rezultat i angazhimit spiunesk të Shaqir Fetait.

Shaqir Fetai rusit në fjalë ia ngritë vizitën në nivel shtetëror, ndërsa “i ngulë” edhe Talat Xhaferrin si dhe drejtuesit e Komunës së Tetovës të cilët kanë premtuar se një park të këtij qyteti do t’ia vënë emrin e “liderit Çeçen”, Ahmad Kadyrov, i cili do të përfundojë si lojalisti më i madh i politikave shtetërore të Putinit. Pas vrasjes

së tij liderizmin do ta rrëmbejë babai i vet, Ramzan Kadyrov, i cili sundon me autoritarizëm dhe është besnik i Kremlinit dhe presidentit rus Putin!

Është e pabesueshme por, kështu thotë Radio Evropa e Lirë, kurse, deri më sot, as Talat Xhaferi por as strukturat udhëheqëse të Komunës së Tetovës, nuk dolën të kërkojnë falje publike për atë që u manipuluan nga një bashkëpunëtor i ngushtë i Putinit.

Tërë kjo lojë është edhe një fakt për ta kuptuar të vërtetën se, Shaqir Fetai, nuk është njeri që çon ujë në mullirin kombëtar e as partiak, por, është si një jaz i devijuar që e çon ujin në mullirin ruso-serb. Kujdes! Shaqir Fetai nuk mbanë llogari as për autoritetin dhe personalitetin e Kryetarit të parë shqiptar të Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, z. Talat Xhaferit!

Z. Xhaferi, bazuar në linjat partiake, me automatizëm i ka zënë besë Shaqir Fetait, i cili nuk është ndërtuar, për asnjë ditë, si karakter besnik, sepse, të jeshë udbash dhe të jeshë besnik, është sikundër të jeshë pikë uji në sipërfaqen e diellit!

Gati është e pabesueshme se Talat Xhaferi mund të jetë takuar me këtë mashtrues ordiner dhe marionetë e Putinit, aq më pak që këtë takim ta ketë realizuar me kërkesë të vet! Se ka qenë i mashtruar dhe i manipuluar nga Shaqir Fetai, kjo nuk vihet në dyshim, megjithatë, i takon Talat Xhaferit që sa më parë ta demantojë këtë informatë, apo, nëse jo, të paktën, t'i kërkojë falje opinionit që ka pranuar ta degradojë autoritetin e vet si dhe të Shtetit para mashtruesve Shaqir Fetai-Nijazov!/BotaPress/24.08.2021

Nëse nuk fiton BDI-ja shkarkohet Shaqir Fetai. Vjen i LSDM-së

Shaqir Fetai ka nisur t'i numërojë ditët e veta së qenuri instalacion e qeverisë maqedonase në krye të BFI-së! Stacioni i fundit i tij do të jenë zgjedhjet lokale që pritet të mbahen pas gati dy muaj! Në zgjedhjet e fundit, Shaqir Fetai dështoi, madje në katundin e vet, nuk i solli pritshmëritë e atyreve që e instaluan. Është shumë i ndërgjegjshëm se po i vie fundi. Tik-tak

Nga Ilir R. Topi

Se shteti është ulur këmbëkryq në kolltukun e BFI-së, se pushteti politik i ka të futur duart deri në bërryla në organizmin e jetës fetare islame në vend, këtë më së miri e dëshmon rasti i Shaqir Fetait.

Shaqir Fetain pushteti maqedonas e solli “në pushtet” pak javë para se të mbaheshin zgjedhjet e fundit parlamentare. Shaqir Fetai u instalua politikisht në krye të BFI-së më 27 maj të vitit 2020, kurse zgjedhjet parlamentare u mbajtën në mes të muajit korrit të po të njëjtit vit. Ndonëse, në bazë të premtimeve megalomane të Shaqir Fetait, prishmëritë ishin optimale, megjithatë, “instalaconi” humbi në katund të vet. Nuk ia falën tradhëtinë, ndonëse, në aparence, e respektuan “si reis”! Pushteti ia fali këtë dështim, me arsyetim se, është shumë i ri në këtë post dhe se nuk ka arritur të ushtrojë ndikimin e tij të realtë.

Ndikimi real i Shaqir Fetait në opinionin e gjërë të myslimanëve të vendit nuk mund ta kalojë as 1%. Të kota paskan qenë 27 vitet e angazhimit të ish-reisul ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepit, për ta

imponuar Shaqir Fetain si “hallkë” jetike e jetës fetare islame në Maqedonin e Veriut, kur, në çastin e fundit “Ura e Siratit” iu bë miliona herë më e hollë se fija e flokut! E refuzoi katundi i vet, Çegrani! Pse? Këtë më së miri e dinë vetë çegranasit lokalë! Shaqir Fetai kohëve të fundit në mesin e hoxhallarrëve ka hedhur një rrenë të madhe! Mbase në ndonjë myftini minore do ta mbajë “premtimin” e vet, dy-tre imamëve respektivë do t’ua rrisë rrogat, por jo edhe të gjithë imamëve të Maqedonisë së Veriut siç po premtton! Sepse, nuk është në tagrin e Shaqir Fetait, nuk është në duar të reisit ngritja apo zbritja e rrogave të imamëve! Është e kundërta – varësisht nga aktiviti i hoxhallarëve, varësisht nga angazhimi i myftinive si organe, varësisht nga kapaciteti menaxhues i drejtuesve të organeve dhe të institucioneve, rritet rroga e shërbimeve të Rijasetit dhe vetë “reisit” (nëse nuk e paguan shteti nga “buxheti i vet”!) Pra, nga aktiviteti i hoxhallarëve dhe i myftinisë si organ, akumulohet buxheti nëpër myftini, prej të cilave, një përqindje shkon për anëtarët dhe shërbimet profesionale të pushtetit, një përqindje tjetër për institucionet arsimore të BFI-së dhe, pjesa tjetër, ngelë në myftini, buxhet ky që mund të diktojë rritjen (ose edhe zvogëlimin!) e rrogave të imamëve.

Megjithatë, Shaqir Fetai ka vendosur “t’ua rrisë” rrogat imamlerëve! Sepse, thotë që ka buxhet, sepse, thotë që ja, erdhi sekretari gjeneral i ligës arabe dhe, ka sjellë me thasë para! Kushti i vetëm për rritjen e rrogave është që ta ndihmojnë që të fitojnë partitë (LSDM-BDI) që e sollën në pushtet! Nëse nuk angazhohen të gjithë imamlerët e Maqedonisë së Veriut që ta bindin popullatën respektive që të votojë për këta dy parti të pushtetit aktual, atëherë, do të shkarkohet dhe nuk ka rritje të rrogave!

Në fakt ky është kushti i BDI-së që së fundmi ia kanë shqiptuar Shaqir Fetait: ose të angazhohet me të gjitha strukturat e BFI-së dhe të fitojnë, ose, Shaqir Fetain nuk e pret nëntori në krye të BFI-së.

Për këtë kushtëzim radikal dhe për këtë përzierje flagrante në BFI, BDI-ja është e deyruar, sepse edhe ajo është kushtëzuar nga LSDM-ja: herën e parë patëm mirësinë dhe e pranuan propozimin e juaj si BDI që ta instalojmë Shaqir Fetain në krye të BFI-së! Nëse edhe kësaj radhe humbim në katundin e tij, atëherë, ne si LSDM do ta instalojmë kandidatin tonë në BFI, duke e risjellë frymën e Rexhep Sulejmanin përmes figurës së tij, dekanit të FSHI-së, Shaban Sulejmanit! Ky është shpjegim dhe arsyetim i Shaqir Fetait

për angazhimin e tij me të gjithë bashkëpunëtorët dhe imamlerët e vendit në taborrin e BDI-së

Pra, kjo është një lojë pistë e Shaqir Fetait dhe BDI-së – kërcënohen imamlerët si dhe strukturat e ndryshme të BFI-së: ose të ndihmojnë Shaqir Fetain e BDI-së në zgjedhjet e pritshme lokale, ose do të vie në krye të BFI-së instalacioni tjetër, Shaban Sulejmani i LSDM-së!

Kësisoj, Shaqir Fetai tashmë BFI-në e ka shndërruar në një poligon të ndëshkueshmërisë mesjetare! BFI-ja e ka patjetër që të angazhohet në fitoret e pushtetit. Po kur do të humbë pushteti dhe, në “vllast” të na vije opozita! A do të ngelë pa u ndëshkuar BFI-ja? Në çfarëdo varianti, më së keqi do të pësojë BFI-ja! I vetmi shpëtim shihet në depolitizimin total të saj si dhe në injorim total të të gjitha strukturave që agazhohen për politikat ditore të pushteteve!

BFI-ja duhet të jetë opozitë e përjetshme e pushteteve dhe, mospërfillëse totale e opozitave! Ky është shpëtimi i BFI-së! Rrenat dhe synimet e Shaqir Fetait vetëmsa do ta përmbysin deri në shkatërrim total këtë Institucion të vetëm fetar islam në vend. Këtë brengë nuk e ka Shaqir Fetai! Halli i tij është si të fitojë LSDM-BDI! Sepse, e kërcënojnë edhe njëra edhe tjetra. Shaqir Fetai po përpiqet të kapet për një fije bari – të rrejë sa të mundet se, nga nëntori, imamlerëve të Maqedonisë së Veriut do t’ua rrisë rrogat. Mund ta realizojë këtë premtim nëse do t’i shesë arat e babës së vet dhe, jo, në asnjë mënyrë me bonat që mund t’ia ofrojë pushteti aktual në shenjë denacionalizimi të pronave sa për t’i shpenzuar në fushatat e veta partiake! Pra, para nga arabët nuk ka, sepse, nuk japin më në dorë, financojnë projekte në rrugë bankare! Para mund të ketë vetëm nga bonot në vlerë.

Shaqir Fetait i tërhiqet vërejtja (si vërejtje absolute e imamlerëve të vendit) që mos të abuzojë dhe mos t’i shpenzojë bonot në rroga. Sepse, për çdo bono të shpenzuar, nesër-pasnesër, do të ketë padi më vete. Pësia e BFI-së do t’i duket shumë e maaathe, e papërmballueshme, fundosëse! /Zhurnal/26.08.2021

A ka turpi brirë

“Sekretari gjeneral” i Shaqir Fetait, Irsal Jakupi, ka nisur të merret me reklama. I përzgjedhur si figurë mediale për reklama, ai tashmë ka nisur të reklamojë vaksinat kundër Kovid 19. Nga ana tjetër, në vend të nënës së vdekur, familjes së përvëlur i ofrohet arkivoli me “çifko Dragin” brend, nga Prilepi, dhe asnjë reagim nga BFI-ja e Shaqir Fetait. Shumë rënd ka pllakosur harami mbi BFI-në e Shaqir Fetait, aq rëndë sa, nuk mund të bëjnë “as geg as mrrek”

Nga Jasir Jashari

A ka gjë më të shenjtë se nëna për fëmijët? A ka gjë më të shenjtë se gruaja për familjen e devotshme, për shtëpinë e shëndoshë. Kur vdes nëna, thonë, tërë shtëpia ngelë jetim! Feja islame nënave ua ka caktuar vendin më prestigjioz në mes të njerëzimit.

Vdes nëna, si ajo e familjes në fshatin Vrapçishtë të Gostivarit dhe, kur e marrin për t’ia kryer ceremonitë fetare, shohin që në arkivol, të cilin ia kanë sjellë dikush nga agjencitë e shërbimeve të varrimit, nuk është nëna e tyre por një burrë, një i ndjerë, maqedonas nga Prilepi! Vetëm një dhembje e fuqishme e së bijës, ka bërë që mos të kryhen ceremonitë fetare isame ndaj një burri përkatës i fesë tjetër, ndërsa, po ashtu, ka shpëtuar që gruaja të varroset me ceremoni e rite fetare të një feje tjetër, e në varreza të huaj.

A ka më tmerr se kjo! A duhet të mbajë përgjegjësi dikush? A duhet që e tërë Bashkësia Fetare Islame të ngritet në këmbë dhe, nëse nuk janë vetë fajtorë, të kërkojnë fajtorin, të kërkojnë masa ndaj fajtorit, të kërkojnë zgjidhje të tjera, duke ua hequr monopolin

agjencisë për shërbime të varrimit, siç është “Buteli”-i!
Nuk u shënua në asnjë fb, si zakonisht, as nga BFI e as nga Shaqir Fetai, se në ceremoninë mortore të nënës nga Vrapçishti morën pjesë edhe përfaqësues nga BFI-ja A thua pse? Janë vetë fajtorë? Apo, nuk patën fytyrë dhe nuk patën guxim, sepse në atë vaki mortore, me siguri që Shaqir Fetai do të bombardohej për heshtjen hipokrite karshi një tragjedie të dyfishtë.
Dikush deshti që familjes së mrekullueshme islame nëna t’iu vdesë dy herë brenda 24 orëve. Vdekja e natyrshme, ajo që vie nga Allahu xhsh., nuk ka problem, e kemi hak, por ama, të toleroshë e ta shkaktoshë vdekjen morale të merhumit, kjo nuk tolerohet! Një institucion serioz, një institucion fetar, i pavarur e i pakapur nga institucionet shtetërore dhe nga dora e pushtetit, me rasin e nënës nga Vrapçishti, do ta mbështeste shtetit për murë dhe do ta detyronte në hapa konkretë:

– ta thyej monopolin e agjencive për shërbime varrimi, të lejojë dhe të detyrojë me ligj të vçantë themelimin e agjencive përkatëse komunale të cilat ceremonitë do t’i kryejnë sipas përkatësisë fetare të të vdekurve;

-të ndërpriten të gjitha rryshfetet për ta nxjerrë nga bodrumet e spitaleve të vdekurin (paguhet doktori, paguhet infermierja, paguhet portiri)

-të ndërpriten të gjitha pagesat ekstra që i bën një familje myslimane e cila paguan anëtarësinë vjetore (hoxha paguhet në mevlud, hoxha paguhet në ceremoni mortore, në ceremoni martesore, në syneti etj.) Anëtarësinë nuk e paguan si kontribut për t’ua siguruar imamlerëve rrogat por, paguan që një ditë t’i ketë të disponueshme të gjitha shërbimet dhe ceremonitë fetare pa pagesë, si në Turqi.)

-arkivolet e të vdekurve myslimanë të jenë me xham te fytyra, sepse, nëpër shtëpitë myslimane, sipas traditës, të vdekurit i zbulohet fytyra me qëllim që të përshëndeten me të gjithë ata që dëshirojnë të përshëndeten për herë të fundit;

-agjencitë përkatëse të pajisen me transportues adekuat e profesional dhe jo të barten arkivolet me turlifarë furgoni lakrash, patatesh apo skelesh për ndërtimtari;

-të vdekurit t'i ruhet dinjiteti deri në hudhjen e llopatës së fundit të dheut mbi varr!

Nëna e ndjerë nga Vrapçishti duhet të shërbejë si pikënisje për arritjen e një mrrëveshje me organet shtetërore, apo edhe rasti të ndjehet si thikë në kockë dhe të shprehen të gjitha reagimet deri në një siguri të plotë se në të ardhmen nuk do të ndodhë më një problem i tmerrshëm si ky që ndodhi në Vrapçisht të Gostivarit. Të gjithë subjektet politike të bllokut mysliman, tërë BFI-ja, me të gjitha organet dhe institucionet e saj, i kanë borxh, të paktën, një kërkim falje, kësaj familje, një zotim para kësaj familje se do të jenë këmbëngulës në gjetje të mundësive ligjore, në zgjidhje institucionale të problemeve të tilla.

Në Gostivar dhe gjithandej, pas këtij lajmi, myslimanët që kanë varrosur të dashurit e tyre që vdiqën nga virusi e të mbyllur hermetikisht nëpër sanduqe, po shprehin pasiguri të plotë nëse i kanë varrosur njerëzit e vet apo dikë tjetër! Skandal i tmerrshëm, të cili dikush po dëshiron ta gëlltisë si një farë luledielli të çëruar! Turp! Ky është skandal dhe jo, kush me kë po bën koalicione partiake në prag të zgjedhjeve lokale! Të na varrosen të dashurit nëpër varreza të huaja dhe të huajt t'i varrosim nëpër varrezat tona e me ceremoni islame?! Na fal, o Zot!/TetovaSot/28.08.2021

Zhgënjim dhe hidhërim

Shaqir Fetai është person që refuzohet, që nuk ngjiz askund, që nuk është i ideve, i aksioneve të shëndetshme, i projekteve origjinale – ai është vetë turpi e vetë harami

Gjithnjë e më shumë po qartësohen konstatimet se:

- Shaqir Fetai është hendikep i papërballueshëm për secilin subjekt që i qëndron mbrapa;
- Shaqir Fetai është turpi më i madh që i ka ndodhur komunitetit tonë dhe;
- Shaqir Fetai nuk është i denjë për t'ju prirë as çështjeve fetare por as çështjeve kombëtare, sepse, një jetë të tërë e ka kaluar si një parazit hibrid – i kombinuar me huqe të skuthit dhe me veti të dhelprës (do me thënë, pa veti të njerëzisë!)

Shaqir Fetai u imponua si materie elastike për instalacion politik në krye të një Institucioni fetar! Si materie e ngurtë, ai nuk u shqua për ndonjë afinitet organizativ, për shkathtësi të lidërshiptit, për ndonjë figurë karizmatike, pa kurrfarë vetishë tërheqëse magnetike.

Si i tillë, ai doli edhe zhgënjimi më i madh i instaluesve të këtij farë instalacioni pa formë, pa trajtë, pa përmbajtje e pa kuptim! Ai i përmbushi të gjitha kriteret për t'u vlerësuar si cung, i paaftë për

drejtim, i pamend, pa kurrfarë ideshë dhe, për rrjedhojë, imitues i dobët por dhe devijant i praktikave të lëna nga “babai i tij shpirtëror”, ish-reisul ulema i BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi!

Për dështimet e tij ka nisur të etiketojë njerëz, fajtorët t’i kërkojë të bashkëpunëtorët e vet (të cilët gjithnjë e më shumë i përcepton si vegla të mëtejme të H. Sulejman Rexhepit), dështimet t’ua faturojë jo vetëm bashkëpunëtorëve të vet por edhe njerëzve që e instaluan e që tani, kur e ka më së rëndi, për shkak të zgjedhjeve lokale, e kanë lënë manash dhe po e injorojnë tërësisht. Shaqir Fetai ka menduar se, deri sa do të mrizojë e do të mllaçisë taxhi, për të do të punojnë Zoran Zaevi e Ali Ahmeti, kuse ky, kur t’i çohet (bitha) do t’i vjelë frutat e punëve të tyre “fetare”! Ky ka menduar se të tjerët, ata që e instaluan, do ta shtyejnë përpara, pavarësisht nëse do të punojë islamikisht e kombëtarisht, apo jo! Ky ka menduar se, Zoran Zaevi dhe Ali Ahmeti do të jenë “goma traktori” që do t’ia fshijnë të zezën në të bardhë, të zezën që dëshmon për të kaluarën e tij të pistë!

Shaqir Fetai ankohet për disa drejtorë që i paska gjetur aty kur është instaluar! Asnjërin nuk e ka ndërruar, sepse kështu i paskan thënë ata që i garantuan se do ta ketë gjithë vaj! Tani, ankohet Shaqir Fetai, nuk po ia dilka dot me njerëz të tillë që tërë ditën rrinë nëpër telefona duke raportuar në lloj-lloj shërbimesh! Tani paska konstauar se qenkan të shërbimeve?!

Për njërin drejtor (për të cilin na ka ardhur një letër nga një nëpunës i BFI-së në inboxin e Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI), paska vendosur që ta “avancojë” në zëdhënës të BFI-së? Ja çfarë logjike ka Shaqir Fetai! Njeriun, të cilin e akuzon se qenka i shërbimeve, do ta heq nga posti drejtor i sektorit dhe, të njëjtin ta “avancojë” në zëdhënës të BFI-së! Frontmeni bashkëpunëtor i shërbimeve të ketë komunikim me mediat e vendit, aq më tepër kur të njëjtin e akuzon për hajni?! Kështu mendon vetëm ai që është i ushqyer me logjikën gebelsiane të diktatorit të poshtër! Po ata drejtorë e nëpunës me biografi kilometrike përplotë me suksese në spiunazhë, në tradhëti, në vjedhje, në kurvëri e në poshtrime të ndryshme, këta si do t’i avancojë e ku do t’i “rehatojë”?

Shaqir Fetai hiç më larg se para dy dite, pas një vakie, në një tavolinë duke shijuar kafënë, pasi ka shprehur shqetësime të tilla, ka deklaruar: “nuk do të largohem pa ua tollovitur punët këtyre që më instaluan e që më lanë qyqe vetëm”!

Shaqir Fetai është person që refuzohet, që nuk ngjiz askund, që nuk është i ideve, i aksioneve të shëndetshme, i projekteve origjinale – ai është vetë turpi e vetë harami, vetë hipokrizia e vetë tradhëtia!/LMR në BFI/Mileniumi3/30.08.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (13)

Shaqir Fetai është “mjeshtër i madh” i cinizmit dhe i komunikimit me alegori! Është “gjuhë” dhe afinitet i komunikimit të shërbimeve që janë përplotë me kode e simbole të njohura vetëm për oficerin dhe për bashkëpunëtorin

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

Sa herë që flet Shaqir Fetai, sidomos kur shpreh “mirënjohje e lavdërata”, duhet kuptuar të kundërtën e asaj që e flet! Shaqir Fetai është frikacak i llojit të vet, ai nuk guxon të flasë për të mëdhenjtë e kombit (bie fjala për ish-reisin që e tradhëtoi dhe të cilit i ra thikë pas shpine)! Shaqir Fetai alegorinë, temsilet dhe cinizmin e përdorë kur gjendet përballë me sojin e vet! E keni dëgjuar se si thotë “sot qëndroi në kabinetin tim”! Kabineti në BFI është i reisul ulemasë dhe nuk është i Shaqir Fetait. Ai mund të ketë kabinet vetëm në shtëpinë e vet, apo diku, në ndonjë objekt, që mund ta ketë si donacion nga ndonjë firmë e diskutueshme! Por, ky ka nevojë t’i japë peshë vetes, sepse, askush nuk po ia futë qepën!

2.

Shaqir Fetai sa herë që takohet me skutha thotë se u takua me një “personalitet kombëtar e fetar”, ndonëse i ka të gjitha informacionet se është ulur me një tradhëtarë, me një udbash, me një spiun, me një hajn! Meqë është i vetëdëshëm se është vizituar nga një i poshtër, meqë ka nevojë të vizitohet, të “përsëndetet dhe të urohet”, madje edhe nga llumi i shoqërisë, ai, sakaq do ta aktivizojë cinizmin e vet dhe do ta paraqesë vizitën si të një “personaliteti fetar e kombëtar”!

Pas njëzet viteve qenka takuar me “një mik” (!!!) të vetin nga Likova, z. Ejup Dautin, për të cilin e lutë Zotin që ta bekojë! Ky zotëri mbase edhe më parë e ka vizituar BFI-në por, kurrë “vizita” e tij nuk është bërë publike, sepse, ose është ndonjë zotori që nuk çon kurrfarë peshe, ose është ndonjë qytetar i thjeshtë për të cilin nuk ia vlenë as të diskutohet!

Nga një koment brenda informacionit të postuar nga Shaqir Fetai, merret vesh se qenka babai i Mustafa Dautit, njeriu më kontravers dhe më i poshtër që e ka BFI-ja! A po do spiun, po! A po do hajn, po! A po do vjedhës i ndihmave humanitare, po! A po do hipokrit, po! A po do injorant deri në pikën e fundit, po! A po do manipulatore që është në gjendje ta manipulojë edhe babain e vet, po!

Dhe babai i këtij personi kontravers të jetë “si një kontribues i madh i jetës fetare kombëtare” (siç shpehet me cinizëm Shaqir Fetai)?! Ky që nuk ka dhënë kurrfarë kontributi në gdhendjen e birit të vet? Është problem i tij familjar, por ama, Shaqir Fetait i ndalohet rreptësisht që personat si vetja e tij të na i shesë për “vlera”! Sepse një vlerë e mirëfilltë kurrë nuk do të pranonte që të fëlliqej duke vizituar persona si “Shaqir Fetai”!

Vlera fetare e kombëtare do të pranonte që të takohet sy më sy me Shaqir Fetain vetëm sa për ta pështyrë në fytyrë, ashu siç pështyhen spiunët, kmplojistët dhe tradhëtarët!

3.

Tani, me gjasë, në BFI do të defillojnë të vijnë të gjithë prindërit, vëllezërit, familjarët e nëpunësve të Shaqir Fetait, të cilët duhet të vijnë e ta vizitojnë këtë farë “beregëti”, ta përkrahin dhe t’i urojnë suksese “në rrugëtimin e tij në përballje me sfidat e kohës”! Vërtet,

cilat janë ato sfida të kohës që përbëjnë problem për Shaqir Fetain?!

Ku di Shaqir Fetai se çka është sfida! Sfidë për Shaqir Fetain do të jetë përjetë vetëm problemi se si të çlirohet prej faktit se ka qenë bashkëpunëtorë i oficerit të UDB-së serbe, prej nga edhe e katapultuan në krye të BFI-së!

4.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike! Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/17.09.2021

Në Myftininë e kapur të Shkupit po rridhka “mjalt e qumësht”?!

Tashmë është dëshmuar katërcipërisht se Myftinia e Shkupit është kapur nga rrencat e matrapzët, të cilët, një jetë të tërë kanë punuar edhe kundër kësaj Myftinie për ta sjellë në dërxhe të jazit që çon ujë në mulli të huaj

Nga Izair Saliu

Këto ditë “drejtuesit” e Myftinisë së Shkupit paskan mbajtur një mbedhje, sa për t’ia përgatitur një terren Shaqir Fetait që ky të ketë mundësi pastaj të vetëlavdërohet se, ja, paska marrur pjesë në mbledhjen e Myftinisë! Do me thënë, të tregohet se sa “proaktiv” është i instaluari nga pushteti aktual në krye të BFI-së, Shaqir Fetai! Që këtu shihet se kjo mbledhje është e pakuptimtë, e paqëllimtë, mbledhje që i dedikohet Shaqir Fetait dhe, bashkarisht të vetëlavdërohen “deri sa të krihet plaka”!

Dhe, ja, që në titull të informacionit shihet se mbledhja e kotë i dedikohet Shaqir Fetait. Në iformacionin e tij thuhet: “Reisul ulema merr pjesë në mbledhjen e Myftinisë së Shkupit! Përpjekje për mashtrim optik, për tallje me opinionin! Shaqir Fetai, nëse i ka thënë vetes “reis” ai duhet ta njohë Kushtetutën dhe ta kuptojë mirë e qartë. Ai ose ndonjë anëtar Rijaseti, e ka detyrim kushtetutar që të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e organeve dhe institucioneve të BFI-së! Pra, kjo është në funksion të punëve ditore, të angazhimeve të tij të domosdoshme. A ka kuptim të informohet se, Shaqir Fetai sot paska falur namazin e sabahit, apo se, sot paska lexuar një ajet kuranor, apo se, sot paska ”realizuar

një takim” me portirin e Medresesë, apo me udhëheqësin e një shërbimi profesional të BFI-së! Jo po, ky së shpejti edhe këto takime si dhe këto veprime ditore fetare do t’i shndërrojë në “informacion” që do të flasin për “angazhimin proaktiv” të tij. Sepse, a mos po di se çka të punojë, si të punojë, si të menaxhojë me BFI-në si Instiucion fetar, si t’i ngrisë dhe si t’i imponojë politikat e larta të BFI-së, si ta avansojë jetën fetare islame, si ta bëjë që të jetë axhendë e faktorëve me relevancë në vend, axhendë e korit diplomatik, e faktorëve ndërkombëtarë! Merr pjesë në një mbledhje dhe eksitohet nga “mjeshtria” e atyreve që dinë, ngjashëm si ai, të çojnë ujë në jazin e mullirit të huaj. Shaqir Fetai do miq në këtë destruktivitet, ka frikë se po ngelë vetë!

Ku konsiston destruktiviteti i duetit Fetai-Ismaili

Qenan Ismaili paska realizuar një mbledhje shumë të suksesshme! Që në titull shihet serioziteti i këtij “organi” që i shërben Shaqir Fetait për vetëkënaqësi! Mbledhjet e rregullta mbahen! Pse “u realizua”?!

Kurse, reston e vetëkënaqësisë Shaqir Fetai ia kthen edhe Qenan Ismailit. Shaqua thotë “shpreh konsideratën për punën dhe angazhimin proaktiv të Myftinisë së Shkupit”! Si more “proaktiv”? Pse a paska edhe “angazhim pronegativ” ë! Nëse ai bazohet në veprimin e tij destruktiv, duke realizuar me sukses tradhëtinë dhe komplotin në BFI, ky po që është “angazhim pronegativ”! E ku e pa Shaqir Fetai “proaktivitetin” e kësaj Myftinie! Ai foli akoma pa u raportuar “aktiviteti periodik” i Myftinisë së Shkupit! Nuk është me rëndësi aktiviteti, i rëndësishëm është momenti “i krijuar” për vetëkënaqësi (masturbim idiotiko-pervers i kësaj dyshe që po llogariten si turpi historik i BFI-së)!

Dhe, pastaj, paska filluar matrapazllëku dhe idiotësiat e Qenan Ismailit! Ai paska raportuar për “aktivitetet dymujore” të “myftnisë” së tij! (Që kur u vendos që Myftinitë të raportojnë në çdo dy muaj? Apo, kështu do të bëhet sa herë që ka nevojë Shaqir Fetai të plasohet si shumë “proaktiv”, duke “realizuar mbledhje të suksesshme”!)

I llogarit si të suksesshme disa “aktivitete”, për të cilat askush nuk e tha një fjalë? “Netët Kulturore Islame”! Ky duhet të jetë projekt mirë i elaboruar dhe jo vetëm një ide e dalur prej bythe dhe, hajde të bëjmë diçka! Projekt i realizuar konsiderohet ai projekt i cili,

tashmë i jep frutat e veta, i cili, tashmë e ka fitbekun e vet, i cili, paraprakisht ka pasur qëllim, ka pasur synim, ka pasur zhvillim, dinamikë, plan akcional, kosto financiare dhe, përfundimisht, përfitimet nga ai projekt! Pa i raportuar këta elementa si guxon të thuash se ka qenë aktivitet i suksesshëm! Vetëm pse është mbajtur a?

Qenan Ismaili, ngjashëm si “prijësi i tij”, Shaqir Feti, i mësuar në vjedhje të aktiviteteve të huaja, mundohet që të sheshë “dushk për gogla”! Si more për brenda aktiviteteve dymujore ia paska arritur që “ta kthejë” Kapan An-i, Bezisteni, dhe objektin e mëparshëm të kinemasë “Napredok”! Nëse janë kthyer këto prona, Qenan Ismaili duhet të pranojë dhe të raportojë se u kthyen disa prona, procesi i decentralizimit të të cilëve ka filluar qysh më vitin 2006, nëse jo edhe më herët! Dikush ka dhënë mund, ka dhënë aktivitet maksimal, dikush është përfshirë nëpër shumë procese gjyqësore duke mbrojtur interesin e vakëfit të BFI-së, dikush ka thyer gishta derisa ka gjetur donacione të ndryshme që janë dashur për shtyerjen e procesit të rikthimit të pronave dhe, tërë ky angazhim epik, në kohën kur Qenan Ismaili e ka luftuar BFI-në si e luftonin të pafetë dhe urrejtësit e islamit! Dikur ka pasur një ekip që kanë punuar natë e diitë për kthimin e këtyre pronave dhe jo se e bëri këtë Qenan Ismaili për “dy muaj! Ky “dikushi”, meritë absolut në shtyerejn e procesve nëpër shumë faza të rënda e me plot ndër-këmbëza, pa dyshim që ka qenë personi i cili publikisht kritikonte krerët e shtetit, ai i cili ne debate i bënte për pesë para dushmanët e vakëfit.

Qenan Ismaili është dashur të raportojë se çka po bëhet me objektin (ish-selinë e Myftinisë së Shkupit, te “Varrezat Franceze”) ku ai e filloi tremujorshin e parë të “myftillëkut” të vet! Çka u bë me këtë vakëf? Pse ai vakëf nuk gjeneron të ardhura me qëllim që ta shtojë vakëfin? Pse nuk flet Qenan Ismaili se, sa është i kënaqur me çmimin e IBNI PAJKO-s dhe, nëse nuk është i kënaqur, çka ka vepruar më tej, deri ku është procesi i rivlerësimit objektiv të kësaj prone të nacionalizuar!

Pse Qenan Ismaili nuk e tha asnjë fjalë për hotelin që deri më tani është dashur të përfundojë te “KOMUNALECI”? Ajo pronë është decentralizuar që më vitin 2013? Çka bëri me këtë vakëf të Myftinisë së Shkupit Qenan Ismaili! Çfarë të hyrash kanë rrjedhur në xhirollogarinë e kësaj Myftinie nga kjo pronë? Kush po fiton nga ajo pronë? Cili është niveli i korrupsionit për këtë pronë, çfarë

krimi antiislam po ushtrohet mbi atë pronë! Këto duhet t'i raportojë Qenan Ismaili dhe jo ta vjedhë angazhimin e huaj, mundin e tjetrit dhe t'i raportojë si "suksese personale"!

Mendjemadhësia vetëm sa ta thyen qafën

Qenan Ismaili, trukxhia dhe matrapazi që me gënjeshtër e dallavere ia mori dekretin H. Sulejman ef. Rexhepit për "Myfti" të Shkupit, duke menduar sigurisht se tashmë është "doktor" dhe i përgatitur për të zhvilluar turli farë "aktiviteti intelektual", paska realizuar edhe një "seminar" të cilin ia paska kushtuar imamëve dhe mualimëve (!!!), më temën "Metodologjia dhe planprogrami mësimor në mektebe"! Si more seminar që u kushtohet imamëve!!! Diçka unikale, e pandodhur më parë, në asnjë cep të botës myslimane! Manipulim flagrant! Sepse, Qenan Ismaili duhet të dijë se asnjë prej "hoxhallarëve" të tij nuk ka kryer Metodikën dhe, si rrjedhojë, nuk mund ta njohin Metodologjinë si shkencë, ndaj dhe, nuk janë të thirrur për të folur për Metodologji! Ky problem duhet t'i shqetësojë akademikët e mirëfilltë, personat pedagogë të rryer, ekspertët e problematikës në fjalë si dhe ekspertët me përvojë në hartimin e planprogrameve mësimore, natyrisht, në bashkëpunim me teologët e mirëfilltë që kanë njohuri esenciale mbi problematikën të cilën Qenan Ismaili e bën turkuzë! Ja edhe një vjedhje perfide e Qenan Ismailit, i cili pa fije turpi raporton në këtë formë: "Me financimin direkt dhe me përkrahjen e donatorëve të saj, Myftinia e Shkupit, kontribuoi me vlerë prej 45.000 €, dhe barti procesin e sigurimit të tokës – vakëf për xhaminë e Hatunxhikut"! Është hipokrizi dhe poshtërsi të thuash se myftinia pagoi sumën ndërkohë që në atë sumë paskan hise donatorë që ka kontribuar, sepse kështu shlyhet borxhi shpirtëror ndaj tyre. Qenan Ismaili është dashur të raportoj për secilin donacion, për secilin donator që kanë dhënë me aq sa kanë pasur mundësi, me qëllim të sigurimit të tokës së Xhamisë së Hatunxhikut! Bëhet fjalë për një segment të raportit me plotë defekt dhe diletantizëm, me plotë hile dhe amatorizëm të skajshëm.

Porta e hapur e mjerimit

Dhe, raportohet edhe ky idiotizëm: “Me përkrahjen e Myftinisë së Shkupit, Pajazit ef. Kadrievskit i mbulohen gjitha shpenzimet në vlerë prej 2000 €, dhe më pas fiton statusin e pensionistit”! Dhe, pastaj, nga ky “sukses” fascionet Shaqir Fetai, i cili, asnjë sekond nuk ka qenë i përqëndruar në këtë mbledhje por, si t’ia bëjë me vetëveten të cilit “bira e miut po i duket 300 grosh”!

Ndërsa kulmi i paftyresisë vjen në pikën ku Qenan Ismaili i raporton si dylber para jargëve të dhelprës dhëmbëthyer, se: “Myftinia e Shkupit, Femi ef. Nuhijut i siguron rrogë mujore në vlerë prej 10.000 den. dhe merr përsipër mbulimi i gjitha shpenzimeve të nevojshme për rregullim e statusit të tij pensional në të ardhmen”! Ku i mori këto para kjo Myftini? Pse t’ia sigurojë një personi rrogën dhe kontributet pensional? Personi nëse punësohet në Myftininë e Shkupit (qoftë si nëpunës apo si imam, mualim, vaiz, hatib etj.) Myftinia e Shkupit ka detyrime ligjore ndaj tij! Është e detyruar t’ia sigurojë rrogën! Çka ka këtu “sukses profesional” për t’u raportuar!

Dhe, fare në fund, shikojeni se si Qenan Ismaili e raporton dështimin flagran si “sukses”: “Kurbani 2021” – këtë vit Myftinisë së Shkupit i’u besuan 1298 kurbana”! Këtë fiasko të turpshme Qenan Ismaili ia shet për sukses Shaqir Fetait, kurse ky krrekoset si gjelëdet! Në tërë territorin e Myftinisë së Shkupit, në të cilën jetojnë mbi 150 mijë familje myslimane, janë dhuruar vetëm 1298 kurbanë? As një për qind?!? Ky është suksezi i ekipit të Qenan Ismailit? Këtë aktivitet e quan Shaqir Fetai si “angazhim proaktiv”? E pra, ky aktivitet, sa për dijeni të Shaqir Fetait, është tërësisht “pronegativ”! Dhe me këtë fakt dëshmohet se, Myftinia e Shkupit është në hall të madh; është në degradim të turpshëm, është në duar të të pamëshirshmëve, është brenda “projektit” për shkatërrim të një prej Myftinive gjigante, që dikur llogaritej si kala me bedene të pathyeshme e Bashkësisë Fetare Islame në RMV! Sot është pasqyrë e hipokrizisë, e dështimeve, e injorancës dhe paaftësisë së Shaqir Fetait! Është portë e hapur e mjerimit!/Lajme7/05.09.2021

Vasaliteti i Shaqir Fetait

Cili është sot autoriteti i BFI-së? Zero autoritet! E humbi që kur u tradhëtua nga Shaqir Fetai, i cili vuri themelet e një praktike shumë të shëmtuar: BFI-ja të merret përmes tradhëtisë, komplotit dhe puçit të ndihmuar nga pushteti të cilit duhet t'i shërbeshë në përmasa të vasalit! A e ka sot BFI identitetin e vet? Le të jetë kjo një enigmë epike për të gjithë hoxhallarët e vendit që nusërojnë para instalacionit të pushtetit antiislamik – para Shaqir Fetait, personit më kontravers në historikun e BFI-së

Nga Shukrane Fida

Ju kujtohet koha kur në një odë me burra e me plotë hoxhallarë, futej një njeri i pushtetit, zakonisht “agjentët e UDB-së”, apo, sot spiunët, sakaq tërë vëmendja kthehej kah spiuni: burrat rrinin para tij në dy gjunj, ndërsa hoxhallarët gjithë sy e veshë e ndiqnin se çka po thotë “njeriu i pushtetit”! Heshtej muhabeti islam, heshtej shpjegimi sipas sheriatit, sipas praktikave të Muhamedit a.s., gjithë vëmendja tek spiuni i UDB-së, i cili, mision e kishte të përhapë frikë dhe disiplinë, dëgjueshmëri e nështrim para pushtetit serbo-komunist, se sa të qante hallet e popullit, apo, të inicone ndonjë të mirë për popullin e ngratë.

Është e njëjta situatë që kur u vendos që “karavanit të hoxhallarëve” t’ju prijë Shaqir Fetai, alias ORAO, nofkë kjo me të cilën e pagëzoi oficeri i UDB-së, Stanko Dragoviqi, qysh kur ishte student në FSHI të Sarajevës! Ndoshta situata sot është edhe më e

rëndë, më poshtuese, situatë që të përbaltosë personalitet e dinjitet! Sepse, tashmë nuk shkon “spiuni” nëpër oda të mbushur me plotë hoxhallarë, por, vetë hoxhallarët shkojnë te spiuni për t’u rrëfyer e nënshtruar. Sepse, dikur, UDB-ja i ngarkonte me këtë detyrë me qëllim që t’i poshtrojë deri në placë. Ndërsa sot vetëposhtrohen sa herë që i buzëqeshin ëmbël Shaqir Fetait, jo në “odën e burrave” por në “zyren e spiunëve”.

Që kur u instalua nga shërbimet e dyshimta Shaqir Fetai në krye të BFI-së, ky Institucion ka humbur zërin e vet, ka humbur guximin e vet për t’i ngritur dhe shpalosur problemet që i ka në raport me pushtetin antiislamist! BFI-ja është shndërruar në “digaster qeveritar” e cila merr frymë sipas sasisë dhe ritmit të diktuar nga “qeveria”! Në asnjë moment nuk ia ka turbulluar ujin, në asnjë moment nuk ia ka ngritur tensionin e gjakut, në asnjë moment nuk është imponuar si faktor relevant i vendit! BFI-ja tashmë është defaktorizuar deri në vasalitet anemik! Shaqir Fetai sot BFI-në e drejton vetëm sipas skemave ditore të pushtetit partiako-politik që e instaoi në krye të BFI-së.

BFI-ja nuk e ngritë më zërin kundër padrejtësive ditore që i bëhen! BFI-ja nuk i bën karshillëk segmenteve të caktuara që ashiqare e ushtrojnë misionin e tyre në depersonalizimin dhe defaktorizimin e BFI-së. BFI-ja sot funksionon sipas mentalitetit të militantëve partiakë, që angazhohen me vetëmohim në të mirë të pushtetit që pastaj i kënaqë duke ua hedhur ndonjë kockë sa për t’ua ndaluar lehtjen!

Pushteti ta paguan për 300 mij euro vakëfin e uzurpuar që realisht kushton mbi 3-4 milion euro, kurse BFI-ja gëg me goj nuk bën, sepse hidhërohet pushteti.

Pushteti ia mundëson njeriut të vet që ta rrëmbejë pronën e BFI-së dhe aty të ngrisë biznesin e vet, kurse BFI-ja nuk guxon të protesojë, sepse hidhërohet pushteti!

Pushteti të lejon që me paratë e tua të ndërtoshë sa të duash xhami nëpër vendbanime me shumicë myslimane, por nuk të lejon që të kërkoshë të ndërtohet Xhamia e Prilepit, e djegur dhe e shndërruar në WC publike. Nuk guxon të kërkoshë as që ta rrethoshë e ta shpëtosh nga fëlliqësitë e pisave, sepse menjëherë hidhërohet pushteti!

Cili pushtet? Ky që ka frikë nga një grup individësh të cilët mund të rrebelohen nëse e rindërtojmë xhaminë, kurse palla nuk i ha për revoltën e myslimnëve, sepse, realisht nuk ka revoltë dhe as që

mund të ketë me Shaqir Fetain dhe strukturat e tij që e përkrahin në mercenarizëm përkrah segmenteve të pushtetit që kanë për detyrë defaktorizimin e tërësishëm të BFI-së.

Cilit pushtet i shërben Shaqir Fetai? Këtij që toleron uzurpimin e Xhamisë në Shtip dhe shndërrimin e saj në kishë, derisa Shaqir Fetai hesht, sepse mund të hidhërohet pushteti i cili e instaloi në krye të BFI-së!

Për çka e instaloi? Për dëgjueshmëri dhe vasalitet, sidomos gjatë fushatave parazgjedhore për zgjedhjet lokale apo parlamentare! Shaqir Fetai nuk është për interesa të popullatës, apo për interesa të hoxhallarëve, por, ekskluzivisht për interesa të pushtetit, ndaj të cilit, i zënë si peng, i ka shumë borxhe!

Shaqir Fetai është në hipotekë tek segmente të caktuara të pushtetit politik aktual.

Shaqir Fetai manipulon me hoxhallarët, të cilëve, si duket u vie lezet nga ky manipulim! Shumë shpejt do t'u vie turp që të mbajnë edhe shallin në krye, ngase i kanë shërbyer me përkorë një njeriu që tërë atë nderë e respekt ua ka falur qarqeve dhe segmenteve të caktuara që mision e kanë depersonalizimin e hoxhallarëve si dhe defaktorizimin e Institucionit fetar islam në RMV dhe, mundësisht, edhe më gjërë në Ballkan. Nëpër këtë skenar bredh Shaqir Fetai!/1KlikLarg/07.09.2021

Fundi i epokës së BFI-së si zgjatim i fundit i Rilindjes Kombëtare

Vdekja e BFI-së si zgjatim i Rilindjes Kombëtare dhe, instalimi i strukturave të UDB-së në krye të saj, nuk mund të kuptohet sot për sot, por ama, më së voni pas pesë viteve (sa zgjasin “planet afatmesme”) do të kuptohet shumë qartë. Atëherë, mjerisht, Shaqir Fetai me bashkëpunëtorët e vet do të zvetënohen të shtrydhur, ngjashëm si limoni i shtrydhur që hidhet në pleh

Nga Shpëtim Piraku

Që nga shkatërrimi i Perandorisë Osmane e këndej, myslimanët e viseve ballkanike, sidomos populli shqiptar, ka qenë në përpjekje të vazhdueshme për t'i themeluar institucionet nacionale e shtetërore. Të gjithë strukturat, të gjithë profilet e shoqërisë shqiptare, kanë qenë në bashkërendim të veprimtarive kombëtare. Në këtë vazhdë edhe struktura teologjike ka qenë në po të njëjtën vijë dhe, hera-herës edhe i ka prirë proceseve. Varësisht nga strategjitë e armikut për ta stegmentarizuar veprimtarinë patriotike të shqiptarëve, varësisht përpjekjeve të tyre për ta dobësuar një hallkë të kësaj veprimtarie, ashtu edhe janë kundërpërgjigjur strukturat tona, sidomos hoxhallarët që kanë pasur një aktivitet më të ngjeshur dhe më të përditshëm me xhematin i cili, kryesisht ka qenë i etnisë shqiptare. Prandaj, sot, historia njeh me qindra emra të hoxhallarëve të dikurshëm të cilët e bënë të pamundshmen për komb e atdhe. Po ata ishin fetarë? Po, por, duhej atdheu për ta praktikuar dhe zhvilluar fenë (fetë që i

praktikojnë shqiptarët)! Ata që hoqën dorë nga angazhimi kombëtar për ta ndihmuar kombin dhe atdheun, ata sot janë fetarë të devotshëm por, fatkeqësisht të asimiluar. Me qindra mijëra shqiptar ortodoksë nga Beogradi e deri në kufiijtë e në Vranjë u asimiluan, po ashtu edhe shqiptarë myslimanë që ngelën nën pushtimin serb në zonën e Sanxhakut, me qindra mijëra shqiptarë ortodoks të Greqisë, Maqedonisë, u asimiluan në grekë e maqedonasë. Me miliona shqiptarë të shpërngulur në Turqi sot, ndonëse me vetëdije kombëtare, janë asimiluar. Roli i hoxhallarëve, por edhe i priftërinjëve shiptarë, në diasporën e sotshme është shumë i madh në aspekt të ndërëgjegjësimit kombëtar të fëmijëve, të të rinjëve. Aty feja mësohet shqip dhe, me këtë, shtohet edhe përkujdesi dhe dashuria ndaj gjuhës shqipe, ndaj shiptarizms. Një shqiptarë i mirë është një dobi më shumë për atdheun dhe kombin, një shqiptar i mirë dhe fetarisht i devotshëm, është mburojë e atdheut dhe kombit.

Në këtë filozofi racionale duhet të kërkohet arsyeja e angazhimit dhe impenjimit të teologëve të dikurshëm shqiptarë në lëvizjet dhe në proceset kombëtare.

Institucioni i Bashkësisë Fetare Islame ishte një prej çerdheve ku kultivohej dhe zhvillohej edhe shqiptarizmi! Kush iu kundërvye politikave gjenocidale dhe planeve çubrilloviqiane për shpërngulje e shqiptarëv për në Turqi? Ishin ata, hoxhallarët, përgjithësisht teologët shqiptarë, që haptazi iu kundërvyen kësaj strategjie të spastrimit etnik, duke apeluar gjithnjë e më fuqishëm që mos të braktiset atdheu, mos të iket për në Turqi! Udhëhqësia e atëhershme e Bashkësisë Fetare Islmame, në veçanti ajo e Shkupit, ishte fole e aktiviteteve kombëtare. Kjo shihet sidomos në raportin e vitit 1937-1940, të hartuar nga komisioni i BFI-së së Shkupit e të udhëhequr nga Hafëz Bedri ef. Hamidi, i cili, nën udhëqejën e Sherif Langut, kishte qenë edhe sekretar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Fryma e Rilindjes Kombëtare ndër komunitetin e teologëve myslimanë shqiptarë nuk pushoi deri te Rilindasi i fundit, H. Sulejman ef. Rexhepi.

Faktet historike, informacionet e bollshme, veprat, CV-ja epike e tij, rrëfimet mbi të bëmat e tij heroike, dëshmojnë se Sulejman ef. Rexhepi e mbajti të gjallë deri në pikë të fundit atë filozofi që thotë se, kur të lëngojë populli dhe atdheu, të gjitha strukturat, të gjitha kapacitetet kombëtare duhet të aktivizohen për ta shëruar popullin

dhe atdheun. Nuk bën asnjë para praktikim i fesë në një atdhe që lëngon, nga një popull që është në proces të degradimit kombëtar! Sulejman Rexhepi ishte “problematiku” më i gjallë dhe më transparent në luftën e BFI-së për mbrojtjen dhe avansimin e shqiptarizëms. Nëse këtu do t’i shpalosnim të gjitha aktivitetet e tij në këtë drejtim, do të duhej një tekst i përmasave për doktoranturë (sugjerohet të lexohet, të paktën, CV-ja e tij.)

I vetmi moment të cilin H. Sulejman ef. Rexhepi e neglizhoi dhe nuk e lexoi si duhet, ishte pajtimi i tij që të etablohen fort elementët e depërtuar në BFI e që ishin tërësisht në shërbim të strukturave të ndryshme inteligjente. Nuk e kuptoi se po i luhej loja e komprometit të tij dhe e kapjes së BFI-së nga duart armiqësisht të forcuara. Sikur ta bënte atë reformë të kërkuar me ngulm nga “opozita” e tij, do ta ruante kontinuitetin e frymës së Rilindjes Kombëtare, do ta çlironte BFI-në nga armiqtë e saj të ishtaluar nga lloj-lloj shërbimesh antifetare e antikombëtare dhe, Institucionin e vetëm fetar Islam do ta bënte kockë të fortë para çfarëdo strategjie e plani anti-BFI!

Fatkeqësisht, me H. Sulejman ef. Rexhepin mori fund epoka e BFI-së e cila, tërë kohës nga mediat dhe propaganda nacionaliste maqedonase është vlerësuar politikisht si “çerdhe e nacionalizmit shqiptar”!

Hijenat e etabluar brenda BFI-së e që me dekada rrinin te prapanica e H. Sulejman ef. Rexhepit, ia luajtën lojën dhe, e shkarkuan. Shkarkimi u mundësua me përkrahjen e padiskutueshme të pushtetit maqedonas, respektivisht, të segmenteve të caktuar të pushtetit, të cilët dekada me radhë ishin angazhuar për këtë situatë të BFI-së së degraduar e të poshtëruar. Për herë të parë ndodhë që nga kabineti i reisit, të dalë “lideri” dh bashkë me komandantin e “brantellave” t’i dënojë “brohoritjet nationalist”: “UÇK-UÇK”, “Rroftë Ilirida” etj.

Pra, BFI-ja, tashmë “nën drejtimin” e Shaqir Fetait, instalacionit të pushtetit maqedonas, i ka marrur të gjitha tiparet e një filiale të segmenteve të caktuara antiislame, filiale kjo që nuk merr as frymë pa lejen e këtyre segmenteve!

Shaqir Fetai, me gjasë, akoma nuk është i vetëdëshëm për dëmin jashtëzakonisht të madh që ia ka shkaktur BFI-së, këtij Institucioni fetar e kombëtar! Tashmë pushteti maqedonas nuk e ka atë kujdestarin permanent për ta goditur sa herë që ia mendonte të keqen këtij Institucioni por edhe, sa herë që

mendonte ta mohojë ekzistimin e çështjes shqiptare në Maqedonë e Veriut. Shaqir Fetai tashmë është shndërruar në nuse të përhershme që është në pritje të lloj-lloj dhëndurve, me kostume të prerë e të qepur nga pushteti. Atij i ka ngelur fustani i bardhë i nusërisë në duar, është urdhëruar të jetë i disiplinua, i dëgjueshm, “posllushnik”, ndryshe, mund të ndërrohet me “bashksitë fetare islame” të regjistruara së fundmi, me pëlqimin e tij, akt ky që shënon fundin e BFI-së shumë shekullore.

Vdekja e BFI-së si zgjatim i Rilindjes Kombëtare dhe, instalimi i strukturave të UDB-së në krye të saj, nuk mund të kuptohet sot për sot, por ama, më së voni pas pesë viteve (sa zgjasin “planet afatmesme”) do të kuptohet shumë qartë. Atëherë, mjerisht, Shaqir Fetai me bashkëpunëtorët e vet do të zvetënohen të shtrydhur, ngjashëm si limoni i shtrydhur që hidhet në pleh./Kombetare/09.09.2021

A ka sy opizita shqiptare në Maqedoninë e Veriut?

Opozita shqiptare-myslimane nëse nuk denjon që ta ketë në fokusin e vet edhe depolitizimin e BFI-së dhe shpëtimin e saj nga “demonët partiakë”, pastaj, pas zgjedhjeve, nuk do t’i ketë hije t’i akuzojë e t’i shajë hoxhallarrët se e ndihmuan akcilën parti për të fituar

Nga Mr.Eset Shaqiri

Këto ditë, u fol e u përfol gjithandej, në media e në oda, në xhami e nëpër çajtoje, sjellja e Shaqir Fetait e cila, këtë farë “teologu” të diskutueshëm e ka shpërfytyruar në një kallëp të vasalit! Bëhet fjalë për vetëhedhjen e tij në aventurë partiake si dhe të pushtetit që t’i japë sa më shumë zor për ta paraqitur rastin e Spitalit Modular të Tetovës (që gëlltiti në flaka 14 persona që i kishin besuar spitalit për shërim nga Kovid 19), si ngjarje tragjike në të cilën “ka gisht” Zoti! Meqë “të Zotit jemi dhe tek Ai do të kthehemi”, Shaqir Fetai, përmes kësaj të Vërtete Absolute, përpiquej që ta ulë interesin si të familjarëve po ashtu edhe të institucioneve dhe hetuesisë për ta hetuar rastin dhe për të gjetur se mbi kë bie përgjegjësia për këtë tragjedi të rëndë.

Natyrisht që, në këtë rast, Shaqir Fetai u pëdor, (apo edhe u imponua të përdoret) vetëm si vegël e partive të cilët e ndihmuan në tradhëtinë dhe komplotin mbi BFI-në me qëllim të kapjes së këtij Institucioni fetar islam nga duart e politikës që më se tri dekada përpiqen ta uzurpojnë dhe politikisht të ndikojnë mbi këtë

Institucion!

Pra, u fol e u përfol për “fenomenin Shaqir Fetai” edhe atëherë kur ky “teolog” i diskutueshëm pranoi që të shndërrohet në vegël publike të të interesuarve për ta dëmtuar deri në palcë trungun e unitetit si dhe integritetin e të vetmin Institucion fetar islam në vend!

Me të madhe po flitet, madje edhe nëpër xhami se, shumë imamëve u ofrohet “strategjia e Shaqir Fetait” për t’u kyçur në fushatë parazgjedhore si dhe për të bindur e siguruar sa më shumë xhemat që të votojnë parti të caktuara!

Askush nuk ka asgjë kundër bashkëpunimeve. Gjithësesi që edhe Bashkësia Fetare Islame duhet të zhvillojë bashkëpunim konstruktiv me të gjithë partitë politike që ia duan të mirën dhe që ia mbrojnë interesin këtij Institucioni. Por, Shaqir Fetai nuk është interes i BFI-së!

Bashkëpunimi i BFI-së me faktorë relevantë është etik për shoqërinë tonë, sepse ky Institucion ka punuar dhe gjithnjë ka shprehur interesim për një bashkëjetesë, për mirëqenie dhe për harmoni ndërjetare e ndërnacionale!

Në asnjë moment në historinë e BFI-së ky Institucion nuk na del të jetë nënshtruar, të ketë vepruar nën diktatet partiake apo ideologjike! Mjerisht, sot kemi një BFI që po degradohet nga Shaqir Fetai deri në një vegël vasale e kolaboracioniste!

Imamët janë nën trysni të hatashme, nga ata po kërkohet që, ose të agjitojnë për partitë në pushtet të cilët ngritën një “riaset” vasal, ose, në të kundërtën, do të rrënohet ky “riaset” dhe brenda do të futen “arushat” që do t’ju shqepin!

Me këto fakte, tërë blloku opozitar është i njohtuar, sidomos opozita shqiptare, e cila, deri më sot po heshtë para kësaj të vërtete duke demonstruar një dorëzim total para “uraganit” që do t’i sjellë fitore bindëse pushtetit aktual.

BFI-së nuk duhet t’i interesojë se kush do të fitojë! Le të fitojnë ata që e bindin elektroatin me program më të mirë për mbarë shoqërinë. Por ama, këtë fitore nuk duhet ta synojnë përmes Institucionit fetar, BFI-së, sepse, një ditë duhet të japë llogari gjithësecili që ka lejuar dhe ka punuar për politizimin kaq të madh të Bashkësisë Fetare Islame. Sot BFI-ja përceptohet si “filiale gjigante” e pushtetit!

Edhe heshtja e opozitës do të llogaritet si kontribuese në këtë politizim të skajshëm! Situata mund të dalë nga kontrolli dhe, për

rrjedhojë, të kemi pasoja të parikuperueshme për një kohë të gjatë. Nëse do të lejohet partizimi dhe politizimi i BFI-së, të kota do të jenë pastaj të gjitha përpjekjet për ruajtjen e trekonfesionalitetit, si vlerë e kësaj shoqërie, të kota do të jenë angazhimet e shoqërisë për ruajtjen e harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfaqetare.

Opozita shqiptare-myslimane nëse nuk denjon që ta ketë në fokusin e vet edhe depolitizimin e BFI-së dhe shpëtimin e saj nga “demonët partiakë”, pastaj, pas zgjedhjeve, nuk do t’i ketë hije t’i akuzojë e t’i shajë hoxhallarët se e ndihmuan akcilen parti për të fituar! Do të ishte një hipokrizi nga rdhët e opozitës nëse do të mallkonte e do të kritikonte hoxhallarrë, të cilët, paraparakish u lanë nën kthetra të politikës, të dekurajuar, të pambrojtur e të papërkrahur në misionin e tyre të vetëm – në zhvillimin e jetës fetare islame në vend!

Me gjasë, të gjithë, përveç opozitës shqiptare (nëse ekziston kjo opozitë!) e kanë më se të qartë se, Shaqir Fetai aktualisht është vetëm një “put” para të cilit përkulen administrata e tij komplotiste e ngarkuar me peshën e fajësisë dhe joshjeve partiake! Sot, po vegjetojnë disa “telogë” të trimëruar me bluza propagandistike të afishuara: më mirë me pushtetin dhe për pushtetin i cili, në çdo moment, mund të të bëjë “reis” si Shaqir Fetain!

Opozita shqiptare dhe, tërë ajo e bllokut mysliiman, duhet të ndihmojë në çrrënjosjen e kësaj logjike të pistë! Opozita këtë angazhim duhet ta kuptojë si detyrë kombëtare dhe fetare!/BotaPress/14.09.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (14)

Sa herë që flet Shaqir Fetai e dëshmon papjekurinë e vet, injorancën e vet dhe dëshmon se është i perealizueshëm përgjatë këtyre viteve, si në familje ashtu edhe në karrierë. Se si ka qenë si nxënës i oficerit të UDB-së, Stanko Draoviqit, i përmbushur apo “i zbrazët”, kjo po hulumtohet dhe shumë shpejt do të tronditet opinioni nga të bëmat e Shaqir Fetait nën siglën “hafëz” e me pseudnim policor “ORAO”

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

Shaqir Fetai, instalacioni i pushtetit maqedonas në krye të BFI-së, paska qenë këto ditë në Kroaci, i shoqëruar me tërë “administratën” e tij prej servilëve të pushtetit. Siç na foli dhe na tregoi Shaqir Fetai “Ndër synimet kryesore të vizitës së delegacionit të BFI e RMV ishte vizita Ambasadës së RMV dhe Ambasadorit të ri Prof. Dr. Milaim Fetahut...”

Shaqir Fetai, keqprdorë financat e BFI-së, tallet me fitrin dhe zeqatin, duke pasur si ndër qëllimet kryesore vizitën e Ambasadës së Maqedonisë së Veriut në Kroaci! Se çka i hy në xhep e çka i sjell kjo vizitë BFI-së, për ç’gjë edhe ia “vlenë” të shpenzohen e të keqpërdoren fitri e zeqati, këtë e di vetëm Shaqir zeza! Ambasadori Fetahu është kushëri i afërt me Shaqir Fetain dhe, për këtë periudhë që kur u instalua nga pushteti maqedonas në krye

të BFI-së, janë takuar “zyrtarisht” nja 3-4 herë! Dhe, sa herë që takohen, Shaqir Fetai e dekoron, i jep mirënjohje, e lavdëron, e miklon ambasadorin duke e ngritur në qiell, thuase kanë vdekur të gjithë ata që e njohin, që nga banka shkollore e deri në “doktoraturë”!

Paramendoni, sikur një kushëri i Stevo Pendarovskit ta takojë atë dhe, pastaj të publikojë një fotografi e të lavdërohet se e paska pritur Presidenti i Maqedonisë së Veriut! Kjo nuk i bën vaki as debillit më të madh në vend, me përjashtim Shaqir Fetait! Vizitat ndërfamiljare, shkuarja te njëri-tjetri, darkat dhe ndejat e përbashkëta, zhvillohen, pa dyshim, edhe në mes të funksionarëve e personlitateve të larta shtetërore. Por, në asnjë rast, për më të madhin kijamet nuk keqpërdoren ato, nuk shënohen, nuk publikohen, sepse janë çështje private, familjare, emocionale! Shaqir Fetai, sa herë që dëshiron që të fryhet pak si gjeldet, sakaq, ose e pret ose i shkon për vizitë ambasadorit kushëri. Madje kemi raste kur ka “informuar” se, “sonte mysafir në shtëpi e pata ambasadorin, përndryshe familjarin tim, Milaim Fetahun! Sa i përket “dekorimeve” dhe mirënjohjeve të cilat Shaqir Fetai i ndanë sikur të ishin llokuma të tepruara pas varrimit, ky farë “reisi” i S. Dragoviqi duhet të dijë se ato kushtojnë, se shpenzimet nuk janë të papërfillshme! Shaqir Fetai duhet të dijë se BFI nuk ka kurrfarë rregulore që parasheh kritere të qarta se kush mund të dekorohet, kush mund të falënderohet me ndonjë mirënjohje, kush e jep, kur jepet, dhe cilat janë motivacionet e këtyre gjesteve njerëzore! Prandaj, ndryshmet që do të bëhen në BFI, struktura e re që do të vie pas këtyre banditëve, punën e parë gjatë reformave që duhet të bëhen, duhet të jetë shpallja “nult” e këtyre dekoratave e mirënjohjeve dhe tërheqja e të gjitha atyreve që u janë dhuruar turlifarë njeriu dhe pa kurrfarë kriteri, përfshirë këtu dhe Milaim Fetahun, sepse, kontributi i tij për BFI-në është ZERO, siç është zero edhe “kotributi” i Shaqir Fetait pas tradhëtisë dhe komplotit që e zhvilloi në BFI.

2.

Shaqir Fetai, ky kiç-instalacion nga pushteti maqedonas në krye të BFI-së, thotë: “Sot është 28 Shtatori Dita ndërkombëtare e kombit

boshnjak. Uroj për zemërsisht këtë ditë të madhe duke uruar ngritje në të gjitha sferat për një ardhmëri më të ndritshme dhe më të lumtur. Zoti i bekoft!” Shumë mirë! Çka ka këtu Shaqir Fetai të përcjellë mesazhe politike! Kur i ka uruar Boshnjakët me rastin e ndonjë feste fetare, siç i ka hije një “reisi”!

Nga ana tjetër, Shaqir Fetai a mund të na e gjejë një urim të kryetarëve të tyre apo të myftilerëve boshnjakë që ua kanë uruar Shqiptarëve festat e tyre kombëtare!

Çka ka Shaqir Fetai që përjaget kaq shumë? Jo bre, nuk është dosja e tij si bashkëpunëtor i UDB-së sa ka studiuar në fakultetin boshnjak, në duart e boshnjakëve por, le ta kërkojë në arkivin e ish-Jugosllavisë, si dhe në arkivin slloven!

Shaqir Fetai, meqë e ka shumë të qartë, meqë e beson (!) si Zotin një se, ka probleme me identitetin e vet kombëtar, gjenë mënyra për t’u paraqitur, të paktën, si multikulturalist! Ai që ka problem me të qenurit kombëtar, ai vetëmsa mund të jetë i asimiluar, i arratisur nga identiteti i vet për të cilin duhet të përkujdeset natë e ditë, madje secili shqiptar (përrjashto këtu udbashët!)

3.

Shaqir Fetai sot e paska pritur Drejtorin e Komisionit për marrëdhënie me bashkësitë fetare dhe grupet religjioze, z. Darijan Sotirovski, me të cilin paska bashkëbiseduar lidhur me Ligjin për Kishën dhe bashkësitë fetare si dhe për akreditimin e Medreses si dhe për “dhjetra” medresantë që po pritkan para dyerve të fakulteteve publike!

Shaqir Fetai flet me një zyrtar shtetëror lidhur me Medresenë, kurse në takim mungon drejtori i sektorit për çështje fetaro-arsimore, mungon drejtori i Medresesë, mungon përfaqësuesi i stafit arsimor si dhe përfaqësues të medresantëve nga Medresja Isa Beu!

Shaqir Fetait nuk i bëjnë punët, sepse po del që paskësh qenë gënjeshtar i paskrupullt, i cili me gënjeshtër e me mashtrime është munduar të blejë paqe ndër organet e BFI-së, ndër studentët dhe medresantët!

Pse e hedh problemin te drejtori i Komisionit për marrëdhënie ndërfetare? Ç’lidhje ka ky problem me këtë drejtor? Për shtatëqind

mij bajrama ky farë drejtori nuk mund ta zgjidhë problemin e Medresesë, sepse, as nuk është kompetent dhe as që i intereson ky problem!

Pse Shaqir Fetai nuk i mbledh ministrat e BDI-së që vegjetojnë në qeverinë e Zoran Zaevit, i cili prononcohet për këtë problem duke thënë se, ndonëse është shumë i vjetër, tash e pesë vite po mundohemi të gjejmë modalitete dhe ta harmonizojmë ligjin e nevojshëm me sistemin sekular të shtetit!!! Jo more, problem i madh qenka. Paskan kaluar pesë vite dhe hala nuk e paskan gjetur atë harmonizim!

Medresja nuk akreditohet pa një takim përfundimtar të Zoran Zaevit, Ali Ahmetit, ministrit të financave, ministrit të drejtësisë dhe ministrit të arsimit! Këta janë ata që do ta zbusnin zemërimin e medresantëve dhe të prindërve të tyre që po protestojnë dhe që do të protestojnë, që do ta sillnin vendimin për akreditimin e Medresesë dhe për hapjen e fakulteteve edhe për medresantët tanë! Nëse këta nxënës nuk qenkan të denjë për fakultetet publike, atëherë, pse nuk merren masat kundër manipulatorëve dhe keqpërdorusve të cilët prodhojnë “kuadro të panevojshëm”, përse nuk i mbyllin shkollat fetare! Apo, mbase u konvenon të krijohen stogje nxënësish të cilët do të duhej të shpërthenin kundër vetëvetes!

Kurrë në historikun e BFI-së nuk ka pasur protesta të nxënësve kundër BFI-së! A nuk është ky shpërthim kundër vetëvetes. Apo, Shaqir Fetai mendon se tjetër gjë është Medresja e tjetër gjë BFI-ja! Me hedhjen e problemit të Medresesë në Drejtorinë e Sotirovskit, Shaqir Fetai dëshmon se, as që ka ndërmend të ndërmarrë diçka për tejkalimin e këtij problemi jetik për medresantët tanë. Shaqir Fetai nuk do përgjegjësi, ndërsa e do kolltukun për ta ulur bythën aty, mundësisht të përforcuar në ndonjë kunj.

4.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e

muslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as muslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/29.09.2021

Shaqir Fetai shumë shpejt do të përjashtohet nga “skenari”

A mundet që prezenca në xhemat e një grupi të hajnave, të tradhëtarëve, të rrencave, të pisave, të shitet si miratim dhe si gëzim i masës për këtë lloj uniteti që e “pasqyrojnë” kjo kategori më e poshtër e shoqërisë

Nga Nagip Selmani

Janë të kota përpjekjet partiake por edhe të shërbimeve sekrete që e kanë instaluar Shaqir Fetain në krye të BFI-së që ta paraqesin si “lider”, si “udhëheqës që i pritë delegacioneve të Rijasetit”, si “unifikus” i shqiptarëve, sepse, pa fije dyshimi, Shaqir Fetai mund të llogaritet vetëm si një “put prej druri”, para të cilit rrejtshëm përulen një grup administratorësh të tij “fetaro-politik”!

Grupimi i Shaqir Fetait, me bashkëmendimtarët e vet në tradhëti e në komplot, në vjedhje e në spiunim, nuk mund të pretendojë se përfaqëson unitetin, se reflekton unitetin e hoxhallarëve të vendit. Hoxhallarët e vendit, kurrë nuk mund të pajtohen që të prihen prej një pisi, më sa që u pajtuan ndonjëherë devet që të prihen prej gomarit!

Hoxhallarët nuk reagojnë kundër ëndërrave të pista të Shaqir Fetait, sepse, ata nuk ndjehen fajtor për instalimin e tij në krye të BFI-së! Nuk është faj i hoxhallarëve të vendit se Shaqir Fetai ushtroi tradhëti e komplot mbi BFI-në, sepse ata as nuk e zgjodhën dhe as nuk e përkrahën. Thjesht, hoxhallarët e vendit Shaqir Fetain e shohin si një copë mishi të kalbur, të cilin në

“trajtë njeriu” e instaluan në krye të BFI-së shërbime sekrete antishqiptare e antimyslimane si dhe partitë nga i njëjti brum që përbëjnë “masën” e pushtetit aktual.

Hoxhallarët Shaqir Fetait nuk e përceptojnë si lider për të cilin duhet të angazhohen, të brengosen, ta mbrojnë, apo ta përkrahin! Hoxhallarët kanë mision që t’i shërbejnë xhematit gjegjës dhe vetëm atyre t’u japin llogari!

A është parë ndonjë hoxhë që t’i dalë në mbrojtje Shaqir Fetait!!! Cili hoxhë ka shpehur bindje të plotë se Shaqir Fetait kurrë nuk ka qenë nxënës i oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviqit!

Hoxhallarët nuk kanë punë as me pushtetin, as me udbashët, hoxhallarët ruhen si nga pushteti ashtu edhe nga udbashët, gjithnjë duke pasur kujdes që të jenë sa më të dashur dhe sa më të afërt me xhematin e vet.

Bredhja spiuneske e Shaqir Fetait nga një “rast” në tjetrin “rast”, duke u shoqëruar nga anëtarë të rijasetit të vet, nuk do të thotë se kjo është forma e dëshmisë së “unitetit”, sepse nëse ka “unitet” aty ai është vetëm “uniteti i hajnisë”, “uniteti i spiunazhit”, “uniteti i marionetave partiake”, “uniteti i tradhëtarve” që demonstrojnë fuqinë e komplotit dhe shpejtësinë e nguljes së thikës pas shpine! Nuk ka as aty “unitet të sinqertë”, në mes të “bashkëshoqëruesve të Shaqir Fetait në rrugëtimin e shndërrimit të BFI-së në vegël politiko-partiake”! Cili prej tyre deri më sot “shprehu dhembje” për reisin e tyre tashmë të lakuriqësuar deri në palc e në shpirt?! Kujt i ha palla se kush është Shaqir Fetait? Thjesht, ata nuk guxojnë të mungojnë aty ku është Shaqir Fetait, sepse – çkuptim do të kishte “kundërzbulimi”! Ata duhet të raportojnë diku për besnikrinë dhe sinqeritetin e Shaqir Fetait karshi “shërbimeve sekrete” që e katapultuan nga bashkëpunëtor i UDB-së në “reis”!

Mosreagimi i hoxhallarëve kundër përpjekjes së pushtetit që përmes Shaqir Fetait ta vë nën kontrollin absolut BFI-në, flet për mungesën e gatishmërisë së hoxhallarëve për t’u konfrontuar me pushtetin, sepse, sakaq do të fillojnë stigmatizimet dhe etiketimet politike të hoxhallarëve. Këtë e dëshiron dhe e pret Shaqir Fetait, por, këtë dëshirë kurrë nuk do t’ia plotësojnë hoxhallarët.

Hoxhallarët janë shumë të vetëdëshëm për lojën e ndyrë të Shaqir Fetait por edhe për ndjeshmërinë e çështjeve kombëtare që dikush përpiqet që t’u japë konotacion të ekstremizmit fetar! Rreth kësaj ndjeshmërie hoxhallarët e vendit janë unikë dhe, pa dyshim, të pamanipulueshëm. Prandaj, shumë shpejt, nga ky skenar i

shërbimeve sekrete do të përjashtohet Shaqir Fetai, si i paaftë për të shkaktuar veprime që do ta degjenerojnë çdo çështje kombëtare të Shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut./1KlikLarg/17.09.2021

Virtytet

Çka mund të presë njeriu prej një njeriu të pavirtytshëm si Shaqir Fetai! Asgjë më shumë se sa lojëra të pandershme e të pista! Në çdo segment të jetës ai mund të jetë vetëm tip i rrezikshëm, planprishës, devaluës e degradues i projekteve kombëtare e fetare. Prapa tij mund të qëndrojnë vetëm skuthët

Nga Petrit Rexhepi

Virtytet janë veti të çmueshme të një karakteri të mirë. Janë prirje dhe aftësi e një njeriu për të kryer një veprim të caktuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Shkenca e etikës i njeh pesë virtyte të një njeriu të mirë: a) urtësia, b) drejtësia, c) guximi, d) matura, e) morali!

Cilët nga këto virtyte mund të hasen te Shaqir Fetai, instalacioni i dhunshëm i pushtetit maqedonas në krye të BFI-së? Asnjë! Sepse, një njeri nuk mund të bëhet bashkëpunëtorë i shërbimeve sekrete të huaja, i UDB-së, nuk mund të tradhëtojë mikun, nuk mund të shesë interesin e përgjithshëm për makuteritë personale, pa përjetuar fillimisht një mutacion të gjeneve që janë shtylla vertikale të këtyre virtyteve. Kur shkaktohet ky degjenerim, atëherë nuk mund të flitet për një njeri të mirë, por për një qenie me aftësi dhe instikt dhelpreje të plagosur.

– a) Urtësia – ç’urtësi reflekton Shaqir Fetai, përpos “urtësinë” e një skuthi. Urtësia apo pjekuria e tij mund të shpjegohet me konstatimin brilant të ish-myftiut të Kërçovës, rahmetliut, H.

Murat Hyseini, i cili për këtë biçim hafëzi thoshte: “Shaqir Fetai është një pubertetli, një axhami i përjetshëm”!

– b) Drejtësia – sjellja e tij e fundit, kur vendosi që të tradhëtojë e të kryej komplot në BFI me qëllim që të krijojë terren për ta instaluar në krye pushteti aktual maqedonas, dëshmoi se kemi të bëjmë me një person i cili drejtësinë nuk e duron dot. Ndaj dhe, për ta ndihmuar pushtetin aktual maqedonas që ta instalojnë njeriun e tyre në krye të BFI-së, marshoi “si budalla” mbi të gjitha aktet dhe normat juridike të BFI-së por edhe mbi të drejtën që buron nga mësimet islame.

– c) Guximi – a pati guxim Shaqir Fetai që ndodnjëherë t’i thotë “babait të vet shpirtëror” në sy se, këtu dhe këtu po gabon, je në gabim! A pati guxim ndonjëherë Shaqir Fetai t’i bashkangjitet opozitës që po kritikonte punët në BFI? A pati guxim Shaqir Fetai që të paraljamërojë apo të kërkojë dorëheqjen e ish-reisul ulemasë së BFI-së? A pati guxim Shaqir Fetai që të zhvillojë fillimisht një debat të brendshëm fushatë kundër ish-kreut të BFI-së dhe pastaj të ftojë një mbledhje urgjente në selinë e Rijasetit (jo zyreve te shërbimeve sekrete në Gostivar) për ta kërkuar shkarkimin e ish-reisit? A pati guxim intelektual e burrëri që dukuritë negative në BFI t’i luftojë publikisht? Ky “guxim” i erdhi vetëm kur e ndërseu dhe turri pushteti maqedonas dhe kur i premtuan shërbimet sekrete se do t’i qëndrojnë prapa!

d-) Maturia – me një maturi prej debilli flet për ish-reisul ulemanë në një prononcim për një dokumentar kushtuar reisit historik të BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepit! Madje fill një javë para se të futej vullnetarisht në skemat e shërbimeve sekrete për ta degraduar BFI-në deri në një filiale të parëndësishme të pushtetit maqedonas.

– e) Morali – spiunët dhe tradhëtarët janë njerëz më të pamoralshëm që mund të ekzistojnë në fytyrë të tokës. Bëhet fjalë për ata tradhëtarë dhe spiunë që dëmtojnë interesin kombëtar e fetar. Një “hafëz” që pranon t’i bëhet nxënës oficerit të UDB-së (Stanko Dragoviqit), një i degjeneruar që pranon t’i bëhet bashkëpunëtorë oficerit më famkeq të UDB-së në rajonin e Pellagonisë, Temellko Boshkovskit, ekspertit në “gjuajtjen” e “nacionalizmit dhe seperatizmit shqiptar”; nje njeri që e tradhëton liderin e vet të cilit “me besnikëri” i ka shërbyer për 30 vite me

radhë, që i thurrë komplot me qëllim që t'ia vjedhë postin – ky njeri të jetë i moralshëm? Shaqir Fetai i moralshëm?!? Ky që tashmë nga disa përgjime rishtas të publikuara i bëhet fjala edhe si për Don Zhuan të hoteleve?

Një njeri si Shaqir Fetai, me virtyte të degjeneruar, është, thjesht, njeri i keq dhe, si i tillë, nuk i duhet as kombit e as fesë! Një njeri akombëtar, afetar, apolitik e apartiak, me veti të skuthit, i cili karrierën e vet e mbështet, megjithatë, në përkrahje partiake, rrënimin e vet do ta gjejë, gjithësesi, nga ndëshkimet partiake! Njerëzit e degjeneruar sigurinë e vet e gjejnë vetëm nëse janë krah “liderit të moth”! Kjo sjellje dhe kjo kërkesë e skuthëve është shumë neveritëse për liderët të cilët japin urdhër të pamëshirshme për pastrimin prej skuthëve të subjektit që drejtojnë. Shaqir Fetai nuk drejton institucion fetar, ai kujdeset që të jetë sa “më i sinqertë”, “sa më besnik” ndaj partive të pushtetit të cilët e “ngjallën” dhe të cilët “do ta vdesin”! Është kjo “rregull i pashkruar” që i ka përcjellë të gjithë skuthët, njerëzit pa virtyte. Ky është “fat i vulosur” edhe i Shaqir Fetait. / 1KlikLarg/ 19.09.2021

Çka flet heshtja e Shaqir Fetait

Kaluan 24 orë që kur është lajmëruar gjuajtja me armë zjarri në drejtim të Medresesë së vajzave në Tetovë dhe, deri në këto çaste nuk kemi asnjë prononcim nga Bashkësia Fetare Islame. Me këtë rast, janë dëmtuar dritaret në katin e parë dhe të dytë, gjegjësisht dritaret e koridorit. Po sikur të kishte medresante në ndonjë orë plotësuese

Nga Aliriza Osmani

Që nga vitet 1980-1985, kur ka pasur disa përpjekje për të rrafshuar me eksploziv BFI-në si dhe ndonjë xhami, në shenjë të urrejtjes kundër fesë dhe institucioneve islame në vend, deri më sot nuk ka pasur ndonjë sulm me armë zjarri në drejtim të objekteve në pronësi të BFI-së. Ka pasur edhe një rast në gjysmën e parë të decenies së këtij shekulli, kur është gjuajtur me armë zjarri në drejtim institucionit! Në të gjitha rastet, reagimet e zyrtarëve të BFI-së kanë qenë të menjëhershme dhe, pa dyshim që është dënuar ngjarja dhe është kërkuar me këmbëngultësi që sa më parë të gjenden autorët e këtyre veprave penale dhe të vihen para drejtësisë!

Në opinion nuk ka kurrfarë reagimi nga BFI-ja. Në faqen zyrtare të BFI-së kemi vetëm një “filozofemë” të huazuar nga faqa personale e Shaqir Fetait e që flet vetëm për demagogjinë dhe hipokrizinë e vetë “autorit”!

Në faqen zyrtare të Shaqir Fetait kemi urime dhe përsëritje që ua dërgon hoxhallarëve që punësohen e që ky po i njihkëka qysh nga Sarajeva dhe se qenkan “intelektualë” të mëdhenj që “paskan

kontribuar” në çështjen fetare e kombëtare. Kur një bashkëpunëtor i UDB-së të vlerëson se sa je intelektual, se cili është kontributi yt kombëtar e fetar, këtu ose kemi të bëjmë me tallje, ose me cinizëm dhe hipokrizi, ose me përpjekje për të përçuar mesazhe spiuneske se sa ka qenë vigjilentë për të përcjellë se kush është aktiviteti i secilit shqiptar në planin kombëtar dhe fetar.

Pse Shaqir Fetai nuk doli në vendin e ngjarjes, siç doli me rastin e djegies së Spitalit Modular në Tetovë! Për një çast dislokoi krejt Rijasetin në Tetovë. Plumbat që kanë rënë brenda Medresesë kanë mundur të jenë “koktel Mollotovi”, flakë zjarri, bomba... Po sikur të ishin shtatë vajza në Medrese në atë orë të gjuajtjes me armë! Sot do të kishim shtatë viktima të pafajshme!

Shaqir Fetai nuk doli në vendin e ngjarjes për të kërkuar në mënyrë ultimative që sa më parë të gjenden kriminelët dhe të zbulohet se cili ishte mesazhi i kriminelëve me këto të shtëna në drejtim të dritareve të Medresesë!

Shaqir Fetai duhet të dalë me konstatime se siguria e objekteve fetare islame pas kësaj ngjarje do të duket e brishtë nëse nuk intervenojnë organet përkatëse për zbardhjen e tërësishme të rastit! Shaqir Fetai është dashur tashmë ta njohtojë edhe korin diplomatik me këtë vepër penale, e cila, fare lehtë ka mundur të përfundojë tragjikisht!

Fatkeqësisht, nuk kemi as reagim të Myftinisë, as reagim të drejtorisë së Medresesë “Isa Beu” dhe as nga stafi arsimor i paraleles së vajzave në kuadër të Medresesë Isa Beu!

Të gjithë janë të kapur dhe të shtrënguar nga Shaqir Fetai. Të gjithë janë të detyruar që mos të çojnë pluhur nga ky rast sepse, në prag të zgjedhjeve lokale, gjithësesi që do të zbehte “imazhin” e partive që participojnë në pushtetin aktual!

Për të mirën e pushtetit aktual Shaqir Fetai është në gjendje që t’ia vë flakën tërë BFI-së e gjithë organet dhe institucionet e saj!

Kuluareve po qarkullojnë muhabete se, mbase ky akt edhe mund të jetë i porositur, sepse Shaqir Fetai po e vuan shumë mungesën e sigurimit siç e kishte ish-reisul ulema H. Sulejman ef. Rexhepi!

Shaqir Fetai do të inskenojë ndonjë pasiguri me qëllim që të përcillet edhe ai nga sigurimi personal, ngjashëm si paraardhësi i tij!

Është e natyrshme që të ruhet dhe të sigurohet një hoxhë-lider, si H. Sulejman ef. Rexhepi por, ç’do që të ruhet një bashkëpunëtorë UDB-je si Shaqir Fetai!/Kombetare/20.09.2021

**Kthehet një vakëf, dhjetra të tjerë vidhen,
tjetërsohen, shiten, zhduken...**

Heshtjen morbite të Shaqir Fetait si dhe të tërë BFI-së me rastin e të shtënave me armë zjarri në drejtim të objektit të paraleles së vajzave, të dispersuar në Tetovë, e që është pjesë e Medresesë Isa Beu të Shkupit, u munduan ta thyejnë me zhurmën patetike të Qenan Ismailit, njeriut që vodhi postin e myftiut të Myfinisë së Shkupit, e që mundohet të vjedhë edhe merita të huaja, duke rrahur gjoks se e paskëshin kthyer objektin ish-kino Napredok, ku funksionon Institucioni Nacional, Teatri për fëmijë dhe të rinjë, në Çarshinë e Vjetër të Shkupit

Nga Mevlan Shaqiri

Iniciativa për kthimin e objektit ku funksionon Teatri për fëmijë dhe të rinjë, në Shkup, është ngritur dhe daton qysh nga viti 2007! Janë bërë shumë përpjekje, janë derdhur para të majme, janë mbajtur shumë procese gyqësore dhe, natyrisht që, më në fund do t'i kthehet pronarit të vërtetë – BFI-së, e cila e ka pasur edhe tapinë origjinale të kësaj prone! Qenan Ismaili as që ka ditur që kjo prone është në fund të procesit të denacionalizimit! Qenan Ismaili duhet të na tregojë se sa kërkesa për denacionalizim ka ngritur deri më tan! Duhet të na tregojë se sa vakëfe ka

humbur, sa ka falur, sa ka tjetërsuar. A a e ka kryer hartëzimin dhe si duket harta e vakëfit të Myftinisë së Shkupit! Duhet të na tregojë se, si ka heshtur para ndërtimeve të egra në prona të vakëfit që shtrihen në territorin në mes të Gazi Babës dhe Çairit! Qenan Ismaili duhet të na tregojë se çfarë po ndodhë me ish-objektin e Myftinisë së Shkupit në Kala të Shkupit! Duhet të na tregojë se sa është humbja nga heshtja në punët që po kryhen në ish-oborrin e Komunalecit. Çka po bëhet me këtë pronë të vakëfit e çka po bëhet me Hotelin i cili derimë tani është dashur të jetë në funksion dhe të gjenerojë para për shtimin e vakëfit të Myftinisë së Shkupit.

Këto ditë, ishim dëshmitarë se si në oborrin e Xhamisë së Ballabanit, u hodh guri themeltar për ndërtimin e një “Palestre sportive” që i bashkangjitet Shkollës fillore “Jashar Bej Shkupi”! Qenan Ismaili, nuk ka guxuar të bëjë gëg me gojë, meqë nuk ka dashur që ta iritojë BDI-në e cila “e përkrah” këtë skuth, ndërsa ky gurëthemel është aktivitet partiak në prag të fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale që mbahe më 17 tetor të vitit 2021.

Natyrshisht, ky gurthemel mund të jetë dhe gurthemel i “katakombës” së karrierës së Qenan Ismailit, sepse, në sy të tërë botës e tuhajëson vakëfin pa kurrfarë leje, pa kurrfarë vendimi dhe pa kurrfarë dëmshtëpërblimi (kthimi i Teatrit për Fëmijë nuk mund të konsiderohet si “kthim i borxhit”, sepse objekti i këtij Institucioni, me të gjitha nishanet është pronë e BFI-së)! Duke ia pasur frikën e ragimit të hoxhallarëve për këtë “dorë kaq të lirë” të Qenan Ismailit kur është në pyetje vakëfi i Myftinisë, ai tashmë ka filluar një fërkim me disa persona të bllokut opozitar, të cilëve u ankohet se po shantazhohet dhe po kërcënohet nga BDI për faljen e tokave nga vakëfi, madje duke u munduar që t’i animojë në ndonjë reagim të ashpër kundër kësaj grabitje nga ana e BDI-së! “Po ma bëjnë edhe më keq se dikur Mulla Sulës”, është ankuar te një sekretar dege i një partie opozitare.

Qenan Ismaili pret reagim nga partitë opozitare edhe për gurthemelin në tokën e grabitur që është vakëfi i Xhamisë Ballaban! Megjithatë, opozita vështirë se do të reagojë, meqë tashmë e ka kuptuar lojën e Qenan Ismailit, i cili, mbase edhe e pret këtë heshtje inatçore dhe, kësajsoj, t’i kalojnë gjërat korruptive në heshtje mortale!

Shitjet, tuhajësimet, degradimet i bëjnë në mënyrë sa më të heshtur. Madje mundohen t’i mbyllin edhe në “arkën e harresës”,

siç mundohet edhe “lideri i tij”, Shaqir Fetai, ta heshtë dështimin e Qendrës tregtare në qendër të Gostivarit, të cilin si vakëf do ta themelonte Banka Islamike për Zhvillim. Mos realizimi i kësaj Qendre flet se aty Shaqir Fetai është munduar që ta zhvillojë një korrupsion të tmerrshëm, sa që i ka trembur dhe revoltuar edhe vetë donatorët arabë. Një mend, çfarë u bë me një “xhami në Mavrovë”, të cilën Shaqir Fetai e ka paralajmëruar me pompozitet para mediave kur ishte myfti i Gostivarit? Epo, kështu e ka, ky vetëmse me rrena ka bërë karrierë, me rrena ka jetuar, me rrena është zhvilluar dhe me rrencakë është rethuar! Rrena është nëna e të gjitha të këqijave. A rrenë “reisi”, a? Po myftiu a rrenë? Marrë parasysh karakteret hipokrite të të dy të apostrufuarve këtu, me gjasë rrena është “morali” dhe “feja” e tyre! /Mileniumi3/21.09.2021

Protestë kundër shkollimit të manipuluar

Ndodhi edhe ky turp: për herë të parë në historikun e Medresesë Isa Beu, nxënësit e saj të ngriten të revotuar në protestë kundër Rijasetit. Ata kërkojnë që mos t'u ngulfatet shkollimi dhe Medreseja të akreditohet me qëllim që nxënësit të kenë mundësi të vazhdojnë nëpër fakultete, ku t'u dojë e bardha zemër

Nga Qerime Bajrami

Medresantet e paraleles së vajzave në Tetovë, pa dyshim që do të ngelin në histori si të parat protestuese që shkrinë akullin e paturpësisë dhe u ngritën kundër manipulantëve të “Rijasetit” të BFI-së! Nxënëset kërkuan akreditim të Medresesë me qëllim të vazhdimit të shkollimit sipëror nëpër universitete publike e private. Universitetet, nga viti i shkuar akademik, kanë urdhër që mos të regjistrojnë asnjë medresant ndërsa ata-ato që gjenden nëpër fakultete, të çregjistrohen dhe të dëbohen jashtë. Aparthejd i gjallë! Për raste të tilla është shkruar disa herë dhe opinionimi i gjërë është fort mirë i njohtuar.

Ajo që të habit më së shumti është “guximi i teologëve”, ideja e mbrapsht e “rijasetlinjëve” që të shpenzojnë mijëra euro për reklama e apele hajdutërie që të japin myslimanët e vendit sa më shumë fitra e zeqat të cilat “po u dedikoheshkëkan” Medresesë! Nga ana tjetër, medresantët paguajnë vit për vit shkollimin e tyre. Kaq lehtë i japin të drejtë vetes për manipulim këta “hoxhallarë” të

“rijasetit” të Shaqir Fetait? Flitet se, dikur, në fillet e para të Medresesë, nuk janë pranuar në vit më shumë se 60-70 medresantë, të cilët, deri në fund nuk kanë ngelur më shumë se 30-40 dhe, për këtë numër nxënësish BFI-ja ka pasur mjaftueshëm buxhet për t’i shkolluar pa e mjeruar fare xhepin prindërve, myslimanëve të vendit. Ndërsa sot, i regjistrojnë nga 150-200 në vit, ndërsa si gjeneratë, në fund, të dalin nja 300 medresantë! Pa kurrfarë kriteri e kujdesi, me korrupsion e me shitje të viteve shkollore, plus që u kërkojnë që ta paguajnë vitin shkollor! Nuk është ky synim djallëzor për ta rënduar sa më shumë portofolin e prindërve, myslimanëve të vendit, edhe atë në emër të Medresesë, e cila, në vend se t’ua hapë ertpektivat, u shkaktonte telashe jetësore!

Islamikisht do të duhej të ishte ky qëndrim dhe ky apel institucional: “Medreseja nuk është e akredituar dhe nuk pranohet! Medreseja është shkollë profesionale që përgatit ekskluzivisht hoxhallarë për nevojat e BFI-së! BFI-ja nuk ka nevojë më shumë se për 10-20 hoxhallarë në vit, ndaj dhe, numri i medresantëve që duhet të regjistrohen në vitin shkollor do të jetë i kufizuar në 30. Të tjerët, le të vrapojnë e le të orientohen pas perspektivave të veta!” T’u bëhet me dija edhe fakti që, Medreseja kurrë nuk do të akreditohet dhe nuk është mirë të akreditohet, sepse, do të rrëshqiste në llojin e Medresesë së mbretërisë serbe, “Medreseja Aleksandri i Madh”! Kuadrin teologjik do ta profizilonte pushteti politik!

Çka kërkuan konkretisht medresantet nga paralelja e dispersuar në Tetovë?

“A mundet që medresantët pas përfundimit të medresesë si krejt nxënësit të regjistrohen në universitetet publike dhe private? Sigurisht përgjigjja është jo. Kërkesat tona, hasin në veshë të shurdhër nga Riaseti i BFI-së dhe nga Ministria e Arsimit e Qeveria. Po marshojmë! Mjaftë ishte. Duam drejtësi, duam arsimim të barabartë si gjithë bashkë moshatarët tanë”, foli e revoltuar njëra nga medresantet në protestë.

Ndërkaq një prind që i ishte bashkangjitur protestuesve do të shtojë: “E shihni edhe vet, protesta është lajmëruar që dje, ka qenë i njoftuar edhe myftiu edhe zëvendësi por, e shihni, arkivi është i mbyllur. Por nuk e lëmë me kaq, ne do vazhdojmë”!

Të merremi vesh: kësaj proteste i vie era manipulim! Në Maqedoninë e Veriut, është Medreseja qendrore në Shkup si dhe

nja pesë paralele të dispersuara, me nja 800 nxënës sipas prononcimeve mburracake “të zyrtarëve” të BFI-së së Shaqir Fetait. Të paktën, për këtë numër nxënësish kërkojnë fitra e zeqate, kurbanë e lëkura të kurbanëve! Problemi i vjimit të studimeve nuk duhet të jetë shqetësim vetëm i nxënësve medresante të Tetovës por, ky problem duhet t’i tangojë të gjithë medresantët. Protesta duhet të jetë gjithëpërfshirëse. Të kordinohen mirë nxënësit në mes vete dhe, pa dyshim që duhet të formojnë urgjentisht një këshill protestues i cili do të jenë bartës dhe shtrues i kërkesave të medresantëve si para “rijasetit” të politizuar, ashtu edhe para subjekteve tona politike por edhe para organeve shtetërore, si negociatorë për tje kalimin e problemit jetik për medresantët! Marshuta e protestës është shumë e gabuar! Çfarë faji ka Myftinia e Tetovës? Manipulim! Marshuta e protestave duhet të jetë nga paralelja e medresanteve në Çarshi të Vjetër në Shkup, ku duhet të mbliidhen medresantët e paraleleve gjithandej viseve ku funksionojnë dhe, protesta të shtrihet nga aty e deri para Rijasetit dhe, pastaj nga aty e para Qeverisë!

Manipulimi, rrena dhe grabitja në emër të Medreseve planifikohet në Rijaset e jo nëpër myftini! Madje, harambashët e “rijasetit” të Shaqir Fetait edhe me këtë rast dalin me “reagim” idiotik sa, me të vertetë këta të BFI-së e meritojnë një protestë gjithëpopullore deri sa të vetëdijësohen se aty janë për t’i shërbyer popullit dhe jo për t’i manipuluar dhe grabitur.

Nga BFI-ja e dërguan këtë reagim kundër protestave të medresanteve (nuk patën kurrfarë prononcimi për gjuajtjen me armë në drejtim të objektit të paraleles së këtyre medresanteve): “Prej 5 vitesh bëjmë përpjekje për akreditimin e Medresesë së Isa Beut në sistemin arsimor të vendit. Si rezultat i asaj që vitin e fundit janë intensifikuar përpjekjet në këtë drejtim, tashmë është përgatitur drafti i cili në një afat të caktuar do të futet në procedurë parlamentare me qëllim të miratimit të ligjit. Në bisedat e shumta që ka pasur kryetari i BFI-së, Shaqir Fetai me bashkëpunëtorët e tij, ka marrë premtime se kjo çështje do të merr epilogun e vet pozitiv. Të këtilla janë garancitë nga faktorët relevant politik dhe Qeveritar”, thuhet në reagimin-pamflet partiak të BFI-së.

A është lexuar komunikatë më idiotike të një organi kundër “fëmijëve” të vet? Prej pesë viteve po bëka përpjekje Shaqir Fetai, ndërsa në krye të BFI-së u instalua nga pushteti maqedonas tash e

një vit e ca muaj! Shaqir Fetai paska biseduar me bashkëpunëtorët e vet dhe prej tyre paska marrur premtime për akreditim!!! Po kush janë ata bashkëpunëtorë të tij që japin akreditime! Po si qenka gati drafti i cili së shpejti do të futet në parlament për miratim! Pa kaluar fare në debat publik? Pa marrur miratimin e stafit akademik të BFI-së, pa marrur pëlqimin, miratimin dhe sugjerimet e kuadrit teologjik të vendit? Apo Shaqir Fetai ka vendosur që këtë Medrese t'ia falë pushtetit ndërsa të hapë një privat për t'i shuar “frustrimet intelektuale” që i ka sa një stog plehu! Punë që nuk bëhet kurrë!

Se nuk mund të bëhet kurrë e pohojnë edhe kompetentët nga Ministria e Arsimit të cilët nënvizojnë se “Shkollat fetare nuk janë pjesë e sistemit arsimor nacional që financohet nga shteti, sepse edhe Kushtetuta e RMV-së është shumë decide për sa i përket sekularizmit të shtetit tonë.”

Atëherë, protestat duhet të orientohen ose për ndryshime kushtetutare (që gjasat për të ndodhur janë zero), ose në kthim të parave të dhëna për shkollim në Medrese! Perspektiva e të rinjëve është gjë e shenjtë. Atë nuk guxon ta manipulojë askush, pra, as Shaqir Fetai.

Me Shaqir Feta nuk zgjidhet asnjë problem i BFI-së dhe i medresantëve, sepse ai nuk është instaluar në krye të BFI-së që t'i shërbejë medresantëve porse t'ia amortizojë problemet pushtetit që mund t'i vinë nga paknaqësitë eventuale të shtresave të teologëve të tashëm e të ardhshëm. Shaqir Fetai premtion “parajsë”, ashtu siç i premtojnë “parajsë” atij përfaqësuesit e pushtetit me zero interesim për problemet islame në Maqedoninë e Veriut./ 1KlikLarg/23.09.2021

Shaqir Fetait po ia kthejnë kah Zagrebi

Shaqir Fetait po i skadon “mandati” i vjedhur duke e lëvizur b... sa në Sarajevë, sa në Zagreb. Me siguri, krejt varësisht se ku ia caktojnë vendin pr t’i marrur instrukcionet se si të veprojë më tutje

Nga Valdrin Emrullahi

Në një krizë të rëndë financiare, në të cilën ndodhet aktualisht Bashkësia Fetare Islame që kur u dëmtua në kurriz nga komploti dhe tradhëtia e Shaqir Fetait, të nisesh për një vizitë krejtësisht private me shtatë-tetë veta, siç qenka nisur Shaqir Fetai me krejt administratën e BFI-së, kjo jo që shpreh budallallëk të skajshëm, por shpreh edhe angazhim për ta vjedhur, zhvatur e varfëruar edhe më shumë Institucionin fetar, në prag të ndonjë “furtune të papritur!

Shaqir Fetai me administratën e vet merr udhë për në Zagreb, në inspektim të Qendrës Islamike në ndërtim e sipër në Sisak të Kroacisë! Çka kërkon atje ky farë manjaku?! Pse a nuk ka se çfarë të inspektojë këtu, në Shkup? A e ka inspektuar punën në ndërtimin e Hotelit të BFI-së në truallin e ish-Komunalecit, apo, ka hequr dorë nga ky vakëf në shenj mirënjohje për ata që e instaluan në krye të BFI-së! A e ka inspektuar hala punën e ndërtimit të xhamisë në Fushë Tophanë!

Është çështje konspiracioni! Deri te burimi i instrukcioneve nga shërbimet sekrete nuk shkohet drejt për drejtë por, gjithnjë nëpër rrugë dytësore, sa më larg dhe, eventualisht, përgjatë ndonjë “vizite gjysëm zytare”!

Paska shkuar në Solemnitetin e 27 të garave ndërkomëtare të

lexuesëve të Kur'anit Famëlartë organizuar nga Meshihati i BI në Kroaci! Në solmnitete të tilla mund të ftohet i pari me ndonjë shoqërues dhe jo tërë administrata e një Institucioni Fetar. Simbas protokolit, gjithnjë ai që fton mbulon shpenzimet e fjetjes dhe të ushqimit të një-dy përfaqësuesve, bishti që ngjitet ha e fle në kurriz të atij që e merr mbas vete, në rastin konkret, në kurriz të BFI-së, edhe pse, vizita e Shaqir Fetait paska qenë tërësisht private! Paska shkuar Shaqir Fetai në Kroaci, sepse , çuditërisht, shkuarje e tyre, madje edhe event i Leximit të Kuranit, paska përkuar me nxjerrjen e dy hafizëve të rinj, njëri nga Likova e tjetri nga Çegranit! Çegranasi te çegranasi, duke ia përplasur edhe një ekip të tërë prej administratës së BFI-së. Turp për të ndershmin dhe “detyrim” për hipokritin!

Tani Shaqir Fetait i ka ngelur vetëm t'i gjejë çegranasit dhe t'i vizitojë e para tyre të shesë sa të mundet pordha.

Dhe, fare në fund, e tradhëton “kuadri fotografik”! Shaqir Fetai shkon në Kroaci për ta takuar ambasadorin e Maqedonisë së Veriut, i cili rastësisht ka qëlluar kushëriri i Shaqir Fetait dhe, i cili, rastësisht ka pirë bashkë me Shaqir Fetain në të njëjtën pjatë që ua kanë servirur oficerët e UDB-së.

Si shumë shpesh po takohet me “kushëririn” Shaqir Fetai, madje sa më larg syve të opinionit, atje ku fshehurazi mund të merren instrukcionet e veprimit nëntokësor, apo të jepen raportet nga “aktiviteti i nëntokës”!

Shaqir Fetai kohë më parë ishte edhe në Kosovë dhe, aty nuk bëri kurrfarë vizite e as “inspektimi”, sepse, nuk ia rrasën fort! Mezi e lexoi një “kumtesë”, ndonëse ishte i paraparë vetëm për fjalë përshëndetëse (e lexoi me belbëzime e me njëmijë gabime e për faqe të zezë) dhe, me bisht nën shalë u kthye nga kishte shkuar! Në Kosovë pasuli i shitet në kokrra, ndërsa në Bosnjë e në Kroaci, i shitet me thes! Ku punon, aty fiton!

Kliko linkun

<https://www.facebook.com/1kliklarg/videos/38507213638307>

5/

/1KlikLarg/27.09.2021

Ora e ndërgjegjes kolektive

**Në horizont po vërehet një zgjim i ndërgjegjes së teologëve!
Asnjë teolog nuk e miraton veprimin prej bashibuzuku të
Shaqir Fetait; asnjë teolog nuk e miraton “politikën” e huaj
për BFI-në që imponon zhvillime shkatërrimtare, nënçmuese
dhe tepër ofenduese, “politikë” kjo që aktualisht po
përfaqësohet nga Shaqir Fetai dhe honxho bonxhot e tij**

Nga Ilir R.Topi

Kontinuiteti i tradiconales ndërpritet vetëm kur ndodhë dukuria e prurjeve të reja, e risive, e modernitetit! Megjithatë, edhe kjo ndërprerje kur të ndodhë, është një kujdes nacional që, të ruhet tradicionalja, të ngritet në pedestal si vlerë e shtrenjtë kombëtare, të mos harrohet kurrë dhe, gjithnjë të përkujtohet si trashëgimi që të jep emër e nder!

Kontinuiteti tradicional i Bashkësisë Fetare Islame u ndërpre, u këput mu në kurriz dhe, vështirë se ndonjëherë mund të jetë vertikale, të ec e pavarur dhe pa “mjete ndihmëse”! Jo për shkak të nevojës, jo për shkak të nxjerrjes në pah të prurjeve të reja, jo për shkak të ndonjë “moderniteti” (sepse këto bien ndesh parimeve të mirëfillta islame), por, kjo “ndërhyrje kirurgjikale” spiuneske, ndodhi për shka të tradhëtisë, për shkak të kompleteve, për shka të lakmisë së babzitur për ta marrur dhe pushtuar atë që nuk të takon, erdhi deri te një mohim i tërësishëm i së kaluarës historike por edhe i së kaluarës jo të largët! Bashkësia Fetare Islame ngeli pa institucionin e “kulturës së respektit”, pa institucionin “muzeu i së shkuarës” përplot me eksponante si relikte të së kaluarës së

lavdishme; Bashkësia Fetare Islame ngeli pa insistuticonin e besës që respekton ruajtjen me çdo kusht të betimit për veprimtari islame, kushtetuese dhe institucionale; ngeli pa veprimtari kushtetutare, sepse, fatkeqësisht, u uzurpua nga tradhëtarë, nga spiunë, nga të shitur, nga militantë të verbuar partiakë, jo sepse këtyre marionetave u ha bytha për çështje kombëtare që janë “target” i partive politike, por sepse, përmes këtyre strukturave mëtojnë jetësimin e ëndrallave të tyre të sëmura – të bëjnë karrierë të pamërituar dhe të padenjë, madje, të padenjë për ta ruajtur edhe epitetin “hoxhë”!

Natyrisht kjo ndërhyrje spiuneske as nuk do të shërbejë si urë lidhëse në mes të së kaluarës së lavdishme të BFI-së dhe të tashmes poshtëruese e fyese të saj, e as nuk do të shërbejë si urë lidhëse nga një vlerë në tjetrën, sepse “materiali” i kësaj ure është i gjithi spiunim, tradhëti e komplot!

Kjo “koh vdekatare” e Bashkësisë Fetare Islam do të kalojë, do të ngelin vetëm gjamat, trishtimi, dhimbjet, nënçmimi dhe lojërat e ulta për shkatërrim të vlerave islame; do të kalojë dhe sërish BFI-ja do të kthehet në atë pikë të sigurtë saldimi prej nga do të vazhdojë tradita e jetës institucionale.

Jetë nga pozita e “institucionit” bëjnë edhe lolot, honxho bonxhot dhe dallkaukët e BFI-së, porse, ata nuk bëjnë “jetë institucionale”, sepse aktiviteti i tyre bazohet nëpër kanalizimet septike prej nga nuk mund të dalin strategji përveçse të atyreve të shkatërrimit. Politikat nëntokësore kurrë nuk kanë qenë të hajrit e as të së mirës, sepse e ushqejnë izolimin, vetëmjaftimin, shmangien prej debateve si formë e avancimit të mendimit dhe të veprimit shkencor, e stimulojnë ndjenjën e triumfalit, ndaj dhe trashet përgjegjshmëria, dëshira për vjedhje, për shkatërrim, për imoralitet dhe amoralitet.

Nocioni Bashkësi Fetare Islame përveçse nënkupton Institucionin, organet dhe entet e saj, nënkupton edhe gamën e gjërë të të punësuarve brenda Institucionit. Mbi nëntëdhjetë për qind e të punësuarve kurrë nuk janë pajtuar me këtë tradhëti e komplot që e luajtën disa marioneta që tërhiqen nga dyzginat partiake të pushtetit që asgjë nuk ka të bëjë me islam! Rrjedhimisht, as këta marioneta nuk përfaqësojnë asgjë nga islami, ndaj, kjo përqindje e të punësuarve, shumë shpejt do të reagojë dhe do të ngulmë në rikthimin e jetës institucionale dhe në mallkimin e të gjithë atyreve që u bënë shkak i shkëputjes së kontinuitetit të tradicionales që

është histori e paprekshme e Bashkësisë Fetare Islame. Nëse shtyerja në mosha është pengesë që t'i hyhet kundërshtimit të dukurive poshtëruese, nëse kapja peng e shumë hoxhallarëve të ndershëm, duke u kërkuar lojalitet në këmbim të punësimeve, mosdëbimeve nga puna (të fëmijëve nipërve, mbesave etj.), përfitimeve meskine, ky nënçmim nuk mund t'ju bëhet të rinjëve! Të rinjtë nuk do të pranojnë të llogariten, madje as si pasardhës të atyreve që pranojnë tradhëtinë, komplotin dhe nënçmimin! Ideali i të rinjëve është e mira! Ata nuk duan të jetojnë dhe të kalojnë keq si paraardhësit e tyre!

Si asnjëherë në historinë e Bashkësisë Fetare Islame kemi revoltë rinore, kemi protesta të medresantëve dhe solidarizim nga studentët e FSHI-së kundër kësaj strukture banditësh që i kanë ngulur thonjtë e pista mbi kurriz të BFI-së duke e drejtuar kah "gardhi kurth" që siguron vdekjen totale! Vdekja që vjen prej duarve të hoxhallarëve?!

Ora e ndërgjegjes kolektive po troket! Kurse Bashkësia Fetare Islame patjetër duhet të kthehet në datën e 26 majit të vitit 2020, një ditë para se të ndodhë "dita" që po mëton të zgjasë deri në shkatërrim të BFI-së; një ditë që mund të zgjasë deri në harrim total të historisë shekullore të BFI-së! Më përpara do të ndodhë harrimi i kësaj dite poshtëruese se sa që do të ndodhë harrimi total i BFI-së që për momentin po lëngon nën thonjtë e komplotistëve që synim kanë "jetën islame" të shfrenuar!

Shkatërrimi dhe vjedhja e vakëfit, trajtimi i Mez'hebit Hanefij si sekt, lejimi dhe stimulimi i regjistrimit të "bashkësive islame" të reja, përkrahja e veprimtarive të "armiqve" të përhershëm të BFI-së, bashkëpunimi me sekte fetare e politike nën pretekstin e "zhvillimit të islamit" në vend, shkatërrimi i vlerave që mbajnë shenja identifikuese kombëtare (si avllia e Xhamisë në Dibër) – çka mund të jenë këto veprime përveçse promovim i një "tradhëtie të heshtur" si dhe i veprimit që sjell degradim dhe mohim, si të vlerave të shenjta fetare ashtu edhe të vlerave kombëtare! Pse a kjo na paska qenë detyrë e Bashkësisë Fetare Islame? Jo, me gjasë, kjo është detyrë ekskluzivisht e Shaqir Fetait të instaluar në krye të BFI-së nga qarqe jo të sinqerta në raport me islamin, me myslimanët dhe, përgjithësisht, me shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, nga ato qarqe që akoma mund të jenë nën komandën e oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviqit./ 1KlikLarg/05.10.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (15)

Shaqir Fetai tashmë e paska shtuar aktivitetin e vet dhe, nga dita e sotshme na del edhe si furnizues me “lajme” si dhe përditësues i FB-ut të BFI-së! Megjithatë, tashmë është publikar konstatimi i cili, nuk bëhet fare monoton nëse përsëritet si refren: Shaqir Fetai sa herë që flet rrenë, sa herë që publikon ndonjë “informacion” ai në fakt dezinformon, sepse, ai ndryshe nuk mund të funksionojë! Punë udbashësh

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

Shaqir Fetai kishte parë të arsyeshme për të folur pak dhe, sakaq ia kishte “timuar” në FB-un e BFI-së ku kishte thënë: “Delegacioni i BFI-së vizitoi Republikën e Turqisë”! Pra, edhe kësaj radhe, me të hapur gojnë, Shaqir Fetai përplas rrenën e radhës! Madje, duke pretenduar që të tregohet shumë i “moooth” (bastardim i fjalës “madh” nga ana e Shaqir Fetait), dhe shumë i rëndësishëm, ai, vizitën e një province turke, apo, vizitën gjatë natës të një qyteti, e identifikon me vizitën e tërë Republikës së Turqisë. Do me thënë, si Makroni, apo Merkeli, që viziton Ankaranë, apo Stambollin, ndërsa mediat botërore raportojnë se Makroni, apo Merkeli, apo Bajdeni, vizitoi Turqinë, ashtu edhe Shaqir Fetai, nga qëndrimi në Edirne, lajmëron se e vizitoi Republikën e Turqisë!

Vizitat ndërshtetërore mund të emërtohen me emër të shtetit përkatës, por, vizita e Shaqir Fetait nuk do të thotë hiç më shumë se sa vizitë turistike në një provincë apo qytet të Turqisë.

Shaqir Fetai, niset për të shkuar në Edirne, për të marrur pjesë në duanë e daljes së një numri të kondiserueshëm të hafëzlerëve të rinjë nga ky qytet! Me vete merr gjysmën e organeve të BFI-së, sepse, gjysmën tjetër e kishte orientuar për në Shkodër, për të njëjtën gjë! Shaqir Fetai i thyen të gjitha rregullat, të gjitha normat protokolare, të gjitha ftesat personale që nënkuptojnë se me vete mund të marrë edhe një shoqërues, apo një përkthyes dhe, hiç më shumë, sepse, frikësohet se po e mori njërin, të tjerët do t'i rrebelohen, do t'i shprehin padëgjueshmëri. Pra, Shaqir Fetai u bën lajka duke i marrur me vete, nëpër shëtitje ndërkombëtare, pavarësisht se kjo kushton sa tubimi i fitrit nëpër dhjetra xhami të vendit!

Shaqir Fetai lajmëron se, delegacioni i tij paska zhvilluar edhe një aktivitet “bombastik” – paska falur namazin në Xhuminë Selimije! Zatën, është thënë se, Shaqir Fetai, shumë shpejt për “aktivitet institucional” të tij do ta llogarisë edhe faljen e namazit!

Fare në fund, për t'i dhënë peshë budallai vetes, thekson se, mikpritësit turq, ia paskan organizuar Shaqir Fetait dhe myhybëve të tij “një pritje e nivelit të lartë e cila meriton çdo lavdatë”! Ata kanë pasur mysafir prej të gjitha shteteve të Ballkanit dhe janë përkujdesur për një organizim dhe pritje të njëjtë për të gjithë, Shaqir Fetai ia do qefi që tërë ai organizim gjigant të duket se ka qenë enkas për atë! Këtu shihet se sa i sëmurë që është i ngrati.

2.

Të shtunën, më 2 tetor të vitit 2021, heeej, me sugjerim të “të madhit” xhuxh, Shaqir Fetait, gjysma tjetër e organeve të BFI-së paska shkuar në Shkodër, ku është bërë një dua e një numri të hafëzlerëve të rinjë nga Shoqata Istambull e Shkodrës.

Paramendoni, nëse nuk do të sugjeronte Shaqir Fetai këta nuk do të shkonin! E çka ka sugjeruar ky farë miu i gjirizit: të shkojnë gjysma e rijasetit të Shaqir Fetait në Shkodër! Si te gjysma e rijasetit që ka udhëtuar në Edirne, ashtu edhe gjysma tjetër që ka shkuar në Shkodër, në përbërje kanë pasur fytyra të dyshimta,

spiunë, tradhëtarë, persona me cilësi antiislame, që i lufton feja, Kurani, ndërsa këta marrin pjesë në promovimin e Ruajtësve të Kuranit!!! Në fund, ndonëse në këtë manifestim ka pasur mysafirë pothuajse nga të gjitha shtetet e Ballkanit, Shaqir Fetai kërkon që lajmi të bëhet se, vetëm për delegacionin nga BFI e Maqedonisë së Veriut paskan organizuar vizitë godinës së Medrese së Vajzave Haxhi Shej Shamija, qendrën e Kuranit për meshkuj dhe qendrën e Kuranit për femra! Vetëm për këtë delegacion sepse ka prezantuar në Shkodër me sugjerim të Shaqi Fetait! Po kush e njeh këtë farë mahluku në Shkodër që t'i bëhet një respekt i veçantë! Në Shkodër nuk shërohen komplekset e Shaqir Fetait, as frustrimet e "ORAO" dhe as nuk mbulohen veprimtaritë prej spiunazhi në të mirë të oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviqit.

3.

Heeej, lexoni more këtë titull të Shaqir Fetait: "Reisul Ulemaja bisedon për përfundimin e Xhamisë së Tophanës"! Pse të bisedojë Shaqir Fetai, kush na qenka ky farë hamami që interesohet për xhami?! Pse tani të bisedojë Shaqir Fetai? Pse tani në prag të zgjedhjeve lokale a?

Është, pastaj, problem më vete se si përfaqësues të ambasadës turke involvohen në një fushatë në prag të zgjedhjeve, se si lejojnë të manipulohen nga një mi i gjirizit, siç është Shaqir Fetai! Pala turke, si investitore e ndërtimeve të kësaj xhamie, duhet të dalin fillimisht e të shpjegojnë për vonimin disa vitëshe të ndërtimit të kësaj xhamie. Të tregojnë se ku është problemi dhe, jo të bien "nën influencën" e Shaqir Fetait dhe të dorëzohen para tij sa, kur t'ju thotë ai "tani niseni xhaminë" pala turke menjëherë të dalë në terren!

Pse Shaqir Fetai nuk ka treguar deri më tani interes për përfundimin e kësaj xhamie? Pse aktivizohet pikërisht tani, në prag të zgjedhjeve lokale. Xhamia është në territorin e Myftinisë së Shkupit! Ç'përzihet këtu Shaqir Fetai? Ndoshta Myftiu i Shkupit mundohet ta keqpërdorë këtë xhami dhe votat t'ia orientojë ndonjë kandidati të cilit nuk i ka kurrfarë borxhi Shaqir Fetai? Ndoshta i ka Qenan Ismaili! Ç'ngatërrohet në këto punë Shaqir Fetai, përveçse nëse angazhimi i tij është ekskluzivisht në të mirë të

oficerit të vet, udbashit Stanko Dragoviq. Një “aktivizim” i këtillë serioz, tash e tre vite përsëritet sa herë që ka zgjedhje! Pala turke, para se t’i hyj seriozisht kësaj pune duhet që myslimanëve të vendit t’ia sqarojë në hollësi tërë këtë vonesë; të tregojë, nëse vonesa ka qenë si problem i financave, apo si problem i moslëshimit të dokumenteve të rregullta nga ana e menaxherëve të komunës, të cilët sërish duhet të ndihmohen, sepse, po qe se erdhën të tjerët xhamia nuk do të ndërtohet kurrë! Ky është frikësimi që ua mbjell turqëve Shaqir Fetai, ë! Prandaj, kur ky thotë “të bëhet xhamia”, ajo bëhet menjëherë. “Bëhu” – dhe ajo bëhet! Nga ky nivel i shikon punët mëkatari Shaqir Fetai, përbuzje kjo e të Vërtetës Islame në stilin e udbashëve të Stanko Dragoviqit.

4.

Nuk i del fb-u personal ku i takon që të vetëbisedojë dhe të rrëfëhet spiunueshëm se çfarë paska bërë sot, ai kërkon që ta kontrollojë dhe ta përditësojë edhe fb-un e BFI-së. Pa fije turpi rrëfen pallavra duke tentuar që ta rrejë krejt opinionin e gjërë si të vendit ashtu edhe të diasporës. Dhe, sakaq, prej xhepit i nxjerr mirënjohjet, të cilat, tashmë kanë humbur çdo vlerë, sepse, janë shndërruar në “monedhë” me të cilat Shaqir Fetai mundohet të blejë pak “lojalitet” dhe “simpati”! Mund të simpatizohet satana?! Një ditë, të gjitha mirënjohjet, të gjitha “dekoratat” dhe çmimet që janë ndarë nga Shaqir Fetai do të shpallet të pavlefshme dhe do të tërhiqen me një urdhër, sepse, nuk lejohet që vlerësimet e një udbashi të jenë nderime institucionale ndaj personave të ndryshëm të vendit. Ky “nder” i Shaqir Fetait nuk i duhet askujt, përveçse Stanko Dragoviqit!

5.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!
Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e

injon ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/06.10.2021

Periudha më e errët e Vakëfit brenda shekullit të fundit

Çka po ndodhë në këtë kohë derisa BFI-në po e shkatërron Shaqir Fetai si dhe derisa Myftininë e Shkupit po e varfëron Qenan Ismaili si asnjë sistem kolonial e neokolonial më parë! Është hequr dorë prej shumë proceseve të mëhershme dhe kërkesave për kthim të pronës, prona vakufore po vidhet, prona po falet, po tjetërsohet, po tëhuajësohet, nuk po ngulmohet për kthime të reja, sepse hidhërohet pushteti

Nga Aziz Sejdiu

Që pas rënies së Perandorisë Osmane dhe tërheqjes së saj në kufijt aktual të Shtetit Turk, myslimanët e hapësirave të pjesës jugore të Ballkanit të sotshëm Perëndimor, përjetuan ngjarje nga më tragjiket. Nëpër trojet e tyre shekullore u instaluan pushtues të rinj, sisteme e ideologji të reja. Fillimisht u shtri perandoria e mbretërisë serbe, periudhë kjo kur u krye ekspropriimi i pronave të myslimanëve të cilët iu nënshtruan programit dhe strategjisë serbe për dëbimin e myslimanëve, në veçanti të shqiptarëve, për në viset turke si dhe konfiskimi i pronave të tyre. Në këtë periudhë më së keqi e pësoi prona e vakëfit, sepse, fshatra të tëra, qytete të tëra, vendbanime të vejtra, u shpërngulën në mënyrë kolektive, duke lënë gjithçka, pra, edhe pronat e vakëfit në duart e plaçkitësve dhe shkatërruese serbë.

Sa i përket vakëfit që në këtë periudhë ishte nën mbikëqyrjen dhe

kujdesin e Drejtorisë së Vakëfit pranë Ulema Mexhllisit të Shkupit (nën administrimin e së cilës përfshiheshin nga Beogradi, gjysma e Serbisë, Mali i Zi, Sanxhaku, Lugina e Preshevës, Kosova dhe tërë Maqedonia e Veriut), mund të thuhet se kjo periudhë, pra, vitet e para të shtrirjes së mbretërisë serbe, koha kur nis ekspropriimi, shënon etapën më të errët, kohën ku u zhvat, u shkatërrua, u përvetësua e u zhduk një numër i konsideruar i pronës vakufore, sidomos ajo e zonave rurale.

Etapa e dytë është ajo e sistemit ideologjik më të pashpirt në raport me fenë! Ideologjia komuniste instaloi sistemin e nacionalizimit të pronës, me çrast prona e bashkësive fetare kaloi nën pronësi të pushtetit! Me qindra dyqane, me dhjetra objekte afariste, me mijëra hektar tokë, kullosa e pyje u zurpuan dhe gjithçka kaloi nën menaxhin e organeve gjegjëse të pushtetit. Se cilat ishin pasojat e nacionalizimit të këtyre objekteve, deri më sot janë shkruar me qindra tekste e artikuj, me dhjetra disertacione për magjistraturë e doktoranturë. Saktësisht dihet sa sa objekte janë marrur, cilat janë marrur, çfarë po bëhet me ato objekte, madje dihet edhe vlera e tyre, dëmi që i janë shaktuar komuniteteve fetare me nacionalizimin e këtyre pronave!

Megjithatë, del puna se periudha komuniste në raport me vakëfin paska qenë vetëm etapë e “konservimit të pasurisë” dhe të eksploatimit të saj në të mirë të të tjerëve e në dëm të bashkësive fetare! Me të përfunduar të kësaj ideologjie, me kalimin në sistemin demokratik, u soll dhe miratua, veç tjerash, edhe ligji për denacionalizim të pronave të nacionalizuara, me çrast fillimisht përfituan individë, dhe më vonë, edhe bashkësitë fetare. Për vendet dhe objektet tashmë të shndërruara në interes të pëtgjithshëm shoqëror, u dëmshpërblyen përmes pagesave në bono, duke u vlerësuar paraprakisht nga komisione përkatëse shtetërore!

Pa dyshim që, pas 30-40-50 viteve, do të shkruhet edhe për fatin e këtyre pronave të vakëfit siç është shkruar për vakëfin në kohën e mbretërisë serbe por edhe në kohën e socializmit. Kur do të kemi në letër edhe fatin e vakëfit të kësaj periudhe, për shembull të periudhës 2020-2030 dhe, kur do të bëhen krahasimet në mes të periudhave, do të del se vakëfi, fatkeqësisht ka pësuar më së keqi pikërisht në këtë periudhë, në kohën kur me fatin e Vakëfit të Shkupit po tallet si Shaqir Fetai ashtu edhe Qenan Ismaili! Nësë kohën e eksproriimit të pronave vakufore, në emër të ndërtimit të “rrugëve nacionale”, të “hekurudhave”, të

“koperativave bujqësore”, të “urave” etj., porse kryesisht të atyre pronave që kishin ngelur pa pronarë për shkak të shpërnguljeve masovike, Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfit pranë Ulema Mexhllisit të Shkupit i propozon kryesisht qendrore që, në përputhje me parimet e vakufnames, ajo pronë të mos lihet djerrinë e të uzurpohet nga individë, por të bartet dhe të zbriten ato prona nëpër qendra të mëdha e urbanistike! Si të barten? Të këmbehen, për shembull, dy-tre livadhe me një-dy dyqane në qendër, tri-katër dylymë tokë në qendër të katundit të këmbehet me objekte afariste në qendër, pronat që i kërkon ministria e arsimit për shkolla të rregullta e që janë më të përshtatshme për vijueshmëri mësimore nga nxënësit e vendbanimeve, të këmbehen me prona adekuate në qendrat dhe vendet e urbanizuara. Dhe kështu ka funksionuar pavarësisht nëse ka sunduar mbreti serb apo nëse kanë drejtuar digastere të mbretërisë serbe.

Kështu po ndodhë edhe me Ligjin e fundit për denacinalizim të pronës së baskësive fetare! Po kthehen pronat ose po “dëmshpërblehen”!

Fatkeqësisht, kurrë nuk ka qenë më tmerr për vakëfin se në këtë periudhë, sidomos përgjatë procesit të “dëmshpërblimit”! Me qëllim që, Shaqir Fetai ta ketë mirë me pushtetin, me organet “dëmshpërbluese”, me qëllim që Qenan Ismaili, myftiu i kontrabanduar në krye të Myftinis së Shkupi, të jetë sa më pranë pushteteve, lejojnë deri në falje të thjeshtë që “dëmshpërblimi” të jetë qesharak, sa për sy e faqe! Lejojnë “dëmshpërblimin” sipas tekeve dhe prioriteteve të pushtetit. Pra, nuk kemi zbatueshmëri të plotë të Ligjit por, kemi plotësim të fontanës së dëshirave grabitqare të individëve të caktuar të pushtetit! Objekti miliona euro pranohet të dëmshpërblehet për pak mbi 300 mij euro, vetëm e vetëm që mos t’i ngelë qejfi pushtetit dhe ta kenë sa më mirë e sa më ngrohtë me pushtetin.

Në këtë periudhë, kur nuk dihet sa po shkon pasuli, kur nuk dihet se çka po kthehet e çka po ngelë “interes nacional”, kur shumë prona po jepen nën emrin e “patriotizmit shqiptar”, sepse fëmijët duhet të kenë shkolla, ndërsa për këtë të mbajë llogari Vakëfi dhe jo Ministria e arsimit, apo, përgjithësisht pushteti, po falen prona, po jepen dyqane, po jepen hapësira për ndërtim të biznesit për personat që janë të lidhur ngusht me pushtetin.

Si në periudhën e mbretërisë serbe, ashtu edhe në periudhën e ideologjisë sllavo-komuniste, komunitetet fetare, konkretisht,

Bashkësia Islame, ka kundërshtuar çdo përpjekje për zhvatje apo grabitje, ose edhe tjetërsim, të vakëfit, me fanatizëm të tmerrshëm ka ruajtur vakufnamet, tapitë, dokumentet pronësore, dhe vazhdimisht i ka kërkuar, vazhdimisht ka reaguar dhe ka shprehur pakënaqësi me keqpërdorimin apo uzurpimin eventual të pronës. Në vitet e para të periudhës postkomuniste, BFI-ja e ka pasur të hartëzuar gati tërë vakëfin që ka qenë pronë e BFI-së dhe ka grumbulluar dokumente e ka shtruar kërkesa, madje edhe procese gjyqësore për kthimin e tërë vakëfit të nacionalizuar, pa përjashtime.

Çka po ndodhë në këtë kohë derisa BFI-në po e shkatërron Shaqir Fetai si dhe derisa Myftininë e Shkupit po e varfëron Qenan Ismaili si asnjë sistem kolonial e neokolonial më parë! Është hequr dorë prej shumë proceseve dhe kërkesave për kthim të pronës, prona vakufore po vidhet, prona po falet, po tjetërsohet, po tëhuajësohet. Myftinia si organ po hesht, sepse mund të jetë e korrumpuar! Po hesht edhe Mexhlisi i Xhemateve, sepse, u duhet ta kenë mirë me Myftiun, ndryshe, hiqen nga puna, raportohen në parti si armiq partiakë dhe, sakaq nisin dëbimet nga puna e fëmijëve, nipërve, mbesave, nisë mosvazhdimi i kontratave në vepër, shkatërrimi i biznesit privat etj.

Këto vakëfe të falura, të vjedhura, të të huajësuar, të lëna nën hipotekë sepse Shaqir Fetait i duhen para për rroga, kurrë nuk kthehen, nuk ka dokument valid që mund t'i kthejë.

Kur një ditë do të shkruhet për këtë veprimtari kriminale, kur do të përgatiten dhjetra analiza, studime, disertacione, do të shihet se periudha e Shaqir Fetait dhe myhybëve të tij, me diploma falce, me "disertacione" të blera, me titull të falsifikuar "hoxhë", do të jetë absolutisht periudha më e errët për Vakëfin, periudhë kur vakëfi dhe jeta fetare islame është "drejtuar" nga kopukët të cilët antiislamizmin e kanë pasur gjak e palcë dhe që nuk kanë ditur të zhvillohen e të rrisin familje përveçse me haram! Kungulli kurrë nuk ka shkuar gjithnjë mbi ujë./Mileniumi3/07.10.2021

Vakëfi po dëmtohet nga hoxhallarët si dikur nga mbretëria serbe dhe sistemi komunist-ateist

(Edhe diçka rreth problemit të vakëfit të cilin e trajton z. Aziz Sejdiu në shkrimin autorial me titull “Periudha më e errët e Vakëfit brenda shekullit të fundit”, të botuar në portalin kombetare.com)

Nga Mevlan Bakiu

Shkrimin në fjalë e lexova me një frymë! Ç’të lexoshë! Një tmerr i vërtetë, një turp e një siklet, i cili të nxit të derdhësh tërë mallkimin e botës mbi Shaqir Fetain dhe mbi atë “Myfti Mindilin” e Shkupit, Qenan Ismailin, i cili, “devotshmërinë fallce” prej mynafiku, mundohet që ta kamuflojë përmes vazeve me porositë e të cilave asnjëherë nuk ia qëllon!

Autori ka bërë një përshkrim konciz të statusit dhe të situatave të Vakëfit, si pronë e Bashkësisë Fetare Islame, që nga periudha postosmane, ajo e mbretërisë serbe, periudhës komuniste e deri më sot! Topi nuk e luan! Pushtuesit dhe ideologjitë kanë ikur, kurse vakëfi ka ngelur, duke iu kthyer pronarit të vetëm – BFI-së!

Po pse periudha e sotshme qenka më e tmerrshmja nëpër të cilën po kaluaka Vakëfi?! Si është e mundur që situata e vakëfit të jetë më e mirë dhe më e lakmueshme në periudhën e okupatorit serb si dhe në atë të sistemit ateist, se sa sot, në kohën kur vlerat e njeriut, të komunitetit, të asociacioneve dhe institucioneve joqeveritare, janë mbi çdo gjë tjetër?

Ne periudhën e mbretërisë serbe paska pasur mundësi që të bëhet

tëhuajësimi i vakëfit duke marrur si kundërshpërblim vakëf tjetër në, më në qendër? Në periudhën postkomuniste, pra sot, lejohet tëhuajësimi i vakëfit për faktin se ajo pasuri tashmë ka kaluar dhe është bërë pronë e interesit të përashkët, por, si kundërshpërblim jepen letra në vlerë!

Sipas një informacioni deri më sot janë shpronësuar me pagesë prona në vlerë prej mbi 7-8 milion euro! Kjo shumë ka hyrë në xhirollogarinë e BFI-së? Por, shtrohet pyetja: a janë shpenzuar këto të holla sipas dedikimit! Sa vakëf është blerë me këtë shumë të akumuluar nga “shitja” e vakëfit?! Asnjë metër katëror! Asnjë dyqan! Asnjë pronë tjetër nuk është blerë! Tërë shuma është harxhuar për rroga e për qejfe, për shëtitje e për llukse, për nepotizëm dhe për blerje të lojalitetit prej “myhybëve” nga ana e gazda Shaqir Fetait!

Shaqir Fetai akoma nuk ka treguar, ndonëse vazhdimisht ftohet të rrëfëhet: si ndodhi që t’i dëbojë financuesit arabë të cilët qenë të gatshëm dhe në prag të fillimit të investimeve miliona dollarë për një qendër afariste mu në mes të Gostivarit e që do të ngelte vakëf jashtëzakonisht i rëndësishëm për institucionin! Kush i dëboi, pse u “trembën” arabët, cili ishte roli i Shaqir Fetait si Myfti në këtë humbje të këtij vakëfi?

Qenan Ismaili duhet t’u thotë myslimanëve të territorit të Myftinisë së Shkupit se çka po ndodhë me ish-godinën e Myftinisë së Shkupit, në Kala, në krah të “Varrezave franceze”? Çka po ndodhë me Hotelin të ish-Komunaleci i cili është dashur të dorëzohet në pronësi të kësaj Myftinie qysh para dy viteve? Për këto vite Myftinia e Shkupit vetëm nga mungesa e këtij objekti hotelerik ka humbur qindra mijëra euro dhe e ka varfëruar Vakëfin!

Qenan Ismaili duhet të tregojë se sa ryshfet ka dhënë për “kthimin” e disa pronave vakufore, të cilat, me patjetër që do të ktheheshin edhe pa kurrfarë korrupsioni, sepse janë ezauruar të gjitha procedurat e kthimit të cilat kanë filluar qysh më vitin 2007, me nënshkrimin e vendimit nga ana e ministrit të atëhershëm për kulturë, z. Arifhikmet Xhemali, i cili i përgjigjet komisionit pranë ministrisë së financave se, një sërë objektësh, kryesisht në Çarshinë e Vjetër, mund t’i rikthehen pronarit të vërtetë (BFI-së), meqë nuk i mbulon Drejtoria për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Janë dëmshpërblyer shumë objekte me letra në vlerë dhe, që të gjitha i ka hëngër macja! Kurse mësimet islame thonë se me paratë

e vakëfit shtohet vakëfi dhe jo të bëjë qejf, ndere e favore Shaqir Fetai dhe Qenan Ismaili.

Pa, dolëm te e vërteta e trishtë, te ajo e vërtetë që dhemb, të cilin autori i shkrimit “Periudha më e errët e Vakëfit brenda shekullit të fundit”, sikur e fsheh sikur nuk e thot, sikur i vie rënd që ta shpalosë dhe t’i bie pikës mbi “i”!

Ja pra, pse kjo periudhë qenka më e pashpirta në raport me Vakëfin. Sepse, në periudhën e parë postosmane vakëfin ta paska grabitur e dëmtuar okupatori mbretëria serbe, në periudhën ateiste vkëfin e paska eksploatuar sistemi ideologjik antifetar, kurse në periudhën e fundit, në sistemin demokratik, Vakëfin e dëmton, e vjedh, e shet, e tëhuajëson, e fal për interesa idiotike, vetë hoxha! Këtë krim e bëjnë hoxhallarët, e bën Shaqir Fetai, e bën Qenan Ismaili... Pra, armiku i vetëm i Vakëfit na dalin hoxhallarët! A ka më trishtim se kjo?

Zot, derdh mallkim mbi keqpërdoresit e vakëfit si dhe mbi të gjithë ata vrojtues të këtij keqpërdorimi, tolerues të këtij harami! /1KlikLarg/08.10.2021

Zyrtarizimi i përvetësimit të vakëfit

Këto ditë u shkrua dhe u tha gjithçka mbi grabitjen, përvetësimin dhe shkatërrimin e vakëfit nga instalimi politik i Shaqir Fetait në kye të BFI. Vjedhje është edhe mohimi apo fshehja e kontributit të të tjerëve që e dhanë për kthimin e pronave e që po koincidon që të kthehen pikërisht tani, kur me lezet po i shkatërron Shaqua me honxho bonxhot e vet

Nga Ilir R.Topi

Kiç-Instalacioni politik i pushtetit aktual maqedonas, Shaqir Fetai, paska marrur pjesë në mbledhjen e fundit të Myftinisë së Gostivarit e cila, i paska raportuar për ramazanin e vitit që po e lëmë, për kurban bajramin si dhe për aktivitete të tjera! Tani kur është koha të fillohet të mendohet për aktivitetet e festave fetare të vitit të ardhshëm, Shaqir Fetai lejon që të debatohet mbi të kaluarën dhe të gjejë fije kashte ku të mbahet!!! Shaqir Fetai nuk guxon t'i mbajë peng mbledhjet e myftinive dhe ato të mbahen vetëm ky kur është i lirë, kur t'i dojë b... Mbledhjet mbahen menjëherë pas manifestimeve, festave, aksioneve fetare ndërsa në kryesi dërgohen raportet nga mbledhjet prej nga edhe informohet instalacioni Shaqir Fetai! Pra, këtij farë "reisi" të leshit nuk i intereson jeta fetare, nuk i interesojnë aktivitete, as sukseset, por, thjesht, i intereson "madhështia" e vet e cila duhet të jetë prezente në çdo mbledhje!

Myftinia e Gostivarit, thotë Shaqir Fetai, sivjet i paska tejkalkuar pritshmërinë e BFI-së? Jo more, pse, a vetëm pse edhe ky e instaloi një myfti siç u instalua vetë dhe, hajde burra, ta lavdërojmë m...

tim!

Çfarë kryesie qenka ajo që pret shumë më pak ndërsa organi i sjell shumë, shumë, shumë më tepër!?

Nejse, nëse nuk vetëlavdërohen, kush do t'i lavdërojë?

Dhe, qershia mbi tortë ndodhë në fund të mbledhjes! I frustruar nga shpalimi i shkatërrimit të vakëfit që po ia bën Shaqir Fetai, i kompleksuar deri në veshë, i turpëror e i fajësuar nga largimi i Bankës Islame për Zhvillim që dëshironte të bëjë vakëf për Gostivarin një qendër tregëtare miliona euro, Shaqir Fetai shpik një risi të turpshme: “Në fund m’u dorëzua Vendimi i plotfuqishëm i pronës së re vakuf i BFI në teritorin e Muftinisë së Gostivarit.” A është i vetëdëshëm se çfarë bën Shaqir Fetai? Hiç më pak se sa ai, në fakt, e zyrtarzon zhvatjen, vjedhjen, shkatërrimin e vakëfit!

Shaqir Fetai nëse nuk është pronar i atij vakëfi, nuk është, ama bash nuk është kurrfarë personi që duhet t’i dorëzohet vendim për pronën e Myftinisë së Gostivarit, madje ky gjest idiotik nuk është i sanksionuar me asnjë ligj dhe me kurrfarë rregullore! Vendimi i është dorëzuar këtij organi si dokument se tash e tutje prona i kthehet Myftinisë. Nëse Shaqir Fetai dëshiron të luajë lojëra sa për ta zbutur shkatërrimin që po ia bën vakëfit, dhe merr në dorëzim një dokument i cili e vërteton se pronar i kësaj prone është BFI, atëherë, duhet ta ketë të qartë se Shaqir Fetai ka rënë në pozita të postierit apo të kuririt të thejshtë. Sepse, ky dokument nga ana e Myftiut të Gostivarit ka mundur të nisët edhe përmes kuririt apo shoferit të tij dhe të dorëzohet në arkivin e BFI-së! Pse t’i dorëzohet Shaqir Fetait, pse t’i jepet edhe roli i kuririt! Ofendim, ë! Nejse, edhe ky është një isharet që flet se, pa të lënë mendja, nuk bëhesh për në “Bardovcë”!

Hej, po Shaqir Fetai është në fushatë partiake! Po ai duhet të dëshmojë se është në funksion të agjitacion-propagandës partiake të atij pushteti maqedonas që e instaluan si qyp të ndyrë në krye të BFI-së? Po disa nga pronat e kthyera që i përmend Shaqir Fetai janë kthyer qysh në fillim të vitit. Pse ka nevojë t’i nënvizojë tani, në fund të fushatës zgjedhore? A mban mend dikush se a ka kundërshtuar diçka Shaqir Fetai që e dëmton interesin e BFI-së? Jo, sepse, Shaqir Fetai është shumë i vetëdëshëm se vetë ai është dëmi më i madh që i është bërë interesit të BFI-së përgjatë histoikut të vet! Tani kur po shpalosen faktet që flasin se si Shaqir Fetai po i vjedh edhe meritat e huaja por edhe po e shkatërron pronën e vakëfit, është krim që të flasë tani Shaqir Fetai për

pronën që po i kthehet BFI-së. Ai duhet të flasë për pronat e Vakëfit që i ka hëngër “kuta partiake” , në kohën derisa ai po vegjeton si instalacion politik! Pastaj ky flet për haramin dhe hallallin. Harami flet për hallallin! Zot, ruana!/Fakte/09.10.2021

Cinizmi idiotik i Shaqir Fetait

Ndërkombëtarët duhet të reagojnë dhe t'ia tërheqin vërejtjen Shaqir Fetait, i cili, pa dyshim që BFI-në e ka shndërruar në filiale partiake ndërsa vetë, me të gjitha organet e BFI-së është vënë në shërbim të fushatës së partive që e sollën në pushtet sa për ta zhvatur vakëfin. Shaqir Fetait nuk i intereson vakëfi, i intereson “mirëqenia” në kolltukun e të parit të BFI-së

Nga Masar Nuhiu

Shaqir Fetait paska “dekoruar” një anonimus partiak, i cili, sipas Sh. F. paska kontribut të jashtëzakonshëm në kthimin e pronave të BFI-së, respektivisht, të Myftinisë së Shkupit! A është i vetëdijshëm Shaqir Fetait se çka flet? A aq naiv është ky farë “reis” duduku dhe mendon se mund t'i anashkalojë të gjithë faktorët relevantë, të gjitha proceset, të gjitha kontributet reale që u dhanë përgjatë këtyre dy decenieve për denacionalizimin e pronës së Vakëfit të BFI-së? Shaqir Fetait, në mënyrë perfide mundohet që kontributin e një varg faktorësh t'ia atribuojë një personi të një subjekti politik, të cilit madje, nuk e njohin as vetë anëtarët e kryesisë së asaj partie! Nuk është me rëndësi kjo, e rëndësishme është që të nënvizohet se, “ky është kontribut” i personit që është funksionar partiak i BDI-së!

Pse kjo lojë e Shaqir Fetait në emër të kthimit të pronës që i përket BFI-së? Pse kjo fushatë kaq naive e Shaqir Fetait, pse tani, kur dihet se kthimi i këtyre pronave është një proces i cili pas vetes tërheq një kontribut të jashtëzakonshëm të ish-reisul ulemasë H. Sulejman ef. Rexhepit! Ku është këtu kontributi i myftive paraprakë, i myftiut aktual? Secili referent përkatës pranë Myftinisë së Shkupit ka kontribut e angazhim më të madh se sa “i dekoruari” anonim i Shaqir Fetait! Mirënjohja nuk është dekoratë,

kurse Shaqir Fetai e kupton këtë gjë por, ja që ia do b... që të tallet me njerëz, si gjithnjë, verbalisht të deklarojë se ka “dekoruar” kuadrin partiak dhe me këtë të gjitha meritat t’i shkojnë “partisë mëmë”!

Jo vetëm angazhimet dhe kotributet e pararendësve, jo vetëm proceset dhe mbledhja e të gjitha fakteve që dokumentojnë të vërtetën e BFI-së, por edhe dokumente plotësuese arkivore dëshmojnë për angazhimin e faktorëve të ndryshëm, të cilët sollën deri në këtë moment që, prona të kthehet në BFI kurse Shaqir Fetai ta përjetojë këtë proces si servimin e kafesë që ia bën vjehrra nuses!

Në arkivin e Ministrisë së Kulturës, gjendet edhe një dokument i arkivuar me numër 02-2364/1 të datës 19. 02. 2008, i nënshkruar nga ish-ministri shqiptar, Prof. Arifhikmet Xhemali, i cili nënshkruan mendimin e kompetentëve lidhur me pronat e BFI-së, konkretisht: Kapan Hanin, Suli Hanin, Bezistenin dhe Allaxha Xhaminë, me kërkesë të Komisionit qeveritar për denacionalizimin e pronave të bashkësive fetare.

Dokumenti i nënshkruar në fakt jep miratimin kompetent për t’u përgjigjur pozitivisht në kërkesën e BFI-së për denacionalizim të Vakëfit.

Ky është momenti kur ligjërisht futet në procedurë kthimi i këtyre pronave të BFI-së që shtrihen në territorin e Myftinisë së Shkupit. Nga ky moment janë mbajtur dhjetra seanca gjyqësore, është paguar sigurimi i dokumentave dhe grumbullimi i tyre, ka pasur persona që janë konfrontuar me gjykatës hilexhinjë e me subjekte tendenciozë që kanë pasur synim dëmtimin sa më të madh të Vakëfit, janë kërkuar dhjetra takime me subjektet qeveritare, janë shprehur dhjetra ankesa te faktori relevant ndërkombëtar prej të cilëve është kërkuar ndërhyrja për kthimin e pronës së nacionalizuar. Nëpër takime të tilla, në bisht të delegacioneve ka qenë edhe Shaqir Fetai, pra, ai i di shumë mirë kontributet e gjithësecilit! Prej nga atëherë ”dekoratë” një anonimusi partiak, një administratori, i cili, si të gjithë administratorët e tjerë, edhe ky ka kryer eventualisht ndonjë detyrë ditore institucionale. Hiç më shumë!

Prandaj, është mirë që Shaqir Fetai të heq dorë nga manipulimi, nga fushata partiake, të heq dorë nga cinizmi idiotik që e shpreh sa për të mohuar çdo proces para se të instalohet ai udbash në krye

të BFI-së!

Shaqir Fetai, nëse jep “dekorata” për kthim të pronave, atëherë, çka duhet me i dhënë vetë Shaqir Fetait, humbësit të pronave të vakëfit, dëbimit të institucioneve bankare arabe që shprehin interesim për të ngritur vakëf në vlerë prej miliona eurove! Këtë gjest prej udbashi Shaqir Fetai nuk mund ta kamuflojë me “dekorime” të anonimusëve si dhe me përvetësim e personalizim të punës së një plejade të tërë teologësh që kanë kontribuar që denacionalizimi, sado minimal, të bëhet realitet!

A mund të na thotë në përqindje Shaqir Fetai, cili është kontributi i të “dekoruarit” partiak dhe cili është kontributi i Myftiut aktual? Cili është kontributi i referentve përkatës të Myftinië së Shkupit? Po kontributi i drejtorit të Sektorit të Vakëfit?

Meqë e ka për shpirt ”dekorimin” Shaqir Fetai, pse nuk i ndanë dekoratë Prof. Arifikmet Xhemailit, në kohën e të cilit, Ministria e tij i ndau BFI-së donacione në qindra mijëra euro! Për herë të parë kjo Ministri në kohën e z. Xhemailit u ndau ndihmë xhamive në ndërtim në vlerë prej mbi 100 mijë euro! Ky ministër i dha të gjitha pëqlimet, dha leje për kthimin e domosdoshëm të çdo prone të Vakëfit që deri atëherë llogaritej si “pronë e përbashkët”!

Cinizmi i Shaqir Fetait mund t’i bëjë dëm vetëm atij, ndërsa të tjerët do ta vështrojnë vetëm si një shpirt të mjerë, të zi, të poshtër.../Kombetare/13.10.2021

Shaqir Fetai “kampion” i budallallosur i praktikave skandaloze

“O besimtarë, përse thoni atë që nuk e bëni? Është shumë e urryer për Allahun të thoni atë që nuk e bëni!” (Es-Saff, 2-3)

Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI

Shaqir Fetai, iu paska drejtuar qytetarëve të Maqedonisë së Veriut si “kryetar shteti” me një apel që të jenë pjesëmarrës masovik në zgjedhje të qeta, të lira dhe demokratike! Kurse me këtë veprim prej manjaku nuk u mor as media, as opozita e tij dhe as faktori ndërkombëtar! Në këtë rast, kur hesht një zinxhir faktorësh me relevancë në vend, atëherë kjo do të thotë kemi të bëjmë me një idiot, me një të shashtisur të cilit nuk duhet t’i reagohet, sepse të merresh me një të budallepsur është edhe mëkat por edhe gjynah! Shaqir Fetai thërret në zgjedhje demokratike?! Po me çfarë zgjedhesh u instalua ai në krye të BFI-së? Ka të drejtë ky farë manjaku që të apelojë për zgjedhje demokratike ndërkohë që për vete i theu të gjitha parimet, të gjitha rregullat, të gjitha nenet kushtetuese, të gjitha ligjet e shtetit, të gjitha porositë e shenjta, vetëm e vetëm që ta çojë në vend qëndrimin e shërbimeve të huaja që të pranojë të instalohet në mënyrë të përçëdnueshme në krye të BFI-së!

Kush ia kërkon këtij farë loloje një apel të këtillë! Me sa të drejtë i drejtohet të gjithë qytetarëve të vendit? Apo, ta përkufizojm, si ia nisë këtë apel besimtarëve, respektivisht, shqiptarëve të vendit!? Thua të jenë këta ata më problematikët ndaj duhet që “i pari i fesë” t’i lusë për zgjedhje të qeta, që do me thënë, jo të dhunshme, jo të përgjakshme; të lira, do me thënë, të mos ushtrojnë dhunë, trysni mbi votuesit por të jenë të lirë në dhënien e votës për ata, për të

cilët janë përcaktuar paraprakisht; të jenë demokratike, do me thënë, të mos jenë të manipuluar dhe jasht standardeve që i ka vënë demokracia dhe që i kërkon bota demokratike! Pse pranon Shaqir Fetai që të ofendojë shqiptarët, apo, kush ia ka kërkuar këtë ofendim kaq të turpshëm?

Çka e lidhë Shaqir Fetain me këto zgjedhje? Pse të apelojë Shaqir Fetai (pse të lëshojë letër qarkore deri te Myftinitë e caktuara duke kërkuar prej myftinjëve që të ndikojnë tek imamët të apelojnë të votohen kandidatët e një partie e cila e instaloi këtë farë burri të ligë në krye të BFI-së?)

Zgjedhjet e lira dhe të ndershme qenkan “obligim ndaj elektoratit”?! Mos do të thotë Shaqir Fetai se elektorati në RMV është i thirrur që të zhvillojë zgjedhje të lira e të ndershme?! Këto zgjedhje qenkan “obligim ndaj imazhit të shtetit tonë”!!! Mos do të thotë Shaqir Fetai se zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë obligim për imazhin e shtetit tonë?!

Si, “ndaj miqve tanë”?! Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë obligim i elektoratit të RMV-së sepse këtë e kërkojnë miqtë tanë! Mbase këtë e mendon Shaqir Fetai? Apo, ai fare nuk mendon, sepse është mësuar t’ia fusë si kau pelës!

“Të Dielën më 17 Tetor 2021, e kemi për obligim që nëpërmjet votës dhe sjelljes tonë të japim kontributin në ngritjen e nivelit demokratik dhe në organizimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme të cilat janë parakusht për ardhmërinë e Maqedonisë së Veriut.” – thotë Shaqir Fetai?

Po cili është parakushti për ardhmërinë e Bashkësisë Fetare Islame! Tradhëtia e Shaqir Fetait? Komploti i Shaqir Fetait? Pranimi për një instalim të dhunshëm të tij në krye të BFI-së? Sjellja e Shaqir Fetait llogaritet si “ngritje e nivelit demokratik” apo si ngritje e nivelit shkatërrimtarë të BFI-së?

Në tërë këtë apel të Shaqir Fetat është një hile, është një ofendim, është një mesazh i tij që shpërndahet si porosi e atyreve që përkujdesen për nxirjen e imazhit të elektoratit shqiptar! Shaqir Fetai apelon që të dalin sa më masovikisht në votime? Pse? Sepse vota sa më masovike në fakt e pengon mundësinë për vjedhje, për mbushje të kutive. Do me thënë, Shaqir Fetai ka informacion, Shaqir Fetai na del prej kruzhokqeve ku përflitet se në këto zgjedhje partitë shqiptare në pushtet do të tentojnë të vjedhin e të mbushin kutitë e votimeve, prandaj, dilni sa më masovikisht që me votën tonë ta parandalojmë këtë masakrim të votimit! Mesazh

shumë perfid i Shaqir Fetait, veti kjo e skuthave!
Shaqir Fetai sillet si të jetë “organi më i lartë shtetëror”, pastaj,
herë si “subjekt politik”, herë si “pararobjë e demokrracionit” (siç e
bastardon Shaqir Fetai fjalën demokraci)! E paska obligim BFI-ja
“që ta inspirojë elektoratin” të dalë e të vendosë për fatin e vet
katërvjeçar!

Njerëzit e mençur këto “punë” të këtij apeli paçavër i kryejnë pa
pompozitet, pa zhurmë dhe pa rënë në sy! Munafikët tjerë veprojnë
tjetër apelojnë, pikërisht, si Shaqir Fetai!

Shaqir Fetai është në shërbim të djallit, prandaj, përgjigjet,
pikërisht ashtu siç thonë kërçovarët “si gomari pa pokanë”!
Dhe, ja, pas Shaqir Fetait, të gjithë politikanët, liderët partiakë, do
ta koptojnë atë dhe do të apelojnë ngjashëm si ky! Po sikur liderët
partiakë, politikanët të dalin me apel dhe të kërkojnë që në
Bashkësinë Fetare Islame të organizohen zgjedhje të qeta, të lira
dhe demokratike! Apo, kjo do të llogaritej përzierje në punët e
brendshme të institucionit fetar? Zatën, Shaqir Fetai do të ngelë në
historinë e këtij Institucioni si “kampion” i budallallosur i
praktikave skandaloze./Mileniumi3/15.10 .2021

Shaqir Fetai “peshku i madh” i BFI-së

Shaqir Fetai po e stimulon sektarizimin fetar, ideologjik e politik të Bashkësisë Fetare Islame. Vetë është rreshtuar krahu “mjetit stimulativ” (LSDM-BDI) që ia ngacmon imagjinatën ku veten e sheh si “peshk i madh” i cili shumë shpejt do t’i gllabërojë “peshqët e vegjël” të BFI-së! Ai kërkon mbretërim të hapësirës dhe nuk duron t’ia turbullojë ujin asnjë “peshk”. Megjithatë, pa peshqët e vegjël ai bëhet kërm për hienat e bregdetit

Nga Vesel Azemi

Bashkësia Fetare Islame po vlon prej rrymave të ndryshme sektariane, ideologjike, partiake, përveçse që vlon prej hajnave, të pamoralshmëve, shkatërruesve të traditës historike të BFI-së. Shaqir Fetai e stimulon një situatë të tillë, sepse mendon se do ta ketë mundësinë më të madhe të shantazhimit përmes të cilit ai do ta mbërrijë pensionimin e vet. Këtë synim e ka Shaqir Fetai, nxënësi i eprorit të UDB-së, Stanko Dragoviqit! Sektet e ndryshme në BFI nuk e bëjnë hesap Shaqir Fetain, të gjithë e shantazhojnë. Në BFI-në aktuale stimulohet shantazhi i ndërsjellë, si dhe respektimi i ndërsjellë në veprimtarinë e kriminalizimit të BFI-së, në respektimin e organeve-rijasetë që drejtohen nga “13 reisë”! Shantazhet janë të natyrave të ndryshme, që dalin prej amoralitetit e deri te vjedhjet, zhatjen dhe hajnitë e ulëta. Shaqir Ftait më së shumti i ka interesuar edhe pozicionimi partiak i të punësuarve në BFI. Duke e ditur për secilin se ku është i pozicionuar, në cilën parti politike aderon, ai ka lëshuar letër qarkore përmes së cilës i

obligon muftinjtë që të kërkojnë prej hoxhallarëve të terreneve përkatëse që të agjitojnë për partitë politike që e instaluan në krye të BFI-së (LSDM-BDI). Prandaj pati edhe prej hoxhallarëve të cilët, pak prej joshjeve pak prej shantazheve, i përdorën qyrsitë dhe hytбет për të thirrur publikisht që të votohet iks maqedonasi, iks politikani, iks partia! Pati edhe prej atyre hoxhallarëve që agjituan për partitë e tjera. Këtë e stimuloi Shaqir Fetai, pak për të krijuar një “balans partiak”, sepse, nuk i dihet, mund të humbë partia e tij dhe, pak për të pasur mundësinë e shantazhit edhe më të madh mbi “teologët e padëgjueshëm”, të cilët, për vendin e punës do të pranojnë të shndërrohen në marionetë të Shaqir Fetait.

Kësaj radhe, si e hartëzoi partiakisht BFI-në Shaqir Fetai? Strugën, Kërçovën, Dibrën ua la ta kontrollojnë Aleanca-Alternativa, Gostivarin ia la BDI-së, Tetovën Besës, Shkupin e orientoi që ta ndihmojnë Grubin dhe Bujarin në dëm të Visarit dhe Izetit, Kumanovën, Velesin, Manastirin i urdhëroi që të punojnë për VMRO-në, kurse Strumicën, Resnjën, Ohrin, Prilepin ua la ta lërojnë LSDM-ja!

Edhe më fatale është sektarizimi i BFI-së. Kjo situatë nuk do të mund të kontrollohet për gjatë kohë. Nëse nuk ndërhyjnë faktorët relevantë, shumë shpejt në BFI do të krisë dajaku e plumbi, do të bëhen copë e kafshatë në mes vete, sepse, shantazhi po bëhet gjithnjë e më i pistë (po prek edhe shtratin bashkëshortor!!!). Po flitet se, ish-reisul ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, duke u bazuar në tërë dokumentacion arkivor që e ka, është duke përgatitur libër ku do t'i shtjellojë të gjitha dukuritë e ndodhura në BFI dhe rreth saj që nga BFI-ja post-komuniste e këndeje; do të flasë për “personalitetin” e të gjithë atyreve që i shërbyen për 10-15-20-25-30 viteve dhe, në fund, brenda natës e tradhëtuan dhe e komplotuan, duke hedhur gur e baltë mbi të!

Aktualisht, Bashkësia Fetare Islame në RMV është shndërruar në filiale partiake të BDI-së, si dhe në zyre të rrymave e sekteve të ndryshme, por edhe e “bashkësive islame” të reja. Sot BFI-ja është zyre edhe e LSDM-së, zyre legale e sekteve të ndryshme, turko-arabe, zyre e “forumit rinor islam”, zyre e “lidhjeve-zgjidhjeve rinor myslimane”, zyre e “aleancës”, e “alternativës”, “e udb-së”, zyre e rrymave dhe sekteve të dryshme që islamin e përdorin si kamuflim të veprimtarive që priten t'i ndërmarrin e të na bëjnë gaz i botës. Fatkeqësisht, ai që i grumbulloi dhe i futi brenda BFI-së me qëllim për t'i kontrolluar më lehtë dhe për t'i shfrytëzuar në interes të

BFI-së, nuk është më, u dëbua me tradhëti e komplot. Shaqir Fetai nuk mund t'i kontrollojë, sepse që të gjithë e kontrollojnë atë, që të gjithë i janë shndërruar në "këmbë karrike" dhe, tërheqja e secilës nga këto "këmbë" do ta rrëzonte Shaqir Fetain në kokërr të shpinës e me këmbë përpjetë. Prandaj ky nuk u bën presion, i lë të kullostin dhe të enjten pak, sepse, Shaqir Fetai do "mish"!

Shaqir Fetai po e stimulon sektarizimin fetar e politik të Bashkësisë Fetare Islame. Vetë është rreshtuar krah "mjetit stimulativ" (LSDM-BDI) që ia ngacmon imagjinatën ku veten e shih si "peshk i madh" i cili mund t'i gllabërojë "peshqët e vegjël" të BFI-së! Ai kërkon mbretërim të hapësirës dhe nuk duron t'ia turbullojë ujin asnjë peshk. Megjithatë, pa peshqët e vegjël ai bëhet kërm për hienat e bregdetit. Ata që e përkrahin daroviten me "dekoracione", ata që ia thejnë hundët duke e kritikuar për tradhëtinë dhe komplotin që e bëri, nuk i bën "lajm" që erdhën dhe ia uruan "postin"!

Shantazhi i ndërsjellë që po mbisundon aktualisht në BFI gjason në atë "bashkëjetesë" të bandave bullgare, të cilat u stimuluan dhe u lanë të veprojnë lirshëm nga qeveria bullgare e viteve'90!

Policia u tërhoq në breg, prej nga i ngacmonte bandat derisa krisi luftimi i njëra tjetrës. U vranë e u likuiduan gati të gjithë, kurse, ata që ngelën, u bënë kafshatë lehtësisht e kapërdishme e pushtetit!

Megjithatë, nëse nuk intervenohet sa më parë por lejohet që të stimulohet "strategjia bullgare e likuidimit të bandave" më së rëndi dhe më se keqi do ta pësojë Bashkësia Fetare Islame, sepse, aktualisht, ky Institucion po shërben, siç u tha më sipër, strehë e të gjitha "bandave" të BFI-së. Minimi i tyre do të thotë shkatërrim edhe i kulmit të përbashkët, që po i thonë "Bashkësi Fetare Islame" e RMV-së./1KlikLarg/17.10.2021

Qenan Ismaili ia bart kompetencat e myftiut ministrit Oliver Spasovski

Ish-reisul ulema i BFI-së H. Suejman ef. Rexhepi patjetër të ketë ditur gjë kur thoshte se FRI është filiale e shërbimeve sekrete maqedonase. Qenan Ismaili, si “liderçiç” i FRI-së së Shkupit, tash “myfti” i Myftinisë së Shkupit, me sjelljet e veta po e dëshmon katërcpërisht konstatimin e efendi Rexhepit

Nga Lazim Rexhepi

Muaj më parë, banorët e Nerezit paskan inicuar ndërtimin e një xhamie të re. Pas sërë takimesh, ndejash, konsultimesh, pas caktimit të grupit inicues, paskan nisur me ndërtimin e kësaj xhamie, e cila bëhet për nevoja të kësaj lagje, me përkujdesin, kontributin fizik dhe financiar të vetë banorëve të Nerezit. Si anekënd vendit, edhe në këtë lagje, xhemati vendor ka nisur ndërtimin të vetëdishëm se në fund, xhaminë me gjithë oborr por edhe me ndojë objekt përcjellës biznesor do t’ia lënë në pronësi Bashkësisë Ftare Islame në RMV. Në vend se “myftiu” Qenan Ismaili dhe instalacioni në krye të BFI-së Shaqir Fetai t’ua urojnë këtë dëshirë dhe iniciativë për të ngritur një Shtëpi të Zotit, prej këtyre të dyve u vie pengesa e ndërtimit të xhamisë. Nuk bën, u kanë thënë, po bëni vepër penale, (ndërtimi i xhamisë vepër penae?!?) sepse nuk keni leje nga shteti! Banorët e Nerezit janë interesuar të dinë se ku duhet ta marrin atë leje që puna mos t’ju ngelë përgjysëm. Kanë pasur takim edhe me Shaqir Fetain edhe me Qenan Ismailin por, që të dy u kanë thënë se patjetër duhet të

takohen me Ministrin e Punëve të Brendshme, z. Oliver Spasovskin, i cili do t'u japë ose nuk do tu japë leje për vazhdimin e punëve për ndërtimin e xhamisë së re.

Në Maqedoninë e Veriut janë ndërtuar me qindra xhami pa kurrfarë leje të shtetit, sidomos në zonat rurale, ku vetë banorët ndajnë lokacion dhe vetë ata e ndërtojnë. Në fund, i dorëzohet në pronësi BFI-së e cila bën kërkesë për ta legalizuar. Kaq! Institucionet shtetërore nuk janë ata që duhet të përcaktojnë nëse i duhet xhematit një xhami apo jo! Kjo është nevojë e banorëve dhe ky është obligim i Institucionit që përkujdeset për jetën fetare islame anekënd vendit.

Një grup qytetarësh nga Nerezi kanë realizuar takim edhe me Ministrin, z. Oliver Spasovskin. Sipas tyre, ministri në fjalë kategorikisht ka qenë kundër ndërtimit të xhamisë, për më tepër tani në kohën e zgjedhjeve vendore. Ka qenë kategorik edhe kundër madhësisë së xhamisë, paçka që projektuesi e ka paraparë nja 10 herë më të ulët se “Kryqi i Mileniumit” në Vodno!.

Oliver Spasovski, së bashku me zëvendësin e vet, kanë ushtruar trysni mbi këshillin nismëtar që ta ndërpesin punën dhe të presin sa të përfundojnë zgjedhjet, sepse opozita mund ta keqpërdorë këtë fakt dhe t'ua nxijë “imazhin” LSDM-BDI si koalicion që në prag të zgjedhjeve ndërtojnë xhami!

Po tani që do të përfundojnë zgjedhjet, cila do të jetë sjellja e “myftiut” të zhveshur nga ingerencat! Po halli i Shaqir Fetait – cili do të jetë? Për hirë të “imazhit” të LSDM-BDI-së duhet të heqim dorë nga ndërtimi i Shtëpisë së Zotit! Mbase këtu Shaqir Fetai e Qenan Ismaili e involvojnë kot e kot BDI-në, sa për ta nxirë para myslimanëve? Mbase strukturat e dyshimta të BFI-së (Qenanat e Shaqirat) punojnë për imazhin e LSDM-së, qoftë kjo edhe me ndërprerje të ndërtimit të xhamisë!

Banorët kanë realizuar kontakte edhe me subjekte të ndryshme si në nivel vendor ashtu edhe në atë qendror. Asnjëherë njuk janë shoqëruar nga “myftiu”, asnjëherë nuk kanë pasur ndonjë letër motivimi, ndonjë letër përkrahje, ndonjë kërkesë deri te organet kompetente shtetërore nga ana e Shaqir Fetait me qëllim që mos të parqiten pengesa administrative përgjatë ngritjes së kësaj xhamie si nevojë e domosdoshme e banorëve të Nerezit. Janë demotivuar si nga Shhaqir Fetai ashtu edhe nga Qenan Ismaili, ndërsa nëpër takime ua kanë dhënë ndonjë “referent” të Qenan Ismailit që nuk dinë të flasin as maqedonisht, as të sqarojnë e as t'i shtyjnë punët

përpara por që shquhen si ekspertë të pengimit dhe të përcjelljes së mesazhit të Shaqir Feait e të Qenan Ismailit – mos lejoni para zgjedhjeve të ndërtohet xhamia, ky është qëndrimi edhe i Oliver Spasovskit.

Se cili do të jetë fati i kësaj xhamie ndërtimi i së cilës është ndërprerë përkohësisht, kjo do të varet sapo të përfundojnë zgjedhjet vendore. Banorët janë të vendosur që, do ta ndërtojnë pa lejuar asnjë individ, qofshin ata edhe zyrtarë të lartë, por as struktura të kriminalizuara të BFI-së që të pengojnë ndërtimin e saj. Xhamati nuk dëshiron që xhamitë e domosdoshme t'i lidhë me zgjedhje vendore apo parlamentare. Xhamitë nuk i duhen as Parlamentit por as komunave, ato u duhen besimtarëve, për t'u falur aty e për t'u lutur për mirëqenie, për mbarësi, për devotshmëri e për prosperim si të komunitetit ashtu edhe të shtetit. Aty, pra, te kjo xhami e re, mund të shkojnë e të falen edhe Qenanat e Shaqirat, natyrisht, pa pasur nevojë që të marrin leje për falje prej Spasovskave!/Lajme7/19.10.2021

Pasojat e mungesës së identitetit kulturo-etnik

Nga Agim Idrizi

Medresetë janë shkolla të mesme profesionale që përgatisin kuadro fetar për nevojat e institucioneve të komuniteteve myslimane. Sot, anekënd trojeve shqiptare funksionojnë dhjetëra medrese. Pas rënies së Perandorisë Osmane, këto shkolla fetare do të mundohen ta ruajnë fizionominë dhe traditën e vet fetaro-arsimore. Në atë periudhë, gjegjësisht gjatë viteve 1918-1939, vite këto të sundimit të Mbretërisë së Jugosllavisë, në viset etnike shqiptare, të cilat i mbulonte Ulema Mexhlisi i Shkupit, funksiononin rreth tridhjetë medrese, private e shtetërore, prej të cilave si më të njohura ishin Medreseja Gazi Isa Beu, Medreseja Medah dhe Medreseja e Madhe, “Aleksandri I”, në të cilën ligjëronin kryesisht “hoxhallarë” serbë, rusë etj. Megjithatë, nga këto medrese do të dalin personalitete që kanë lënë gjurmë në historinë kombëtare shqiptare, siç ishin: Sinan Hasani, Hivzi Sulejmani, Abdulla Krashnica, Ibrahim Kelmendi, Idriz Ajeti, Mehmedali Hoxha, Azem Morana, Ilmi Shehu, Haki Efendi Sermaxha, Shaip Mustafa e shumë të tjerë. Përkundër fakteve historike që flasin për këtë epokë si për njëjërën nga më të errëtat dhe më të trishtat për shqiptarët e viseve etnike, megjithatë shqiptarizma që kishte marrë hov gjithandej tokave shqiptare, po ndikonte në çdo sferë të identitetit kombëtar. Ndonëse përkujdesi i “hoxhallarëve” serbo-rusë për të serbizuar sa më shumë shqiptarë ishte i jashtëzakonshëm, i shoqëruar edhe me përndjekje, më tortura, me vrasje, me presion për shpërngulje sa më masovike, megjithatë, këta medresantë, por edhe shumë të tjerë, nuk devijuan nga identiteti kombëtar dhe nga interesat e popullit të vet! Medreseja e Madhe “Aleksandri I” ishte e akredituar nën vëzhgimin e qeverisë mbretërore, “kuadri teologjik” përzgjidhej dhe punësohej vetëm me lejen e ministrisë së Arsimit, kuadër ky që në shumicë absolute ishte nga përkatësia serbe, ruse dhe

boshnjake sa për t'i dhënë nuanca të “myslmanizmit”!
Gjatë Jugosllavisë ateiste, të gjitha këto medrese do të mbyllen. Më vonë, në disa qendra do të hapen dy-tri medrese. Në Shkup gjatë viteve '80, do të startojë Medreseja Isa Beu, e cila do të ngelë vatër arsimore e Bashkësisë Fetare Islame. Mbi tridhjetë vite kjo shkollë fetare do të financohet vetëm nga popullata e vendit, asnjë cent nuk do të derdhet në xhiro-llogarinë e saj nga buxheti i shtetit. Shteti nuk do ta njohë, nuk do ta akreditojë as sot e kësaj dite. Shteti i Maqedonisë së Veriut nuk i njeh diplomat e kësaj shkolle të mesme, prandaj edhe ka urdhëruar të gjitha universitetet e vendit që mos të regjistrojnë asnjë medresant në asnjë fakultet. Për pasojë, për herë të parë do të organizohen protesta nga ana e nxënësve të kësaj Medrese që do të shprehin revoltë dhe pakënaqësi si kundër Ministrisë së Arsimit, ashtu edhe kundër Bashkësisë Fetare Islame!

Çuditërisht, nga ana tjetër, kjo shkollë fetare islame, si asnjë shkollë fetare në rajon e më gjerë, do të shërbejë si “poligon” i rekrutimit të bashkëpunëtorëve e të nëpunësve të shërbimit inteligjent maqedonas. Është “sekret publik” fakti se pas një “konkursi intern” në ish-drejtorinë maqedonase për zbulim dhe kundërzbulim janë pranuar njëherazi 8 medresantë shqiptarë! Medresantët nuk kanë të drejtë të vijojnë arsimimin sipëror, kurse pranohen me shumë lezet në zbulim e kundërzbulim! Nuk është e qartë se prej nga kjo dëshirë kaq e madhe e medresantëve për të punuar si bashkëpunëtorë, operativë apo “nëpunës” të zbulimit dhe kundërzbulimit; prej nga kjo dashuri e medresantëve për t'u shtrirë në rrjetin e spiunazhit; nuk është e qartë akoma se cili është kontributi i personelit arsimor, etnikisht “shqiptarë”, i kësaj Medrese! Cili është kontributi i parisë fetare! Cili është kontributi i partive politike shqiptare?

Kurse kreu i BFI-së gjithnjë këtë përfshirje të medresantëve në këtë shërbim inteligjent e ka konsideruar si punë shumë të madhe, si kontribut të kësaj vatre arsimore që përkujdeset për shtetin, ndonëse shteti nuk e shpreh as të voglin respekt për medresantët e “Isa Beut”! Ç'moral i ulët i kësaj logjike “të hoxhallarëve”: “Sa më shumë të kemi të njollosur, aq më e vogël do të jetë përqeshja në mes nesh”!/Hejza/19.10.2021

Idiotizëm, diletantizëm, amatorizëm, deziluzionizëm...

Bashkësia Fetare Islame e Shaqir Fetait po gufon nga këta “izma” të cilët shpiejnë, pa dyshim, në defaktorizim dhe në shkatërrim të Institucionit shekullor – BFI-së. Bartës të këtyre emërtimeve janë idiotët, diletantët, amatorët, ata që zhgënjejnë e që në këtë Institucion janë me bollëk, aq sa do të duhej një tërplotë gjigante për t’i hedhur në pleh

Nga Visar Nika

Përfundimisht, ata që i ndjekin “aktivitetet” dhe kahet e zhvillimeve të BFI-së, tashmë e kanë të qartë se, Shaqir Fetai, jo që është naiv, jo që është amator, jo që është totalisht dibidus, por, mbi të gjitha, ai e ka mision degradimin e BFI-së deri në arenë të sjelljeve idiotike pas çka, detyrimisht, duhet ose një kurim thelbësor ose një dry epik në dyert e këtij Institucioni shekullor.

Izolimin total Shaqir Fetai “e then” duke i “vizituar” organet e Rijasetit?!

Kiç-instalacioni i pushtetit që mezi po rri ulur në shkamb të kalbur, Shaqir Fetai, për të dëshmuar se është në lëvizje, se nuk është tërësisht i izoluar, endet nëpër organet e BFI-së duke i titulluar këto endje si “vizita”! A ka më turp se “reisi” t’i vizitojë organet nën drejtimin e të cilit janë që të gjitha?! Shaqir Fetai, është shumë i vetëdëshëm se, në atë Organizëm të trungut të myslimanëve të Maqedonisë së Veriut, është si trup i huaj, i refuzueshëm, i papranushëm për organizmin, i cili, duke ikur nga “antitrupat”, shumë shpejt do të nxirret përmes urinimit! Jashtëqitjes i shmanget përmes këtyre lëvizjeve, si p... n’tirqi, duke

i shitur si “vizita”! Në Medrese nuk shkon reisi për ta vizituar këtë organ, porse, aty patjetër që duhet të ketë 10-15 takime në vit, takime pune, me të gjithë të punësuarit e institucionit arsimor, me nxënës e me personelin teknik!

Pse ta “vizitojë” Medresenë Shaqir Fetai në prag të fillimit të vitit shkollor, kur është dashur të ketë takim pune, të prezantojë strategji, apo të kërkojë nga drejtori strategji se si do të tejkalohet situata aktuale disfavorizuese e Medresesë; t’i jepet shpresë nxënësve të Medresesë se si sivjet do të akreditohet kjo vatrë arsimore dhe se si sivjt, në tetor, të gjithë medresantët e interesuar mund të regjistrohen në cilindo fakultet shtetëror. Në Medrese shkohet edhe si në zyre ku duhet të planifikohet një reformë thelbësore, ndryshime rrënjësore kadrovik, të prezantohet programi dhe mënyra e implementimit të tij me synim rritjen e cilësisë mësimore dhe të kapaciteteve teologjike për të nxjerrur kuadro të denja në krye të proceseve reformuese të përditshmërisë sonë fetare.

Nuk ka se çka i shkon reisi drejtorit të medresesë në zyre për t’u informuar në hollsi me punët e kësaj vatre mësimore! Kjo vatrë nuk është shkollë private e Shaqir Fetait dhe, drejtori nuk është punëtor privat i tij! Drejtori thirret në Rijaset dhe publikisht raporton mbi punët dhe problemet e Medresesë dhe jo sy më sy me Shaqir Fetain, i cili, më terpër e shantazhon me ndërrim se sa që i intereson Medersja. Ndërsa këtij shantazhi për largim nga posti drejtues, drejtori aktual i përgjigjet me kërcënim se “pa arritur gjaku deri në gjunj” nuk ka lënie të postit! Ja pra, deri në ç’nivel ka degraduar ky institucion arsimor i BFI-së – deri në vend ku mund të plasë në çdo sekond krimi! Shantazhi ngulfatet me përgjigje ekstremise! Si përfundim, mos ta ngacmojnë njëri-tjetrin dhe, që të dy të rrinë në punë të veta, edhe pse i kanë berbat!

Hipoktitët organizojnë “panel shkencor” për ditëlindjen e Pejgamberit a.s.

Nën patronazhin (!!!) e kiç-instalacionit të pushtetit të LSDM-BDI-së në krye të BFI-së, Shaqir Fetait, qenka organizuar një “panel shkencor” me rastin e Ditës së Lidnjes së Pejgamberit tonë, Muhamedit a.s. A ka më ironi se kjo! A ka më ofendim se kjo – një “institucion” i kapur nga imoralët, nga hajnat, nga tradhëtarët, komplotistët e pisat, organizon “panel shkencor” për Vulën e Pejgamberisë? Dhe, këta horra, mundohen t’i shesin “shkencë” njëri-tjetrit. Rijaseti organizon për anëtarët e Rijasetit “panel

shkencor”?! Njëri-tjetrit i shesin “ilëm”! Po a nuk guxuan që t’i mbledhin hoxhallarët, të paktën secila myftini nga nja 10-15 hoxhallarë dhe të mbanin një orë akademike më të dinjitetshme për një Institucion që është bartëse dhe zhvilluese e jetës fetare islame në vend! Apo, i ikën këtij tubimi nga frika se nuk do t’i shkonte askush, kështu që, të tubohen axhuzet dhe të diskutojnë në mes vete! Natyrisht, më i menquri prej tyre do të prezantohej më injoranti i të gjitha kohërave – Shaqir Fetai! Po a i ka hije këtij të flasë për Pejgamberin! A i ka hije këtij të na tregojë për praktikat e Pejgamberit! A i ka hije Shaqir Fetait të diskutojë mbi këtë Personalitet të papërsëritshëm në tërë historinë e njerëzimit, ndër kohë që, vetë ai, veprimet e tij, fryma e tij, intrigat e tij, truri i tij, tërësisht janë në kundërshtim me porositë esenciale të Pejgamberit për njeriun e mirë! Njeriu i keq si Shaqir Fetai, komplotisti, tradhëtari, instrumenti politik, përkrahësi i imoralitetit, mynafiku, shpirtkatrani, fytyrëzi, i rrethuar me honxho-bonxhot e vet, nuk guxon as ta zë ngojë emrin e Pejgamberit a.s. Sepse, e ka haram! “Shkenca” e Shaqir Fetait bazohet në haram, “ilmi” i Shaqir Fetait bazohet në diletantizëm, në idiotizëm, në cinizëm, në intriga që do t’ia kishte lakmi edhe vetë shejtani! Vetëm shejtanit do t’i shkonte të mendo një “panel shkencor” sa për të diskutuar me “ushtarët” e vet!

Çka i tha ambasadori i Egjiptit Shaqir Fetait

Shaqir Fetain e paska vizituar edhe ambasadori i Egjiptit në Sofje, i cili e mbulon edhe Shkupin! Kjo vizitë qenka realizuar ekskluzivisht sa për t’i thënë Shaqir Fetait se “e vlerëson lartë punën dhe funksionimin e BFI nën udhëheqjen e H. Hfz. Shaqir ef. Fetait si dhe i dëshiroi shëndet e shumë suksese në realizimin e aspiratave në të ardhme të këtij institucioni fetar islam në RMV”! Kurse Shaqir Fetai i paska folur ambasadorit për Medresenë Isa Beu!!!

Ndjekësit e protokolit të këtyre vizitave, pra, të ambasadorit egjiptian në BFI, e dinë fare mirë se, vizitat e tilla, gjithnjë kanë rezultuar me nënshkrim të marrëveshjeve në mes të përfaqësuesve të shtetit egjiptas, ambasadorëve, me reisin e BFI-së (H. Sulejman ef. Rexhpin), marrëveshje këto që kanë paraparë kuotë të caktuar për studentët shqiptarë për në Universitetin e El-Az’harit si dhe bursa e lehtësime të ndryshme! Ndërsa, për herë të parë kjo vizitë bëhet sa për t’u njohtuar ambasadori me punët e Medresesë!!! Veç kësaj, në fund të takimit qenkan marrur vesh për një

“bashkëpunim të ndërsjellët dhe çështje të ndryshme që tangojnë palët”!

Epo, cila është ajo çështje që e tangon palën egjiptase dhe BFI-në? Natyrisht, ambasadori egjiptas, sipas informatave burimore që dalin nga brenda BFI-së, është interesuar ekskluzivisht për kapacitetet e Rijasetit, konkretisht të Shaqir Fetait, për t’u përballur dhe për t’i eliminuar elementët recidivë të “Vëllazërisë Myslimane” që në BFI, sipas informatave të palës egjiptase, qenkan me bollëk!

Lukunia e përjargur nën petkun fetar

Në Tiranë qenka organizuar një konferencë nën moton që mund të kuptohet vetëm nga organizatori dhe me temë që mund të zbërthehet, po ashtu, vetëm nga organizatori (ose, përkthimi është idiotik sa, tërë konferencën e bën alogjike), në të cilën paska marrur pjesë edhe përfaqësuesi i BFI-së, “drejtori i sektorit për marrëdhënie me jashtë dhe me organet e brendshme”, Mustafa Dauti!

Natyrisht, kjo pjesëmarrje hedh hije mi të gjithë të pranishmit në këtë konferencë, e njollos tërë organizmin, e bën të pakuptimtë dhe të kotë. Sepse, ky farë përfaqësuesi, Mustafa Dauti, është njeriu më kantravers i BFI-së, hajn e antihuman, pronar i sërësh pronave të paligjshme, njeri imoral për të cilin janë shkruar qindra artikuj duke e lakuriqësuar deri në palcë, person me përgatitje akademike të falsifikuar e të blerë! Ky të flasë për ekstremizmin fetar? Ky që nuk ka lënë asnjë qark ekstremist pa bashkëpunuar vetëm e vetëm që të arrij deri te një pasuri marramendëse, krejtësisht të paligjshme!

Ky paska folur për “rolin dhe kontributin e BFI ne ruajtjen tolerances, mirkuptimin, dialogun nderfetar dhe nderetnik, masat e ndërmara per parandalimin e radikalizmit dhe extremizmit te dhunshem por gjithashtu paraqiti edhe sfidat me te cilat perballet BFI”?!

Të gjithë faktorët relevantë e dinë që roli i BFI-së si dhe kontributi i saj si Institucion në ruajtjen e tolerancës dialogut ndërfaqetare dhe ndërfaqetare është zero! Zero! Roli dhe kontributi në BFI ka qenë individual dhe, dihet se kush e ka kryer këtë rol dhe kush ka dhënë kontribut në këtë drejtim! BFI-ja është nocion shumë i gjërë, apo, siç do të thoshte Shaqir Fetai “BFI qonka diçka shuumë e mothe”!

BFI-ja kurrë nuk ka ndërmarrë kurrfarë mase në këtë aspekt! Apo,

mbase këta të BFI-së “masë” e konsiderojnë “tribunën” me tre katër hoxhallarë të Ohrit e të Strugës të cilëve u kanë “ligjëruar” do “ekspertë pordhacë” kundër terrorizmit dhe radikalizmit fetar! Të gjitha veprimet ekstremiste, të gjitha përgatitjet e individëve si dhe grupeve ekstremiste që janë munduar në emër të fesë të zhvillojnë vepra terroriste dhe kundër bashkëjetesës ndërjetare, kanë qenë të survejaur nga faktorë relevantë në vendin tonë dhe, në prag të veprimeve i janë dorëzuar Ministrisë së Punëve të Brendshme! Nëse edhe njerëz të BFI-së kanë gisht në këto dorëzime “spiuneske”, atëher, dakord, mund të konstatohet se edhe BFI ka kontribut në thyerjen e këtyre përpjekjeve antihumane, antifetare dhe kundër mirëqenies e paqës së përgjithshme!

Po, BFI-së i është bërë “hejdie” një projekt (STOP RadTerr) që është lavdëruar deri në instancat më të larta të BE-së, dhe që, kurrë, nuk është realizuar asnjë shkronjë e shkruar në atë projekt, ndërsa, “bartësi” i saj, ky farë përgjegjësi i BFI-së për marrëdhëniet me “organet e brendshme”, është shkoqur duke zhvatur lekë të donuar për realizimin e këtij projekti që, më vonë, do të bëhet model për vendet e Ballkand dhe më gjërë, të cilët do të thithin fonde milioneshë për parandalimin dhe eliminimin e çdo përpjekje për të shkaktuar destabilizime në emër të feve.

Ky farë M. D. paska folur edhe për sfidat me të cilat po u përballka BFI-ja? Të gjitha sfidat që si shqiponjë i rrinë pezull aktualisht BFI-së mbi krye janë vetëm ato që e stopojnë dhe e lakuriqësojnë lukuninë e ujqve të BFI-së! BFI-ja, aktualisht, në rrafshin konkret, ka probleme vetëm me rrymat, me ekstremizmat me konceptet idiotike, me synimet e djallëzuara të “srukturave” të instaluar dhe tashmë të etabluara brenda këtij Institucioni. Kjo po që është sfidë aktuale e BFI-së, e cila, shumë shpejt mund të shpërthejë dhe – t’i zhgënjejë e t’i paraqesë lolo të gjitha “konferencat” që i sigurojnë një karrige njeriut më kontravers të BFI-së për të dëgjuar “plane e projekte” si të luftohen dukuritë antihumane që pezullojnë në emër të fesë dhe, pastaj, një Zot e di se kujt mund t’ia “shesë”!

Lavdi i Shaqir Fetait është thikë pas shpine

Nuk ka veprim publik i Shaqir Fetait e që nuk është përplot me idiotizma! Avdalli mendon se ashtu duhet, vendimet, apo dekretet t’i organizojë të jenë publike dhe, të përbëjnë “lajm më vete”! Ia paska dorëzuar vendimin Shaban Sulejmanit! Cilin vendim? Çfarë vendimi? Për çka ai vendim? Këtë e di vetëm Shaqir Fetait dhe

Dekani i FSHI-së Shaban Sulejmani! Paska folur edhe shumë fjalë miradie për të! Por, asnjë fjalë nuk ia paska thënë se prej nga po dalin disa incizime dhe përgjime komprometuese nga brenda zyreve të FSHI-së! Mos po i përhapë vetë “dekretxhiu”, ë?!
Lavdërimi i Shaqir Fetait gjithnjë duhet të pranohet me rezervë dhe duhet të kuptohet si thikë pas shpine, si hyrje në një veprim shumë të rrezikshëm për vetë të lavdëruarin!
Një javë para se t’ia ngulte thikën “babait të vet shpirtëror”, reisit të tij, H. Sulejman ef. Rexhepit, para asaj tradhëtie dhe komploti fatal, publikisht e lavdëroi me fjalë që dolën se ishin nga “opusi i oratorisë” së hipokritit të pakonkurrencë!
Edhe i lavdëruari i Shaqir Fetait, ky farë dekani Shaban Sulejmani, “omileniku” i LSDM-së për “reis” pas “fitores spektakulare të LSDM-së në zgjedhjet lokale” (bilibic!), e lavdëroi atë që kot e kot ia dha shansin të vetëkënaqet me titullin Dekan, H. Sulejman ef. Rexhepin! Edhe ky pastaj do të rreshtohet pas shejtanit. Dhe tash, kanë ngelur që ta “fërkojnë” njëri tjetrin me lavdërata e me “vendime” që mbajnë erën e shpërblimit për bashkëudhëtim me shejtanin në aventurën që nuk mund të zgjasë më shumë se një ëndërr!/BotaPress/23.10.2021

Me komplot e tradhëti nuk përmirësohen “situatat e vështira”

Mbi Raportin e Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut, për vitin 2021, i cili, konkretisht, në faqen 28, përmbanë një fjali paushalle, e padenjë për këtë Komision dhe për raportuesin e përgjumur, e në të cilën është një konstatim tepër ofendues për mua si ish-reisul ulema dhe për të gjithë myslimanët e vendit. Konsideroj se, “raportuesit evropianë” duhet t’u kërkojnë falje publike myslimanëve të vendit

Nga H. Sulejman ef. Rexhepi

Raporti i sivjemë i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut, sidomos fjalia që flet për “liritë fetare”, më la një ndiesi shumë të hidhur, sikur më krijoi bindjen se është një raport i sponsorizuar nga qarqet sorosoide të ulur këmbëkryq nëpër kolltuqet e pushtetit aktual.

Në faqen 28 të këtij raporti, veç të tjerash shkruan: “KRYETARI I SAPOZGJEDHUR I BASHKËSISË FETARE ISLAME KA LUAJTUR NJË ROL POZITIV NË PËRMIRËSIMIN E DIALOGUT NDËRFETAR NË VEND.”

Si e para, ky farë “kryetari” nuk është i “sapozgjedhur”, por, është instalacion nga qarqet qeveritare të pushtetit aktual!

Po, ka qenë bashkëpunëtor servil i imi për dekada me radhë dhe, përkrahës i pakompromis në qëndrimet e mia të gjithanshme, edhe në përkeqësimin eventual të dialogut ndërfetar si pasojë e qëndrimeve të mia “kryeneçe”!

Meqë me këtë “kryetar” na qenka “përmirësuar dialogu ndërfetar”, shtrohet pyetja: cili paska qenë ky “dialog” në kohën e paraardhësit të këtij farë “kryetari”, pra, në kohën time?

Pse, në mënyrë indirekte, “sorosoidët” e Komisionit Evropian zbulohen se paskan qenë pjesë e komplotit dhe tradhëtisë që m’u bë mua; pse këta sorosoidë e përkrahin lojën e ndyrë politike për ta uzurpuar BFI-në dhe për ta partizuar e politizuar deri në rrënim total? Pse këta sorosoidë evropianë pa pagesë vihen në shërbim të propagandës qeveritare e cila mundohet t’ia përmirësojë imazhin “kryetarit aktual” i cili na paska pasur edhe begraund të spiunit të UDB-së!

Më duhet të dal përtej modestisë dhe të nënvizoj fuqishëm se në këtë shtet, personalisht unë kam qenë ARKITEKT i dialogut dhe harmonisë ndërfetare dhe, për këtë fakt, kam mirënjohje të larta pothuajse nga tërë kori diplomatik në vend dhe nga organizata të ndryshme botërore! Mbi tridhjetë vite kam qenë pjesëmarrës nëpër konferenca të ndryshme ndërkombëtare, madje edhe drejtues i tyre, në të cilat është kontribuar për një dialog ndërfetarë anekënd botës.

Ta ruash harmoninë fetare në kohën kur Bashkësisë Fetare Islame i vinin shigjeta më helmuese nga kampusi ortodoks politik, duhet mjeshtri dhe shpirtgjërësi unikale! Historia më e re e Republikës së Maqedonisë së Veriut dëshmon katërcipërisht edhe për lojërat e ndyta që pushtetet politike janë munduar t’i luajnë mbi kurriz të BFI-së. Të gjitha këto lojëra i kam refuzuar, të gjitha i kam denoncuar publikisht, të gjitha i kam shpjeguar në çdo takim me faktorin ndërkombëtar në vend. Këmbëngulja ime për t’i refuzuar të gjitha tendencat politike për t’u futur brenda BFI-së nuk kanë qenë kontribut i imi në përkeqësimin e dialogut ndërfetar! Në të tilla raste, asnjëherë nuk kam qenë i vetëm, por, gjithnjë i shoqëruar me të gjithë anëtarët e Rijasetit, të cilët, qëndrimeve të mia publike u kanë duartrokitur publikisht, pra, edhe ky “kryetari” juaj që ju paska lënë mbresa në “përmirësimin e dialogut ndërfetar”!

Ju ftoj publikisht, të dilni e të na e tregoni vetëm një “levizje” të tij, vetëm një gjest, vetëm një kontribut në drejtim të “përmirësimit të

dialogut ndërftar"! Është më se e qartë se, qarqet sorosoid të mbështetura edhe nga qeveria aktuale, ju kanë kërkuar që ta shprehni një fjali inkurajuese për "kryetarin" sorosoid, sepse i duhet një përmirësim imazhi!

Ju, "përmirësim të dialogut ndërftar" e konsideroni heshtjen e tij para shndërrimit në VC publike të Xhamisë së djegur në Prilep!

Ju, "përmirësim të dialogut ndërftar" e konsideroni lejimin e "kryetarit" të juaj sorosoid që të regjistrohen sa më shumë "bashkësi fetare", dhe me këtë të lejohet sektarizimi dhe defaktorizimi i BFI-së deri në filiale të shërbimeve të huaja intelektuale?

Ju, "përmirësim të dialogut ndërftar" e konsideroni lejimin e "kryetarit" të juaj që të zhvatet, të vidhet dhe të keqpërdoret vakëfi i BFI-së nga qarqe të ndryshme politike të pushtetit aktual!

Ju, "përmirësim të dialogut ndërftar" e llogarisni edhe gatishmërinë e "kryetarit" të juaj sorosoid për t'u takuar me spiunët e Putinit dhe për t'i shëtitur ata nëpër "odat politike" të institucioneve tona shtetërore?

Lukuninë kameleonike të "kryetarit" të juaj sorosoid për ta partizuar me çdo kusht BFI-në, duke u krijuar hapësirë, gati të gjitha forcave politike të pushtetit aktual, për të lejuar që përbrenda Institucionit të lulëzojnë fraksione, sekte e ideologji që e zbehin orientimin puro-proevropian të popullit tonë, ju e konsideroni "kontribut në përmirësimin e dialogut ndërftar", kurse ne shqiptarët por edhe myslimanët në përgjithësi, e konsiderojmë TRADHËTI, sepse del nga po ai brum i skenarit që e parasheh rrënimin e Institucionit gjashtëshekullor – Bashkësinë Fetare Islame në RMV!

Fare në fund, e kam shumë të qartë se në cilin moment bazoheni ju që të konstatooni se dikur na qenkan prishur dialogjet ndërftare dhe se me ardhjen e "kryetarit" të juaj sorosoid na qenka "përmirësuar" ky dialog!

Opinionin i gjërë e di fare mirë se unë, si Reisul Ulema dhe të gjithë anëtarët e Rijasetit, pra, përfshirë edhe "kryetarin" e juaj, i pata "ngrirë" përkohësisht marrëdhëniet me Komisionin për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze, me Ministrinë e punëve të Brendshme si dhe pata hedhur dyshime në sinqeritetin e gjykatësve tanë! Ky reagim imi ishte publik dhe i duartrokatur edhe nga ky farë "kryetari" (që ju përpiqeni t'ia rregulloni imazhin e pandreqsshëm) me rastin e përpjekjes së parë të pushtetit aktual

për të organizuar puç klasik në BFI, me dokumente të falcifikuar, e me përkrahje policore! Për këtë lojë të poshtër natyrisht që BFI-ja pat ngritur procese gjyqësore kundër të gjithë akterëve të përfshirë në këtë puç klasik! Natyrisht, ky proces gjyqësor do t'i lakuriqësonte disa struktura qeveritare, do të zbardhej projekti i defaktorizimit dhe rrënimit të BFI-së si dhe do të dilnin në tapet personat politikë përkrahës të këtyre lojërave të poshtra! Për t'i stopuar këto procese gjyqësore që shtyheshin me gjoks e me argumenta nga unë, pushteti aktual, me shantazha e me frikësime, me elementë nga shërbimet inteligjente, ia arritën që të më "eliminonjë" dhe në vendin tim ta sjellin elementin e tyre më të dëgjushëm, i cili, çuditërisht, nga ju vlerësohet si "kryetar i sapozgjedhur e që paska luajtur rol në përmirësimin e dialogut ndërfaqetar"! Mua më shkarkuan duke shkelur 17 nene të Kushtetutës së BFI-së, kurse "kryetarin" e juaj sorosoid e instaluan në krye të BFI-së duke i shkelur plot 33 nene të po kësaj Kushtetute.

Meqë ra fjala – në raportin e juaj nuk ka asnjë fjali për këtë ndërhyrje politike të pushtetit aktual për ta kapur BFI-në! Ju nuk mund të na e impononi për "kryetar" një vegël prej letre, kapacitetet "intelektuale" të të cilit i njohim të gjithë ne, teologët myslimanë të vendit, për të cilin ekziston një mendim i përbashkët se, karriera e tij deri këtu nuk është shtyrë për shkak të afinteteve të tij intelektuale, por është i shtyre nga shërbimet e ndryshme, për lojalitetin që e ka treguar ndaj tyre. Për ne, emri i kësaj "karriere" është tradhëti! Me tradhëti nuk ka përmirësim të dialogut ndërfaqetar, ka vetëm spostim të këtij problemi, i cili, herët a vonë, do të shpërthejë shumë keq. Ku do të ngelë atëherë "vlerësimi" ei këshilltarëve evropianë që lejojnë të manipulohen nga sorosoidët e vendit që kanë metastazuar në çdo pore të jetës! Sinqerisht, unë pres një kërkim falje nga Këshilli i Evropës, i cili, të kaluarën tonë ndërfaqetare e paraqet të zezë dhe se, "me ardhjen e kryetarit të sapozgjedhur qenka përmirësuar dialogu ndërfaqetar"! Kjo nuk mund të dëshmohet në asnjë moment dhe me asnjë fakt! "Kryetari i sapozgjedhur" është lehtësisht i manipulueshëm, ai nuk ka përgatitje të duhur për dialog, sepse nuk ka personalitet, Uni i tij është anemik, e kaluara e tij e zyrtë ia mbyll gojën para çdo situatë! Këshilli i Evropës nuk mund ta dijë këtë fakt, por, e dimë ne, teologët myslimanë të vendit! Këshilli i Evropës në raportet e veta nuk guxon të ketë konstatime paushalle! /Lajme7/27.10.2021

Konferencat e Mustafa Dautit

Mustafa Dauti, nuk po flet më në cilësi të “drejtorit të sektorit për punë të jashtme dhe kontakt me organet e brendshme”, sepse, kështu i kanë thënë punëdhënësit e tij të vërtetë! Njeriu që është larguar nga puna më vitin 2014 për shkak të manipulimeve dhe vjedhjeve në emër të “humanitetit”! Mustafa Dauti, njeriu më kontravers, më i përfolur nëpër media më shumë se çdo kush tjetër, hajni, i pamoralshmi, me një biografi shumë të dyshimtë – ky ta prezantojë BFI-në nëpër “qarqe ndërkombëtare”?

Nga Fatime Ademi

E njoh këtë farë imorali përmes një shoqe time, i di të gjitha idiotizmat e tij, i di të gjitha kapacitetet e tij antinjerëzore, e di tërë pasurinë e tij të paligjshme, e di afërsinë e tij me disa struktura të shërbimeve sekrete të vendit, e di edhe periudhën e tij kur punonte në Strugë e kur fërkohej me narkodilerë e me kriminelë të ndryshëm! Ky tani të flasë për islam, për luftën e ekstremizmit dhe radikalizmit fetar? Të prezantojë nëpër konferenca ndërkombëtare? Ç’është e vërteta, Mustafa Dauti, nëpër knferenca të tilla është një vullnetar hipokrit i cili realizon programe e projekte të huaja që kanë për qëllim ta stigmatizojnë sa më shumë islamin dhe myslimanët e vendit!

Mustafa Dauti, ky farë sadisti në kufijt e manjakut, të ftohet nëpër konferenca ndërkombëtare është ofendim që i bëhet ulemasë së vendit (nëse ekziston kjo ulema?!), njollosje që i bëhet myslimanëve të vendit dhe, përgjithësisht, fesë islame! Mustafa Dauti nuk ka

asgjë të përbashkët me mësimet islame, me parimet islame dhe me njohuritë mbi këtë fe. Sepse, Mustafa Dauti, fenë islame e përdor për përfitime personale si dhe si petk mbi veprimet e tij të poshtra! Le ta marrim konferencën e fundit të cilën e paska organizuar GIZ-i gjerman dhe ku paska folur pallavra edhe Mustafa Dauti! Çka kërkon në konferenca të tilla Mustafa Dauti përveçse ta legjitimojë stigmatizimin e fesë islame! Pse në këtë konferencë nuk ka pasur përfaqësues nga komunitetet e tjera fetare si dhe nga grupet religjioze? Pse nuk marrin pjesë Kisha, komuniteti i të krishterëve, i herbenjëve, sepse, qëllimi është që të ftohet “ai që e ka mizën nën kapuç”, sepse komunitetet e tjera me forcë e refuzojnë etiketimin e feve të tyre si “burim” të radikalizmit dhe ekstremizmit fetar! Sepse, Mustafa Dauti duhet ta amnistojë tërë atë diskriminim fetar e politik që i bëhet BFI-së, muslimanëve të vendit, të cilët, sipas Mustafa Dautit, janë “burim” i radikalizmit dhe ekstremizmit fetar! Mustafa Dauti nuk është madje as i kalibrit të të ftuarve në debat, sepse, është tullë, është injorant, është falsifikator e blerës i diplomave “akademike”!

Është e kotë edhe mbështetja që ia japin strukturat e caktuara të shërbimeve sekrete duke e imponuar nëpër “konferenca ndërkombëtare” sa për ta nxjerrur si “kualitet”, sepse të gjithë e dinë se çfarë bilmezi është ai!

Ai është edhe gënjeshtar, madje gjithnjë hedh gënjeshtër spektakulare! Thotë se Medresja jonë po prodhuaka kuadro “të cilët po reflektojnë shumë dobishëm në shoqërinë tonë duke predikuar islamin e pastër si në vend dhe në çdo cep të Botës.”! Thotë se, Bashkësia Fetare Islame qenka “i vetmi institucion që financohet nga burime të pastra që burojnë nga populli musliman brenda vendit dhe nga diaspora.” Financohet nga burimet që burojnë nga populli!!! I vetmi institucion? Po institucionet e tjera fetare, grupet religjioze? Si financohen ato? Pse Mustafa Dauti nuk e ngre këtë si problem por flet për BFI-në, për të cilën komuniteti ndërkombëtar në vend e dinë më mirë se ai të vërtetën dhe nuk bazohen në gënjeshtër të tij idiotike! Edhe ndërkombëtarët e vendit e dinë se sa shumë ka vjedhur Mustafa Dauti nga ai burim i pastër financiar që vjen nga populli! Të gjithë e dinë se sa ka vjedhur nga ndihmat humanitare. (E ftoj H. Sulejman Rexhepin që, në librin që po e përgatitka për “stafin e tij” që ia nglën thikën pas shpine, ta trajtojë në hollësi edhe hajninë epike që e ka kryer Mustafa Dauti në BFI)! Janë shumë qëndrime dhe levizje ekstremiste e

fundamentaliste të komuniteteve të tjera që kanë ushtruar diskriminim e padrejtësi kundër komunitetit mysliman në vend dhe se BFI-ja kurrë nuk e ka ushtruar të kundërtën! Për kriminelë, për radikalistë, për “mercenarë”, janë ministritë e brendshme, janë drejtoritë dhe agjencitë e zbulimit e të kundërzbulimit, të cilat duhet t’i gjurmojnë, t’i kapin dhe t’i burgosin, dhe nuk është për këtë punë BFI-ja!

Mustafa Dauti paska folur edhe “për rolin jashtëzakonisht të rëndësishëm të BFI në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit”, ndërkohë që, kurrë, në asnjë moment, nuk e ofroi një fakt, një aksion, një moment, për ta dëshmuar këtë “rol të jashtëzakonshëm”! Paska nënvizuar se “udhëheqësia aktuale e BFI-së” qenka shumë e pastër dhe e përgatitur në të gjitha nivelet”! E përgatitur edhe në nivel të spiunimi? Edhe në nivel të tadhëtisë? Edhe në nivel të bashkëpunimit me shërbimet sekrete? Edhe në nivel të hajnisë dhe të kriminalitetit? Udhëheqësia aktuale që brenda ka Mustafë Dautin dhe shumë bajga të tjera si ky, jo që është katastrofale por, për më keq, është si një kurtizane që tërë natën shet trupin, e në mëngjes mundohet të flasë për moral! Mustafa Dauti është shembulli tipik i imoralitetit dhe, këtë fakt e dinë të gjithë, madje edhe ndërkombëtarët, të cilët, sa herë që kanë qejf ta shohin se si gënjen BFI-ja dhe në ç’nivel kadrovik është, organizojnë konferenca ku “këndin e rrëfenjzës” ia jep edhe Mustafa Dautit, sa për ta dëshmuar nivelin e katandisë ku ka rënë BFI-ja! Ky është qëllimi dhe jo rast për “intektualitet” të Mustafa Dautit e për “lajm” në paçavrën zyrtare të BFI-së sa për ta ngushëlluar se, ja, ka kush shkruan mirë edhe përkundër shkrimeve që zbardhin tërë opusin imoral të Mustafa Dautit, “drejtorit për marrëdhënie me jasht si dhe për kontakt me organet e brendshme”! Pse a paska organe të brendshme Mustafa Dauti?/1KlikLarg/28.10.2021

O millet! Shaqir Fetai paska falur drekën

U bënë gaz i botës, por po i turpërojnë edhe mbarë myslimanët e vendit!

Zoti mos e lëntë pa i turpëruar ditë e më shumë

Kemi thënë edhe më herët se, Shaqir Fetai, shumë shpejt edhe faljen e namazeve do ta paraqesë si aktivitet të tij “që e bën për të mirën e BFI-së në përballje me sfidat e kohës”! Pas kësaj, ai do të na kumtojë: “sot zhvillova aktivitet duke rënë në shehadet”!

Ky far instalacioni më i shëmtuar i pushtetit aktual maqedonas, kohëve të fundit, ceremonitë e varrimit i koncepton si “manifestime”, ndaj dhe, pa fije turpi në prag të faljes së xhenazeve, nis e i përshëndet bashkëpunëtorët e vet, thuase po u jep selam “melaqeve”!

Vetëm një avdall si Shaqir Fetai do të kërkonte që të bëhet lajm falja e namazit të drekës bashkë me Drejtorin e Vakëfit të Turqisë në Xhaminë Mustafa Pasha, në Shkup!

Në këtë lajm, na “dëshmohet” se si Shaqir Fetai e paska pritur në takimin e fundit mysafirin turk. Ishalla kjo pritje do të jetë e fundit se, me të vërtetë që u bë e tepërt degradimi i BFI-së që kur në krye të saj u instalua ky farë avdalli!

A ka më turp, më ofendim e më diletantizëm se sa të thuhet se në këtë takim të fundit bashkarisht i paskan analizuar vizitat e mysafirit nga Turqia që ua paska bërë disa myftinive të vendit! Ky zhargon është i UDB-së! Vetëm shërbimet intelegjente analizojnë vizitat e ndërkombëtarëve që qëndrojnë për vizita private nëpër

qendra të ndryshme të një vendi!

Në informatën e parë publikuar me rastin e vizitës së Drejtorit të Vakëfit të Turqisë, bilmezat e Shaqir Fetait kanë shkruar: “Sipas protokollit të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, mysafirët e lartë nga Turqia janë në një vizitë tre ditore në vendin tonë”! Në informatën e fundit, sërish injoranët thonë: “Sipas protokollit të BFI, vizita e fundit prej ku edhe u përcoll Z. Burhan Ersoj dhe stafi i tij”!

Shaqir Fetai dhe avdallçiçët e tij as që e dinë dhe as që e kuptojnë se çka do të thotë fjala “protokol”! Në të dy raste kanë dëshmuar se nuk janë të denjë as të përkujdesen për shtallë e jo më për Institucion të lartë dhe reprezentativ siç është BFI-ja!

U bënë gaz i botës, por po i turpërojnë edhe mbarë myslimanët e vendit!

Zoti mos e lëntë pa i turpëruar ditë e më shumë! / 1KlikLarg / 28.10.2021

Pse këto zgjedhje lokale janë aq të rëndësishme për Shaqir Fetain

Shaqir Fetai duke dashur që ta luaj rolin e “babait të madh” të popullit të Maqedonisë së Veriut, në të dy raundet e zgjedhjeve lokale del e apelon për votim masiv për të mirën e demokracisë së vendit! Ç’ne kjo brengë e Shaqir Fetait për demokracinë e vendit kur në rrafshin fetar i ka punët zi e më zi

Nga Vlera Thaçi

Në Maqedninë e Veriut, për këta tre decenie sistem plural, para çdo lloj zgjedhjeve ka pasur një akt nënshkrimi të kodit prej të gjithë liderëve partiakë për zgjedhje të lira e të ndershme. Madje, të gjithë liderët partiakë, të gjithë udhëheqësit e institucioneve më të larta shtetërore, në prag të zgjedhjeve kanë apeluar për zgjedhje të lira e të ndershme. Çuditërisht, kjo nuk ndodhi në këto zgjedhje! Asnjë apel, asnjë nënshkrimi kodit, asnjë thirrje e përbashkët e liderëve politikë apo fetarë për zgjedhje të lira e të ndershme. Një iniciativë të tillë nuk pati, si rëndomë, as nga faktorët ndërkombëtarë në vend, ngase tashmë ekziston një bindje se në vendin tone është konsoliduar mirë e fort demokracia dhe se obligimet demokratike qytetarët e vendit i kryejnë me dinjitet më të lartë!

Megjithatë, këtu rron një “baba i popullit të Maqedonisë së Veriut” i cili kujdeset për një apel të tillë, paçka se, duke qenë kikirik i vetëm në këtë thirrje, del snob e hipokrit i pashoq.

Në raundin e parë, të 17 tetorit të vitit 2021, në prag të zgjedhjeve

lokale Shaqir Fetai do të apelojë: “Zgjedhjet e ndershme dhe të lira janë obligim ndaj elektoratit të RMV, ndaj imazhit të shtetit tonë, ndaj miqve tanë dhe ndaj ndërtimit të ardhmërisë së vendit tonë. Andaj Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut, bën thirrje për zgjedhje të qeta, të lira dhe të ndershme.”

Për të qenë “në trend”, për ta përsëritur cirkuziadën e vet, për ta shprehur “kujdesin” e “babait të kombit” Shaqir Fetai, të njëjtin apel e përsërit edhe me rastin e raundit të dytë të zgjedhjeve të sivjeme lokale, dhe, sërish thotë: “Zgjedhjet e ndershme dhe të lira janë obligim ndaj elektoratit të RMV, ndaj imazhit të shtetit tonë, ndaj miqve tanë dhe ndaj ndërtimit të ardhmërisë së vendit tonë. Andaj Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut, bën thirrje për zgjedhje të qeta, të lira dhe të ndershme.”

Po pse kaq jetike për Shaqi Fetain këto zgjedhje! Pse asnjë lideri fetar nuk i interesuan këto zgjedhje! Pse asnjë lideri politik nuk i shkon në mend një apel i tillë, edhe pse një gjë e tillë është obligim i tyre! Ç’i hynë në punë këto zgjedhje lokale Shaqir Fetait? Ku i dhemb Shaqir Fetait? Pse Shaqir Fetai apelon si papagall duke thënë: “Andaj Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut, bën thirrje për zgjedhje të qeta, të lira dhe të ndershme.”

Kush është Bashkësia Fetare Islame që apelon për zgjedhje politike?! Pse Shaqir Fetai mundohet ta rrisë rolin dhe peshën e vet edhe pse krejt bota e di që roli dhe pesha e tij është vetëm e një tradhëtari dhe komplotisti udbashian!

Shaqir Fetai, ngjashëm si “liderët politike” të pushteti aktual po e ndjenë se, nëse do të humbin këto zgjedhje, i pret një debakël në karrierë! Dikush ka paralajmëruar dorëheqje të parevokueshme, dikush ka paralajmëruar tërheqje nga skena politike, dikush e ndjenë se do të largohet! Këtë parandjenjë e ka edhe Shaqir Fetai. Shaqir Fetai e di fort mirë se, spostimi i pushtetarëve aktualë në opozitë, do ta nxjerrë edhe Shaqir Fetain në opozitë. Në opozitë liderët politik bëjnë luftë për rikthim të sërishëm, ndërsa në opozitë Shaqir Fetai do të bëjë luftë të përjetshme me vetëveten brenda katër muareve të dhomës apo të avllisë së vet!

Prandaj Shaqir Fetai ka mobilizuar edhe hoxhallarë që ta keqpërdorin, madje edhe hutben e namazit të xhumasë, për të apeluar që të votohen kandidatët për kryetarë komunash, të cillët madje nuk kanë të bëjnë asgjë me fenë islame por që janë kandidatë të pushtetit aktual!

Prandaj Shaqir Fetai ka mobilizuar “xhematlinjë” që në ditën e

zgjedhjeve të jenë në rolin e taksistëve për të bartur votues nëpër qendrat e votimeve, ndërsa shpenzimet do t'ua mbulojë vetë ai prej buxhetit të krijuar nga fitri e nga zeqati. Madje të pabindshmit edhe mund të korruptohen me paratë e po këtij buxheti! LSDM-BDI duhet të fitojnë gjithandej, të dalin koalicion me sa më shumë komuna, sepse, në fitoren e tyre do të ndjehet edhe trimëria e Shaqir Fetait, i cili, madje edhe nga hutbja ka kontribuar në këtë “fitore”! Por, mos thashtë Zoti të humbë ky koalicion, atëherë, Shaqir Fetai duhet të përgatitet e të zhduket në lëvozhgën e kikirikave të Afrikës dhe, pastaj, të futet në “proces reinkarnimit”, sërish nga e para!

Sado që në këtë moment Shaqir Fetai mendon se po e luan rolin e “babait të popullit”, megjithatë, ky moment do të jetë njolla më e zezë që i hidhet BFI-së! Na ishte dikur një “institucion fetar” që apelonte për zgjedhje politike demokratike, ndonëse vetë ishte futur në një anarki totale, përmes zgjedhjeve të manipulueshme pas një puçi dhe komploti klasik të drejtuar nga një kurrkushi hiç, me emrin Shaqir Fetai, alias “ORAO” si nxënës i oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviqit!/Kombetare/30.10.2021

Partizimi i institucionit fetar do të thotë sektarizim politik i tij

Askujt nuk i duhet një BFI që do të dridhet nga pushtetet, por, të gjithëve u duhet një BFI që dridhë madje edhe pushtete të verbër e të pasinqertë

Nga Mr.Abaz Islami

Ishte nje periudhë kur i vetëquajturi “reis” i BFI-së, Shaqir Fetai, po thërriste njerëz që t’i vinin në zyrë dhe ta uronin! Edhe nga jashtë, subjekte “te huaja” për Institucionin e BFI-së, po i organizoni vizita “të rëndësishme” (të gjitha partiake), për t’ia uruar postin dhe për t’i dëshiruar suksese! Pse kjo përpjekje sa djallëzore aq edhe dëshpëruese e Shaqir Fetait? Ai kishte nevojë, pa dyshim, për t’ia legjitimuar veprimin prej puçisti dhe komplotisti! A ia arriti kësaj? A u legjitimua edhe nga vizitat e të huajve?

Dëshira dhe nevoja e Shaqir Fetait nuk mund ta përmbysë të vërtetën e madhe që flet mbi instalimin e tij politik në krye të BFI-së.

Nuk ka qytetar i Maqedonisë së Veriut, nuk ka subjekte me relevance si dhe nuk ka faktor ndërkombëtar që nuk e di se si u ekzekutua tërë ai komplot dhe puç që u zhvillua në BFI. Shaqir Fetai doli edhe publikisht me grupin e vet të partizuar e të politizuar duke belbëzuar “triumfalisht” se po e shkakrojnë Reisul Ulemanë, se ky na e paska shkelur Nenin 58 të Kushtetutës së BFI-së. Ky gjest, pa dyshim që është më fatali për BFI-në, sepse

krijon precedent dhe, i hap rrugë kompleteve e puçeve të reja në BFI. Kush mund të pengojë dhe ta minimizojë një organizim të tillë të “rijasetit” për ta ndërruar Shaqir Fetain si shkelës të Nenit 58? Ja pra çfare praktika ka instaluar Shaqir Fetain në BFI, praktikë që i jep fund unitetit të këtij Institucioni, që i hap rrugë shantazheve dhe kërcënimeve të ndryshme me qëllim të prezantimit të një uniteti të rrejshëm; ka instaluar praktikë të goditjeve të ulëta mbi këtë Institucion, i cili tashmë gjithnjë do të jetë shënjestër uzurpimi nga karrieristët, nga hipokritët, nga servilët e pushteteve, që e ngulfasin meritokracinë dhe vlerën e mirefilltë në këtë Institucion.

Grupi i komplotistëve me në krye Shaqir Fetain, nuk zhvilluan kurrnjëfarë aktiviteti për të shprehur pakënaqësinë dhe kundërshtimin e tyre kundër ish-reisul ulemasë. Përkundrazi, e duartrokisnin dhe e puthnin në ballë për politikën udhëheqëse të Institucionit. Nuk pati asnjë mbledhje, asnjë takim, asnjë vërejtje as me shkrim e as me gojë që ia thanë ish-reisit. Nuk e nxorën as në komision dhe nuk zhvilluan kurrfarë aktiviteti sensibilizues të opinionit të gjërë për aktivitetet antikushtetuese të ish-reisit. E morën sinjalin nga struktura të ndryshme politike dhe, e shkarkuan reisin se paska shkelur Nenin 58, pa treguar kohën, format dhe mënyrën e kësaj shkelje! Po kush është ky grup që mori guxim të tillë puçist? A do të jetë grupi i parë dhe i fundit? Tërë aparati shtetëror të çohet në këmbë, të gjithë kori diplomatik, të gjithë faktorët me relevance botërore të ngriteshin e të vinin te kabineti i kapur i Shaqir Fetait, ta uronin e ta përgëzonin, kjo nuk do ta fshihte mënyrën e instalimit të Shaqir Fetait në krye të BFI-së, madje as që do të mund të legjitimohej akti i tij tradhëtues e komplotist. Këta faktorë do të vijnë në BFI për respekt të Institucionit, historisë dhe traditës së tij, dhe jo për t’i legjitimuar veprimet puçiste dhe komplotiste.

Nuk mundet të minimizohet dhe të harrohet historia tredekadëshe e BFI-së, as viti 1990 kur për herë të parë në krye të BFI-së do të zgjidhet i pari nga më të mirët, do të zgjidhet dhe vlerësohet më i afti prej komunitetit të gjërë të teologëve dhe me këtë do të përjashtohet ndikimi politik dhe i pushtetit komunist në zgjedhjet e drejtë për drejta në BFI. Nuk do të harrohet as viti 2020 kur në BFI do të futet politika dhe pushteti duke e imponuar në krye të BFI-së njeriun e tyre! Kësisoj, fati i reisul ulemasë u lidh me fatin e pushteteve të cilët, me afat katërvjeçar, shkojnë e vijnë, të cilët,

tash e tutje do ta kenë edhe një synim më tepër – në krye të BFI-së të venë njeriun e vet. Pra, nga një BFI të komunitetit të teologëve dhe të besimtarëve, tash e tutje do të kemi një BFI politiko-partiak të pushteteve! Shumë keq!

Megjithatë, ekziston një forcë opozitare, ekziston LEVIZJA PËR REFORMA NË BFI, e cila përkujdeset dhe angazhohet për ruajtjen e pastërtisë së BFI-së së vërtetë, jashtë ndikimeve dhe synimeve të hienave që nuk janë për hajër të Institucionit. Kjo Lëvizje nuk do të rreshtë së kundërshtuari politikat e huaja për islamin, nuk do të pajtohet për asnjë çast që BFI të jetë në duart e karrieristëve me arsimim të blerë e të falsifikuar, të shtyre e të përkrahur nga strukturat e ndryshme politike të dyshimta e të pandershme në raport me BFI-në. Kjo Lëvizje angazhohet dhe është advokuese e faktit pa reforma të thella dhe gjithëpërfshirëse nuk ka BFI të vërtetë dhe kushtetuese.

Shaqir Fetai dhe grupi i tij komplotist natyrisht që kurrë nuk do të ishin për reforma që i ka përfshirë kjo Lëvizje që në Platformën e vet ! Nuk do të ishin, sepse këto reforma do t'i përfshinin edhe Shaqir Fetain me komplotistët e tij. Dhe, pa këtë reformë nuk do të ketë BFI, por, vetëm filiale të partive e të pushteteve që do të shkojnë e do të vijnë. Askujt nuk i duhet një BFI që do të dridhet nga pushtetet, por, të gjithëve u duhet një BFI që dridhë madje edhe pushtete të verbër e të pasinqertë!/TetovaSot/01.11.2021

“Urimet” e Shaqir Fetait pasojë e tronditjeve të tij psikike e shpirtërore

Bashkësia Fetare Islame nuk është as Komision Shtetëror Zgjedhor e as Ministri e Punëve të Brendshme, sado që përbrenda vlon nga “nëpunësit” e këtij digasteri! Shaqir Fetai duke e parë që ka kapur një post i cili i duket mision absolutisht i pamundshëm për të, ka nisur që të futet në rolet e lidhshpimit politik, ndonëse deri më tani ka dëshmuar se nuk është i denjë as për rolin e çobanit

Nga Idriz Rushiti

Shaqir Fetai kohëve të fundit, sikur ka filluar ta ndjejë fuqishëm peshën e papërbalueshme të Institucionit të BFI-së. Gjithnjë e më shumë e ka të qartë se ky Institucion për Shaqir Fetain është kafshatë gjigante dhe e pa kapërdieshme prej tij, ndaj dhe, mezi pret të shërftyrohet në diçka që do ta mbajë sa më larg postit të cilin e grabiti si hajn i përallave.

Ndaj dhe, herë e merr rolin e kryetarit të Komisionit Republikan Zgjedhor, herë atë të Kryetarit të Shtetit, herë të Kryeministrit e herë të liderit të gjithë shqiptarëve! Me këtë sjellje, pa dyshim që, ky farë duduki hedh dyshime dhe hije edhe mbi aftësitë e këtij lidhshpimi për t'i kryer detyrat dhe, imponohet sikur ky të ishte “i dërguari i Zotit” për ta bërë fet këtë shtet e këtë shoqëri!

Asnjë personalitet i vendit dhe as nga ndërkombëtarët nuk doli me apel për zgjedhje të lira e të ndershme, sepse, tashmë kjo është më se e nënkuptueshme: zgjedhjet doemos duhet të jenë të ndershme e të lira, pa apeluar askush! Por, ja që Shaqir Fetai e di se në Maqedoninë e Veriut vidhet, vidhet edhe posti, postet kapen në mënyrë të pandershme, sepse, kështu ka bërë vetë ai, ndaj dhe, mendon se tërë bota janë hajna si Shaqir Fetai!

Zgjedhjet përfunduan dhe fituesit tashmë po dihen! Humbën ato

parti për të cilat agjitonte Shaqir Fetai me bandën e vet, madje duke kërkuar që të keqpërdoren edhe hutbet për të propaganduar për kandidatët e LSDM-BDI-së, për të cilat shpenzoi para të majme nga buxheti i BFI-së i përbërë nga fitri dhe zeqati!

Nga fituesit e zgjedhjeve u përmend edhe emri i Shaqir Fetait si i pozicionuar për ta dëmtuar opozitën! Por, aq e ka sinqeritetin dhe besnikërinë Shaqir Fetai! Me të dalur rezultatet, me të kuptuar se si ky pushtet u dridh fort pas dorëheqjes së Kryeministrit aktual, sakaq nisi ta interpretojë rolin e “melaqes së Stançit”!

Shaqir Fetai del dhe i vetmi “lider” e uron popullin për këto zgjedhje kaq të ndershme e të qeta!

Një “letër” të tillë me plot “triumfalizëm” mund ta lëshonte për opinion vetëm ajo strukturë që do të caktohej që të zhvillonte zgjedhje të lira e të ndershme, si për shembull policia, apo ushtria. Një “optimizëm” të tillë do të mund ta përcillte edhe kryetari i Komisionit Republikan Zgjedhor! Me tone të kryetarit të shtetit Shaqir Fetai do të thotë: “Të nderuar besimtarë dhe qytetarë të vendit. Më lejoni që në emrin tim personal dhe në emër të Bashkësisë Fetare Islame t’ju uroj për procesin pozitiv, të qetë dhe të ndershëm zgjedhor, i cili edhe një herë dëshmoi se jemi një shoqëri me prirje drejt vlerave demokratike, ku respektohet vullneti i çdo qytetari, pa dallim të kombit, besimit, moshës, gjinisë apo ngjyrës.” Meqë qenkemi popull me vlera të larta demokratike, çka pati nevojë Shaqir Fetai për të apeluar për zgjedhje të lira e të ndershme?!

Ndërsa, fraza e fundit e këtij farë “urimi për zgjedhje të lira e të ndershme” dëshmon katërcipërisht se kemi të bëjmë me një person shizofren, avdall por me veti të natyrshme të një dhelpre me llapë përdhe e të lodhur nga jeta! Me këtë frazë, avdalli i jep BFI-së tone të një “shtabi zgjedhor”, të një “komisioni shtetëror zgjedhor”, të një “agjencie ndërkombëtare monitorimi” që, në momentet postzgjedhore gjithësesi që duhet të thonë diçka! Shaqir Fetai thotë: “Po ashtu, kandidatët që nuk arritën të zgjidhen, i falënderojmë për pjesëmarrjen e tyre në këto zgjedhje, për kontributin e dhënë në zhvillimin e vlerave demokratike. Urime dhe na priftë e mbara”!

Pas kësaj fraze çdo koment do të ishte i tepërt, çdo gjë që do të thuhej për këtë farë uzurpatori të dhunshëm të postit të reisit, do të ishte e kotë dhe do të dukej “tendencioze”. Sepse, katundi që shihet nuk do kallauz!

Shaqir Fetai veten e llogarit gjithçka që i përket politikës, vetëm teolog dhe “ulema” i teologëve jo! Sepse, realisht nuk është, madje edhe sikur të ishte, është i refuzueshëm unanimitisht prej teologëve. Mëkatarët gjithnjë kanë fundin e trishtueshëm. Nisin si palaço e përfundojnë si limoni i shtrydhur e i hedhur në pleh! Frikën e limontë e ka Shaqir Fetai! /1KlikLarg/ 01.11.2021

Dorëheqja si akt moral

Sot gjithçka ka evoluar! Edhe robërimi, po! Sot nuk ka robërim klasik, pushtim e sundim mbi një popull, mbi një shtet. Sot, robërohet udhëheqësi dhe, krejt shoqëria e shteti janë nën robëri! Robërohet një udhëheqës dhe, tërë Institucionin e ke nën robërim. Për shembull – robërohet Shaqir Fetai tërë Bashkësinë Fetare Islame e ke përdhe, paçavurë

Nga Mr. Eset Shaqiri

Zgjedhjet vendore që sapo kaluan, hodhën hije të rëndë sidomos mbi dy persona: mbi kryeministrin në dorëheqje, Zoran Zaev dhe, mbi intslacionin e tij në krye të BFI-së, Shaqir Fetain! Të parin populli e demaskoi si “lider të fallsifikuar”, që nuk gëzon përkrahjen e popullit dhe, të dytin, Shaqir Fetain, e demaskoi politika si një urith që kur të del në dritë verbohët tërësisht, sepse, habitatit i tij është terri dhe nëntoka!

Është e rëndë kur të sulmohet “lideri fetar” nga politika, kur të akuzohet si militant i verbër i një partie! Lideri fetar, natyrshëm është lider mbi të gjithë liderët e tjerë pjesëtarë të të njëjtit komunitet; lideri fetar ka tagrin që t’i qortojë e t’ua “tëheq” veshin të gjithë liderëve që shkajnë nga kauza e përbashkët; lideri fetar ka të drejtën që t’i ftojë të gjithë drejt një fitore të përbashkët, drejt një të arriture historike, drejt një synimi të përcaktuar nga rrethanat histoike...

Shaqir Fetai, si mos më keq, shndërrohet në militant partiak dhe, sipas një kandidati për prefekt të një komune, paska kërkuar në emër të Zotit e të Allahut vota për një parti ku aderon ai! Po partitë e tjera, t’i mallkojë Zoti, Allau, në humbje e në zhdukje? Po ata dhjetra mijëra pjesëtarë të partive të tjera që nuk aderojnë në

“partinë” e Shaqir Fetait, çka të bëhet me ata? Edhe këta të mallkohen në humbje e në zhdukje? Këtë mëkat nuk e ka menduar Shaqir Fetai, sepse ai nuk mendon vetë, sepse vegël, mjet me mend nuk ka!

Pse kaq poshtë ka degraduar Shaqir Fetai? Çka i ka borxh partisë për të cilën militon duke e devaluuar postin e “reisit” deri në militant të thjeshtë të një partie! Ndoshta kjo parti ia ka rehatuar të gjithë anëtarët e familjes ndaj dhe, humbja e saj mund të shkaktoj “tërmet familjar”! Është thënë e shkruar në qindra e qindra shkrime e komente se, Shaqir Fetai është “instalacion” i të njëjtës parti që e solli në krye të BFI-së e për të cilën tani mundohet ta kthejë borxhin!

Pse Shaqir Fetai t’i ketë borxh një partie, pse t’i ketë borxh një ministri, një drejtori, apo një pushteti? Me një thes problemesh që i ka BFI-ja të shkaktuara nga pushtetet e ndryshme të këtij shteti, sot do të duhej të ishte opozita më e fortë e pushtetit dhe, jo t’i shërbejë pushtetit si lake pa kurrfarë dinjiteti!

Në foltoret e veta që po i mbanë Sali Berisha anekënd Shqipërisë, do ta theksojë edhe një citat të Niçes, i cili thotë: “Njeriu i robëruar është turp i natyrës, njeriu i lirë është fëmija i natyrës”! Tutje, Sali Berisha e trajton edhe dukurinë e heqjes dorë nga dinjiteti për të mirën e një force politike!

Njeriu i kapur, si Shaqir Fetai, njeriu i cili një jetë të tërë ia ka borxh pushtetit, i cili e avancon në karrierë pa kurrfarë merite, jo që është i robëruar por, praktikisht është i vdekur, pa gjak, pa shpirt, i cili, sillet si një robot me bateri. Është në këtë derexhe, sepse ai është pa dinjtet, e ka shitur dinjitetin, apo edhe e ka falur dinjitein për një karrige, të cilën e ëndërron që në “fëmijëri” por që është shumë koshient që nuk e meriton, nuk mund ta arrijë me kapacitetet e veta, ndaj dhe i nënshtrohet pushtetit, partisë!

Është e drejtë absolute kjo e Shaqir Fetait! Është i lirë të veprojë çfarë të dojë por, nuk është e drejtë që në krye të BFI-së të qëndrojë një njeri i kapur, një i robëruar, një i nënshtuar, sepse i tilli është “turp i natyrës”, respektivisht, turpi i Bashkësisë Fetare Islame në RMV!

A duhet që të jetë kaq shumë e turpëruar BFI-ja, a duhet që të drejtohet prej një të turpëruari, prej një që është pa dinjtet, apo, me dinjtet të lënë peng në kundërshtpërblim kolltukun që nuk e meriton?!

Një mysliman i devotoshëm, një njeri që ka sedër e dinjtet, një

njeri me besim, për më të madhin kjamet nuk do të pranonte që ta njolloshte BFI-në ta degradonte, ta nënvlerësonte, ta turpëronte deri në uljen e nivelit të saj në filiale partie!

Kori diplomatik i vendit tashmë është njohtuar me fakte konkrete që flasin për Shaqir Fetain si agjikator i zjarrtë i një partie politike përgjatë fushatës partiake për zgjedhjet vendore që sapo përfunduan. Subjektet e tjera politike e fetare tashmë e dinë se kush është Shaqir Fetai dhe, në çfarëdo takime e iniciativa do ta kenë një qëndrim refuzues, bllokues ndaj tij, sepse tashmë e dinë që përballë e kanë një militant partie!

Politika nuk do ta lë me kaq punën e Shaqirt Fetait! Ai tashmë është i stigmatizuar si “militant partie”, ndaj tij mund të zhvillohen situata të veçanta “hakmarrëse”, të cilat, do ta njollosnin edhe më shumë figurën lara-lara të Shaqir Fetait. Ndaj, nëse Shaqir Fetai ka vetëm dy gram mend, më e mira për të do të ishte që, të tërhiqej dhe të shpëtonte nga lojërat që pa dyshim do të luhen mbi “çallmën” e tij! Është koha më e mirë që ai të tërhiqet, në shenjë të kërimit falje ndaj shoqërisë sonë, për tërë atë njollë që e ka hedhur mbi personalitetin e BFI-së si subjekt juridik! Fundja, Shaqir Fetai është i padëshirueshëm edhe në katund të vet, edhe në qytetin e vet ku ka shërbyer si Myfti. Të paktë ishin ata që iu përgjigjën apeleve, lutjeve, përbetimeve të tij për t’u rreshtuar në krah të partisë ku aderon ai. Shaqir Fetai humbi si në Çegran ashtu edhe në Gostivar! Nuk ia futën fare apeleve të tij! E refuzuan dhe, si i padëshirueshëm që është tani, ai do të duhej të izolohej deri në një moment më të lakmueshëm për të. Momenti aktual është tepër shumë i disfavorshëm për Shaqir Fetain, të cilin, mund ta zbusë vetëm Shaqir Fetai me tërheqjen e vet prej jetës publike! Ky nuk është një presedent që të lë gojëhapur, por, është një praktikë morale për të gjithë humbësit e ndershëm. Fundja, dorëheqje nga jeta publike dha edhe kryeministri i Shaqir Fetait, Zoran Zaev! Shëndet!/BotaSot/05.11.2021

Nusprodukti i një komploti

Në një shkrim autorial, një politolog i ri kishte pyetur se, çka dëshirojnë hoxhallarët që futen në politikë. Kishte thënë se hoxhallarët e kanë vendin në xhami e jo në politikë! Pse fusin turinjë hoxhallarë në politikë, kishte pyetur ai? Ndërsa tërë mllefin e kishte me Shaqir Fetain, i vetëshpalluri “reis” pasi në mënyrë perfekte realizoi një tradhëti dhe një komplot në BFI me ndihmën e pushtetit në ikje

Nga Valbon Osmani

Heshtje mortale, e pakupimtë, që nuk i bën nder asnjë hoxhe, heshtje që u japim pretekst të tjerëve që të shajnë, që të pështyjnë, që të derdhin mallkim mbi ne!

Kam pritur gati dy ditë në mos po reagon ndonjë nga hoxhallarët institucionalë; në mos po e ngritë zërin në ndonjë nga vazet ditore e t'i reagojë politologut të ri i cili kishte shkruar mbi hoxhallarët që duke u marrë me politikë po i lënë jasht punës ata që kanë kryer fakultetin e shkencave politike, që kanë dalur politologë! Thotë se hoxhallarët e kanë vendin në xhami dhe se nuk kanë se çka turren pas politikës! Këtë mllef të tij ai e kishte të ngacmuar nga reagimi i Arben Taravarit, kryetarit të Komunës së Gostivarit, i cili, gjatë një emisioni televiziv dy-tri herë e sulmoi Shaqir Fetain si agjikator i zellshëm i BDI-së. Sipas Taravarit, sipas mesazheve që i kishte ai, Shaqir Fetai i kishte përbejtur myslimanët e Gostivarit, në Zot e

Allah, që të votojnë për BDI-në e Ali Ahmetit, për Nevzat Bejtën!
Pra, nuk paskan qenë hoxhallarët por, Shaqir Fetai dhe tajfa e tij prej nja 4-5 vetëve që kësaj radhe, me ashk e me shpirtë janë angazhuar për kandidatët e BDI-së, madje që kanë përdorur edhe hutben e xhumasë për të propagur në të mirë të kandidatëve të koalicionit LSDM-BDI, pavarësisht përkatësisë etnike e fetare. Mbi 99.90 për qind e hoxhallarëve nuk i janë përgjigjur kërkesës së Shaqir Fetait, edhe pse ky, sipas disa hoxhallarëve nga Kumanova, u ka çuar disa myftinive edhe letër qakore ku i urdhëron që t'i mobilizojnë hoxhallarët për të siguruar sa më masovikisht vota për Partinë e Ali Ahmetit!

Pra, “nuk i paskan futur turinjtë në politikë hoxhallarët”, porse me dy këmbë në llucë të politikës qenka zhytur Shaqir Fetai për ta ndihmuar partinë e Ali Ahmetit. Ndërsa tek tani janë bindur në partinë e liderit të BDI-së se, Shaqir Fetai, si hoxhë, është i padëshirueshëm madje në katundin e vet. Angazhimi i Shaqir Fetait në politikë e ka njollosur BFI-në kurse e ka penalizuar BDI-në! Aty ku ka apeluar Shaqir Fetai, në masë të konsiderueshme e kanë bojkotuar, nuk ia kanë “qokur” ama bash hiç!

Hoxhallarët nuk janë përzier, që ta dijë politologu i ri që na paska ngelur pa punë, sepse hoxhallarët ia paskan zënë punën në politikë! Hoxhallarët nuk kanë reaguuar as kundër BDI-së që ka luajtur lojë të pandershme me Shaqir Fetain në kurriz të BFI-së! Hoxhallarët nuk dëshirojnë të konfrontohen publikisht me këtë Parti, sepse anëtarë të familjeve të gjëra të tyre aderojnë në këtë parti, janë të punësuar nga kjo parti, janë nëpër forume të kësaj partie dhe, misioni i tyre nuk është që të përçajnë njerëz, familje, por, ta heshtin fenomenin e mbrapshtë dhe të apelojnë në sa më shumë ibadete, mirësi e mbarësi! Megjithatë, 99.99 për qind e hoxhallarëve, intimisht janë shprehur “ishalla ik BDI-ja që të ik edhe Shaqir Fetai”! Pra, kjo përinde kaq e lartë e hoxhallarëve Shaqir Fetain e konsiderojnë si derivat të partisë, si bastard të politikave jo të shëndetshme kombëtare, prandaj janë lutur që të bie nga pushteti BDI-ja, që në rënie e sipër ta tërheqin pas vete në gropën skeptike edhe Shaqir Fetain!

Ndryshe, sa për t'ia bërë me dije politologut të ri, hoxhallarët mund ta kenë vendin dhe të zënë pozita të lartë në çdo pore të jetës! Nga momenti që vendos hoxha të bëhet spiun, të bëhet, deputet, të bëhet kryetar shteti, kryeministër, drejtor, ai nuk është më hoxhë por, mbanë titullin e profesionit të ri që vjen me përgatitje

akademike nga sfera e teologjisë! Pra është agjent, është spiun, është politkan, është deputet, që vjen nga radhët e hoxhallarëve. Historia jonë kombëtare njeh hoxhallarë liderë që kanë dridhur armikun e kombit. Në botë ka burrshtetas që janë hoxhallarë! Kur populli e vë në ballë një hoxhë, ky nuk është mëkat dhe as përzierje në punët e brendshme të një politologu, por, është respektim i vullnetit të popullit. Por kur në proceset politike shtyhet nga një parti një hoxhë, i cili nuk përfaqëson as një të katërtën e dëshirës së popullit, këtu pastaj kemi të bëjmë me “hoxhë” palaço, me “hoxhë” të instrumentalizuar, me “hoxhë” karrieristë i cili e meriton gjithë mllefën dhe urrejtjen e popullit si dhe gjithë mallkimin e Zotit. Zatën, pa derdhur mallkim mbi ty Zoti, nuk mund të bëhesh rezil e të vishë të pozita të turpshme siç erdhi Shaqir Fetai! Një gjë është më se e sigurt: Pollogun e humbi BDI-ja, sepse kështu deshti Zoti, jo se nuk i bënë kandidatët, por sepse me këtë humbje Vetë Zoti deshti që ta turpërojë deri në palcë Shaqir Fetain, ta ndëshkojë për tërë atë tradhëti e komplot që ia bëri BFI-së për ta degraduar deri në shtab partiak! Hoxhallarët nuk duan kacafytje, nuk duan përçarje, nuk duan pozicionime partiake, gjithçka që ata duan është që të humbë BDI-ja, të fundoset dhe, bashkë me të, të fundoset në gropën skeptike edhe Shaqir Fetai, ky nusprodukt i politikave antikombëtare e antifetare./1KlikLarg/05.11.2021

Kujt po i shërben Kryemyftiu i Kosovës!?

Kryemyftiu i Bashkësisë Islame të Kosovës, z. Naim Tërnavë, paska qenë mikëpritës i Shaqir Fetait, instaluesit të dhunshëm në krye të BFI-së nga pushteti aktual maqedonas!

Naim Tërnavë e ka përshëndetur këtë gjest ofendues për shqiptarët, të qeverisë aktuale maqedonase, e cila, ka pranuar urdhëra nga UDB-ja serbe për ta ndihmuar dhe ngritur në karrierë Shaqir Fetain; e ka përshëndetur, i ka uruar shëndet e suksese dhe e ka pritur si “vëllai vëllanë”!

Naim Tërnavë këtë hap e bën ose për inat të të madhit Nexhat Ibrahimit, të cilin e ka përndjekur Shaqir Fetai si student në Sarajevë (1983) me urdhër policore serbe, ose këtë vepër e përsëritë, sepse një Zot e di se kush mund ta porosisë në “pritje vëllazërore”! Se çka mund të bashkëpunojë njeriu me një udbash siç është Shaqir Fetai, këtë mund ta dijnë vetëm soji i tij!

Naim Tërnavë këtë hap e bën ose për inat të të madhit Nexhat Ibrahimit, të cilin e ka përndjekur Shaqir Fetai si student në Sarajevë (1983) me urdhër policore serbe, ose këtë vepër e përsëritë, sepse një Zot e di se kush mund ta porosisë në “pritje vëllazërore”! Se çka mund të bashkëpunojë njeriu me një udbash siç është Shaqir Fetai, këtë mund ta dijnë vetëm soji i tij!

Naim Tërnavë e ka dëmtuar BFI-në mjaft shumë duke u turrur në përkrahjen e politikave të cilat as që kanë qenë në interes të myslimanëve të Maqedonisë së Veriut, as në interes të islamit dhe aq më pak në interes të shqiptarëve të këtij vendi. Naim Tërnavë

tashmë duhet ta njohë se kush ka qenë dhe kush është Shaqir Fetai! Të paktën duhet të ketë qenë i njohtuar me dokumentin e publikuar nga dosjet e UDB-së, të cilën nuk mund ta mohojë as Shaqir Fetai dhe as Naim Tërnavë. Apo, mbase Naim Tërnavë mund ta ketë pyetur UDB-në serbe për vërtetësinë e dokumentit dhe, pasi e ka marrur përgjigjen, ka vendosur që t'ia miklojë shpinën Shaqir Fetait!

Shaqir Fetai sa herë që i ka punët pisk në Maqedoninë e Veriut, prehjen shpirtërore e gjenë te Naim Tërnavë! Është në vete ky farë kryemyftiu apo – të gjithë këta janë të një linje serike!

Në Maqedoninë e Veriut lustrimi i figurave publike lakuriqëesoi shumë “patriotë”, e “fetarë”! Hajt se, këtij procesi nuk do të mund t'i shpëtojë as Kosova. Udbashët nuk mund të bëjnë historinë e shoqërisë. Ata janë llumi i përmutur i shoqërisë. Është vetëm çështje kohe kur do të dalin si ai sendi mbi sipërfaqen e ujit!/BotaSot/06.11.2021

Vazhdon tallja e Shaqir Fetait me Institucionin e BFI-së

Nga BFI-ja e Shaqir Fetait informohemi se na e paskan themeluar “Arkivin” e BFI-së! A e di Shaqir Fetai se çka do të thotë Institucioni ARKIV, si themelohet ky Institucion, kur themelohet ai, cilat janë motivet e themelimit të këtij Institucioni, ndërkohë që organet dhe institucionet e BFI-së e kanë shërbimin e domosdoshëm arkivor

Ardhja dhe instalimi i Shaqir Fetait në krye të BFI-së, si dhe zhvillimet e mëtejme në Institucionin e BFI-së, që nga 27 maji i vitit 2020, të gjitha janë jashtë çdo përcaktimi kushtetutar dhe normave juridike të Bashkësisë Fetare Islame.

Këshilli për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI në RMV me kohë ka tërhequr vërejtjen për zhvillimet amatoreske dhe jashtë çdo standardi që përcakton peshën dhe seriozitetin e një institucioni.

Këto ditë Shaqir Fetai ka informuar se paska themeluar një “Arkiv” në kuadër të BFI-së? Duhet të jetë kjo punë hipokrite ekskluzive e Shaqir Fetait apo “punë profesionale” e Rijasetit! Mbi cilët akte normative, mbi cilët motive e mbështeti nevojën për themelimin e këtij “institucioni”? Opinioni nuk di asgjë! Natyrisht, themelimi i një institucioni aq të rëndësishëm siç është Arkivi vjen pas një analize të hollë e të thellë, pas vlerësimeve dhe konstatimeve profesionale! Nëse shërbimet arkivore kanë qenë katastrofale, këtë duhet ta

shpjegojë dhe ta nxjerrë Shaqir Fetai si motiv i domosdoshëm i themelimit të Arkivit! Nuk dimë asgjë se në çsituata e gjeti shërbimin arkivor Shaqir Fetai?

Se Shaqir Fetai është devaluës i pashoq i institucioneve, se ka mision jetik përçmimin e institucioneve relevante dhe me peshë shumë të rëndësishme, këtë tashmë e ka dëshmuar katërcipërisht. Çdo veprim i tij ndërmerret me qëllim që ta mashtrojë opinionin se ai po punon, se ai po zhvillon “aktivitete”, ndërkohë që çdo veprim i tij është jashtëkushtetues!

A e ka aktin themeltar të “Institucionit të Arkivit” të BFI-së?

A e ka aktin juridik në të cilën bazohet Shaqir Fetai për një institucion të tillë?

A e ka sistematizimin e punës për kuadrin profesional në një institucion të tillë?

A e ka kodin etik për të punësuarit në këtë Institucion?

A i ka deklaratat e të punësuarve se do ta ruajnë “sekretin” e çdo dokumenti i cili nuk do të nxirret jashtë Arkivit?

A e ka Statutin e Arkivit?

A e ka Rregulloren e Arkivit?

A e ka vendimin e Rijasetit për dorëzimin e materialit arkivor nga shërbimet arkivore të organeve dhe institucioneve të BFI-së!

A e ka vendimin e themelimit të komisionit pranues të këtij materiali?

A e ka Protokolin e vlerësimit, sistematizimit dhe digjitalizimit të materialit arkivor?

A e ka vendimin për rregulloren sipas të cilit do të kualifikohet dokumenti, koha e ruajtjes së tyre, kategorizimi i dokumentit në të përkohshëm e të përhjetshëm etj. etj.

Në bazë të informatave tona që na vijnë nga brenda BFI-së së Shaqir Fetait, asnjë prej këtyre akteve normative nuk i ka Shaqir Fetai dhe “arkivi i tij”! Flitet se ai i ka hyrë kësaj aventure sa për të siguruar nja dy-tri vende pune për ata të cilëve ua ka borxh shpirtin dhe për të siguruar nëpunës të cilët do të jenë në përkrahje të tij!

Këshilli ia tërheq vërejtjen Shaqir Fetait që të ndalojë me devaluimin e Institucionit të BFI-së përmes veprimeve amatoreske e diletanteske, përmes “themelimit” të instituteve e institucioneve të cilat i shërbejnë vetëm interesave të tij meskine dhe që e zbresin nivelin e punës së Institucionit gjashtëshekullor në një “kopsht

fëmijësh” ku harlisja është në kufijtë e normales së botës fëmijërore.

Këshilli për mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI në RMV

/Fakte/07.11.2021

“Arkivi” si përmendore e naivizimit

Shaqir Fetai, në fillimet e tij karrieriste prej instalacioni nga pushtetit politik, pati proklamuar me pompozitet se do të themelojë “institut të arkivit të BFI-së”! Pataj përjetoi një lumë kritikash për diletantizmin e tij në dallimin e institutit prej arkivit! Dhe, ja, më në fund, Shaqir Fetai “themeloi arkiv” duke e manifestuar paturpësisht përçmimin më të madh që dikush ia ka bërë institucionalisht materialit arkivor të BFI-së

Nga Afrim Tahiri

Shaqir Fetai, projeksioni më dështak i pushtetit politik, na e paska kryer një “reformë” në BFI, duke “e themeluar institucionin e arkivit të BFI-së”! Çka është arkivi si institucion? Pse themelohet? Kush e themelon? Kur themelohet? A ka pasur Shaqir Fetai ndonjë vizion mbi arkivin i cili i duhet BFI-së?

Shërbimi arkivor ka ekzistuar dhe ka funksionuar në BFI, gjegjësisht nëpër organet dhe institucionet e BFI-së, sepse pa këtë shërbim nuk ka profesionalizëm, nuk ka seriozitet në punë, nuk ka përkushtim për një jetëgjatësi infinite të punës institucionale. Tubimi i informacionit, i të dhënave historike, i dokumentave në një vend, nën një çati, është i domosdoshëm, është punë e dinjitetshme. Por, kur bëhet ky tubim, si dhe ku bëhet? Në një objekt me konsrukcion metalik? Bëhet nga njerëzit e papërgjegjshëm, nga matrapazët, nga kompilatorët e fakteve? A duhet në atë arkiv të jetë këndi i të parëve të BFI-së, biografia, veprimtaria dhe kontributi i tyre? A do të jetë aty si relik i

çmueshëm edhe periudha dhe personaliteti i ish-reisul ulemasë? A do të përfshihen edhe të dhënat mbi komplotin dhe tradhëtinë e Shaqir Fetait që e ndërmori në BFI me qëllim të degradimit dhe shkatërrimit të këtij Institucioni? A do të jenë të dhënat dhe kontributet e atyreve që kanë kaluar nëpër këtë Institucion, i atyreve që janë dëbuar nga ky Institucion, faktet, argumentat, arsyet e dëbimit...

Çka është arkivi

Arkivi është institucion i rëndësishëm i cili themelohet për evidentimin, pranimin, ruajtjen, konservimin, rregullimin, sistematizimin, digjitalizimin dhe publikimin e lëndës arkivore; të mundësojë dhe të lehtësojë shfrytëzimin e lëndës arkivore për hulumtime shkencore si dhe për nevoja tjera të cilat janë në interes për organet, organizatat, institucionet, personat civil-juridik dhe qytetarët. Arkivi, shprehur metaforikisht, paraqet memorien e kombit, të cilin nuk mund ta “redaktojë” dhe ta retushojë kurrnjëfarë diktatori, aq më pak Shaqir Fetai.

Arkivi, si institucion më vete, ushtron veprimtarinë e vet publike në pajtim me ligjin, në pajtim me statusin, me aktet normative të themeluesit si dhe në pajtim me rregulloren e hartuar nga themeluesi. Pa dyshim, këto akte juridike të çdo arkivi si institucion më vete janë të standardizuar në nivel ndërkombëtar.

Përse themelohen arkivat

A mund të themelohen arkivat nga njerëz që nuk ia kanë haberin se çka është arkivi? Përse duhen ato? A duhen vetëm sa për ta shuar paksa etjen e një mendjemadhësie hipokrite? Lënda arkivore është tërë dokumentacioni, i tërë materiali burimor dhe i riprodhuar (i shkruar, i vizatuar, i shtypur, i fotografuar, i filmuar, mikrofilma, shënime të lexuara me makinë, shënime digjitale, datoteka, duke përfshirë edhe mjetet për shfrytëzimin e tyre). Pa dyshim, meqë lënda arkivore ka rëndësinë historike, kulturore, shkencore dhe ka cilësinë e monumentit të kulturës, ruhet në mënyrë të përhershme.

A ka një aparat zjarrfikës në “arkivin” e Shaqir Fetait

Meqë lënda arkivore na e paska vlerën e paimagjinueshme, atëherë, a mund të lejojmë që një material i tillë të ruhet në një konsrukcion metaik me dy dhoma, e me një bodrum që gjithmonë rri ngulfatur në lluc e në ujëra të zeza, në pluhur e në “pëlhurë” merimangash? Dokumentet shekullore të BFI-së do të përfshihen vetëm në këto dy dhoma metalike? A e di Shaqir Fetai se, arkivi me konstrukcion metalik është vendi ideal për shkatërrimin dhe zhdukjen e tërë materialit arkivor? Arkivat janë institucione të një rëndësie që kanë institucionet shtetërore, ndaj dhe ruhen dhe janë nën vëzhgim të të njëjtave masa që i kanë edhe intitucionet shtetërore! Arkivat kanë të instaluar sistemin automatik të sigurisë dhe të parandalimit nga zjarret. A ka qoftë edhe vetëm një aparat për fikjen e zjarrit në “arkivin” e Shaqir Fetait?

Cili arkiv publik në botë është i konceptuar pa vendin e përshtatshëm për shfletim të dokumentave, pa leximoren, pa kartotekë ku evidentohen të gjithë qytetarët që kanë kërkuar për studim qoftë edhe vetëm një dokument; pa aparat fotokopjues, kompjutorë në leximore si dhe “reflektorët” për fotografi, pajisje këto elementare që i duhen arkivit bashkëkohor. Apo, Shaqir Fetai ka vendosur që, cilido që kërkon dokumenta për hulumtim apo studim, mund t’i marrë dosjet me vete në shtëpi dhe, varësisht prej ndërgjegjes së tij mund t’i kthejë, t’i dëmtojë apo edhe t’i zhdukë! Shaqir Fetai duhet të dijë se të drejtat e përdorimit të lëndës arkivore janë të parapara me ligj. Në Maqedoninë e Veriut hulumtimi dhe shrytëzimi i lëndës arkivore, komunikimi i dokumentave publike dhe i mjeteve të kërkimit, që nuk çenojnë interesin shtetëror e publik, që nuk keqpërdoren për të cenuar subjektin, bën pjesë në të drejtat themelore të qytetarit, të garantuar me ligj për informim të lirshëm dhe të papenguar, dhe, si e tillë, në parim nuk mund të kufizohet.

A mund të jenë lëndë arkivore, bie fjala, kutia e duhanit, cigarellëku, unuri, plisi, veshjet kombëtare, librat e vjetër, tespihët shumë të vjetër, dorëshkrimet qindvjeçare, apo, këto relikte i takojnë muzeve dhe bibliotekave nacionale! Vetëm dosjet e xhamive në Maqedoninë e Veriut do të kërkonin raftë gjigante të shtrira në një hapësirë hermetikisht e mbyllur nga ndikimet e kushteve klimatike, kushteve të brendshme si dhe me një sistem të

përsosur të sigurisë dhe të mbrojtës. A mund të themelohet arkivi sa për të ruajtur fleta nga “kaca pranon” dhe për të dëshmuar Shaqir Fetai se sa pak ka harxhur dhe me sa “nikoqirllëk” ka drejtuar BFI-në? Fletat e tilla nuk kanë kurrfarë vlere arkivore!

Klasifikimi i dokumentave

Klasifikimi i dokumentave sipas periudhave të caktuara është punë jetike e arkivave, kurse klasifikimi i dokumentave sipas rëndësisë është punë rutinë e cila përcaktohet me rregullore të veçantë!

A ka rregullore të veçantë për klasifikimin, kategorizimin dhe sistematizimin e dokumentave ky “arkiv” i Shaqir Fetait? A ka rregullore të veçantë se si përdoret një dokument i arkivit; mbi bajtjen shënim të vizitorëve, qëllimin e vizitës!

A ka rregullore mbi evidentimin e fondit të dokumentave dhe të lëndës tjetër arkivore, mbi kategorizimin e tyre, mbi numërizimin dhe katalogizimin e tyre, mbi bibliografinë e tërë fondit arkivore?

A janë sjellë vendime nga organi më i lartë për mënyrën e klasifikimit të dokumentave sipas vlerës, rëndësisë dhe peshës historike që kanë! A ka vendim mbi atë se cili dokument do të ruhet dy vjet, pesë, dhjetë vjet dhe cili dokument ruhet përjetësisht!

Arkivi pa akte juridike

A ka “arkivi” i Shaqir Fetait ndonjë akt juridik, rregullore të përgjithshme, ndonjë dokument i cili do të shpjegonte mbi rolin, detyrat dhe objektivat e një institucioni të tillë?

Arkivit i duhet një akt juridik, i cili, për arkivin dhe lëndën arkivore, do të përcaktonte:

- statusin juridik të arkivit;
- llojin e arkivit;
- veprimtarinë e arkivit;
- themelimin, organizimin, financimin dhe funksionimin e arkivit
- lëndën arkivore dhe materialin regjistruar;

- krijimin, ruajtjen, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e materialit arkivor;
- përzgjedhjen e lëndës arkivore;
- dorëzimin dhe pranimin e materialit arkivor;
- menaxhimin me arkivin;
- mbikëqyrjen e arkivit;
- kuadrin profesional dhe atë teknik;

Nëse nuk e ka aktin juridik arkivi i Shaqir Fetait, atëherë nuk kemi të bëjmë me subjekt juridik por, thjesht, me një akt të tërheqjes të dosjeve të themeluara nëpër zyre e “sektore” të BFI-së, në një objekt ku zhdukja dhe shkatërrimi i tyre është më i lehtë, më i realizueshëm, dhe me një përgjegjësi formale mbi një person të jashtëm i cili ka punuar në kushte absolutisht më të papërshtatshme “arkivore”, për ç’gjë edhe sanskionet mund të jenë formale! Mbase edhe ky është qëllimi: grumbullimi dhe zhdukja e gjurmëve me pasoja sa me të papërfillshme!

Një arkivi profesional do t’i duhej edhe ndonjë akt juridik i cili do të përfcaktonte definicionin e materialit arkivor, se kush është lëndë arkivore, si krijohet lënda arkivore, çka është materiali regjistror prej nga nxirret materiali arkivor, a është mbështetur iniciativa në ndonjë ligj të vendit i cili garanton sigurinë dhe mbarëvajtjen e punëve arkivore të institucionit privat të Shaqir Fetait, cilit organ i ka kërkuar ndihmë për siguri dhe mbrojtje të arkivit (sepse arkivat mbrohen nga organet gjegjëse të shtetit)!

Një institucion arkivor profesional do të kishte edhe rreglloren që do të përcaktonte se kush mund të jetë dorëzues i materialit arkivor dhe kush mund të ishte pranues, si bëhet evidentimi i pranimit-dorëzimit të materialit arkivor, cilat janë përgjegjësitë juridike dhe obligimet profesionale të dorëzuesit-pranuesit të materialit arkivor; cilat janë obligimet e dorëzuesit të materialit arkivor dhe cilat janë obligimet e atij që pranon, cilët janë sanskionet juridike të keqpërdoruesve, të atyreve që nuk kujdesen mirë për materialin arkivor si para dorëzimit ashtu edhe pas dorëzimit të dokumentave!

Një institucion profesional e publik, para së gjithash, gjatë themelimit të vet do të duhej të kishte edhe një akt juridik, një rregullore mbi shfrytëzimin e lëndës arkivore! Për çfarë nevojash mund të përdoret materiali arkivor! Kush mund ta përdorë këtë material; cili material mund të publikohet në opinion nga hulumtuesit dhe studiuesit; kush vlerëson se akcili dokument

është i interesit të përgjithshëm publik, shkencor e kulturor; kur mund të refuzohet një kërkesë për studimin e ndonjë dokumenti me rëndësi të veçantë. Mbi të gjitha, a ka ndonjë rregullore specifike që do të caktonte kohën se kur do të mund të bëhej objekt studimi një dokument! Arkivat profesionale dokumentet e dorëzuara nuk i japin për hulumtime shkencore pa kaluar, të paktën, një periudhë tridhjetëvjeçare nga dita e dorëzimit të materialit arkivor në “amzën” e vet!

A mund të startojë me punë një “arkiv” pa një akt juridik që rregullon mbikëqyrjen inspektuese nga organi themelues i arkivit? Si bëhet financimi i arkivit? Cilat janë dispozitat ndëshkuese?

Kur inicohet themelimi i institucionit të arkivit

A mund të themelohet një arkiv për shkak të një materiali të pasistemuar arkivor, ndërkohë që nuk ke ngritur ekip të profesionalizuar për një veprimtari aq shumë të rëndësishme për shoqërinë tonë. Çdo themelues i një institucioni të tillë fillimisht do të mbante kurs trajnimi, do të përgatiste kuadrin nga ekspertë të vendit apo edhe nga jashtë! Do të duheshin manuale e proces trajnimi për gjatë kohë para se të inicohej themelimi i arkivit. Ndryshe, jo që do të dilje hipokrit, por, mbi të gjitha, do të bëheshe gaz i botës! Shaqir Fetai futet nëpër zyrat e BFI-së, sheh plotë dosje me materiale, mbase edhe të panevojshme për t'u ruajtur dhe, o burra hajde të themelojmë arkiv, sepse, ja-ja, sa dosje kemi! A e njohin të punësuarit në “arkivin” e Shaqir Fetait legjislacionin e vendit mbi arkivat, a e njohin Kodin deontologjik të arkivistëve miratuar nga Ansambleja e Përgjithshme e Këshillit Ndërkombëtar të Arkivave, cilët janë normat tekniko-profesionale për punën me dokumentat administrative dhe arkivore, a e njohin përpunimin tekniko-shkencor të dokumentave që arkivohen, a e njohin ekspertizën e vlerës së ruajtjes së dokumentit, a e njohin komunikimin, shfrytëzimin dhe ruajtjen e dokumentave! A do të dijnë “arkivistët” e Shaqir Fetait që të dallojnë materialin arkivor nga materiali dokumentar!

Ndërtimi i arkivit në një objekt me konstrukcion metalik është vetëironizim dhe tallje me një institucion të tillë, për më tepër, pastaj, mbështetja e rafteve për mure të jashtëm që tërheqin lagështinë dhe thithin ngrohtësinë përcëlluese nga dielli i verës,

është veprim për shkatërrim pa lënë gjurmë! Nën kushte të tilla në mënyrë “ideale” mundësohet asgjësimi i dokumentave brenda një kohe të shkurtër, pa i dhënë llogari askujt, sepse, tani nuk do ta ndëshkojmë shiun apo diellin!

“Reformat” cinike dhe sharlatantese të Shaqir Fetait

Thënë shkurt, “arkivi” i Shaqir Fetait është vetëm një propagandë hipokrite personlisht e atij që i duhet për vetëngritjen e moralit që i ka rënë përdhe duke mashtruar e gënjyer se po bën reforma në BFI. Reforma nuk bëhen duke ngritur “institucione” mbi themelet e Institucionit të rrënuar nga “kazmat” e jashtëligjshme që detyrë parësorë e kanë rrënimin e aktiviteteve kushtetuese dhe instalimin e anarkisë mbi logjikën “përçaj e sundo”! Nuk ka sundim mbi një gjë të cilën e ke lënë pa bazament e pa tjegulla mbi kulm! Ka vetëm shfrytëzim i cili sjell degradimin deri në rrënim e shkatërrim total! Tjetër qëllim nuk ka pasur instalimi i Shaqir Fetait nga pushteti në krye të BFI-së! / 1KlikLarg/ 11.11.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (16)

Shaqir Fetai, instalacioni politik më brutal i pushtetit aktual maqedonas, i ekspozuar në krye të BFI-së, pa dyshim që shquhet edhe për paturpësinë e tij për të vjedhur suksese, për të vjedhur gëzime, por edhe për të vjedhur vdekje e dhembje dhe, për t' i paraqitur ato si aktivitete të veta

Nga Faik Shahinbejlliu

A e keni parë Shaqir Fetain, këtë kallëpin e komplotit dhe të tradhëtisë kombëtare e fetare, se si pa fije turpi mundohet që të vjedhë punë të bereqetshme dhe suksesshme të huaja e t'i prezantojë si "reforma të reisit të ri" dhe si suksese personale e të BFI-së së tij?! Punën e mundimshme të teologëve që nxjerrin hafiza të rinjë, e paraqet si sukses personal, ndërsa jo të gjitha vdekjet e myslimanëve, por vetëm ato të familjarëve të personaliteteve të njohura, i paraqet si aktivitete të BFI-së për përcjellje në botën tjetër! Këtë veprim do ta bënte vetëm ai që e ka fytyrën një hektar, vetëm një diletant, një hiprokit i llojit të Shaqir Fetait. Vjedhje e tillë ishte edhe paraqitja e tij sot në një xhami të Tetovës, imami i të cilës kishte pikasur një fëmijë gjeni i cili do të bënte punë vetëmohuese për ta nxënë përmendësh Kuranin e Madherishëm! Cila tani këtu është merita e Shaqir Fetait që ua çau b... të pranishmëve me një fjalor të denjë vetëm për një mëkatar dhe një snob? Shaqir Fetai, pasi e keqpërdori mundin e djaloshit, pasi ia keqpërdori vendin dhe eventit për t'i përshëndetur dr. e mr. idiotësh që i kishte marrur me vete, për të treguar se çfarë ekipi "të maaath" ka me vete, ai do të flasë gjëra që më së paku duhet të

dalin nga goja e tij prej të cilës kanë dalur llafe spiunazhi që kanë mbushur qindra e mijëra faqe dosjesh të hapura nga UDB-ja serbe; foli me të njëjtin dikcion si “moderatori” para fëmijëve të vegjël, ngjashëm si Branko Brankice në “Kock-kocka-kockice”!

Shaqir Fetai, veç të tjerash tha: 1.Ne mesin tonë është doajeni i leximit të Kuranit nga Ferizai; 2.Promovimi i një hafëzi të ri është një ngjarje e madhe; 3. Të jeshë hafiz do të thotë të jeshë ushtar dhe të qëndroshë para Zotit e t’i thuash, ja, qëndroj me mendje e me trup në mbrojtje të islamit; 4.Ju jeni ata që me kënaqësi të madhe po na jepni përkrahje; 5. Të lexoshë Kuranin do të thotë drejtë për drejtë të flasësh me Allahun xh.sh.; 6.Ky djalosh këtu mund të jetë 16 vjeçar por mua më duket 11 vjeçar; 7.Unë t’ju them drejt u dogja të nxjerr një hafiz por s’un e bona!

1.

Në mesin tonë është doajeni i leximit të Kuranit nga Ferizai! – Shaqir Fetai edhe më herët e ka përdorur fjalën “doajen”! Kjo fjalë u dedikohet personave që kanë një përvojë të gjatë në një aktivitet kulturor, arsimor, shkencor, të cilët janë në prag të fundit të tyre! Hafëz Egzon Ibrahim, ky fenomeni i këndimit bukur të Kuranit, nuk mund të jetë doajen. Shaqir Fetai tallet me këtë “nocion” me hafëz Egzonin, e përçmon, e ironizon! Ata që nuk e njohin Shaqir Fetain duhet të dinë që e folura e tij është kryekëput cinike dhe plotë sarkazëm. Në atë mexhllis doajen ishte vetëm ish-myftiu i Tetovës. Nëse para hoxhë Alifikri Esadit na del, sipas Shaqir Fetait, doajen hafëz Egzoni, atëherë i bie që, për Shaqir Fetain më i vjetri aty ishte Egzoni, ndërsa të vjetërit e tjerë ishin “hije të vdekurish”!

2.

Promovimi i një hafëzi të ri është një ngjarje e madhe! – Ja pra, për Shaqir Fetain promovimi është ngjarje dhe jo nijeti, jo procesi dyvjeçar apo tri, deri sa hafëzi e ka nxënë përmendësh Kuranin. Promovimi është aktivitet i organizuar i një personi, i një organizate, i një “korporate” dhe, nëse ky është aktivitet më i

rëndësishëm se sa tërë ajo punë nga e cila del një Mbrojtës i Kuranit, atëherë ja pra edhe një dëshmi se Shaqir Fetai është një qese bërllogu përplotë me cinizëm dhe me injorim!

3.

Të jeshë hafiz do të thotë të jeshë ushtar dhe të qëndroshë para Zotit e t'i thuash, ja, qëndroj me mendje e me trup në mbrojtje të islamit! – Po një “hafiz” i cili ka shkja nga kjo rrugë dhe një jetë të tërë qëndron para Stanko Dragoviqit, oficerit të UDB-së, duke u paraqitur si mbrojtës i ideologjisë komuniste! Shaqir Fetait, këtij nxënësi të oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviqit, rreptësisht i ndalohet të manipulojë në emër të islamit, sepse nuk i ka hije një komunisti që, nën petkun e “myslimanit të devotshëm” të flasë për islam e për Kuran! Shaqir Fetai nuk qëndroi kurrë para Zoti, nuk u dridh para Tij, por, së fundmi dëshmoi edhe praktiksht se gjithnjë ka qëndruar dhe është dridhur para pushteteve antiislame. Ndryshe, assesi nuk do të mund ta pranonte porosinë dhe angazhimin për ta kryer një komplot dhe një tradhëti që u ndërmor për ta rrënuar Bashkësinë Fetare Islame! Një rojtar i Kuranit do të vdiste e nuk do të pranonte që t'i luste myslimanët me përçmim e ofendim “nëse keni Allah, votoni për...” – për turlifarë antimyslimani e për turlifarë përfaqësuesi ideologjikë si pasardhës të komunistëve sllavë!

4.

Ju jeni ata që me kënaqësi të madhe po na jepni përkrahje! – Kësaj i thonë manipulim publik! Shaqir Fetai e shfrytëzon rastin dhe i kap “mat” të pranishmit, duke u thënë: ju na jepni përkrahje! Nuk ka musliman në Maqedoni që nuk e di se, t'i japësh përkrahje Shaqir Fetait është mëkat prej mëkteve të mëdha, sepse, edhe mysliman edhe të jeshë në bisht të spiunit, komplotistit e tradhëtarit, nuk shkon! Shaqir Fetait mund t'i japin përkrahje gjysma e familjes së vet (jo e tëra, sepse ka famijarë të tij që flasin zi e më zi për të), mbase edhe një 0.0001% e myslimanëve të

vendit. Mbase Shaqir Fetai mund të shpresojë në përkrahje të të palindurve akoma, spse këta që kanë vetëm një gram logjikë e dinë shumë mirë se kiç-instalacioni i pushtetit antiislam nuk mund të përkrahet por të mallkohet e të përçmohet me loçkë të zemrës.

5.

Të lexoshë Kuranin do të thotë drejtë për drejtë të flasësh me Allahun xh.sh. – Le të na thotë Shaqir Fetai, ky farë “hafizi” që kurrë në jetën e vet nuk nxori një hafiz, ndërsa nxori plotë spiunë, pra, le të na thotë se, a ka folur më shumë me Allahun xh.sh. apo me oficerin e UDB-së, Stanko Dragoviqin? Shaqir Fetai sot duhet t’i përdorë këto evente të madhërishme për t’i lutur hafizlerët e rinj që kurrë të mos joshen (siç u joshë vetë ai) nga kurrfarë shërbimi inteligjent dhe nga asnjë forcë e lëvizje që nuk ia do të mirën islamit dhe myslimanëve të vendit. Në këtë shteg ka marshuar gjatë kohë Shaqir Fetai, ndaj dhe, nëse është penduar në momentin e instalimit të tij në krye të BFI-së, atëherë, le t’i përdorë këto momente për apele të përsëritshme që mos të lejojnë të futen nëpër kallëpe të spiunazhit!

6.

Ky djalosh këtu mund të jetë 16 vjeçar por mua më duket 11 vjeçar! – Shaqir Fetai merr pjesë në një “promovim” ndërsa nuk e njeh veprën, nuk di asgjë për veprën, madje as që e ka lexuar. A ka më diletantizëm se kjo; a ka më sharllatantizëm se kjo, a ka më hipokrizi se kjo! Ky “sinqeritet” cinik e injorant mund të rrjedhë vetëm prej sojit të Shaqir Fetait! Ja sa i ka interesuar Shaqir Fetait, procesi nëpër të cilën ka kaluar djali, ja sa ka interesuar që ta motivojë si institucion, ja sa e ka përcjellë punën e një rojtari të Kuranit dhe, fare në fund, ja sa ka njohur i mbi hafëzlerët e rinj ky farë “reisi”! Turp! Cinik deri në thithej të tërë urrejtjes njerëzore! Vetëm Shaqir Fetai që i lejon vetes t’i keqpërdorë eventet e tilla për t’u shpërfytyruar në kamer e në “TV të BFI” si “mësuesi i kombit”, si “patriot i kombit dhe vatanit” (edhe pse në ceremoni vetëm një

herë tha Tetova e Madhe, ndërsa Ballkanin e përmendi dhjetra herë, madje edhe në Meke e paskan pyetur për Ballkanin!!!) si “hoxhë”, dhe përmes kësaj intrige të mundohet ta zbusë të qenurit i përkryer në komplot e tradhëti!

7.

Unë t’ju them drejt u dogja të nxjerr një hafiz por s’un e bona! – Thotë Shaqir Fetai! U dogj për ta nxjerrë një hafiz por nuk ia arriti! A mos e ka pasur ndonjëherë qëllim kryesor nxjerrjen e hëfëzit! Jo, kurrë! Sepse ka qenë i angazhua në spiunim, në bërje të karrierës së dobët, në ushtrim të pamerituar të postit “myfti” (sa për ta djegur e degraduar këtë organ!!!), qëllim ka pasur si të lidhet me struktura të pushtetit që do ta ndihmojnë në komplot e tradhëti që do t’ia vinte kazmat e shkatërrimit të të vetmit Institucion fetar islam në RMV – BFI-së!

8.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/14.11.2021

Pse frikësohet Shaqir Fetai? Po “myhybtë” e tij?

Ta spostoshë apo ta deklasoshë me intriga e me insinuata liderin, me qëllim që ta realizoshë puçin e orkestruar nga nëntoka për t’ia rrëmbyer “fronin”, është jo vetëm krim moral por edhe njerëzor. Intrigantin do ta ngulfasë ndërgjegja deri në përjetim të të njëjtës ngjarje të cilës nuk i shpëton dot në jetën e vet. I poshtëruar do të jetë ai që i nënshtrohet pushtetit. Kurani Famelartë thotë: “Unë jam urdhëruar që të jem i pari që t’i nënshtrohem Atij” (6:14)

Nga Lirim Dullatahu

Kush e urdhëroi Shaqir Fetain në thurrjen e intrigës së poshtër për ta sendërtuar një plan sa antikombëtar po aq edhe antifetar-antiislam duke e thyer traditën e sjelljes së të parit në krye të Institucionit të komunitetit të myslimanëve. Tashmë botërisht dihet që Shaqir Fetai, i dalur nga kanalizimet e UDB, ushtroi një komplot e puç si në eliminimin e ish-udhëheqësit të tij shpirtëror, H. Sulejman ef. Rexhepi, ashtu edhe në kapjen e “fronit” të tij. Pa dyshim, Shaqir Fetai ndjehet shume i turpëruar, i vënë në lojë nga pushteti aktual maqedonas, ndjehet i mallkuar për gjestin antihuman që bëri, ndjehet i hendikepuar deri në “person në nevojë”, ndaj dhe nuk ka fytyrë t’i dalë përballë H. Sulejman ef. Rexhepit. E ka turp takimin me të, qoftë edhe të rastësishëm, por, natyrisht, e ka edhe frikë, e ka urdhër nga “nëntoka” e cila është shumë e bindur se, në çdo takim me Sulejman Rexhepin, Shaqir

Fetai mund t'i lëshojë pantallonet, me gjithë benevrekë! Pra, për fytyrën dhe namuzin e Shaqir Fetait më tepër përkujdeset “nëntoka” që e instaloi në krye të BFI-së se sa vetë ai! Të instaluarit e pushtetit nuk duhet ta kenë merak autoritetin e vet por autoritetin e pushtetit. Pa pushtetin, ata janë, thjeshtë, bajgë!

Pse fshihet Shaqir Fetai

A e keni parë se si ik Shaqir Fetai nga H. Sulejman ef. Rexhepi, nga ai të cilin e tradhëtoi dhe e “poshtroi” në pleqëri! Kush është më i dashur në komunitet: tradhëtari apo i tradhëtuar. Kush është më i lavdëruar në histori: tradhëtari i shkathët apo i tradhëtuar që mund të ketë përplotë të meta!

Pse nuk ftohet Sulejman Rexhepi nëpër ato evente fetare, në dua hatme, në dua hifzi, në përrurime të xhamive. Po Sulejman Rexhepi ka marrur pjese në shumë evente të tilla, madje me pjesëmarrje masovike të xhemateve, të cilat as që imagjinohen aty ku merr pjesë Shaqir Fetai! A do ta madheronte apo do ta nënçmonte një mexhllis përfshirja në event edhe e Sulejman Rexhepit?

Po pse kërcënohen me largim nga puna të gjithë ata nëpunës që do ta takojnë Sulejman Rexhepin! Pse frikësohen prej të gjithë atyreve që kontaktojnë me Sulejman Rexhepin?

Shaqir Fetai nuk dëshiron të ndjehet i turpëruar, i dhjerë në poture, nuk dëshiron që të njihet si frikacak, frikën e vet për ta takuar Sulejman Rexhepin dëshiron ta paraqesë si solidarizim me bashkëpunëtorë “të shumtë” që nuk dëshirojnë ta takojnë “mëkatarin”, të cilin dikur e përkrahnin në çdo “mëkat”, i miratonin nëpër kuvende vjetore “çdo mëkat”, i duartrokisnin çdo “mëkat”, një javë para komplotit dhe tradhëtisë do t'i thurrin elozhe “mëkatarit”...

Vërtet pse kanë frikë nga Sulejman Rexhepi i cili i punësoi, i emëroi myfti e drejtorë? Apo janë shumë koshientë se këtë nderë nuk e kanë merituar nga Sulejman Rexhepi, sepse thellë në vete e ndjejnë se janë tërësisht të pavlerë!

Pse Shaqir Fetai ik nga frika prej Sulejman Rexhepit i cili, e punësoi, e bëri drejtor e profesor, e bëri myfti, pra në asnjë moment nuk ia rrezikoi karrieren dhe nuk ia nëpërkëmbi dinjitetin por, përkundrazi, gjithkund e mori me vete, e njohtoi me opinionin e gjërë, të cilit pa rreshtur ia imponoi si vlerë. Pra ishte vetë Sulejman ef. Rexhepi që u përkundes për pia-rin dhe reklamimin e

Shaqir Fetait në opinion, ndërsa ky e kishte të qartë se Sulejman Rexhepi e dinte fare mire se ç'plehër ishte ky farë "reisi"!

Frikë apo turp

Shaqir Fetai, pas komplotit dhe tradhëtisë që ia bëri "babait shpirtëror" të tij nuk pranon dhe nuk lejon takim me ish-Reisul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepin! Biografia dhe veprat, aktivitetet dhe kontributet e H. Sulejman ef. Rexhepit do të ngelin përjetë kapital që do të dëshmojnë vetëm për një periudhë, ndonëse shumë e mynxyrshme, me shumë suksese, me shumë ngjitje, me shumë name e të arritura, të cilat vogëlsia e Shaqir Fetait nuk mund t'i shohë as në ëndërr, sepse as Zoti nuk pajtohet që një intrigant i djallëzuar të shohë ëndërra të bukura!

Shaqir Fetai do të mbahet mend si intrigant që arriti ta sendërtojë një plan të huaj e fatkob për BFI-në duke e qëlluar pas shpine me thika njeriun e miritave dhe të sukseseve të BFI-së si Institucion që deri më 27 maj 2020 shquhej si faktor determinues për shumë perspektiva kombëtare e fetare në vend dhe më gjërë.

Cv-ja e Sulejman Rexhepit është e paarritshme! Veprat e Sulejman Rexhepit janë materie për qindra doktorantë të ardhshëm.

Kontekstet historike e shoqërore mbajnë vetëm emrin e Sulejman Rexhepit, ndërsa emri i Shaqir Fetait do të mbahet mend si vrasës dhe asgjësues i këtyre kontesteve, sepse kështu kanë dashur urdhërënësit e tij.

A mbahet Institucioni me frikësim e shantazhim

Shaqir Fetai ju thotë bashkëpunëtorëve të tij se, nëse nuk i nënshtrohen dhe nuk e përkrahin, gati është të vijë Sulejman Rexhepi dhe, pastaj, rikthimi i tij do të thotë "spastrim", largim i të gjithëve nga puna! Po pse t'i largojë të gjithë nga puna kur Sulejman Rexhepi e ka shumë të qartë se ata kanë qenë të manipuluar nga kryeintriganti Shaqir Fetai. Së kendejmi, mund të largohet eventualisht Shaqir Fetai, manipulatori dhe, jo të manipuluarit. Pra, shantazhin që e përdor Shaqir Fetai duke i frikësuar të tjerët e ka vetëm sa për t'i mbajtur të nënshtuar, sepse vetëm "si perandor" ai mund t'ia zgjasë vetes karrierën e ultë. Po cilit "perandor" i ka shkuar gjithmonë kungulli mbi ujë! Shaqir Fetai dhe myhybtë e tij po seleksionojnë teologë në: hoxhallarë tanë dhe në hoxhallarë të Sulejman Rexhepit dhe Afrim Tahirit. Madje u thonë hoxhallarëve të rinj, të përkushtuar për ta kultivuar devotshmërinë, nuk mund të punësohesh se je parë

duke pirë kafe me Afrim Tahirin i cili kontaktuaka me Sulejman Rexhepin! Kush e thotë këtë? Ata që dekretin e punësimit dhe të avancimit e të karrierës e kanë nga Sulejman ef. Rexhepi! Po tani, pse kjo frikë nga Afrim Tahiri? Kush mund ta ketë frikë Afrim Tahirin!? Asnjë nuk mund të thotë se në kohën sa Afrim Tahiri ka qenë sekretar gjeneral i BFI-së ndonjë hoxhë apo nëpunës fetar ka hequr të zinjte e ullirit prej tij! Përkundrazi, i ka mbajtur nën mbrojtje, madje duke u konfliktuar edhe me reisin! Nga ajo që është lexuar deri më sot, në kohën sa ka qenë sekretar i përgjithshëm Afrim Tahiri ka qenë tmerr e trishtim vetëm për matrapazët, për imoralët, për hajnat që nën petkun e teologut janë munduar të bëjnë veprime të padenja për njeriun normal. Në kohën e tij më së rëndi e kanë pasur pushtetarët të cilët kurrë nuk i ka lënë që ta ngjyjnë “kafshatën në pjatën e BFI-së!

Po pse pra kjo frike nga Afrim Tahiri i cili tash për tash vepron në opozitë dhe kundër komplotistëve të BFI-së? Kush po frikësohet nga Afrim Tahiri? A mos janë të gjithë ata të përfshirë në listën e siguruar nga Afrim Tahiri e që flet për drejtorë e myfinj matrapazë, me shkollim e dokumenta të falsifikuar, me “tituj shkencorë” të blerë? Pa dyshim, nëse një ditë rikthehet Afrim Tahiri (e kjo do të ndodhë me patjetër, sepse kjo është dëshirë gjithnjë e më e madhe e besimtarëve) këta pseudo-teologë do të ikin vetë, do të vetëpastrohen, pa pasur nevojë për “fshesën reformuese”!

Mëkatarët nuk kanë se çfarë kërkojnë në një Institucion fetar islam! Ata janë të vetëdëshëm për këtë, prandaj e gjithë kjo frikë nga Sulejman Rexhepi dhe Afrim Tahiri. / 1KlikLarg/ 16.11.2021

BFI dhe politika e jashtme e saj

Dikur BFI ishte institucioni më i vizituar prej faktorëve të ndryshëm ndërkombëtar, ishte anëtare e shumë kongreseve dhe konferencave ndërkombëtare, lideri i saj ishte udhëheqës e anëtarë kryesie i shumë organizatave dhe konferencave ndërkombëtare. Sot prestigji i saj është përdhe! Imazhi i saj jo është për ibret. “Lideri” i saj gjithandej njihet si komplotist, tradhëtar dhe njeri i shërbimeve intelegjente antiislame

Nga Admirim Muça

BFI-ja e Shaqir Fetait na është shndërruar në vend argëtimi për të gjithë ata që e njohin për “lider” Shaqir Fetait! Ata që nuk e njohin janë jo dashamirë të BFI-së së Shaqir Fetait. Ky farë avdalli veten e identifikon me BFI, prandaj, kush nuk e njeh Shaqir Fetait është armik i BFI-së!

BFI-ja e Shaqir Fetait ka “drejtori ekskluzive” për kontakte me punë të brendshme dhe me organet e kësaj “ministrie”! Njerëz mendërisht të sëmurë! Njerëz që kqyrin të prodhojnë në institucionin fetar policë e agjentë policësh! Themeluesit dhe udhëheqësit e këtij digasteri janë njerëz me dosje të trashë nga veprimtaria imorale dhe amorale e tyre. Dhe, pikërisht këta njerëz kanë të drejtën e kontaktimit edhe me botën e jashtme!

BFI-ja e Shaqir Fetait ka edhe “sektorin” për kontakt me botën arabe! Narrativi idiotik i Shaqir Fetait se ka arritur të “ngrisë” një BFI që po ia kanë lakmi shumë institucione simotra në botë, është vetëm një “mastrubim” i një manjaku i zënë vetë në kurthin e tradhëtisë që u mundua t’ua ngrisë të tjerëve.

Shaqir Fetait që kur u instalua nga pushteti aktual maqedonas në krye të BFI-së ka qenë “shuumë herë” nëpër botë (dy here EBA e një herë në Egjipt; një herë në Turqi, Bosnje, Kroaci, Kosovë e Shqipëri)! Çka ka bërë aty? Kurrigjë, është sjellë si qura në mjegull, si pordha n’tirqi, është injoruar e nuk është përfillur fare. Është

ftuar si Institucion, ndërsa është përçmuar si personalitet me biografi aspak të denjë për një mysliman.

Në EBA, Shaqir Fetai takohet me kryetarë asociacionesh e shoqatash, si dhe, takimin më të rëndësishëm e ka me ambasadorët e Maqedonisë!!! Me paret e fitrave të myslimanëve të vendit Shaqir zeza i viziton ambasadorët e Maqedonisë! Çka i duhet ky “aktivitet” nëse jo kthim borxhi politik partive që u bënë sebeb të jetësohet plani dhe sugjerimi i oficerëve të UDB-së. Do të thotë Shaqir bilmezi se në Egjipt, në konferencën kushtuar Ditëlindjes së Pejgamberit a.s. u takua edhe me Presidentin e Republikës së Egjiptit! E çka është me rëndësi kjo? Presidenti egjiptas ka detyrim ta realizojë axhendën e vet e cila i sjell personalisht atij pika politike. Takimi i presidentëve me grupe njerëzish përgjatë eventeve të organizuara në nivel të lartë, është ekskluzivisht takim kurtoazie, pa kurrfarë domethënienl dhe rëndësie. Por, çështja është çka fitoi vetë Shaqir Fetai që u injorua tërësisht dhe, krejt në fund, çka fituan myslimanët e vendit. Çdo vizitë jashtë shtetit, nëse nuk sjell perfitime morale apo materiale, është, thjesht, eskursion idiotik me paratë e popullit.

A i kërkoi Shaqir Fetai protokolit shtetëror dhe organizatorit që t’ia parashohë takimet tetatet me personalitete të cilët do të mund të ndihmonin për të dalur nga kjo situatë katastrofale ku është katandisur BFI! Jo, sepse, ku ia ka haberin Shaqir Fetai protokoleve dhe arsyes primare të organizimeve të eventeve të tilla. Shaqir Fetai nuk e di se nëpër evente të tilla lidhen miqësitë, arrihet marrëveshjet për bashkëpunime bilaterale; fitohet ndonjë bursë për studentët tanë që dëshirojnë të studiojnë nëpër fakultete të ndryshme, fitohet ndonje kuotë për studentët tanë, ndonjë përkrahje materiale për specializime të kuadrit tonë etj. Shaqir Fetai nuk mund të kthehet në vendlindje pa i takuar ambasadorët e Maqedonisë! Çfarë avdalli!

Shaqir Fetai komunikimin me botën e jashtme, me shtetet arabe, e percepton si “bankë mëshirëplote” ku ai e ka mundësinë të nxjerrë para sa herë që i duhen atij. Prandaj e nisë nëpër boten arabe “drejtorin” e vet për të kërkuar dhe për të sjellë para. Kjo i konvenon “drejtorit” sepse do të takojë miq e “punëdhënës” të vetë, ndërsa e di që personalisht atij nuk i jep askush, sepse të gjithë në botën arabe ia dinë biografinë, ndaj dhe as që e merr mundin të kërkojë.

Fare në fund, Shaqir Fetai nuk kupton se sot, vetëm ndonjë pare e

pistë, e krimit dhe e drogës mund të qarkullojë kesh duke kaluar “tinëzisht” kufij, doganierë e policë. Sot askush nuk jep para. Sot është koha e finansimit dhe e përkrahjes së projekteve dhe jo e mbulimit të rrogave e honorareve. BFI-ja, deri më sot, falë Afrim Tahirit dhe Avni Halimit, ka arritur të bëjë vetëm një projekt (STOP RadTerr), të ketë shumë miq e përkrahës të projektit dhe, shumë donatorë të gatshëm për ta ndihmuar. Por, që në momentin kur Shaqir Fetai lejoi që ai projekt të drejtohet nga hajni, banditi dhe matrapazi i BFI-së, të gjithë donatorët do të tërhiqen dhe do të raportojnë ndër qarqe ndërkombëtare për BFI-në si për një qerthull matrapazësh.

Shih për këtë, sot për sot, BFI-ja, jo si Institucion, por si qerthull e matrapazëve dhe manipulantëve në emër të fesë, ndër qarqet ndërkombëtare trajtohet si katastrofë. Ky imazh nuk përmirësohet me plafe mbi fëlliqësirë por me politika të mirëfillta që mund të jenë rezultat i reformave themelore, në të cilat pjesë e reformës do të ishte, pa dyshim, edhe vetë Shaqir Fetai!/1KlikLarg/18.11.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (17)

Shaqir Fetai është duke themeluar nga e para “Bashkësi Fetare Islame”! Me të fillon gjithçka, madje edhe pajisja e kabinetit të tij me orendi të reja. Shaqir Fetai ka publikuar foto ku shihet se si e ka renovuar sallën e “rijasetit”! Shaqir Fetain me e hyp dhe në Hënë ai megjithatë ngelë fuks dhe injorant nën petkun e hipokritit

Nga Faik Shahinbejlliu

Shaqir Fetai vazhdon duke u shpërfaqur ditë e më shumë në hambar gjigant të turpit! Po i turpëron gjithë myslimanët e vendit me injorancë, me snobizëm dhe me hipokrizi. Është ithtarë i vetëfërkimit, i fërkimit në mes vete me myhybtë e vet, sepse, për Shaqir Fetain e rëndësishme është që në mes të anëtarëve të “rijasetit” të konsumohen bolet për bubrekë duke i lavdëruar kënaqshëm se hëngrën diçka të lezetshme.

Shaqir Fetai nuk mund të kalojë javë pa ndonjë lëvizje hipokrite që, nga një vlerësim normal (pa egzaminimin psiko-psikiatrike) del se ai aq sa është naiv po aq është edhe lolo.

1.

Shaqir Fetai paska organizuar një “sesion shkencor kushtuar mësimbesimit në mektebe dhe sfidat bashkëkohore”! A mos ishte më mirë që një sesion i tillë t’i kushtohej (mos)mësimbesimit nëpër shkolla shtetëror? Apo, Shaqir Fetai tashmë ka lidhur paqe me shtetin sa edhe gishtin në bythë me ia futë ai nuk do të reagojë! Shikojeni Shaqir zezën se çfarë bën! I mbledh myhybët e vet, si ata të ylbertet kur mblidhen në një odë-harem dhe “diskutojnë” në mes

vete! Në mesin e atyre myhybëve pjesëmarrës, të paktën nja 10 persona ishin që nuk kanë lidhje me teologji, rrjedhimisht as me mundësinë për të qenë mualimë-mësues mektebi! Çka është me rëndësi që me këtë temë të njohtohen në mes vete myftinj të cilët, dorën në zjarr, as që e dinë se sa mektebe kanë dhe as që i vizitojnë ndonjëherë! Po si nuk i shkoi në mend Shaqir Fetait që t'i mbledhë të gjithë mualimët e vendit dhe t'ju tregojë se tash e tutje, pas "reformave" që i bëra, në mekteb mësimesimi fetar do të zhvillohet sipas kësaj metodike, sipas këtij koncepti dhe me këto mjete bshkëkohore (kompjutorë, laptopë, prozhektorë etj.)! Jo, sepse, Shaqir Fetai ka pasur dy qëllime: ta promovojë sallën e "rijasetit" i cili ka qenë mjaft i mirë por, për Shaqir zezën ka qenë i ish-reisit të cilit i komplotoi duke ia ngulur thikat e tradhëtisë pas shpine dhe, ja që ka pasur frikë nëse do t'i përgjigjeshin nja dhjetë-pesëmbëdhjetë mualimë e mësues mektebesh, sepse as që ka çarë kokë ndonjëherë për ta, madje as nuk ua ka nivelizuar rrogat e as që i ka futur në sistem pensiono-invalidor!

Në faqen hipokrite të FB-ut të vet Shaqir Fetai, pa fije turpi, pa një gram modestie, do të shkruaj një fjali përmes të cilës ai dëfton se i injoron dhe i tallë të gjithë akademikët dhe intelektualët që sado pak e dinë se çka është sesioni dhe si, pse dhe për kë përgatiten sesionet. Shaqir Fetai thotë: "me sukses u realizua Sesioni shkencor në nivel të Rijasetit të BFI e RMV"! Ja, unë, autori i këtij shkrimi, jam njëri prej intelektualëve (miliona herë më i fuqishëm se Shaqir zeza) që ia kontestoj suksesin e një cirkuziade të tillë. Kush ia verifikoi suksesin Shaqir Fetait! Ai vetë lanë e vetë shpëlanë. Thjesht, në këtë kontekst, edhe ky sesion mund të jetë i suksesshëm vetëm në shpëlarje të parave, në shpenzim kot e kot të parave, keqpërdorim flagrant i fitrave dhe zeqatit të myslimanëve të ngrat të këtij nënqielli! Për t'i dhënë peshë "akademike" tërë kësaj cirkuziade, Shaqir Fetai do të thotë: "Nivel i lartë i ligjëruesëve Prof.Dr. Qani ef. Nesimi, Dr. Qenan Ismaili dhe Prof.Dr. Naser Ramadani"!!! Të gjithë me "tituj" ndërkohë që nuk kanë më të voglën njohuri nga shkenca e Pedagogjisë, nga Metodika dhe nga Informatika si shkencë, për të dhënë kontribut në një sesion me një temë të tillë pretencioze! Por, ne jse, hajde t'i shesim mend njëri tjetrit! Ka para të fitrave Shaqir Fetai, mund t'i lejojë vetes që t'i shpërdorë edhe për një vetëkënaqësi të tillë!

Në fjalën e vet të qelbosur Shaqir duduki paska thënë "pa edukim të mirëfilltë dhe të shëndoshë nuk mund të mendojmë në një

ardhmëri të shëndoshë për Islamin dhe muslimanët në përgjithësi, andaj mësimbesimi islam në mekteb është baza e edukimit tonë të përgjithshëm dhe se duhet t'i kushtojmë rëndësi të jashtzakonshme". Ky është një konstatim i hershëm rilindas! Nuk është në gjendje dhe nuk është i thirrur Shaqir Fetai të konstatojë por të veprojë! Çka ka bërë, çka ka ndërmarrur Shaqir Fetai si hap të jashtëzakonshëm në drejtim të një edukimi të mirëfilltë dhe të shëndoshë? As këtë nuk është në gjendje ta bëjë Shaqir Fetai, sepse, edhe nuk di por edhe nuk i lejohet nga mësuesit e tij me zyre në UDB! Një udbash me plotë udbashçiçë të vet të na flasë për mësimbesimin në mektebe?!

Paskan sjellë konkluzione në fund të sesionit, ndonëse nuk i publikojnë, sepse nxjerrin në shesh amatorizmin, sharlantantizmin dhe hipokrizinë e tyre! A kanë konstatuar këta të "rijasetit" të Shaqir Fetait se sa mësimdhënës dinë t'i përdorin mjetet bashkëkohore të ligjërimit?! Sa kanë njohuri elementare mbi informatikën! A duhet të themelohet një drejtori e veçantë, me një "tog" ekspertësh, prej njohës të pedagogjisë, metodikës e deri te IT e mirëmbajtës të rrjetit kompjutorik, sepse, a medon Shaqir diletanti se koha është që mektebet të ndërlihen mes vete dhe të kenë një program të unifikuar! Ku i merr vesh këto gjëra Shaqir Fetai, e aq më pak "niveli i lartë i ligjërimit", Qenan Ismaili, i cili, në mbledhjen e myftinisë që e ka shndërruar në filiale të FRI-së, raporton se, është shumë i lumtur me suksesin që ka arritur në a) shtimin e lexuesve të fb të myftinisë, b) në shtimin e "like"-ve për 1000 si dhe c) në shtimin e "followers"-ave për 327 të rinj! Me të tillë "të sukseshëm" Shaqir Fetai mendon të mbërrijë suksese?! I dështuar është vetë ai ashtu siç i ka të dështuar dhe "ekspertët" e vet!

2.

Shaqir Fetai thotë: "Përfundoi rregullimi i Studio TV IKRE"! Kë e gënjenë Shaqir Fetai! Pse edhe më tej mundohet që mbi baza të rrenave të bëjë karrierë?! Po çfarë karriere "studioja" xhanëm?! A e di Shaqir ahmaku se çka do të thotë studio televiziv! Cilët janë parametrat e një objekti për t'u quajtur studio! "Tv Ikre" është në po atë "studio" ku ka qenë, me inventar të ndryshuar, me ndërrimin e tavolinës dhe largimin e prapavijës karikaturë! Me këtë ndryshim që paska bërë, me këtë "studio" të re të vjetër, tashmë

Shaqir Fetai paska “themeluar” një Tv Ikre që “do të jetë zë i fuqishëm i vlerave islame”! Po deri dje – çka ishte ky “tv”?

3.

Duke qenë totalisht i izoluar dhe i injoruar, Shaqir Fetai tashmë ka nisur t’i ftojë nëpunësit e BFI-së dhe prej tyre të bëjë lajm mbi vizitat që po shpresohen në “kabinetin e Shaqir Fetait”! Shaqir Fetai ka qenë koleg me profesor Hasan Xhilon, me një nga mendimtarët më serioz të mendimit islam në Maqedoninë e Veriut! Kurrë nuk ka shprehur admirim për të, madje gjithnjë është tallur në llogari të Hasan Xhillos! Ka qenë një prej kundërshtarëve të mëdhenj të shfrytëzimit të zyres së Bibliotekës “Isa Beu” ku Hasan Xhillo, deri sa ishte drejtor i Bibliotekës, po e përkthente Kuranin në gjuhën maqedonase! Ka qenë për ta ndëshkuar për këtë “shfrytëzim” të zyres për interesa personale! Përkthimin e Kuranit në maqedonisht Shaqir Fetai e vlerësonte “interes personal” të Xhillos! Por, kurrë, asnjëherë, për asnjë çast nuk ka pasur mendim të mirë Hasan Xhillo për Shaqir Fetain, sese e ka njohur që nga Sarajeva, si studentë, kur Shaqir Fetai bënte kërdrinë mbi “shqiptarët nacionalistë e seperatistë” dhe mbi boshnjakët që po ia prisnin terezinë nacionaliste serbëve!

Mysafir e paska pasur edhe profesor Nizam Reshitin, kontaktuesin me botën turke! Po a është po ky Nizam Reshit të cilit Shaqir Fetai i ka kërkuar falje dhe hallallëk sepse është bërë shkaktar për ta dëbuar nga BFI-ja dhe për ta dektisur profesor në FSHI? Sepse Shaqir Fetai ka qenë i bindur se Profesor Nizam Reshiti është “spiun turk” brenda BFI-së që shërben për shërbimet turke që janë kundër H. Sulejman ef. Rexhepit dhe BFI-së! Nuk flet kjo për hipokrizinë e poshtër të Shaqir Fetait? Shaqir Fetai nuk ka flokë në kokë sa vetëve duhet t’u kërkojë hallallëk për atë që është bërë sebeb për t’ua nxirë jetën! Më shpirtzi se Shaqir Fetai nuk gjenë as në “shumadi”!

4.

Phaaaa, se si është “rasti mbret i botës”! Krejt rastësisht e paska vizituar edhe myftiu i Gostivarit si dhe një elektrikist me të cilën paskan këmbyer përvoja dhe “mendime të begata”! Ja se si Shaqir Fetai i shpalosë “kualitetet” e veta! Na ishte futbollist e aktor, tani

na doli edhe elektrikist sepse, pa qenë i tillë nuk mund të këmbeshë mendime mbi fushën përkatëse! Prandaj Shaqir Fetai takohet edhe me spiunë e bashkëpunëtorë të UDB-së e të shërbimeve telegjente të ndryshme! Ka njohuri edhe në këtë fushë dhe mund të këmbëjë përvoja e mendime edhe në aspekt të spiunimit. Avdall i profesionalizuar!

5.

Shaqir Fetai shpreh urime për gjuhën shqipe ndërsa shpesh del edhe bastardues i kësaj gjuhe, sepse, aq ka njohuri ai, por edhe e ka porosi që të tallet me këtë gjuhë! Shaqir Fetai me ashk e bastardon fjalën, me shpirt e boshnjakëzon fjalën ndërkohë që Fjalori i gjuhës shqipe e njih vetëm si “AMANET” pra, jo si “emanet” fjalë kjo e gjuhës boshnjake!

Shaqir Fetai, ky hilexhi e grotesk i fëlliqtë thotë “gjuha shqipe si një xhevahir ngrit lartë qenien tonë kombëtare në këtë nënqiell!” Do me thënë në nënqiellin e Maqednisë së Veriut, ku jetojnë shqiptarët! Po çfarë gjuhe flasin ata të nënqiellit të Shqipërisë, ata të nënqiellit të Kosovës, të Luginës së Preshevës, të Malit të Zi... Apo Shaqir Fetai për botë shqiptare e njih vetëm këtë të “nënqiellit” tonë! Hej! Po sikur Shaqir Fetai ta mendojë “nënqiellin tonë” me SHQIPËRINË ETNIKE!!! Me Shqipërinë e Madhe! Thua të jetë kaq “patriot” Shaqir Fetai! Mbi të gjitha, mund të jetë ekskluzivisht provokator i UDB-së dhe asgjë tjetër!

Për Shaqir Fetain gjuha shqipe qenka “inspirim i gjallë për të tashmen dhe të ardhmen tonë të ndritshme bashkë me kombet tjera.”! Po a nuk ka qenë inspirim edhe në të kaluarën a! Apo, të kaluarën tonë nuk e njih dhe nuk e di Shaqir Fetai, sepse ka qenë duke kaluar korridoreve të UDB-së! Gjuha shqipe dhe ne si komb paskemi ardhmëri të ndritshme bashkë me kombet e tjera? Ndryshe, nëse nuk bashkëpunojmë me serbë, me maqedonë... na paska hëngër pusi a! Shaqir zeza! I është thënë miliona herë: më mirë është të mos paraqitet fare se, çdo paraqitje e tij përbën skandal që e turpëron qenien kombëtare dhe fenë islame! Sepse – ku i ka hije more një udbashi të flasë për islam e për komb shqiptar!

6.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/22.11.2021

Deri ku mund të shkojë prishunia e Shaqir Fetait

Tërë Maqedonia e Veriut nën peshën e zisë, nën peshën e dhembjes së rëndë, veç Shaqir Fetai ka kohë të fotografohet e të zgërdhiet me profesorë e me myhybtë e vet, madje këtë informatë edhe ta postojë! Nuk e ka postuar vetëm si informacion por, mbi të gjitha, për t'i bindur “punëdhënësit” e tij se si tallet me akademikët shqiptarë, me dhembjen shqiptare, me institucionet fetare islame

Nga Halid Sadiku

Vetëm një i prishur shpirtërisht, si Shaqir Fetai, mund të mbajë një “drejtor” (Mustafa Dautin), i cili, dikur, në cilësinë e “kryetarit” të OH Hilal mezi priste të ndodhë një katastrofë natyrore, sepse i jepej mundësia për të vjedhur në emër të humanitetit.

Vetëm një i prishur në shpirt, një skizofren, një manjak, një shpirtërisht i ngarkuar me veprime monstruoze antikombëtare e antifetare, si Shaqir Fetai, mezi pret të ndodhë ndonjë tragjedi, që të përpiqet e të dalë në sipërfaqe si “shpirtmirë” e me plotë “dhembshuri njerëzore”! Një fuks, i cili ka djegur shumë zemra, kurrë në jetë nuk mund ta tejkalojë veten prej fuksi e të shprehë dhembje qoftë vetëm një herë në jetën e vet. Në fakt, fuksat nuk dinë të shprehin dhembje, prandaj dhe, fuksi Shaqir Fetai, në telegramngushëllimin e vet thotë: “që ta tejkalojnë me sa më pak shqetësim këtë sprovë”!!! Thuhet “me sa më pak dhembje” o duduk! Ta kanë thënë udbashët, hiç mos u shqetso ORAO se do të marrësh në qafë ndonjë shqiptar, këtë e ke detyrë patriotike jugosllave!

Këtë “shqetësim” Shaqir Fetai e shpreh me rastin e tragjedisë që ndodhi në autobusin e “Besa Transit” që po kthehej nga Stambolli për në Shkup dhe që rrugës në Bullgari u dogj flakë me ç’rast humbën jetën 45 persona!

Pas tragjedisë së fundit që kanë ndodhur në Maqedoninë e Veriut, janë mobilizuar të gjithë organet gjegjëse shtetërore dhe, duke e parë këtë situatë, sakaq si “karabiber” është imponuar edhe Shaqir Fetai, sepse e ka nuhatur momentin e “shpëlarjes shpirtërore”! Paska mbajtur mbledhje urgjente me “rijasetin” e tij? Po pse? Për të thënë se i mbulojnë shpenzimet e ceremonisë fetare? Për t’u lavdëruar me këtë “gjest”! Për të thënë se ceremoninë fetare do t’i mbulojë kjo “bashkësi”? A e di Shaqir Fetai se në raste të tilla ai mund të futet në “vrimën e miut”. Të gjithë këta viktimë kanë vendlindjen e tyre, i kanë varrezat e tyre, i kanë imamët e tyre, të cilët, në raste të tilla, detyrimisht, detyrimisht, detyrimisht obligohen, madje edhe vetë ofrohen vullnetarisht, për t’i kryer të gjitha ceremonitë fetare, madje fare pa ia ngulur “kepën” Shaqir Fetait. Kështu që, ky truk i tij është shumë i poshtër dhe, është shfrytëzim momenti (nga tragjedia) për t’u imponuar si “humanist”! Po ku ka fuks humanista?! Shaqir Fetai, fuksi, për t’i dhënë vetes pak “peshë” informon opinionin e gjërë se, nga momenti i tragjedisë vazhdimisht është në kontakt me Bashkësinë Islame të Bullgarisë! E çka është i rëndësishëm ky kontakt? Kujt i hy në punë? Vetëm Shaqir Fetait për të shkaktuar huti! Punë fuksi! Urdhëron të bëjnë lajm nga lutjet e nxënësve, nga falja e namazeve, nga këndimi i hatmeve për shpirtërat e viktimave! Është ky aktivitet për lajm? E bën për vëllazëri Shaqir Fetai? Jo! E bën për Allah? Pa dyshim që jo! E bën vetëm për ta kapur bishtin e rastit sa për ta shkundur ndonjë pluhur nga e kaluara e tij antikombëtare e anifetare!

Maqedonia mbajti zi tre ditë! Kosova dhe Bullgaria një ditë! Në këto dit nuk ka mburrje, nuk ka hare, nuk ka gëzim, nuk ka shënim aktivitetesh, ka përjetim të dhembjes kombëtare! Vetëm Shaqir Fetai del para aparati forografik duke u zgërdhirë si skuth! Telegramngushëllimet i publikojnë mjetet e informimit, ndersa ai që ngushëllohet e arkivon telegramin dhe rri nën peshën e dhembjes së papërballueshme, që ta pëlçet kokrrën e lotit! Shaqir Fetai paska marrur telegrame të tilla! Edhe atë “Filani e ngushëllon Shaqir Fetain”! Dhe ky, pastaj, ja, ja myslimanë, ja si më do bota, ja si më nderon duke më nisur telegrame ngushëllimi! Nëse nuk më besoni, ja, po ua publikoj!

Vetëm një shpirtzi i gëzohet dhe i publikon telegramngushëllimet! Një Institucion i publikon duke nënvizuar se i ka arritur një telegram përmes të cilit ngushëllohen myslimanët e vendit...”!

Nuk është hera e parë që Shaqir Fetai mundohet që mbi viktimat të pretendojë se është “shpirtbardhë”! Katran, zi katran është ky farë fuksi!

Të nesërmen e ngjarjes, Shaqir Fetai poston lajm se paska pritur alamet shkencëtarin në BFI, gjegjësisht, njëfarë alamet intelektual e paska vizituar Shaqir Fetain! Po si ky farë myslimani nuk e paska ngushëlluar “të parin e fesë” për tragjednë që i ka ndodhur myslimanëve “të vet”!? Ky farë shkencëtari nuk është askush i veçantë përveçse që është familjar i ngushtë i kreut të BDI-së! Paska shumë merita të posaçme për zhvillim shkencor, e sidomos si anëtarë i komisionit për themelimin e Fakultetit të Shkencave Islame, për ç’gjë edhe “dekorohet” nga fuksi Shaqir Fetai? Janë me dhjetra persona që janë meritore për themelimin dhe ndërtimin e FSHI-së! Janë me dhjetra persona që nuk kanë fjetur natë e ditë duke punuar e duke u përgatitur për themelimin dhe ndërtimin e FSHI-së! Është më meritore, pa diskutim, ish-reisul ulema H. Sulejman ef. Rexhepi dhe, nëse dikush duhet të falënderohet deri në përjetësi për kontributin në themelimin, në ndërtimin e FSHI-së si dhe në zhvillimin e mendimit intelektual e shkencor është ekskluzivisht H. Sulejman ef. Rexhepi, ky të cilit Shaqir Fetai ia nguli pas shpine të gjitha thikat e tradhëtisë përmes komplotit dhe puçit nga më të pandodhshmit në historikun e BFI-së! Veç kësaj, të gjithë, absolutisht të gjithë profesorët e FSHI-së janë shumëfish më meritore se sa “vizitori i Shaqir Fetait”, por, ja që asnjë prej profesorëve nuk janë kushëri të Ali Ahmetit!

Tërë Mqedonia e Veriut nën peshën e zisë, nën peshën e dhimbjes së rëndë, veç Shaqir Fetai ka kohë të fotografohet e të zgërdhiet me profesor Ismail Ahmetin, madje këtë informatë edhe ta postojë! Nuk e ka postuar vetëm si informacion por, mbi të gjitha, për t’i bindur “punëdhënësit” e tij se si tallet me akademikët shqiptarë! Vetëm shikojani stafin Shaqirt Fetait se me kë e ka pritur Prof. Dr. Ismail Ahmetin! Cili prej tyre mund të shprehte nderë për profesorin? Asnjëri! Të gjithë përdoren në mënyrë cinike për ta nënçmuar z. Ahmetin!

Shaqir Fetai vazhdon me propagandën e tij të ndyrë në çastet më dramatike për myslimanët e vendit, në çastin kur viktimat dihen ndërsa janë akoma të paidentifikuar. Zot, mos provo asnjë popull me trishtime të tilla, mos sprovo asnjë millet me dhembje kaq të rënda! Shaqir Fetai duhet të shkojë në Fakultet, të bëjë aktivitet, dhe t’ju tregojë barcaleta profesorëve që të shkulen së qeshuri, të

zgërdhien si gomerët vizatimorë që nuk dinë as çka është trishtimi, as çka është dhembja, e as çka është turpi! Diskutimet që qenkan zhvilluar në këtë mbledhje paskan lënë “përshtypje të veçanta”!

Qershia mbi tortë është ky titull “Imami i xhamisë së Rinisë në vizitë tek Reisul Ulemaja”! Titull nga logjika e njëmendësisë komuniste! Titull i denjë për raportet policore të UDB-së! Jo “vizitoi”, por “në vizitë”! Sepse, kështu dikush-dikush në të kaluarën shkonte te oficeri i UDB-së, Stanko Dragoviqi, për të raportuar e për të marrur më qafë ndonjë student shqiptar! Dhe, krejt në fund, Shaqir Fetai, në vend se të zgjidhte Myftininë e Dibrës për t’u shkoqur së qeshuri me hajgare e me “vica” në ditën më të rëndë të shqiptarëve për këto dy-tri dekada, do të ishte mirë që të mblidhte “rijasetin” e vet dhe të shkonte në familjet për t’i ngushëlluar e për t’iu gjendur pranë në çastet më të rënda! Tani është momenti kur pranë këtyre familjeve duhet të jenë sa më shumë hoxhallarë, organe të BFI-së, “rijaseti”, dhe jo pasi të varrosen e të mbyllet e pamja! Shaqir Fetai nuk ka kohë për këtë mirësi e gjest human, sepse ka shumë “aktivitete”, duhet ta presë të hurit e të konopit, duhet të shkojë kodër pas bregu për të shitur idioti pordha, se ja, shikoni “reisin” çfarë është duke bërë! Një m... është duke e bërë!/Opinione/26.11.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (18)

Pak nga injoranca, pak nga frika se do t'i hidhërojë punëdhënësit e vet dhe, shumëfish më tepër nga halitia, sa herë që flet Shaqir Fetai, del karakteri i tij prej naivi analfabet

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

Shaqir Fetai ishte munduar që shqiptarëve t'ua urojë Ditën e Flamurit! Kurrë në jetë nuk ua ka uruar, ndonëse ka qenë në pozitë udhëheqëse të një territori të madh të Myftinisë së Gostivarit! Në urimin e sivjemë ka një hile, e cila më shumë flet për frikën prej oficerëve të UDB-së se sa që flet për ndonjë harresë të tij. Nga ana tjetër, edhe nëse është harresë duhet kuptuar njeriun i cili sillet si me qenë sklerotip!

Shaqir Fetai tha: “Andaj, kjo ditë e madhe – Dita e flamurit dhe e Pavarësisë...”, “Në këtë ditë të madhe të Flamurit dhe Pavarësisë shfrytëzoj rastin...” Për cilën Pavarësi e ka fjalën Shaqir Fetai? Pse frikohet të thotë “Pavarësia e Shqipërisë”?! Kush ia ka ngushtuar lakun në fyt dhe e ka trishtuar aq shumë sa mos të guxojë ta përmendë se është Pavarësia e Shqipërisë? Pse frikësohet të thotë atdheu ynë, mëmëdheu yn, por, thotë “vatani ynë”? “Vatani” i duket fjalë më universale, për të cilën nuk kanë çarë fort kokën udbashët, por ama, për fjalën “atdhe” e “mëmëdhe” janë dënuar me nga 10-15 vjet burgë nga UDB-a e Serbisë, ku ka shërbyer edhe vetë Shaqir Fetai nën pseudonimin ORAO!

2.

Shaqir Fetai u ndikua nga një shkrim paraparak, kur u sugjerua që gjatë këtyre ditëve me tërë “rijasetin” e tij të shkojë për ngushëllime nëpër familje shqiptare që i humbën më të dashurit e tyre në ngjarjen tragjike në Bullgari ku u dogjën 45 persona në autobusin e BESA TURSIT në të kthyer nga Stambolli në Shkup.

Shaqir Fetai me myhybët e vet paska shkuar në një familje të cilën e paska zgjedhur për një ngushëllim formal dhe për pozim të pederaftë! Si nuk i ka ardhur turp që të publikojë rreth 30 fotografi nga kjo vaki në të cilat Shaqir Fetai pozon duke bërë grimasa “dhembshurie” në fytyrë! Nga eventet e ndryshme edhe mund të publikohen më shumë foto, por ama, të publikohen kaq shumë fotografi nga një ngushëllim, kjo flet për skizofreninë e Shaqir Fetait! Familjarët duhet të kërkojnë që urgjentisht Shaqir Fetai t’i heqë ato fotografi nga atmosfera e zyrtë dhe përplotë dhembje e trishtim në shtëpinë e tyre. Nuk ka nevojë që Shaqir Fetai të luajë rolin e manikinit në dhembjen e tyre!

3.

Shaqir Fetai është më se i vetëdëshëm se është i padëshirueshëm kudo që futet. Tai nuk është në traditën e shqiptarit që ta dëbojë nga konaku madje edhe një shkja! Shaqir Fetai e keqpërdorë këtë traditë dhe nganjëherë edhe “mburret”! Thotë se, ja, shqiptarët po më duan dhe po më mirëpresin! Shaqir Fetai nuk shkon me raste të tjera por, vetëm kur familja do të jetë me dhembje e pikëllim, kur, në çaste varrimi dhe ngushëllimi pranon edhe ujqër e çakaj! Shaqir Fetai tha: “Na pritën shumë mirë”! Ky farë pisi mendon se ka shkuar me ndonjë rast gëzimi, për ç’gjë familjarët janë përkujdesur që ta presin sa më mirë! Po kush e shpreh një konstatim të tillë! Vetëm ai që e ndjenë se është i padëshirueshëm, vetëm ai që e ndjenë se është instalacion i huaj në komunitet, vetëm ai që e ndjenë se është “caktuar” përkundër vullnetit dhe dëshirës së komunitetit të gjërë! Një i tillë, në një vizitë familjare, do të thoshte “Na pritën shumë mirë”!

Në rastin konkret, familjarët nuk e kanë pasur hallin ta presin “shumë mirë” Shaqir Fetain, ndërsa ky e ka pasur test për vetë! Të shikojë nëse do ta presin mirë apo keq! Ky nuk e kupton dhembshurinë e tjetrit, ky nuk e kupton hallin e tjetrit, Shaqir

Fetai nuk e ka dert trishtimin e tjetrit. Ai hall ka nëse është i dëshirueshëm apo jo tek shqiptarët. Në rastin konkret paska marrur pak fllad b...! “E paskan pritur shumë mirë”!

4.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/29.11.2021

Hipokriti nuk ka brirë, është vetë Shaqir Fetai

Kur snobi “bekohet” nga djalli, bëhet ushtar i devotshëm i tij. Si kundërshtëpërblim, djalli ia falë cilësinë më të poshtër që mund ta ketë njeriu i ligë – hipokrizinë! Kjo hipokrizi emrin e ka Shaqir Fetai

Nga Blerim Mahmuti

Kur ish-deputeti i parlamentit të Maqedonisë së Veriut dhe nënkryetar i LSDM-së, Muhamed Zekiri, sulmoi nga foltorja e Kuvendit ish-reisul ulemanë H. Sulejman ef. Rexhepin, një nga muftinjtë që i reagoi me ashkë e me shpirt ishte ish-myftiu i Gostivarit, Shaqir Fetai! Madje, ky farë myftie ia bënte me dije se, të ofendoshë H. Sulejman ef. Rexhepin është ngjashëm sikur ta ofendoshë tërë Bashkësinë Fetare Islame, madje të gjithë myslimanët e vendit. Pra, Shaqir Fetai aq e donte dhe aq shumë e respektonte efendi Rexhepin sa atë e shihte si personifikim të tërë BFI-së, të të gjithë myslimanëve të vendit.

Deputeti i atëhershëm, Muhamet Zekiri, paskësh deklaruar në një televizion nacional se janë me shumicë myftinjtë dhe organet e BFI-së që e përkrahin atë në denoncimet publike që ia bënë H. Sulejman ef. Rexhepit, kurse Shaqir Fetai e përgënjeshtroi atë, duke thënë: “Me vetëdije të lartë konstatoj se kjo deklaratë e Muhamet Zekirit është një shpifje e paskrupullt vetëm e vetëm që t’i forcojë qëndrimet e tij kundër BFI-së dhe kundër rrrreisul ulemasë H. Sulejman ef. Rexhepi.” Kur ish-deputeti në fjalë pohonte se pas vete ka shumicën e myftive, Shaqir Fetai, si ata skuthët e egër, si hipokritët e yshtur nga djalli, do të deklaronte se sulmet e Muhamet Zekirit si dhe shpifjet e tij janë përzjerje flagrante në punët e BFI-së si dhe në organet bazë të BFI-së! Pak kohë më vonë do të dalë në shesh e vërteta e madhe që fshihej në ato deklarata denoncuese të Muhamet Zekirit: vetë Shaqir Fetai paskësh qenë marionetë e huaj që kishte në shërbim disa aletamyftinj për të cilët deputeti Zekiri thoshte se e përkrahin atë!

Shaqir Fetai nga një “ushtar besnik” nga një “luftëtar i denjë” nën komanden e H. Sulejman ef. Rexhepit, do të bëhet pikërisht ai “Hamzë Kastrioti”, ai tradhëtari më i madh që kishte qenë nën direktivat e ish-deputetit, që i përkiste shumicës parlamentare të asaj kohe LSDM-së e cila ishte në koalicion me BDI-në! Pikërisht, këto dy parti do ta “trimërojnë” apo do ta “yshtin” Shaqir Fetain për ta ndërmarrur tradhëtinë me të rëndë që ka ndodhur ndonjëherë në institucionet fetare në vend, në rajon e më gjërë! Do t’ia ngulë thikën pas shpine njeriut që e llogariste “baba shpirtëror” të vetin!

Shaqir Fetai nuk pranonte që politika të përzihet në BFI! Po vetë që është produkt i një politike anisllame? Po vetë që u instalua në krye të BFI-së nga një politikë aspak miqësore në raport me BFI-në si Institucion?!

Se Shaqir Fetai është në shërbim të politikave që e instaluan në krye të BFI-së dëshmuar edhe zgjedhjet e fundit vendore! Një prej intelektualëve më të dashur e më të çmuar për momentin ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, doktor Arben Taravari, do të ankohet publikisht nga Shaqir Fetai i cili, i politizuar deri në veshë, agjitonte në shërbim të LSDM-BDI-së e kundër kryetarit aktual të Gostivarit. Sot, Shaqir Fetai, aq shumë e ka politizuar BFI-në, aq shumë e ka degraduar sa e ka shndërruar në filiale të BDI-së e në kotec të LSDM-së, të mbushur përplotë me pula të cilat gjelin e shohin në figurë të Muhamed Zekirit.

Kur dikush fliste kundër Sulejman ef. Rexhepit, Shaqir Fetai konstatonte se kjo është përzierje flagrante e politikës në punët e BFI-së. Sot, kur Shaqir Fetai akuzohet si i ngjyrosur politikisht, kur BFI-ja e tij akuzohet si filiale e një partie, kjo paraqet kënaqësinë më të madhe për Shaqir Fetain. Kjo është fe e shkuar feve për njeriun që del nga korridoret e UDB-së serbe nën pseudonimin ORAO!

Për më tepër, ndiqeni videon për të kuptuar se çfarë biçim hipokriti është Shaqir Fetai.

<https://www.facebook.com/113481260056706/posts/719716592766500/>

<https://youtu.be/H1JE3-ZOPzc>

/1KlikLarg/02.12.2021

Shejtani gurëzohet, nuk dëgjohet

**Shaqir Fetai, udbashçiqi që po vdes për t'u rritur e për t'u bërë
tamam udbash, paska marrur rrugë për në Bazel të Zvicrës!
Edhe atë me ftesë të një farë kurrkush hiqit! Do të mbajë
ligjerata Shaqir Fetai! Udbashi, bilmezi, avdalli e hiporiti u bë
për ligjeratë?!**

Nga Sami Veliu

Bazeli, një prej vendeve ku më së shumti strehoheshin veprimtarët shqiptarë, me kohë ka qenë në fokusin e UDB-së! Në emigracionin tonë shkonin e vinin shqiptarë që ishin marioneta të shërbimeve policore serbe. Shqiptarët e emigracionit, sidomos ata që vinin nga Zvicra, jo rallë kanë qenë “mysafirë” me zor nëpër zyret e UDB-së, në biseda informative, por edhe në të shumtën e rasteve kanë qenë të vizituar nga udbashët të cilët, nën petkun e patriotizmit të kamufluar vilnin informacione në llogari të UDB-së! Ka shumë shqiptarë që i përkujtojnë vizitat nëpër oda të Shaqir Fetait dhe temat e bisedave spiuneske sa herë që ktheheshin mërgimtarët në atdheun e tyre! Këta mërgimtarë fare lehtë i lidhin bisedat me Shaqir Fetain por edhe pastaj “bisedat informative” nëpër zyret policore!

Nuk ka shqipar në botë që nuk e di se kush paska qenë Shaqir Fetai; nuk ka shqiptarë në botë që nuk e dinë se ai dikur paska qenë nxënës i oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviqit, te i cili ka marrur detyra dhe ka raportuar nën pseudonimin policor ORAO, duke mjerruar me dhjetra shqiptarë nacionalistë e patriotë!

Tani këtë spiun dikush e thirrë në qendër të Bazelit që të mbajë ligjeratë?! Po kush është ai që ia jep fjalën një eski-udbashi? Pse nuk thuhet se Shaqir Fetai me rastin e pesëvjetorit të ndërtimit të xhamisë do t'i drejtohet xhematit të kësaj xhamie me një vaz! Pse ligjeratë? Sepse, me termin “vaz” Shaqir Fetai “degradohet” në hoxhë klasik, ndërsa me termin “ligjeratë” ai ngritet në nivelin e akademikëve që ftohen nëpër botë për të mbajtur ligjerata profesionale para komuniteteve elitare! Shaqir Fetai turpërohet të ndjehet hoxhe, ia do qejfi që injorantin ta rajtojnë si “intelektual i lartë”!

Pse Shaqir Fetai e kurdis një “ligjeratë” në Bazel? Janë dy motivet e tij të xhindosur: 1) t'ua bëjë me dije patriotëve të devotshëm të Zvicrës se UDB-në gjithmonë do ta kenë në qafë, gjithmonë sa të rrojnë Shaqir Fetaha e pisa të tillë dhe, 2) për të demonstruar fuqinë e UDB-së, për t'ua bërë me dije shqiptarëve se, UDB-ja nuk ka vdekur, ajo nuk trembet, ajo gjenë forma për të qenë në mesin e shqiptarëve përherë!

Të dëgjosh kah të pallamudë Shaqir Fetai me “ligjeratat” e tij përplotë hipokrizi është ngjashëm si t'i bëshë sexhde shejtanit. Shejtani gurëzohet, nuk dëgjohet! Ta ftoshë Shaqir udbashin në mes të emigracionit më patriotik shqiptar është përpjekje për t'ia thyer krenarinë dhe dinjitetin kësaj mërgate! Të hapen sy e veshë para Shaqir Fetait ky është një testim klasik e shumë i poshtër për të dëshmuar nëse është akoma gjallë emigracioni patriotik shqiptar apo “kanë vdekur” që të gjithë! / 1KlikLarg/04.12.2021

Shaqir Fetai vrasësi i akteve normative të BFI-së

Shaqir Fetai sikur të vepronte edhe me Ligjet e Sheriatit, nuk i ka hije, nuk i beson askush, nuk ia pranon as Zoti Fuqplotë, sepse, edhe ky veprim do t'i dilte kamuflazh! A i ka hije një tradhëtari, një komplotisti, një udbashi, një nxënësi të oficerit të UDB-së serbe që e ka pagëzuar me nofkën spiuneske ORAO, të veprojë me Sheriat

Nga Blerim Mahmuti

Në një kundërpërgjigje drejtuar ish-deputetit Muhamed Zekirit dy-tre vite më parë, ish-myftiu i Gostivarit, Shaqir Fetai, ia bënte me dije deputetit se, Bashkësia Fetare Islame, të gjitha organet e saj, duke filluar që nga imamët e deri te Kuvendi i BFI-së, që të gjithë punojnë bazuar në aktet normative që i ka ky Institucion, si Kushtetuta, rregulloret e organeve bazë, statutet e institucioneve arsimore etj. Tutje, Shaqir Fetai e porositë deputetin që mos të merret me punët e brendshme të BFI-së por të merret me realizimin e obligimeve që i marrin në Paralement e sidomos me realizimin e premtimeve parazgjedhore që si qeveri LSDM-BDI ia kanë dhënë BFI-së!

Çka flet ky fakt i pamohueshëm!

E para, pa dyshim që BFI është Institucion shumë serioz, e cila, në fillimvitet nëntëdhjeta punonte si institucion i kategorisë statutare! Për t'u avancuar në kategori kushtetutare, është dashur një punë e mynxyrshme, të cilën, Shaqir Fetai as që mund ta imagjinojë; Shaqir Fetai as që ka kapacitet për ta kuptuar se nëpër ç'probleme e ç'rreziqe është futur H. Sulejman ef. Rexhepi me shokët e ngushtë (këtu kurrë nuk është përfshirë Shaqir Fetai, sepse ia kanë ditur kualitetet e spiunimit) për ta avancuar BFI-në në

kategori kushtetutare!

Pas kësaj është dashur një mal punë për t'i harmonizuar të gjitha aktet normative me tërë materien e Kushtetutës së BFI-së.

Pikërisht, më 27 maj të vitit 2020, BFI-ja do ta përjetojë goditjen më të rëndë fatale që ia ka dhënë ndonjëherë ndonjë armik! Shaqir Fetai, i cytur nga politikat e poshtra, antifetare e antikombëtare të shërbimeve të ndryshme, mori guxim që të dalë publikisht dhe të demonstrojë thyerjen në "kurririz" të BFI-së! Duke ushtruar një komplot të pistë dhe një tradhëti të poshtër, ai shkelë Kushtetutën, mohon çdo akt normativ të BFI-së vetëm e vetëm që të jetësojë projektet e shërbimeve të huaja, të cilët e kishin marrur nën mbrojtje këtë farë "teologu" të rritur e të trashur me lavdëratat të përditshme që ia dedikonte "babai shpirtëror" i tij, H. Sulejman ef. Rexhepi.

Që nga kjo datë aktet normative të BFI-së u shkelën me qindra herë, ndërsa Shaqir Fetai as që guxon të mendojë se në BFI ekziston diku ndonjë kushtetutë e saj, sepse ai drejtohet nga direktivat partiake e politike të huaja, andaj nuk ka nevojë për asnjë akt normativ të BFI-së. I përmend herë pas herë, kur të kapet gafil duke vepruar publikisht në shërbim të partive dhe strukturave që e instaluan në krye të BFI-së!

E dyta, edhe H. Sulejman ef. Rexhepi qenka përzier më parë me partitë politike, ë! Kështu, tërthorazi na e bën të ditur Shaqir Fetai! Por, përzierja e efendi Rexhepit paska qenë ekskluzivisht në të mirë të BFI-së! Pra, ish-reisul ulema, efendi Rexhepi, paska arritur që t'i detyrojë partitë që të premtojnë gjëra të rëndësishme për BFI-në? Po Shaqir Fetai? Ç'prettime mund të presë përveçse t'ia garantojnë paprekshmërinë në kolltukun e uzurpuar përmes komplotit e tradhëtisë së turpshme?! Shaqir Fetai nuk pranohet si palë negociuese, por, pranohet vetëm si palë militantiste! Duhet të militojë, duhet të lusë myslimanë që nëse kanë Allah të votojnë kandidatin e LSDM apo të BDI-së, sepse, do t'i luhet karrigia e pastaj mund të kthehet Sulejman Rexhepi apo Afrim Tahiri, njeriu më kushtetor në historinë e gjithmbarshme të BFI-së!

Fare në fund, Shaqir Fetai sikur të vepronte edhe me Ligjet e Sheriatit, nuk i ka hije, nuk i beson askush, nuk do t'ia mundësonte as Vetë Zoti Fuqiptotë, sepse, edhe ky veprim do t'i dilte kamuflazh! A i ka hije një tradhëtari, një spiuni, një udbashi, një nxënësi të oficerit të UDB-së serbe që e ka pagëzuar me nofkën spiuneske ORAO, të veprojë me Sheriat? Ai mbase edhe mund të

pendohet, porse, ai pendim nënkupton tërehqje nga parrugësia ku është futur dhe kthim te Allahu Mëshirëplotë! Pra, kjo pendesë duhet të jetë për Allah dhe jo për “liderë politike”! Pendesa nënkupton heqje dorë nga hipokrizia. Gjithçka mund të bëjë Shaqir Fetaj, por, të heq dorë nga hipokrizia, këtë nuk e bën dot. Për më tepër ndiqeni video-insertin e mëposhtëm!

<https://www.facebook.com/113481260056706/posts/721977942540365/>

https://youtu.be/rxD1Inc_tEI

/1KlikLarg/06.12.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (19)

Shaqir Fetai është tallësi më i madh që njohin myslimanët e vendit. Ai tallet me gjithçka dhe në llogari të gjithkujtë! Edhe në vazin e tij në “Xhaminë Kërçova” në Bazel, xhemati e ka hetuar se si tallet! Ka pasur prej atyreve që kanë dashur të ngriten në këmbë e t’ia tëkërlisin shallin përdhe! Ndërsa, prandaj imami i xhamisë, i shkruan duke e falënderuar për ligjeratën e tij “përplotë urtësi”! Ligjeratat e udbashit mund t’i vlerësojë “urtësi” vetëm personi tjetër që është kandidat për udbashçiq

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

Shaqir Fetai paska shënuar 3 Dhjetorin, Ditën e personave me aftësi të veçantë, apo, të kufizuar! Shaqir Fetai u thotë “me aftësi të posaçme”! A e di kuptimin e fjalës “posaçëm”? Apo, i duket fjalë e re dhe “shumëkuptimplote”! Po ja që këta persona nuk janë me “aftësi të posaçme” por me aftësi të kufizuar”! Madje, që nga java e kaluar, organizata gjegjëse botërore ka sjellë vendim që kjo kategori tash e tutje mos të quhet si “person me aftësi të kufizuar” por, “person me një aftësi të kufizuar”!

Shaqir Fetai edhe me këtë kategori njerëzish tallet! Thërret ndonjë nga këta persona, të cilët, në karrocë, me përpjekjet maksimale të forcës së tyre të brishtë, afrohen deri te Shaqir Fetai dhe, ky mahluk, “trak” shkrep aparatën për fotografi dhe, e publikon foton duke na treguar se është me “një djalosh me emrin Labinot, një djalosh i buzëqeshur, i çiltër, i bukur, i sinqert, i dashur, i pastër

në ndjenja dhe në zemër, dhe mbi të gjitha besimtarë i devotshëm, me besim e shpresë të paluhatshme për jetën i falënderon Zotit duke u falur dhe besuar fuqishëm në lidhjen e tij me Zotin”!

A e kupton Shaqir Fetai që kjo Ditë nuk është ditë për lajka, nuk është ditë për ta kamufluar të zinë e shpirtit katran me një tist të bardhë e të tejdukshëm, nuk është ditë që Shaqir Fetai të shesë pordha, por, është ditë kur institucionet e ndryshme humanitare e fetare, ua zgjasin dorën individëve apo enteve e asociacioneve që trajtojnë individë me aftësi të kufizuar! U dhurojnë karroca, televizorë, video-lojra, lodra, mjete nga teknika smart etj. Shaqir Fetai nuk e bën këtë gjest human, sepse ai është antihumani më i madh në fytyrë të tokës që ka nevojë të fotografohet me persona të dashur e me aftësi të veçantë sa për t’u shitur fytyrëzezi si “person i dashur”! Ai mund të shitet por kush është në zor për ta dashur atë majanë e uthllës! Vërtet, pse këtij djaloshi me nevoja të veçanta Shaqir Fetai nuk ia ndau një “dekoratë” në shenjë respekti për devotshmërinë e tij! Natyrisht, sepse prej tij nuk ka shansë t’i hyjë asgjë në xhep Shaqir Fetait. Edhe një gjë: pse Shaqir Fetai nuk e shfrytëzoi këtë Ditë për të mbajtur një “ligjeratë” e për ta kritikuar qeverinë aktuale që nuk ka bërë asgjë për personat me nevojë të veçantë?! Shaqir Fetai është i kënaqur e i stërlumtur që qeveria aktuale, të paktën, kanë bërë mjaftueshëm për Shaqir Fetain, për këtë bastard me nevoja të veçantë në shpirt!

2.

Shaqir Fetai e ka gjetur një “livadh të babës” ku po kullotë si xhoja e gjallë! Zvicrën! Do “imamë” të korruptuar, ngjashëm si Shaqir Fetai (në një shkrim do t’ju tregojmë se pse Shaqir Fetai është i korruptar!), e ftojnë në Zvicër, në rajonin e patriotëve shqiptarë, atdhetarëve e revolucionarëve të cilët natë e ditë, deri sa po punonin për Kosovë e shqiptarë të lirë, ishin në shënjestër të UDB-së! UDB-ja qenka shembur por ama, udbashçiqët hala kanë ngelu dhe si minj të frikësuar po vrapojnë arave! Të ftohet një udbash nën pseudonimin ORAO është sa turp kombëtar aq edhe mëkat! Qenka nënshkruar kontrata e blerjes së xhamisë!!! Kjo nuk i sjell asgjë në xhep Shaqir Fetait, madj as që është në dijeninë e kësaj vepre e aq më pak të ketë ndonjë gram kontributi në tërë këtë gjest

madhor fetar! Shaqir Fetai duket aty pari vetëmse me porosi të UDB-së: “sillu nëpër punktet tona të vrojtimit dhe, le ta dinë shqiptarët se UDB hala është gjallë! Merr vesh diçka prej tyre! Je në kombinim me agjentët vehabistë që e çojnë ujin në mulli të UDB-së”! Kjo është porosita dhe ky është qëllimi i vizitës së Shaqir Fetait.

Shaqir Fetai ishte i kompleksuar deri në veshë, ai vdes për pak post, për pak karrierë, ai e ka në gjen karrierën, ndërsa i vetëdëshëm se atë nuk mund ta arrije me meritë, i futet kompleteve dhe tradhëtive i ndihmuar nga strukturat e dyshimta antiislame. Shaqir Fetai, në “informatën” e tij tha se xhemati i këtij vendi i pasa organizuar “një pritje të nivelit të lartë...”! Kujt i organizohen pritje të tilla përveçse nikoqiri shtetëror homologut të vet! Pritje të larta janë ato pritje që organizohen nën protokollet shtetërore! Pritjet e dorës së dytë, të tretë, të katërt, pritjet private, familjare, miqësore, mund të jenë vetëm “pritje të ngrohta” dhe assesi nuk mund të thuhet se ishin “pritje të nivelit të lartë”! Mund ta ketë ëndërr Shaqir Fetai që një ditë maqedonasit si dhe tërë struktura e UDB-së ta propozojnë edhe për kryetar shteti dhe të pritet pastaj “në nivele të larta”!

Paramendoni se çfarë paraqet befasi e hatashme për Shaqir Fetain! Ai qenka mrekulluar, qenka mahnitur, qenka shkrirë meqë shqiptarët e Bazelit ia paskan organizuar: “darkën në Gjermani, faljen e akshamit në xhaminë e arabëve në teritorin e Francës, ndërsa faljen e Jacisë dhe tribunën fetare në Xhaminë e Bazelit”! Heeej, kqyre more, Shaqir Fetai paska hëngër darkë në Gjermani dhe pastaj e paskan shëtitur si putanen nga një qosh në qoshin tjetër! A ka më ofendim për atë xhemat se sa befasi t’ua llogarisish darkën që ta kan dhënë! Pastaj, ata myslimanë të devotshëm, ata haxhi baba, jo Shaqir Fetain në cilësi të UDB-së, por, sikur t’u shkonte edhe një qen i zgjebosur ata do ta strehonin, do t’i jepnin buk e ujë dhe do t’ia dëgjonin ndonjë kuisje që mund të jetë edhe “falënderim”!

3.

Çka tha Shaqir Fetai në “memoarin” e vet në shenjë përmbyllëse të kësaj vizitë! “Akademiku” që na paska mbajtur një “ligjeratë

shkencore” ka thënë diçka! Nëse i lexohet kjo palo “memoare” do të shikohet se kemi të bëjmë me një injorant të llojit të vet, me një demagog e hipokrit, i cili, ja që ia arrinë t’i mësojë përmendësh nja 10-15 fraza dhe ta “dehë” me pseudovaz xhematin e sinqertë. Le ta analizojmë se çka tha Shaqir Fetai? Ky tha: “Mbetet e paharuar vizita Xhamisë “Besimtari” në Bazel, pritja shumë e ngrohtë dhe vëllazërore që vërtetë tregoi se kjo xhami është vatra më e vjetër e cila vazhdon të jetë në nivel të detyrës”!

Xhamia që ia paska organizuar një pritje shumë të ngrohtë!

Prandaj, sipas Shaqir Fetait, kjo xhami qenka në krye të detyrës, fill për këtë “pritje të ngrohtë”! Jo për lutje Zotit, jo për tubim të myslimanëve për t’i drejtuar lutje Zotit Fuqiplotë, por, thjesht, kjo xhami e kryen detyrën e vet vetëm nëse do ta presë Shaqir Fetain sa më ngrohtë! Tutje, Shaqir Fetai vahdon me talljen e vet: “në krye të së cilës xhami me sukses qëndron Z. Bari Demiri dhe Imami H. Bunjamin ef Azizi bashkë me besimtarët tjerë”! A keni parë more dikund xhami që udhëhiqet nga një kryetar, nga një imam dhe nga tërë xhemati?! Kjo është fjali e një njeriu që është në varshmëri nga një strukturë e gjërë që e përkrahin, e ndihmojnë dhe e këshillojnë në punët e tij të mbrapshta! Pastaj, tallja e Shaqir Fetait nuk mer fund, por merr “vlerat” e ofendimit: “Prezenca e Kryetarit të KMSHZ H.Hfz. Mehas ef Alija dhe shumë imamë i dhanë një shije të vërtetë.” Shije?! Kujt i dha shije? Cilës gjellë? Me këtë fjali, Shaqir Fetai dëshiron të na thotë se “mercenarin” e vet, Mehas Alijën nuk e konsideron asgjë tjetër përveçse “karabiber”, vegetë, e lloj barnishtash, që i japin shije dhe që e lezetojnë gjellën!

Fare në fund, Shaqir Fetai dëshmon se nuk është normal! Atij vetja i duket lloj “profeti” me cilësitë për ta “ripërsëritur” Isranë! Shaqir Fetai tha: “shfrytëzojmë rastin që në emrin tim dhe në emrin e delegacionit të dy qendrave dhe besimtarëve tanë kudo që janë t’ju shprehi falenderimet më të sinqerta për pritjen dhe nderin që na e bënë me një organizim të lartë.”

Pra, kudo që janë myslimanët, Shaqir Fetai i falënderon për pritjen e nivelit të lartë që ia kanë organizuar! Muslimanët janë në çdo cep të botës dhe ky i falënderon të gjithë, sepse e kanë pritur, edhe pse nuk janë në gjendje të kuptojnë se Shaqir Fetai i ka vizituar që të gjithë dhe se ata i kanë organizuar “pritje të nivelit të lartë”! Ja pra pse ky farë Hamami i Hyrës (Shaqir Fetai), është karrierist i verbuar, është me afinitete të një manjaku i cili nuk i frikësohet as Zotit, pasi që ndjehet i fortë me UDB-në pas shpine!

Po pse jo? ORAO (shqiponja) fluturon gjithandej! Në cilësinë e ORAO-s Shaqir Fetai mund t'i ketë vizituar të gjithë myslimanët kudo ku janë!

4.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/07.12.2021

Të korruptuarit dhe ekstremistët janë “Vëllezërit Siamezë”

Pse Shaqir Fetai nuk është i ftuar në asnjë event ndërkombëtar organizuar kundër ekstremizmit dhe radikalizmit, apo, pse ai lejon që BFI-në ta prezantojë njeriu më kontravers në Maqedoninë e Veriut, hajni Mustafa Dauti

Nga Kadri Lusjani

Jo rallë herë Institucioni i BFI-së është etiketuar si “bastion” i ekstremizmit dhe radikalizmit fetar, apo si Institucion fetar që e ka përjetuar këtë dukuri johumane. Por, falë aktiviteteve këmbëngulëse dhe trimëruese të ish-udhëheqësve të këtij Institucioni, jo rallë BFI ka dalur si bartëse e projekteve që e kanë luftuar me forca vetanake çdo përpjekje ekstremiste për ta njollosur dhe stigmatizuar si BFI-në ashtu edhe besimtarët e saj. Prandaj, BFI, respektivisht ish-sekretari gjeneral H. Afrim ef. Tahiri dhe Drejtori i sektorit për botim, Avni Halimi, hartuan një projekt (STOP RadTerr) i cili jo vetëm që nderoi faqe botës BFI-në por edhe i stopoi të gjitha etiketat dhe stigmatizuesit e llojllojshëm që po punonin në devalvimin, degradimin dhe shkatërrimin e këtij Institucioni!

A mundet të luftohen dukuritë e shëmtuara pa u luftua dhe çrrënjosur korrupsioni dhe zhvatja! Korrupsioni është “saksia” e paramilitarëve që ushqim e kanë radikalizmin, ekstremizmin dhe terrorizmin!

Sot, në BFI, a ka njeri më të korruptuar dhe më hajna se sa Shaqir Fetai dhe Mustafa Dauti! Dihet vjedhjet dhe korrupsionet që i ka bërë Shaqir Fetai sa ka qenë “myfti” i Gostivarit! Hajn i përkryer! Dihen edhe vjedhjet e tmerrshme që i ka kryer Mustafa Dauti në emër të “humanizmit”! Hajn i pashpirt. Më të korruptuar nuk e

gjenë në asnjë gjeneratë në tërë historinë e BFI-së! Profesionistët mbahen në mes vete! Të korruptuarit njihen, duhen dhe perkrahen shume fort në mes vete.

Prandaj, i korruptuari dhe hajni, Shaqir Fetai, përkrah dhe angazhon të korruptuarin dhe hajnin, Mustafa Dauti. Duke e ditur se korrupsioni prodhon dhunë, ekstremizëm, radikalizëm, terrorizëm, për ta kamufluar tërë këtë shkak-pasojë, bartësin e këtij aktiviteti të fëlliqtë e emëron si përgjegjës kundër ekstremizmit pikërisht Mustafa Dautin! Pse i ik kësaj përgjegjesie Shaqir Fetai! Apo sepse e di që është edhe më i fëlliqtë se ky farë mahlukati!

Që të dy këta, kanë pasur nevojë për një “institucion anarkik, pa kushtetutë e pa rregullore, të lirë nga veprimi sipas akteve normative, me qëllim që ta kamuflonjë prishurinë dhe lukunine e tyre duke u vetëpozicionuar në “krye të detyrave”! Megjithatë, ndërkombëtarët nuk hanë barë, u duhet edhe ndonjë pjesëtarë i ndonjë klani mafioz për t’i kuptuar sa më shumë përpjekjet e shejtanëve për t’u shpërfaqur në “engjëj”!

Aktualisht, BFI-ja, si Institucion ku aktet normative nuk njihen, nuk kuptohen, shkilen, shtrembërohen, me të drejtë po llogaritet si bastion i ekstremistëve, i të korruptuarve, i komplotistëve dhe spiunëve, që janë ekstremisht të rrezikshëm meqë nuk respektojnë Institucionin dhe kurrfarë akti të tij! Si të tillë ata janë edhe keqpërdorues të institucioneve dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare të cilat i përdorin “si makiash” për të mbuluar fëlliqësitë e tyre para besimtarëve të vendit!

BFI-ja, pa u kthyer një ditë para 27 majit të vitit 2020, ditë kur u rrënuar integriteti i saj, nuk mund të jetë as Institucion i dinjitetshëm e as i respektuar! Të ulet Reisi ne Rijaset, t’i numrohen të gjitha “mëkatet”, të kërkohet dorëheqja e tij dhe, duke u miratuar rregullore për zgjedhjen e reisit te ri – të zhvillohen të gjitha procedurat në harmoni të plotë me vlerat islame. BFI-ja nuk mund të jetë Institucion fetar islam, ndërkohë që aktualisht ngjanë në “kështjellë” e dallkaukëve, matrapazëve, hajnave, hipokritëve, spiunëve, ekstremistëve, sektaristëve e pisave të llojlojshëm! Islami dhe hajnia, islami dhe korrupsioni, islami dhe hipokrizia, islami dhe spiunimi – nuk shkojnë bre amani ju qoftë./Kombetare/13.01.2021

Avazi psikopatik i Shaqir Fetait

Shteti përbëhet prej shumë organizmave. Një organizatë përbëhet prej disa sektoreve. Sektoret përbëhen prej disa njësive! Dhe, që të gjitha këto kanë udhëheqës të tyre që përbëjnë lidërshpin e një gjëje! Lidërshipi ka strukturë të tërë, nëpunës e punonjës që janë në varësi të tij. Nëpër zyret e lidërshpimit gjatë ditës hynë e dalin qindra persona që janë në varësi e që drejtohen prej udhëheqësve! Bëhet lajm kjo hyrje-dalje e të varurve?! Këtë e bën vetëm abdalli, Shaqir Fetai

Nga Qazim Mehmedi

Hoxha i fshait Mateç, Rexhep Ismaili, paska zhvilluar një aktivitet personal dhe, duke e vizituar “resin” e vet, Shaqir Fetain, e paska shfrytëzuar mundësinë për ta reklamuar një libër që e paska botuar, me titull: “Vrasja – Mbytja sipas Islamit”. Një keqërdorim sa flagrant aq edhe i mençur i hoxhës në fjalë ushtruar mbi Shaqir Fetain e ngratë! Po sa libra dhurohen e falen, jepen e këmbehen në ditë, sikur të bëheshin lajme, do të duhej një satelit i veçantë për të qenë në shërbim të platformës “japim-marrim libra”!

Ky veprim mund të llogaritet si shkathtësi e hoxhës së Mateçit i cili, e shfrytëzon Shaqir Fetain për t’i reklamuar botimet personale!

Hoxha nuk ka se për çfarë ta vizitojë ”resin”! Hoxha i përgjigjet thirrjes së “reisit” për t’u dukur në zyrën e tij! “Reisi” duhet ta vizitojë hoxhën në detyrë e në vend pune! Te reisi mund të vijnë një grup hoxhallarës për një motiv të caktuar që mund të jetë edhe kërkesë për ndihmë institucionale për zgjidhjen dhe tejkalimin e ndonjë nga problemet e shumta që i mendojnë sot hoxhallarët!

Vizitat e tilla nuk mund të llogariten aktivitet, sepse janë pjesë dhe detyre kushtetuese të “reisit”!

Shaqir Fetai po pëlçet si “thiu i bozhiqit” që të vdesë dikush, mundësisht i “popullarizuar”, që të lëshohet ndonjë “i madh” nga spitali, që ta thyej këmbën ndonjë politikan partiak, që ta heq dhëmbin lideri politik, që të shqetësohet lideri eventualisht nga gazrat në stomak, sepse, këto i duhen Shaqir Fetait si motive për vizita, të cilat pastaj i shndërron në lajme! A ka idiotizëm më të madh se fotografimi te i sëmuri, te falja e xhenazes së ndonjë personaiteti (nuk bëhet fjalë këtu për fotografitë në “plan të plotë”), te i sëmuri, apo te familjari te i cili shkohet për ngushëllime por që, nuk dihet, nëse Shaqir Fetai shkon për ngushëllime “fise bililah” apo shkon për fotografi me të cilën do ta ilustrojë “lajmin” mbi aktivitetin e vet! Aktivitet: “isha për ngushëllime”, “sot falëm namazin e xhuma”, “sot e varrosëm”... Këto janë margaritarët e psikopatit Shaqir Fetai!

T’i kthehemi edhe pak vizitës që paska ndodhur në “zyren” e Shaqir Fetait! Shaqir Fetai na thotë se një hoxhë ia paska dhuruar librin e vet me titull “Vrasja-Mbytja sipas Islamit”! Fatkeqësisht, ky informacion po e përplotëson konstatimin që doli në një shkrim paraprak e ku flitej për Shaqir Fetain si më të korruptuarin në vend e, për pasojë, edhe më ekstremistin dhe më radikalistin i cili, tashmë është trimëruar deri në atë shkallë sa, merr guximin dhe i shkon nëpunësit në zyrë, duke ia sharë nënën e duke e kërcënuar nëse vetëm edhe një herë ia përplasë derën (natyrisht, përplasja ka ndodhur si pasojë e “promajës”!).

Shaqir Fetai reklamon libër me titull “Vrasja-Mbytja sipas islamit”! Të ishte me dy gram mend, fillimisht nuk do ta pranonte fare egzistimin e një libri të tillë, ose, do të duhej që të insistonte në ndërrim të titullit qysh kur ka kuptuar se ekziston një libër i tillë, ose do ta heshte fare egzistimin e një libri të tillë me një titull antiislamist e shumë ofendues!

Mbase Shaqir Fetai mendon se bëhet fjalë për një libër që mëson se si islamikisht duhet të mbyten-therren kafshët! Por jo edhe të vriten, sepse gjëja e gjallë e vranë (që ka ngordhur nga vrasja) nuk halet!

Nëse aludohet në njeri-njerëz – cili qenka ai libër në botë që mëson se si të vritet njeriu sipas islamit? Si të mbytet njeriu sipas islamit? Nëse “islami” e predikon këtë veprim atëherë kjo nuk është fe! Sepse Allahu Mëshirëplotë thotë: “nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve”, 5:32) Çka i duhet Shaqir Fetait një libër-doracak që mëson “Vrasjen-Mbytjen sipas islamit”? Cili është ai islam që na mësuaka se si të vrasim e si të mbysim?!? Nëse vërtet ekziston një “doracak” i tillë, një pamflet i tillë idiotik, atëherë, pse i duhet Shaqir Fetait që ta reklamojë? Kush po e trimëron Shaqir Fetain, nga një “pulë e lagur” të na shndërrohet në “elefant Mamuth”? Mbase instikti i këtij lloji elefanti, i cili, shumë pak çaste paran gordhjes, shkonë dhe vetë e hap varrin e vet!

Të jemi pak të njerëzishëm, të paktën me autorin! Autori-hoxha mund të jetë i ri, mund të ketë probleme me sintaksën e gjuhës shqipe por që ka shumë vullnet të shkruaj, të “hedhë dritë” mbi probleme të ndryshme, të gjitha nga këndvështrimi i fesë islame! Mbase edhe në këtë libër autori flet për qëndrimet e islamit, për pikpamjet islame mbi vrasjen-mbytjen! Pra, nëse kemi të bëjme me një libër “Vrasja-mbytja sipas pikëpamjeve islame”, “Vrasja-mbytja sipas këndvështrimit islam”, atëherë, sakaq do të kuptohej se bëhet fjalë mbi qëndrimin e fesë kundër dukurisë më të shëmtuar e më të poshtër, më të papranueshme islamikisht e më antihumane, siç është vrasja-mbytja! Me gjasë, Shaqir Fetai ka nevojë për një libër-doracak “Vrasja-Mbytja sipas islamit”? Kjo nevojë idiotike e tij flet se janë përmbushur të gjitha kushtet që sa më parë Shaqir Fetai të lidhet dhe të “rehatohet”. Ai nuk na duket mirë me shëndet mendor! Sepse, po të ishte mirë, nuk do të harronte që hoxhës t’ia jepte dhuratë librin e madh “TRADHËTIA DHE KOMPLOTI I SHAQIR FETAIT NË KOHË PANDEMIE”!/ 1KlikLarg/15.01.2021

USHT-ja ka historinë e vet të pamohueshme nga askush

Shaqir Fetai paska shprehur dhe publikuar një “urim” me rastin e 27 vjetorit të Universitetit Shtetëror të Tetovës! Përmes këtij “urimi”, Shaqir Fetai, ky kallëp i hipokritit, mundohet ta retushojë të kaluarën e BFI-së ashtu siç mundohet ta retushojë edhe të kaluarën e vet prej udbashi
Nga Valmir Idrizi

Me rastin e 27 vjetorit të themelimit të USHT-së, nën patronatin e rektorit u mbajt një manifestim tradicional, moment ky kur përkujtohen sfidat nëpër të cilat kaloi kjo vatër e lartë arsimore, sukseset e arritura si dhe perspektivat e saj. Të pranishmëve sivjet iu dejtua Rektori Prof. dr. Reshat Qahili. Fjalimin e tij, fatkeqësisht, e paska dëgjuar edhe i instaluari politik në krye të BFI-së, Shaqir Fetai, i cili, në “shënimin” e vet thotë se, nga Prof. dr. Reshat Qahili iu paska bërë një nder i veçantë! Tani, të thuash se Prof. dr. Reshat Qahili i paska bërë nder të veçantë, Shaqir Fetait, nxënësit të oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviqit, është nënçmim dhe tallje me personalitetin e z. Qahilit. Sepse, krejt bota e di se rektori në fjalë nuk është dashamirë i udbashëve! Prof. dr. Reshat Qahili mund ta ketë nderuar Instiitucionin e BFI-së dhe jo udbashin Shaqir Fetai, i cili, e keqpërdorë këtë respkt që i bëhet Institucionit duke e personalizuar!

Shaqir Fetai përmes momenteve të tilla kombëtare, mundohet t’i japë peshë vetes, mundohet që ta ”kombtarizojë” biografinë e vet, vetëm e vetëm që ta kamuflojë aktivitetin spiunesk të shërbimeve

serbe nën pseudonimin policor ORAO!

Shaqir Fetai, në urimin e vet shkruan: "... këto urata më shumë u shkojnë atyre që sakrifikuar gjithçka për këtë ditë, atyre që u radhitën në vijat e para të themelimit dhe u bënë digë në mbrojtjen e ardhmërisë së rinisë tonë – studentëve..."

Atyre që sakrifikuar gjithçka? Atyre që u radhitën në vijën e parë të themelimit? Po, veç të tjerëve, kush sakrifikoi, kush u radhit në vijën e themeluesve?

Pse nga goja e Shaqir Fetait nuk përmendet roli i pakontestueshëm i BFI-së? Pse nuk nënvizohet kontributi i pamohueshëm i "babait shpirtëror" të tij, ish-reisul ulema i BFI-së, H. Sulejman ef.

Rexhepi?!

Pse Shaqir Fetai nuk e nënvizon faktin që UT aktivitetet e para arsimore i mbajti në objektet e BFI-së që drejtohej nga H. Sulejman ef. Rexhepi?

Pse Shaqir Fetai nuk shpreh mburrjen se është "pasardhësi" i njërit prej themeluesve të USHT-së, H. Sulejman ef. Rexhepi?

Pse Shaqir Fetai nuk e nënvizon faktin se H. Sulejman ef. Rexhepi plotë një vit financoi revistën studentore STUDENTI të UT-së që atëbotë falë BFI-së dilte çdo muj?

Pse Shaqir Fetai nuk e shpalosë të vërtetën mbi aktivitetet ndërkombëtare të H. Sulejman ef. Rexhepi i cili, në çdo takim me të huajt, në çdo konferencë ndërkombëtare, në çdo takim me përfaqësues të organizatave turko-arabe, gjithnjë ka folur mbi qëndrimet shoviniste të pushtetit të atëhershëm karshi UT-së dhe mbi nevojat e të gjitha llojeve të përkrahjeve ndërkombëtare të këtij Universiteti!

Nëse Shaqir Fetai nuk ka pasur mundësinë e angazhimit, sepse ka qenë i penguar nga strukturat policore serbe, ka pasur burra BFI-ja që e kanë kryer edhe këtë detyrë patriotike. Një ndër miqtë më të ngushtë të themeluesit të UT-së, Prof. dr. Fadil Sulejmani, pa dyshim që ka qenë H. Sulejman ef. Rexhepi, ish-kryetari i BFI-së, me të cilin ka pasur takime të rregullta, shumë të shpeshta si dhe aksione të përbashkëta për të siguruar financa që të ngritet në këmbë të veta Universiteti Shtetëror i Tetovës!

Nëse Rektori, z. Reshat Qahili, në fjalën e vet nuk e ka parë të arsyeshme (në respekt të kohës së shkurtër gjatë fjalimit) që t'i evidentojë këto fakte të pamohueshme, të paktën kjo i ka takuar Shaqir Fetait! Por, ja që ky turpërohet nga e kaluara e BFI-së, ashtu siç turpërohet nga e kaluara e vet përplot me aktivitete

spiuneske në shërbim të UDB-së! Meritat kombëtare dhe fetare të BFI-së si dhe të pararendësve patriotë, udbashi Shaqir Fetai nuk mund t'i zhdrukë, as t'i fshehë, as t'i mohojë! Madje këtë nuk ka mundur ta bëjë dhe as që mund ta bëjë edhe vetë “qerthulli” i Shaqir Fetait – UDB-ja!

Nuk i dihet – mbase këtë “harresë” Shaqir Fetai e manifeston qëllimisht, sa për t'i dalur me fakte e argumente, me letra e dokumenta të cilat ai kurrë nuk i ka ditur rreth themelimit të UT-së dhe kontributit të BFI-së dhe H. Sulejman ef. Rexhepit. Mbase i ka ikur diçka pa raportuar në UDB! Është e njohur kjo “strategji” e udbashëve!/Lajme7/19.12.2021

Figura e juaj kombëtare duhet të ngelë e papërlyer

Letër e hapur Ali Ahmetit

Në një inervistë në mediat maqedonase ju paskeni folur për veprat e Juaja të pakontestueshme patriotike e shtetërore. Lexova një titull: “Historia do të shkruaj për veprat e Ali Ahmetit”! Për asnjë moment nuk do të doja të lexoj në historinë kombëtare se, edhe Shaqir Fetai, udbashi me nofkën ORAO, është vepër e Juaj! Nuk dua që në historinë kombëtare lideri im të dalë gabimtar e i vetënjollosur

Nga Ilir R. Topi

Me shumë respekt për liderin tim, Ali Ahmeti!

E di që jam tërësisht “anonimus” që t’Ju drejtohem me një letër të hapur por, ndjej obligim kombëtar që të jap kontributin tim në ruajtjen e pastërtisë absolute të figurës Suaj!

Pa dyshim, keni shumë vepra të pakontestueshme kombëtare! Keni arritur shumë dhe, shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, duhet t’Ju jenë mirënjohës deri në amshim! Nuk dua që lideri im të jetë i njollosur, as të jetë objekt manipulimi, përmes paisjes me informacione nga më të gabueshmet, nga ato që mund t’i plasojë vetëm shërbimi serbo-rus!

Natyrisht, jam shumë i vogël dhe fare i parëndësishëm që t’Ju sinjalizoj në këtë kurth, por, që kur e keni pranuar publikisht se edhe Shaqir Fetai është “vepër e Juaj”, ndjej thellësisht në shpirt se, dikush duhet t’Ju këndellë e t’Ju tregojë se, me këtë vepër, ia keni huqur shumë keq, deri në përmasa të tradhëtisë kombëtare! Kjo huqje nuk dua që të jetë “vepër e Juaj”! Këtë vërejtje ua thotë vetëm ai që është i sinqertë dhe që Ju do me gjithë shpirt, që Ju respekton deri në “Perëndi” e që në ju e sheh “shpëtimin

kombëtar”!

Ju, natyrisht që jeni njeri që gjithnjë keni pasur kujdes të veçantë ndaj “teorive të konspiracionit”, gjithmonë keni pasur kujdes ndaj stigmatizimeve dhe etiketimeve të njerëzve të ndryshëm. Ndaj dhe nuk u shkoi ndoresh shërbimeve sekrete serbe që t’ju etiketojnë si “spiun serb”! Ju luftuat, Ju patët shumë miq që luftuan për ju, ju patët një komb të tërë në krahun Tuaj dhe ia arritët ta shpallni “nul” tërë atë etiketë të paimagjinueshme.

Megjithatë, z. Kryetar, si mund t’Ju amnistoj nga një gabim trashanik që e keni bërë duke u rreshtuar pas njeriut më kontravers për momentin në Maqedoninë e Veriut, pas spiunit me dokument të UDB-së, Shaqir Fetait. Dakord, pas një kohe të gjatë të shoqërimit, të ngrënies së mishit të skuqur e të pijeve të llojlojshme, erdhi koha e ndarjes me ish-mikun e Juaj, H. Sulejman ef. Rexhepit, por nuk e kuptoj pozicionimin e Juaj në krah të Shaqir Fetait, kushëririt të Milaim Fetait, spiunit të dëshmuar që Ju, pa kurrfare verifikimi, e keni emërtuar ambasador në Kroaci!

Ky gjest, ky vendim, ky përcaktim nga ana e Juaj është i pakuptueshëm, shumë e dyshimtë dhe që nuk Ju bën aspak nder! Ju, tashmë jeni bindur në rolin provincial të Shaqir Fetait; jeni bindur se dëmi është shumëfish më i madh se sa dëmi që po shkaktohej nga H. Sulejman ef. Rexhepi! Shaqir Fetai është i papërfillshëm, është i padëshirueshëm, është i parespektueshëm, ngase nuk ka personalitet, ngase kapaciteti i tij angazhues është provincial, ngase e kaluara e tij e bën shumë të kompleksuar, ngase është më i padëshirueshmi i popullit (jo i partisël!), prandaj, është koha që detyrimisht ta korrigjoni gabimin e juaj fatal! Shaqir Fetai është shumë i vogël dhe pa kurrfarë bagazhi intelektual e fetar që Ju të angazhoheni që ta vini në krye të BFI-së!

Në krye të BFI-së duhet të jenë njerëz me kompetencë, me njohuri të stërholluara, me dinjitet e integritet që edhe ju do t’Ju jepte peshë në angazhimin eventual për ta hequr qafe! Ju nuk guxonit të ia huqni! Ju gjithnjë duhet të jeni në krye të detyrës kombëtare dhe të përkujdeseni që mos të gaboni! Ju nuk mund të keni respekt për një person për të cilin nuk kanë respekt as familja e tij, as lagja e tij, as katundi i tij! Shaqir Fetain nuk e duan sepse të gjithë e dinë se cili ka qenë roli i tij derisa ju përndiqeshit nga policia serbe viteve tetëdhjeta. Shaqir Fetai ka përndjekur

shqiptarë, ndaj gjithnjë ka qëndruar si “macja nën sofër”, prandaj, më habit gatishmëria e Juaj për ta përkrahur Shaqir Fetain, alias Orao-n (nofkë policore serbe)!

Ju e kani detyrë kombëtare që ta shpëtoni Institucionin e BFI-së nga degradimi i më tej. Ju, me përcaktimin e Juaj që ta përkrahni Shaqir Fetain, në fakt keni kapur në dorë kazmën e degradimit dhe shkatërrimit të BFI-së! Edhe kjo vepër nesër do të llogaritet si vepër e Juaj?! Ishalla jo, kurrë nuk do t’Tu kisha dashur një etiketim të tillë.

Ju jeni shumë i vetëdijshëm se kush mund të jetë ai që ka kapacitete të lidërshiptit në krye të këtij Institucioni! Ju e keni obligim kombëtar (nëse jo fetar) që ta shpëtoni këtë Institucion sa fetar aq edhe kombëtar! Ju nuk guxoni që këtë Institucion t’ia lini në dorë një udbashi të dokumentuar katërcipërisht! Ju nuk guxoni që të përfshihen në dëshirën e flaktë të LSDM-së për emërtimin e tij në krye të BFI-së. Të paktën Ju keni forcë morale, kombëtare e fetare për ta korrigjuar këtë gabim fatal për një nga Institucionet më të rëndësishme të vendit! Ju, përfundimisht, duhet të çliroheni nga etiketimi si “adhurues” i udbashëve që ua do xhani që t’i emërtoni nëpër poste të rëndësishme!

Ju lutem Kryetar, Ju përgjërohëm me përvullje, reflektoni dhe përmirësojeni këtë gabim fatal për Ju dhe për Myslimanët-Shqiptarët e vendit. Mos u bëni pre e informatave servile, e informatave të luluara dhe pre e grupimeve kalsite që të forcohen ata e t’Ju njollosin JU! Dua që amshueshëm të ngelë e papërllyeme figura e juaj e ndritshme kombëtare.

Me shumë respekt!

/BotaPress/22.12.2021

Distancimet telefonike janë hipokrizi

Në BFI-në e Shaqir Fetait punët janë llugë! Shaqir Fetai nuk mund t'i fshehë pakënaqësitë reale përmes “takimeve” dhe “dekorimeve” me turlifarë mahluki! Asnjë problem nuk zgjidhin takimet private të puçistit Shaqir Fetai. Myslimanëve të Maqedonisë së Veriut nuk i hy në xhep asgjë nga takimet e stisura dhe private të Shaqir Fetait. Vetëm Shaqir Fetai mendon se “dekorimet” nga BFI janë “reformë” të Institucionit

Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI

Në BFI-në e uzurpuar nga Shaqir Fetai, po vlon! Çdo ditë na telefonojnë për zënka të ndryshme, për sharje e ofendime, na telefonojnë për ngecje të punëve, na flasin për tendenca të turpshme për të manipuluar në emër të islamit, na telefonojnë për panikun e madh që i ka kapur mynafikët dhe hipokritët të cilët janë shumë të vetëdëshëm se janë turpi i myslimanëve të Maqedonisë së Veriut. Na telefonojnë dhe kërkojnë ndihmë! Ka edhe nga ato telefonata që kërkojnë shpалosje të strategjisë, kërkojnë të dijnë “planin B”, “planin C” ... të Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI të RMV-së! Insistojnë që ta “spiunojmë” Planin Zhvillimor të Lëvizjes!

Të gjitha këtyre telefonatave u thonë “fërkime”! Nuk janë distancim real, por, thjesht, “distancim telefonik”! Pendesën e pranon edhe Zoti i Madh! Por ka kushte kur “pendesa” pranohet si PENDESE! Pendesa e shprehur në çast, pas një shqetësimi apo nervozizmi si rrjedhojë e ngecjes së përmbushjeve të orekseve personale, thjesht

është hipokrizi! Zoti i ka mallkuar hipokritët, ngjashëm si shejtanin!

BFI-ja pa dyshim që u uzurpua turpshëm, me ndihmën e partive politike të pushtetit të cilat pësuan një fijasko të turpshme për ç'gjë merituan edhe mallkimin e Zotit dhe, ata që kanë një gram mend do të pranojnë se tatëpjeta e pushtetit nisi pikërisht në çastin kur i zhytën duart e pista në Institucionin tonë të shenjtë.

Në këtë Institucion sot ka pakënaqësira të mëdha. Ka një vetëdijësim të “aktorëve” të cilët gjithnjë e më shumë po kuptojnë se punët nuk po venë mirë, se këtu ka ngecur gjithçka, madje ka një rrokullisje tatëpjetë në degradim të çdo gjëje që është arritur ndër shekuj e dekada. Mbase Shaqir Fetai e ka edhe detyrë, për ta degraduar Institucionin por edhe për t'i fyer e poshtruar partitë që deshtën ta bëjnë “reis”!

Të pakënaqurit akoma nuk po e kuptojnë se tashmë është koha për distancim publik, sepse, vetëm kësisoj mund të llogariten nesër si pjesë e Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI. Këta të pakënaqur duhet të dinë se, nëse “e kanë bishtin e zënë me derë”, të paktën mund të heqin dorë nga rroga! Rrogën nuk mund të ta japë askush me dhunë, as me kërcënime, as me shantazhe! Të pakënaqurit duhet të dinë se nuk paguhen nga myslimanët që t'i rrinë sus kryekeqbërësit të BFI-së, sepse atë rrogë do ta kenë haram. Me haram nuk mbahet familja, të paktën jo ata fëmijë, ata engjëj që një ditë do të paguajnë shpirtërisht për haramin e baballarëve të tyre.

Asgjë nuk bëhet nëse i kthehet shpina hipokritit dhe degjeneruesit të vlerave islame siç është Shaqir Fetai, në moment mbase edhe mund të përjetohet rëndë largimi nga puna, por ama, secili që refuzon t'i shërbejë shejtanit, ndonëse i dëbuar nga puna, ndonëse pa rrogë, do të ndjehet i lumtur, do të ndjejë rehati të madhe shpirtërore, do të ndjehet i bekuar, do të ndjehet më i fuqishmi i botës! Këtë ndiesi pa dyshim që ia përforëcon Vetë Zoti Fuqiplotë! I Madhi Zot në Kuranon thotë: **“Përse ata nuk kthehen me pendesë tek Allahu e t'i kërkojnë falje Atij?! Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë!”** (5:74)

Ata që u bënë palë me shejtanin dhe i ndihmuan që të ngjitet në krye të BFI-së, ata që menduan se “ky është ai i duhuri” dhe i

shërbyen derisa nuk u vetëdijësuan se “ky i duhuri” qenka katastrofa e Institucionit të shenjtë, pra këta kurrë nuk do ta kenë vonë që të pendohen për gabimin që bënë, të pendohen ekskluzivisht në emër të Zotit dhe vetëm për Zot! Sa më parë që do ta bëjnë publikisht, aq më të vogla do të jenë pasojat mbi degradimin fatal të BFI-së në të cilën ajo është katandisur!/Koha/25.12.2021

Shaqir Fetai “pendohet” që i festoi Krishtlindjet

Nga Levizja Myslimane per Reforma ne BFI

Hipokriti Shaqir Fetai feston Krishlindjen ndërsa nuk e regjistron askund këtë aktivitet! Hipokriti Shaqir Fetai “mburret” me vlerat kombëtare ndërsa “i fsheh kontributet e veta” në nderim të atyre vlerave kombëtare. Hipokriti Shaqir Fetai “mburret” me trekonfesionalitetin e shqiptarëve, si vlerë unike në botë, ndërsa turpërohet për të publikuar aktivitetin e vet në festimin e Krishtlindjeve

Shaqir Fetai, i izoluar dhe i marginalizuar tërësisht, mezi pret të lëvizë diku apo të vijë e ta vizitojnë “meraklinj të çajit rus” dhe të bëjë “lajm sensacional”! Edhe kur të shkojë diku në ngushëllime, ai e keqpërdorë situatën, e fotografon dhembjen e trishtë të anëtarëve të familjes dhe bën lajm! Edhe kur merr pjesë në varrim ai bën “lajm”! Edhe kur falë namazin e ndonjë mehrumi, ai bën “lajm” mbi “aktivitetin” e tij! Edhe kur të fal xhumanë Shaqir Fetai bën lajm! Edhe kur t’i vie ndonjë badihavxhi e ndonjë injorant në kabinetin që e ka uzurpuar, ai bën lajm!

Më 23 dhjetor të vitit 2021, Shaqir Fetai mori pjesë në “kishë”, aty ku tash e sa kohë funksionon edhe “sinagoga” pranë ITSHK të Shkupit, për të festuar Krishtlindjen si dhe për të nderuar trashëgiminë e Nënës Terezë si dhe të komunitetit katolik shqiptar në Shkup! Punëtorët shkencorë që punojnë në kuadër të Institutit premtajnë që, për Bajramin e Ramazanit do të organizojnë manifestimin e dikurshëm të ish-reisul ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepit, “Sofra e bakllavasë së Bajramit të Ramazanit”, pastaj edhe atë të “Bajramit të Kurbanit”!

Instituti për trashëgimi shpirtërore dhe kulturore veprimtarinë e vet e ka shumë açik dhe nuk e fsheh, i pëlqeu kjo dikujt apo jo. Por, nuk është e ndershme që këtë aktivitet ta “fshehë” Shaqir Fetai, i cili, edhe merr pjesë në madhërimin e festës së Krishtlindjeve edhe turpërohet!

Shaqir Fetait shumë ia do b... që të pjerdhë në prezencë të intelektualëve dhe shkencëtarëve shqiptarë (mbase e ka detyrë nga UDB-ja) por, mundësisht t’ia fshehin këtë “aktivitet”, sepse do t’i hidhërohet UDB-ja!

Shaqir Fetai, duke u frikësuar nga reagimi i myslimanëve të vendit për pjesëmarrjen e tij aktive në festimin e Krishtlindjeve, harron t’u drejtohet komunitetit shqiptar katolik por edhe të tjerëve për t’ua uruar festën e Kërshëndellave dhe për t’iu uruar shëndet, mbarësi e suksese në jetë.

A nuk është kjo një cilësi e hipokritëve? Vetëm puçistët, vetëm hajnat, vetëm ata që arrijnë të vjedhin edhe poste të huaja, si puna e Shaqir Fetait, të gjithë urimet dhe sukseset, shëndetin dhe mbarësitë, i mbajnë për vete. Të tjerët u bëfshin copa e iu humbtë nami e nishani. Shaqir Fetai ua uron të tjerëve atë që nuk e do për vete!

Shaqir Fetai si i marrë i gëzohet “aktivitetit” që e përvetëson ndonëse nuk është i tij, ndërsa “aktivitetet” e veta të ulta i fsheh, duke menduar se kështu do ta mashtrojë edhe Zotin! Punë djalli! Kurs ajeti 188 i sures Ali Imran thotë: **“Mos mendo se ata që gëzohen për çfarë kanë punuar dhe dëshirojnë të lavdërohen për çfarë nuk kanë punuar, pra, kurrsesi mos mendo se ata do t’i shpëtojnë ndëshkimit; për ata ka ndëshkim të dhembshëm.”**! /Opinione/26.12.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (20)

Kemi thënë, sa herë që flet Shaqir Fetai, prej gojës së tij rrjedhin lumenj gënjeshtresh, vetëlavdërimesh, intrigash, përvetësime dhe personalizime të meritave të huaja, fshehje të dështimeve personale; mundohet ta fshehë suksesin në spiunim, tradhëti, hajni; mundohet të krijojë mashtim optik mbi atë se “të gjithë e duan”...

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

Shaqir Fetai gjenë momente morti dhe, pikërisht në të tilla situata të trisht, futet ndër shtëpitë myslimane. Ndryshe, në situata normale, as që ia qokë ndokush, as që merr guximin të futet nëpër shtëpitë myslimane, sepse, për të pabesin, për të poshtrin dhe për hipokritin nuk ka vend nëpër shtëpitë myslimane.

A i ka hije një puçisti, a i ka hije një të pabesi, a i ka hije një hileçari, a i ka hije njeriut që ia ngulë thikën pas shpine “babait shpirtëror”, atij që një jetë të tërë e lavdëroi, e mburri, e përgëdheli, foli me miradi më shumë se për fëmijët e vet, pra, a i ka hije këtij farë biçim “hoxhe” që të shprehë ngushëllime! A i ka hije një të poshtri si Shaqir Fetai që të shprehë dhembshuri e trishtim ndërkohë që veprimet e tij janë po ato të djallit?!

A e keni parë Shaqir Fetain se edhe në raste mortore, edhe në raste gëzimi, madje edhe ndër varreza, i drejtohet xhematit duke i përshëndetur me emër e mbiemër, me poste e funksione bashkëpunëtorët e vet! Me këtë ai dëshmon se nuk shihet, nuk takohet as me bashkëpunëtorët e vet. Ndryshe, i ka hije vetëm një

budallai që ta përshëndesë njeriun me të cilit ka kaluar një, dy, tri orë në makinë deri sa ka mbërritur në ndonjë “vaki”! Të njëjtin e përshëndet!!! Çka do me thënë me këtë idiotizëm Shaqir Fetai? Ja, ja, shikoni se me sa njerëz që më duan ju kam adhur, ë! Kurse harron se, nuk ka mysliman që nuk e di se, të gjithë ata që i shkojnë pas Shaqir Fetait janë edhe më të prishur se vetë ai. Sepse, vetëm të prishurit mund të lejojnë që të udhëhiqen nga një i prishur në shpirt e në tru, siç është Shaqir Fetai!

2.

Shaqir Fetai paska qenë në teatër për të përcjellë një shfaqje dhe, këtë aktivitet, këtë vepër personale të regjisores, Vjollca Zylbehari, ai e bën lajm dhe e paraqet si “aktivitet” të vetin! Aktivitet llogaritet vetëm ai veprim që bëhet gjithnjë për herë të parë, që ndodhë edhe një herë tjetër por në përmasa e parametra të tjerë, që është i organizuar, i paraparë në planin zhvëllimor, në axhendën e “kabinetit”. A mundet njeriu normal ta llogarisë “aktivitet” përcjelljen e një shfaqje teatrale, leximin e një libri, dëgjimin e një kënge! A mund të thotë ndonjë mendje normale se “sot isha në teatër”! Kjo është detyrë etiko-estetike e jetës, siç është detyrë jetësore edhe falja e namazit! A mund të thotë myslimani i devotshëm se, “sapo fala namazin”, të bëj lajm nga ky aktivitet! Po, këtë poshtërsi këtë mund ta bëjë vetëm Shaqir Fetai! Çka kuptoi Shaqir Fetai nga shfaqja ku paska luajtur edhe Labinot Salija, aktor me nevojë të veçantë? Cili ishte mesazhi i shfaqjes për Shaqir Fetain? A e kuptoi moalin e lojës së Labinotit të dashur? A nuk vërejti Shaqir Fetai se, porosia kumbuese e shfaqjes ishte që, të gjithë njerëzit janë të njëjtë, krijesa të shenjta të Zotit të Madh dhe se, si të tillë, të gjithë gjenden para sprovave të ndryshme! Mjer ata që tundohen nga sprovat e djallit! Mjer ata që nuk orientohen nga parimet e shenjta të Zotit Mëshirëplotë! Shaqir Fetai, në një shënim në fb-un e vet tha: “Labinot Salija një djalosh me vullnet të paluhatshëm jep shpresën vetvetes që reflekton tek të tjerët për të jetuar me shpresë, dashuri, solidaritet dhe optimizëm në jetë”! Pra, a nuk ishte tërë kjo porosi për Shaqir Fetain se në jetë njeriu nuk duhet të shtyhet me bërryla, t’ia vjedhë tjetrit meritat dhe shpresat, të shpresojë në suksese përmes intrigave, përmes tradhtisë dhe hajdutërisë? Shaqir Fetai nuk duhet t’i gëzohet jetës bujare e fisnike të Labinot Salijit, porse,

Shaqir Fetai nga ky rrëfim, duhet të trishtohet nga jeta e vet e stërm bushur me intriga, hipokrizi dhe tradhëti! Ky duhet të jetë ai katarsisi që e ngulfat Shaqir Fetain pas asaj shfaqje! Nuk është e rastit që pas shfaqjes, i tha shoqëruesit të vet: “ç’mu desht të futem në këtë terr që ma terroi krejt kuptimin për jetë”!

3.

Shaqir Fetai paska marrur vesh që, pranë familjes së vet paska ardhur një mërgimtar i cili dikur ishte punëtor i BFI-së ndërsa tash jeton e vepron në Zvicër. Bëhet fjalë për hoxhën Shemsudin Ismaili nga Sedllarca e Tetovës. Menjëherë e ka ftuar për ta vizituar në “kabinet” Shaqir Fetai, i cili me Shemsudinin paskan qenë edhe në Medresenë e Prishtinës por edhe në Fakultetin e Sarajevës. Gjithnjë bashkë! Tani, nuk u kuptua nëse Shemsudini kishte ardhur për ta vizituar ORAO-n, Shaqir Fetain, bashkëpunëtorin e UDB-së, i cili, në kohën sa ka studiuar ka spiunuar studentë shqiptarë për llogari të UDB-së! Tashmë botërisht dihen dy emra që i ka spiunuar, të madhin Nexhat Ibrahimimi dhe hoxhën e pafat, Ramiz Aliun, bashkëvendas i Shemsudinit! A i ka ditur Shemsi efendia këto fakte apo në mos edhe ky ka qenë në të njëjtën vijë me “studentin” Shaqir Fetai! Gjatë kësaj vizite, a i evokuan kujtimet, ose, a e pyeti Shaqir Fetain se si prej një spiun klasik u ngjit në pozitën e “reisit”?! A nuk e pështyu në fytyrë për faktin se ia paska spiunuar bashkëvendasin Ramiz Aliun? Apo, krejt këto fakte i harroi sapo “u dekorua” nga Shaqir Fetai! Punë shejtanësh!

4.

Shaqir Fetai, komplet si një mynafik i regjur, u paska dëshiruar mirëseardhje mërgimtarëve tanë! Tani, pas kësaj “mirëseardhje” prej mynafiku, ai pret edhe vizita të shumta në kabinetin e vet. Të gjithë ata që vijnë në Pazar të Shkupit, nëse kanë ftohtë apo nëse janë lodhur, mund të vijnë te çajtorja e Shaqir Fetait, plus të marrin edhe ndonjë “dekoracion”! Më herët, kur ishte i emëruar si myfti prej H. Sulejman ef. Rexhepit, kurrë nuk i uroi mirëseardhje asnjë mërgimtari gostivarli! Tani, që ka nevojë që të vizitohet sa më masovikisht, po, ua uron dhe tashmë ka lëshuar “misionarë” që t’ua bëjnë me dije se dyert e BFI-së i kanë të hapura! Vetëm të vijnë e ta vizitojnë “reisin” se ka mbetur pa “aktivitete”!

5.

Shaqir Fetai paska marrur pjesë në hapjen solemne të Xhamisë “Hamza” në Doberdoll të Komunës së Vrapçishtit. Kur paska nisur renovimi, Shaqir Fetai paska qenë shumë skeptik dhe nuk paska zënë besë se mund të ndërtohet kjo xhami! Pra, ky është karakteri i Shaqir Fetait, ai nuk u zë besë besimtarëve të devotshëm, ai është skeptik dhe mundësisht, edhe parandalues, në çdo vepër të hajrit! Në fjalën e vet Shaqir Fetai duhej të thoshte diçka! T’i përshendest të gjithë bashkëpunëtorët e vet, me emër e mbiemër. Pastaj iu tha të pranishmëve: “Në këtë gëzim po ju nderoj me tërë stafin e Rijasetit”! A ka pisllek më të madh se kjo fjali? Stafi i Rijasetit të Shaqir Fetait i cili staf i shërben shejtanit për t’i mihur themelet e Institucionit të vetëm fetar islam në vend? Staf i cili e ndihmoi shejtanin që të kryej puç politik dhe të instalohet partiakisht në krye të BFI-së?

Pse tallet Shaqir Fetai me xhematin, me njerëzit që ndërtojnë Shtëpi të Zotit? Pse këto tallje i gjenë t’i demonstrojë Shaqir Fetai pikërisht të Shtëpi të Zotit! Sepse, ai nuk është i aftë dhe nuk ka kapacitet që t’i mbledhë as pesë burra e t’ju kuvendojë mbi një problematikë? Sepse, nuk ka mysliman në Maqedoninë e Veriut dhe më gjërë, madje nuk ka qytetar që nuk e di se si erdhi e u instalua në krye të BFI-së?

Shaqir Fetai, tha: “Xhemat i dashur, para jush janë, ata që kanë ardhur ta ndajnë gëzimin me ju, alima e teologë të respektuar...” Kurse përpara xhematit e kishte nxjerrë Irsal Jakupin, atë i cili, së bashku me një ish-“prokuror” bënëin plane se si ta vjedhin “Haxhin 2015”! Këtë fakt e di mbarë opinioni i vendit! O Zot, xhematit të mrekullueshëm ua kishte nxjerrë hajnin më të fëlliqtë, atë që nga ndihmat humanitare dedikuar të varfërve të vendit, ka përfituar pasuri marramendëse, nga tubimi i parave për nevojtarët e vendit, ka blerë banesa e dyqane, atë që ka dëmtuar deri në shkatërrim BFI-në, atë më të pandershmin e BFI-së, Mustafa Dautin! Po a nuk vidhte Shaqir Fetai së bashku me Mustafa Dautin nga ndihmat humanitare dedikuar të varfërve që shpërndahennë Muajin e Ramazanit. A është ky Shaqir Fetah që ia mbulonte rrenat dhe hajninë Mustafa Dautit që thoshte se në Gostivar i dorëzoi 1200 pako ndërsa i linte vetëm 3-4 qind!

Shaqir Fetai e ka në gjak që të tallet me myslimanët e vendit. Ai nuk mund të frymojë nëse nuk tallet me myslimanët, nëse nuk e

ofendon islamin, nëse nuk i kryen urdhërat e UDB-së. E ka në gjak dhe, pikë! Tani, ai nuk ka faj se pse ia dëgjojnë pordhët xhemati i rastësishëm! Xhemati ka faj që mendojnë se Shaqir Fetai është “reisi”! Përderisa ai është instalacion i pative antiislame, si mund të llogaritet “reis”! Ai është vetëm “i dashuri” i segmenteve antishqiptare që duhet të avancohet për shërbimet e tij kundër popullit shqiptar e mysliman, madje të shtyhet deri në “reis”!

6.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/27.12.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (21)

Kur njeriut i plasë cipa, ai gënjen fare lehtë, nuk i skuqet fytyra, madje për asnjë veprim të turpshëm nuk gajlohet! Nuk ka më trishtim se ky i pacipi ta konsidertojë veten “hoxhë”, madje, edhe palo “hafiz”! Edhe i pacipë edhe hoxhë? Edhe spiun e tradhëtar edhe “hafiz”? Edhe rrenc deri në qykë edhe “teolog”! Të pacipin është mëkat ta dëgjoshë e lëre më ta prezantoshë si “të sukseshëm”! Cili mysliman në Maqedoninë e Veriut mund t’i numërojë vetëm dy suksese autoriale të Shaqir Fetait, fuksit që një jetë të tërë e kaloi nën pseudonimin policor “ORAO”

Nga Faik Shahinbejlliu

Është një praktikë gazetareske që në fundvit të rekapitullohet puna e një viti të plotë, duke vënë theksin kryesisht mbi sukseset që janë arritur përgjatë vitit që po ik! Kësisoj, Shaqir Fetai paska kurdisur një intervistë në “Tv Ikre”, “gjirizi” i vetëm i tij prej nga mundohet të derdhë fëlliqësirën e vet të “luluar” me gënjeshtër nga më banalet! I thotë vetes “kryetar” i Institucionit fetar kurse të kripë me gënjeshtër, ndërsa buzë e fyt i ngjiten nga rrenat e thata që tashmë i janë bërë “refren” i përditshmërisë së vet.

Le t’i analizojmë veç e veç të gjitha përgjigjet e Shaqir Fetait që i hedh si lopa bajgën, duke menduar se truri i myslimanëve të Maqedonisë së Veriut është i thatë dhe nuk regjistron asgjë, prandaj dhe, mund të genjejë sa t’i dojë b... atij! Pa fije respekti, pa fije turpi, pa fije ndërgjegje, duke i shtrembëruar buzët e duke u munduar të nxjerrë fjalë “të mëdha”, nuk shpreh më të voglën droje se, mund të ofendohen fëmijët e vet, nipërit, mbesat, familja e gjërë, miqësia, ata që e instaluan si mumie të gjallë, mbarë shoqëria myslimane, nga gatishmëria e tij për të gënjyer dhe për ta kamufluar të vërtetën. Megjithatë, gjatë fjalëve boshe të Shaqir

Fetai, fluturojnë disa kode që ai mendon se janë të pakodifikueshme për vegjëlinë e thjeshtë ndërsa janë “selame” që ia nisë shërbimeve inteligjente që kurrë nuk ua kanë dashur të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve në përgjithësi. Shaqir Fetai tha:

1.

Jemi në fund të vitit 2021! Cilat kanë qenë përjetimet tuaja gjatë këtij viti?, ishte pyetja që iu shtrua mynafiikut! Shaqir Fetai e fillon me një rrenë të madhe! Thotë që, viti që po e lëmë, për të paska qenë me aktivitete të jashtëzakonshme, të duarnduarta! A nuk është ekspert i gënjeshtërs, i trillimit, i shpifjes madje pa ju skuqur asnjë sekond fytyra! Njeri tipik i pacipë! Po cili, aman cili aktivitet i tij ishte i jashtëzakonshëm! A e kupton Shaqir Fetai fjalën “i jashtëzakonshëm”? Përveç veprimeve të tij imorale asgjë të jashtëzakonshme nuk ka pasur gjatë këtij viti! Thjeshtë, Shaqir Fetai është i jashtëzakonshëm në veprimet e tij parësore, ndonëse “hafiz”, ai tradhëton, spiunon, rrenë dhe lavdërohet si putanja kur mbronë “ndershmërinë” e vet! Paska zhvilluar “aktivitete të jashtëzakonshme”, sepse edhe viti paska qene “me një dinamikë të ngjarjeve të ndryshme, qoshin ato të mira, apo jo të këndshme”? Ja pra avdalli, të gjitha aktivitetet, të gjitha ngjarjet, të gjitha skenat e mira apo të pakëndshme që kanë ndodhur përgjithësisht në Maqedoninë e Veriut, ai i llogaritë si aktivitete të veta për të cilat ka pasur përjetime të veçanta (afinitet ky ekskluziv i spiunëve)! Ajo që e kënaq Shaqir Fetain në këtë vit është fakti që myslimanët e vendit i paskan tejkaluar me shumë sukses të gjitha sfidat e këtij viti dhe në të njëjtën kohë të dalin më të sigurt, më stabil dhe, me një komoditet të lehtë të kalojnë dhe të jenë më të përgatitur për vitin I CILI NA VJEN NË TË ARDHMEN!!! Hahaha, ec e mos bëj “mëkat” dhe mos qesh me budallain që veten e llogarit si “reis”! Viti që vjen në të ardhmen!!!

Myslmanët i paskan kaluar të gjitha sfidat me sukses, i paskan tejkaluar të gjitha dhembjet dhe trishtimet me sukses! Sukses për Shaqir Fetain është edhe humbja e më të dashurve në rastin e djegies së spitalit modular në Tetovë! Sukses paska qenë edhe tragjedia e tmerrshme kombëtare me rastin e djegies së autobusit ku humbën jetën plotë 45 myslimanë, ku u shuan familje të tëra! Këto janë sfida o duduk!) Kësisoj, familjarët e tyre që humbën më

të dashurit e vet u përgatitën që me sukses të futen në vitin i cili do të vie në të ardhmen – ky është mesazhi i Shaqir Fetait, këtij farë duduki që me pacipësinë e vet po na e nxinë fytyrën tonë! Çështja kryesore që po e gëzuaka Shaqir Fetain na qenka fakti që ia paskan arritur të krijojnë “stabilizim financiar”! Pse a nuk paska pasur “stabilizim” në të kaluarën a? Po Shaqir Fetai, si pjesëtarë i strukturës së Rijasetit kurrë nuk e ka shprehur më të voglin shqetësim për ndonjë “destabilizim financiar”! Kurrë nuk e ka shënjestruar asnjë organ për keqpërdorim financiar! Ka kontribuar Shaqir Fetai në destabilizim financiar? Pa dyshim që po, sepse, për shkak të lakmisë së tij për ta zhvilluar korrupsionin bëri që investitor gjigant nga bota islame të largohet nga projekti që parashihte investim me dhjetra milionë dollarë në qendër të Gostivarit, projekt ky që do ta shtonte si askush më shumë stabilitetin financiar të BFI-së, duke fituar një vakëf stabil, shumë përfitues dhe me efikasitet financiar si asnjë objekt tjetër valkëf i BFI-së! Shaqir Fetai, tashmë është dëshmuar katërcipërisht se ka vjedhur, se i ka heshtur keqpërdorimet eventuale financiare, sepse nuk e ka thënë asnjëherë qoftë vetëm një fjalë, dhe që, as pas puçit dhe tradhëtisë që e zhvilloi, nuk nxorri asnjë “tezë” të tij nga b... se u detyrua në këtë hap për shkak të keqpërdorimeve financiare. Nuk e ka thënë sepse, ose nuk ka pasur, ose ka qenë thellësisht i zhytur në vjedhje e në korrupsion! Tani, kjo farë “melaqe” ia paska arritur të krijojë “stabilitet financiar”! Prej nga? Prej parave të xhematit, të cilat ky i keqpërdorë duke i shëtitur b... nëpër ambasadat maqedonase që janë “seli” të partisë që e konrabandoi duke e instaluar në krye të BFI-së!

Dhe, ky farë duduku “sukses financiar” e quan faktin që ia paska dalur pa ndodnjë problem t’i plotësojë “të gjitha kërksat e Rijasetit”, dhe jo edhe kërkesat e myslimanëve që e mbajnë këtë “rijaset”! I paska mbuluar shpenzimet e Medresesë (dhe jo medreseve!!!) me paralelet e saj të shpërndara nëpër dia qendra të vendit; i paska përmbushur nevojat financiare të Fakultetit, por dhe të sektoreve të ndryshëm. Po në të kaluarë a nuk mbuloheshin suksesshëm të gjitha këto shpenzime të këtyre organeve, institucioneve e sektoreve? Çka flet palidhje, pse vetëlavdërohet avdalli kur krejt bota e di se këto vatra arsimore, këto organe e sektore u krijuan falë nikoqirllëkut të ish-reisul ulemasë H. Sulejman ef. Rexhepit, i cili i themeloi, i hapi dhe i mbajti pa asnjë proble. I vetmi problem i tij ishte që u mbështet në persona të

dyshimtë, duke u besuar spiunëve e tradhëtarëve, të cilët e patën dert që ta njollosin, ta ofendojnë, ta degjenerojnë me qëllim që tradhëtinë e tyre të mëvonshme ta konsiderojnë si “veprim të detyrueshëm”, për ta shpëtuar financiarisht BFI-në!

Dhe, Shaqir Fetai na qenka befasur nga reagimi i myslimanëve duke i dhënë këntriibutet e tyre! Natyrisht që do të ndjehet këndshëm i befasuar, sepse ai ka qenë i bindur se tradhëtarit dhe spiunit nuk do t’i përgjigjet askush! Në fakt, këtu edhe është i gjithë problemi! Shaqir Fetai vazhdon që ta keqpërdorë mirësinë dhe devotshmërinë e besimtarëve dhe, thotë se myslimanët po e përkrahin veprimtarinë e tij prej tradhëtari dhe spiuni dhe jo se myslimanët kanë një besatim të përjetshëm me BFI-në për ta mbajtur financiarisht deri në ditën e Kijametit! Shaqir Fetai dëshiron që përmes “filozofisë” së tij prej spiuni, ta irltojë masën, ta rrebelojë dhe ta detyrojë që mos të japin asnjë cent dhe, me këtë, t’ia arrijë qëllimit të marrur nga UDB-ja – rrënimi total i BFI-së!

Avdalli pastaj shpërfytyrohet në hajvan amorf sidomos kur mburret se me sukses ia paska dalur në zbutjen e Kovid 19! BFI-ja paska dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në zbutjen e kësaj epidemije dhe, tërë kjo na rgjistrohet si “Aktivitet i BFI-së në vitin 2021”!

Shaqir Fetai është shumë koshient se kjo epidemi “fatkeqësisht mori një numër të madh të qyetarëve”!

Tani, ku është këtu aktiviteti i BFI-së? Shpëtoi shumë jetë apo mori shumë jetë! Zbatimin e urdhërit të trupave të veçantë shtetërorë që formohen në raste krizash, Shaqir Fetai e konsideron aktivitet të vetin personal!

“Kontributi jonë, kam bindjen, ka luajtur një rol të jashtëzakonshëm në zbutjen e epidemisë Kovid 19”, thotë turulum, Shaqir Fetai!

Ku është këtu aktiviteti? Kontributi i Shaqir Fetait ka qenë zbatim i kërkesës për të mos falur namaze në xhami, për të mos organizuar lutje të përbashkëta me xhemate, masa këto të kërkuara dhe të miratuara nga trupa gjegjëse prej ekspertëve të vendit të formuar me rastin e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme!

Shaqir Fetai e llogarit si kontribut dhe si aktivitet të vitit 2021 mosfaljen e namazeve të përbashkëta në xhami!

Nuk e llogarit këtë dhembje shpirtërore, nuk e llogarit trishtim, nuk e llogaritë si kufizim të detyrueshëm që për herë të parë në këtë dy-tre shekuj të mos falen namazet me xhemat në xhami, por e llogarit si “aktivitet të vitit 2021”!

Krejt në fund të kësaj përgjigje, Shaqir Fetai, ky “hafiz” i pacipë thotë se paska pasur akktivite të duarnuarta por që në mungesë

të kohës nuk do t'i theksojë të gjitha veç e veç! Po mirë bre, le t'i thotë nja dy-tri aktivitete që janë interes i përgjithshëm i myslimanëve të vendit. Jo nga ato aktivitete që i ka bërë sa për të shitur “intelektualitet”, ndonëse është hipokrit e snob i dëshmuar katërcpërisht si dhe mjeshtër i vargëzimit të snobëve dhe hipokritëve të tjerë që i ka bërë gjerdan për qafe, si ata priftërijtë “me gjerdanin” e vet të shenjtë! Shaqir Fetai aktivitet i llogariitë edhe pierjen e çajit me ata që rastësisht i zatesin në zyrë si dhe dhënien e “dekoracioneve” që i ka si fara të lulediellit e që, megjithatë, kushtojnë, kërkojnë buxhet. Tmerri edhe më i madh është sepse Shaqir Fetai tashmë e ka devaluuar “dekorimin” e BFI-së deri në nivel të “lojës me tashakë”! /Kombetare/31.12.2021

Shaqir Fetai e mbyllë BFI-në me 13 kyçe

Shaqir Fetai thotë se ka ekzistuar një urdhër nëntokësor që i tuboi të gjithë mynafikët e BFI-së më 27 maj të vitit 2020. Tani, po i njëjti urdhër i prerë i vie Shaqir Fetait që t'i marrë e t'i darovitë me “umre” të gjithë ata mynafikët e dëgjueshëm të shërbimeve që e duan BFI të gjunjëzuar. Tradhëtarët në umre? Mynafikët të kryejnë veprim islam përpara se të pendohen publikisht për tradhëti e kodoshllëk

Nga Taip Musliji

Paramendoni sikur një qeveri të dilte jasht vendit me të gjithë ministrat dhe të bënte kokrrën e qejfit duke u shëtitur nëpër botë për dhjetë ditë rresht! Një institucion të ngelte për dhjetë ditë pa drejtuesit e vet! Kush do ta bënte këtë akt idiotik?! Vetëm ata “drejtues” që janë lodhur e janë konsumuar nga “pushteti” dhe, mezi presin një ndërhyrje nga jashtë për t'i flakur!

Nga brena BFI-së dëgjohen zëra se si Shaqir Fetai ka uruar që t'i bëhet një “puç” derisa do të jetë jasht “vatanit” të vet, madje duke ia krijuar terrenin me të gjitha letësimet për t'u realizuar ajo përmbytje e pritshme! Ikja nga “vatani”, me të gjithë organet, me të gjithë myftinjët, në fakt do të thotë vënia e 13 dryrëve në portën e BFI-së! Ky akt nuk ka ndodhur kurrë në historinë e BFI-së! Shaqir Fetai “posllushnikët” e vet, ata që zbatuan urdhërin e shërimeve antiislame duke shkaktuar ngjarjen e paprecedant në historinë e këtij Instiucioni që do të mbahet mend si “puçi i 27 majit 2020”, i shërben me “umre”!

Kështu ka qenë arsyetimi i Shaqir Fetait se pse po e merr me vete tërë “rijasetin” e tij! Ndërsa e vërteta është se askujt në shërbime intelegjente nuk i ha b... për anëtarët e “rijasetit” të Shaqir Fetait, të cilët tashmë e kanë kryer detyrën dhe janë hedhur në pleh si limoni i shtrydhur! E vërteta është se, Shaqir Fetai nuk u zë besë, asnjërit nuk i beson! Për të gjithë ka bindjen se mund të kontaktojnë me “armiqtë” e Shaqir Fetait dhe të manipulohen duke ia ngulur edhe këtij thikën pas shpine! Pra, marrja e të gjithëve me vete, qoftë kjo edhe me kyçje të BFI-së konsiseton në frikën e tij se këta mund të manipulohen dhe ta eliminojnë kryemynafikun. Kështu – më mirë mallin nën kokë!

Po ku shkuan të gjithë! Në Umre! Sa do t'i kushtojë kjo buxhetit të BFI-së? Ftesa e dërguar në emër të Rijasetit nga Shaqir Fetai kuptohet si ftesë për tërë Rijasetit! Zakonisht, shkon i pari, me një shoqërues e me një përkthyes! Kjo aventurë e abdall Shaqir Fetait, as është parë diku e as është dëgjuar! Është budallaki unikale që mbanë firmën e Shaqir Fetait.

“Me këtë vizitë, delegacioni i lartë i Bashkësisë Fetare Islame të RMV iu përgjigj ftesës vëllazëror të mikut të BFI Shkëlqesisë së tij Z. Sulejman esh Shiddijit me qëllim të plotësimit të dëshirës së tij dhe të delegacionit në fjalë”, thuhet në komunikatën e shërbimit lolo të Shaqir Fetait! Mik i BFI-së? Kur u bë ky farë Shiddiji mik i BFI-së! Me çka e meritoi epitetin “mik i BFI-së”? Cili është kontributi i tij për këtë lidhje miqësore! Çka di opinionin i gjërë për këtë farë “shkëlqësie”, apo miqësia me të është ngritur rreptësisht në sekret të potë!

Paramendoni se çfarë thuhet në këtë komunikatë!!! Kjo ekspeditë e budallakaftë na del si rezultat i dy dëshirave paraprake! Paska pasur dëshirë Sulejman Shiddiji që të realizohet kjo vizitë, por, po kaq dëshirë paskan pasur edhe këta të BFI-së! Ndërsa që të gjithë shkojnë për të kryer UMREN! Po pse kaq turp për të pranuar se kanë shkuar për një veprim islam dhe po kaq mburrje se ia kanë dalur ta plotësojnë dëshirën e “shkëlqësisë” së tij! Kjo është karakteristikë tipike e mynafikëve. Pikë!

Më tej, shprehet kënaqësia se “rijaseti” i Shaqir Fetait do të ketë rastin të njohtohet dhe të pajise me përvoja të reja nga ky vend (me vehabizëm?!?) ndërsa autoriteteve shtetërore të vendit do t'ua japin përvojën e BFI-së së Shaqir Fetait, përvojë kjo që konsiston fund e krye në praktika tradhëtie, mynafikllëku dhe sjellje joislame!

Deri më sot Shaqir Fetai ka arritur të takohet vetëm me disa studentë nga Kosova e Maqedonia e Veriut që studiojnë në Universitetin e Rijadit dhe, ka nënvizuar pritjen madhështorë që ia paskan organizuar studentët! Epo dërkaxhi më të pacipë se Shaqir Fetai nuk bën më nëna! Pritje madhështore prej studentëve, ndërkohë që është ftuar nga “autoritetet saudite” për çgjë edhe është nisur për ta vizituar Mbretërinë e Arabisë Saudite! Ftesë nga mbretëria ndërsa e presin studentët?! Për më tepër, kjo pritje paska qenë edhe domethënëse! Pritje domethënëse?!? Janë këto “margaritarë” të një të sëmuri për mend siç është Shaqir Fetai.

Shaqir Fetai nuk ngurron që t'i vë kapak budallakisë së vet duke nënvizuar: “U këmbyen mendime dhe përvoja rreth çështjeve aktuale dhe sfidave të kohës”! Përvoja mbi çështjet aktuale? BFI këmben përvoja me studentë të stërngarkuar me përvojat e tyre! Nuk e ka dert Shaqir Fetai për një budallallëk të tillë, sepse, ai është gjallë i interesuar për ta sektarizuar dhe për ta ideologjizuar sa më shumë BFI-në! Ai ka lejuar që të regjistroheshin lloj-lloj “bashkësi fetare islame”, me zgjedhjet kadrovike të tij ka mundësuar sektarizimin dhe ideologjizimin e BFI-së, politizimin dhe partizimin e saj, sepse, vizioni i Shaqir Fetait është kjo: degradimi i BFI-së deri në shkatërrim total me qëllim që nesër, ata që do të nisin

rimëkëmbjen e BFI-së të mos kenë kohë të merren me idiotizmat e Shaqir Fetait por me ringritjen e Institucionit! Rrënimi i BFI-së përjetë do ta mbajë vulën e Shaqir Fetait. Këtë e di mileti, këtë e di edhe Zoti! Vetëm një abdall si Shaqir Fetai mund të mendojë se mund ta gënjejë edhe miletin edhe Zotin! Një ftesë zyrtare e autoriteteve më të larta saudite do të ishte garanci e mjaftueshme për spostimin e tërë “rijasetit” në Mbretërinë e Arabisë Saudite, kurse spostimi i “rijasetit” për t’ia përmbushur dëshirën një anonimesi është e barasvlefshme me vënien e 13 kyçeve në portën e BFI-së dhe për ta përmbushur dëshirën e Shaqir Fetait, alias ORAO-s, nxënësit të oficerit të UDB-së, Stanko Dragoviqit! Qenie këto të fëlliqta! Vallahi!/1KlikLarg/02.01.2022

Kështu foli Shaqir Fetai (22)

Në intervistën e fundit të porositur, Shaqir Fetait, pasi kishte festuar Kërshëndellat dhe pak para se të niset për në “umre”, veç tjerash kishte folur për “stabilitet financiar”, si sukses epokal të BFI-së! Natyrisht, edhe kjo ishte marrëveshje para se t’i qasej puçit dhe komplotit të pashembullt në historinë e BFI-së që e ndërmoi Shaqir Fetai me shërbimet e nëntokës që vetëm e mira e islamit dhe shqiptarëve nuk mund të jenë

Nga Faik Shahinbejlliu

Shaqir Fetai na e paska “stabilizuar financiarisht” BFI-në! Ku i mori paratë? Kush ia dha paratë? Pse ia dhanë paratë për ta arritur këtë “stabilizim financiar”? Të gjitha analizat, të gjitha faktet, të gjitha raportet flasin për një iritim të popullatës myslimanë të vendit dhe për një ndërgjegjësim të tyre se, pa një reformë rrënjësore dhe përmbajtësore në BFI nuk do të ketë as fitra, as zeqat, as kontribute vullnetare! Këto obligime financiare islame kanë pësuar një rënie rapide, sidomos që kur u instalua politikisht në krye të BFI-së Shaqir Fetai. Nuk ka as ndihma humanitare, sepse, askush nuk po dëshiron që t’i japë jetë bastardit të instaluar nga pushteti politik i cili kurrë nuk ia ka dashur të mirën as isamit dhe as shqiptarëve të vendit.

Atëherë, ku i mori paratë Shaqir Fetai për këtë “stabilitet financiar” të BFI-së? Shaqir Fetai, duke dashur që ta lavdërojë pushtetin aktual, duke dashur që të tregojë “se sa nikoqir që është”, duke dashur që në mënyrë falce të paraqesë një “gatishmëri të pushtetit” për të bashkëpunuar dhe bashkëjetuar me BFI-në, në fakt e nxjerr në sipërfaqe një hajni të tmerrshme, një krim të pafalshëm që është duke e bërë.

Shaqir Feta ka marrur letra në vlerë në shumë prej mbi 4 milion

euro, prej të cilave mbi një milion ia ka dhënë Myftinisë së Skupit, e cila është në prag të një shit-blerje nga më kriminalet që mund të ekzistojë. (Jemi duke i përcjellë tratativat e “hajrave islamikë” të cilët kurrë nuk do t’i harrojë bota myslimane e vendit, më sa e kanë harruar “Zhëngër babën”!

Shaqir Fetai ka pranuar letra në vlerë nga pronat që dikur ishin vakëf e që tani janë vlerësuar si e mirë e përgjithshme shoqërore. Islamikisht – me këto letra do të duhej që të blehet vakëf tjetër dhe të shtohet pasuria vakufore me qëllim që jeta islame në Maqedoninë e Veriut asnjëherë të mos pësonte krizë financiare, ashtu siç kanë dëshiruar dhe ëndërruar të gjithë ata që pasurinë e tyre e kanë lënë vakëf!

Me këto letra Shqip Fetai i rritë rrogat e nëpunësve të BFI-së, i siguron rrogat e nëpunësve, honoraret dhe mëditjet si dhe e blenë rehatinë dhe lojalitetin e atyreve të cilët, meqë kanë tradhëtuar një herë mund të tradhëtojnë tërë jetën! Shaqir Fetai duhet të dijë se po bën krim financiar dhe jo “stabilitet financiar”! Një ditë, edhe në varr do t’i kërkohet përgjegjësia për këtë vjedhje dhe për këtë shkatërrim të vakëfit! Askush nuk i ka lënë vakëf Shaqir Fetait që ai të ketë mundësi të shkojë në Umre. Shaqir Fetai për këtë vepër penale do të përgjigjet. Vallai do të paditet, pa mëdyshje!

2.

“Në pika të shkurta a mund të na numroni ndonjë sukses a njihërit edhe ndonjë sfidë me të cilët jeni ballafaquar gjatë këtij viti”, ishte pyetja e dytë që i parashtrohet Shaqir Fetait në intervistën e porositur sa për t’u lavdëruar naivisht, të paktën, në “Tv Ikre”! Gazetari ia shtron këtë pyetje me qëllim që ta provokojë e të flasë injoranti, sepse, as vetë ky (gazetari) nuk di se cilat kanë qenë ato suksese e sfida gjatë vitit 2021. Sikur t’i dinte me siguri që do t’ia theksonte një nga një në pyetje dhe do ta pyeste se si ia arriti që të përballet me këto suksese e me këto sfida. Por, shihet qartë që gazetari nuk i di as sukseset dhe as sfidat, ndaj e mbështet për muri Shaqir Fetain, me qëllim që ta provokojë e ta detyrojë të heqë dorë nga vetëlavdërimi.

Shaqir Fetai, tamam si një snob e hipokrit i pashoq, do të përgjigjet duke thënë se, gjatë vitit që e lamë “në të kaluarën!!!”, dy paskan

qenë prioritetet e tij (!!!): e para paska qenë angazhimi për denacionalizimin e pronës! Te kjo e para Shaqir Fetai po rrenë, pa një gram sëkuqe në fytyrë, i pacipi gënjen dhe pallamudë idiotizma. Procesi i denacionalizimit të pronës është i hershëm dhe, ky proces ka përjetuar shumë procese gjyqësore, shumë djersë të dikujt që ka përfaqësuar BFI-në në procese gjyqësore, shumë shpenzime (Shumë! Qindra mijëra euro) që sot Shaqir Fetai ta gëzojë produktin e tërë këtij angazhimi! Shaqir Fetai nuk ka dhënë asnjë kontribut, as më të voglën kokërr të djersës, as më të voglin mund që "të përmbillet" me sukses ky proces. Shaqir Fetai kurrë nuk u përball me pushtetin, kurrë nuk i reagoi pushtetit deri në destabilizim total të vendit, kurrë nuk u përpoq që të futen në axhendën e pushtetit kthimi i pronave të BFI-së. Shaqir Fetai u "prremtoi" sekserëve (nga rrrugaçë e deri në "ministra") se do ta falë pa kurrfarë problemi përqindjen e denacionalizimit, vetëm të kryhet kjo e të shpallet "stabiliteti financiar i BFI-së"! Pa dyshim, ky "stabilitet" do të jetë varri i trishtë i Shaqir Fetait.

Prioritet i dytë i Shaqir Fetait paska qenë "hapja e BFI-së" me faktorët e jashtëm! Shaqir Fetai edhe në këtë "prioritet" gënjen pa krip, gënjen si një mjeshtër i gënjeshtres, ndonëse i thotë vetes "hoxhë" e "hafiz"! Hapja paska qenë në dy aspekte: Shaqir Fetai qenka vizituar nga lloj-lloj bashkësi fetare të Ballkanit, vizita këto që nuk kanë munguar as në të kaluarën dhe që janë ngritur në praktika të përvitshme nga ish-struktura udhëheqëse e BFI-së. Shaqir Fetai lavdërohet kot, ndërsa rrenë si një njeri i poshtër e i pacipë. Këto vizita i paska kthyer edhe Shaqir Fetai dhe i paska shfrytëzuar për shpjegimin e islamit! Ky jo vetëm që di të jetë i pacipë, por edhe shumë ofendues, prandaj, në çdo fjali meriton shuplakë e tëkërlitje të shallit nga koka e munafikut. Qenka angazhuar për menaxhimin e islamit burimor me qëllim që mos ta depërtojnë ideologji të ndryshme në emër të fesë! Po Shaqir Fetai, a nuk është ky mynafik që lejoji regjistrim të "bashkësive fetare islame" të dyshimta që do të veprojnë kinse në emër të islamit. A nuk është i njëjti person i cili e mbushi BFI-në me përfaqësues të sekteve dhe të ideologjive të ndryshme që nuk kanë të bëjnë asgjë as me islam dhe as me shqiptari! Shaqir Fetai mendon se me këtë intervist do ta kamuflojë angazhimin e tij për t'i jetësuar të gjitha parashikimet e UDB-së?! Si sukses tjetër Shaqir Fetai llogarit faktin që ia paska arritur që ta detyrojë kryetarin e Bashkësisë Islame të Turqisë që të jetë mysafir i Maqedonisë së Veriut!!! Me

këtë rast, për herë të parë Dijaneti i Turqisë i paska dhënë një përkrahje të jashtëzakonshme BFI-së së Shaqir Fetait? Po pse këtë përkrahje, në çfarë politika? Në çfarë suksese? Shaqir Fetai duhet të thotë se siguruam përkrahje të turqëve për politikat tradhëtuese dhe të puçit i cili nuk u krye me sukses në Turqi nga “gjylenistët”! Ky po që është sukses i Shaqir Fetait, të tjerat të gjitha janë dështime, janë brum i materies së një historie nga më të zymtat që ka kaluar populli ynë.

Ngjarje e dytë, e cila paka qenë edhe prioritet i BFI-së së Shaqir Fetait, paska qenë vizita e sekretarit gjeneral të RABITA-s! Madje, sukses i Shhaqir Fetait qenka dhe vizita e shejh Isës, i cili, si mysafi i BFI-së ia paska bërë presidentit të shtetit si dhe kryetarit të “parrllamentit” të Maqedonisë! Shaqir Fetai nuk e përmend edhe skandalin më të tmerrshëm që e ka bërë “në sferën e hapjes së BFI-së”! Ishte nikoqir i të dërguarit të Putinit të cilin, si mysafir të BFI-së, ia dërgoi edhe kryetarit të “parrllamentit” të Maqedonisë, shqetësim këtë që e ngritën edhe mediat ndërkombëtare! Shaqir Fetai thotë: ”patëm vizitë edhe nga ambasadorja e SHBA-së (nuk ia di emrin), si dhe nga ambasada e Britanisë së Madhe (nuk ua di emrin!) e kështu me radhë, thotë avdalli! Kush, kështu me radhë! Kush i shkoi! Le t’i përmend! Asnjë! Sepse kori diplomatik tashmë e ka të qartë se Shaqir Fetai është tip i rrezikshëm, i paparashikueshëm, tashmë e dinë të gjithë se si erdhi, se si është ithtar i anarkisë, ndaj, asush nuk dëshiron që ta legjitimojë me vizitat e veta, ndërsa çdo vizitë që i bëhet është në funksion të mbledhjes së informacioneve që u duhen për shërbimet e tyre sekrete, dhe jo se po vizitojnë ndonjë alamet “intelektuali” prej të cilit kanë se çfarë të dëgjojnë e të përcjellin në vendin prej nga vinë.

Shaqir Fetai, i kompleksuar nga gjesti tradhëtues që e ndërmoi, nuk e lë pa theksuar: “vërtet morëm një përkrahje të madhe nga puna që po zhvillohet në BFI”! Po kjo përkrahje, madje edhe më e fuqishme, më kuptimplote dhe më përmbajtësore ka qenë edhe në të kaluarën. Kjo përkrahje, pa fije dyshimi, ka filluar të zbehet e të sillet në nivelin zero sidomos pas komplotit të zhvilluar nga Shaqir Fetai. Të gjithë e dinë se BFI-ja aktuale mund të jetë vetëm ndonjë njësi e papërfiillshme e “shërbimit intelgjent maqedonas”, ndaj, nuk kanë nevoj për vizita sepse informacionet burimore i mbarrin nga vetë shërbimi intelgjent maqedonas.

Sfidë tjetër e Shaqir Fetait na qenka edhe akreditimi i Medresesë!

Shpresa të mëdha paska Shaqir Fetai se, këtë vit do të bëhet akreditimi, sepse tashmë po ekzistuaa draftdokumenti!!! Shaqir Fetai mendon se Medresja do të bëhet institucion arsimor shtetëror dhe, me këtë, shteti do të nisë të prodhjë kuadro profesionalë për nevojat e BFI-së, pra, hoxhallarë! Ishalla bëhet!/?/Kombetare/03.01.2022

Lajmet e rreme të Shaqir Fetait

Kush ndërhyri që Shaqir Fetai me muhybët e vet të takohet nga ndonjë autoritet saudit?! I kishte ftuar një “ekselencë” i cili deri më tani nuk i pranoi, pas takimit me tre-katër studentë që studiojnë në Universitetin e Rijadit, qenkan takuar edhe me këshilltarin fetar të Mbretit saudit! Po me kë paska dashur Shaqir Fetai që të takohet? Natyrisht me kompetentët për t’ia matur rrenat që i bën në emër të fesë

Nga Vexhi Murseli

Natyrisht, edhe kjo vizitë do të “përpunohet” laboratoriumeve protokolare si dhe të shërbimeve intelektuale për të dalur në përfundim se, deri ku mund të shkojë rrena, prishunia dhe megalomania e një instalacioni politiko-partiak në krye të një institucioni fetar, siç është Shaqir Fetai!

Pasi i mbylli të gjitha organet e BFI-së, duke i marrur përfaqësuesit e tyre me vete, sepse nuk ua ka besën t’i lë vetë deri sa ai gjendet për kohë të gjatë jashtë vendit, Shaqir Fetai u nis për në Umre. Tha më vete, pse mos të takoj diku rrugës! Tani kur në një shtet hy një “delegacion i tërë” fetar islam, natyrisht që ai delegacion duhet të jetë nën vëzhgimin e organeve kompetente, madje edhe duke i dalur si “mikërpitës”! Dikush duhet t’i testojë budallenjtë! Shaqir Fetai, si mburravec i pacipë që është, bëri lajm se qenka takuar me studentët shqiptar në Rijad. Alamet aktiviteti! Aiii patjetër që duhet të shpërblehet me një “dekoracion”!

Lajmi tjetër nuk ishte ai që u takua me këshilltarin fetar të Mbretit të Arabisë Saudite, por, u bë lajm “këshilltari i mbretit paska shtruar drekë solemne për Shaqir Fetain”! Drekë solemne!!! A e kupton Shaqir Fetai fjalën “solemne”! A e di Shaqir Fetai se kur

shtrohet dreka solmene. A e di Shaqir Fetai se cilës drekë protokoli shtetëror i thotë “drekë solemne”! Do me thënë, shkelja e Shaqir Fetait në tokën e shenjtë fetare qenka festë, qenka ngjarje shumë e rëndësishme, qenka diçka e paparë dhe e papërsëritur, qenka diçka madhështore, ndaj dhe duhet të shtrohet “drekë solemne”! Shaqir Fetai vetëm ka hëngër një drekë të rëndomtë në momentin kur iu është hëngër edhe këshilltarit, apo kur ai ka vlerësuar se fakirëve t’u jepet një drekë e begatë!

Shaqir Fetai, i ekzaltuar nga ky takim formal, i cili më tepër ka qenë për ta analizuar delegacionin e rrencakëve dhe të tradhëtarëve se sa që ka qenë ndonjë delegacion special, përmes një deklarate pompoze dhe të pistë, tipike e spiunëve të UDB-së, thotë se, “gjatë këtij takimi mjaft të rëndësishëm, pjestarët e delegacionit të BFI kaluan çaste mbresëlënëse dhe mjaft të frytshme, ku Këshilltari Esh Shethri bisedoi për një bashkëpunim të mirëfillte në të ardhmen, me qëllim të shpjegimit të Islamit në mënyrë të pastër si e vetmja veprimtari në kultivimin e vlerave të ngritjes së dinjitetit të njeriut në paqe e solidaritet dhe për të demantuar mendimet e gabuara ndaj Islamit dhe vendit ku jetojmë.” Po çfarë islami qenka predikuar deri më sot në Maqedoninë e Veriut? Me çfarë islami qenkemi pajisur dhe, tash e tutje, duhet që të korrigjohemi dhe të pajisemi me po atë islam që do të na e sjellin Shaqir Fetai me 13 myhybët e vet! Do me thënë se, deri më sot, hoxhallarët e vjetër dhe të sotëm, na paskan predikuar islam të papastër, islam që paska krijuar mendime të gabuara mbi fenë tonë. Tash e tutje, falë kësaj “vizite zyrtare” të Shaqir Fetait, myslimanët e Maqedonisë do të dalin në selamet! Shaqir Fetai kahdo që të rrotullohet meriton shpulla faqeve e shqelma bythës, sepse është shumë injorant, shumë i poshtër, për një “drekë solemne” shet islamin shekullor të vendit, për një takim me një personalitet fetar sakaq mbushet me bateri për të ofenduar e përçmuar fe e komb. Sjellje kjo tipike e personave labilë dhe e atyreve që të kaluarën udbasheske e kanë kompleks të pashërueshëm.

Nga “rrjedhja e informacionit kuptojmë se Shaqir Fetai rastësisht

është takuar me një personalitet shtetëror i cili i është prezantuar si këshilltar fetar i mbretit! Nuk po hamendësojmë asgjë, por, habit fakti se si Shaqir Fetai dhe myhybtë e tij nuk e paskan njohur më parë këtë personalitet mbretëror! Informacioni thotë se “nga bisedat që u zhvilluan treguan qartë se Shejh Sa’d Esh Shethri, është një personalitet i lartë, i urtë dhe me njohuri të gjëra mbi rrjedhat fetare në përgjithësi!” Natyrisht, personaliteti në fjalë do t’u prezantohet si këshilltar fetar i Mbretit, por, sa Shaqir Fetai iu prezantua këtij këshilltari? Sa ishte islamikisht i drejtë ndaj tij? Sa i tregoi se si është instaluar në krye të BFI-së? A i tregoi se ai është produkt politiko-partiak i përkrahur dhe shtyrë nga shërbimet sekrete të ndryshme! A i tregoi këshilltarit fetar se ai nuk ka ardhur fetarisht në krye të BFI-së, por ka ardhur pas një puçi dhe komploti përplotë me tradhëti e të përkrahur nga pushteti “laik”! A i tregoi këshilltarit fetar se Shaqir Fetai fenë e ka vetëm trampolinë për të arritur në karrierën e vet; a i tregoi sa ka vjedhur, sa ka rrejtur, sa ka shkelur parime fetare e kushtetutare, a i tregoi se çfarë spiuni që është, a i tregoi se vjen prej tajfës së kodoshëve të UDB-së, a ia shpalosi tërë shpirtin për t’ia treguar tonelatat e katranit që i ka brenda! Natyrisht, Shhaqir Fetai është n... sa për të kuptuar se rreth tij sauditët dijnë çdo gjë e në hollësi! Këshilltari fetar i Mbretit i ka takuar (ndonëse nuk ka qenë në “protokol” të Shaqir Fetait) për t’i analizuar dhe testuar se sa këta pisa mendojnë islamikisht, sa janë të orientuar nga parimet islame, sa gënjejnë dhe sa janë të sinqertë! Këshilltari i Mbretit të Arabisë Saudite nuk ha barë, brenda për brenda delegacionit të paktën i ka dy-tre spiunë (a t’ua themi emrat?!) të hershëm të cilët kanë raportuar në hollësi, natyrisht, jo në të mirë të BFI-së! Delegacioni i BFI-së të prirur nga Shaqir Fetai përbëhej nga 16 anëtarë (drejtus të të gjithë organeve të BFI-së)! Çka i prezantuan të gjithë këta nikoqirit të tyre, këshilltarit të Mbretit saudit? Me çfarë projekti i dolën përpara ekselencës? Cili ishte fitbeku nga ky takim? Çka do të përfitojnë myslimanët e Maqedonisë nga kjo aventurë e kushtueshme e Shaqir Fetait? A pati premtime konkrete nga shkëlqësia e tij, apo, nuk pati sepse ai ishte për një

ekzaminim të dilinxhive! Nëse i hedhet një sy fotografive që i kanë postuar, sakaq do të vërehet se me të vërtetë janë tërësisht në aut, nuk njohin kurrfarë bon-toni dhe kurrfarë protokoli, nuk dinë si të rrinë, si të ulen, si të duken kur janë në delegacion që priten zyrtarisht. Njëri me maskë në vesh, tjetri në hundë, një tjetër në mjekër, një tjetër pi kafe e me maskë në gojë, tjetri bën selfie deri sa “drejtuesi” i tyre dhe mikëpritësi bisedojnë. Një sjellje nonshalante dhe e padenjë për një hoxhë! Edhe kjo pamje është me skenar,, por, duduku Shaqir Fetai nuk e kupton! Prandaj, jo rastësisht përshtypja e parë e zyrtarëve arabë është që në vend kanë hyrë një grup dilixhinjësh, tradhëtarësh e spiunësh që profesionin e tyre të pistë e ushtrojnë nën petkun e islamit./1KlikLarg/05.01.2022

Kështu foli Shaqir Fetai (23)

Në intervistën e vet të fundit, natyrisht të porositur nga vetë ai, sepse askush nuk po i jep hapësirë, sepse që të gjithë janë “bymyer” me rrenat e ulta, Shaqir Fetai fuqishëm dëshmon se është i pacipë, se e ka në gjak e në gjen rrenën si dhe shtrembërimin e fakteve, qofshin këto edhe vlera cvilizuese të ndërkombëtarëve. Shaqir Fetai jeton me rrena, për rrena dhe, hiç nuk e ka dert për vetëlavdërim nëse të tjerët nuk e bëjnë hesap

Nga Faik Shahinbejlliu

3.

Në pyetjen e radhës përplot cinizëm dhe sarkazëm të gazetarit të “Tv IKRE”-s, Shaqir Fetai, instalacioni politik i forcave antisilame e antishqiptare në vend, të cilët, nga strukturat e UDB-DBK-së, e instaluan në krye të BFI-së, orientohet të shpалosë gjithë “thesarin” e vet të mbushur përplot me rrena, me vetëlavdërime dhe me shtrembërime të fakteve. E do Shaqir Fetai shtrembërimin e fakteve, sepse kështu i hapet oreksi për vetëlavdërim, meqë të tjerët as që po ia çokin “n’rrotë”.

Gazetari e pyet me qëllim që ta fusë lakrave të huaja: “Pas gjithë atyre sukseseve, angazhimeve, punës permanente që ju bëtë gjatë këtyre dy viteve, nuk ishte e rastësishme që ju u veçuat dhe morët mirënjohje nga Komisioni Evropian. Si e komentoni këtë?” Kurse Shaqir Fetai, i habitur deri në lakuriqësi të karakterit të vet, shprehet: “Ardhja e mirënjohjes nga KE ishte i befasishtëm sepse angazhimt tona nuk kanë qenë drejt asaj që të merret ndonjë çmim nga ndonjë institucion i lartë... Edhe pse aty personalisht

përmendet emri im, pra, kryeytarit të BFI-së i jepet një mirënjohje nga Komisioni Evropian, une mendoj se kjo dekoratë apo mirënjohje që më jepet i përket të gjithëve punën e të cilëve e ka analizuar mirë Komisioni Evropian dhe më në fund ka vendosur ta japë atë mirënjohje.”

Në dy-tre fjali të para Shaqir Fetai radhitë një mori rrenash që nuk i bëjnë nder as BFI-së por as strukturave më të larta evropiane! Çka thuhet në të vërtetë në faqen 29 të raportit të KE-së ku “na u përmendta emri i Shaqir Fetait: “Liria e mendimit, e besimit dhe e religjionit është e garantuar me ligj dhe në praktikë dhe diskriminimi me bazë fetare është i ndaluar. Të koordinuar nga Komisioni për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze, liderët fetarë bashkërisht ranë dakord të mbështesin Qeverinë në ballafaqimin me COVID-19 dhe bindjen e njerëzve në heqjen dorë nga grumbullimet masive gjatë festave fetare. Kryetari i sapozgjedhur i Bashkësisë Fetare Islame ka luajtur një rol pozitiv në përmirësimin e dialogut ndërfaqetar në vend.”

Hë pra, ku përmendet emri i Shaqir Fetait? Ku qenka këtu mirënjohja? Ku qenka këtu dekorata për të cilat vdes Shaqir Fetai, t'i marrë e t'i japë, sepse kësisoj ai mendon se duke marrur dekorata do të shpëtojë nga bombardimi me kritikën objektive që i adresohen atij si person që është katapultuar nga shërbimet sekrete serbe (UDB) në krye të BFI-së!

Nuk ka asnjë aktivitet që e faton kontributin e Shaqir Fetait në përmirësimin e dialogut ndërfaqetar! Nuk ka asnjë konferencë të përbashkët, asnjë tryezë të përbashkët, asnjë “kongres” të përbashkët, asnjë vizitë të ndërsjellë, asnjë deklaratë apo ligjeratë! Shaqir Fetai është i vetmi “kryetar” në historinë e BFI-së që ka qejf të hajë nga këteringu i organizuar me rastin e Kërshëndellave por, mos t'i urojë të krishterët për këtë festë fetare! Shaqir Fetai, nga frika se do ta akuzojë dikush për dhënie epshore pas ortodoksisë, ikë në “Umre” ndërsa nga atje nuk drejton asnjë urim për të krishterët ortodoksë me rastin e Krishlindjes! Tani, Shaqir Fetai po kontrbuoka në përmirësimin e marrëdhënieve ndërfaqetare?!

Budallain mos e vet se të tregon vetë! Në përgjigje e sipër, Shaqir Fetai thotë se kur e paska marrur (grabitur) postin e kryetarit, sakaq paska vërejtur se bashkësitë fetare në mes vete paskan krijuar një distancë të theksuar. Menjëherë, punën e parë që e paska bërë Shaqir Fetai, paska kërkuar nga kryetari i Komisionit për Kishën dhe bashkësitë fetare si dhe grupet religjioze, që të

takohen sa më shpesh me qëllim të përafrimit të bashkësive fetare në mes vete. Pra, nuk ka kërkuar nga kryetari që të japë shpjegime se si u bë që në këtë Komision të regjistrohet dy-tre bashkësi fetare “islame” si dhe po aq grupe religjioze që veprojnë në emër të “islamit”, por, paska kërkuar që të afrohet sa më shumë me bashkësitë e tjera fetare në vend! Natyrisht, kjo kërkesë e Shaqir Fetait ka qenë politikisht e stisur, me qëllim që pushteti të kërkojë nga Komisioni që të insisojë në raportin e Komisionit Evropian që të nënvizohet kontributi i “kryetarit të posazgjedhur” në përmirësimin e dialogut ndërfeetar, në fakt, për mosreagimin e tij institucional kundër politikave antiislame për ta fragmentarizuar dhe për ta dëmtuar sa më shumë Bashkësinë Fetare Islame duke regjistruar “bashkësi simotra”, ndonëse Ligji për Kishën dhe bashkësitë fetare nuk e lejon një gjë të tillë! Kjo është e vërteta e “dekoracionit” që e paska marrur (!!!) Shaqir Fetai nga KE-ja! I pacipi, pa pikë turpi thotë se: “kjo ka qenë arsyeja që Komisioni Evropian mua, njeriut të parë të BFI-së, t’ia japë një mirënjohje dhe një lavdatë për gjithë aktivitetin tim”! Natyrisht, nëpër qarqe të caktuara ndërombëtare tashmë është krijuar bindja se Shaqir Fetai është karakter shumë i rrezikshëm, i cili mund të të bëjë edhe dëm nëse vetëm ia zgjatë dorën. Prandaj dhe ky “i dekoruari” i Evropës, është marginalizuar deri në mosërfillje nga turpat e ndryshëm ndërombëtarë që veprojnë në vend. Edhe pak ato takime që i ka, organizohet sa për t’ia matur pulsën e karakterit të dobët dhe sa për ta shikuar se sa është në korniza të portretit të pikturuar nga të tjerë faktorë objektivë që merren me përcjelljen e angazhimit politiko-partiak dhe me shërbimet intelegjente (serbore) të Shaqir Fetait.

Shaqir Fetai e përfundon këtë pëgjigje duke e minimizuar vlerën e Kuranit vetëm në dy ajete që qenkan të vlefshme për të dhe për myslimanët e Maqedonisë e që porosisin që të punohet dhe se vlerësues i punës qenk Allahu Fuqiptotë. Pa dyshim që ai vlerëson punën e myslmanëve. Por ama punën e Shaqir Fetait Allahu Fuqiptotë e dënon ndërsa e vlerëson oficeri i UDB-së, Stanko Dragoviqi, me propozimin e të cilit Shaqir Fetai do të katapultohet prej fuksi në “kryetar” të BFI-së. Prandaj dhe Shaqir Fetai nuk po u marrkëka me thashethemet që po vikan nga rruga kundër tij! Le të përgjigjet Shaqir Fetai, ky munafik e komplotist i pacipë, sa janë thashetheme nga rruga këto pyetje:

A shtë e vërtetë se ai një javë më parë e lavdëronte deri në kupë të qiellit ish-reisin e tij, Sulejman Rexhepin, kurse pas një jave ia ngulë thikën pas shpine duke i organizuar puç, tradhëti e komplot të llojit të UDB-së?

A është e vërtetë se Shaqir Fetai (bashkë me vjehrrin e vet) ka qenë vegël e Temellko Boshkovskit?

A është e vërtetë se Shaqir Fetai mori urdhër politiko-partiak, por edhe përkrahje nga pushteti politik, për t'i përmbysur të gjitha vlerat fetare e kombëtare që ishin ngritur mëse tri degada në BFI nga shumë teologë të vendit?

A është e vërtetë që Shaqir Fetai është absolutisht i padëshirueshëm, i parespektueshëm dhe i panderueshëm nga myslimanët e vendit dhe jo vetëm! A është e vërtetë se Shaqir Fetai, nëse do të shkonte në një referendum popullor (pa përkrahje partiake!) nuk do të siguronte përkrahje veçse nga dhjetë-pesëmbëdhjetë shtëpi të katundit të vet?

Nëse këto pyetje janë nga fjalori i thashethemeve, atëherë, nga cili fjalor janë rrenat e Shaqir Fetait i cili, duke e ditur se është fuks i poshtër, mundohet të na shesë "hoxhallëk" duke na treguar se puna e tij qenka ta shpjegojë islamin burimor dhe të pastër. Po puna e tij e deridjeshme, çka paska qen? Çka, përveçse spiunllëkut dhe tradhëtisë?! /Kombetare/08.01.2022

Shaqir Fetai me rrena u nis për në Umre

Në një kohë të pakohë, me probleme sociale dhe me pandemi vdekjeprurëse, Shaqir Fetai u nis për në Umre, sepse, nuk po mundet që edhe më tej ta mbaj mbi supe peshën e tradhëtisë dhe të hipokrizisë që e bëri më 27 maj të vitit 2020, së bashku me të dëgjueshmit e tij dhe të përkrahur nga forcat politike jo të sinqerta në raport me islamin dhe me shqiptarët në vend. Shaqir Fetai mendon se, pasi të dalë nga ihrami, do të jetë i pastër së bashku me fiçfiriqët e vet. Por ama, nuk do të heqin dorë nga tradhëtia dhe shijimi i benifiteve prej një komploti të pandershëm e të turpshëm

Nga Sadik Bislimi

Më 30 dhjetor të vitit që lamë pas, Shaqir Fetai së bashku me “myftinjtë” e vet do të niset për në Umre. Një dhuratë për bashkëpunëtorët për ndihmën dhe përkrahjen që ia ofruan gjatë aktit të tradhëtisë, përmes së cilës e kreu puçin dhe komplotin kundër ish-reisit të tyre i cili kishte probleme kombëtare e fetare me qeveritë maqedonase dhe lakejt e saj shqiptarë. Shaqir Fetai, si rrenc i pashoq që është, edhe kësaj radhe do të përkujdeset që ta sajojë një rrenë me qëllim që ta justifikojë këtë udhëtim dhjetëditor duke e mbyllur Rijasetin si dhe të gjitha organet e BFI-së! Shaqitr Fetai do të përkujdeset për një narrative përplotë me rrena: “Me këtë vizitë, delegacioni i lartë i Bashkësisë Fetare Islame të RMV iu përgjigj ftesës vëllazëror të mikut të BFI Shkëlqesisë së tij Z. Sulejman esh Shiddijit më qëllim të plotësimit

të dëshirës së tij dhe të delegacionit në fjalë, e cila konsiderohet si nderë dhe fat për Bashkësinë Fetare Islame e RMV që personalitetet më me përgjegjësi të jetës fetaro-islame të jenë sa më afër institucioneve të sferave të ndryshme në Arabinë Saudite.”

Dëshirën për ta kryer Umren dhe për t’i shpërblyer të gjithë ata që e ndihmuan në rrënimin e vlerave të padiskutueshme të BFI-së, Shaqir Fetai e kamuflon me “realizim të dëshirës” së atij që i fton!”

Po pse nuk u bë askund i gjallë ky farë Shiddiji? Pse nuk u pa askund, nuk u përfshi në asnjë “axhendë të arabëve” të përgatitur për Shaqir Fetain dhe honxhobonxhot e tij?

Në këtë prononcim lidhur me udhëtimin për në Arabinë Saudite, ka vetëm një të vërtetë: në këtë shëtitje të panevojshme, Shaqir Fetai nuk pati kurrfarë axhende të veten, nuk pati kurrfarë programi nga pala arabe, nuk pati kurrfarë kalendari të detajuar me vizita e aktivitete! Gjithçka ishte stihike, vetëm e evtëm të kalojë kohë e të vijë momenti i kryerjes së Umres! Natyrisht, rrugës do të realizohet ndonjë takim me studentët tanë, të cilët, nga malli që kanë për vendin, do ta mirëprisnin një pastrues rrugësh, një druvar, një teneqepunues e jo më një “hoxhë” nga vendlindja!

Natyrisht, të futet në një vend të huaj një delegacion aq i madh fetar, madje komplet udhëheqësia e organit më të lart fetar, gjithësesi që do të takohej nga ndonjë “këshilltar” i Mbretit, i cili paska shtruar “drekë solemne” për Shaqir Fetain!

Takimet zyrtare dihet se si bëhen, dihet se ku bëhen, dihet se si duhet të vishen gjatë takimit zyrtar, dihen të gjitha rregullat protokollare. Ngrënia e përbashkët e “macasi kucasi” është, thjesht, një drekë e rëndomtë, e shtruar prej atij që i takon, për ta nderuar zemërgjersinë e Mbretit të vet, dhe jo se i bënë nder të veçantë Shaqir Fetait, për të cilin dinë në hollësi gjithçka, që nga koha kur spiunonte si student lëvizjet myslimane të Boshnjakëve e deri në momentin e kryerjes së tradhëtisë dhe komplotit në BFI!

Shaqir Fetai, rrugës qenka takuar edhe me një profesor të nderuar e shumë të madh në Mbretërinë e Arabisë Saudite! Shumë mirë!

Por, a është i ndërgjegjshëm Shaqir Fetai se kë ia ka nxjerrë përballë këtij profesori të nderuar? Me kë e ka takuar? Kush nga

delegacioni dinte gjuhën arabe për të komunikuar me këtë personalitet të respektuar në botën akademike arabe! I ç'nivelit akademik ishte delegacioni i tij! Po, ka plot me tituj dr. e mr., me tituj të blerë e të korrumpuar, me tituj të nxjerrë nga shërbimet sekrete e pa kurrfarë peshe intelektuale. Një grup injorantësh, diletantësh e hipokritësh, shoqërues të kryerrencit, Shaqir Fetait, takohen me një akademik të padiskutueshëm? Është ky takim “mbresëlënës”, siç pretendon Shaqir Fetai, apo është një ofendim i pacipë që i bëhet akademikut arab!

Dhe në fund, shpaloset tërë ajo rrenë e Shaqir Fetait, përmes së cilës dëshionte që t'i japë peshë “zyrtare” vetes dhe sahanëlëpirësve të tij. Pasi e kryejnë tavafin lamtumirës, shprehen: “Bashkërisht gjatë plotë 10 ditëve formuam një ambient vëllazërore dhe harmoni të veçantë duke filluar nga Rijadi, Xhedda, Medina dhe në fund në Qa'ben e bekuar në Mekë, ku kryem Umren, atë për të cilën edhe u nisëm në këtë rrugë të shenjtë.”!

Vetëm shikoni se si shprehet Shaqir Fetai, si ta rrëqethë tërë trupin me “kapacitetin intelektual” të vetin që të iriton deri në çmendri! Shaqir Fetai paska “formuar ambient”! Ambienti bëhet, krijohet, nuk formohet o Shaqir gunkshi!

Pra, fundi i fjalisë dëshmon se ky grup injorantësh paska marrur rrugë për në vndet e shenjta vetëm për ta kryer Umren dhe jo se paska pasur qëllim apo axhendë të ngritur paraprakisht. Të gjithë komplotistët Shaqir Fetai i merr me vete, duke planifikuar që t'ua paguaj tërë aranzhmanin (me paratë nga buxheti që krijohetn ga fitri dhe zeqati i myslimanëve të vendit), madje ka planifikuar që t'ua paguaj edhe mëditje për këto dhjetë ditë “aktivitet zyrtar”, vetëm sa për ta kryer Umren, sa për të veshur ihramin dhe për ta zhveshur atë, duke menduar se kësisoj, që të gjithë do të jenë të pastër si në çastin kur u lindën! Në këtë konstatim të shenjtë nuk duhet të dyshojë askush, por ama, çka nëse të njëjtit vazhdojnë për t'i bërë hizmet tradhëtisë, komplotit, vjedhjeve, rrenave, ngrëniës së vakëfit, shkatërrimit të mëtutjshëm të BFI-së? Apo, Shaqir Fetai edhe një herë ia ka mësyer që ta gënjejë Allahun e Gjithëdëshëm, porse, kësaj radhe, në këtë rrenë dhe mëkat dëshiron që mos të

jetë i vetmuar por të përfshijë një kastë të gjërë
bashkëmendimtarësh në komplot e tradhëti. Zoti qafën ua theftë!

<https://www.facebook.com/431725080239010/posts/4558872760857534/>

/1KlilLarg/10.01.2022

Kështu foli Shaqir Fetai (24)

Snobët kur nuk kanë se çfarë të thonë, kur kapen në zgripç të rrenës, ia fusin “nuk kemi kohë të flasim për të gjitha projektet tona për të ardhmen”! Kështu tha edhe Shaqir Fetai në intervistën e porositur në “TV Ikre”

Nga Faik Shahinbejlliu

4

I lutur nga pseudogazetari i BFI-së që për fund Shaqir Fetai të flasë shkurtimisht për projektet e vitit 2022 të BFI-së, ai do të shprehet se është kohë shumë e shkurtër që të përgjigjet për të gjitha projektet e ardhshme të BFI-së! Do me thënë, ai nuk e përcjell gazetarin, nuk e dëgjon por në plan ka të flasë atë që e do ai, atë që e kanë porositur dhe të thurrur me fijet e rrenave nga më banalet! Pseudogazetari e pyet për projektet e vitit 2022, ndërsa ai thotë se “nuk ka kohë të flasë për të gjitha projektet e ardhshme”! Tipike kjo e snobëve, e hipokritëve, e rrencakëve që ia mësyjnë shtegut që të nxjerr ga rrena e në maje të “bregut”!

Shaqir Fetai, si një ndër projektet kryesore për të ardhmen e BFI-së (Pse a Shaqir Fetai qenka projektuesi i ardhmërisë së BFI-së? Ruana Zot!) po e parashihkëka “stabilitetin ekonomik” të BFI-së, ndërsa në fillim të intervistës shpreh kënaqësinë që ka arritur ta stabilizojë financiarisht” këtë Institucion që e ka uzurpuar e që e ka shndërruar në “çajtove katudi”!

Shaqir Fetai ia mësynë biznesit i cili do ta stabilizojë BFI-në dhe, të mos varet më nga fitri dhe zeqati, (sepse e ka ndjerë në palë

urrejtjen dhe bojkotin e popullit) por, të krijojë biznes-qendra që do të gjenerojë financa për buxhetin e BFI-së!

Natyrisht, ky plan nuk është “shpëtim për BFI-në” por, thjesht, mundësi për korrupsion dhe përfitime personale, ngjashëm si në të kaluarën!

Për çfarë biznesi flet ky farë instalacioni politiko-partiak, me sugjerim të shërbimit intelektual serb, UDB-së, kur, një biznes të tillë e refuzoi derisa ishte myfti i Gostivarit! Biznes-qendra, projekti i së cilës u përurua me pompozitet idiotik, që do të financohej prej bankës islamike për zhvilli, kurrë nuk u ndërtua. Ndonëse gatishmëria ishte për një investim miliona dollarëshe, që do të ngelte si një burim i pashterrshëm për financat e BFI-së, Shaqir Fetai do ta refuzojë, gjegjësisht, do t’i iritojë financuesit, sepse, pa dyshim që prej tyre do të kërkojë përfitime personale. Arabët do të ikin ndërsa Shaqir Fetai do të ngelë pa kurrfarë “bisnesi”! Deri më sot nuk e ka thënë asnjë fjalë se pse u irituan arabët prej tij dhe BFI-ja ngeli pa një burim financiar të përhershëm!

Edhe vetë ai ka prezantuar në ceremoninë e hedhjes së gurëthemit të hotelit të BFI-së të ish-oborri i “Higjienës Komunale”! Është dashur që në afat prej tre vitesh të përfundojë ky projekt, të nisë të gjenerojë financa për BFI-në dhe pastaj, investitori në pronën Vakëf të BFI-së të nisë e të ndërtojë godina banimi për intresa të biznesit të vet! Godinat janë në përfundim e sipër, ndërsa për hotelin as që bëhet fjalë! A nuk është ky kontribut i Shaqir Fetait në dëmtim mizor të vakëfit dhe të financave të BFI-së?

Megjithatë, ky farë i pandershmi nuk harron që të falënderojë edhe diasporën tonë e cila po e kryeka vazhdimisht “detyrën dhe obligimin” duke kontribuar financiarisht në plotësimin e kërkesave të Rijasetit! Shaqir Fetai, ky “reis” i pacipë, pa fiej turpi ia takson diasporës kontributin financiar si detyrim, si obligim! Pra, sipas Shaqir Fetait rrogat e “rijasetit” qenkan detyrë dhe obligim i diasporës, shetitja e bythëve poshtë-lartë duke shpenzuar kot e kot para nga buxheti i krijuar nga fitrat e zeqati, qenkan detyrim dhe obligim i myslimanëve të vendit! Ata të japin si detyrim ndërsa Shaqir Fetai ta mbushë gushën e të vjedhë sa të mundet! Ky qenka detyrim islam! Kjo është hajni, eksploatim i pastër, është manipulim i Shaqir Fetait në emër të fesë. Këtë e di edhe Shaqir Fetai, e ka shumë të qartë se myslimanët e vendit nuk i kanë absolutisht kurrfarë detyrimi dhe as obligimi BFI-së së shndërruar

në filiale partiake e në sektor të shërbimeve intelegjente që nuk kanë asgjë të përbashkët me islamit dhe normat e tij! Ata “obligimin financiar” islam mund ta kryejnë edhe ndaj të varfërit, ndaj bonjakut, ndaj jetimit dhe jo ekskluzivisht që ta ndihmojnë Shaqir Fetain në “stabilitetin financiar” të BFI-së të cilën e paskan detyrim dhe obligim! “Emanet që ua paska dhënë Allahu”! Shaqir Fetai vetëm “emanet i Allahut” nuk mund të jetë, por, mbi të gjitha, imponim partiak i propozuar nga oficeri i tij i UDB-së, Stanko Dragoviqit, deri sa ky e rriste si evlad nën pseuonimin policor ORAO!

5.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/17.01.2022

Pasqyra e hipokritit

Shaqir Fetai paska dhënë një intervistë në revistën e tij album personal “Hëna e Re” dhe, këtë intervistë e paska zhvilluar me një “ekip gazetarësh”! Me demek, nuk ekziston gazetar që mund të zhvillojë intervistë me Shaqir Fetain, patjetër duhet të jetë “ekip gazetarësh”

Nga Jasir Jashari

Një “ekip gazetarësh” që intervistën e titullojnë me “URTËSIA DHE DURIMI NË VEPRIM JANË VIRTYTËSITË TONA”, dëshmojnë se kanë shkruar një intervistë sa për t’ia bërë qejfin Shaqir Fetait i cili edhe më tej po ngelë në anonimitet (ndryshe, nuk do t’ia gabonin emrin sa herë të përlitet në media)! Për cilën urtësi flet Shaqir Fetai? Për të tijën?! Tashmë e ka dëshmuar “urtësinë” e vet dhe, në tradhëti të ketë urtësi kjo as nuk është parë dhe as nuk është dëgjuar! Shaqir Fetai paska thënë “durim në veprim”?! Në veprim ka maturi, ka sinqeritet, ka ndershmëri e besnikëri, ndërsa durimi është fenomen i cili vie në shprehje para çdo veprimi! Durim do të thotë “sabër” o bilmeza!

Një intervistë e kurdisur, e porositur, një bashkëbisedim sa për mastrubim të trurit të tredhur, tepër shumë subjektive, që na del si një pasqyrë që pasqyron ekskluzivisht hipokritët e tipit të Shaqir Fetait! A guxon të fillojë intervista me Shaqir Fetain me pyetjen “Tashmë i bëtë afër një vit e gjysmë në krye të BFI të RMV. Cilat janë përshtypjet Tuaja si njeri i parë i një institucioni kaq të rëndësishëm?”, ndërkohë që hala nuk është përgjigjur në pyetjet e

popullit: cili ishte çmimi i tradhëtisë që ia bëri ish-reisit të vet?
Kush ia ofroi skenarin e tradhëtisë, pse e pranoi atë tradhëti? Çka fitoi nga ajo tradhëti! Sa kohë më parë e kishte bluar tradhëtinë?
Kush i dha sinjal për tradhëti, sepse, një javë më parë e kishte vlerësuar ish-reisin e vet si “figurë markante...”?

Çka pati nevojë Shaqir Fetai që të jetë “njeri i parë”, ndërkohë që gjithnjë ka qenë në krah të të parit? Çfarë pati nevojë Shaqir Fetai për ta rrëzuar të parin ndërkohë që gjithnjë ishte nën sqetullën e të parit? Pse paska pasur nevojë të jetë “i pari”, ndërkohë që reisi i tij kurrë nuk ka marrur vendime pa pëqilimin e Shaqir Fetait, madje edhe atëherë kur ky propozonte me këmbëngulje që t’i largojë nga puna miqte më të ndershëm të “reisit” që i kishin shërbyer edhe si parzmorë pa zhveshjen e së cilës Shaqir Fetai nuk mund t’ia ngulte thikën të parit të vet!

Shaqir Fetai intervistën e fillon duke e nxjerrë në pah një “vlerë” të tij: ai kurrë nuk po u ankuaka për diçka që nuk e arrinë! Dhe, sipas kësaj fraze (“budallain mos e vet se të kallzon vetë”) tashmë Shaqir Fetai e ka arritur atë që ka dashur, ndërsa tani duhet edhe të ankohet se, kush qenë ata që e detyruan në këtë arritje të turpshme! Të paktën të ankohet se pse e lanë instalacion në krye të BFI-së dhe nuk e viktimizuan duke e torturuar si “Krishtin të pafetë”! Sepse, Shaqir Fetai pa pak viktimizim nuk ka se si ta shpreh pafajësinë e tij në tradhëti!

Tutje, Shaqir Fetai thotë se në fillim paska qenë i frikësuar dhe se paska pritur turbllira të mëdha, porse, falë Zotit gjithçka i paska shkuar sikur të jetë hedhur në mjalt. A thua ku do të bie kur do t’i mbarojë mjalti?!

Natyrisht, Shaqir Fetai ka qenë shumë i vetëdijshëm për pasojat pas asaj tradhëtie, ka qenë shumë i vetëdijshëm se mund të ketë kundërreaksion pas atij veprimi antiislamik që e ndërmoi kundër reisit të tij dhe kundër traditës shekullore të BFI-së se kush mund të jetë në krye të saj! Nuk ishte zgjuarësi e Shaqir Fetait fakti që punët rrodhën qetësisht, porse, zgjuarësi ishte e atyreve që u tradhëtuan dhe që ndëshkimin për tradhëti e komplot ia lanë Vetë Zotit! Hakmarrja njerëzore do ta paraqiste Shaqir Fetain martir,

ndërsa hakmarrja nga Zoti – çka do ta paraqesë Shaqir Fetain?
Këtë më së miri e di Zoti i Madhërishëm! Mallkimi i Tij mund të
vonojë por, një gjë është e sigurtë – Ai kurrë nuk harron për ta
ndëshkuar të pabesin!

Në këtë “rrugëtim suksesi” Shaqir Fetai e paska pasur përkrahjen
e “bashkëpunëtorëve tanë”? Të kujt janë këta bashkëpunëtorë? Kush
janë “bashkëpunëtorët tanë”? Shaqir Fetai nuk është Institucion i
shërbimeve për të pasur bashkëpunëtorë! Shaqir Fetai këtë
rrugëtim e pati me bashkëpunëtorët e vet që vijnë nga e njëjta
guzhinë, nga të njëjtat kanale minjësh, sepse, ndryshe nuk do të
mund ta realizonin tradhëtinë dhe komplotin që ia bënë “babait” të
tyre, e që assesi nuk po ia dalin ta demantojnë faktin që ishin
mercenarë e mision anti-BFI!

Shaqir Fetai mendon se kjo “strategji” e tij paska dhënë rezultate
konkrete! Shaqir Fetai shantazhin policor, ndërsimin e shërbimeve
sekrete, obligimet dhe detyrat ndaj këtyre shërbimeve – të gjitha
këto marifetllëqe i paraqet si “strategji të veten”! Nuk ka strategji
në botë, nuk ka fuqi në botë, nuk ka plan në botë, nuk ka ideator
në botë që, brenda natës i mbedh bashkëpunëtorët për ta
ndërmarrur veprimin e puçit dhe të shantazhit. Këtë mund ta
bëjnë vetëm bashkëpunëtorët e shërbimeve të cilët, brenda një
sekondi i nënshtrohen urdhërit, madje nëse duhet edhe për ta
nërkëmbur edhe nderin familjar.

Shaqir Fetai e përfundon përgjigjen e parë duke thënë se puna e tij
qenka transparente! Si mund të jetë konspiraconi punë
transparente? Si mund të jetë transparente ikja nga pyetjet
objektive? Si mund të jetë transparente shmangia nga debati
ngjashëm siç ik djalli prej temjanit? Shaqir Fetai transparente e ka
vetëm rrenën, vetëlavdërimin, heshtjen para tradhëtisë dhe
errësimin e misionit të tij./In7/18.01.2022

Artikuluesi artistik i rrenës

Është prej mëkateve të mëdha që mos të reagoshë pas rrenës publike! Në një intervistë të botuar në albumin e vet personal, “Hëna e Re”, Shaqir Fetai, veç tjerash, flet edhe për “punët me prioritet” të tij me t’u instaluar partiakisht në krye të BFI-së

Nga Mr. Eset Shaqiri

Po cilat paskan qenë ato “punë me prioritet”?! Nuk ka asnjë punë! Sepse, aksioni politik për komplot dhe puç ishte aq i furishëm sa, si një tërmet fatal i cili as sot e kësaj dite nuk ofron mundësi për sanim të pasojave dhe për adresim të prioriteteve që i ka BFI-ja e Shaqir Fetait!

Nuk ka qenie e gjallë në Maqedoninë e Veriut që nuk e di se si rodhi procesi i instalimit të Shaqir Fetait në krye të BFI-së! Dhe, çuditërisht, “reisi” i instaluar dhunshëm na paska ardhur në kohën kur Kovid 19 e paska arritur kulmin e përhapjes së vet! Shaqir Fetai nuk paska pasur mundësi të mendojë në punë të tjera, sepse para vetes “paska pasur” masa që OBSH-ja i paska “nxjerrur” që ky ta luftojë pandeminë! A nuk është kjo një përpjekje qyqare e Shaqir Fetait për ta kamufluar paaftësinë e tij totale për t’i prirur një organizate aq të madhe siç është BFI-ja! A nuk është një përpjekje perfide e tij për ta fshehur revoltën e popullit dhe gatishmërinë unanime për ta bojkotuar një BFI të kontrolluar nga vegla të pushtetit anntiislam dhe nga militantët

partiakë! OSHB-ja e paska ngarkuar Shaqir Fetain me masa kundër epidemisë?! OSHB-ja dhe Shaqir Fetai! I sëmurë për t'i dhënë vetes peshë! Madje aq mirë i paska respektuar këto masa sa paska arritur që në botë të dëshmojë se cila është "fuqia ndikuese" e BFI-së?

Së pari, OSHB-ja ka rekomanduar masa për çdo ministri shëndetësore në botë, apo për çdo komision shtetëror të formuar enkas për ta luftuar përhapjen e kësaj pandemie! Tutje, Komisioni shtetëror me në krye ministrin e shëndetësisë, i ka ngarkuar të gjitha institucionet dhe organizatat e vendit që t'i zbatojnë ato rekomandime. Pra, BFI-ja, si të gjitha të tjerat, kanë qenë të obliguara që t'i zbatojnë rekomandimet e këtij Komisioni të cilat ishin të bazuara në rekomandimet e OBSH-së, dhe, së këndejmi, të pushojë Shaqir Fetai duke u lavdëruar lidhur me këtë pandemi, e cila desh e mbyti vetë atë kurse i mori jetë edhe bashkëmendimtarëve të vet! Asnjë nga komunitetet fetare në vend nuk ka raportuar se ka pasur nëpunës të infektuar apo të vdekur nga kjo pandemi. Në BFI-në e Shaqir Fetait ka vluar!

Së dyti, kur u instalua Shaqir Fetai, nuk ishte kulmi, por situata ishte zbutur, ndaj dhe u lejua falja e namazit në xhemat pasi, për herë të parë në historinë e myslimanëve të vendit, ishte ndaluar gati një vit më parë, kur epidemia po përhapej me përmasa shumë tragjike. Kur u instalua Shaqir Fetai në fuqi ishte falja e namazit në xhemat me distancë! Kontributi i Shaqir Fetait ishte zero, ndërkohë që kontributi paraprak ishte konkret! Ish-reisi i tij i kishte pranuar të gjitha masat e Komisionit shtetëror për menaxhim me këtë pandemi, ndërsa kishte nisur edhe aksionin e donimit të mijëra maskave për institucione të ndryshme të vendit. Ky po që është kontribut!

Së treti, nuk është e vërtetë se kjo pandemi e paskësh rrezikuar financiarisht BFI-në! Sepse, prezenca e përditshme e xhematit në xhami nuk gjeneron kurrfarë të ardhurash për BFI-në, të paktën nuk do të duhej! Ai u instalua në kohën kur fitri ishte paguar në BFI, por në masë të madhe edhe zeqati! Veç kësaj, ish-reisi i Shaqir Fetait, kishte këmbëngulur që edhe BFI-ja të përfshihej në

buxhetet shtetërore të krijuar për lehtësimin e krizave financiare si pasojë e pandemisë. Madje ishte kërcënuar me padëgjueshmëri qytetare, gjë që i kushtoi duke u eliminuar politikusit dhe zëvendësuar partiakisht me Shaqir Fetait! Në fund, përfillet se kërkesa e ish-reisit që të paguhen me rroga edhe imamët e vendit, u realizu duke u derdhur në xhirollogarinë e BFI-së së Shaqir Fetait mijëra euro, të cilat “efendiu” në fjalë i përdori për ta blerë pakënaqësinë reale duke ua ngritur rrogat disa strukturave të BFI-së. Veç kësaj, u realizu denacionalizimi i disa pronave të Vakëfit, të cilat, u këmbyen në letra me vlerë! Kjo ndikoi që buxheti në BFI të rritet dhe jo se pati ndonjë “aksion gjithëpopullor” për të shprehur kënaqësinë që u instalua në krye të BFI-së Shaqir Fetait. Një interpretim autentik i vakëfit do të konkludonte se sjellja e Shaqir Fetait në raport me Vakëfin është pa dyshim, sjellje e mëkatshme! Vakëfi nuk është lënë që një ditë ta tjetërsojë Shaqir Fetait, duke “e shitur” dhe duke krijuar buxhet për rroga! Vakëfi mund të tjetërsohet e të shitet, por ekskluzivisht për të siguruar të njëjtin vakëf apo edhe për ta shtuar! Të parët tanë nuk e lanë pasurinë e tyre që një ditë Shaqir Fetait të sigurojë rrogë të pamërituar për veten e tij dhe për bashkëmendimtarët e vet!

Shaqir Fetait duhet të jetë i sinqertë me bashkëpunëtorët e vet dhe i devotshëm para Allahut të Gjithëdijshëm! Feja nuk bëhet me para: nëse ka rroga ka fe, nëse nuk ka rroga, nuk ka fe! A ia arriti Shaqir Fetait t’i bindë të gjithë bashkëmendimtarët e vet, hoxhallarët e vendit, akademikët që, të japin kontributin maksimal të tyre, pa pagesë, për kultivimin dhe praktikimin e fesë së Zotit edhe në kohën kur gjenden para një sprove të madhe të Zotit Fuqiplotë! Shaqir Fetait kur ishte “profesor” në Medresenë Isa Beu” e di fare mirë se si vinin ndihmat popullore nga tërë vendi. Magazja e saj kurrë nuk ka qenë bosh! Mirëmbajtja e Mdresesë ka qenë ekskluzivisht “barrë” e popullit dhe jo e vakëfit, sepse kur ka nisur kjo vatër mësimore vakëfi ka qenë pothuajse i tëri i nacionalizuar dhe i uzurpuar! Tani, në kohën e Shaqir Fetait, duhet të vijnë letrat në vlerë nga vakëfi i tjetërsuar që të zhvillohet jeta fetare, pa pasur paraprakisht kurrfarë raporti publik mbi vlerën e këtyre

letrave me vlerë, me të vetmin qëllim që të zhduken gjurmët e korrupsionit, të vjedhjes dhe të tjetërsimit të vakëfit, nga një pasuri islame në rroga të bashkëmendimtarëve të Shaqir Fetait. Një ditë, gjithësesi që do të ketë përgjegjësi morale e penale për çdo centimetër të vakëfit të zhdukur e të shfarosur për të siguruar rroga! Dikush ka varfëruar familjen e vet duke e lënë pronën familjare në interes të islamit, ndërsa sot dikush e shet, e shndërron në rroga, e ha këtë pasuri islame për të kënaqur veten dhe familjen e tyre. Dhe këtë fakt mundohet ta fsheh si “ndërgjjesim të myslimanëve” që kontribuojnë financiarisht për të rritur rroga. Vetëm në BFI-në e Shaqir Ftait sigurohen rrogat duke dëmtuar pronën e përbashkët islame në vend!

Turp!/In7/19.01.2022

Vetëlavdërimi që del nga përroi i gënjeshtreve

Ajo që assesi nuk kapërdihet nga “bluarja” e Shaqir Fetait, janë rrenat e tij, përpjekjet e tij për ta “idealizuar” veten dhe për të plasuar gënjeshtren më të madhe: “gjithçka në BFI ka filluar me mua”! Thua kaq shumë të vuajë nga amnezia? Jo, ky është stil i njerëzve të shëndetshëm por që janë pa cipë

Nga Mr.Abaz Islami

Në një intervistë të Shaqir Fetait, të botuar si përpjekje për ta rekapituluar punën e BFI-së së tij për vitin 2021, veç të tjerash ai do të flasë edhe për “momentin” e hapjes së BFI-së ndaj botës! Përmes një pyetje të porositur e dalur në formatin “U vërejtën disa lëvizje edhe jashtë vendit, ku hapët rrugët e njoftimit dhe të bashkëpunimit me shumë vende fqinje dhe të botës në përgjithësi”, Shaqir Fetai në fakt insiston që të “institucionalizohet” rrena e tij se, deri në instalimin e tij politik në krye të BFI-së gjithçka paska qenë terr e skëterr për BFI-në!

Shaqir Fetai, do të përgjigjet: “E vërtetë. Një ndër synimet e platformës sonë ishte të hapen rrugët e bashkëpunimit me Bashkësitë Islame simotra në Ballkan, pastaj me Turqinë dhe me vendet e botës arabe”!!! Platformë e Shaqir Fetait që të hapë rrugë bashkëpunimi?! A e kupton ky farë bilmesi se çka do të thotë fjala platformë! Çka përfshinë, çka përmbanë brenda vetes një platformë! Po supozojmë se kjo paska qenë “platformë” e tij – për ta nxjerrë nga terri ku qenkësh plandosur ky Institucion! Ishte

përjetë në këtë terr, apo errësira e kaploi këto vite? Po ku ishte Shaqir Fetai më herët që nuk e tha asnjë fjalë! A është po ky Shaqir Fetai që, një javë para aksionit të puçit dhe komplotit, publikisht thurri elozhe nga më të palexuarat më herët për personalitetin e atij që e rriti dhe ky në fund ia nguli thikën!

Ky “konstatim” i Shaqir Fetait demantohet fare lehtë dhe pa kurrfarë respekti nga faktet që nuk mund të mohohen as prej tij dhe as prej kurkujt në botë! Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë së Veriut ka qenë Institucion lider në vend, në Ballkan e më gjërë! BFI-ja ka qenë e përfshirë në shumë konferenca ndërkombëtare, ka qenë anëtare e shumë konferencave ndërkombëtare; kryetari i saj ka qenë në poste drejtuese të këtyre konferencave ndërkombëtare. Ka qenë kooprative me të gjitha ambasadat dhe faktorët relevantë në vend, por dhe ka qenë e pakompromis në mbrotjen e pozitive, të të drejtave dhe të veprimeve të veta islame! Ka qenë kundërshtarja e denjë e të gjitha pushteteve të cilat kanë ngurruar që të respektojnë të drejtat e këtij Institucioni. BFI-ja ka pasur vendin e merituar në qarqet ndërkombëtare, është mirëpritur e është ndihmuar! Ka pasur vizionin e vet, programin e vet bazuar në një platformë që është zhvilluar mbi shtyllën “pa atdhe nuk ka fe dhe, anasjelltas” (sot Shaqir Fetai e përdor “pa iman s’ka vatan” me qëllim që ta kopjojë “tinëza” plaformën e reisit të vet!

Kjo BFI ka arritur që të sigurojë qindra kuota për studentët tanë nëpër universitete të ndryshme të qendrave islamike, ka arritur të sigurojë bursa të shumta për studentët tanë, ka arritur të sigurojë fonde të përjetshme për bursa studentëve tanë që dëshirojnë të studiojnë nëpër fakultete të ndryshme nëpër botë e në vend! Nga respekti i madh që ka pasur në botë, ka arritur të sigurojë edhe fonde vjetore (nga institucionet turke) prej një milion euro për shërim të rasteve të rënda që nuk mund të shërohen në vend! Të gjitha këto fakte, që kur u instalua dhunshëm në krye të BFI-së Shaqir Fetai, janë shuar, janë heshtur, janë refuzuar, sepse, Shaqir Fetai duhet ta shënojë “epokën e vet”!

Po çka bëri Shaqir Fetai brenda vitit që e lamë? U vizitua nga 13 ndërkombëtarë të ndryshëm! Realizoi 18 vizita nëpër institucione të ndryshme në vend e në botë (në Sarajevë, përfshirë këtu edhe dy vizita ambasadës së RMV-së në Kroaci (kushëririn e vet), si dhe tri ambasada të tjera të RMV-së – Sarjevë, Emirate të bashkuara Arabe dhe në Kajro)! Në kuadër të këtyre 18 vizitave janë përfshirë edhe ato që ia ka bërë FSHI-së, Medresesë (!!!) si dhe “Reisul ulema vizito Dr. Bajram ef. Ajetin”)! Ka vizituar Bashkësinë Islame të Kosovës me të cilën BFI ka marrëdhnie tradicionale dhe shumë të forta vëllazërore! Gjithashtu, së fundi, ka realizuar edhe Umren, respektivisht, vizitën vendeve të shenjta, për të gjithë “të varurit” dhe bashkëmendimtarët e vet! Shaqir Fetai ka organizuar 36 pritje të “haxhi babave” dhe të meraklinjëve të çajit të rusit, por, ka realizuar edhe 23 takime me funksionarë të vendit, prej të cilave nja 2-3 janë me funksionarë të shtetit dhe të gjitha të tjerat me funksionarë partiakë (të BDI-së)! Ja, këtë “hapje” e ka pasur Shaqir Fetai për vitin 2021!

Kurse, në vitin më të vështirë të BFI-së, më vitin 2015, vit ky kur disa nëpunës të BFI-së u ngritën dhe publikisht kërkuan reforma të thella në BFI, duke e detronizuar këtë institucion për shumë marifetllëqesh që po lëshonin rrënjë e që po krasiteshin edhe nga myftiu-Shaqir Fetai, si dhe duke mos pasur kurrfarë respekti për politikën e mbropshta që po përkraheshin edhe nga Shaqir Fetai, Bashkësia Islame është vizituar nga dhjetë personalitete botërore si dhe nga ambasadorë të ndryshëm në RMV. Ka realizuar katër vizita jasht vendit, katër pritje të badihavxhive që u pihet çaji në kabinet si dhe ka takuar tri herë funksionarë të shtetit. Nga ana tjetër, ka publikuar 24 punime dhe ka pasur 6 reagime të ashpra drejtuar institucioneve të ndryshme shtetërore.

Një vit më vonë, pra, më vitin 2016 reisi i atëhershëm në kabinetin e vet pret 12 personalitete dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, realizon shtatë vizita jasht vendit, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në Konferencën Islamike të Shurës Evropo-aziatike. Realizon vetëm një takim çaji dhe tri takime

me personalitete të jetës politike në vend. Publikon 14 punime, të natyrave të ndryshme! Natyrisht, institucioneve shtetërore i kundërvihet me katër reagime të ashpra.

Nëse analizojmë edhe vitin 2017, atëherë konstatojmë se ky vit i përlligj të gjitha ato “vetëlavdërime” të Shaqir Fetait, i cili në mënyrë naive mendon se BFI-ja fillon me të! Më vitin 2017 kabineti i ish-reisit vizitohet 25 herë prej personaiteteve të ndryshëm kombëtar e ndërkombëtar. Po kaq herë, pra, plotë 25 herë ish-reisi realizon takime e vizita të ndryshme nëpër botë. Nëntë herë ka ngritur zërin publikisht kundër padrejtësive qoftë institucionale shtetërore apo kundër lojërav antiislame që janë luajtur në vend. Natyrisht, ka pritur edhe meraklinjë të çajit (katër sish), kurse ka publikuar 9 punime autoriale. Ka realizuar edhe 7 takime me krerët institucional shtetëror apo partiak!

Peshën, rolin dhe rëndësinë e BFI-së në këtë periudhë historike post-komuniste nuk mund ta fshijë e ta minimizojë askush, madje as Shaqir Fetai i cili edhe mund ta ketë mision! Një njeri i ndershem, një mysliman i sinqertë, një person i pa hile, një “nëpunës shekullor” i BFI-së, në asnjë mënyrë nuk do të pranonte t’i përgjigjej një pyetje tendencioze pa i reaguaz gazetarit duke ia bërë me dije që nuk do të provokohet nga pyetjet e tilla idiotike! Shaqir Fetai rrafall përgjigjet në pyetjen e shpifur “Menjëherë me ardhjen Tuaj, selia e Bashkësisë Fetare Islame u vërshua nga vizitorë të vendit dhe nga jashtë. Si e komentoni këtë”? I esulli në tru do të thoshte se vizitat ishin në vazhdën e atyre vizitave tradicionale (nëse jo edhe më pak, sepse Shaqir Fetai nuk pranohet si i zgjedhur por i imponuar nga qarqet politiko-partiake!) të miqve e të atyreve që kanë respekt për BFI-në e që janë shquar si miq të Institucionit tonë. Me këtë pyetje të porositur dhe me përgjigjen tendencioze, ai sikur dëshiron të thotë se, ndonëse i instalur, gjeti përkrahje nga vendi e nga jashtë! Nëse është në këtë logjikë, kjo po që ka kuptim. Por ama nëse ai mendon se me ardhjen e tij u bë kombëtarëzimi dhe ndërkombëtarëzimi i BFI-së, kjo nuk ka kuptim sepse fund e krye është RRENË!

Pa dyshim, nuk ka fuqi që mund ta mohojë një realitet: viti që e lamë pas, për BFI-në shënon një ngjarje më të turpshme që ka mundur t'i ndodhë këtij institucioni: shënon epokën pos-puçit klasik dhe komplotit tradhëtues, dukuri këto që nuk kanë ndodhur në asnjë vit të funksionimit të BFI-së përgjatë historisë së vet mbi gjashtëqindvjeçare! Për herë të parë kemi të mbjellë një “reis” politiko-partiak, rast ky që i zvetënon të gjitha “aktivitetet” të gjitha “sukseset” dhe të gjitha “zhvillimet” islame të këtij Institucioni! Nga viti 2015 e deri më vitin 2020 ish-reisi i Shaqir Fetait nuk ka arritur të realizojë takime me funksionarë shtërorë e pariakë sa ka arritur ky farë “reisi” aktual brenda vitit që e lamë! Nuk i janë dashur për asgjë përveçse të sigurojë përkrahje nga ata që e instaluan në krye të BFI-së dhe mos të ndjehet i braktisur e i tradhëtuar! Ai që tradhëton gjithësesi që një ditë do të tradhëtohet edhe vetë! /TetovaSot/20.05.2022

Show i dy krye-hipokritëve “fetarë”

I nderuar dhe me fat paska qenë Shaqir Fetai për vizitën që ia paska bërë një delegacion nga BIK me në krye Kryemuftiun Naim Tërnavë! Se ç’nder e ç’fat sjell kjo vizitë, këtë mund ta dinë vetëm këta dy fuksa që “motivohen” për “vizita hutuese” nga një qendër e përbashkët me seli mbase në Beograd

Nga Valdrin Foniqi

Në momentin kur para një mediumi të favorizuar deri në bezdi nga Shaqir Fetai, para një mediumi lokal por që ia mbanë “ison”-n e tradhëtisë Shaqir Fetait, para një mediumi që shërben për absorbim të jashtëqitjes “intelektuale” të Shaqir Fetait, pra në momentin kur ky, si një nuse e përdalë kur mundohet të shes moral, nisë dhe na e prezanton njeriun me të cilin paska pasur “fat e nder” të bashkëbisedojë – mysafirët ia bën emrin dhe titullin tërkuzë! “U vizitova nga delegacioni më i lartë i Bashkësisë Islame të Kosovës, në krye me, apo (apo më mirë me thënë – shprehje kjo e ish-reisit të tij), i udhëhequr nga eminenca e tij, kryetari i BIK, myftiu magjistër Naim efendi Tërnavë”! Duke u munduar që buzët t’i dalin sa më të ngrehur e më të hekurosur, i shkreti harron (apo edhe qëllimisht e nënçmon kur dihet cinizmi katundaresk i Shaqir Fetait!) se, Naim Tërnavë është Kryemyfti i Bashkësisë Islame të Kosovës! Ky është titulli i tij dhe, për këtë periudhë që kur e ka uzurpuar dhunshëm karrigen e “reisit”, ky vazhdimisht ua ngatërron titujt mysafirëve të vet!
Shaqir Fetai do të jetë shumë i lumtur sepse tashmë ka një

“bashkëveprimtar” institucional

Shaqir Fetai ishte ndjerë shumë i lumtur nga ky takim, sepse paskësh qenë “një takim shumë serioz, shumë konstruktiv”! I bie që të gjithë takimet e tjera me të njëjtat figura Shaqir Fetain nuk e kanë bërë të lumtur, sepse nuk kanë qenë seriozë dhe konstruktivë! Shaqir Fetai, në fakt, ka vetëm një arsye se pse ka qenë kaq i lumtur nga kjo vizitë e Tërnavës: mbase për herë të parë Tërnavës i thonë oficerët e UDB-së që të shkojë dhe ta takojë “homologun” e vet në BFI të RMV-së të instaluar nga ata! Tani i bie që, Shaqir Fetai duhet të lumturohet sepse nuk është vetë, shërbimet nëntokësore kujdesen për “vëllain Siamez” të tij! Shaqir Fetai pretendon se ia paskan arritur që të merren vesh që tash e tutje bashkarisht të bëjnë projekte për ta shpjeguar islamin autokton (!!!) në trojet shqiptare, në Ballkan dhe më gjërë! A nuk ju duket një pretenciozitet i sëmurë, një përpjekje për ta instrumentalizuar islamin në duar të UDB-së, si dhe për të nënçmuar teologët e viseve të tjera të trojeve shqiptare, të Ballkanit dhe më gjërë? Po si mund të bëhet shpjegimi i slamit në sfera të ndryshme (!!!) nga personat në BFI të cilët në fakt përfaqësojnë injorancën por edhe ideologjinë vehabiste e gjyleniste! Kujt do t’ia hedhë Shaqir Fetai, kur nuk ka mysliman në Maqedoni që nuk e di se BFI-ja është çerdhe e vehabistëve, e gjylenistëve, e puçistëve dhe e udbashçiqëve! Për herë të parë, Shaqir Fetai, paska bindjen se ky bashkëpunim do të jetë për të mirën e islamit dhe të shqiptarëve! Po bashkëpunimi i Naim Tërnavës me strukturat e më hershme të BFI-së a nuk ka qenë për të mirën e islamit dhe të shqiptarëve? Sipas të gjitha gjasave jo, sepse Naim Tërnavë në fjalimin e vet të thatë dhe formal, nuk do ta përlligjë këtë konstatim idiotik të Shaqir Fetait. A ka ndonjë këshilltarë aty brenda BFI-së që ta korrigojë Shawir Fetain me qëllim që, të paktën, mos të dalë si i frymëzuar nga qendra dirigjuese të tij! “Emanet” është nocion sllav që e degradon nocionin shqiptar AMANET që në fjalorin tonë përdoret si turqizëm. Nuk ka nevojë që turqizmat t’i sllavizojmë! Nuk ka nevojë që aq aq të dalë Shaqir Fetai si i “përgatitur” nga “qeniet nëntokësore beogradase” për mënyrën dhe diskutimin që duhet ta shpreh para tek-mikrofonit të katundit të vet të paguar nga fitri dhe zeqati i myslimanëve të Maqedonisë! Sërish, në fund të fjalimit të vet, duduku Shaqir Fetai, e falënderon (duke e nënçmuar) “Mytiun e BIK Naim Tërnavën” për mundësinë që ia dha që ta përjetojë kënaqësinë me këtë vizitë! Çfarë

perversiteti i pederakatë e çfarë turpi! Çfarë je, çfarë ndjehesh atë interpretim do ta formuloshë!

E ka një shtëpi Naim Tërnavë ne Shkup, konkretisht, në Sulare të Epërme

Po Naim Tërnavë?! A nuk i vie turp që të takohet me një udbash? Të paktën, për hirë të mendimtarit më të madh islam në Kosovë dhe më gjërë, të madhit Prof. Nexhat Ibrahimimi i cili ka vuajtur aq shumë nga spiunimi i Shaqir Fetait deri sa kanë qenë studentë në Fakultetin Teologjik të Sarajevës, duhet të heqë dorë nga “përputhjet e pederasta” me Shaqir Fetain (shih në fund të shkrimit doc. nga UDB-ja!)

A nuk ka me kë të bashkëpunojë Naim Tërnavë, apo, ky është i njëjti sugjerim e dirigjim nga i cili drejtohet edhe Shaqir Fetai! A do të thotë kjo se edhe BIK-un gradualisht po e fut në dorë UDB-a serbe, me qëllim që të përhapë mjegull në mesin e Shqiptarëve të trevave jashtë shtetit amë! Asgjë nuk ka të keqe në deklaratën e singertë: erdhëm në Shkup për një drekë të begatë! Apo, duhet “takimi” sa për t’i arsyetuar shpenzimet dhe mëditjet! Çka janë këto nevoja për të hënger mish në Maqedoninë e Veriut ku e përgatisin shumë të mirë! Kjo vizitë e Tërnavës ishte ekskluzivisht për ta çuar në vend porosinë e “qendrës” si dhe për t’u llullur me mish, edhe atë me një delegacion sa më të madh, dhjetra persona, sepse BFI ka para nga Vakëfi i shitur prej të cilit do ta mbulojë një drekë për “Vëllain Siamez”! Por, ja që për këtë mish duhet t’i jepet përkrahje “insitucionale” fuksit, Shaqir Fetait që aq shumë ka nevojë që të “kombëtarizohet”!

“Bismilahi rrahmani rrahim” – e drejt e në rrenë, në hipokrizi!

Naim Tërnavë thotë se sa herë që vjen në Shkup ndjehet i relaksuar, ndjehet si në familjen e vet, si në shtëpi! Në fakt Naim Tërnavë ndjehet rehat sepse e realizon detyrën e marrur: institucionalizim dhe verifikim të tradhëtisë dhe komplotit të Shaqir Fetait, ndjehet i përmbushur sepse shpreh një përkrahje, një solidarizim dhe një mbështetje ndaj “instrumentave nëntokësore” politko-partiake që e instaluan Shaqir Fetain në krye të BFI-së! Tani më e ka një bashkëpunëtorë që mund t’i lidhë i njëjti “mision” – për t’iu pirë bashkësive fetare të mbushura plotë me detyra e me angazhime nga guzhinat serbe!

Pse rrenë Naim Tërnavë se paska ardhur në familjen e vet, në shtëpinë e vet! Dihet se ku e ka “konakun” Naim Tërnavë, dihet se ku e streohi kokën kur u dëbua nga forcat paramilitare serbe!

Naim Tërnavë na del bukëshkalë dhe njeri hipokrit, që rrenë kur thotë se jam në “shtëpinë time”! Naim Tërnavë e di fort mirë se çka ka bërë për të ish-reisul ulema H. Sulejman ef. Rexhepi! Naim Tërnavë kurrë nuk e nxori një kokërr loti nga trishtimi se çfarë i bëri “bashkëpunëtori” i tij më i ngushtë, Shaqir Fetaj! Naim Tërnavë nuk harron që ta shpreh edhe epitelin “ekipi i mrekullueshëm që ka Shaqir Fetaj”! Për cilin ekip e ka fjalën? Për këtë ekip i dalur nga shërbimi inteligjent serb-maqedonas? Për këtë ekip i cili pati guxim që t’ia ngulë thikën pas shpine bartësit dhe ideatorit të projekteve kombëtare e fetare, H. Sulejman ef. Rexhepi, tek i cili Naim Tërnavë gjeti strehën dhe hapi zyren e BIK të Kosovës, në ekzil!

Po pse Naim Tërnavë nuk e shfrytëzoi këtë vizitë për ta përqaftuar edhe vëllin e tij i cili diti t’i japë peshë “personaliteti” të kryemyftiut të Kosovës! Pse nuk i shkoi në shtëpi, në Sullare, dhe të puthë pragun ku bashkë me familjn e vet gjeti shpëtim, ngrohje familjare dhe dashuri vëllazërore! Çka e lidhë Naim Tërnavën me Shaqir Fetajn, para të cilit dridhet nga frika dhe ia realizon ultimatumin që mos të kontaktojë, qoftë edhe për një vizitë të një plaku, “të plagosurin” nga Shaqir Fetaj! Mos ia ka ndalur edhe Naim Tërnavës UDB-a që ta kontaktojë e ta takojë H. Sulejman Rexhepin, sepse ky distancim nuk ka shpjegim as islam, as kombëtar dhe as njerëzor! Apo Naim Tërnavë nuk e bën këtë gabim sepse, pastaj, kush do t’ia paguajë dreka e darkat nëpër Shkup, sa herë që atij t’i dojë b...

Qenkan marrur vesh...

Çka? Asgjë! Sepse vizitat me pretendime për të arritur marrëveshje realizohen duke nxjerrë në tavolinë projekte konkrete! Duke i nënshkruar ato! Duke formuar komisione për jetësimin e atyre projekteve për të cilat ka dakortësi paraprake!

Naim Tërnavë dhe Shaqir Fetaj, tamam si dy hipokritë të frymëzuar e të kurdisur, qenkan marrur vesh për:

- “Ta forcojnë bashkëpunimin të dy bashkësitë simotra”! Çështë e vërteta, deri më sot, bashkëpunimi i këtyre dy bashkësive ka qenë ZERO, me përjashtim të bashkëpunimit në shkoqje të mishit nëpër dreka e darka, gjithnjë me paratë e myslimanëve të ngratë! Tani, u ngelë se qenkan marrur vesh që këtë zero bashkëpunim ta forcojnë edhe më tej, ë! Natyrisht, strategji kjo e UDB-së;
- “Vazhdimi i realizimit të projekteve në sferën e botimit të veprave të ndryshme, si dhe Revista e përbashkët nga tri Bashkësitë

Fetare: e Maqedonisë së Veriut, e Shqipërisë dhe Kosovës"! Kjo ide ka qenë e nxitur dhe e motivuar ekskluzivisht nga ana e ish-reisul ulemasë H. Sulejman ef. Rexhepit, madje ai ka pasur edhe projekte konkrete se si të jetësohen këto ide, por që gjithnjë kanë hasur në refuzim nga ana e BIK-ut me arsyetim se "nuk kanë para"! Do të ishte korrekte dhe me plotë mirënjohje sikur të thuhej "ta shtyjmë përpara projektin e H. Sulejman ef. Rexhepit"! H. Sulejman f. Rexhepi madje shkante edhe një hap më tej: këto projekte nga sfera e botimeve mund të realizohen vetëm pasi të bëjmë një redaksi, një zyre të përbashkët me seli në Tiranë dhe me buxhet prej të tri komuniteteve islame të vendeve përkatëse! "Marrëveshja" e Shaqir Fetait dhe Naim Tërnavës del që është vetëm "ide fiktive" sa për të arritur deri te ndonjë zhvatje apo shpëlarje parashë! Asgjë të shëndetshme, as kombëtare e as fetare, nuk ka në këtë "marreveshje" të dyshes që paskan "dashuri" aq shumë në mes vete;

- "Organizimi i paneleve, simpoziumeve, konferencave të ndryshme si dhe gara të Kur'anit Famëlartë dhe organizime të ndryshme"! Asgjë konkrete! Thjesht, sa për të hedhur diçka në letër e cila do t'i justifikonte harxhimet dhe mëditjet për aktivitete të kota;
- "Vizita të ndërsjella të imamëve në territoret e Bashkësive Islame me ligjërues të njohur;"! Do me thënë instrumentalizim të hoxhallarëve, të cilët, tash e tutje nuk mund të këmbëjnë vizita vëllazërore në mes vete pa lejen e institucioneve respektive! Asnjë hoxhë nuk mund të vie nga Kosova në vizitë te kolegu i vet, i cili, për ta respektuar e nderuar mund t'ia japë fjalën për ndonjë vaz apo shpjegim në xhaminë e vet! Nuk mundet sepse nuk e ka lejen e "sulltan" Naim Tërnavës, apo anasjelltas, nuk e ka lejen e udbashqiqit, Shaqir Fetait, i cili dëshiron të jete besnik dhe shumë korrekt ndaj "guzhinave" që ia mbushin barkun prej liliputi!
- "Këmbimi i përvojave të ndërsjella rreth organizimit të Haxhit dhe projektit të kurbanëve"! Thjesht, të koordinohen në format sa më të përkryera të vjedhjes nga Haxhi si dhe të shoqërohet Naim Tërnavë në blerjen dhe therrjen e kurbanëve nëpër Hungari, Çeki-Slllovakia, Rumani apo diku nëpër Rusi;
- "Kultivimi edhe më i shëndoshë i doktrinës burimore islame me qëllim të evitimit të synimeve eventuale të radikalizmave të llojeve të ndryshme"! Dy komunitete me plotë vehabistë, me plotë "ideologë", me plotë ekstremistë, anarkistë, puçistë e tadhëtarë të shpjegojnë "doktrinën burimore islame"! Krejt bota islame do të

mblidheshin bashkë dhe do t'i shpërblenin me nga 10 milion dollarë, si Naim Tërnavën ashtu edhe Shaqir Fetain, vetëm e vetëm që ta zbërthenin në tri fjali “doktrinën” islame! Pra, këta dy janë për doktrinarizëm, lëvizje kjo shumë e rrezikshme, e pëlqyer dhe sponsorizuar ekskluzivisht nga armiqtë e islamit;

- “Përpyetje maksimale të shpjegimit islam konform rrjedhave të kohës me qëllim të një prezantimi të shëndoshë dhe të pastër të Islamit në trevat tona.” Qëllimi i kësaj përpyetje dyshe qenka që të prezantojnë një islam të shëndoshë dhe të pastër në trevat tona! Euroke! Na shpëtoi Zoti! Falë këtyre dy hipokritëve në vendin tonë do të nisë një islam i pastër dhe i shëndoshë, sepse, ky që është zhvilluar deri më sot paska qenë “i sëmurë dhe i papastër”! Fali o Zot, sepse ata nuk dinë se ç’thonë, ose, theu qafën, sepse kanë hyrë në projekte shumë të poshtra antikombëtare (sepse fetare nuk ka asgjë këtu!)

- “Vizita të ndërsjella të objekteve fetare të njohura dhe atraktive në të dy vendet, bashkësive”! Pa dyshim, kjo është një pikë e “marrëveshjes” e cila flet se që të dy “liderët fetarë” janë të sëmurë për mend! Tani, edhe vizitat e objekteve fetare do të duhet të jenë “të instrumentalizuara”! Apo, në mendje e kanë “turizmin fetar” por që nuk ia kanë haberin se si projektohet dhe si reaizohet ai! Nuk guxon asnjëra palë t’i vizitojë objektet me rëndësi të veçanta pa pasur leje prej njërit apo tjetrit “reis”! A bën që të dy të shkojnë në ...! /Lajme7/21.01.2021

Kështu foli Shaqir Fetai (25)

Shaqir Fetai përveç që ka shumë qejf të vizitohet e të pritët nëpër ndeja të kota, ia ka ënda shumë që të jetë prezent edhe nëpër xhami ku ka fëmijë! Përmes vizitave dhe ftesave për ndeja të kota ai mendon se mund të dëshmojë se sa shumë duhet, përkundër faktit që është fuks e tradhëtarë dhe, në rastin e dytë, vetëm nga fëmijët mund të gëzojë ndonjë “respekt” sepse vetëm ata nuk e dinë që Shaqir Fetai është fuks e tradhëtarë

Nga Faik Shahinbejlliu

A ia keni parë statuset Shaqir Fetait në fb?! Tipike si raportet policore, raportet spiuneske që kishin format të caktuar se si duhet të raportohet! Nuk e përfundon “informacionin policor” pa treguar se me kë po shoqërohej dertisa e dëgjoji apo i tha “mysafirit”! Është “deformim profesional” ky por, mund të jetë edhe detyrë bashkëkohore: duke qenë korrekt me informacionin, duhet të ofrohet raport sa më “gjithëpërfshirës”! Ujku qimen e nërron por zanatin jo!

1.

Shaqir Fetai e paska pritur në vizitë Drejtorin e Fondacionit turk “Maarif” në RMV, z. Mehmet Baran, prej të cilit në hollësi qenka njohtuar rreth Fondacionit dhe mbi synimet e tij, “sidomos në

sferën e arsimit”, na njofton “radio-Shaqiri” (pandam i radio-Milevës së dikurshme)!

Edhe Shaqir Fetai, ky instalacion politik i qarqeve antiislame e antishqiptare në krye të BFI-së, e paska njohtuar mysafirin me “synimet e BFI në RMV”? Po cilat na qenkan ato synime?! Synimet e “subjektit juridik” janë po ato që ngërthehen në programin e të parit! Në rastin konkret, BFI-ja është pa kurrfarë synimi, sepse “drejtohet” nga një diletant e snob i cili as që di se çka është dhe si duket programi!

Nëse ia lë “subjektit juridik” që të drejtojë synime, atëherë, çka nëse synim i BFI në RMV të jetë çlirimi sa më i shpejtë nga zgjedhat e linçuesve, puçistëve dhe komplotistëve pa kurrfarë dinjiteti! Dhe, pa dyshim, si Zoti që është Një, synim parësor i BFI-së, si Institucion fetar, është që sa më parë ta dëbojë qenien e pistë që e ka uzurpuar, duke ia vënë dyzgjinat që çojnë vetëm në drejtimin e tij të paracaktuar që përfundon në komprometim, në degradim dhe shkatërrim total të këtij Institucioni të planifikuar guzhinave të huaja, “synim” ky që është zotuar Shaqir Fetai se do ta zatojë me “përpikmëri”!

2.

Pasi Shaqir Fetai e paska marrur edhe dozën e tretë të vaksinës (ndërsa nuk tregon nëse i ka shkuar fena zhag), na thotë se me drejtorin e spitalit të Gostivarit paska biseduar mbi shumë çështje të rrjedhave aktuale!

Le të na i numërojë Shaqir Fetai vetëm tri rrjedha aktuale! Ku di Shaqir Fetai se kush janë rrjedhat aktuale, cilat rrjedha janë më aktuale! Pra, ky farë duduki nuk i di rrjedhat aktuale e lëre më të dijë se cilat janë çështjet e rrjedhave aktuale për të cilat duhet të bisedojë ai! Sot, në BFI, nuk ka rrjedhë më aktuale se sa degradimi i këtij Institucioni deri në çerdhe spiunësh, tradhëtarësh e komplotistësh! A e di këtë fakt Shaqir Fetai? Rrjedhë tjetër është angazhimi i disa strukturave për ta spostuar sa më shpejt në breg të plehut, aty ku e ka vendin! Rrjedhë tjetër aktuale në kuadër të BFI-së është procesi i vëhabizimit dhe turqizimit të BFI-së, me qëllim për ta zvenitur dhe varrosur tërë atë të kaluar fetare e kombëtare të BFI-së post-komuniste!

Shaqir Fetai nuk i llogarit për rrjedha këto fakte, ai mendon se

“rrjedha” janë vetëm tundimet politike të partive që e instaluan dhunshëm në krye të BFI-së.

3.

Këtë fundjavë, Shaqir Fetai paska prezantuar në xhami, me rastin e dua hatmeve të fëmijëve të fshatit Strimnicë dhe në xhaminë “Turi Sina” në Gostivar. Shaqir Fetai thotë se në ceremoni të tilla ndjenë kënaqësi! Gënjënë, sepse, ai në fakt futet nëpër “programe” të tilla vetëm e vetëm sa për t’i njollosur, sa për t’ua minimizuar dhe nëpërkëmbur dinjitetin dhe personalitetin xhematit, sidomos lexuesve të Kuranit Madhështor. “Orao” në xhami, ky fuks i UDB-së sllave, është ngjashëm sikur “udbashqiqët” e viteve të fundit të mbretërisë serbe kur kërkonin konflikt të përgjakur me shqiptarët myslimanë. Çka bënin ata? Në bazë të rrëfimit të mexhllisit të xhematit dhe raportimit të Drejtorisë së Vakëfit të Prishtinës, në mesnatën e 8 dhe 9 janarit të vitit 1939, një bandë e panjohur e shumë të rinjve, duke i këputur shufrat e hekurta të dritareve, është futur brenda dhe e ka shkatëruar tërësisht xhaminë. Veç kësaj, në mihrab kanë vënë turirin e derrit të sapotherrur. Mynafiku, tradhëtari, spiuni, hipokriti, në xhami, është i po të njëjtit rang me “derrin në mihrab”!

Prandaj, Shaqir Fetai e di fare mirë se kush është ai në të vërtetë! Një “hafëz” që pranon të futet në skema nëntokësore, të spiunojë, të tradhëtojë, ta eliminojë nga skena njeriun që një jetë të tërë e mbajti në tepe të kokës, duke e ngritur lart e më lart me lavde e me pozicione të pamerituara! Tani ky njeri, me këtë “bagazh fetar” të futet në mesin e nxënësve plotë entuziazëm për ta mësuar islamin burimor? A nuk është ky nënçmim që i bëhet që në start këtyre fëmijëve?! Mynafiku e hipokriti në mesin e nxënësve që mësojnë ta lexojnë mirë e këndshëm Kuranin! Ai mbase mundohet të shfajësohet përmes këtyre fëmijëve të pastër e të çiltër, por ama, ai një gjë e ka të sigurtë: në hoistorinë kombëtare dhe të vetë Institucionit – BFI-së, do të ngelë si qenia më e pistë i cili një herë e në një kohë u mundua që ta mashtrojë Zotin dhe myslimanët e vendit me “reisllëkun e merituar” të tij! Ky është synimi i tij, ndërsa, në çdo paraqitje të tij Zoti gjithnjë e më shumë ia shpalosë shpirtin e zi duke e diskredituar rënd para të devotshmëve. Këtë nuk e heton Shaqir Fetai, sepse nuk është mision i tij që të ndjehet keq, misioni i tij është që ta “deh” xhematin me “devotshmërinë” e

tij dhe ta vjelë sa të mundet. Sikur Shaqir Fetai të mbante “marëdhënie të ngushta” me Zotin, ai deri më sot do të çmendej nga vaji e trishtimi për tradhëtinë e bërë si dhe për pranimin e urdhërave që t’u shërbejë strukturave nëntokësore që e kanë pasur ëndërr atë situatë që e shkaktoi përmes tradhëtisë Shaqir Fetai në BFI, që nga 27 maji i motit 2020 e këndej!

4.

Shaqir Fetai, mu në mesin e xhematit gostivaras, tha: “xhamitë janë rruga më e mirë për zhvillimin dhe prezantimin e Islamit nga fëmijët”! A nuk është kjo fjali djallëzore përmes së cillës Zoti Fuqiplotë ia këputë boshtin kurrizor Shaqir Fetait! Islami duhet të prezantohet nga fëmijët? Jo nga hoxhallarët, jo nga teologët por nga fëmijët, të cilët duhet t’i marrin në duart të tyre xhamitë! Po pse kjo mendje e djallëzuar e Shaqir Fetait, a? Nuk i bëjnë punët me hoxhallarë e teologë a! U kërcënohet me fëmijët, me shtresën më të pafajshme në tërë atë lojë të pistë ku është zhytur Shaqir Fetai, në atë lojë të cilën nuk dinë dhe nuk munden t’ia lexojnë vetëm fëmijët!

Shaqir Fetai, sa herë bie në trans nga turpi që po i rri si kryq mbi shpinë, nuk është në vetëdije se çfarë fletë e çfarë thotë! Sepse, realisht i dhemb tradhëtia që e ka bërë, i dhemb spiunimi që e ushtron i dhemb trishtimi në të cilin është mbërthyer.

Mes tjerash, Shaqir Fetai tha: “Islami në kohën aktuale ka nevojë për aktualitetin e kohës”! A nuk ju duket edhe kjo fjali e djallëzuar, si shenjë që ai në çdo hap, në çdo vend, në çdo veprim, bart mallkimin e Zotit! I mallkuari nuk mund të jetë i mbrojtur nga njollosja që ia bën vetëvetes! Islami në kohën aktuale paska nevojë për aktualitetin e kohës! Po cili është aktualiteti i kohës për të cilën paska nevojë islami në kohën aktuale?! Ja, po ia numërojmë disa Shaqir Fetait! Aktualiteti i kohës përbëhet prej luftrave, maskarave, akteve terroriste, përpjekjeve okupuese, kompleteve të rënda, prej drogës, prej prostitucionit, prej krimin, prej politikave antiislame, prej prodhimit sintetik e organik të votuseve, prej raketave shkatërruese, prej gjakimit të sumurë për gjakderdhje, për shtypje, për eksploatim, për thithje gjaku etj. etj. Për cilat nga këto dukuri aktuale të kohës ka nevojë Islami, o pis, o analfabet që qëllimisht i bënë këto “gafa”! Shaqir Fetai asgjë nuk thotë pa pasur synimin që është i projektuar nga nëntoka prej nga ka dalur ai!

Prandaj thuhet dhe konkludohet se Shaqir Fetai është jashtëzakonisht njeri i ligë, se duhet të merret me rezervë çdo paraqitje e tij dhe se duhet të evitohet sa më shumë të jetë e mundur nga takimet publike! Sepse, është i xhindosur, i djallëzuar, i perfeksionuar në mynafikllëk e në hipokrizi!

5.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/24.01.2022

Frikacakët e Rijasetit

Se, Institucionin tonë të vetëm fetar, BFI-në, e ka kapluar një mjegull e trishtueshme, që nuk të lejon të shohësh as brenda dhe e as përtej “Institucionit”, kjo tashmë nuk ka asnjë dyshim! BFI-ja jeton në mjegull dhe përhap mjegull! Shpëtimi nga kjo situatë e mjerë është vetëm debati publik, sqarimi para opinionit i gjithçkafit që ka ndodhur e që po ndodhë! E kemi shumë të lehtë të dalim para opinionit! Si do të dalim para Zotit?

Nga Mulla Nazmi Jashari

Deri para dy viteve, opinionin “bombardohej” nga kritikantët opozitarë kundër mënyrës së organizimit dhe funksionimit të BFI-së! Ish-reisul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi nuk kishte ditë që nuk kritikohesh. Çuditërisht, ndonëse ishte i rrethuar me shumë “miq” asnjëherë nuk ngriti zërin asnjëri për ta mbrojtur nga kritikantët sa të arsyeshme aq edhe tendencioze! Gjithashtu, ekzistonte edhe një frikë e madhe në mesin e anëtarëve të Rijasetit, të drejtuesve të organeve të BFI-së si dhe të shumë imamëve që të takohen me oponentët, sepse, për një kafe, apo për një shtrëngim islamikisht të duarve me oponentët, “të shkante koka”, largohej njeriu nga puna! Që të gjithë “anëtarët” e Rijasetit kishin frikë por edhe e urrenin opozitën e BFI-së, atë strukturë që po e mërziste shumë reisin e tyre! Këta “anëtarë” të Rijasetit ishin shndërruar në mburojë e

Sulejman Rexhepit, “kësaj figure markante”, këtij “luani të kombit e të fesë”, kësaj “figure historike që kishte bërë shumë për fenë e për kombin”, këtij “lideri historik fetar” që i taksoheshin të gjitha sukseset historike të BFI-së! Mërzitë dhe shqetësimet e reisit “miqtë” e tij po i përjetonin si dhembje të trishta. Haxhi Sulejman ef. Rexhepi kishte shumë “miq”, sepse shumëkë e kishte lënë që të kullosë sa të dëshirojë në BFI, kishte lejuar që të shfrytëzohet BFI për pasurime personale e familjare, i kishte hapur dyert e BFI-së për t’u punësuar gratë, motrat, vëllezërit, nipat e “miqve” të tij, kishte sjellë në krye të Myftinive persona të cilët, ndonëse nuk e kishin merituar, i kishin premtuar me gjithë shpirt që do të jenë lojalë deri në frymën e fundit të jetës. Nuk e kishin frikë, sepse po ta kishin frikë nuk do të bënë të pabërat për një teolog të sinqertë! E respektonin? E respektuan aq shumë sa, kurrë nuk do të jetë i kuptueshëm as puçi dhe as komploti që ia bënë! Ishin vetë ata apo prapa tyre fshihej dikush që vepronte në emër të tyre? Ata mendojnë se kjo do të mbetet përjetë një “mister” i pandriçuar, ndonëse të gjitha veprimet e tyre janë aq lehtësisht të lexueshme! Që të gjithë parapëlyqen që të shkëputen për një çast nga të qenurit i sinqertë dhe në shërbim të Sulejman Rexhepit dhe, që të gjithë të vihen në shërbim të strukturave antiislame dhe antikombëtare në vend dhe më gjërë!

Pra, në fund, këta miq, brenda natës, sikur t’i kishte kapluar epidemia e papërjetuar hala, brenda natës, mblidhen dhe merren vesh që t’ia ngulin thikën pas shpine njeriut që ia kishin borxh jetën, shëndetin (shumë persona i shëroi nëpër botë duke ua mbuluar shpenzimet), pasurinë, mirëqenien, dashurinë, karrierën – H. Sulejman ef. Rexhepi! Ata që nga respekti i madh që e kishin ndaj “reisit të tyre”, iknin prej çdo “armiku” të tij, më në fund, vetë ata e “vranë”, e tradhëtuan, e varën, e poshtëruan, e eliminuan, e harruan!

Po çfarë u bëri efendi Rexhepi këtyre mjeranëve? Pse e tradhëtuan! Ata kurrë keq nuk i kishin bërë! Si lejuan që të gabojnë vetëm një herë dhe ta qëllonjë mu në “lule të ballit”! Dakord, njeriu edhe mund të gabojë një herë! Gabimi edhe falet! Por, a falet

mosmirënjohja?

Pse as sot e kësaj dite, këta që e tradhëtuan “liderin” e tyre (Sulejman ef. Rexhepin) as nuk e shajnë eventualisht “për të bëmat e tij”, por as nuk e lavdrojnë, qoftë për një punë të hajrit që e ka bërë ish-reisul ulema i BFI-së. Pa dyshim, janë qindra punë të hajrit që i ka bërë, janë qindra të mira që ua ka bërë bashkëpunëtorëve të vet që do ta tradhëtojnë, janë qindra suksese që ia ka radhitur BFI-së. Mazallah se e thonë një fjalë! Edhe tani nuk guxojnë as ta kritikojnë por as edhe ta lavdërojnë! Në mesin e hoxhallarëve që janë të moshës së tij, asnjëri nuk ka përmendur se i ka telefonuar, se e ka pyetur për shëndet, se e kanë vizituar, se i kanë shkuar për një kafe! Thonë, nuk guxojmë se Shaqir Fetai na dëbon nga puna! Edukata, morali, virtytet njerëzore, porositë e shenjta kuranore, Sunneti i Pejgamberit tonë, janë miliona herë më të rëndësishme se sa puna e Shaqir Fetait që ta ofron, e aq më të rëndësishme se sa largimi nga puna që ta bën “reisi”!

Nëse në të kaluarën punëtorët e BFI-së nuk guxonin ta takojnë oponentin e Sulejman ef. Rexhepit, sot është edhe më trishtueshëm: sot këta të punësuar nuk guxojnë t’i takojnë as oponentët e efendi Rexhepit që i trashëgoi Shaqir Fetai, por nuk guxojnë ta takojnë as Sulejman ef. Rexhepin!

Kush është ky farë reisi, Shaqir Fetai, që ua ka zënë frymën hoxhallarëve! Të gjithë qenkan në rrezik nëse e hidhërojnë Shaqir Fetain? Atëherë, që këtu shihet se nuk kemi të bëjmë me një “udhëheqës” por me një njeri me mision të caktuar! Mjer për ne! Zot, na shpëto nga ky turp ku jemi mbërthyer, të kemi frikë nga respekti, nga mirënjohja? Kurse këtë frikësim Shaqir Fetai nuk e bën për të mirën e hoxhallarëve por, për interes të vetin. Dhe kjo sjellje joislame është shumë aqik sa për mos t’u parë nga hoxhallarët e mjerë! Kuku për ne!/Vatra/28.01.2022

Kështu foli Shaqir Fetai (26)

Shaqir Fetait iu kujtua dhe shkoi në Bullgari për të folur me ambasadorin e Kuvajtit e për ta pyetur se pse ai ka një “kruzhok” në Maqedoninë e Veriut me të cilët shpesh takohet ndërsa asnjëherë me Shaqir Fetain? Paska folur fuksi edhe me dy kirurgë të rinj me të cilën paska këmbyer përvoja rreth koronavirusit! Pas kësaj atë e lëshon toka dhe asnjë ngushëllim për familjarët e të burgosurit politik që vdiq në burgun e Idrizovës, Rexhail Qerimit. Fjalë shpirti paska folur për tjetrin trim të kombit që paska vdekur, ndonëse kurrë nuk e ka njohur dhe as qe ka ditur për të! Ndoshta për të ndonjëherë i ka raportuar udbashit Stanko Dragoviqit

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

“Me një pritje të ngrohtë dhe të sinqertë e vëllazërore, në selinë e Ambasadës së Kuvajtit në Sofje, Ekselencia e Tij, Ambasadori i Kuvajtit Dr. Ja’kub El Atiki”, i paska dëshiruar mirëseardhje Shaqir Fetait në Sofje! Ambasadori në fjalë, ndonëse shpesh ka ardhur në Maqedoninë e Veriut dhe është takuar me një rreth të caktuar njerëzish, me një “kruzhok pushtetarësh” i cili Shaqir Fetain e llogaritë si periferik prandaj dhe asnjëherë nuk ka pasur shansin ta takojë në Shkup. U ngrit Shaqir Fetai dhe shkoi në Sofje, (një Zot e di se cili ishte qëllimi i shkuarjes në këtë

ambasadë, ndonëse e kamufloi “mirë”) e takoi ambasadorin dhe, mbase ia kërkoi ndonjë grumbull lekësh nga ato që i “shpenzon” nëpër Maqedoninë e Veriut. Natyrisht që jo, nuk është ky sebepe, por, dy-tre ditë pas kthimit nga takimet me vehabistë të ndryshëm, natyrisht që do ta zgjidhte një vend që nuk e honeps fort ideologjinë saudite. Por ama, këtë vizitë do ta realizojë me të njëjtët njerëz që do ta shoqërojnë edhe gjatë “kryerjes” së Umres dhe (nën çergë) gjatë takimit me do “alamat personalitete” shumë të rëndësishme! Në parantezë, të theksohet edhe nervozizmi dhe urrejtja e bashkevepritarëve të cilët i la grumbull, të flejnë e të pushojnë në një dhomë, si në ahur!

Edhe në Sofje, Shaqir Fetai do të shoqërohet nga bashkëveprimtarët e vet dhe, çuditërisht, i përmend edhe dy shoqërues tërësisht anonimë për BFI-në: Emin dhe Bashkim Abazi! Kush janë këta dy persona që shëtiten e bëjnë qejfe nëpër Sofje me paratë e vakëfit, të fitrit e të zeqatit! Nëse janë dy “shoqërues”, në fakt, dy përcjellës të angazhuar nga Drejtoria 6 e policisë së shtetit, atëherë, me çfarë të drejtë Shaqir Fetai ua zë në gjë emrat! Nuk ka “kryetar” në botë që ua përmend emrat përcjellësve roje, por, nëse kanë qenë miq të Shaqir Fetait atëherë ky duhet të ofrojë fatura që do të dëshmojë mbulimin e shpenzimeve të tyre nga vetë xhepi i “reisit”!

Paska shfrytëzuar rastin Shaqir Fetai dhe ekselencën e tij e paska informuar me BFI-në dhe me islamin në Maqedoninë e Veriut! Po ambasadori i di fare mirë këto punë, ai më shpesh ka qenë në Maqedoninë e Veriut se sa që ka shkuar në Kuvajt. Informacionet i ka nga dora e parë dhe jo nga fundi i bishtit siç është Shaqir Fetai! Shaqir Fetai e tha edhe këtë budallallëk: “Me qëllim të zhvillimit të këtij bashkëpunimi u bisedua edhe për procesin e akreditimit të BFI në shtetin e Kuvajtit!” BFI-ja të akreditohet në Kuvajt? Kjo dëshmon se Shaqir Fetai tërësisht është në aut, nuk ka lidhje me BFI-në, as si funksionon, as cila është pesha, cili është roli i këtij Institucioni, prandaj dhe nuk ka pasur në historinë e BFI-së njeri më antikushtetutar, njeri më që ka vepruar tërësisht antikushtetues se sa Shaqir Fetai! Ky, BFI-në e llogarit si “foshnjore” që duhet të akreditohet nëpër institucionet shtetërore kuvajtase. Shaqir Fetai gjithnjë e më shumë po rëndohet mendërisht nga kompleksi që i vjen nga e vërteta për të si për njeriun më të turpshëm e më mëkatar që ka shkelur ndonjëherë në BFI!

Në fund, sipas Shaqir Fetait, ambasadori paska përdorur një gjest me të ciën e paska dëshmuar afërsinë me BFI-në – i paska shtruar drekë Shaqir Fetait. Çfarë llaskuci, mezi pret të raportoje se ka hëngër drekë nëpër “rezidenca”, sepse, i shkreti kurrë nuk ka mundur të hajë jasht katundit të vet dhe, jashtë zyreve raportuese të UDB-së ku është rrasur “mesni narezak”!

2.

Meqë paska qëlluar në Sofje Shaqir Fetai, i paska vajtur mendja që, hajt more, ta takojë edhe kryetarin e BFI-së së Bullgarisë dhe, me këtë “levizje ta kamufltojë edhe më shumë të vërtetën e shkuarjes në Sofje! O e lidhë diçka Shaqir Fetain dhe Bashkësinë Islame të tij me Bullgarinë bre! Zoti hajër ishalla!

Kush e fëlliqë krejt nëse jo Shaqir Fetai me deklarata të tipit “Me një pritje të niveli të lartë, Kryemyftiu i Bullgarisë u dëshiroi mirëseardhje vëllazërore delegacionit të BFI”! Me një “pritje të nivelit të lartë”! Shaqir Fetai si person i perealizuar, si i papërmëshur, si pa asnjë gram qytetarie, me nivel përtoke të kulturës personale, me një mentalitet ruralo-bukolik, edhe kur t’ia hapin derën për ta futur në ahur, do të thoshte, “vëllzërisht ma hapën portën e perspektivës dhe më organizuan një pritje madhështorë”! Për të pasur një pritje madhështore, edhe mysafiri duhet të jetë madhështor dhe jo udbash!

Shaqir Fetai raportoi dhe foli: “dhe këmbyem mendime e eksperiencia për përvojat e ndërsjella.” Çfarë mendimi mund të ketë Shaqir Fetai përveçse mendimeve të djallëzuaara! Çfarë përvoje mund të ketë Shaqir Fetai përveçse përvojës së tij jetike – për të qenë besnik në raportimin para oficerëve të UDB-së! Këtë përvojë do t’ia ofrojë Kryemuftiut të Bullgarisë? Po këtë efendi e paska falënderuar për “kujdesin dhe angazhimin e treguan ndaj viktimave të ngjarjes tragjike të aksidentit të autobusit në Bullgari, ku humbën jetën 45 njerëz, fëmijë, gra e burra, që ishte një tragjedi e përmasave të mëdha dhe një sakrificë e vërtetë për familjet e viktimave.” A e lexuat këtë fjali të Shaqir Fetait? A ju duket fjali normale? A ju duket fjali që del nga “mendja intelektuale” e një mediokri si Shaqir Fetai? Shumë keq e ka degraduar BFI-në bre! Në fund Shaqir Fetai e paska ftuar

homologun e vet që ta vizitojë BFI-në dhe të njohtohet më për së afërmi me jetën fetare në Maqedoninë e Vriut, por jo edhe me politikën antislame të Shaqir Fetait me të cilat “e drejton” të shkretën BFI!

3.

Shaqir Fetai, ky manipulator i përkryer, ia paska dalur që t'i ftojë në çaj edhe nja dy mjekë të rinj, të çiltër, të devotshëm, të cilët mendojnë se është nder të pishë një çaj me Shaqir Fetain, i cili, të gjitha ndejat i përdor si material të mundshëm për të raportuar te eprorët udbashë siç e bënte diku këtë te Stanko Dragoviçi i UDB-së serbe!

Me këtë dy mjekë të ftuar Shaqir Fetai paska “zhvilluar bisedë me dy intelektual bashkëkohor për rrjedha dhe zhvillime në sfera të ndryshme, në veçanti nga përvoja e tyre në luftë me Covid 19”! Bilmezi të bisedojë me dy intelektualë! Shaqir Fetai të bisedojë për përvojat në luftimin e Koronavirusit! Është tallur ky edepsëz, sepse, as vetë, as këta dy të rinjë nuk janë kompetentë për të folur për Koronavirusin. Shaqir Fetai me shkencëtarë të rinj duhet të rrëfejë për qëndrimet islame mbi shkencën, në rastin konkret, mbi medicinën, dhe jo të futet në oqeanin e shkencave që merren me studimin e viruseve ku Shaqir Fetai mund të përfshihet si kryevirusi më i tmerrshëm që i ka ndodhur myslimanëve të Maqedonisë.

4.

Këto ditë në burgun e Idrizovës vdiq i dënuari me burg të përjetshëm, Rexhail Qerimi, i akuzur për një rast kontravers i cili kurrë nuk u zbardh. Kjo flet se ai ishte i dënuar politik pas një procesi të montuar nga “kruzhoqet” të cilët edhe e ngulën Shaqir Fetain në kolltukun e të parit të BFI-së! Së këndejmi, kjo plotësisht “e arsyeton” mungesën e Shaqir Fetait në varrimin e të ndjerit, “e

arsyeton” edhe mospërcjelljen të paktën një ngushëllim formal për familjen e të ndjerit. Natyrisht, i takonte që të ngriste lart zërin dhe ta drejtonte gishtin edhe kundër strukturave shtetërore që assesi të ngopen me montime e gjykime raciste kundër shqiptarëve dhe myslimanëve në Maqedooninë e Veriut. Si të ngushëllojë Shaqir Fetai, si ta këndojë te koka e të ndjerit një Fatiha, si ta kritikojë pushtetin, i cili ia hëngër kokën Rexhailit! Shaqir Fetai më përpara do të pranonte që për këtë rast të prishej me të gjithë myslimanët e Maqedonisë së Veriut se sa me pushtetin, me atë mekanizëm që e instaloj në krye të BFI-së. Po bashkëveprimtarët e tij – përfshirë këtu edhe Myftininë e Kumanovës – edhe këta janë palë me Shaqir Fetain në mosshprehje të respektit kombëtar e fetar ndaj luftëtarëve që ua sollën barazinë dhe lirië edhe tipave si Shaqir Fetai? Ja si e sjell i Madhi Zot! “Ra kjo dekë e u pamë”! Ra kjo tragjedi e Shaqir Fetai doli transparent se është vegël e shtetit dhe se nuk flet pa e hapur gojën pushteti që nuk mbanë llogari për luftëtarët e lirisë dhe të barazisë! Akti i tyre e ka shqetësuar Shaqir Fetain, e ka nervozuar, e ka irituar deri në çmendi. Prandaj dhe nuk i respekton, sepse ia kanë prishur rehatinë pushtetit të tij që gjithnjë ka pasur probleme me shqiptarët dhe me myslimanët e vendit.

5.

Shaqir Fetai “di të bëjë edhe politikë”! Meqë e fëlliqi fare punën me mopezencë në varrim dhe me mosngushëllim të familjes së Rexhailit, ai ngutet dhe e përcjell një telegramngushëllim tjetër: “Rafi Halili kaloi në botën tjetër”! Po ku e di Shaqir fuksi se kush është Rafi Halili! Kur ka dëgjuar për këtë personalitet të pashembullt kombëtar? Kurrë! Kur ka dëgjuar Shaqir Fetai për këtë legjendë kombëtare përveçse nga oficerët e tij të UDB-së që mund t’ia kenë dhënë ndonjë detyrë që të shpurisë ndonjë informacion rreth tij! Shaqir Fetai e përdor këtë tragjedi familjare për ta neutralizuar iritimën familjar, mllefin e ushtarëve të UÇK-së, urrejtjen e myslimanëve të Kumanovës për frikën që demonstroi duke e injoruar këtë dhembje e këtë trishtim! Ndoshta edhe ka pasur ndonjë selam që mos të duket atypari, pasi që së bashku me

kryekomandantin e branitellave, Stojançe Angellovin, e patën dënuar publikisht brohoritjen e shqiptarëve nacionalistë “UÇK-UÇK, UÇK-UÇK” si dhe “Shqipëria Etnike”! Shaqir Fetai është për një shoqëri qytetare, ku nuk ka as komb e as vlera kombëtare, as trima e as heronj kombëtar. Së këndejmi, a nuk ju duket si tepër cinike ngushëllimi i familjes së Rafi Halilit nga Shaqir Fetai, nga ky fuks i përjetshëm?!

6.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/29.01.2022

Kush po tenton ta retushojë librin shkencor “Shqiptarët e Maqedonisë”

Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI

Më vitin 1992, historianë e shkencëtarë nga mbarë bota shqiptare u mblodhën në Medresenë “Isa Beu” dhe mbajtën një nga Simpoziumet më të rëndësishme kombëtare. Dikush, për nga rëndësia historike, ia dha epitetin e “Lidhjes së Prizrenit”! U trajtua gjërë e gjatë situata politike e shqiptarëve të këtij shteti si dhe u sollën qindra argumente për autoktoninë e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut. Në këtë Konferencë, veç tjerash, pjesëmarrësit ishin në union të dakorduar që kumtesat të botoheshin në format të librit shkencor që do të mbante po të njëjtin emër të Simpoziumit “Shqiptarët e Maqedonisë”! Botimit i doli zot ish-Reisul Ulema dhe nikoqiri i këtij Simpoziumi, H. Sulejman ef. Rexhepi.

Meqë libri ishte voluminoz dhe kërkohet një tirazh i konsiderueshëm, filloi kërkimi i donatorëve. Donatorë më seriozë ishin organizata të ndryshme nga Turqia që “i siguronte” ish-humanisti i BFI-së, Behixhudin Shehapi në bashkëpunim me të ndjerin Muhamet Oruçin! I pari ishte i përfshirë në komisionin botues së bashku me ish-drejtorin e Medresesë, Bahri ef. Aliun. Sasia e parave të nevojshme ishte siguruar por imponohej një kusht: të retushohej historia, të shtrembëroheshin faktet sidomos të periudhës së Perandorisë Osmane. Dhjetra shkencëtarë, akademikë e historianë, bazuar në të dhënat arkivore, kishin zbardhur fakte e argumente nëpër kumtesat e tyre, ndërsa tani, për hirë të donatorit turk, duhej të retushoheshin të gjitha faktet!

Ky kusht, kaq iritues, kaq ofendues për shkencën shqiptare, për historinë kombëtare, do ta revoltonte tej mase ish-reisul Ulemanë, H. Sulejman ef. Rexhepin, i cili, e refuzoi donacionin dhe u zoua se vetë do ta botonte librin me kumtesa shkencore nga Simpoziumi “Shqiptarët e Maqedonisë”. Kështu dhe ndodhi, doli në dritë një prej studimeve shkencore më burimore dhe më shkencore për shqiptarët e këtushëm, i cili do të vlejë gjatë gjithë kohës si pikë referimi për të drejtat dhe për avansimin e pozitës së shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut.

Nga Bashkësia Fetare e Shaqir Fetait po dëgjohen zëra se, tashmë Shaqir Fetai ka vendosur që ta zbatojë dëshirën e armiqve të këtij libri, të formojë “këshill botues” dhe ta ribotojë me retushim të thellë! Bartës i këtij projekti antikombëtar na qenka Irsal Jakupi! Pra, për hirë të një shume të majme të parave që do të vijnë nga Turqia, do të retushohet historia e Shqiptarëve të Maqedonisë dhe do të ribotohet me një tirazh të kufizuar e që nuk do të kushtojë më shumë se nja 2-3 mij euro, pjesa tjetër e parave do të ndahet në mes të Shaqir Fetait dhe Irsal Jakupit. Në mbledhjen e fundit me “ekipin redaktues” Shaqir Fetai u ka dhën vizë se çfarë duhet të prekin e çka jo, por, gjithnjë duke ua mshelur syrin “anëtarëve të këshillit botues” që t’i hynë mirë e mbarë retushimit të librit, por që para anëtarëve të rijasetit të dalë “i virgjër”!

Natyrisht, udbashët e “lopovët e Bagdadit” nuk të habisin kur i futen projekteve antishqiptare, sepse një jetë të tërë e kanë çuar në projekte të tilla. Habit lakimi i emrit të “politikanit “shqiptar, Zekerja Ibrahim i “Alternativës”, i punësuar në Institutin për trashëgimi kulturore dhe shpirtërore të shqiptarëve të RMV-së, për të cilin thonë se do të jetë në “këshillin botues” të librit të retushuar si dikur kur i bënte nëntoka e censurës komuniste! Ky aksion vetëmssa do të jetë turpi i pseudointelektualëve dhe vjedhja e parave në emër të “historisë kombëtare”! Libri do të ribotohet edhe dhjetra herë, madje siç është botuar herën e parë, me të gjitha gabimet ortografike, gramatikore e sintaksore. Faktet do të ruhen brez pas brezi.

Edhe një gjë: dikush duhet të informojë të gjithë autorët e punimeve të cilat do t’i nënshtrohen pa leje dhe pa pëlqim “retushimit” të shkrimeve të tyre. Autorësia duhet të mbrohet me çdo kusht. Faktet historike nuk mund të jenë patate në tezgën e tregut. Këtë ofendim kombëtar e akademik mund ta bëjë vetëm Shaqir Fetai dhe honxho-bonxhët e vet./TetovaSot/30-31.01.2022

Arabia Saudite “vdes” për “përvojat fetare” të honxho-bonxhove të Shaqir Fetait

Shaqir Fetai tërë veprimin e vet e ka tallje me islamin dhe myslimanët e vendit! A e ka parë Kuranin që e shpërndanë Myftinia e Shkupit? I duket gjë normale? I duket veprim islamikisht i pastër? Shaqir Fetai po të ishte normal dhe i singertë, menjëherë do të duhej të ngriste padi penale kundër Myftiut të Shkupit për përvetësim të Kuranit dhe për përpjekje që Kuranit (përmes shtampimit në kopertinë të llogos së kësaj Myftinie) t’ia “mveshë” autorësinë e Myftinisë së Shkupit

Nga Jasir Jashari

Kohë më parë, Shaqir Fetai bëri veprimin e paprecedan në historinë shumëshekullore të BFI-së! Të gjitha organet e “Bashkësisë Fetare” të tij i mbylli dhe, që të gjithë bashkëveprimtarët e vet i mori dhe i qirasi me një Umre për veprimin e tradhëtisë që e bashkërenditën me tradhëtinë e tij kundër “figurës markante” të BFI-së, kundër “personalitetit eminent” që do ta tradhëtojë një javë më vonë pas epitetëve, duke ia njolllosur karrierën në bashkëpunim me elementet antiislame dhe antikombëtare. Ia “ngulën thikën” pas shpine H. Sulejman ef. Rexhepit, dhe u shpërblyen me “umre” me nijet që të “shpëlaken” nga mëkati i madh që e bënë!

Shkuan në Arabi dhe, nga atje, Shaqir Fetai na u lajmërua duke na thënë se ishte pritur nga një “figurë eminente”! Gënjenë Shaqir Fetai, sepse, për të nuk ekziston asnjë figurë eminente, ose, nëse ekziston një figurë eminente ai gjithësesi që do t’ia ngulë thikën pas shpine, siç ia bëri reisit të vet! Për këtë shkathtësi antihumane tashmë ai është i dëshmuar dhe, çfarëdo lavdëratë që vie nga ai duhet të merret me rezervë dhe, duhet të pritët ndonjë e keqe, sepse, deri më sot, në bazë të shumë reagimeve publike, ai është i njohur vetëm për të këqia!

Dikund, para do kohe, paska thënë se, po të më jepet rasti publik sërish do t’ia thoja po ato fjalë miradie H. Sulejman ef. Rexhepit, sepse ai i meriton të gjitha epitetet e njeriut të ndritur që ia kam renditur në atë video-inçizim! Edhe këtu gënjenë, sepse, tashmë koha është e pendimit për veprimet e bëra, është koha e përpjekjes për t’iu ofruar “babait shirtëror” të vet dhe, nëse e do nevoja, sy më sy t’ia rrëfejë e zbërthejë tërë lojën dhe t’i thotë se kjo lojë ishte e vetmja që do ta shpëtonte faqebardhë Sulejman Rexhepin! Por, jo! Shaqir Fetai ik nga Sulejman ef. Rexhepi, si “djalli nga temjani”, nuk do përballje me të sepse është shumë i vetëdëshëm se mund të çmendet nga të qarat prej turpits se çfarë i bëri njeriut, ikë prej tij sepse, pendimi eventual do të thotë ikje nga vendi i krimit dhe rikthim sërish në pozicionin zero! Kjo e frikëson Shaqir Fetain, ai nuk e do rikthimin e situatave para tradhëtisë, sepse, edhe do të qortohej prej “qendrave” që e instaluan në krye të BFI-së por edhe pastaj do t’i nënshtrohej rigjykimit. Kësaj të fundit, pra, rigjykimit, vështirë se do t’i shpëtojë ndonjëherë, pa dyshim! Shaqir Fetai nuk pranon të përballlet me H. Sulejman ef. Rexhepin, prandaj dhe këtë mospërballje e kërkon nga të gjithë bashkëveprimtarët e vet, nga të gjithë “hoxhollarët” e vendit, sepse, deri më sot ata e kanë dëgjuar vetëm variantin gënjeshtër të Shaqir Fetait. Takimet eventuale me H. Sulejman ef. Rexhepin mund të rezultojnë me njohuri të reja mbi Shaqir Fetain, të cilat i di më së miri efendi Rexhepi. Vetëm ai mund të dijë se kush ishte ky farë avanturieri, pse ia bëri këtë tradhëti dhe kush e detyroi në këtë veprim të poshtër!

Tutje, Shaqir Fetai, në takime me studentë e anonimë të tjerë

paska biseduar edhe për “këmbimin e pëvojave për interpretim të fesë islame”! Për cilat interpretime paska nevojë Shaqir Fetai? Pse a deri më sot hoxhallarët tanë nuk paskan ditur ta interpretojnë islamin? Nuk paskan interpetuar islam? Do të këmbejë përvoja të organizimit të jetës islame? Shaqiri do të këmbejë përvoja me arabët, me banorët ku u shpall Kurani, islami, ku u vunë bazat e fesë së Zotit? Po në këmbim çfarë do të ofrojë Shaqir Fetai!? Kujt i hynë në punë kopallat e Shaqir Fetait që mundohet t’i shesë si ”islam”! Po pse, arabët paskan nevojë për përvojat e mytiut të Prilepit, të Ohrit, të Resnjës, të Strugës, të Kumanovës, të Kërçovës, Dibrës etj.?!

Shaqir Fetai, përveç që tashmë është dëshmuar si “fantazist” ai përfundimisht është edhe ofendues! E ka në gjak ofendimin e të tjerëve, talljen cinike me të tjerët! T’u ofrojë arabëve “përvojë islame” nga përvoja e Myftiut të Resnjës? Të Ohrit? Të Prilepit? Shaqir Fetai tërë veprimin e vet e ka tallje me islamin dhe myslimanët e vendit! A e ka parë Kuranin që e shpërndanë Myftinia e Shkupit? I duket gjë normale? I duket veprim islamikisht i pastër? Shaqir Fetai po të ishte normal dhe i sinqertë, menjëherë do të duhej të ngriste padi penale kundër Myftiut të Shkupit për përvetësim të Kuranit dhe për përpjekje që Kuranit (përmes shtampimit në kopertinë të llogos së kësaj Myftinie) t’ia “mveshë” autorësinë e Myftinisë së Shkupit!!! Shaqir Fetait nuk i intereson Kurani! Shaqir Fetait i interesojnë paratë, qofshin këto të siguruara edhe nga shitja e “islamit”, siç i siguron nga tjetërsimi dhe shkatërrimi i Vakëfit, sepse, ai me para do ta blejë “rehatinë” e vet në kolltukun e BFI-së së uzurpuar me tradhëti e me komplot, i ndihmuar nga qarqet qe tashmë janë dëshmuar si antiislame dhe antishqiptare! /Vatra/02.02.2022

Kështu foli Shaqir Fetai (27)

Çka ka folur Shaqir Fetai?! Ai sa herë të flasë e kontaminon habitatin ku flet! Është i “padëgjueshëm-tinzak”, sepse është rrencak, është hipokrit dhe kur flet dëshmon analfabetizmin e vet prej “teologu” të UDB-së

Nga Faik Shahinbejlliu

Shaqir Fetai e ka zbritur axhendën e Bashkësisë Fetare Islame në nivel të kapaciteteve të “bashkësisë fetare” të veten. Pra, plani zhvillimor i tij është pa axhendë: kush të vdesë aty do të jemi, kush lind apo bëhet synet, aty do të jemi, kush fejohet apo martohet, aty jemi, kush të dëshirojë të pijë kafe e çaj këtu jemi, kush mëson të lexojë Kuran do të jemi aty për t’ua bërë duanë e hatmes. Kaq! Më tepër asnjë hap tutje në demonstrimin e kompetencave unike për ta interpretuar islamin në këtë vend, në demonstrimin e rolit shumë të fuqishëm që duhet ta ketë BFI në jetën shoqërore dhe, në shpalimin e të gjitha problemeve që BFI-së i vijnë nga politikat ditore të pushteteve maqedonase! Nuk e ka as potencialin e zhvillimit institucional të jetës fetare, sepse, është i kapur si nga politika ashtu edhe nga qarqet e ndryshme ekstremiste. Është vetëm çështje e kohës kur do t’ia tregojnë vendin ku e ka (në ndonjë cep të ahurit)! Sado që ka afinitete servilizmi, sado që ka lidhje të ngushta me shërbimet intelgjente, sado që ka afërsi me partitë në pushtet, nuk mund të jetë as më i zgjuar, as më me ndikim dhe as më i suksesshëm se sa ish-reisi i tij, të cilin, e spostuan që të tria faktorët të cilët e instaluan Shaqir Fetain në krye të BFI-së. Shaqir Fetai, është, thjesht, kavall, apo rryp tupani, në krahasim me ish-reisul ulemanë, ndaj të cilit të gjithë faktorët

me relevancë akoma kanë respekt dhe vlerësim, konsiderata këto që Shaqir Fetai as në ëndërr nuk mund t'i shohë! Kontributi i Sulejman ef. Rexhepit, në daç në jetën fetare islame, në daç në jetën shoqëroro-politike, në daç në botën akademike, në daç në rrafshin kombëtar, është i paarritshëm dhe gjithnjë ka rezultuar me suksese që kanë lënë gjurmë në historinë e BFI-së! Po Shaqir Fetai – edhe 100 vite me i dhënë Zoti ymër nuk do të mund ta gëzojë respektin, dashurinë dhe afërsinë me asnjë mysliman e subjekt shoqëror-politik në vend dhe më gjërë! Prandaj, Shaqir Fetai ka nevojë për t'i "prishur" ato vlerësime të realta që janë për të, se është i parespektueshëm, se në çdo moment rrezikohet karriera e tij, ndaj dhe i merr me vete në eskursione private të gjithë përfaqësuesit e organeve dhe institucioneve të BFI-së! Nuk ua ka besën, ndërsa turlifarë udbashi e turlifarë rusi proputin ua dërgon edhe faktorëve me relevancë të fortë shtetërore e partiake që e instaluan tradhëtisht në krye të BFI-së.

1.

E keni parë se si ngulet nga gabimi në gabim Shaqir Fetai sa herë që përpiket të tregohet "mendimtar" duke përdorur fjalë "të fuqishme" vend e pa vend! Shkon për ngushëllime te familja e të ndjerit Rexhail Qerimit, ndërsa e injoron varrimin e tij si dhe nuk shpreh kurrfarë dhembje publike për këtë viktimë të politikave antishqiptare e anti-UÇK që manifestohen në këtë vend. Vërtet, pse nuk ishte në varrim të atdhetarit Rexhail Qerimi në të cilën morën pjesë mijëra shqiptarë e myslimanë të vendit dhe jo vetëm? U frikësua? I çoi dikush ndonjë selam? Ndryshe, Shaqir Fetai është i njohur si merakli i përfitimit nga masa popullore, apo kësaj radhe pati frikë të manipulojë, sepse, një Zot e di, në mesin e asaj turme "të çartur" mund të ketë qenë ndonjë të cilin Shaqir Fetai e ka marrë më qafë duke e spiunuar! Apo, është shumë i ndërgjegjshëm që, në varrim të atdhetarëve ai nuk ka se çfarë kërkon, sepse mund t'i tëkërlitet shalli e të bëhet rezil! Pasi ia çelë udhën patarica e tij, ky de që i thotë vetes "myfti" i Kumanovës, vendos të shkojë në familjen e të ndjerit me qëllim që t'i ngushëllojë me shprehjen: "Mehrumit Zoti ia faltë Xhenetin e amshueshëm"!!! "Xhenet i amshueshëm"? Pse a paska edhe jo të amshueshëm a!

Këtë idiotizëm mund ta shprehë vetëm Shaqir Fetai, i cili vuan për të përdorur fjalë të mëdha, pavarësisht nëse janë me vend apo jo! Pisi shkon në ngushëllim dhe, aty bën poza me familjarët e të ndjerit duke shprehur gëzim për faktin që ia pranuan ngushëllimet! Del në foto me krejt gëzimin e pistë që e ka në shpirt!

2.

Në një urim të vetin me rastin e hyrjes në tre Muajt e Mëdhenj, Shaqir Fetai përfundon: “Paçim bekimin e Allahut”! I devotshmi, i pastërti në shpirt, i përkushtuari, i binduri se është jashtëzakonisht besnik ndaj Zotit të Gjithëdëshëm, gjithmonë uron: “Qofshi të bekuar nga Zoti”, apo, “Paçi bekimin e Zotit”, pa e përfshirë edhe veten! Shaqir Fetai me këtë lutje e me këtë uratë mendon se do të mund t’ia hedhë edhe Zotit dhe, “kude svi turci tamo i goll Hasan”, duke shpresuar se nën bekimin e Zotit për të gjithë, mund të përfshihet edhe vetë. Pra, ai shpreson se Zoti do t’ia falë tërë atë krim të poshtër që ia bëri Institucionit, ish-babait të vet shpirtëror dhe myslimanëve të vendit! Mendon Shaqir Fetai se Zoti do ta mëshirojë (ndonëse asnjëherë ky mahluk nuk shpehu pendesë publike në emër të Zotit) duke ia falur tradhëtinë, spiunimin, krimin, vjedhjet, komplotin, degradimin e BFI-së në “bashkësi fetare” personal, zhvatjen e Vakëfit...? Në asnjë mënyrë! Prandaj Shaqir Fetai është “unikat”, tek, nuk ka si ai, nuk ka pasues, nuk ka përkrahës të sinqertë, por ka vetëm servilë, të shantazhuar dhe ata që kërcënohen prej tij se mund të flasë për kualitetet e tyre prej bashkëpunëtorëve të shërbimeve intelegjente! Dhe, pastaj, një person si ky i ulët të presë edhe për vete “Bekimin e Zotit”! Tybestigfa!

3.

Redaksia e portalit “Kombëtare.com” ka drejtuar sot pyetje deri te Meshihati i Bashkësisë Islame të Kroacisë për qëllimin e vizitës së kryetarit Aziz ef. Hasanoviq i cili sot qëndroi në bashkësinë fetare të Shaqir Fetait. Nga atje, thjesht, morëm këtë përgjigje: “iu përgjigj

disa ftesave rresht që ia ka drejtuar kryetari i BFI në RMV Shaqir ef. Fetai! Me sa dimë ne, efendi Fetai ia ka mundësuar edhe një takim me Kryetarin e Parlamentit të Maqedonsë. Natyrisht, secili lider fetar do të kishte dëshirë që të pritët edhe nga drejtues të lartë të shtetit ku qëndron për vizitë private"! Do me thënë, nuk ka kurrfarë axhende, do me thënë, nuk ka kurrfarë projekti, do me thënë, thjesht, kjo vizitë është sa për t'ia plotësuar dëshirën patologjike Shaqir Fetait. Shaqir Fetai thotë se z. Xhaferi na priti me "nderime të larta shtetërore"! Deri në këtë shkallë ka shkuar prishunia e tij! Ai po e vuan izolimin e tërësishëm, po e vuan vetminë si pasojë e injorimit që shprehet ndaj një fuksi, po ndjenë nevojë për t'u përmbushur me vizita që ua bënë meraklive të çajit të rusit. Me efendiun në fjalë paska biseduar për të këmbyer përvoja në interpretim të islamit! E çfarë islami po u interpretuaka në Kroaci që po na u dashka kjo përvojë të implementohet edhe në Maqedoninë e Veriut?! Kundërmuese është kjo vizitë, së shpejti do t'i dalë edhe tymi!

4.

Shaqir Fetai bashkë me krerët e tjerë të bashkësive fetare në vend (nuk u kuptua kush është "bashkësia ebreite"!!! Cili bilmez i Shaqir Fetait e ka emërtuar kështu Bashkësinë Hebraike në RMV?!) paskan realizuar një takim me Kryeministrin e sapo zgjedhur të RMV-së, z. Dimitar Kovaçevski! Dhe, nuk paska pasur kurrfarë pune tjetër kryeministri, përpos që ta njohtojë sidomos Shaqir Fetain (!) me rrjedhat politike në vend, siç thotë derdimeni! Ky i shkretë, për t'i qëndruar nën bole pushtetit, nuk paska harruar që t'ua urojë mbetjen në të njëjtin post të qeverisë së re, z. Grubit dhe z. Spasovskit! Po këta ministra të ri shqiptarë a nuk bënë t'i urojë Shaqir Fetai, a! Jo se pastaj ia ... "faktorët" politiko-policor që e instaluan si dordolec në krye të BFI-së. Tutje, Shaqir Fetai foli me isharete e me mimikëri dhe tha se paska hapur edhe "çështjet e pazgjidhura si Xhamia e Prilepit, e Llazhecit, akreditimi i Medresesë"! Por, Shaqir Fetai vetëmse i paska hapur çështjet, ndërsa nuk tregon se çka u tha pushtetarëve dhe çka i thanë ata këtij! Rrenë Shaqir Fetai, sepse as që i ka hapur këto çështje dhe, as që do t'ia zgjidhin ndonjëherë këto çështje me këtë servilizëm që

demonstron karshi pushtetarëve të cilët, as që kanë dëgjuar ndonjëherë për këto probleme!

5.

Shaqir Fetai herë pas here është aktiv edhe në fb-un e vet privat! Edhe aty del po aq i pacipë dhe i poshtër siç është edhe në publik! Kah fundi i muajit janar ka qëndruar në shtëpinë e një imami të Gostivarit “për t’i shprehu urimet e lindjes së vajzës së filan imamit dhe të babait të tij”!!! Tani, e kujt është ajo vajzë, e imamit apo e babait të tij, apo e të dyve! Duhet të prononcohet publikisht Shaqir Fetai, ndryshe, ua ka borxh moralin kësaj familje të ndershme! Kemi thënë, sa herë që folë Shaqir Fetai, ai hedh fjalë goje si lopa bajgën!

6.

Krerët fetar qenkan takuar edhe me Ministrin e ri të shëndetësisë, z. Bekim Sali, të cilin nuk e ka uruar siç e ka uruar një ditë më parë Grubin e Spasovskin! Qenka përbetuar se bashkësia fetare e tij me rigorizitet i zbaton rekomandimet që “ia jep OBSH”-ja Shaqir Fetait. Gjithashtu, krejt ky takim qenka realizuar që edhe një herë, duke u betuar në tokë e në qiell, t’i dëshmojë ministrit se e ka marrur vaksinën e tretë. Po kujt i ha b... se sa vaksina ka marrur Shaqir Fetai. Çka ka më shumë ky se edhe nja 170 mij të tjerë që kanë marrur vaksinën e tretë e për të cilët askush nuk ka dëgjuar asgjë. Rrenë Shaqir Fetai kur thotë se i zbaton rekomandimet. Rrenë edhe në fotografi ku shihet me maskë. Para pushtetit Shaqir Fetai del me maskë, ndërsa para mysafirëve, apo gjatë mbledhjeve që i mban me nga 30-40 persona, asnjëri nuk mbanë maskë! Është hipokrit Shaqir Fetai, pa dyshim!

7.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit!/Kombetare/03.02.2022

A i shkon filozofia hipokritit

Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI

Shaqir Fetai paska keqpërdorur faqen zyrtare të BFI-së (tashmë të shndërruar në klub të vetin me plotë honxho-bonxho) dhe aty paska botuar një “mendim filozofik” të vetin! Filozofia dhe Shaqir Fetai janë dy koncepte që i përngjajnë gacës dhe ujit!

Shaqir Fetai sinqerisht mendon se është person që mund të lë “amanete”, “porosira”, “mendime filozofik”, si ata të urtit e mëdhenj që janë në prag të vdekjes. Lamtumirën e fundit ia lënë popullit! Porosia e tyre është përplot urtësi, përplot njerzillëk, përplot burrëri e shtigje drejt së cilës duhet të lëvizin të gjithë ata që e duan. Plakun e urtë e respektojnë edhe armiqtë e tij, por ama, kur një avdall aktron të urtin dhe mundohet të lë “amanete” ky natyrish që shndërrohet në qesharak, në palaço që të shkulë së qeshuri.

“Veproni mirë dhe silluni mirë – është koncept islam” thotë Shaqir Fetai! Kush thotë? Ky që me dy këmbë ka shkelur mbi konceptin islam?! Po ku ka lidhje me islami tërë veprimi i tij prej hipokriti! Nga goja e kujt dalin “porositë islame”? Nga goja e personit që një karrierë të tërë e ka ngritur mbi intriga, mbi spiunllëqe, mbi tradhëti, mbi rrënime të jetës institucionale, mbi vjedhjen dhe zhvatjen e vakëfit... Ky të flasë për koncepte islame? Mendon se

duke folur për tema të mëdha (ku ai del si mizë kali) do të mund ta mashtrojë popullin dhe të amnistohet nga krimi që ka bërë, nga jeta e tij e dyfishtë: herë si antikonstitucionalist e herë si “islamist”! Njeriu që shkel mbi Kushtetutën e BFI-së e cila bazë dhe koncept ka parimet islame?! Njeriu që shitet për një kolltuk! Njeriu që kolegët e vet i shet, i shkelë, sepse prej tyre e ndjenë rrezikun e deshifrimit të shpirtit të tij të pashpirt!

Shaqir Fetai, si asnjë “teolog” tjetër, si asnjë hipokrit e mynafik në vend e në rajon dhe më gjërë, tashmë është deshifruar dhe zhveshur në mijëra publikime të ndryshme; është lakuriqësuar si alet i pushteteve antiislame e antikombëtare, si vegël manipulimi në duart e atyre “subjekteve” që nuk e durojnë ekzistimin e Institucionit të BFI-së; është zbërthyer si hipokriti më unikat në këtë nënqiell e më gjërë! Dhe, tash, ky farë “insani” të na flasë me alegori, ta lusë opinionin që të sillet e të veprojë brenda konceptit islam, ndërkohë që vetë, ka vepruar atë që nuk e kanë bërë as ateistët!

“Kjo është baza e edukimit të vetvetes dhe të tjerëve”, vazhdon tutje Shaqir Fetai, duke qenë i bindur se, ja, tha diçka të “mençur” diçka “të pathënë” deri më sot e që do të dhezë te masa e gjërë dhe do ta falë nga veprimet hipokrite që i ka në gjak! Cila është edukata e Shaqir Fetait nëse jo intriga? Cila është edukata e Shaqir Fetait, nëse jo tradhëti? Cila është edukata e Shaqir Fetait, nëse jo ngulja e thikës pas shpinës së mikut? Cila është edukata e Shaqir Fetait nëse jo shkelja me këmbë të pista mbi parimet islame? Të thërrasë në parime islame Shaqir Fetai është ngjashëm sikur krimineli të thërrasë në miklim të viktimës!

Shaqir Fetai mendimin e vet përplotë hipokrizi e përmbyll: “Historia nuk mban mend se e keqja zhvillon rrugëtim të mirë për vetveten dhe të tjerët”!!! A mos është ky makthi më i madh që po e mundon dhe që po e trishton Shaqir Fetain! A mos është ky shqetësimi i tmerrshëm i Shaqir Fetait që e detyron në lënien e këtij “amaneti”?! Shaqir Fetai në fjalinë e fundit të “mendimit

filozofik” të tij na del më se i vërtetë dhe mëse i saktë! Ai po tmerrohet nga rrugëtimi i tij! Ai është shumë i sigurtë se veprimi i tij nuk ka të ardhme. Hipokrizia e tij nuk siguron kurrfarë të ardhme as për vetë atë dhe as për BFI-në dhe komunitetin e saj! Në këtë përfundim është shumë koshient Shaqir Fetait! Atij vetëm sa mund t’i vërtetohet se, me të vërtetë historia nuk mban mend ndonjë rrugëtim të gjatë të një tradhëtie, të një hipokrizie, të një munafikllëku si të Shaqir Fetait. Këtë e ka të qartë edhe vetë Shaqua, ndaj porositë që të veprohet në kuadër të koncepteve islame. Kjo alegori është porosi e tipave si Shaqua i shkretë: “Punoni çfarë t’ju them unë dhe mos veproni siç bëj unë”! Porositë “e urta” të Shaqir Fetait janë si ato fluska sapuni që lëshohen gjatë reshjes së dëborës!

Po sa mirë ia kishte komentuar një qyetetar i cili në reagimin e vet i thotë: “Kur t’ju besohet diçka, mos tradhëtoni... pjesë nga një hadith i saktë! E paska harru këtë porosi, o “reis”!/ 1KlikLarg/06.02.2022

Kur të futet frika në palcë

Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI

Shaqir Fetai paska marrur pjesë në inagurimin e Reisit të posazgjedhur të Malit të Zi, Rifat ef. Fejzić! Drejtë për drejtë ka marrur pjesë në një zgjedhje të rregullt dhe islamikisht të pastër! A thua, si do të jetë ndjerë Shaqir Fetai në këtë proces, kur tashmë çdo ditë po e vret ndërgjegjia nga zgjedhja e tij imorale, komplotiste dhe jasht çdo standardi islam? Shaqir Fetai edhe imanin do ta jepte vetëm e vetëm që mos ta kishte këtë hipotekë të përjetshme në biorafinë e vet!

Po pse Shaqir Fetai shkon me gjysmën e “rijasetit” në një përrurim ku nuk shkohet më shumë se vet dhe, eventualisht ndonjë shoqërues i tij (me gjithë shoferin)?! Shikoni fotografinë që flet dhe nuk mund të demantohet dot! Teprica gjithnjë përjashtohet! Ulet në rreshta të fundit dhe në mënyrë perfide injorohet nga ngjarja! Apo, Shaqir Fetai, bazuar në shpirtin e vet perfid dhe hipokrit, qëllimisht e merr me vete “rezikun potencial” për t’ia treguar vendin dhe për t’i treguar se kush është më i rëndësishëm dhe më i respektuar në sy të ndërkombëtarëve. Sikur të mos kishte hile Shaqir Fetai, për më të madhin kijamet nuk do të lejonte që të dukej sekundar delegacioni i vet, nuk do të lejonte që vetem prapa shpinës së tij të kishte rresht nga delegacioni i vet i cili tërësisht duket i tepër! Pse Shaqir Fetai tashmë e ka bërë traditë që nëpër udhëtime ta marrë ose tërë “rijasetin” ose gjysmën e tij! Vetë i dhjeti në Mal të Zi? Me dy-tri makina! A e kupton Shaqir Fetai që

frika e tij po i kushton shtrenjtë BFI-së, të cilën ky farë “reisi” po e përdor si tampolinë të “aparatura” e realizimit të qejfeve të tij katundareske?!

Shaqir Fetait i është rrasur mendja se dikush do t’i bëjë puç ashtu siç ia bëri ai Reisit të vet, H. Sulejman ef. Rexhepit! Ndaj, ka zgjedhur strategjinë që, kudo që të shkojë të marrë me vete anëtarët e “rijasetit”, të dëshmuar tashmë si të manipulueshëm! Askush nuk do t’i bëjë puç Shaqir Fetait i cili tashmë vetëvetes i ka bërë puç, ndërsa shumë shpejt do ta detyrojë veten që të largohet nga kjo rrugë qorre ku është futur! Madje, anëtarët që i merr me vete duhet të rrinë sus para “shoqëruesit” të delegacionit sepse mund të kenë probleme! Një delegacion i tërë që ka me vete “shoqërues”? Këtë idiotizëm e bën vetëm Shaqir Fetait!

Frika kushton dhe, megjithatë, nuk ka ilaç! /Fakte/07.02.2022

Askush nuk mund ta cenojë pronësinë intelektuale të tjetërkujt

Nga Akademik Abdullah Mehmeti

Reagim publik

Në bazë të një shkrimi në formë reagimi të publikuar këto ditë në mediet në gjuhën shqipe në Maqedoninë Veriore (në emër të Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI), hapur denoncohet plani i një grupi dashakeq për ribotimin e censuruar të librit "Shqiptarët e Maqedonisë", përmbledhje e punimeve shkencore të Simpoziumit "Shqiptarët e Maqedonisë", i mbajtur në objektin e Medresesë "Isa Beu" në Kondovë të Shkupit, më 20, 21 dhe 22 dhjetor 1991, që ka qenë i pari i këtij lloji ndër shqiptarët e Maqedonisë. Ky simpozium është organizua nga Bashkësia Kulture Shqiptare në Maqedoni, ndërsa bartës formal të këtij aktiviteti kanë qenë Shoqata e Arsimitarëve të Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe nga Tetova dhe Biblioteka "Isa Beu" e Medresesë në Kondovë të Shkupit. Shih shkrimin tim në dy vazhdime, në bashkëngjitje të këtij reagimi. Në emër të Bashkësisë Kulture Shqiptare, në cilësi të kryetarit të saj, organizatorit të këtij Simpoziumi, duke qenë i njoftuar në hollësi me procesin e botimit të punimeve shkencore të këtij simpoziumi dhe pengesat gjatë asaj kohe (1992-1994), edhe nga agjentë shqiptarë që kanë ndërhyrë atëkohë, duke dezinformuar e shpifur te autoritetet turke që ta sabotojnë botimin e librit sipas marrëveshjes, siç shkuan edhe autori i reagimit të këtyre ditëve, përveç kërcënimeve të hapura nga pushteti i asaj kohe, me tendencë për heqjen e së paku 80 faqe tekst nga përmbajtja e disa kumtesave shkencore, me pretekst se ato përmbajtje e dëmtojnë historinë e periudhës Osmane, kinse i rëndojnë marrëdhëniet miqërore mes shqiptarëve dhe turqve dhe i cenojnë interesat e sotme të shtetit të Turqisë në rajon!

Për hollësi të tjera mund të deklarohen publikisht edhe aktorë të tjerë pjesëmarrës në këtë projekt, në përgatitjen e materialeve,

redaktimin dhe botimin e librit me punimet shkencore të Simpoziumit "Shqiptarët e Maqedonisë", për ta sqaruar të vërtetën para opinionit. Këtë e kanë borxh edhe ndaj autorëve të punimeve shkencore, shumica e të cilëve nuk janë gjallë, si edhe ndaj organizatorit të Simpoziumit.

Me këtë rast, i paralajmëroj të gjithë aktorët e sotëm për veprimet në tentim, nëse ka tendenca të këtilla siç thuhet në reagimin e këtyre ditëve, të mos guxojnë të ndërmarrin një hap të tillë, përderisa materialet e përfshira në këtë libër janë pronë intelektuale e autorëve dhe organizatorit të Simpoziumit "Shqiptarët e Maqedonisë", Bashkësisë Kulturore Shqiptare në Maqedoni.

Mos guxoni!/Lexo-Shqip/06.02.2022

I varfër në shpirtë

Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI

Jo njëherë Shaqir Fetai ka dëshmuar se është shumë i varfër në shpirt, se është i papërbushur, i paplotësuar, probleme komplekse e psikike këto të bartura që nga fëmijëria e vet. Njeriu në fëmijëri ëndërron të bëhet astronom, të bëhet mjek, të bëhet shofer, polic, komandos... Shaqir Fetai ka ëndërruar të bëhet “teolog” dhe “reis”, jo se i ka kuptuar këto dy nocione, por, thjesht, ka menduar se përmes këtyre profesioneve ai do ta shëtisë botën dhe me vete do të marrë sa më shumë njerëz që kanë pasur fatin e tij të izolimit. Ai nuk ka dalur përtej oborrit të fëmijërisë së vet, ndaj, ëndërr e ka pasur bredhjen nëpër botë! Me kohë, atij i është xhindosur shpirti dhe ato orekse fëmijërore i ka përdorur edhe për qëllime të tjera, për shembull, që të tregohet sa më i madh në botë, sa më i rëndësishëm, sa më i nderuar, sepse, fëmijërinë e vet e ka kaluar pas dere, si macet e zeza që presin ndonjë copë zorre nga kukureku që t’i hidhet!

Cilën shëtitje që kur ka uzurpuar postin e reisit Shaqir Fetai nuk e ka realizuar “i shoqëruar” me dhjetra bashkëveprimtarë! Shëtitje pa axhendë, pa synim, por, me qëllim, ose ta punësojë ndonjë familjar të veten nëpër xhamitë e Perëndimit, me qëllim që t’ua demonstrojë familjarëve të vet se sa “i madh” që është bërë tani, ose të ketë sa më shumë shoqërues që do t’ia verifikojnë raportet spiuneske që do t’i dorëzojë në polici pas çdo “vizite”! Të gjithë bashkëshoqëruesit dhe të punësuarit e Shaqir Fetait, doemos duhet të jenë vegla të Shaqir Fetait, ndryshe do të dëbohen prej tij, ndërdsa do t’u kërkojë prej tyre që ta shkruajnë dorëheqjen në mënyrë sa më të kulturuar (Për këtë praktikë antihumane të

Shaqir Fetait ka plotë dëshmitarë që janë të gatshëm të dëshmojnë edhe publikisht)!

E fundit, Shaqir Fetai na paska prezantuar në inagurim të reisit të Bshkësisë Islame të Malit të Zi! Para kësaj vizite ishte në Arabinë Saudite, “i ftuar zyrtarisht” (sipas rrenave të Shaqir Fetait) dhe, me vete e mori tërë “rijasetin”! Natyrisht, nikoqiri do të sigurojë dhoma për të ftuarin që nuk shkojnë në më shumë se një-dy persona, ndërsa shoqëruesit e tij, që të gjithë, do të futen në një dhomë, si dhentë e zgjebosur. Pesëmbëdhjetë vetë në një dhomë! Shaqir Fetai nuk u del zot shoqëruesve të vet, as që i intereson dinjiteti dhe personaliteti i tyre. I merr me vete duke shpenzuar dhe dëmtuar vakëfin sa për t’ua dëshmuar se sa “e respektojnë” dhe sa e “nderojnë” të huajt, adje ia japin edhe një dhomë më vete në hotel! Ky është qëllimi i Shaqir Fetait në “vizita” i shoqëruar me sa më shumë; t’i degradojë shoqëruesit dhe ta “madhërojë” veten!

Nuk i doli për zot as delegacionit që e kishte marrur kot e kot në Mal të Zi! Nuk i mbledhi në tavolinën e përbashkët por i la pas shpine të vet, në rreshtin pas b...! Nga kjo ngjarje, në faqen zyrtare të BFI-së Shaqir Fetai paska botuar një fotoreportazh nga inagurimi i reisit të Malit të Zi! Këtë reportazh nuk e kanë bërë vetë shërbimet e BI të Malit të Zi! Çka i duhet Shaqir Fetait që ta vjedhë aktivitetin e një subjekti të huaj dhe ta paraqesë si aktivitet të vetin! Shaqir Fetai, përmes këtyre fotografive të fotoreportazhit, dëshiron të tregojë se “sa shumë e kanë respektuar”, se çfarë “pritje impozante” që i kanë organizuar dhe se, inagurimi si ngjrije, ka qenë nën hijen e peshës së tij me një delegacion megaloman!

BI e Malit të Zi, vetë reisi aktual i myslimanëve të këtij shteti, ishte në kohën kur Shaqir Fetai, i ndihmuar nga strukturat partiako-policore, e vodhi potin e reisit të BFI-së, por ama, ai ka pblikuar vetëm një lajm të shkurtër informativ, dhe jo një raport policor siç i bën Shaqir Fetai!

Fotoreportazhet bëhen vetëm për të shënuar një aktivitet madhështor të subjektit gjegjës dhe jo të subjekteve të huaja!

Pastaj, Shaqir Fetai, tipik një katundar i regjur, në të kthyr nga Mali i Zi, thotë: jemi se jemi këtu, hajde t’i bimë më qafë edhe

Ambasadës së Arabisë Saudite dhe të kërkojë intensifikim të bashkësisë fetare të tij me Mbretërinë e Arabisë Saudite. Shaqir Fetai nuk e di vendin e vet, nuk e kupton pozitën e vet, nuk e ka të qartë rolin e tij prej bashkëpunëtori të shërbimeve sekrete! Megalomania e Shaqir Fetait nuk ka të sosur! Megalomania e një injoranti dhe snobi! Ai nuk e kupton rolin e Institucionit Fetar, nuk i di kufijtë e aktiviteteve fetare, qejfi i tij është që këto aktivitete të kenë ndërlidhje sa më të madhe me shërbimet sekrete policore, vetëm e vetëm që nga këto shërbime të marrë vlerësime sa më të mëdha, sepse, tashmë është e qartë se populli nuk e do! Ai edhe shehadetin kur e thotë, shahet nga popullata myslimane! Është filmaxhi i dobët; është rrenacak dhe përvetësues i suksesëve të huaja. Një “reis” që nuk e njeh gjuhën e Kuranit dhe me një arab flet me përkthyes!!!

Ai nuk di se çka janë aktivitetet dhe sukseset, sepse, fëmijërinë e vet e ka të zbrazët, mendërisht është i hendikepuar, sepse, nuk është e lehtë që, që nga “hafizi” të kaloshë në spiun i UDB-së! Nuk është e lehtë që, tërë fëmijërinë dhe rininë ta kaloshë i mbyllur si “haxhuze” brenda murve të shtëpisë. Çka bën viçi i mbyllur deri sa të bëhet dem! Kur të lëshohet i lirë në oborr, ai bën kërدينë, “vret e pret”! Ai nuk e kupton se tashmë është bërë dem, edhe më tej sillet si viç, sepse, sjellja si viç (në rastin e Shaqir Fetait) mund edhe të të amnistojë nga fajësia, tërë dëmi mund të duket “simpatik” i ardhur nga një viç lozonjar! /Tetova/08.02.2022

“BF”-ja e Shaqir Fetait në radar të Mbretërisë së Arabisë Saudite?!

Shaqir Fetai na publikon në fb-un e vet një “lajm ekskluziv” përplot me rrena. E tradhëton koha dhe përmbajtja! Thotë, sot u dha lajmi i Kabinetit të Ministrive të Mbretërisë së Arabisë Saudite! Thotë se “Sot lajmi u dha në të gjitha mediat arabe”, ndërkohë që këtë lajm ia paska konfirmuar qysh më 6 shkurt ambasadori arab në Tiranë! Po çfarë lajmi paska qenë ky

Nga Valmir Idrizi

Që kur nga qarqet antiislame e antishqiptare Shaqir Fetai u instalua me puç e me komplot në krye të Bashkësisë Fetare Islame të RMV-së, ky farë mahluku bëri çmos që të kurdisë turlifarë takimi e vizite vetëm e vetëm që të krijojë përshtypje kinse sa shumë e duan dhe se, që të gjithë e kanë amnistuar “vëllazërisht” nga tradhëtia dhe komploti që e zhvilloi për herë të parë në historikun e Institucionit të BFI-së!

Është dhelpër e llojit të vet, është skuth, është intrigant e hipokrit i paparë, i cili, në çdo hap të tij deshifrohet, i cili, kurrë nuk pranon debate publike nga frika se, për çdo ditë fatkeqe që kur u instalua, do të mund të lakuriqësohej e të nxirrej në pah karakteri i tij tepër shumë i ulët. E ka dëshmuar qindra herë, madje publikisht që nga 27 maji i vitit 2020!

Në parantezë, këtu, do ta përdorim një rrëfim nga “Përallat popullore të Drenicës”: “Na ishte një nuse e cila, sapo kishte ardhur në shtëpi të re dhe, për t’u dëshmuar si nuse e zgjuar dhe punëtore, vetëm lante e shpëlante, kot e kot, pa llogaritur se do ta çojë dëm të zotin e shtëpisë, vjehrrin. Një ditë, derisa po zinte rraqe mbi shporetin e mbushur me disa kusi e tenxhere, sakaq, para vjehrrit i shpëtoi dhe u pjerdh fort. Me bisht të syrit e pa vjehrrin dhe nisi të kërcasë me lugë nëpër kusia e tenxhere, me qëllim që vjehrrin të mendonte se “zhurma” erdhi nga tenxheret dhe jo se bëri pordhë nusja! Atëherë vjehrrin ngriti kokën dhe i tha: nuse, me këtë potere zërin po ia humb por, çka do t’i bëshë erës e cila na e zuri fytyrën, na qelbe, nuseee”!

Shaqir Fetai, realisht, na ka qelbur. Qelbja e fundit e tij ka të bëjë me një “lajm ekskluziv” sa kontravers aq edhe të habitshëm, sa interesant aq edhe të rrezikshëm!

Bashkësia Fetare e Shaqir Fetait paska rënë në radarin e Mbretërisë së Arabisë Saudit! Dhe, këtë “lajm ekskluziv” madje ia paska kumtuar ambasadori i kësaj Mbretërie në Tiranë!

Natyrisht që, qeveria e kësaj Mbretërie do të merret me bashkësinë fetare të Shaqir Fetait, i cili, lejoi dhe përkrahu regjistrimin zyrtar të dhjetra komuniteteve, xhamive e “bashkësive islame” që rrënjët i kanë nga shërbimet intelektive të kësaj Mbretërie; i cili bashkëvepron ngushtë, veç tjerash, edhe me agjentët e këtij shërbimi. Bashkësia Fetare Islame e dikurshme, fatkeqësisht, tashmë është shdërruar në qendër e agjenturave të ndryshme, në të cilën ka të punësuar plotë bashkëpunëtorë të shërbimeve të huaja, në mesin e të cilëve më i rrezikshmi, pa dyshim, ai i “shërbimit intelektual arab” (i shumëfishtë)!

Shaqir Fetai na publikon në fb-un e vet një “lajm ekskluziv” përplot me rrena. E tradhëton koha dhe përmbajtja! Thotë, sot u dha lajmi i Kabinetit të Ministrive të Mbretërisë së Arabisë Saudite! Thotë se “Sot lajmi u dha në të gjitha mediat arabe”, ndërkohë që këtë lajm ia paska konfirmuar qysh më 6 shkurt ambasadori arab në Tiranë ku zhvilloi një vizitë si në “hanin e Mahmut Pashës”! Po çfarë lajmi paska qenë ky? Ministri për Çështje Fetare qenka obliguar që të

diskutojë me përgjegjësit e bashkësisë fetare të Shaqir Fetait për bashkëpunim “në sfera të ndryshme”! Për çfarë “shumë sfera të ndryshme” rrenë Shaqir Fetai kur dihet se kjo Ministri ngarkoht të diskutojë ekskluzivisht për çështjet fetare! Hap i parë serioz i këtij bashkëpunimi mund të jetë, për shembull, ndryshimi i kohës së fillimit të Ramazanit dhe ditës së Bajramit, ashtu siç pat bërë vite më paarë një homolog i tij, derisa u detyrua që vetë t’i dorëzojë emrat e “ekstremistëve” të indoktrinuar me ideologji vehabiste në shtetin e vet! Nëse nuk ndodhë kjo, pastaj çështja bie përtokë: bëhet fjalë për nënshkrimin e memorandumit i cili për çdo vit nënshkruhet me të gjitha komunitetet islame në botë, ndryshe, nuk mund të sigurojnë kuotë për Haxh! Pra, nënshkrimi nënkupton pajtim germ për germe me rregullat dhe me vendimet arabe për sa i përket organizimit të kryerjes së Haxhit.

Veprimet e Shaqir Fetait janë vetëm një provë dhe përpjekje për t’i hutuar ndërkombëtarët, të cilët, pa dyshim që ka kohë që po e mbajnë nën llupë dhe po ia analizojnë hapat e një të dehuri nga ekstrati i karrierës së sëmure. Zot, shpëtoje BFI në RMV nga kthetrat e pista të personave të ulët e të papërgjegjshëm!

Papërgjegjshmëria e Shaqir Fetait më së shumti do t’i kushtojë çështjeve kombëtare të shqiptarëve të RMV-së dhe më gjërë! Rrenën se BFI do të nënshkruaj memorandum për bashkëpunim të gjithanshëm me Mbretërinë e Arabisë Saudite, Shaqir Fetai po e përduraks si “strategji” për t’i revoltuar turqit dhe për t’i nervozuar që të angazhohn fiqishëm dhe, deri në Bajram të Vogël ta mbarojnë xhaminë në Fushë Tophanë, të cilën Shaqir Fetai dëshiron ta ketë si “dekoratë” të “reisllëkut” të tij, ndonëse, që kur ka ardhur Shaqir Fetai nuk po ia dalin që ta përfundojnë vetëm një kubë, sepse, themelet dhe karabinaja janë ngritur në një kohë tjetër, kur Shaqir Fetai, e kishte përshkuar një energji fantomike e servilosjes së turpshme!

Për Mbretërinë e Arabisë Saudite, Shaqir Fetai dhe bashkësia e tij fetare nuk kanë kurrfarë kuptimi, aq më pak ndonjë peshë apo rëndësi, me përjashtim nëse ndjejnë një gatishmëri institucionale për t’u shndërruar në “qendër ballkanike e vehabizmit”. Në këtë

rast pa dyshim që do të niste një “bashkëpunim në sfera të ndryshme”, që ka karakterin e bashkëpunimit bilateral, si shteti me shtet! / 1KlikLarg / 09.02.2022

Kështu foli Shaqir Fetai (28)

Çka foli, përveçse u dëshmuar edhe një herë, madje edhe më fuqishëm se, Shaqir Fetai me cinizmin e vet satanik është një prej sadistëve më të tmerrshëm i cili krimin e vet moral ka qejf ta ushtrojë mbi kurriz të tjetrit, mundësisht të jetë “mik” i tij. Sepse vetëm te miqtë e vet mund ta shesë perfiditetin e vet të djallëzuar, ves këtë që e ka shumë për shpirti

Nga Faik Shahinbejlliu

1.

Nëpër myftinitë e “rijasetit” të “bashkësisë fetare” të Shaqir Fetait janë në përfundim e sipër zgjedhjet e anëtarëve të myftinisë. Janë mbajtur zgjedhjet e janë zgjedhur anëtarë të rinjë. Në asnjë proces të tillë nuk ka qenë praktikë që të përzihet reisi! Është punë e brendshme e secilës myftini. Por, ja që Shaqir Fetai, për të krijuar dhe për të ndjellur pakënaqësi te myftinitë e vendit, nuk e lë pa ndërhyrë! Mbase edhe i ka thënë dikush se, dikujt aty brenda, nja dy-tre anëtarëve të rinjë u duhet “vendimi nga reisi” sepse këtë ua kërkon punëdhënësi i tyre që të ketë motiv për t’ju derdhur dollarë sa ta kanë qejfin! Apo, i ka rënë vonë në mend se, ekziston një “strategji” që mund ta përdorë Shaqir Fetai për të qenë pak aktual: t’ua dorëzojë vendimet anëtarëve të posazgjedhur nëpër të gjitha myftinitë e ta shohim një “spektakël” përplot cinizëm alla-shaqirçel! E filloi me Myftininë e Shkupit dhe, mbase do ta vazhdojë te të tjerat pasi ka përfunduar procesi zgjedhor. Ose, këtu do ta

përfundojë sa për të futur spica ndër myftinitë e tjera, të cilave u tregon se kush është me peshë e me rëndësi dhe se të gjitha të tjerat janë “myftini periferike”!

Po ku ka parë e ku ka dëgjuar Shaqir Fetai se ai duhet t’u ndajë vendime anëtarëve të myftinive! Çka përzihet ky farë avdalli në punë që nuk i takojnë e nuk janë për të?! Si guxon ta ngrisë në “institucion” një punë që është voluntere!

A i ka hije Shaqir Fetait, njeriut më kontravers, njeriut që i ka shkelur të gjitha nenet e Kushtetutës së BFI-së, njeriut i cili ka ardhur jo me propozim të organeve por me instalacion nga qarqet e dyshimta antiislame e antishqiptare, pra, a i ka hije Shaqir Fetait që ta “institucionalizojë” një proces ndërkohë që vetë është anti-institucioni i vetëm në historikun e Institucionit të BFI-së tashmë të shndërruar në qendër agjente të shërbimeve të ndryshme antiislame e antikombëtare!

A i ka nderuar me këtë gjest Shaqir Fetai apo i ka çnderuar anëtarët e rinj! A kanë pasur dëshirë ata që të përballen me një antinjeri në një situatë madje edhe të “nderohen” me vërtetime prej tij! Shtatëdhjetë për qind prej anëtarëve të rinjë janë ndjerë në siklet, nuk do të kishin kurrë dëshirë që të rrinë një sekond në një hapësirë me “ORAO”-n e Stanko Dragoviqit, me një alet të shërbimeve të huaja intelegjente. Për më të madhin kijamet nuk do të pranonin që të token me Shaqir Fetain por, ja që edadukata e tyre, nuk i ka lejuar që t’ia tëkërlisin shallin nga koka e kalbur! Shaqir Fetai, para anëtarëve të rinj foli e tha: “Sot keni marrë përsipër që të çoni përpara një amanet nga paraardhësit tanë që ta përçoni islamin tek breznitë e rinj” ! Manipulator i pacipë bre! Krejt avdall! Shikoni se me çfarë i ngarkon anëtarët e Myftinisë! Do me thënë, ju shisni hoxhallëk, përhapne islamin, mos t’ju interesojë ruajtja e vakëfit, mos t’ju interesojnë fitri, as zeqati, as kurbanët e lëkurat e kurbanëve; mos t’ju interesojë se kush zgjidhet imam në territorin përkatës, as mos të dini asgjë se si shpenzohen të mirat materiale, si degradojnë të mirat shpirtërtërore, asgjë; ju vetëm duhet ta përçoni islamin te brezrat e ri”! A nuk është isharet ky i Shaqir Fetait se kanë vendosur me Myftiun e Shkupit që të bëjnë hara-kiri në këtë Myftini dhe se organi i saj nuk ka të drejtë të flasë, të ankohet, të kritikojë por vetëm ta “përçojë islamin” te gjeneratat e reja! Sjellje tipike prej skuthi!

Pastaj, Shaqir Fetai, si haxhuze plakë që e ka harruar të kaluarën e vet imorale, thotë: “Bëni vepra të mira sepse veprën tuaj do ta sheh Allahu Fuqiplotë, i dërguari i Tij dhe besimtarët.”! Pse a për vepra të mira qenkan zgjedhur këta anëtarë të Myftinisë, apo për ta përcjellë punën e saj, për të kërkuar raporte narrative e financiare prej saj, për t’ia tërhequr vërejtjen, për ta parandaluar në ndonjë hap antiislam, në shitje të ndonjë vakëfi, në degradim të krejt vakëfit... Këta anëtarë nuk janë aty në mekteb, para mualimit, por janë me një detyrë shumë fisnike! Për ta mbajtur në binare Myftininë dhe për të lënë gjurmë të hajrit në këtë Myftini përgjatë mandatit të tyre katërvjeçare! Dhe, kush po na thotë se Allahu i sheh veprat tona? Shaqir Fetai!!! Po a i sheh Allahu i Gjithëdëshëm veprat e Shaqir Fetait! Çka mendon ai për tradhëtinë, për vrasjen morale, për eliminimin nga “jeta” të babait shpirtëror të vetin, duke e përplasur për dysHEME dhe duke ia zënë karrigen e pamerituar sot e përjetë! A mendon Shaqir Fetai se Allahu nuk ia ka parë mynafikllëkun, hipokrizinë, vjedhjen, tradhëtinë, intrigat, një vister veprimesh imorale që i ka ndërmarrur sidomos dy-tri vitet e fundit! Ja pse Shaqir Fetai është shumë i poshtër, shumë i ligë dhe shumë i rrezikshëm. Sepse, ai sinqerisht mendon se mund t’ia hedhë edhe Zotit, siç ua ka hedhur “shokëve” të tij! (Mbani mend: Shaqir Fetai nuk ka shokë, ai kërkon të ketë vetëm bashkëveprimtarë kah për krah me “ushtrinë e djallit”)

2.

Shaqir Fetai e ka edhe cilësinë e tinëzakut! Sy më sy nuk ka b... që të përballet dhe t’i thotë të gjitha ato që i mendon për një person por, ia keqpërdor gjestin apo veprimin dhe nga distanca e bën hor! A është sjellje njerëzore, a është gjest normal, a është shprehje humane që të shkruajë në fb-un e vet se, Myftiu i Myftinisë së Tetovës, Prof. Dr. Qani ef. Nesimi ia paska organizuar një takim ngushëllimi! Demeke, ia ka pastruar rrugën, ia ka hapur shtegun duke ia hequr therrat, ia ka shtruar tapetin e kuq, ia ka mbledhur njerëzit, ia ka renditur një nga një...! Ja se çfarë pisi është Shaqir Fetai, i cili paska shkruar në një familje për të ndarë ngushëllime!!! Shaqir Fetai foli: “ndamë ngushëllimet tona”! Si more i ndamë!

Ngushëllimet a qenkan pronë personale të Shaqir Fetait, a! O avdall, ngushëllimi është ndjenjë dhembshurie që shprehet! Pra, nuk ndahet por shprehet! Dhe, ky farë duduku, për ta “ndarë” këtë ngushëllim paska pasur nevojë për një “pritje të sinqertë”! Shaqir Fetai sërish foli: “Patëm një pritje të sinqertë...”! Me këtë Shaqir Fetai dëshmon se paska pasur edhe pritje jo të sinqerta! E paskan pritur formalisht, pa kurrfarë dëshire! Ose, Shaqir Fetai në palcë e ka frikën, ai është shumë i vetëdëshëm se mund të hasë në ndonjë familje që i ka djegur, që mund t’ua ketë marrur më qafë ndonjë djalë, ndonjë baba, ndonjë anëtarë të familjes ndaj dhe, sa herë që pritet thotë: “hasëm në një pritje të sinqertë”, apo “madhështore”, apo “të ngrohtë e vëllazërore” etj. Ose, edhe pse në Tetovë, përkundër përpjekjeve për t’i ndjellë tetovarët kundër një (ANTI-gostivarlie) “unë pata një pritje të sinqertë”! Shaqir Fetai e keqpërdorë dhembjen, Shaqir Fetai e keqpërdorë trishtimin, Shaqir Fetai e keqpërdorë vdekjen dhe gëzimin, sëmundjen mendore e shpirtërore, Shaqir Fetai keqpërdorë gjithçka, vetëm e vetëm që ta ngrisë një intrigë, të arrijë që në fytyrë ta ngrijë një buzëqeshje djallëzore. Shaqir Fetai e përmbyllë këtë “dhuratë” ngushëllimi (sepse ai i ndanë ato, ai mendon se në raste ngushëllimi është në rolin e babadimrit që duhet të ndajë “dhurata”): “Falënderojmë organizimin e kësaj ndeje nga ana e Muftinisë së Tetovës në krye me Muftiun Prof Qani ef Nesimit dhe kolegëve të tuj”! Tani, Shaqir Fetai a ishte në ndonjë ndejë apo ishte në një vaki ku nuk ka nevojë për kurrfarë organizimi! Pse ka nevojë Shaqir Fetai që atij t’i organizohen ndejat dhe, këto organizime të jenë të nivelit të lartë, mundësisht t’ia organizojë Profesor Dr. Qani ef. Nesimi! A nuk ju duket cinizëm prej një të poshtri?! A nuk ju duket sjellje hipokrite prej një të djallëzuari?! A nuk ju duket një “kënaqësi” prej oficeri udbash! I poshtër është, pa dyshim që është tepër jonjerëzor, Shaqir Fetai!

3.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e

injon ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/10.02.2022

Injoranti na tranoj me “filozofi”-e

“Mos më pyeti sa vite kam, sepse, nga veprat e mia do ta kuptoni moshën time”

-Shaqir Fetai, filozof-

Nga Safet Rushiti

A e keni lexuar more “filozofinë” e Shaqir Fetait! O “filozofinë” ia dhjefshin qentë e Çegranit! O i është thënë miliona herë – o ahmak, mbylle, mos fol, sepse sa herë po flet, po e dh... fare! Kush mundet ta deshifrojë “filozofinë” e Shaqir Fetait, e ka një trileqe nga autori i shkrimit! Po të ishte thënie e fortë, pa dyshim që do ta kishte dhuratë një fluturim turistik për në Hënë! Shaqir Fetai, pasi ka marrur një pozë si ata dylberat e ktunihershi, thotë: “Gjatësia e jetës nuk qëndron në numrin e madh të viteve, por në vepra dhe në gjurmët e mira që i le në to”! Kjo është ajo budallaki e “reisit” apo, ajo urtësi” e të marrit!

E parë, sintaksa e gjuhës shqipe nuk e pranon këtë fjali! Kjo do të thotë se Shaqir Fetai logjikon në serbisht e mundohet të shkruaj në shqip!

E dyta, logjikisht, është një fjali që vjen nga një i stërmoshuar por që ka logjikën e një fëmije pesë-gjashtë vjeçare, të atij fëmije lozonjar që ka kaluar ca ditë nëpër oda të burrave dhe që, sakaq i

jepet t'ia këpusë ndonjë “urti”. (Ngjanë si ajo macja e vogël në arbain, kur del së bashku me macet e mëdha për të gjuajtur ndonjë gjë)!

E treta, as budallai më i madh, as krimineli më i famshëm, as ahmaku unikat nuk do të thoshte një fjali të tillë, sepse, e di që krejt ajo i përshtatet vetë atij, sepse kjo kategori e njerëzve, përfshirë këtu edhe Shqir Fetain, në jetën e tyre nuk kanë bërë asnjë vepër të mirë, që i bie se, nuk kanë bërë fare jetë, ndonëse mund të jenë në moshë 60-70 vjeçare!

Gjatësia e jetës pa dyshim që matet me vite që dëshmojnë për moshën. Mbase Shaqir Fetai dëshiron të thotë se vlera e jetës nuk varet nga vitet, sado qofshin ato, por nga veprat e mira! Kjo fjali po që ka logjikë!

Ndryshe, i bie që Shaqir Fetai nuk ka jetuar më gjatë se 12-15 muaj, derisa nuk ka nisur të belbëzojë ndonjë fjalë të tipit “papa-qebapa”, sepse, sapo ka nisur të flasë, sapo ka nisur të hedhë një hap në jetën e vet, ai vetëm gjurmë të pista ka lënë, vetëm gjëra të mbrapshta e të djallëzuara ka bërë! Ai mendon se me vetë faktin që paska hyrë në xhami paska bërë vepra të mëdha! Po ai edhe në xhami kur ka hyrë ka qenë i djallëzuar, ka qenë i preokupuar me tradhëti e me puç, me linçime e me komplete!

Apo, ndoshta mendon se, ai është “hafiz” dhe atij i ljohej të veprojë gjithçka antinjerëzore. Ai, avdalli, mendon se, meqë është “hafiz”, popullata mund ta amnistojë nga krimet e tij dhe ta pranojë për “njeri të mirë”! Po ky, pa dyshim, që ka qenë “hafiz” dhe, si “hafiz” ka qenë edhe nxënës-spiun i oficerit të UDB-së serb, Stanko Dragoviqit! Tani, cilat janë veprat e mira që ia zgjasin jetën këtij farë biçim “hafuzi”? Edhe spiun edhe “hafuz”?!

Vërtet, me çfarë vepra të mira mund ta masë Shaqir Fetai moshën e vet! Kur të merren parasysh të gjitha veprimet e pista, të gjitha veprimet antinjerëzore, imorale, të gjitha planifikimet djallëzore, del puuna që Shaqir Fetai akoma është një adoleshent në fazën e hershme të tij. Ndaj dhe ia këput “filozofirave” të tilla, sepse, ia arsyeton ndërvoja e tij prej adoleshenti. Jo vetëm kjo fjali, por tërë veprimtaria e tij dëshmon se Shaqir Fetai është me kapacitet

intelegjence sa të një të riu të klasës së 7-8! Ndërsa, pa dyshim, për nga veprimtaria e tij, ai nuk ka jetë, akoma nuk ka lindur, dhe bën mirë të mos lindë fare, sepse, jeta e tij do të jetë një shembull për një jetë se si nuk duhet të jetohet, as shkurt dhe as gjatë! Sepse, të lindësh dhe ta degradoshë Bashkësinë Fetare Islame në një qendër agjentësh të huaj, kjo me të vërtetë që është avullim dhe shlyerje të të gjitha gjurmëve pas një stuhie apokaliptike! Erdhi si stuhi, iku si avull, fshiu gjithçka dhe, nisi një epokë e re. Një epokë e re do të jetë për BFI-në pas ikjes së Shaqir Fetait. Ikja e tij nuk do të shënohet me kurrfarë gjurme, por ama me histori të zezë gjithësesi që po! / 1KlikLarg / 11.02.2022

Kështu foli Shaqir Fetai (29)

Shaqir Fetai paska shkuar në Egjipt dhe atje paska pallamudë diç për “Bamirësinë si fuqi dhe jo si dobësi”! Këtë konstatim mund ta japë vetëm injoranti Shaqir Fetai; vetëm ky farë komplotisti i shërbimeve sekrete mund të konstatojë se bamirësia qenka fuqi e jo dobësi! Cili mahluk në botë paska pas menduar se bamirësia është dobësi?! Dëgjojeni snobin, Shaqir Fetain – bamirësia “nuk është dobësi por fuqi”

Nga Faik Shahinbejlliu

Shaqir Fetai në Egjipt! Për herë të parë dikush ia tërhoqi vërejtjen që mos të shkojë me tërë “rijasetin” e tij në udhëtim “zyrtar”, sepse ky lloj udhëtimi nuk është piknik por aktivitet që i përket të parit! Në Egjipt paska udhëtuar me atë që nuk e do fare, që e urren për shkak të xhelozisë profesionale (spiunët tmerrësisht urrehen në mes vete!), por që në botën arabe e merr me vete sepse i duhet një përkthyes! Shaqir Fetai është i vetmi “reis” në botë që nuk e di arabishten!

Në fillim lajmi që Shaqir Fetai do të shkojë në Egjipt, pastaj lajmi tjetër se Shaqir Fetai mbërriti në Egjipt dhe lajmi pasues Shaqir Fetai u kthye nga Egjipti! Publicitetet hipokrit që i kryhet atij që i duhet një imazh pozitiv dhe imponues në masë e cila e urren tmerrësisht! Kjo përpjekje imponuese e shton neverinë edhe më shumë te masa; masa e heton sakaq “propagandën” naive të atij që është shumë i vetëdëshëm se urrehet nga kombi e nga feja! Dhe,

për më keq, gjatë këtyre “propagandave perfide” ka edhe lëshime e gabime nga më të budallakaftat!

1.

Shaqir Fetai në Kajro, me ratin e mbajtjes së Konferencës së përgjithshme të Këshillit të Lartë për Çështje Fetare Islame, qenka takuar me Ministrin për Çështje Fetare Islame të Egjiptit me të cilin “paskan bërë një vizitë te kompleksi i Kalasë të Muhamed Ali Pashës”!

Kjo Konferencë e rregullt mbahet nën patronazhin e kësaj Ministrie ndaj dhe, është e pashmangshme në protokoll që mysafirët të priten nga ky Ministër, sepse janë mysafir të tij. Pra, jo vetëm Shaqir Fetai, por me këtë Ministër janë takuar të gjithë të pranishmit edhe atë jo më gjatë se 15 minuta! Nuk ka shansë absolute, nuk mund të ndodhë gjallë në botë që, Shaqir Fetai dhe Ministri për Çështje Fetare të dalin dhe të shëtisin, t’i bëjnë një vizitë Kalasë. Në protokoll mbase është paraparë që të gjithë të ftuarit, të shoqëruar nga Ministri në fjalë, të bëjnë një vizitë të përbashkët në Kalanë e Muhamed Ali Pashës! Shaqir Fetai, në stilin e një udbashi cinik, ia do b... shumë fort që gjithnjë të fusë huti në opinion duke hedhur një gënjeshtër me mëlmesa perfide vetëm e vetëm që të tregojë diçka me një “të vërtetë” dykuptimore! Ky ishte stili i dikurshëm i UDB-së serbe!

Para kësaj vizite Shaqir Fetai ofron një informacion tamam si dikur nëpër kanalizime të UDB-së, duke informuar se si e falën xhumanë, ku e falën xhumanë, kush ua fali xhumanë! A bëhet lajm falja e xhumasë amani ju qoftë! Dhe, “Pastaj nën udhëheqjen e Ministrit, Reisul Ulemaja vizitoi Kalanë e Muhammed Ali Pashës”! Shumë e poshtër, shumë e ulët! Të përjashtoshë personalitete fetare nga e gjithë bota dhe, ta personalizoshë Ministrin për Çështje Fetare në këtë vizitë, vërtet që është e poshtër, naive dhe shumë perfide!

Dhe, paramendoni, “Gjatë këtij takimi, Reisul Ulemaja u njoftua me mënyrën dhe praktikën të cilat i aplikon Qeveria e Egjiptit në menaxhimin dhe me organizimin e jetës fetare në vend. Poashtu edhe Reisul Ulemaja pati mundësinë që ta njoftojë Ministrin për Çështje Fetare të Egjiptit me funksionimin e Bashkësisë Fetare Islame në RMV”! Do me thënë, Ministri egjiptas qenka ndalur në një qoshe të Kalasë me Shaqir Fetain dhe i paska raportuar për

menaxhimin dhe praktikat në organizimin e jets fetare në Egjipt!
Po ashtu, shpejt e shpejt (që mos të hidhërohen të tjerët!) edhe
Shaqir Fetai e paska informuar për organizimin e jetës fetare
islame në Maqedoni! Nëse “ka informuar” Shaqir Fetai, pa dyshim
që ka rrejtur, e ka zhonglirë Ministrin në fjalë, sepse vetëm
organizim të jetës fetare islame nuk ka në Maqedoninë e Veriut,
vetëm BFI nuk ka në këtë shtet! Po, ka një “bashkësi fetare” (që
nuk është islame) e Shaqir Fetait, porse, askujt në botën turko-
arabe nuk i ha b... për “bashkësinë fetare” të Shaqir Fetait!
Kulmi i ironisë dhe i cinizmit të pistë të Shaqir Fetait është “fjalja”:
“Ata (Shaqir Fetai dhe Ministri egjiptas) këmbyen eksperiencën të
përbashkëta dhe ndruan mendime rreth çështjeve të ndryshme
fetare”! Shaqir Fetai shumëfish më tepër ka eksperiencë në
spionim se sa në çështje fetare. Pikël!

2.

Në Kajro këto ditë qenka organizuar Konferenca e rregullt me temë
“Kontrata e qytetarisë dhe ndikimi i saj në realizimin e Paqes në
shoqëri dhe në Botë”! Egjipti i Universitetit më të vjetër në botë “El
Az’har”, ndër vendet me ulema më të fuqishme në botë, me
inelektualë të kalibrit botëror, të organizojë një Konferencë me një
titull të tillë?! Nëse titulli është i vërtetë, atëherë kemi të bëjmë me
një Egjipt totalisht analfabet, por, pa dyshim, e vërteta është se në
Egjipt kanë prezantuar dy dibiduzë e dy analfabetë të llojit të vet
që titullin na e shqipërojnë në këtë formë pa kuptim e pa
përmbajtje! Mbase është edhe misioni i tyre për ta devaluuar klasën
intelegjente të Egjiptit duke ua mvëshur organizimin e një teme
alogjike!

3.

Shaqir Fetai dhe piuni i tij paskan realizuar edhe një takim me
studentët shqiptarë të Ez’herit! Një takim i formatit që nuk mund të
dalë përtej kornizave të kodoshllëkut! Shaqir Fetai, ndonëse “i
çmuaka” studentët e këtij Univeriteti, megjithatë, nuk lë pa u
tallur me ta dhe pa i gënjer! Ai u thotë se këta studentë janë në
fokusin e “bashkësisë fetare” të tij, ashtu siç shpreh përkujdesje
“për të gjithë studentët e tjerë në vend ashtu edhe nëpër botë”! Nëse
Shaqir Fetai e di numrin e studentëve shqiptarë që studiojnë nëpër

botën turko-arabe, nëpër qendra të ndryshme islame e shkencore, nëse di se në cilët shtete turko-arabe studiojnë studentë shqiptarë, atëherë, ia vlenë që t'i thuhet një "bravo", por, nëse nuk i di atëherë duhet të kamxhikohet si gomari që nuk ia arrinë t'i lëvizë këmbët nëpër baltë!

Pastaj Shaqir Fetai kërkon nga studentët shqiptarë që të gjurmojnë në arkiv të Universitetit dhe të merren informacione për të gjithë studentët shqiptarë që kanë mbaruar në këtë Universitet dhe, për këtë qëllim, paska formular edhe "komision" të veçantë, me emra e mbiemra studentësh, ndonëse kjo çështje mund t'i caktohej ndonjërit prej studentëve si disertacion magistrature apo doktorature! Dhe, vërtet, pse i duhen këto informacione Shaqir Fetait?! Pse i duhen BFI-së? Ky hulumtim i ka edhe kostot e veta! A u ofroi përkrahje financiare studentëve për ta realizuar këtë temë e cila më tepër zgjon kërkshërinë e UDB-se serbe se sa të popullatës myslimane në Maqedoninë e Veriut. Këtë informacion mund ta ketë secili "shkencëtar" në Maqedoninë e Veriut, sepse "Az'haristët" njihen dhe dihen, siç njihen dhe dihen edhe manipulantët dhe fallsifikatorët! Nëse i duhet kjo listë Shaqir Fetait "dikush" mund t'ia dorëzojë rrum për gjysëm ore! Natyrisht, kjo nuk i duhet Shaqir Fetait, por ai e përdor këtë truk sa për të thënë, zha-zha, çfarë projekti kemi inicuar në Kajro që na qenka Kryeqyteti i Egjiptit (phuuu, si nuk e paskemi ditur bre!!!) I duhet për vetëlavdërim, sepse është fare koshient se punët i ka m..., i ka helaç, berbat dhe, me këto elementë fiziologjikë nuk mund të mbulohet pislliku edhe më i madh që u shkaktua me rastin e tradhëtisë, komplotit dhe puçit të Shaqir Fetait që, i ndihmuar nga elementët antiislam e antikombëtar, i ndërmori kundër BFI në RMV!

Gëzim i papërshkrueshëm i Shaqir Fetait paska shpërthyer në çastin kur studentët i paskan premtuar se do të vijnë në mënyrë të organizuar për ta vizituar dhe për t'ia bërë për hajër "reisllëkun" dhe për t'i dëshiruar shëndet suksese si deri më sot!!!

4.

Para qindra liderëve fetar Shaqir Fetai paska prezantuar temën e vet! Ndonëse i vetëdëshëm se tema e tij nuk korrespondonte askun me temën boshte të Konferencës, ndonëse i vetëdëshëm se po gënjente, ndonëse i vetëdëshëm se nuk po e tregonte të vërtetën, ai po belbëzonte në një arabishte të tij qesharake, më plotë gabime në

lexim, të përkthyer për hakaret nga shqipja e Shaqir Fetait në arabishten e bashkëveprimtarit të tij, Ismet Ademi! Shaqir Fetai kishte zgjedhur një temë me titull “Bamirësia – Fuqi e jo Dobësi”. Natyrisht, ndër mendimtarët e ndryshëm nga bota në këtë Konferencë, ky titull shkaktoi një të qeshur të pandalshme! Për herë të parë po informoheshin se “bamirësia qenka fuqi e jo dobësi”! A nuk tallet Shaqir Fetai me parimet e bamirësisë, me mësimet islame mbi bamirësinë, me vetë esencën e bamirësisë, apo, ky është kapaciteti “intelektual” i Shaqir Fetait në diskutime dhe debate publike, mijëra kilometra larg publikut vendor, i cili ia di edhe frymëmarrjen dhe zorrët në bark! Shaqir Fetai na e paska zbuluar se bamirësia qenka fuqi e jo dobësi! Por, ja që bamirësia e ka bërë shumë të dobët Shaqir Fetain, edhe më të dobët se sa vetëmse në cilësi të kodoshit! Si flet Shaqir Fetai për bamirësi i cili tërë jetën e vet e ka përplot me vepra të këqia e antiislame, e ka përplot me vuajtje e mynxyra që ua ka shkaktuar qindra myslimanëve, e ka përplotë me vjedhje të ndihmave humanitare si vepër bamirësie; si nuk i vjen turp të flasë për bamirës ndërsa ka vjedhur ose e ka ndihmuar ish-kryetarin e Oraganizatës Humanitare “Hilal” (Mustafa Dautin) në vjedhje të qindra pakove dhe të mijëra kilogramëve të ndihmave humanitare; si flet për bamirësi Shaqir Fetai kur tërë bota e di se ai, bashkë me atë, me të cilin vodhën e vodhën deri në “alivanosje” ndihma humanitare, në fund, njëri u instaluasi “reis” e tjetri u kyç në shërbime intelegjente me qëllim që mos të përndiqet për anti-humanitet që e ushtroi mbi myslimanët e varfër të vendit! Si flet për humanitet Shaqir Fetai kur e tërë bota e di se ai pranoi që të tallet me “babain e vet shpirtëror” dhe ta “vrasë për së gjalli” duke shpikur lloj-lloj dezinformate për të, me qëllim që ta spostojë nga fotelja e të parit dhe t’ia rrëmbej atë pozicion pa kurrfarë merite e me përkrahje të elementeve antiislame e antishqiptare?!

Shaqir Fetai e ka rreptësisht të ndaluar të flasë për bamirësi, ndërkohë që të gjitha veprimet i ka antihumane, e ka të daluar sepse me tema të tilla, në fakt ai tallet me vetë Zotin! Sepse, mundohet ta gënjejë Atë dhe myslimanët e vendit!

A ju tregoi liderëve botërorë Shaqir Fetai se nga përfundimi i Ramazanit të vitit 2021 e deri më sot, deri në prag të Ramazanit të vitit 2022, cilin aktivitet bamirësie e ka ndërmarur, sa ka bërë aktivitete bamirësie për myslimanët e vendit që janë buzë varfërisë fatale? Cilit të varfër ia dha qoftë dhjetë dinarë nga xhepi i vet?

Cilit qytetar skajshmërisht të varfër ia ofroi një pako me ndihma humanitare? Zero! Dhe ka fytyrë të flasë para liderëve botërorë? Problem është hera e parë kur të humbësh fytyrën, pastaj të bëhet rrafsh, për më tepër, nëse tallesh dhe i nëpërkëmbë porositë e Zotit Fuqiplotë!

5.

Shaqir Fetai, në rolin e “kryediplomatit” të qeverisë maqedonase nuk harron që, në çdo vend të botës, t’i takojë edhe ambasadorët e vendit! Kësaj radhe “i paska takuar” ambasadorët shqiptarë! Shaqir Fetai informon: “Në këtë takim mjaft domethënës e vëllazëror Reisul Ulemaja dhe diplomatët shqiptarë kaluan një mbrëmje të bukur ku biseduan për shumë çështje, në veçanti për kohën e artë të Egjiptit gjatë udhëheqjes së Muhamed Ali Pashës, i cili ka pasur prejardhje shqiptare dhe të cilin Historia e njeh si reformator i madh i Egjiptit dhe themelues i Egjiptit modern. Njihërit biseduan me kuriozitet për dinastinë shqiptare, e cila me dekada udhëhoqi Egjiptin duke lënë gjurma të pashlyeshme në zhvillimin e Egjiptit.” Ha torta, shpenzo para të vakëfit e fol për hallet e dinastisë shqiptare të Egjiptit. Pi kafe e madhëro Muhamed Ali Pashën! Shaqir Fetai në mesin e diplomatëve shqiptar?! Sakaq është kuptuar nga diplomatët se Shaqir Fetai nuk është i denjë për dy copa dele e jo për punë më të mëdha! Shaqir Fetai manipulon me përmallimin e diplomatëve, manipulon me resektin e tyre, me qytetarinë e tyre, manipulon me hallet dhe misionin e tyre dhe i nënçmon deri në “badihavxhi që kanë kohë për të folur edhe për historinë e dinastisë mbretërore shqiptare në Egjipt. A nuk ju foli diplomatëve për kontributin e vet për të ikur çegranasit nga katundi i tyre që dikur kishte 13 mijë banorë dhe sot ka vetëm 3 mijë! Për t’i ikur kësaj pëgjegjësie historike, fol më mirë për Muhamed Ali Pashën! Madje ky na paska qenë preokupim parësor edhe për diplomatët shqiptar!

6.

Shaqir Fetai, gjatë qëndrimit në Kajro, si të gjithë pjesëmarrësit në Konferencën e rregullt, paska realizuar edhe një takim kurtoazie “me Shkëlqesinë e tij, Ministrin e Vakfit të Mbretërisë së Arabisë Saudite Dr. Abdul – Latif Bin Abdul Aziz Al Shejh”. Shaqir Fetai,

paramendoni, e informon Ministrin me punën e Bashkësisë Fetare Islame të RMV si dhe bashkëpunimin e saj me institucionet e ndryshme të Arabisë Saudite në përgjithësi. E paska falënderuar Shkëlqesinë e tij për konkluzat e miratuara në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të Mbretërisë së Arabisë Saudite për bashkëpunimin e mirëfilltë dhe institucional me BFI. Pse a nuk i ditka ministri “bashkëpunimet” e intitucioneve arabe me “bashkësinë fetare” të Shaqir Fetait?! Ky ministër a është pjesë e Këshilli të Ministrave të Mbretërisë së Arabisë Saudite, apo, thjesht, është një qytetar i rëndomtë i cili duhet të informohet për punët e këtij Këshilli Ministror?! Hej, një Këshill ministror i një Mbretërie që paska miratuar konkluzione për bashkëpunim me një institucion fare të pavlerë e të diskutueshëm në derexhe në të cilën e ka sjellë Shaqir Fetai? Shaqir Fetai edhe një herë dëshmon se është në trans, se ka halle të mëdha, se po e vuan deri në vdekje tradhëtinë, komplotin dhe idiotizmat që i ka bërë e që po i bën, prandaj edhe, nuk di se çka flet, prandaj edhe pranon me lehtësinë e paimgjineshme shpirtërore të gënjejë e të mos turpërohet fare! “Interesimi i Ministrit të Vakfit të Mbretërisë së Arabisë Saudite Dr. Abdul – Latif Bin Abdul Aziz Al Shejh ishte që të ketë bashkëpunim të ngushtë me BFI dhe këtë e vërtetoi edhe me vendimin se shumë shpejt do ta vizitojë Bashkësinë Fetare Islame në RMV ku do bisedohet për bashkëpunimin tonë në të ardhmen”, thotë Shaqir Fetai, por nuk tregon se cili është motivi i kësaj vizite, cila është filozofia e lidhjeve të ngushta në mes të Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe “bashkësisë fetare” të Shaqir Fetait; ai nuk flet asgjë për faktin se pse kaq shpejt dhe përnjëherë u trashën kaq shumë marrëdhëniet në mes të kësaj Mbretërie dhe Shaqir Fetait?! Ministri do të vikëka për evitimin e ekstremizmit dhe radikalizmit tonë?! Ku e sheh këtë ekstremizëm dhe radikalizëm Shaqir Fetai? Pse a nuk paska forcë që ta evitojë vetë dhe, për këtë arsye, paska nevojë për “thirr mikun” për të vënë paqe edhe në Maqedoninë e Veriut si gjithkund në botë!

7.

Meqë ra fjala për takimin e Shaqir Fetait me Ministrin për vakëf, a i tregoi Ekselencës së tij se si Shaqir Fetai ka vjedhur nga vakëfi; a i tregoi se si ka zhvatur nga vakëfi; a i tregoi se si e dështoi projektin e Bankës Islame për Zhvillim për ndërtimin e një qendre tregtare e

cila do të ngelej vakëf për BFI-në në vlerë prej miliona dollarëve; a i tregoi se si pranon çmime qesharake për dëmshpërblim për pronat vakëf që llogariten si interes publik; a i tregoi Ministrit të nderuar se si dëmshpërblimet në bona me vlerë i ha e i rruan me honxho-bonxhot e vet duke u dhënë rroga, mëditje, dreka e darka, në vend se ato të shpenzoheshin për blerje të vakëfit ashtu siç e parasheh parimi i shitjes dhe tëhuajësimit eventual të vakëft! Vakëf për vakëf e jo vakëf për rroga të Shaqir Fetait! Jo, sepse, menjëherë Ministri arab do ta shpallte të pafe e do t'i biente vijë të kuqe. Por, kjo dukuri e përditshme e Shaqir Fetait nuk është mickonjë e padukshme, është veprim kriminal që nuk kalon pa u ndëshkuar. Drejtësia vonon por nuk harron!

8.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/15.02.2022

Viti i keqpëdorimit të vakëfit

Vakëfin, takimet private dhe aspak të rëndësishme për BFI-në dhe myslimanët e vendit si dhe “kontributin në luftimin e Coronavirusit – janë tri fjalë të një refreni të “këngës” së Shaqir Fetait, e cila, jo vetëm që është bërë e besdishme por edhe kur të “këndohet” del si krrokamë mortore e sorrës mbi hurin e gardhit

Nga Mr. Eset Shaqiri

Shaqir Fetai që nga viti i kaluar nuk u ndal së lavdëruari se “ky vit është vit i vakëfit”! I cilit vakëf? I atij të kthyer pas një procesi të gjatë të denacionalizimit? Angazhim mbi dy dekada të strukturave të BFI-së, procese gjyqësore, pagesa të majme për kompletim të dokumenteve, pagesa të majme për ekspertët në hartëzimin e vakëfit dhe në kompletimin e dokumentave dhe, më në fund, vijnë frutet e këtij angazhimi dekadësh, frute këto që po ia “mpijnë dhëmbët” Shaqir Fetait!

Shaqir Fetai, në disa paraqitje të tij publike ka falënderuar publikisht pushtetin e ish-kryeministrit Zoran Zajev, i cili tri-katër muaj me radhë i ka ndarë BFI-së para nga buxheti shtetëror i krijuar enkas për tejkalimin e problemeve financiare si pasojë e pandemisë nga Coronavirusi. Në fund, me gjasë, ata struktura qeveritare që e instaluan në krye të BFI-së e panë më të arsyeshme që ta “mbushin” me bona në vlerë, sepse, njeriun që e ngarkuan

padrejtësisht me një punë që nuk e meriton edhe duhet ta mbajnë disi, që të dalë sa më “faqebardhë”! Aq dinë ata, sepse bonot në vlerë nuk janë “kontribut financiar” për ta shpenzuar Shaqir Fetai me bashkëveprimtarët e vet. Një ditë urdhërdhënësit e shpenzimit të ketyre letrave në vlerë do të përgjigjen për çdo vakëf të shpenzuar e për çdo cent të vakëfit të shitur!

Dhe, Shaqir Fetai mburret me “suksesin e vet” të clin e quan “vit i kthimit të vakëfit”, të cilin ia përshkruan vetes si aktivitet!

Vakëfi po vidhet

Nejse, le të jetë edhe “sukses” i tij, për BFI-në jetike është kthimi i vakëfit! Por, çfarë po ndodhë me këtë vakëf që po konvertohet në bono me vlerë? A po zë vend vakëfi i ri, a po vjen në shprehje filozofia “vakëf për vakëf”, apo, të gjitha bonot po shpenzohen për rroga, për mirëqenie të nëpunësve të Shaqir Fetait, me të cilën ai po e blenë rehatinë e vet! Shpenzohet vakëfi që të zgjasë “karriera” e Shaqir Fetait?

A e ka lexuar Shaqir Fetai rregulloren e BFI-së për sa i përket vakëfit dhe menaxhimit me vakëfin? A e di Shaqir Fetai se sa para nga vakëfi i denacionalizuar në bono shkojnë në Myftininë e Shkupit dhe sa i merr “rijaseti” i tij! Vakëfi nuk mund të jetë në pazar për të përfituar Shaqir Fetai dhe bashkëveprimtari i tij, myftiu i Shkupit (së cilës Myftini i janë kthyer më së shumti vakëf-letra me vlerë), Qenan Ismaili, por, të ardhurat që gjenerohen nga menaxhimi i vakëfit mund të ndahen sipas rregullores së miratuar nga ish-Rijaseti! Assesi nuk guxon që të komprometohen letrat në vlerë që jepen në vend të vakëfit! Ato letra në vlerë duhet të shpenzohen ekskluzivisht dhe tërësisht në blerje të vakëfit të ri, sepse, kjo Myftini duhet të funksionojë nga vakëfi dhe jo nga rjepja e myslimanëve (anëtarësia e myslimanëve të vendit është më e larta në rajon)!

Shaqir Fetai, në vend se “ta vizitojë” Myftininë e Shkupit dhe t’ju ndajë vërtetime anëtarëve të rinj të Myftinisë (!!!), ai duhet të

kërkojë llogari nga Myftinia se çka po bëhet me paratë që erdhën si proces i denacionalizimit të vakëfit të Shkupit. Shaqir Fetai tashmë ka dëshmuar se as “tërrt” veshi nuk i bën për sa i përket vakëfit, sepse në Myftininë e tij derisa ishte myfti i Gostivarit, e largoi investimin kapital miliona dollarë nga Banka Islamike për Zhvillim, nga i cili do të dilte një vakëf më i madhi në vend që do të ishte pasuri e kësaj Myftinie.

Vakëfini nuk është aksion fetar për grumbullimin e financave nga myslimanët e vendit të cilat do të ndaheshin sipas një rregulloreje përkatëse! Paratë e shitjes së një vakëfi, automatikisht duhet të shpenzohen në blerje të një vakëfi tjetër dhe jo në ndarje proporcionalisht sipas marrëvesjes në mes të Myftinisë dhe Rijasetit. Vakëfi i tjetërsuar siguron vakëf tjetër. Dhurimi i një vakëfi për të mirën e përgjithshme siguron një vakëf edhe më të leverdishëm. Vetëm Shaqir Fetai dhe honxho-bonxhot e tij e ndajnë vakëfin “e shitur”! Kompensimi i vakëfit me bono në letër dhe shpenzimi i këtyre bonove, kompensimit i jep karakter shitjeje!

Vizitat private dhe ato to parëndësishmet

Për Shaqir Fetain opinioni i gjërë është i bindur se është i vetmi “personalitet” që i kurdisë vizitat, që fton njerëz për vizita dhe që i lutë njerëzit për t’i vizituar! Pa kurrfarë plani, pa kurrfarë protokoli, pa kurrfarë levërdie! Thjesht, vetëm e vetëm që të mbetet disi “aktual” në fb-un e vet si dhe ta keqpërdorë faqen zyrtare të BFI-së duke i postuar përshtypjet e vizitave të veta private.

Për t’ju dhënë peshë edhe më të madhe, ai ndanë edhe “dekoracione”, “Kuranin e artë”, “Llogon e BFI-së”! U ka ndarë “macasi-kucasi”! Të gjitha këto “dekoracione” natyrisht që janë të kushtueshme dhe, sipas një përlllogaritje të thjeshtë, Shaqir Fetai deri më sot ka ndarë “dhurata” të tilla në vlerë sa një rrogë vjetore e një nëpunësi të tij! Ku pyet Shaqir Fetai për nëpunësin e vet kur është në pyetje “reklamimi” i “ekselencës” së vet! Të tjerët nuk i interesojnë, prandaj, shumë shpejt do të turpërohen nga çastet

nga koha e shtrenjtë e tyre që i kanë ndarë me Shaqir Fetain!
Çfarë është me rëndësi takimi i Shaqir Fetait me miqtë e tij që të publikohen në faqen zyrtare në BFI? Çka është me rëndësi për BFI-në takimi i tij me ambasadorët partiakë (jo me ata të karrierës, sepse ata as që i japin shans për një takim të tillë)! A janë normale “raportimet” në faqen zyrtare mbi faljen e namazit të xhumasë, mbi faljen e xhenazeve, mbi kryerjen e umres...

Historiku i BFI-së nuk njeh të jetë drejtuar nga njeri me një popullaritet kaq të ulët, me një imazh kaq të pështirosur, me një servilosje të paparë!

Shaqir Fetai në roloin “insitucionit” të OBSH-së

Njeriu i cili e kaloi koronavirusin, njeriu të cilit bashkëpunëtori i vdiq nga koronavirusi, njeriu i cili gjysmën e “kabinetit” të tij e paska pasur të sëmurë nga kjo pandemi, paska ndikuar jashtëzakonisht shumë në parandalimin e përhapjes së koronavirusit, “duke i respektuar të gjithë këshillat dhe duke vepruar konform rregullave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë” që i paskan ardhur atij! Flet për një respektim të masave ndërsa kurrë nuk ka zbritur nëpër xhamitë tona për të shikuar se çfarë kaosi bëhet për ditët e xhuma! Flet për mbajtje të maskave ndërsa poston fotografi nga “takimet vëllazërore” ku 30-40 veta janë në sallë, të ngjeshur njëri për tjetrin dhe pa maska! Së këndejmi, me çfarë arsye vetëlavdërohet (apo si është e mundur të nxjerrë kaq shumë gënjeshtër), me çfarë logjike mburret kur këtë nuk e bëjnë madje as vetë institucionet shtetërore që e kanë brengë të madhe pandeminë, madje as vetë OSHB-ja që nxjerr rregullore dhe vendime në raport me pandeminë nuk është lavdëruar kurrë. Me gjasë nuk po i lë rend Shaqir Fetai.

Falë Zotit, është një fatbardhësi për vetë myslimanët e vendit që, askush nga faktorët me relevancë nuk po e marrin si “lider serioz” e as si njeri me të cilin ia vlenë bashkëpunimi i gjithanshëm. Shyqyr Zotit që, madje, as vetë myslimanët e vendit nuk e

llogarisin ndonjë personalitet të vetin, as kombëtar dhe as fetar, ndaj dhe, falë kësaj, myslimanët e vendit nuk kanë kurrfarë përgjegjësie, kurrfarë hipoteke, kurrfarë faji dhe as mëkati. Sepse, ata as nuk e kanë zgjedhur, as nuk e kanë votuar dhe as që e llogarisin për të vetin!

Sepse, të gjithë e dinë se, Shaqir Fetaj, nuk e ka për islam por e ka për pension, prandaj e shtynë disi, duke e hëngër vakëfin, duke e shpenzuar vakëfin vetëm e vetëm që t'i zgjatet qëndrimi në “kolltuk” deri sa të vie momenti i pensionimit. Kolltuku ku është instaluar natyrisht që i garanton një pension më të madh, ndaj dhe nuk çanë kokë për asgjë! Zoi është i Madh, Ai sheh gjithçka, është i Gjithëdhënësi!/TetovaSot/22.02.2022

Bamirësia si pasqyrë e shpirtit

Altruizmi është shkalla më e lartë e bamirësisë. Ai që heq dorë nga të mirat personale, që heq dorë nga një pjesë e pasurisë së vet, që edhe nga kafshata e gojës së vet dhe të familjes heq një pjesë për një të varfër, për një nevojtar, për një të ngratë e për një jetim, dhe këtë veprim e bën vetëm për hirë të Allahut Mëshirëplotë, ky po që është bamirës

Nga Mr.Abaz Islami

Kohë më parë, në konferencën e rregullt ndërkombëtare organizuar në Egjipt, nën patronatin e Ministrisë për Çështje Fetare, me kumtesë para të pranishmëve qenka paraqitur edhe Shaqir Fetai, i vetëshpalluri “reis” i bashkësisë fetare të tij! Titullin “kumtesës” së vet ia paskësh lënë “Bamirësia – Fuqi e jo dobësi”, titull ky i padenjë edhe për nxënësit e klasës së parë, sepse është tepër qesharake, titull fiks për humoreska pa krip. Kush është ai person në botë që paska pas thënë se “bamirësia është dobësi” ndërkohë që, Shaqir Fetai, “pas shumë hulumtimeve” ka dalur me konstatim se “bamirësia qenka fuqi e jo dobësi”, me qëllim që t’ia përlligjë definicionin atij që paskësh menduar se kjo vepër e kryer në emër të Zotit na qenka dobësi! Pha, çfarë zbulimi epokal ky i Shaqir Fetait!

Po le ta shohim se në ç’nivel është bamirësia e Shaqir Fetait. Cila është ana altruiste e tij! A ka marrur dikë më qafë, a ka dëbuar dikë nga puna, a e ka nxjerrë dikë nga puna duke ia vështirësuar jetën personale, të fëmijëve, të familjes! Me çka ka kontribuar

Shaqir Fetai që të zbutet kjo situatë e mjerë. A ia ka ngulur dikujt thikën pas shpine, duke tentuar që t'ia varfërojë personalitetin deri në asgjësim total. Këto janë akte kriminale e jo bamirësie!

Cili është gjesti altruist i Shaqir Fetait! Me ç'farë ndihme humanitare personale ka ndihmuar ndonjë lypsa, ndonjë të varfër, ndonjë nevojtar. Kujt ia ka zgjatur dorën! Është e pamundur të ketë vepruar diçka në këtë drejtim, sepse, ndryshe, facebook-un e vet dhe të bashkësisë fetare të tij do ta kishte vërshuar me informatë mbi “aktin humanitar” të tij, për më tepër, pasi që dihet se Shaqir Fetai është i prirur që edhe qimen ta bëjë tra!

Shaqir Fetai, vetëm kur t'i vie veza, apelon për humanitet, duke e nxitur edhe popullatën që të shtrijë dorën e humanizmit, të kontribuojë financiarisht për mirëmbajtjen e “institucioneve arsimore” të bashkësisë së vet! Nisë e ndërmer veprime në distribuimin e ndihmave të ardhura nga jashtë, ndërsa i paraqet si “bamirësi” e bashkësisë fetare. Duke manipuluar në emër të bamirësisë që nuk është as e tij dhe as e Institucionit që e ka uzurpuar me ndihmën e subjekteve që skanë lidhje me islamin, ai mundohet që ta joshë popullatën që të bëjë po atë veprim humanitar që po “e bën” Shaqir Fetai!

Tani meqë jemi në prag të Muajit të Shenjtë të Ramazanit, ai do të “inskenojë” bamirësi, ndërsa për 1 muaj rresht tashmë është bërë traditë që për Ramazan BFI ta distribuojë ndihmën e ardhur nga institucionet fetare turke. Pastaj, bamirësia e Shaqir Fetait “ngrihet”, “konservohet”, “lihet në heshtje” për rrafsh një vit.

Popullata e mjerë nuk ka më nevojë për ndihma humanitare, për asnjë ditë, javë dhe muaj pas Ramazanit. Në aspekt të humanitetit, çfarë ka bërë Shaqir Fetai që nga përfundimi i Ramazanit të vjëmë e deri më sot? Asgjë, sepse, sikur edhe vetëm një përpjekje ta kishte bërë, (vetë)lavdërimi i tij do të prekte kupën e qiellit! Pra, ai, as si njeri, dhe as si “institucion” nuk ka shans të na ligjërojë mbi bamirësinë, sepse, në këtë aspekt biografinë e ka terr e të turpshme. A e ka keqpërdorur ndonjëherë ndihmën humanitare? Po, madje plotë herë. Madje ka edhe dëshmitarë të gjallë që mund ta vërtetojnë këtë konstatim, sepse jo një herë e kanë futur Shaqir

Fetain në lojën e keqpërdorimeve të ndihmave humanitare. Bamirësi është edhe përpjekja për ta shtuar vakëfin, për ta siguruar financiarisht mirëmbajtjen e jetës fetare islame, të imamëve, hoxhallarëve, profesorëve fetarë etj. Nuk do t'i zgurdullonte sytë pas vakëfit të Shkupit, por do të merrte të gjitha masat institucionale për ta ndëshkuar myftiun e Shkupit për përfshirje në keqpërdorim të vakëfit të denacionalizuar në formë letrash me vlerë. Bamirësia dhe Shaqir Fetai janë dy nocione paralele që kurrë dhe në asnjë moment nuk mund ta kenë një pikëprerje apo një pikëtakimi. Shaqir Fetai e di fare mirë që është antihumanist i regjur. E di fare mirë që jeta e tij është skajshmërisht e varfër në skenën e bamirësisë! Ndërsa Allahu Mëshirëplotë na porositë që të bëjmë sa më shumë vepra të mira, të cilat, që të gjitha regjistrohen si bamirësi në emër të Allahut. Shaqir Fetai nuk e kupton dhe nuk e do bamirësinë. Një vit të tërë të mos e bëjë një vepër bamirësie?! Po, ka bërë herëpaseherë duke ftuar kalimtarë të rastin për t'i qerasur me ndonjë çaj të BFI-së, për të shpenzuar kot e kot fitrin, zeqatin dhe kontributet vullnetare të myslimanëve të vendit të dhëna për zhvillim të jetës fetare. Dhe këtë jo për "bamirësi" por për moment për informatë që do ta "lartësojë ekselencën e tij", Shaqir Fetain, si në fb-un e vet ashtu edhe në atë të bashkësisë së tij "fetare"! Fare në fund, bamirësi është edhe ruajtja dhe ushqimi i islamit burimor si dhe përcjellja e këtij islami te gjeneratat e reja, ashtu siç e mori (nëse e ka marrur?!) edhe Shaqir Fetai prej hoxhallarëve më të vjetër. Nuk është aspak bamirësi ngatërrimi i fesë me ideologjira të kota dhe të huaja, të paktën për shqiptarët myslimanë, siç po e toleron dhe po e ushqen Shaqir Fetai duke u munduar ta lë trashëgim këtë "traditë" të kobshme, sidomos për shqiptarët. Kur mercenarizmi kuptohet si mision "i shenjtë", atëherë bamirësia kalon në dobësi dhe në akt "të shëmtuar". Kuazibesimtari është zhvatës, ai nuk mund të jetë bamirës e t'i zbatojë urdhërat e Zotit të Madhërishëm./TetovaSot/22.02.2022

Rrënimi i frikshëm i autonomisë së organeve

Shaqir Fetai ka shkruar në fb-un e vet se së fundmi ka qenë në Myftininë e Strugës dhe të Ohrit “ku u bë konstituimi i antarëve të rinjë”! Si po u bëka “konstituimi i anëtarëve”?! Konstituohet kuvendi, organet, këshillat dhe jo përfaqësuesit, anëtarët, deputetët! U konstitua deputeti, deputetët! Sipas logjikës së Shaqir Fetait, edhe kjo bën vaki

Nga Shaban Aziri

Myftinitë (dhe jo myftinjtë) janë organe të BFI-së, të cilët kanë autonominë e vet në veprim, bazuar në Kushtetutën e BFI-së si dhe në Rregulloren për punën e Myftinive. Organi më i lartë kolektiv (rijaseti) apo, “organi suprem” (reisi) përcjell punën e organeve si dhe u kërkon raporte periodike apo vjetore. Në rast të dështimit të planeve akcionale atëherë shkarkohet myftiu dhe ndërrohet tërë organi i Myftinisë. Myftia aktivitetet e veta i zhvillon në bazë të planit dhe programit vjetor të vetin i cili duhet ë kalojë para anëtarëve të myftinisë. Anëtarët e myftinisë miratojnë planet e myftiut, përcjellin aktivitetet e tij si dhe të operativës së myftinisë. Së këndejmi, këta anëtarë asgjë nuk i lidhë me reisin, as nuk i përgjigjen atij dhe as që u duhen direktivat “politike” prej tij! Anëtarët e organit të myftinisë nuk janë anëtarë të rijaseti! Ata janë vullunterë dhe aderojnë në organ vetëm sepse janë myslimanë dhe ndjejnë nevojë për të kontribuar për fenë islame, ndaj dhe nuk kanë nevojë për kurrfarë “dekreti” apo vërtetimi prej “reisit” për aktivitetin e tyre vullunter. Apo, edhe këta duhet t’i nënshtrohen

Shaqir Fetait, ndryshe, sakaq mund t'ua bëjë nult vendimin që ua ka dhënë si anëtarë myftinie!

Pse kjo përpjekje djallëzore e Shaqir Fetait?! Pse ai t'u japë vërtetime, kur për një gjë të tillë nuk ka nevojë, kur për anëtarë të myftinisë ka votuar mexhlisi i xhemateve. Pra, këta janë ata që japin besim dhe këtë janë ata që tërheqin besimin, dhe jo Shaqir Fetai. Po pse atëherë imponohet Shaqir Fetai? Sepse dëshiron ta ngulfasë autonominë e Myftinive? Sepse, dëshiron që atyre t'ua bëjë me dije se ky është "pushtetari" i tyre dhe jo myftiu, ky është ai që jep vërtetime dhe, për pasojë, ky është ai që ua tërheq vërtetimet!

Kur ka qenë kjo praktikë? Asnjëherë, madje duket si shumë qesharake, si shumë budallaki e llojit të vet! Apo, ndoshta Shaqir Fetai dëshiron që edhe këtë organ bazë ta zaptojë, ta bëjë për vete, t'i frikësojë dhe, asnjëherë mos t'u shkojë në mend që të kërkojnë raporte mbi vakëfin, kurrë mos t'u interesojë se çka bën Shaqir Fetai së bashku me myftinj të me vakëfin, sepse, sakaq ua merr "muraselen"!

Shaqir Fetai, bazuar në këtë "refomë" të tij, këto ditë paska qenë në Strugë dhe në Ohër ku anëtarëve të këtyre myftinive ua paska ndarë vërtetimet. Shaqir Fetai ka shkruar në fb-un e vet se ka qenë në këta dy Myftini "ku u bë konstituimi i antarëve të rinjë"! Si po u bëka "konstituimi i anëtarëve"?! Konstituohet kuvendi, organet, këshillat dhe jo përfaqësuesit, anëtarët, deputetët. U konstitua deputeti, deputetët! Sipas logjikës së Shaqir Fetait, edhe kjo bën vaki!

Në fund, Shaqir Fetai u paska raportuar këtyre organeve mbi sukseset e BFI-së!!! A është normal ky farë instalacioni i pushtetit maqedonas në krye të BFI-së? A e di se çfarë bën? Anëtarëve të myftinive nuk u raportohet mbi planet, të arriturat apo dështimet e Myftinive, por u raportohet mbi "të arriturat" e BFI-së? Po për çfarë të "arriture" u ka folur Shaqir Fetai kur dihet se që kur u instalua dhunshëm ai në krye të BFI-së, ky Institucion ka regjistruar vetëm dështime, vetëm humbje, vetëm degradime, vetëm mosbesime, vetëm intriga, ka regjistruar vetëm "suksese dëshpëruese"!

Apo, ndoshta Shaqir Fetai sukses e llogarit “vizitorët” e tij që i thërret në çaj, apo kryerjen e umeres, faljen e xhumasë, të namazit të ikindisë, të xhenazes, apo sukses të BFI-së llogarit magjepsjen e “rijasetit” të tij për t’ia lejuar shpenzimin, zhvatjen, vjedhjen e vakëfit në emër të pagesës së rrogave. Apo, sukses e llogarit moskonfliktimin me institucionet shtetërore të cilët ia fragmentarizojnë Institucionin duke ia miniomizuar peshën në shoqëri si dhe duke ia thyer simbolin si unifikues i ummetit në përgjithësi. Ose, u ka raportuar mbi suksesin personal për të ndikuar në institucionet gjegjëse shtetërore për të regjistruar sa më shumë “institucione” paralele me rol dhe funksion si të BFI-së! Shaqir Fetai nuk ka se çfarë u raporton vullunterëve, por, Shaqir Fetai le të urdhërojë e le ta mbledhë rijasetin e tij dhe atyre t’u raportoje, apo, këtë do ta bëjë në prag të Muajit të Ramazanit, me të vetmin rend dite: si ta “vjelim” sa më suksesshëm edhe një herë popullin mysliman të vendit!/TetovaSot/25.02.2022

Hipokrizia e rusofilit

Shaqir Fetai, instalacioni i pushtetit maqedonas në krye të BFI-së, pasi ka dhënë sërë provash se është një rusofil “i lezetshëm”, pasi toleroi dhe heshti përballë “hoxhës” i cili nga qyrsia e xhamisë e dënoi Ukrainën që nuk po i nënshtrohet Ruisë, si “cjapi te kasapi” shkon në zyret e ambasadorit të BE-së në Shkup dhe bashkarisht e dënojnë invazionin e Rusisë mbi Ukrainën

Nga informacioni i publikuar në faqen e “murit të gazetës” elektronike të bashkësisë “fetare” të Shaqir Fetait, shihet që ky farë hipokriti i pashoq sikur paskësh qenë “i detyruar” në një hap të tillë! Natyrisht që, jo të jetë i detyruar por, edhe me tytë në gojë deri në gabzherr është dashur t’i nxirren me pincë fjalët ndëshkuese kundër Ruisë, e cila, në një luftë të tmerrshme po ushtron gjenocid të paparë kundër ukrainasëve dhe po kërcënohet se botën mbarë do ta shkatërrojë.

Në krejt botën demokratike po frymon një qëndrim i prerë kundër agresionit rus, vetëm në Maqedoninë e Veriut, madje çuditërisht prej “shqiptarit”, shih habinë, prej hoxhës në qursi, po shprehet një simpati e gjallë për Putinin i cili po e shkrumbon Ukrainën që dikur paska qenë kundër UÇK-së së Kosovës dhe të asaj të Maqedoonisë së Veriut, pa përmendur se për cilin pushtet të atëhershëm “ukrainas” bëhet fjalë! Natyrisht, të gjithë subjektet politike shqiptare, intelektualë të ndryshëm, e dënuan këtë qëndrim, këtë “ligjeratë” me nëntekstin që si “çeçenët” t’i kthehemi e ta përkrahim diktatorin nazist, Putinin! Vetëm Shaqir Fetai dhe Qenan Ismaili nuk u distancuan nga kjo ligjeratë e hoxhës, i cili përzihet në politikë duke iu shmangur detyrës parësore të tij. Ai kurrë nuk e tha asnjë fjalë për shkeljet kushtetuese në BFI, ai kurrë nuk e tha një fjalë për shkeljet e parimeve islame që bëhen

nga përfaqësuesit e tij dhe nga bashkësia “fetare” e tij, ai kurrë nuk e tha një fjalë për vjedhjen dhe shkatërrimin e vakëfit të Shkupit, por i doli punë me Ukrainën! Shaqir Fetai, i lumtur për anëtarësimin e këtij farë hoxhe në një organ të BFI-së, ia ndanë me pompozitet vërtetimin e të qenurit anëtarë.

Nuk mundet të reagojë ndryshe Shaqir Fetai kundër hoxhës pro-Putin ndërkohë që ai në zyren e vet e pranon hoxhën e Putinit! Duke e vërejtur se ky qëndrim i një hoxhe injorant po merr qëndrim institucional, zyra e BE-së në Maqedoninë e Veriut ka organizuar takim me Shaqir Fetain për t’u njohtuar me atë se cili është qëndrimi i BFI-së në raport me agresionin rus mbi Ukrainën! Natyrisht që Shaqir Fetai, me të gjitha tiparet e hipokritit më të rrezikshëm, do ta dënojë çartjen e Putinit si dhe do të apelojë për kujdes nga “nëpunësit fetar që të kenë kujdes në deklarata dhe qëndrime që dëmtojnë paqen”!

Animi kah agresori nënkupton solidarizim dhe bashkëpunim me agresorin, ndaj, në të tilla raste, edhe “solidarizuesi” llogariitet agresor dhe merren masa të rrepta ndaj tij, ngjashëm si ndaj agresorit mizor! Çka ndërmori Shaqir Fetai kundër nëpunësit të vet i cili me “ligjeratën fetare” të veten e tronditi rajonin dhe mbarë Evropën? Asgjë! Vazhdoi ta mbajë në vendin më të rëndësishëm në Shkup si dhe ta “dekorojë” me anëtarë i një prej organeve më të rëndësishme të BFI-së!

A nuk është kjo hipokrizi e dëshmuar katërcipërisht e Shaqir Fetait! Mbajtja në pozita e të njëjtit person pro-putinian është solidarizim me apelet për t’u përkrahur Putini! Ky është Shaqir Fetai, ky është ai skuth i cili, nuk ndërmer asnjë hap kundër nëpunësve të vet përkrahësve të agresorit të pashpirt, ndërsa deklarativisht pozicionohet pasi të ftohet në zyret e rëndësishme botërore, sepse, kjo do t’i duhet për më vonë për t’u justifikuar se, e ka dënuar Putinin, pasi ka qenë i detyruar prej përfaqësuesit më të lartë të BE-së.

Shaqi Fetai dhe Qenan Ismaili edhe sot e kësaj dite u kërcënohen të gjithë nëpunësve të vet me largim prej punës (siç ka larguar tashmë!) dhe me masa të rrepta kundër të gjithë atyreve që do të kenë një takim miqësor me “armiqtë” e tyre, Afrim Tahirin apo Sulejman Rexhepin, me ata të cilët e kanë dert riorganizimin e BFI-së dhe rimëkëmbjen e dinjitetshme të këtij Institucioni, duke e “çliruar” atë nga hipokritët, matrapazët dhe honxho-bonxhot që

mburren që e kanë për mik dhe për anëtarë organi personin që e
përkrah Putinin në okupimin dhe shkatërrimin e
Ukrainës!/Lajme7/01.03.2022

Shaqir Fetai si Ivica Daçiqi

Nuk ia paska dhënë qeveria serbe përkrahjen Ruisë në përpjekjet e saj për ta bombarduar, shkatërruar e okupuar Ukrainën, por këtë përkrahje ia paska dhënë “interesi i popullit serb”, tha këto ditë Ivica Daçiq! Shaqir Fetai paska shprehur qëndrimin e vet “zyrtar” – e dënon agresionin makabër të Ruisë mbi Ukrainën! Por, a di Shaqir Fetai se si formohet qëndrimi zyrtar?!

Nga Vesel Fazliu

Se Shaqir Fetai është një hipokrit i pacipë, se është një trukaxhi naiv, se është një rrenc i klasit të parë, këtë e dëshmoi edhe këto ditë përgjatë prononcimit për një televizion kombëtar në RMV! Pasi një hoxhë i tij aktiv, një anëtarë i Myftinisë së Shkupit që e posedon “dekretin” e Shaqir Fetait, pra një nëpunës dhe zyrtar i bashkësisë “fetare” të Shaqir Fetait, gjatë një ligjerate në xhami dhe para xhematit kishte vjedhur vrerë kundër kryetarit të Ukrahinës i cili me lotë në sy ishte ankuar për bombardimet ruse mbi popullatën civile, mbi fëmijë, gra e pleq të Ukrainës. Ligjerata ofenduese përkonte me solidarizimin dhe bashkangjitjen e “çëçenëve myslimanë” me hordhitë e despotit Putin! Nuk ngeli shtet, institucion e organizata në BE e, po thuajse në mbarë botën, që nuk po e dënojnë agresionin barbar të Putinit, me përjashtim të Serbisë dhe të bashkësisë “fetare” të Shaqir Fetait. Ky farë “reisi” mendon se mund t’ia hedhë lehtë e paqtë institucioneve perëndimore. Në një takim “miqësor” që e pat me përfaqësuesin e BE-së në Maqedoninë e Veriut, e kishte “dënuar” agresionin e Putinit mbi shtetin e Ukrainës. Në pyetjen e një televizioni nacional se cili është qëndrimi zyrtar i BFI-së karshi sulmeve okupuese të

Rusisë mbi Ukrainën, nga BFI ishin përgjigjur se tashmë Shaqir Fetai “në emër të Bashkësisë Fetare Islame shprehën shqetësimin e madh për agresionin e Rusisë kundër Ukrainës” dhe ka kërkuar nga “nëpunësit fetar që të kenë kujdes në deklaratat dhe qëndrime që dëmtojnë Paqen”! Se ku është ngritur kjo paqe që po e dëmtuakan eventualisht me deklaratat e tyre të papërgjegjshme nëpunësit e BFI-së, këtë mund ta dijë vetëm Shaqir Fetai. Këtë “paqe” po e synon dhe po e proklamon vetë Putini! Natyrisht, tani do të thotë që ka qenë një llapsuz, siç paska qenë llapsuz edhe prononcimi i tij për një diplomati se “lufta qenka e keqe dhe se nuk i sjell mirësi e dobi askujt që lufton”, (as Kosovës? As shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut? As Ukrainës?) dhe që, fill pas disa orësh u detyrua që ta redaktojë e ta fshijë këtë deklaratë që i shkon për shtati vetëm UDB-së dhe Putinit!

Shaqir Fetai, me mendjen e vet të sëmurë, shkon dhe e personalizon Institucionin e BFI-së, duke lënë të nënkuptohet se BFI nuk ka nevojë për prononcim institucional, mjafton që këtë ta bëjë Shaqir Fetai! Sepse, vetë Shaqir Feta na qenka “BFI”!

Po BFI a nuk është edhe nëpunësi i Shaqir Fetait, hoxha zyrtar i një prej xhamive më të rëndësishme në Shkup, anëtar i Myftinisë së Shkupit që e gëzon “dekretin” e Shaqir Fetait? Në kushte të jashtëzakonshme mund edhe të mos mbledhet organi kolektiv për ndonjë prononcim që do të ishte në një vijë me qëndrimet globale, por ama, në kushte paqe kjo e drejtë e organit kolektiv t’i merret dhe të përfaqësohet nga një njeri imoral, pa legjitimitet e ilegal, kjo është më tepër se hipokrizi, është idiotizëm!

BFI-ja sa është e Shaqir Fetait shumëfish më tepër është e hoxhës së xhamisë, i cili, në fund fare, në vend punë ka ardhur më normalisht se sa komplotisti Shaqir Fetai!

Aq sa ka të drejtë në “qëndrimin” e vet Shaqir Fetai shumëfish më tepër kanë të drejtë xhemati për ta përkrahur ligjeratën manipulative të hoxhës së tyre. Prandaj, Shaqir Fetai është dashur ta thërrasë Rijasetin, të formojë qëndrim unik e zyrtar dhe, mbi të gjitha, t’i paraqesin masat kundër çdo mahluku që solidarizohen me “çeçenët myslimanë” në përkrahje të despotit rus, Vladimir Vladimiroviç Putin! Nuk mund të thuhet se Shaqir Fetai ka qëndrim zyrtar ndërkohë që një zyrtar i tij ka qëndrim të kundërt dhe, për më tepër, këmbëngulë në qëndrimet e veta pro-Putin, qëndrime këto që nuk janë private por zyrtare, meqë shprehen në institucion të BFI-së dhe nga nëpunësi i BFI-së! Dihet se çfarë

efektesh anti-Serbi prodhoi “qëndrimi zyrtar i Serbisë” në përkrahjen e Ruisë për ta përshkallëzuar një luftë me përmasa botërore. Jo që BFI-ja nuk e tha asnjë fjalë kundër nëpunësit të vet që i përlligji të gjitha interesat gjeopolitike të popullit shqiptar por, nuk inicoi asnjë reagim të teologëve kundër këtij “hoxhe”! Shaqir Fetai edhe një herë u dëshmuo se nuk është bindës, se është i pafuqishëm, se për interes të vetin të poshtër është në gjendje të dëmtojë interesat nacionale shqiptare. Dihet se kush ia kërkon këtë argatllëk!/Kombetare/03.03.2022

Kështu foli Shaqir Fetai (30)

I vetmi qëllim i daljes në terren i Shaqir Fetait është, jo për të zhvilluar aktivitete, por, thjesht, për ta ndjerë “pritjen e ngrohtë dhe madhështore” që ia organizojnë lakejt, dibiduzat dhe marionetat e tij! “I falënderova për pritjen e ngrohtë”, thotë manipuluesi i dalur nga kthinat nëntoksore të UDB-së

Nga Faik Shahinbejlliu

1. (Shaqir Fetai për ligj aktivitetet e pavarur të myftinive)

Shaqir Fetai, për t'i justifikuar shpenzimet e kota që ia bënë arkës së BFI-së vetëm sa për të blerë pak “popullaritet”, shkon në Myftininë e Prilepit dhe thotë: “sot e konstituam Myftininë e Prilepit”! Pse rrenë Shaqir Fetai? Apo dëshiron të mashtrojë se, pa “pempelen” e tij asgjë nuk mund të zyrtarizohet, pa gishtin e analfabetizmit të tij asgjë nuk mund të zyrtarizohet! Myftinia e Prilepit është konstituuar shumë më herët, si të gjitha myftinitë e vendit por, ja që Shaqir Fetait ia do b... që të për ligjë çdo aktivitet të pavarur të BFI-së dhe, pa “vendimet” e tij idiotike asgjë nuk mund të zyrtarizohet dhe as të institucionalizohet. Kjo flet për një lloj çmendie putiniane që e ka xhindosur Shaqir Fetain nën obsesionin e “disiplinës spiuneske” të UDB-së! Shaqir Fetai ka prezantuar në mesin e “xhematit” të Myftinisë së Prilepit dhe asgjë nuk i ka raportuar se çka është bërë me pronën e

denacionalizuar në letra me vlerë, nuk ka kërkuar raport për të ditur se ku u tretën miliona euro nga deacionalizimi i vakëfit të kësaj Myftinie!

Për ta “kamuflluar” këtë vjedhje shekullore të kësaj Myftinie, Shaqir Fetai të pranishmit mundohet që t’i joshë e t’i “magjepsë” duke ju folur për “procedurën e ndërtimit të Xhamisë së Çarshisë”! Shaqir Fetai foli pa pikë morali dhe tha: “Njiherit informuam edhe për procedurën e ndërtimit të xhamisë së djegur në Prilepit “Xhamia e Çarshisë ” – “Çarshi xhami” dhe angazhimin që bënë BFI e RMV që ka qenë detyrë dhe brengë e kahmotshme.”

Po ky xhemat i Prilepit paska nevojë përt t’u njohtuar me procedurat e Shaqir Fetait? Po kush është Shaqir Fetai që paskësh hartur procedurë ndërtimi? Pse rrenë ky farë debilli! Pse tallet me myslimanët e devotshëm të Prilepit! Ky xhemat ka nevojë të dijë saktisht se kur do të nisë ndërtimi i kësaj Xhamie dhe jo me procedurat e ndërtimit! Po si u bë që kjo “procedurë ndërtimi” të bëhet pikërisht tani, pasi Shaqir Fetai u instalua nga pushteti antiislam në krye të BFI-së?! Cili ishte aktiviti i Shaqir Fetait për këtë “procedurë”? Pse mungoi kjo “procedurë” tash e 21 vite?! Si u bë që pikërisht në “epokën e Shaqir Fetait” të hartohen “procedurat” e ndërtimit dhe të nisë ndërtimi i Xhamisë? Është jashtëzakonisht surreale tërë kjo “deklarate” e Shaqir Fetait për të qenë e vërtetë! Fundja, Shaqir Fetai edhe është mjeshtër i rrenave edhe nuk e ka për turp nëse e lëshonë rrenën si lopa bajgën! Qenka ndarë shumë i kënaqur Shaqir Fetai me “pritjen e ngrohtë”, të myftiut si dhe me raportin e tij për aktivitetet 2021, për ç’gjë Shaqir Fetai paska konstatuar se Myftinia e Prilepit qenka “unike dhe e sigurtë në ardhmërinë e saj”! Me çka e konstatoi këtë gjë ky farë mjerani? Me një faqe raport nga më i parespektuari në krejt nahinë e Prilepit, Shefket Imerovski, i cili hoxhallarët i ka dëbuar nga xhamia me asistencë policore maqedonase? Le ta publikojë raportin e këtij farë analfabeti dhe le të shohin të gjithë myslimanët e vendit se çfarë dhe sa ka raportuar “myftiu” i Shaqir Fetait! Xhemati i Prilepit janë unikë në një fakt “aktivitetet e myftiut të Shaqir Fetait për vitin 2021 janë zero”! Sipas tyre, ka marrur pjesë vetëm në disa synetime, në aminin e duasë për dhëndurët dhe në disa kurora për të sapofejuarit, prej të cilave aktivitete ka shtuar buxhetin e vet familjar! Ia bën hallall këto gjëra Shaqir Fetai, vetëm t’i rrijë besnik dhe mos të manipuloht prej të tjerëve e mos t’i vie thika pas shpine prej tij dhe sojit të tij! O Shaqir Fetai, çka do të

mbjellësh atë do të korrësh. Kastravec ke mbjellë kastravec do të korrësh!

2. (A e di Shaqir Fetai se ku është Llazheci?)

Me të njëjtën strategji të rrenave Shaqir Fetai ka prezantuar edhe në Myftininë e Manastirit! Pasi ka marrur një “dekoracion” nga myftiu efendi Rasimi (myfti ky dhe ai i Stambollit, i Kajros, i Ankarasë etj.!!!), Shaqir Fetai ka konstatuar se “kjo Muftini vazhdon zhvillimin e saj me hapa të sigurtë dhe të shëndoshë”! Edhe këtu, Shaqir Fetai, i paska informuar xhematin lidhur me procedurën e ndërtimit të Xhamisë në Llazhec! Nuk e ka dert të rrejë Shaqir Fetai, ky farë rrencaku nën çallmë është në gjendje t’u premtojë karamelë myslimanëve vetëm që të rrinë urtë e ta mundësojnë pensionimin e qetë të tij! Zatën rrena më e madhe dhe më manipulative e Shaqir Fetait fill pas nguljes së thikës pas shpine të Sulejman Rexhepit ka qenë që, ta lejojnë të paktën t’u prijë dy vite, derisa të dalë në pension! E do Shaqir Fetai një pension të dinjitetshëm dhe jo një shërbim të dinjitetshëm ndaj myslimanëve të vendit!

A e di Shaqir Fetai se kah i bie fshati Llazhec? Me çfarë sebei ka qenë ndonjëherë në këtë fshat? Kur e ka ngritur zërin, kur ka polimizuar, kur ka zhvilluar debate me pushtetin lokal apo qendror lidhur me pengesat që ia bëjnë xhematit të këtij fshati në rindërtim të Xhamisë? Po në çfarë mbledhje apo në çfarë organi shtetëror qenkan hartuar “procedurat e ndërtimit”! Kush u bë shkaktar i nismës së këtyre procedurave? Pse i fsheh shkaktarët, apo kjo është “meritë e Shaqir Fetait”, apo, shpërblim i disa qarqeve qeveritare për shërbimin që ua kreu Shaqir Fetai! E rrejën Shaqir Fetain dhe ky i rrenë myslimanët e vendit që, pas pensionimit, fajin t’ua lë institucioneve shtetërore që e paskan gënjyer e që e paskan detyruar që ky t’u thotë kopalla myslimanëve të vendit!

3. (Jo seriozi në “Myftininë serioze”)

Në këtë informatë mbi vizitën e Shaqir Fetait në Myftininë e Resnjës, e të publikuar në fb-un e tij, veç të tjerash instalacioni partiako-politik shkruan edhe këtë: “Vërtetë ishte një pritje e nivelit të lartë, që tregoi se kjo Muftini tashmë është serioze”!!! Ja se si Shaqir Fetai e konstaton seriozitetin apo mosseriozitetin e një

organi të vet! Pritja e nivelit të lartë dëshmon për serioitetin e kësaj Myftinie (!!!), e cila është, absolutisht më e kota, më e paorganizuar dhe më e përgjumura nga të gjitha myftinitë e vendit! Shaqir Fetait i duhet që ta lavdërojë, i duhet që t'i jap një fllad b..., sepse, ka dëgjuar shumë rrëfime mbi këtë “myfti”! Njeriu më injorant, më hipokrit e pa kurrfarë serioziteti në tërë shoqërinë myslimane në vend dhe më gjërë, Shaqir Fetai, vlerëson se cila myftini është serioze! Dhe cili na qenka kriteri i Shaqir Fetait për të vlerësuar në është apo jo myftinia serioze? Kjo varet nga niveli i pritjes që do t'ia organizojnë Shaqir Fetait. Turpi nuk ka brirë, u bëmë gaz i botës!

Shaqir Fetai thotë se kjo Myftini paska kthyer disa vakëfe, por, nuk thotë sa, sa në pronë sa në letra me vlerë; ku gelën ato kompensime! Shaqir Fetai thotë në fb-un e vet se kjo Myftini paska ndërtuar “komore, gusullhane”! Po pse nuk e lë vetëm me emrin e vet original “gusullhane” por ia shtonë edhe fjalën sllave “komorë”! Apo, Shaqir Fetait i duket më e përafërt kjo shprehje e gjuhës së kthinave të UDB-së ku është gatuar shprehja “gasna komora za shiptari”!

Pasi t'i përfundojë “konstituimet” e myftinive “liçno” të vetat, Shaqir Fetai paska në plan që pastaj, edhe një herë t'i vizitojë myftitë dhe t'i urojë për sukseset e tyre në konstituimin e organeve dhe t'i falënderojë për “pritjet e larta” që ia kanë organizuar. I kujdesshëm është Shaqir Fetai, është perfid, “prefrigan”, manipulator, hipokrit, i dobët, i ulët, i poshtër sa më s'ka, prandaj dhe, këto ditë ishte në Bullgari, te ambasadori i Egjiptit, për t'ia shprehë të gjitha “respektet dhe falënderimet” për pritjen madhështore që ia paska bërë atdheu i tij, Egjipti! Këtë mund ta bëjë vetëm ky manjak i karrierizmit të sëmurë!

4. (Kush e injoron Shaqir Fetain i ka të gjitha sevapet e Zotit)

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu

tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka
e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as
myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/04.03.2022

Tallësi, me të cilin, vetë jeta është tallur me të

“Armikun nuk duhet ta ndaloni derisa është duke bërë gabim”, thotë Napoleon Bonaparta

Nga Latif Emërllahu

Shaqir Fetai, tamam si ai skuthi më i poshtër, ka nisur të mos i përsërisë gabimet për të cilat kritikohet përmes opinioneve të shumta! Atë nuk e ka armik askush, askush nuk e llogaritet për faktor, një hiç person, prandaj nuk mund të shprehet ndaj tij armiqësi; një analfabet me zhvillim mendor të kufizuar dhe, t'i shprehet këtij armiqësi “mund të llogaritet” mëkat! Por, ai i ka shumë, shumë, shumë armiq. I ka armiq të gjithë ata të cilët pinë kafe me Afrim Tahirin, ish-eprorin e tij, për të cilin kurrë nuk mund ta gjejë një fjalë për ta përshkruar si njeri që i ka bërë vetëm një gjë të keqe! Ai e ka armik Afrim Tahirin, rrjedhimisht edhe të gjithë ata që pinë kafe me efendi Tahirin, pikërisht për faktin se Afrim Tahiri ka platformë për reformë të BFI-së, ka program për ta nxjerrur nga kjo situatë ku është katandisur Instituoni i BFI-së, ka plan zhvillimor për t'ia kthyer dhe përforcuar integritetin BFI-së si dhe të gjithë nëpunësve të këtij Institucioni. Kjo i pengon vetëm Shaqir Fetait, ndaj, të gjithë ata që mundohen ta ngrisin nga balta BFI-në, janë armiq të mëdhenj të Shaqir Fetait!

Kritikat si përpjekje për ta shpëtuar BFI-në dhe jo Shaqir Fetain

Mbreti Zog po kritikohet aq shumë nga truri i kombit të asaj kohe, Faik Konica, sa që të gjitha shkrimet i kishte prerë dhe i kishte ngjitur në muret e kancelarisë së tij mbretërore. Më në fund, e fton Konicën që të vijë dhe t'i bëhet ministër, sepse, pa të nuk po di si të funksionojë. Konica pranon dhe kthehet nga Amerika në Shqipëri, i futet në Zyre Mbretit Zog dhe, aty shtanget, ngrinë i tëri. I sheh të ngjitura të gjitha shkrimet, opinionet dhe kritikën e rrepta drejtuar Mbretit. “Qetësohu vëlla, kritikën e tua janë udhërrëfim për mua që të bëj shtet mbretëror. Pa këto kritika nuk do të bëja as një javë në krye të Mbretërisë shqiptare”, i thotë Mbreti Konicës! Shaqir Fetai mendon se pranimi i kritikave që do ta përmirësojë vetë formalisht është gjest i mjaftueshëm! Ai e ka vetëm për personalitetin e vet, kurse Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI e ka për t'ia ruajtur integritetin Institucionit të BFI-së, të cilën, Shaqir Fetai tashmë e ka bërë në filiale të nëntokës më të fëlliqtë që mund të ekzistojë! Pra, nuk vlenë këtu porosia e Bonapartit, kritikën kundër Shaqir Fetait nuk janë që të përmirësohet ai, sepse, edhe për të pranuar kritika duhet të keshë këllqe e të jeshë super-intelegjent. Shaqir Fetai nuk ka kapacitet për të kuptuar kritikën që i adresohen atij, sepse, ndryshe, që moti do të turpërohej e do të mbyllej në “fllanikun” e turshive! Pasi u kritikua Shaqir Fetai, duke ia hedhur për toke titullin e “fjalimit” të tij që e paska mbajtur në Konferencën ndërkombëtare në Egjipt, sot ka publikuar të njëjtin material por me titull tjetër! Para intelektualëve myslimanë në Egjipt ishte bërë përallë (për faqe të zezë!) ku u ishte drejtuar me konstatimin se “Bamirësia është fuqi e jo bobësi!” Sot këtë fjalim e ka botuar nën titullin “TOLERANCA NË ISLAM, DËSHMI E FUQISË DHE JO E DOBËSISË”! Po në fenë e Krishtere çfarë mund të jetë toleranca?! I është thënë Shaqir Fetait që mos të vrapojë pas fjalive të mëdha, pas fjalëve që nuk i kupton ai, mos të ngutet se do të rrëshqasë si thiu në akull; ç'ne që përpiqet të dalë me fjali konstatuese, sepse nuk e ka këtë kapacitet! Shaqir Fetai dhe konstatimet janë dy botëra askund të përputhshme. Mund t'ia dalë vetëm në momentin kur do të heqë dorë përfundimisht nga hipokrizia dhe shitja e p... për “intelektualitet”!

Ngushëllime për “të madhin” i cili Shaqir Fetain nuk e ka llogaritur as për njeri

I mbërthyer në injorancë, pastaj, për shkak se e kupton shumë mirë që është i papranueshëm në botën e intelektualëve, se nuk ka kapacitet për më të voglin debat në fushat e ndryshme, ai në mënyrë perfide gjuan situata (si ajo dhelpër e uritur) dhe, sakaq, fërkon duart duke shpresuar se më këtë hap tashmë do të përqafohet nga intelektualët kombëtar! Këto ditë ka vdekur një prej shkrimtarëve më të medhenj shqiptar, Luan Starova! Shaqir Fetai kishte “përpiluar” një tekst ngushëllues. Kishte folur se sa i madh ka qenë ky i ndjerë, por, Shaqir Fetai nuk ia ka përmendur qoftë vetëm një titull nga ndonjë vepër e tij! E dini pse? Sepse Shaqir Fetai kurrë në jetën e vet nuk ka lexuar qoftë vetëm një faqe nga dhjetra veprat e Luan Starovës, të përkthyer në mbi dyzet gjuhë botërore. Ky konstaton pa e njohur fare! E bën këtë gjest ngase e di shumë mirë se nuk do të marrë pjesë në asnjë bashkëbisedim, në asnjë debat ku do të mund të kapet “mat” për sa i përket njohjes së veprave të shkrimtarit Luan Starova! A nuk është kjo hipokrizi që i ka hije vetëm Shaqir Fetait?

Mesazhet erotike të tortës së Shaqir Fetait

Shaqir Fetai, në prag të 8 Marsit, organizon një takim të gjeneratave IX, XI dhe XII të ish-medresantëve të “Isa Beut”! I përgjigjen nja 10-15 vetë prej tri gjeneratave. Paramendoni gjestin e Shaqir Fetait! I inspiruar prej 8 Marsit, shkon dhe për këta nxënës porositë dy torta njëren të kuqe gjak, e me lule trëndafili, të nënshkruar me “reisi”, me demek, tortën e keni prej “reisit”! Dhe me këtë gjest krijohet iluzioni se, ose ka shkuar në syneti, ose ka fejuar ndonjë të afërm, ose, të gjithë ata i duken dylbera që duhet t’i nderojë me të kuqe e me trendafilin e dashurisë. A ka gjest më të poshtër, a ka sjellje më katundareske, a ka gosti më të pistë se kjo e Shaqir Fetait. Ish-nxënësve, tashmë burra e të martuar, u shkon si përfaqësues i komunitetit të ngjyrave të ylberit, me tortë të kuqe e me karanfil kuq si gjaku. E di Shaqir Fetai se çka simbolizon kjo? Le ta pyes komunitetin e vet se i tregojnë më mirë!

Çka do të bënte Shaqir Fetai nëse do të nderohej me dhuratë “Krishti i gozhduar në kryq”?!

A e keni parë Shaqir Fetain se si, mysafirët, sidomos ata që nuk i përkasin fesë islame, por që janë pjesëtarë të të krishterë, u jep dhuarë ose “Kuranin e artë”, ose “Emblemën e BFI-së” ose diçka të ngjashëm. Të huajt tashmë e paskan kuptuar këtë “mirësjellje” të Shaqir Fetait, pasi që, pas çdo përcjellje të mysafirëve që i ka “dekoruar” me ndonjë nga këto “çmimet” po u thokëka bashkëpunëtorëve të vet “ja, e konvertova në islam edhe një të pafe”!

Vërtet, pse i ngushton kaq shumë mysafirët e tillë ky farë “reisi” i hamamit?! Pse nuk u jep ndonjë fotografi artistike të ndonjë xhamie, ndonjë pikturë nga ndonjë xhami që është nën mbrojtje si trashëgimi kulturore, ndonjë monografi nga xhamitë monumente historike, të përkthyer në gjuhën e mysafirëve? Pse i detyron këta “të dekoruar”, hala pa u futur nëpër oborret e selive të tyre, ta hedhin në pleh “dhuratën” e Shaqir Fetait! Si do të ndjehej Shaqir Fetai sikur t’u shkente në zyre këtyre “të pafeve” dhe këta si dhuratë t’ia jepnin ndonjë Kryq me Krishtin e gozhduar në të, ta qerasnin me ndonjë gotë verë të kuqe të cilën të krishterët e kanë simbol të gjakut të Krishtit!

Shaqir Fetai duhet të ketë libër protokoli i cili, veç tjrash, parasheh edhe llojet e dhuratave për mysafirët specialë. Shaqir Fetai duhet të ketë më shumë respekt për Kuranin dhe fjalën “Ikre” dhe jo t’ua japë si dhuratë atyre të cilët pa dyshim që “dhuratat” e tilla do t’i lënin jashtë, aty skaj kontenjerëve. Edhe Shaqir Fetai kështu do të bënte, mbase nuk e kanë lënë fare ato dy kokrra mend që i ka dhe simbolet krishtere t’i fuste në zyren ku e instaluan elementet partiako-politike antiislame. Shaqir Fetai sa të rrojë do të mësojë. Pra, “armiqtë” e tij nuk synojnë që t’i japin mend Shaqir Fetait, sepse ku di ai se çka është mendja por, thjesht, mbajnë llogari për Institucionin e BFI-së dhe për simbolet e saj islame, me të cilat, Shaqir Fetai tallet duke u munduar të krijojë përshtypje se po respekton. Ai nuk di se çka është respekti, ai është cinik, shpirtzi, është hipokrit e injorant, prandaj me plotë vetëdije tallet. Sepse, ai mendon se tallja është humor, prandaj përpiket që edhe talljen ta shesë për humor (art)! Cilësi e shejtanit, ë?/Mileniumi3/08.03.2022

BFI-ja nuk është Shaqir Fetah

Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI

A mundet që një institucion fetar, siç është BFI-ja, të jetë “antologji” e rrenave, e vetëlavdërimeve, e snobizmit, e injorancës dhe hipokrizisë? Jo dhe, shqyrr që në memorjen e opinionit tonë Bashkësia Fetare Islame është “konzervuar” si në institucion i shenjtë dhe, fatmirësisht, Shaqir Fetah përfaqëson ekskluzivisht bashkësinë e vet “fetare” private.

Le të bëhet një analogji me situatën aktuale në Rusi? Putini nuk është udhëheqës shtetëror që doli pa prituri e pa kujtuar! Ai është një “lider” i cili erdhi deri këtu falë “tolerancës” së botës demokratike! Për të, si për një neodiktator i tmerrshëm, e ka ditur e mbarë bota, megjithatë, e ka toleruar, sepse, është “i zgjedhuri” i një populli! Populli e duron diktaturën e tij, politikën, sjelljen antinjerëzore, agresivitetin e tij! Qindra burrshtetas e kanë vizituar, ia kanë mundësuar takimin lloj-lloj lideri botëror. Edhe sot, në pikun e çartjes së tij, e vizitojnë, e thërrasin në telefon, përshëndeten, bisedojnë për hallet e botës. Në kushte të jashtëzakonshme, çdo bisedë telefonike, llogaritet “vizitë”! Në mbrëmje apo gjatë ditës, Putin del para opinionit rus dhe si skuth vetëlavdërohet duke u thënë rusëve se, ja, sot, bisedoi me Presidentin Bajden, apo me ndonjë lider tjetër botëror! A mos do të thotë kjo se Presidenti Bajden, i paska dhënë përkrahje në politikat

dhe veprimet e tij kriminale! Sapo të hapë gojën Putin, Bajdeni dhe shërbimet e tij menjëherë e kuptojnë që Putin po gënjen, po trillon, po thurrë intriga fëmijërore dhe, ndërsa flasin me orë! Ka nevojë Bajden t'i dëgjojë intrigat e kriminelit?! Jo por, kësisoj merren "monstrat" për ta analizuar anën shpirtërore e mendore të Putinit! Natyrisht, Presidenti amerikan do ta mbajë nivelin e vet dhe, bashkëbiseduesit do t'ia përcjellë një varg mesazhesh që ia bëjnë me dije vijën e kuqe dhe, ia përkujtojnë tërthorazi, pa e futur në siklet bashkëbiseduesin, të gjitha sanksionet dhe pasojat. Edhe pajtimet eventuale, edhe premtimet, edhe lëvizjet politike, të gjitha ia kuptojnë dhe fare mirë e dinë se ai ka nevojë për ta ushtruar snobizmin duke shpërndarë dengla nga më të kotat!

Bashkësia "fetare" e Shaqir Fetait po vizitohet nga ndërkombëtarë jashtëzakonisht shumë të rëndësishëm për shoqërinë dhe vetë shtetin e Maqedonisë së Veriut! Ata kanë informata të bollshme, nuk kanë nevojë të mësojnë nga Shaqir Fetai për asgjë, sepse punët e BFI-së i dinë më mirë se vetë ai! Të gjithë ndërkombëtarët, faktorët me relevancë, e dine fare mirë se kush është Shaqir Fetai, si e uzurpoi BFI-në dhe instalacion i cilave struktura partiako-politike është në atë post të grabitur me intriga, puç e tradhëti! Të gjithë ndërkombëtarët e dinë se, Shaqir Fetai, sapo të hap gojën rrenë, sepse, është i gatuar me rrena, është i zhvilluar dhe strukturuar me rrena e me intriga, mënyrë kjo e të vepruarit uniform për të gjithë shërbëtorët e strukturave të shërbimeve intelektuale të ndryshme. Gjithësesi që do të pasojnë edhe disa vizita që mund të jenë si shqetësim për disa lëvizje të fundit të Shaqir Fetait të cilat nuk i kontribuojnë as tolerancës, as bashkëjetesës dhe as paqes në vend.

Ndërkombëtarët perëndimorë nuk kanë nevojë të dinë se si Shaqir Fetai po ua organizuaka jetën fetare shqiptarëve që jetojnë në Perëndim, sepse e dinë që po rrenë, sepse e dinë që fjala e tij në shtetet e huaja nuk vlenë fare! Shaqir Fetai mendon dhe është i bindur avdalli se, rregullat e veprimit dhe të organizimit në shtetet perëndimore janë meritë personale e tij! Çfarë mjerani e çfarë gjynahu!

Ndërkombëtarët kanë nevojë të dinë qëndrimet institucionale anekënd botës për sa i përket agresionit barbar rus mbi Ukrainën! Asnjërit nuk i duhet qëndrim i Shaqir Fetait, sepse të gjithë e dinë se cilido “qëndrim” i Shaqir Fetait është PA QËNDRIM! Shaqir Fetai “rreshtohet” në anën e amerikanëve, sllovenëve, gjermanëve, anglezëve, polakëve etj. dhe e dënon çdo plumb rus që shkrepet kundër popullit liridashës ukrainas! Por askujt nuk i duhet ky solidarizim i këtij farë bilmezi të gatuar me rrena nga më bajatet! Shaqir Fetai e gënjeu ambasadorin amerikan, atë slloven, francez, të BE-së, siç do t’i gënjejë edhe një sërë sysh, sepse, sërish do t’ju thotë se BFI fuqishëm përkrah qëndrimet e botës kundër Putinit! A mund t’u thotë ndërkombëtarëve Shaqir Fetai se, në mbledhjen e fundit, të organizuar në filan datën, Rijaseti dhe të gjitha organet dhe institucionet e BFI-së, i sollën këto konkluzione për sa i përket agresionit rus mbi Ukrainën që po rrezikon ta përfshijë tërë botën. Le t’i numërojnë, një dy, tre... Për më tepër, a u soll ndonjë qëndrim që do t’i apelonin popullatës myslimane të vendit që të jenë në krah të refugjatëve ukrainasë që do të vërshojnë edhe në Maqedoninë e Veriut! Në këtë aspekt, a u ka folur për planin dhe projektet e BFI-së?!

Jo, Shaqir Fetai nuk dëshiron që ta përfshijë tërë Institucionin e BFI-së, sepse, BFI është vetë Shaqir Fetai! Nëse do ta përfshijë edhe qëndrimin praktik të BFI-së, atëherë, ka frikë se zbehet roli, pesha dhe “madhështia” e “lartmadhnisë”! Kjo dëshmon se, Shaqir Fetai është një diktator naiv e analfabet, serviloset e putanizohet vetëm për faktin se nuk ka fuqi dhe nuk di, ndryshe, do të bënte kërdinë me përkrahjen e nëntokës! Një përkrahje më e vogël që i erdhi, arriti që ta shkatërrojë e t’i japë fund përvojës më se pesëqindvjeçare të organizimit të të vetmit Institucion fetar islam në vend (para se ta uzurponte, sot kemi disa bashkësi të themeluara me “tolerancë”, ose me mision, nga Shaqir Fetai)! Situata në Ukrainë është më se serioze, është kërcënuese për mbarë botën, të gjithë faktorët e vendit dhe të jashtëm nuk kanë nevojë për qëndrimin e kotë të Shaqir Fetait, por, kanë nevojë për organizimin praktik, për strategjinë, për planet konkrete të BFI-së

dhe, mundësisht, për koordinimin e të gjithëve me një “qendër”!
Faktorët e ndryshëm kërkojnë gjëra të prekshme, mbase do t’ia dalin që të mësojnë ndonjë gjë nga strategjia dhe vendimet e Institucionit të BFI-së dhe, aspak nuk u interesojnë qëndrimet snobiste të Shaqir Fetait, i cili, është në bashkëpunim institucional me personin i cili është i vetmi “mysliman” në vend që publikisht përkrahu luftën e Putinit kundër Presidentit ukrainas! Ky bashkëpunim i përlligj të gjitha qëndrimet demagogjike të Shaqir Fetait i cili, para ndërkombëtarëve, po i fëlliq dhe po i njollosë edhe ata subjekte politike që e instaluan në krye të BFI-së duke garantuar se po bëjnë gjënë më të mirë! Shaqir Fetai ka qenë, është dhe do të jetë shëmtia më e trishtuar e BFI-së!

/1KlikLarg/11.04.2022

Shumë poshtë na ka rënë morali

Pse nuk i lejohej Shaqir Fetait që gjatë vizitës së një komuniteti grashë apo vajzash, të shoqërohet nga bashkëshortja e vet apo nga vajzat e veta! Prej nga atë të drejtë Shaqir Fetai të futet si maçok në mesin e vajzave të huaja dhe të flasë për moral

Nga Nurie Pajaziti

Këto ditë, i gjendur jashtë vëmendjes dhe tërësisht jashtë “aktualitetit”, Shaqir Fetai urdhëron pulenin e vet, Ibrahim Idrizin, t’ia organizojë një takim me arsimtaret si dhe me vajzat e paraleles së Medresesë “Isa Beu” në Gostivar! Shaqir Fetai paska konstatuar se Medresja na qenka vatër e dijes dhe moralit! Po si kështu? Si mund të jetë vatër e dijes ndërsa drejtohet nga injortantët! Si mund të jetë vatër e moralit ndërsa pranon të vizitohet nga më të pamoralshmit e mundshëm në këtë fëtyrë të tokës! Vetëm të pamoralshmit dhe të pafytyrët mund të pranojnë që t’i plotësohen Shaqir Fetait të gjitha kërkesat dhe dëshirat sado-mazohiste! Shaqir Fetai urdhëron që, kjo vizitë t’i shoqërohet me një “ikonografi të veçantë, shumë të turpshme, jo e dinjitetshme as për motrat tona dhe as për prindërit e tyre! Po pse Shaqir Fetai nuk e ka marrur me vete gruan e vet apo motrat e veta, apo vajzat e veta dhe t’i urdhërojë që t’i rrinë këmbë me qëllim që t’i plotësohen orekset e tij sado-mazohiste! Çka flet vizita në sallën e arsimtarëve dhe jo në klasë, nëse jo për sado-mazohizëm të Shaqir Fetait! Çka flet të qëndruarit ulur në karrige Shaqir Fetai dhe honxhobonxhove të tij, kurse motrat tona t’i rrinë të rreshtuara e në këmbë, si “perëndeshat mitike para Zeusit”! Si mund t’ju flasë motrave tona njeriu më i pamoralshëm në

historikun e BFI-së? Ai fort mirë e di se sa faqezi që është, e di fort mirë se çfarë prishunie vlon në shpirtin e tij katran, ai, pa dyshim, është shumë i vetëdëshëm për paplotshmërinë e tij përgjatë jetës, adnaj, si guxon që të urdhërojë vajzat e reja të futen në një zyre ku, ky farë mahluku, si “pasha” të rrijë ulur kurse vajzat t’i rrinë në këmbë! O po, kjo situatë flet ekskluzivisht për shpirtin e tij sado-mazohist!

Shaqir Fetai nuk paska pasur nevojë t’i takojë këto vajza, por, ja që qenka organizuar me “ftesë të drejtorit! Po cili ishte motivi, shkakun, arsyeja e këtij tubimi nga “drejtori i përjetshëm” i Medresesë! Po si more “Tubimit iu bashkangjitë edhe shënimi i 7 Marsit – Dita e mësuesit”! Me nivel të kësaj injorance të vizitohet një vatër arsimore?!

Papapa, sa të nderuara e të lumtura na qenkan ndarë medresantet me këtë vizitë, vdesin për të kaluar qoftë edhe vetëm një çast në mesin e gjinisë së bukur, pa llogaritur fare se, shëmtia pranë bukurisë është si trëndafili në pleh!

Shaqir Fetai e paska porositur këtë takim sa për ta përshëndetur profesoreshë Semire Fetahun, “pinjollen e Fetahëve”! Pastaj paska folur edhe për “synimet e BFI-së në ngritjen e Medresesë”! E vetmja shkollë në botë, të cilën, edhe organi i vet themelues, nuk e ka të akredituar, nuk e njeh si shkollë, nuk ia njeh diplomat dhe, kuadrot e veta i lë në shpat si dhelpra këlyshët e vetë!

Pse nuk u ka folur Shaqir Fetai për statusin, pozitën e tyre në të ardhshmen! Medresantet janë të shkollës profesionale, i shkollon BFI-ja për nevojat e veta si dhe të organeve të saj! Sa nga këto medresante janë punësuar në organet e BFI-së, nëpër sektoret e BFI-së dedikuar për gruan myslimane, në redaksi, në botime! Apo, tërë kjo punë nuk është aspak serioze por, duhet të llogaritet vetëm si trampolinë për të arritur ndonjë “simpati”. Antipatiku, si patoku i gërditshëm, kërkon simpati! Pisllekun Shaqir Fetai nuk e ka njolla në rrobe por e ka tatuazh në shpirt! Shumë e keqe kjo! As ky ves nuk arrihet pa qenë fund e krye sado-mazohist! / 1KlikLarg/ 12.03.2022

Fundi i lojës së pandershme

Anëtarësia, fitri, zeqati, haxhi, vakëfi dhe kontributet vullnetare, janë vetëm disa nga burimet financiare të cilat e mbajnë gjallë si dhe e avancojnë tutje jetën fetare islame. Nëse destabilizohen këto burime, atëherë edhe kontributi i teologëve në zhvillimin e jetës fetare islame duhet të jetë vullnetar. Këtu merr fund zhvillimi institucional i kësaj jete

Nga Mr. Eset Shaqiri

Kuluareve të Bashkësisë Fetare Islame po flitet se, si asnjëherë më parë ky Institucion financiarisht ka probleme të mëdha. Mungesa e aksioneve humanitare të cilat BFI-ja duhet t'i ndërmarrë për ta zbutur situatën socio-ekonomike të shtresave të varfëra, flet se, këtij Institucioni populli nuk i përgjigjet as për më të voglin aksion humanitar. Shoqata humanitare e BFI-së nuk është në gjendje të apelojë për asnjë ndihmë, sepse, e ka humbur besimin e popullatës, mjaft ka dhënë populli për të varfër ndërsa të gjitha kontributet e popullit kanë përfunduar në xhepin e atij që ka 4-5 banesa, 2-3 dyqane, 3-4 makina luksoze! Një organizatë fetare, e cila humanitetin duhet ta ketë prioritet kryesor pas aktiviteteve ditore fetare, ndërkohë që duhet të presë ndonjë donacion nga jashtë, sepse popullata brenda nuk i beson, kjo flet se, Institucioni në fjalë ka ngelur pa kurrfarë besueshmërie popullore. Besueshmëria – zero!

Rrëshqitja e BFI-së në prehër të huaj

Ky fakt, zbërthen edhe shumë probleme të tjera që kanë të bëjnë kryesisht me financat dhe buxhetin e Institucionit! A mund të mbahet Institucioni me donacione nga jashtë, ndërkohë që populli nuk të përgjigjet, nuk të beson? Donatorët shumë shpejt do ta kapin këtë të vërtetë dhe, sakaq do të ndërpresin të donojnë për projektet e parapara të Institucionit! Mund të të donojnë vetëm për zbatimin e projekteve të parapara nga donatori, pavarësisht nëse do të jetë interes fetar e kombëtar ai donacion! Institucioni i BFI-së mund të na rrëshqasë në prehër të huaj, të atyreve që nuk u intereson asnjë status politik, kombëtar e humanitar të atyreve ku “i derdhë” donacionet! Kurse donatorët e singertë, profesionistë dhe ata që ndihmën e kanë në zemër, kërkojnë raporte të detajuara financiare, sepse, ata mbajnë llogari për çdo cent të vetin që e donojnë.

BFI-ja si Institucion fetar islam, tashmë ka humbur besueshmëri në një numër të madh të besimtarëve të vendit. Aktivitetet dhe kuadri janë shtuar tej normales, kurse besueshmëria ka zbritur nën mesataren! Të gjitha raportet, flasin se, për çdo vit ka pasur rënie nga 15-20 për qind të kontributeve financiare: më pak fitra, më pak zeqat, më pak kontribute vullnetare, më pak kurbanda, më pak haxhilerë që pranojnë të marrin këtë udhëtim të shenjtë me BFI-në dhe, për rrjedhojë, vrima të thella financiare të shkaktuara në buxhetin e BFI-së!

Vakëfi po shitet! Shkelësit e amanetit quhen tradhëtarë!

Cili burim mund të jetë më i sigurtë, i përhershëm, garantues? Vetëm vakëfi! Nuk është ide e marrë kjo e të parëve tanë të cilët hodhën themelet e vakëfit! Vakëfi është amaneti i të parëve tanë, të cilët, pronat e tyre ua linin xhamive, si institucione fetare, derisa u zhvillua idja e centralizimit të menaxhimit të jetës fetare islame në tërë vendin.

Po ndodhë që në dy periudha është ushtruar dhunë e paparë mbi vakëfin e institucioneve fetare: në periudhën komuniste kur u nacionalizua, u uzurpa çdo pronë që ishte vakëf, madje edhe xhami duke i shndëruar në magazetë e fabrika, si dhe në periudhën

postkomuniste, sidomos pas miratimit të ligjit për denacionalizim të pronave të bashkësive fetare!

Denacionalizimi i pronave të vakëfit prodhoi dy padrejtësi fatale!

Ato që ngelën si “interes shtetëror e shoqëror” u decentralizuan vetëm si bono në vlerë, proces ky që po e shkatërron tërë Institucionin e Vakëfit, planifikim perfid për ta rrezikuar perspektivën e Islamit nëpër këta troje!

1) Komisionet gjegjëse shtetërore ia vënë çmimin e pronës që nuk mund të denacionalizohet! Çmimet janë qesharake, janë grabitqare, janë ofenduese! Ky çmim tallës, pastaj, parcializohet në përqindje që duhen të përfundojnë nëpër xhepa të ndryshëm, që nga sekseri e deri te “ministri” dhe, 2) zhbërja e vakëfit duke i shpenzuar bonot në vlerë për rroga të administratës! As kushtetuta e BFI-së, asnjë rregullore tjetër, asnjë akt tjetër juridik, nuk lejon tjetërsimin apo shitjen e vakëfit por, vakëfi mund të këmbehet vetëm me vakëf. Vakëfi duhet të prodhojë, ta shtojë vakëfin! Vakëfi është “fabrikë gjigante” që e mbanë komunitetin e teologëve dhe që e zhvillon jetën fetare institucionale.

Me paratë nga vakëfi duhet të blihet vakëf. Për çdo vit, nga paratë e vakëfit (qeraja, shitja, mosdenacionalizimi) duhet të blihet pronë e re dhe të shtohet vekëfi dhe, jo që ato para të shpenzohen për rroga, për honorare, për vjedhje e fryerje të xhepave personal. Shaqir Fetai, ky shkelës i Kushtetutës së BFI-së, i ardhur nga struktura të dyshimta në krye të BFI-së, thotë se “kur e mora BFI-në kasën e gjeta vetëm për një rrogë”! Pastaj, thotë “e stabilizova situatën financiare të BFI-së”, kurse sot thotë se “falë pushtetit aktual jemi shumë mirë por shpresojmë se do të bëhemi edhe më mirë financiarisht”!

Raportet bankare që po publikohen flasin se në kasën e BFI-së janë derdhur, ose duhet të derdhen 257.418.782,00 den. që të gjitha bono në vlerë! Pjesa dërmuese e këtyre parave janë nga vakëfi i denacionalizuar në formë bonosh i Myftinisë së Shkupit, pastaj Resnjës, Manastirit etj

BFI-ja – edhe e militantëve partiakë

Në BFI ekziston një rregullore se sa për qind i ngelë myftinive e sa shkojnë në kasën qendrore nga të hyrat e ndryshme financiare.

Myftinia e Shkupit është më së shumti e dëmtuar në aspekt të vakëfit! Myftinisë së Shkupit i takon pjesa më e madhe nga kjo shumë e “denacionaizimit” të vakëfit dhe, kjo Myftini me ato të hyra duhet ta shtojë vakëfin. Hoxhallarët e Myftinisë së Shkupit janë në situatë më të të palakmueshme, bëjnë jetë “në të zezë”, pa siguracione, pa sigurime pensionale invalidore dhe, kjo situatë mund të përmirësohet vetëm me bledhjen e anëtarësimit nga xhemati i territorit të kësaj Myftinie! Jo që po avancon në këtë drejtim por, krahas humbjes së besueshmërisë, për pasojë edhe të fitrit, zeqatit dhe kontributeve vullnetare, ka nisur të humb edhe vakëf. Pa dyshim, një ditë, nuk do të ngelë asnjë i përfshier në tjetërsim dhe shitje të vakëfit pa dhënë llogari, nuk do të ngelë asnjë i përfshirë në zhdukje të vakëfit pa u përballur me drejtësinë e vendit. Ata që do t’i shpenzojnë vakëfet për rroga e për honorare personale, për ta blerë heshtjen e teologëve dhe mosreagimin e tyre kundër shkatërrimit të Institucionit të Vakëfit, do të ndëshkohen, do të detyrohen t’i kthejnë një për një të gjithë ato vakëfe që dikush i gjakut e i fesë na i la amanet. Ata që do ta heshtin këtë krim, do të jenë po aq bashkëfajtorë sa kriminelët!

Tani, pas shkatërrimit të BFI-së duke e stimuluar, duke e ndihmuar dhe përkrahur shkeljen masovike të Kushtetutës së BFI-së, partitë në pushtet do të kenë obligime ndaj militantëve të vetë që do të angazhohen financiarisht nëpër fushata. Këta do të jenë “bisnesmenë” e “afariistë” të ndryshëm, me kapacitete për të organizuar kryerjen e haxhit në linjë private (BFI-ja nuk do të guxojë t’i bllokojë apo t’i pengojë, sepse do të përgjigjet “penalisht” para partisë nënë!), do të organizojnë “ferma” e “therrtore” për kurbanë, për të përfituar për vete dhe jo për BFI-në!

Zatën, BFI-ja po përgatitet të shndërrohet në militantë partishë, në filiale organizative e financiare të partive, ndryshe, dhe, ky aktivitet meskin do të sjellë deri në heqjen dorë nga BFI-ja, nga organizimi i jetës fetare institucionale, deri në falimentimin e këtij Institucioni. Fitues do të dalin vetëm ata që ia kanë mësyer shkatërrimit të BFI-së me në krye Shaqir Fetain, për fatin e keq të tij! Çfarë fundi i trishtë ky, sidomos për një teolog, sidomos për një “epror” të fesë! /TetovaSot/14.03.2022

Vetëm tragjeditë e rënda e mbledhin “rijasetin”

Kushtetuta e BFI-së e obligon Rijasetin që të mbajë mbledhje të rregullta të paktën një herë në muaj. Situatat e jashtëzakonshme mund t'i përshpejtojnë mbledhjet e organit më të lartë kolektiv të BFI-së

Shaqir Fetai, ose nuk di të organizojë mbledhje të rregullta të “rijasetit” të tij, ose nuk do, ose nuk e kupton Kushtetutën, ose qëllimisht e injoron Kushtetutën, sepse fundja, ai është i imponuar politikisht jashtë të gjitha akteve juridike të BFI-së, ose mund të ketë ndonjë arsye subjektive të tij, për shembull, u frikësohet mbledhjeve të rregullta!

Shaqir Fetai, tash e pesë muaj ka sjellë e ndarë qindra vendime, ka kryer punësime, ka kryer disa veprimtari krye më vete, duke injoruar tërësisht Kushtetutën e BFI-së si dhe vendimet dhe qëndrimet e Rijasetit! Asnjë mbledhje të rregullt!

Mbledhja e parafundit e “rijasetit” të Shaqir Fetait është organizuar më 9 shtator të vitit 2021, me rastin e djegies së Spitalit modular për trajtimin e të sëmurëve nga Kovid 19, në Tetovë, me çrast humbën jetën pacientë që ishin shtruar për shërim. Kjo mbledhje u quajt “mbledhje urgjente” e “rijasetit” që u mbajt në Tetovë. Mbledhja tjetër, po ashtu e jashtëzakonshme dhe e fundit e “rijasetit” të Shaqir Fetait, është thirrur më 23 nëntor të vitit 2021, me rastin e tragjedisë së ndodhur në Bullgari ku humbën jetën mbi 40 qytetarë të Maqedonisë së Veriut!

Pra, këto dy ngjarje tragjike, dhe këto dy “mbledhje të jashtëzakonshme” lënë të nënkuptohet se Shaqir Fetai ka guxim të

thërrasë mbledhje të “rijasetit” të vet vetëm kur anëtarët janë emocionalisht të dërmuar dhe kur nuk kanë mundësinë e shprehjes së ndonjë “marifeti” të tyre!

Vërtet, pse Shaqir Fetai u frikësohet mbledhjeve mujore të Rijasetit, ashtu siç e parasheh Kushtetuta e BFI-së? Pse u frikësohet tash njerëzve të vetë të cilët ia dhanë tërë përkrahjen e instalimit të tij nga subjekte politiko-partiake në krye të BFI-së? Si guxon të paraqitet se po funksionon “institucionalisht”, ndërkohë që shkel aket normative të BFI-së dhe nuk ka kurrfarë vendimi kolektiv që do të silllej në dobi të zhvillimit të jetës fetare islame! Cila Kushtetutë ia kërkon Shaqir Fetait që të shkojë nëpër myftini e t’ju kërkojë që aty, në ato mbledhje “të veçanta” t’i raportojnë për “sukseset e arritura” (mbase ajo “kushtetutë” që siguron “pritje madhështore të myftinisë” për të gjorin); cila kushtetutë ia kërkon t’u japë vendim anëtarëve të myftinive! Si guxon të japë “vendime” të tilla, ndërkohë që Komisioni Qendror për zgjedhje të organeve të BFI-së akoma nuk e ka thënë fjalën e vet të fundit, akoma nuk ka raportuar para Rijasetit dhe as para Kuvendit të BFI-së! Prej nga e di Shaqir Fetai se ato zgjedhje kanë qenë konform Kushtetutës, konform rregulloreve për zgjedhje nëpër organet e Myftinive dhe se nuk ka pasur keqpërdorime, imponime të dhunshme, shantazhe të ndryshme! Pa dyshim, Shaqir Fetai i ka hyrë punës së legjitimitetit të sa më shumë fraksionimit politiko-ideologjik të organeve dhe institucioneve të BFI-së!

Shaqir Fetai e ka privatizuar BFI-në, i ka personalizuar të gjitha detyrat dhe obligimet që duhet t’i ketë “reisi” në drejtimin e Institucionit, e ka delegjitimuar tërësisht organin e Rijasetit si dhe sjell vendime vetëm për ato aktivitete që i përshkruhen personalisht atij si sukses dhe ku i jepet rasti për të promovuar “kapacitetet intelektuale” të tij adaptabil me kapacitetet e një skuthi.

Këto ditë, Shaqir Fetai e ka një hall të tmerrshëm! Si të organizojë mbajtjen e një mbledhje të rregullt të “rijasetit” të tij në prag të Muajit të Bekuar të Ramazanit! Është tepër vonë, kjo ia bën edhe më të vështirë punët, por edhe injoranca e tij se çfarë duhet të bëjë

për këtë Muaj e tremb nga thirrja më në fund e një mbledhje të rregullt! Në plan e ka që ta shtyej sa më shumë, sa më pranë fillimit të Ramazanit, me qëllim që “të neutralizohen” të gjitha mbrapshitetë eventuale që mund t’i kenë anëtarët e “rijasetit” të tij e që mund t’ia minojnë mbledhjen!

Kur do t’i raportojnë organet dhe institucionet e BFI-së para rijasetit për punën e kryer qoftë gjashtëmujore; kur do të raportojnë e do të marrin pëlqimin nga “rijaseti” i Shaqir Fetait për programet e tyre të përgatitur enkas për Muajin e Ramazanit, kur do të ngarkohen me vendimet e “rijasetit” dedikuar këtij Muaji! A do të jenë frut i një debati dhe një diskutimi të gjërë e të shtruar apo, thjesht, do të jenë vendime të porosituar nga “partia mëmë”, të cilët, nëse refuzohen apo diskutohen, mund të shoqërohen me reperkusione partiako-politike! Po cila parti e bën hesap Shaqir Fetain? Ai mund të jetë vetëm hendikep i papërballueshëm për çdo parti, me përjashtim të individëve partiakë të cilët Shaqir Fetai i ka bërë hisedarë në buxhetin dhe vakëfin e BFI-së!

Sido qoftë, në cilëndo mbledhje të ardhshme, Shaqir Fetai do të kritikohet (ose duhet të kritikohet) për veprimtarinë e tij antikushtetutare, kundër praktikave të BFI-së, do të kritikohet se pse nuk ka raportuar deri më sot as për situatën financiare, as për situatën e letrave me vlerë të dhëna nga qeveria në vend të denacionalizimit të pronave të vakëfit, për situatën e vakëfit, për shpenzimet enorme të buxhetit të BFI-së për promovimin e politikave të veta diletanteske, për degradimin e këtij Institucioni deri në bashkësi “fetare” me format të një shoqate qytetarësh multikonfesionale! Do të kritikohet për mungesë të ideve, vizioneve, të cilat do të kërkonin një reformë të thellë, duke filluar që nga largimi i tij, si person i padenjë, joadaptabil dhe i pavlerë për të qenë në krye të Institucionit të BFI-së. Sepse, të gjithë organet e BFI-së janë shumë të vetëdëshëm se, me Shaqir Fetain po fundosen ditë e nga pak dhe se ka ardhur momenti kritik që, ose të fundosen si fundrrinë e historisë ose të shpëtojnë faqebardhë. Të gjithë janë të bindur se tashmë fytyra e tyre ka nisur të ngjyroset me ngjyra

ylberi, derisa në fytyrat e tyre të dominojë tërësisht e zeza e fytyrës së Shaqir Fetait.

Këshilli për mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së

Shaban Aziri, kordinator

Eset Shaqiri, zv/kordinator

Mirdi Brao, zv/kordinator

/TetovaSot/17.03.2022

Pritje madhështore në “qevapçillnicë”

Në manifestimin qendror të organizuar nga “rijaseti” me rastin e Natës së Bekuar të Beratit, mungoi Shaqir Fetai dhe krejt “rijaseti” i tij! I la myslimanët e vendit, sepse paska pasur ftesë zyrtare (!) për ta inauguruar Myftiun e Sllovenisë. Dhe, ky farë myftiu nuk do të mund të zgjidhej pa pjesëmarrjen e Shaqir Fetait?! Ç’megallomani prej psikopati

Nga Manushaqe Shakiri

Shaqir Fetai, instalacioni i turpshëm politiko-partiak në krye të BFI-së, po i ikë manifestimeve me myslimanët e vendit, siç po i ikë edhe mbledhjeve me anëtarët e “rijasetit” të vet! Është edhe më tepër se tallje deklarimi se “rijaseti” paska organizuar diçka për të cilën as që është tubuar, as që janë marrur vesh, as që ka pasur plan e program, as që ka pasur thirrje për një organizim të tillë me rastin e Natës së Beratit. Thjesht, tha Shaqir Fetai dhe duhet të bëhet dhe, kur thote ky nuk ka nevojë se çka tubuhet “rijaseti” i tij! Shaqir Fetai me rrena mundohet “të madhërojë” një Natë të Shenjtë!

Me këto sjellje Shaqir Fetai e ka degraduar personalitetin dhe integritetin e BFI-së deri në një shoqatë minoritarësh të papërfillshëm në një shoqëri të gjërë! E ka gjuhëzuar deri në vasal të turlifarë ideologjishë të rrezikshme për vendin e për shoqërinë; e ka bërë strumbullarë të personave të inkriminuar, të

bashkëpunëtorëve të shërbimeve të ndrysh intelektualë, të personave shumë të dëmshëm për çështjen fetare e kombëtare. Shaqir Fetai e ka shndërruar BFI-në në “robot të ndryshkur” që shërben vetëm për plotësimin e qejfeve psikopatike të tij si dhe interesat meskine të njerëzve “politikë” që po e mbajnë afër sa për ta thithur edhe pak “gjakë vakëfi” që ka ngelur në këtë Institucion. Shaqir Fetai tashmë po nuhat se, shumë shpejt do t’i eskalojë situata dhe çdo gjë do t’i dalë nga duart e pista të tij. I frikësuar nga një situatë e tillë, ai nuk pranon të përfshihet në manifestime publike në vend. Këtë mungesë të tij e plotëson gjetiu. Për ta kamufluar frikën dhe ndjenjën e vet shumë të saktë për atë se “dashuria” për Shaqir Fetain është konsumuar aq shumë sa vetëm divorci nëse ia shpëton fytyrën, sa herë që i duhet të dalë në opinionin e vendit, ai ikë dhe këtë opinion e zëvendëson me qëndrimin në “diasporë” (te familjarët e vet dhe te bashkëfshatarët para të cilëve mudn të shesë këllqe për veshkë).

Përveç shpensimeve marramendëse nga buxheti i krijuar prej fitrit dhe zeqatit të myslimanëve të vendit, asnjë përfitim nuk vjen as për BFI-në dhe as për vetë “xhematin mikrpolitës”. Çfarë do të thotë vizita e Shaqir Fetait me “delegacionin” matrapazë të BFI-së në “Çevapxhilnica ALJKO”! Pritje madhështore në qebaptore për Shaqir Fetain! Për një racion me pesë “qevapa” Shaqir Fetai ia reklamon zotëri Alkës qebaptoren duke ia shoqëruar edhe me pesë fotografi. Një qebapë një foto-reklamë! Më hert ishte traditë që, reklamimi i “qebaptoreve” dhe i korporatave të ndryshme duke e shfrytëzuar personalitetin e të parit të BFI-së, në arkën e saj futeshin qindra e mijëra euro, atë vit ishte i garantuar derdhja e zeqatit të firmave të vizituara në arkën e BFI-së! Kjo punë ka qenë transparente dhe kjo mund të argumentohet edhe me dokumenta! Tani, Shaqir Fetai po e kryen këtë propagandë vetëm për një racion prej pesë “qevapave”! Dakord por, ku ka islame këtu, në këtë vizitë? Çka përfitoi BFI e çka myslimanët e vendit!

Shaqir Fetai, për të përjetuar ndonjë “pritje të ngrohtë vëllazërore e madhështore”, sillet si pordha n’tirqi, poshtë e lartë, pa kurrfarë qëllimi e pa kurrfarë synimi! Meqë paska marrë udhë për në

Lubjanë, hajde, thotë i gjori, të vizitohet pak edhe disa “qendra tona” të cilat nuk po na e tëjtin hiç! Kësaj rruge pastaj, Shaqir Fetai, do të vizitohet ose ambasadorët e BDI-së (të cilët deri më sot nuk janë vizituar asnjë sekond madje as nga Ministri i Jashtëm i vendit), ose, viziton firma e “korporata” sa për të shitur pordhë e për t’ju dhënë “dekoracione” për të arriturat e tyre personale! Shaqir Fetai, si me qenë “ministër i ushqimit të lehtë”, baleton nëpër qendra gastronomike shqiptare (natyrisht, që vijë nga fshati i tij apo nga rrethet e fshatit të tij), sa për t’ju thënë “ju dikur, dyshonit në mua por, ja ku u bëra “reis” i juaj!”! Shaqir Fetai po tenton t’i manipulohet bashkëveprimtarët e vet si dhe myslimanët e vendit me “pasuritë e tij” që janë prona të disa bashkëfshatarëve të tij e që në çdo situatë mund t’i fusë në përdorim nëse ngelin keq financiarisht! Shaqir Fetai është tipik si ai dhëndri që në natën e gjergjekut futet në dhomë me veglën e huaj!

Shaqir Fetai i ka dhënë vetes aq lluks të tepërt sa, ia do b... që të kthehet në inspektor si në kohën e Stanko Dragoviqit, oficerit të UDB-së, dhe të dalë e të vizitohet (spiunojë xhematë, sepse spiuni këtë e do: ta degradojë, ta nënshtrojë, ta poshtrojë, ta thyej në kurriz gjahun e vet)! Shaqir Fetai paska pasur nevojë për “mahnitje”; qenka mahnitur me nivelin e organizimit të jetës fetare të disa xhemateve në Itali! A i ka hije të vlerësojë njeriut më të pavlerë; si guxon të vlerësojë Shaqir Fetai i cili Institucionion e BFI-së e ka degraduar deri në zero faktor, deri në “gjyetarë të uritur”, të cilët, pasi nuk ia dalin ta gjuajnë kaprollin, bën që të ngopen edhe me një racion prej pesë “qevapçiqi”! Natyrisht, i viziton vetëm ato xhemate që në shumicë janë familjarë, katundarë, miqasia e tij, ata që, meqë nuk kanë se ku ta çojnë, (islamikisht e kanë siklet që ta çojnë në rr.s.) ia falin edhe të bëmat spiuneske nën pseudonimin “ORAO”! Dhe ky pastaj u jep “dekoracione” për lartësinë në detyrë gjatë zhvillimit të jetës fetare, edhe pse ky organizim është në përputhje të plotë me rregullat, aktet normative, me ligjet e vendit, të cilat, Shaqir Fetain nuk e bëjnë hesap më sa m... e b...

Dhe, çka fitoi BFI nga këto vizita të Shaqir Fetait, të tunduar nga malli për t’i hëngër nja pesë “qevapçiqi” aty kur diku përmes

kodeve spiuneske u raportonte njerëze të UDB-së! Vërtet pse Shaqir Fetai nuk pranoi që të shkojë e t'i vizitojë shqiptarët atdhetarë të grumbulluar pranë Shoqatës së Shqiptarëve të Trevizos? Iu duk ngushtë aty, ë?

BFI nuk fiton asgjë nga vizitat spiuneske të Shaqir Fetait, sepse, ai nuk është aty për të fituar diçka BFI por, thjesh, ai aty është për ta përhapur misionin e tij! Cili është ky mision? Ja, kjo mund të shpjegohet vetëm përmes fjalorit të tij policor dhe, kush ia vë mendjen kur flet ky farë duduki, sakaq do ta kuptojë. Ja se me çfarë fjalimi me fjalor policor iu drejtua të pranishmëve në inaugurimin e myftiut të Sllovenisë: “BFI e RMV është e gatshme dhe e vendosur të jetë në shërbim të bashkëpunimit të ngushtë me të gjitha Bashkësitë Islame në Ballkan”! BFI nuk ka nevojë të jetë në shërbim të askujt, kontratën e ka dhe duhet ta ketë ekskluzivisht me xhematin e vet. BFI angazhohet të bashkëpunojë me të gjitha organizatat simotra të sinqerta dhe të bereqetshme! Nuk ka nevojë të jetë në shërbim të bashkëpunimit, ndërsa Shaqir Fetai nëse ia do shpirti, le të vazhdojë të jetë në shërbim të bashkëpunimit me turliparë shërbimi nëntokësor! / 1KlikLarg/21.03.2022

Talljet cinike dhe të pafundme të Shaqir Fetait

Shaqir Fetai, më në fund, paska mbledhur “rijasetin” e vet sa për ta konfirmuar lojalitetin e marionetave të tij deri në pensionim. Nuk i kanë ngelur shumë, le të qëndrojnë me “sabrën e pelës” dhe, le të sjellin “konkluzë bazë”, pa kuptim, pa logjikë dhe pa përmbajtje. Shaqir Fetait nuk i duhet mbledhje përmbajtësore, i duhet “unitet” qoftë ky artificial apo i fallcifikuar. Urrejtjen popullore ai duhet ta përceptojë si dashuri që i duhet atij: “po mua më duan”! Shtrohet pyetja: kush

Nga Mevludin Pajaziti

Më në fund, pas një presioni të përditshëm, disa javorë, mbahet mbledhja e rregullt e “rijasetit” të Shaqir Fetait. Një mbledhje e mbajtur pas tetë muajve, jashtë të gjitha përcaktimeve kushtetuse, programore e rregullative. Shaqir Fetai, as këtë mbledhje nuk e ka mbajtur pa një “konsultim të gjërë”, sepse, tek ai kishin pas ardhur ca zëra që flisnin se anëtarët e “rijasetit” do t’ia bëjnë edhe atij, siç ia bëri ky paraardhësit të vet – thikë pas shpine! Shaqir Fetai nuk e ka të qartë, në fakt, nuk i zë besë askujt se, në të tilla kohëra në çfarë po jetojmë, nuk mund të ketë komplete, e as tradhëti. Por, ja që ky e ka frikën dhe, paraprakisht, me gjysmën e anëtarëve-kukull të “rijasetit” ka biseduar dhe ka marrur garanca të forta se nuk do ta heqin, të paktën, jo deri sa të dalë në pension, ashtu siç u ka premtuar para dy viteve kur i ka hyrë kësaj aventure. U ka garantuar se sapo të vjen koha për pension (vetëm dy vite bre!) do të tërhiqet nga pozicioni ku ka ngulur b...!

Për këtë marrëveshje dëshmon fotograflia-panoramë para shkallëve të BFI-së si dhe konkluzione idiotike sa për të dëshmuar se u bë njëfarë mbledhje! Çka dëshiron të dëshmojë Shaqir Fetai me një fotografi të tillë: jemi të gjithë të bashkuar?! Po a mund të jenë të bashkuar aq shumë sa Shaqir Fetai me kompaninë e tij me të cilët, një javë pra se t'ia ngulin thikë ish-reisit të tyre, para kamerave thurrën elozhe të padëgjuaara më parë për H. Sulejman ef.

Rexhepin! Shaqir Fetai e di fort mirë këtë truk: "lëmoja shpinën sa të vie çasti për t'ia ngulur thikën"!

Ku ndodhë në botë që pas çdo mbledhje të rregullt të fotografohen dhe ta dëshmojnë "unitetin"! Nëse nuk ka unitet brenda një organizmi, ata problematikët që cënojnë unitetin ndërrohen, hiqen fare, ose, bie i tërë organizmi! Paramendoni sikur kuvendi të fotografohet me të gjithë deputetet pas çdo mbledhje; qeveria të fotografohet para dhe pas çdo mbledhje para shkallëve të qeverisë! Po, një fotografim i tillë me tërë ekipin qeveritar apo kuvendor bëhet, fill pas konstituimit apo në dorëheqje të parevokueshme! Tani, cilën mesazh ta përcjellë fotografimi i Shaqir Fetait me bashkëveprimtarët e vet (në krim) para shkallëve të BFI-së? Të konstituimit apo të ikjes? Uniteti nuk dëshmohet ashtu, uniteti dëshmohet me marrje të detyrave me përgjegjësi, me zbatim të detyrave me profesionalizëm dhe në aksion të përditshëm të tërë ekipit.

U mbldoh Shaqir Fetai dhe, vetëm ky paska raportuar për aktivitetin e vet brenda dy mbledhjeve, ndërsa organet e "rijsetit" të tij paskan raportuar për vitin 2021! Aktivitetet e Shaqir Fetait brenda dy mbledhjeve të rregullta të "rijasetit" të tij konsistojnë në nja 31 "aktivitete" idiotike pritje-përcjellje të çajpirësve, nja 4-5 pjesëmarrje në ngushllime, në 3-4 pjesëmarrje në dua-hatme, në nja 3-4 vizit të ambasadorëve të Maqedonisë nëpër dynja, në dy-tre vizita të biznesit gastronomik sa për të provuar ndonjë "qevapçiç" e ndonjë byrek (mundësisht me mish) si dhe në dy-tre vizita jasht që as një pikë ujë nuk çojnë në dobi të myslimanëve të vendit dhe të BFI-së! I gjithë ky "aktivitet" i Shaqir Fetait i përcjellë me nja 700-800 fotografi. Tani, kemi pasur ndonjë sesion fotografik të manikinit apo të top-modelistit Shaqir Fetai, apo kemi pasur aktivitete jetike të "reisit"! As njërën dhe as tjetrën! Thjesht, kemi pasur përpjekje për pak qytetari të një diletanti i cili me qytetarinë e rëndomtë është larg sa toka me hënën!

Shaqir Fetai është dashur ta mbledhë "rijasetin" e vet për të

debatuar për të vetmin rend të ditës: RAPORT MBI NJË TAKIM SKANDALUZ DHE FATAL TË SHAQIR FETAIT PËR BFI-në DHE FUTJEN E KËTIJ INSTITUCIONI NË FOKUS TË INERESAVE TË VLLADIMIR PUTINIT!

Shaqir Fetai është dashur që të motivohet nga bashkëveprimtarët e vet dhe publikisht të dalë e të distancohet nga ky takim, t'i kërkojë falje opinionit të gjërë të vendit, ose, ta përforcojë qëndrimin e vet pro-Putin! Nuk ka guxuar të flasë mbi këtë problematikë, sepse, pastaj është dashur të formohet qëndrimi institucional kundër aventurës makabër të Putinit në Ukrainë! Këtë gafë nuk guxon ta bëjë Shaqir Fetai, sepse, pastaj do t'i ...(vetëm ai e di)!

Se mbledhja ishte kot e kot dëshmojnë edhe “konkluzat” që i nxori nga ajo mbledhje hipokrite e Shaqir Fetait. A ka ky farë bilmezi njerëz që dinë t'ia organizojnë mbledhjet! A ka ky farë ahmaku njerëz që e kuptojnë fjalën KONKLuzion dhe si formulohen ato, madje, a e dinë se pse formulohen konkluzione? A e di ky far turulum i se çka duhet të flasin konkluzionet dhe cila është gjuha e konkluzioneve? Nuk ka, madje edhe sikur të kishte, nuk do t'i interesonte Shaqir Fetait, pasi fokus i interesit të tij është vetëm “besnikëria” e marionetave të tij derisa ta arrijë pensionimin që ia garanton një pension të majmë në kurriz të të gjithë hoxhallarëve të vendit të cilëve me shumicë nuk u paguhet institucionalisht kurrfarë kontributi invalido-pensional!

Është sevap i madh që t'i bëhet me dije Shaqir Fetait se fjala konkluzion (pra jo konkuze) ka kuptimin e fjalës përfundim. Përfundimi logjik i gjësë! Konkluzioni i përdorur si shprehje në një përfundim të një gjëje të natyrës juridike ka kuptimin e aktit normativ dhe fuqinë ligjore mbi një proces, dukuri a fenomen, siç mund të ketë edhe pasoja juridike e financiare!

A mund të thuhet “konkluzat bazë të rjasetit”? Po, mund të thuhet nga goja dhe truri i diletantit, i mjeranit, i qesharakut që as nuk di të flasë e as nuk di të lexojë, pa një gram kulture shkrimi! Pse a paska edhe konkluzat periferike, konkluzat kulmore, konkluzat ballkonike, konkluzat oborri...

Konkluzioni përmbanë qëndrimin përfundimtar të një organi apo institucioni i cili duhet të jetë me tonalitet vendimi të ekzekutivit.

A mund të jetë konkluzion: “Muaji i Ramazanit fillon më 02.04.2022, që do të thotë se dita e shtunë do të jetë dita e parë e agjërimit të Muajit të Ramazanit!” Kjo i bie që, pas shumë debateve, pas shumë propozimeve të institucioneve botërore me

relevancë islame, më në fund u dakortësuan që dita e fillimit të Ramazanit është 2 prilli! Një “konkluzë” të këtillë mund ta propozojë vetëm një kryeinjorant si Shaqir Fetai! Informacionit ia jep peshën e konkluzionit!!!

Një botë e tërë do të qeshë e do ta llogarisë BFI-në si institucion të mjerë e të kotë sapo ta lexojnë “konkluzën bazë” të Shaqir Fetait: “Të realizohen emisione në TV qëndrore dhe lokale”, apo “dhënia e Sadekatul fitrit është obligative”, apo, kur do ta lexojnë këtë konkluzë “Rijaseti i BFI e RMV ua uron të gjithë besimtarëve Muajin e shenjtë të Ramazanit”, nuk do të ngel organizatë me relevancë që nuk do të konstatojnë se Shaqir Fetai ka një “rijaset” me analfabetë e gjysëmanalfabetë, me lakej e marioneta, me bilmeza e dudukë që, shkrihen me lezet në budallakitë e Shaqir Fetait.

Shaqir Fetait nuk i intereson serioziteti në organizim të një Muaji aq të rëndësishëm si për nga aspekti fetar, moral, human, njerëzor dhe me peshë të burimit jetik financiar të BFI-së. Sepse e di që, një të ndyturi nuk i përket organizimi fetar, sepse e di që ka edhe pak para nga vakëfi dhe mund ta shtyej deri në pensionim të vetin, njëkohësisht duke shkatërruar burimin jetik financiar të BFI-së (pas meje le të fundoset tërë BFI, ky është misioni!) Tërë kjo hile mbështetet në lavdin idiotik të Shaqir Fetait kur thotë se, u raportua financiarisht se në krahasim me vitin 2020 në vitin 2021 kemi qenë 60% më mirë financiarisht? Po si u bë? Prej nga erdhën këto para, nëse jo prej letrave me vlerë në vend të denacionalizimit të vakëfit! Çka u bë me këto para, ku shkuan, apo, thjesht, po shpenzohen në rroga deri në pensionim të Shaqir Fetait! Pse nuk nënvizon Shaqir Fetai se për vitin 2021 nuk u desht të shpenzohet asnjë metalik për procesin e denacionalizimit të pronave, duke përgatitur dokumenta, duke paguar gjyqe e avokatë, duke u përgatitur për procese të mëtejme, si në vitin 2020 e më parë! Fare në fund, në prag të kësaj mbledhje iu publikua skandali më i trishtë që ka mundur t'i ndodhë BFI-së që nga formimi i saj shekuj më parë! Të propozojë që të lartësohet në bronz marioneta e Putinit, babai i aleatit të sotshëm më besnik të Putinit, Ramazan Kadirovit – kjo mund t'i ndodhë vetëm besnikëve të UDB-KGB-së! Dështimi i këtij projekti skandaloz është sot brengë e Shaqir Fetait dhe jo BFI-ja aq më pak organizimi i saj sa më i dinjiteshëm në prag të Muajti të Bekuar të Ramazanit. Zot, mos e fal, sepse ai shumë mirë e di se çfarë bënë! /Fol/26.03.2022

Një lidhje shqiptare me Putinin

Për synimet ruse që “nga distanca” të kenë ndikim mbi politikat e BFI-së, kjo nuk është mohuar asnjëherë. Madje, kohëve të fundit, një bashkëpunim i elementeve ruse me BFI-në ka qenë shumë transpaente, publikisht i tumpetuar, madje, me goxha premtime për palën ruse

Nga Ilir R. Topi

Mbase, si fryt i këtij bashkëpunimi janë edhe angazhimet e disa “hoxhallarëve” të Maqedonisë së Veriut në përhapjen e propagandës kundër presidentit hero të Ukrainës, Volodymyr Zelenskyi, dhe në të mirë të kriminelit Vladimir Putin! Rezultati i këtij angazhimi: BFI-ja është i vetmi Institucion fetar në RMV prej të cilës vazhdimisht kërkohet që ta dënojë invazionin rus në Ukrainë, kërkohet që ky Institucion që drejtohet nga “shqiptarët”, ta dënojë politikën kriminele të Putinit dhe të solidarizohet me të gjithë ata shtete që të paktën moralisht e mbështesin luftën e popullit ukrainas në mbrojtjen e shtetit të vet.

Pa dyshim, nuk janë nën llupën e ndërkombëtarëve këta hoxhallarë të influencuar nga lloj-lloj ideologjishë. Nën llupë është vetë Shaqir Fetai si dhe bashkësia “fetare” e tij!

Popullatës së vendit duhet t’i kujtohet momenti kur Shaqir Fetai në zyren e vet të uzurpuar priti një delegacion nga “Forumi i myslimanve të Evropës me seli në Bruksel” të cilin e drejtonte

njëfarë Abdul-Vahid Niyazov! Ata që e kanë lexuar komentimin e Radio Evropës së Lirë rreth kësaj vizite “misterioze”, sakaq do ta kompletojnë mozaikun i cili ka këtë rrëfim: dy-tre vite më herët, Putini ka planifikuar okupimin e Ukrainës si dhe zgjerimin e një lufte deri te Lufta e Tretë Botërore! Pa përfshirjen e komunitetit mysliman nuk do të përshpejtohej lufta e cila do ta nxirrte Putinin nga situata e palakmueshme ku do të futet. Shërbimet inteligjente ruse formojnë një “forum myslimanësh” në Bruksel, i cili, si synim të parë do të kishte rehabilitimin dhe ngritjen në “kult” të çëçenëve myslimanë pro-rusë. Pastaj, me një celulë të këtij “forumi” që do të themelohej në takimin e radhës në Lituani, do të “sensibilizoheshin” edhe komunitetet e vogla myslimane të Shteteve Balltike, të cilat, me pushtimin e Ukrainës do të shërbejnë si kurth për ta futur në lojën e Putinit tërë NATO-n! Prej veglave domethënëse putiniane parashiheshin Abdul-Vahid Niyazov dhe Shaqir Fetaj, ky agjent i UDB-së i regjur nën direktivat e oficerit serb Stanko Dragoviqit.

Po kush është ky farë Abdul-Vahid Niyazov, cili ishte synimi i tij dhe pse zgjodhi të zhvillojë propagandën pro-ruse pikërisht përmes Shaqir Fetaj dhe pikërisht në Tetovë?

Abdul-Vahid Niyazov, “drejtues i forumit mysliman pro-rus në Evropë”, Drejton po ashtu edhe Qendrën Kulturore Islamike të Moskës, një departament publik i këshillit zyrtar të myftiut rus dhe gjithashtu organ i lidhur me Kremlinin. Në Federatën Ruse, Niyazov konsiderohet si bashkëpunëtor i afërt i presidentit rus, Vladimir Putin, dhe prej vitit 1999 e deri në vitin 2003, ka qenë përfaqësues i partisë së Putinit në Dumën ruse. Te Shaqir Fetaj vjen me direktiva moskovite, sepse rusët e dinë fort mirë afërsinë e Shaqir Fetajit me partinë myslimane në pushtet (BDI-në)! Niyazov do t’ia dalë pikërisht përmes Shaqir Fetajit të takohet dhe t’i inkriminojë në një lojë shumë të rrezikshme drejtues më të lartë të shtetit por edhe të pushtetit lokal. Ia del të marrë premtime se “projekti” i tij do të nisë të realizohet pikërisht në Tetovë, në qendrën e botës politike, arsimore e kulturore të shqiptarëve myslimanë të Maqedonisë së Veriut. Këtij farë deputeti të Putinit

shqiptarët e manipuluar nga Shaqir Fetai do t'i premtohet që një parku në qendër të qytetit t'i vihet emri i "liderit çeçen" të sajuar nga Putini, Ahmad Kadyrov, të cilit pushteti vendor i Tetovës do t'ia ngrisë edhe një përmendore në "parkun e miqësisë ruso-shqiptare"! Shqiptarët dhe tërë bota e dinë që lideri historik i Çeçenisë është Gjeneral Dudayev, i cili, në mënyrë më kriminale u vra nga rusët, u shtyp ideali i këtij populli dhe, që nga atëherë, këta myslimanë drejtohen nga pseudo-çeçenë nën hyqmin e elementeve të Putinit. Natyrisht, pas vrasjes së Ahmed Kadirovit, në krye të Çeçenisë do të vihet djali i tij, Ramazan Kadirov, për momentin i vetmi aleat besnik i Putinit, madje që është futur me "çetën" e vet prej "çeçenëve myslimanë" të synetosur nga Vlladimir Putin, në territorin e Ukrainës duke mbjellë terror e frikë mbi popullatën ukrainase!

Pra, takimi dhe miqësimi i Shaqir Fetait me Vahid Niyazovin si dhe dhënia e karakterit shtetëror kësaj vizite, Fetait i shërben që ta dëshmonte besnikërinë dhe sinqeritetin e tij në lidhje permanente me linjën serbo-ruse. Niyazov lojalist besnik i Putinin, ndërsa Shaqir Fetai angazhohet që "liderit çeçen", Kadyrovit, t'i ngritet një përmendore në mes të Tetovës në shenjë të miqësisë dhe vëllazërisë "ruse-shqiptare"!

Tërë kjo lojë është edhe një fakt për ta kuptuar të vërtetën se, Shaqir Fetai, nuk është njeri që çon ujë në mullirin kombëtar e as partiak, por, është si një jaz i devijuar që e çon ujin në mullirin ruso-serb. Shaqir Fetai nuk mbanë llogari as për autoritetin dhe personalitetin e Kryetarit të parë shqiptar të Parlamentit të RMV-së, as të ish-kryetares së Tetovës, si një femër e parë drejtuese të një komune shqiptare, por as për personalitetin e vetë BFI-së si Institucion fetar islam.

Shaqir Fetai deri më sot, nuk i ka kërkuar falje publike as Kuvendit të Maqedonisë, as Komunës së Tetovës, as bashkëpunëtorëve të vet dhe askujt që e ka futur në llucën e përgatitur nga guzhinat ruse. Sillet me një nonshalancë të një njeriu mermer të ftohtë!

Kjo është arsyeja se pse përfaqësues të BE-së dhe të ambasadave

të ndryshme në vend i kërkojnë Shaqir Fetait që ta dënojë invazionin rus mbi Ukrainë. Kjo kërkesë nuk i shtrohet asnjë bashkësie tjetër fetare, as grupeve religjioze, as liderëve të tyre që funksionojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kësisoj, të huajt, na bëjnë me dije se, BFI-ja, për herë të parë në historikun e vet drejtohet nga një “element” i gatuar nëpër guzhinat ruse! Mbase Rusia një ditë do të kërkojë që, në “parkun e miqësisë” aty ku janë dakorduar që t’i ngriten përmedore Ahmed Kadirovit, babait të Ramazan Kadirovit, t’i ngritet përmendore edhe Shaqir Fetait, të paktën, një pllakë përkujtimore!

Në protokolet e takimeve zyrtare të aranzhmuar nga Shaqir Fetai, është i regjistruar edhe ky premtim zyrtar i institucioneve shtetërore i nxjerrur nga Shaqir Fetai, në emër të miqësisë së ngushtë “shqiptaro-ruse”!

Ky është Shhaqir Fetai, vegla kodër pas bregu e Putinit. Ja pse Shaqir Fetai i kthen qytetarët edhe nga rruga në zyren e tij për t’u dhënë çaj, ja pse kot e kot niset për të takuar pa kurrfarë arsye e nijeti xhemat nëpër “botë”! Sepse, i duhet shtuar besimin Putinit se e ka diku në Maqedoninë e Veriut një “lider fetar” që e duan shumë dhe që ka influencë të madhe, gjithandej! Madje që e do dhe që e viziton shpesh edhe Naim Tërnavë, kryemyftiu i BIK-ut! Të mos distancohesh sot publikisht nga një vegël e Putinit siç paska qenë Vahid Niyazov, të cilin e priti dhe e shëtiti nëpër zyret e instancave më të larta shtetërore, është baraz me kujdesin për mos t’i prishur raportet miqësore “në distancë” me Putinin! /BotaPress/27.03.2022

Zemra bosh e humanistit

Një shprehje popullore shqiptare thotë: “Kur të marrësh i ke duart plotë, kur të japësh e ke zemrën plotë”, nisë letrën e vet një nëpunës i BFI-së që na e nis në inbox e që emri i tij për redaksinë tonë ngelë konfidencial

A mund ta ketë Shaqir Fetai zemrën plotë! Pa dyshim, ky farë instalacioni i pushtetit maqedonas në krye të BFI-së është njeri që tashmë katërcipërish ka dëshmuar se zemrën e ka bosh, të zbrazët, të zi, pa pikë gjaku, zemër që rrah vetëm sipas ritmit të interesit personal.

Kur e keni dëgjuar brenda vitit të ketë bërë ndonjë vepër humane Shaqir Fetai? Kur ia zgjati dorën një skamnori, një të varfëri, një jetimi? Shaqir Fetai humanitetin e llogritë si aksion sezonal, apo, si gjest që duhet të përsëritet vetëm njëherë në vit! Vjen Muaji i Bekuar i Ramazanit dhe, me vrap të luajmë me ndjenjat e myslimanëve të vendit. Të japim pak se ata do të na japin më shumë!!!

Myslimanët e vendit pa dyshim që paguajnë fitrin, japin zeqatin, organizohen për të shkuar me BFI-në për në haxh, me qëllim për ta ndihmuar financiarisht Institucionin, gjithësesi, falin edhe shumë kurvana, si në gjë të gjallë, ashtu edhe duke i paguar. I mbledhin në emër të Medresesë, reston ia japin “të varfëre”! Çka e shtyu sot Shaqir Fetain, tre ditë para fillimit të agjërimit, që të shpërndajë 3200 pako me mish (20 ton mish)?! Ndjenja e humanitetit, apo ndjenja e grabitjes! Shaqir Fetai edhe në këtë aksion e parasheh dhe e toleron grabitjen. Sepse, grabitjen e ka për qëllim! Do të prekë emocionalisht myslimanët e vendit që, përmes një gjesti “simbolik humanitar” të detyrojë sa më shumë myslimanë të derdhin fitra në kacën e BFI-së. Sepse, Shaqir Fetait i duhen fitrat, duhet ta ketë kacën plot që të vjedhë (vjedhje kjo që i miratohet njëzërit nga “rijaseti” me rastin e raportimeve vjetore); i duhet kasa plotë që të blejë “dekoracione”, që të porosisë

“dekoracione” duke i pasur parasysh “konkluzat bazë”; Shaqir Fetait i duhet kasa plotë me fitra sepse i duhen për të vizituar ambasadorë maqedonse nëpër vende të huaj, i duhen për të shëtitur e shijuar objekte gastronomike, i duhen për ndonjë racion me “pesë qevapçiçi”; i duhet kaca plotë me fitra sepse, njerëz të kotë, që thërret na rruga, “hafiza” të cilët kurrë më të voglin kontribut nuk e kanë dhënë për BFI, që e kanë urrejtur “historikisht”, njerëz që i sillen rreth b... sa për t’ia financuar ndonjë projekt të ardhshëm “me ilahi”, pra, këtyre a duhet t’u japë çaj e kafe (mundësisht edhe ndonjë mirënjohje për faktin që e kanë vizituar dhe i kanë uruar shëndet e suksese Shaqir Fetait)! Shaqir Fetai ndanë mish nga kurhani i dhuruar vitin e kaluar! Shaqir Fetai nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet humanitar, asnjë aktivitet për të sensibilizuar myslimanët e vendit që të grumbullojnë ndihma për nevojtarët. Shaqir Fetai, si një magjistar primitiv, reagon dhe e gjenë “zgjidhjen”: t’u japim atë që ua kemi marrur! Epo a ka hipokrizi dhe hipokrit më të madh?! Shpërndanë nga mishi të cilin e ka rezervë për medresantët, shpërndanë nga ai mish i dhuruar të cilën është dashur t’ua shpërndajë qysh vitin e kaluar nevojtarëve të vendit.

Shaqir Fetai po vdes për pak humanitet, o vetëm një gram të konceptohet si njeri human! Prandaj dhe, kërkon që akcioni të nisë nga oborri i BFI-së, ku pakot e para me mish do t’i “falë” Shaqir Fetai! Apo, këtë gjest do ta ushtrojë në të gjitha myftinitë e vendit, sepse, “të varfërit” e Shkupit mund të ndjehen më të “privilegjuar” nga pakot e ”dhuruar” prej Shaqir Fetait, ndaj, për të eliminuar këtë “diskriminim”, do të shkojë myftini më myftini!

Shaqir Fetai paska vendosur që t’i dhurojë 3200 pako me mish. Gjithësej, nëpër çdo myftini nga 250 pako me nga 6 kg mish! Sipas statistikave të fundit, vetëm në qytetin e Shkupit, në zonën myslimane, janë të evidentuar mbi 4000 familje skajshmërisht të varfër! Dhe, Shaqir Fetai këtyre të vafërve do t’u dhurojë 250 pako! Po kaq pako do t’u dhurojë edhe mbi 2500 familjeve të varfër në Tetovë, po kaq në Gostivar, po kaq edhe në Kumanovë me rrethinë ku, sipas regjistrit të Kryqit të Kuq lokal janë të evidentuar mbi 3000 familje të varfër! Ç’kuptim ka kjo sasi e mishit pa vaj, pa krip, pa nja 2-3 kg patate, të cilat i varfëri nuk arrinë t’i blejë. Apo, Shaqir Fetai niset nga fakti që, mjafton ata ta hedhin mishin në prush të zjarrit e ta hanë si ”mbreti në kashtë”! Të paktën, të

ndjehen “mbret” njëherë në vit, me mish të Shaqir Fetait, që e vjedh nga sasia rezervë për medresantët!

Mos të harrojmë, nga pakot e ndara nga Myftinia e Shkupit e në oborr të BFI-së, që në start janë vjedhur 57 pako që kanë përfunduar nëpër familjarët, miqtë dhe të njohurit e të punësuarve! Kështu do të vidhet i tëri kontigjenti “humanitar me mish”!

Edhe një gjë: Shaqir Fetai i paska grumbulluar copat e mishit në 3200 pako, të cilat do t’i shpërndajë gjatë ditëve të para të Ramazanit! Po ku do t’i ruaj këto pako? Apo, mish të “freskët” do të hanë vetëm të parët, ata të fundit mund të hanë edhe mish të prishur! Po pse Shaqir Fetai nuk ka zhvilluar aksion për t’i ndihmuar shoqatat humanitare myslimane në vend dhe ata ta bëjnë shpërndarjen brenda ditës të tërë “mishit humanitar”! Dhe e fundit: me ç’kriteret e ndanë mishin Shaqir Fetai! Kujt ia jep, ku janë listat e hartuara paraprakisht me raste të rënda sociale. Cili komision ka vizituar rastet sociale dhe mbi ç’farë kriteresh kanë vlerësuar se cilat familje duhet të ndihmohen? Apo nuk është me rëndësi kjo punë, me rëndësi është vetëm shënimi se ja, “Shaqir Fetai, veç të tjerash, ka dhe profil humanitar”!

Populli thotë: “dikush është i lindur që të ik nga sevapi e të futet në gjynah” dikush, si ky farë Shaqir Fetai!/Opinione/29.03.2022

Skandal në FSHI: aty fshihet bashkëpunëtori i diplomatëve të dëbuar rusë?!

Nga inboxi i Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI

Pikëllim në Fakultetin e Shkencave Islame për largimin e pesë diplomatëve rusë! Po ndërpitet një bashkëpunim konspirativ. Po e vuan edhe Shaqir Fetai i vetëdekonspiruar para gjithë syve të opinionit. Për shtetin do të ishte më pakë e dhimbshme sikur ta godiste Shaqir Fetain se sa që po i bie samarit, në rastin konkret, diplomatëve rusë

Kohëve të fundit po na arrijnë në inbox shumë letra nga organet e ndryshme të bashkësisë “fetare” të Shaqir Fetait! Të shumta janë nga Medresja si dhe nga Fakulteti i Shkencave Islame. Do ta botojmë një letër në vazhdim, ndërsa të gjithëve do t’ua bëjmë me dije se letra të tjera që na vinë në inbox, me lutje që t’ua ruajmë anonimatit, nuk do t’i publikojmë më. Është mirë që vetë letërshkruesit t’i publikojnë, ose të na i dërgojnë me kërkesë që t’i botojmë. Fshehjet e këtilla nga frika se Shaqir Fetai do të marrë masa me largim nga puna, janë justifikime bajate. U bëjmë apel të gjithëve që kanë fakte e argumenta le t’i publikojnë, më mirë të “ndëshkuar” nga Shaqir Fetai se sa nga Zoti! Të frikosohesh nga Shaqir Feta është ta refuzoshë të Madhin Zot, I Cili na ka mësuar që ta luftojmë të keqen, zullumin dhe hipokrizinë. Të heshtësh para Shaqir Fetait, ose, të veproshë fshehurazi prej tij, nuk është as dinjotoze, as islame dhe as burrërore. Sepse, pastaj hy në lojë turlifarë shërbimi, kurse popullata e vendit ka nevojë t’i shërbejmë Zotit duke e përjashtuar nga mesi ynë zullumqarin që e trashë zullumin në emër të fesë islame.

Më poshtë po e botojmë letrën në tërësi që ka ardhur në inbox nga letërshkruesi prej FSHI-së:

“Të dashur miq! Nuk e keni idenë se si sot, një koleg i yni, na ka rënë mazun aq fort sa verë me gojë nuk po bën!
Ministria e Punëve të Jashtme të Qeverisë së RMV ka publikuar një komunikatë në të cilën thuhet se shpallen “non grata” pesë punonjës të ambasadës ruse për të cilët ka mjaft indikacione se kishin kryer aktivitete që bien ndeshë me Konventën e Vjenës dhe se ata do të duhet të largohen nga territori i Maqedonisë së Veriut brenda një afati pesëditor. Që nga momenti kur kolegu ynë u njohtua me këtë lajm, është zverdhur i tëri. Ne, stafi akademik i FSHI-së e kemi pasur haberin edhe më herët se ai dyshohet si bashkëpunëtor i ambasadës ruse, madje se ka qenë qysh herët, ky që ia ka mbajtur lidhjet Shaqir Fetait me deputetin rus të Putinit, Abdul-Vahid Niyazov, mikun e ngushtë të Ramazan Kadirovit, por që nga ardhja e Shaqir Fetait nga pushteti maqedoas, për ta kamufluar influencën dhe kontrollin rus mbi BFI-në, e ka larguar kolegun nga kabineti i tij dhe e ka spostuar në FSHI prej nga në mënyrë “sekrete” ka ruajtur raportet dhe bashkëpunimin e përditshëm përmes “teologut” me njërin prej këtyre diplomatëve rusë (emrin e “bashkëpunëtorit rusë” e kemi fshirë qëllimisht, sepse bëhet fjalë për një teolog. Redaksia!).
Pa dyshim, u fol edhe një fakt tjetër! U tha se, shërbimet e shtetit kanë kuptuar “agjenturën” e BFI-së me ambasadën ruse në vend ndaj dhe, për ta ndërprerë këtë “bashkëpunim sekret”, mjaft të rëndë për shtetin, kanë vendosur t’i dëbojnë pesë diplomatët rusë me qëllim për ta shkëputur një lidhje destabilizuese për shoqërinë e caktuar si dhe për vetë shtetin.
Është vetëm një gjë e pakuptueshme! Pse shteti i hidhërohet gomarit dhe i bie samarit! Në këto situata të turbullta në rajon e në mbarë botën, do të ishte më mirë që shteti të merrte masa ndaj veglës së vet jo të sinqertë dhe të ndryshkur për nga morali, pra, ndaj Shaqir Fetait që, me gjasë u paska dalur ndorësh, se sa të ngatërrohet me ambasadën dhe diplomatët rusë”, thuhet në fund të letrës “anonime” të postuar nga Fakulteti i Shkencave Islame në Shkup!/Kombetare/31.03.2022

Kush po e keqpërdorë mishin e kurbanit të vjemë

Çdo veprim “publik” i Shaqir Fetait është i barasvlefshëm me haramin. Ai akoma nuk dëshiron të pranojë e të vetëdijësohet se në veprim ai del i cityr nga mësimet dhe joshjet e djallit, sepse, hapësirën për veprim e ka të kundërligjshëm, e ka të kundërkushtetuetshëm, e ka kundër mësimëve islame. Deri te mundësia e veprimit publik ai erdhi duke ia ngulër thikën dhe duke e eliminuar “figurën markante” që e kishte diell për shpirt

Nga Selvete Muaremi

Kur të humbet turpi, atëherë e ke lirinë absolute për të bërë gjithçka që është kundër natyrës së njeriut, për më tepër, të njeriut të ngritur me mësimë islame! Çka ndodhë me këto mësimë islame te njeriu që e humb turpin? Asgjë, përveçse që bëhet “ushtar i shejtanit” dhe që “mbyt” nga frika çdo njeri tjetër që nuk mendon si ai!

Çka mendon Shaqir Fetai? Çka mendon kur e vë kokën në jastëk për të fjetur? Kur të zgjohet në mëngjes, në çka i shkon fillimisht mendja? Kur të hedhë këmbën nga pragu i shtëpisë, për ku e merr udhën? Shaqir Fetai i djallëzuar është rehat me vetëveten. Sikur vetëm një sekond të ishte nën ndikimin e mësimëve islame, ai do ta vërshonte tërë oborrin e vet me lotët e pendesës, me lotët e turpiti! Është edhe në moshë, në atë moshë e cila, kur të zgjohesh në mëngjes, sakaq të shtang për shtrati, të bën të peshoshë miliona kilogram, të shtang në vend duke të të detyruar të

mendosh vetëm një gjë: çka bëra dje e çka do të bëj sot! Çdo mëngjes Shaqir Fetai mendon trimërueshëm: “vrava” dje, do të “vras” sot dhe, asnjëri nuk po guxon të më quajë kriminel, të gjithë po më thonë “reis”! Shaqir Fetai, në çdo ditë të lume, sa herë të hedhë këmbën nga pragu i derës, ai niset i stërlumtur në vendin e krimit, sepse nga ai moment ai lidhi pakt me djallin! Dhe, prandaj, sa herë që i shkon dikush për ta vizituar në “vendin e krimit”, ai është i lumtur, sepse po takon një njeri të pastër, një njeri që për hirë të Zotit niset për një vizitë, ndërsa Shaqir Fetai ia keqpërdorë duke i treguar botës mbarë e, shikoni-shikoni, një njeri erdhi për ta vizituar një shejtan!

Vetëm shejtanit mund t’i shkojë në mend që të tallet me besimtarët e devotshëm! Keni parë se si ditë më parë, pa bërë kurrfarë aksioni gjatë vitit për tubime të ndihmave humanitare për nevojtarët myslimanë të vendit, ai, sakaq u paraqit me kinse 3200 pako me mish! Ky veprim i Shaqir Fetait të djallëzuar po që ishte një skandal i llojit të vet! Ku e mori Shaqir Fetai atë mish! Kush ia dha? Mos e kërkoi diku? Mos shiti ndonjë arë të babës dhe bleu mish për humanitet?

Pikërisht për këtë skandal me të madhe po flitet anekënd vendit. Jo vetëm për faktin që nëpër ato pako më shumë kishte kocka se sa mish, jo se, edhe ai mish që ishte, ishte si shollë këpucësh, i pazishëm, por, edhe për faktin se Shaqir Fetai i preku në sedër shumë myslimanë!

Mishi ishte nga kurbanët e vjetëm të magazinuar në një frigorifer diku në Tetovë. Pse e ka magazinuar Shaqir Fetai këtë mish, kur ky magazinim i ka kushtuar goxha para BFI-së, gati po aq sa ta blente sot e të freskët ta shpërndante për humanitet! Myslimanët që e kanë dhuruar kurbanin e vet, kanë shpresuar qind për qind se ai mish ka shkuar te fukarai, kanë menduar se si të gjithë dhurues të kurbanëve që kanë gëzuar fukaratë, të varfërit e të mjerët në vend, edhe ata kanë gëzuar dikë dhe se ia kanë dalur të fitojnë ndonjë sevap! Shaqir Fetai e ka stopuar shpërndarjen e mishit vjet, sepse, ai nuk ka menduar për sevapet e myslimanëve të devotshëm, ai ka menduar ekskluzivisht për b... e vet, ka menduar që në prag të Ramazanit, t’i joshë myslimanët për humanitet dhe t’ia japin fitrat e zeqatin për medresantët, sepse, ja ja, si po bën humanitet Shaqir Fetai! Mish i fjetur në ngrirje një vit! Mish që futet nëpër pako pa kurrfarë testimi bakterial të vendit ku e futë, mish që shkrihet, mish që shëtitet me dit derisa të mbërrijë

në derë të destinuar! Po listat me të varfër që duhet të marrin ndihma? Nuk është me rëndësi për Shaqir Fetain se ku shkon ky mish, për të me rëndësi është që të shkruhet se, Shaqir Fetai po ndanë mish! Askujt mos t'i interesojë se çfarë mishi është, ku e mori, si e mori por, të gjithë le ta dinë – Shaqir Fetai ndau mish! Natyrisht, ky veprim “humanitar” i Shaqir Fetait është sa skandaloz aq edhe i turpshëm! Është shumë i vetëdijshëm se gaboi, por që nuk është në fuqinë e “ndërgjegjes” së tij! Të turpëruar po ndjehen edhe bashkëveprimtarët e tij, sepse të gjithë po përballen me reagime të myslimanëve: Çka po bëni me bukën e gojës sonë bre Zoti ju marroftë kështu si ju ka marruar. Ndiimën fetare të myslimanëve askush nuk ka të drejtë ta përvetësojë dhe ta paraqesë si ndihmë personale që po ua ofron të varfërve. Fjala ishte, na jepni kurbanat për Medresenë, tepëricën do t'ua japim të varfërve që ta kenë edhe ata plot sofrën e Bajramit të Kurbanit. Kush e fsheh këtë mish dhe e nxjerr nga “sirtari” atëherë kur t'i duhet pak popullaritet? Vetëm shejtanit dhe, natyrisht, Shaqir Fetait./1KlikLarg/31.03.2022

Ku na shpie shtegu i gjurmëve të injorantëve, manipulantëve, intrigantëve...

Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI

A keni parë Shaqir Fetain, instalacionin politik maqedonas në krye të BFI-së, se si nëpër evente fetare merr pjesë me bashkëveprimtarët e tij, të cilët i përshëndet me pietet dhe i garanton pjesëmarrësit se janë në rrugë të mbarë! Kush garanton? Njeriu i cili spiunoi, tradhëtoi dhe shkeli mbi dinjitein, mbi personalitetin e njeriut që në rrugëtimin e vet islam e kishte mbajtur Shaqir Fetain për dore si foshnjen që sapo ngritet nga zvarritja; garanton njeriu që e dëmtoi deri në palcë vakëfin e BFI-së, njeriu prej të cilit kurrnjëfarë hajri nuk pa Institucioni fetar i myslimanëve të vendit, njeriu i cili kurrë në jetën e vet nuk e zbardhi një të keqe që eventualisht e kishte kapur BFI-në! Me çfarë njerëz i rrethuar garanton ky farë mahluku që po dëshmohet katërcipërisht që nuk është hajri i BFI-së por që, ekskluzivisht e shfrytëzon BFI-në për interesa të veta meskine si dhe për interesa të atyreve që e instaluan dhunshëm në kolltukun e të parit të Institucionit.

Shaqir Fetai është vetë mesazhi i së keqes, prandaj, çdo mesazh që mundohet ta përçojë në opinion, në fakt është mesazh i zi i një njeriu që tërë jetën e ka jetuar duke thurrur intriga të cilat do t'ia siguronin “titullin” - ekspert i hipokrizisë dhe tradhëtisë.

A mund të jetë njeri i islamit ai që e vjedh diturinë, shkathtësinë, eksperiencën (siç ia vodhi Shaqir Fetai paraardhësit të vet); ai që e kontrabandon diturinë, që e blenë “pempelen e diturisë”? A mund

të jetë në rrugën islame njeriu (si Shaqir Fetai) i cili e promovon, e përruron dhe e bekon këtë “dituri të kontrabanduar”! Shaqir Fetai është i rrethuar përplotë me bashkëveprimtarë me “pempete” të falsifikuar! Ai e di fort mirë (sepse ka raportuar atje ku duhet!) se cili bashkëveprimtar i tij ka kryer medrese, cili nuk ka kryer, cili nga shkolla fillore direkt është pajisur me “diplomë fakulteti”; ai e di fort mirë se cili nga bashkëveprimtarët e vet ka të fallcifikuar diplomën, cili ka paguar diplomë, cili ka manipuluar njerëz të devotshëm se vjen nga një shtet ateist ku “çdo teolog me diplomë (pra jo i diplomuar) është “shpëtim për myslimanët ateistë”; Shaqir Fetai fort mirë e di se cilët bashkëveprimtarë të tij kanë blerë tituj “mr” e “dr”, e di fort mirë se kush është “specialistë” e kush “spec i mykur”! Shaqir Fetai “qeverisë” me këta bashkëveprimtarë të vet, sepse, pikërisht këta i duhen, sepse, i shantazhon, sepse, asnjë dijetar mysliman i devotshëm nuk do të pranonte për më të madhin kjamet që të bashëpunojë me Shaqir Fetain e pandershëm. Ky farë mahluku e di se, këta injorantë të falsifikuar dhe formalisht të konvertuar “në dijetarë” – vetëm këta që mund t’ia sigurojnë ndonjë përkrahje, sepse, janë të vetëdëshëm se, duke u sillur si miza e kalit rreth “orbitës” së vet, vetëm kështu mund të siurojnë jetëgjatësi “akademike”, ndërsa Shaqir Fetai me këtë “vetëdije absurde” të bashkëveprimtarëve të vet e siguron kolltukun që ia servirën qarqet antiislame e antishqiptare në vend e më gjërë (madje po del puna, deri në Rusi)!

Fatmirsisht, lista e teologëve “të diplomuar” nëpër “universitete” të ndryshme turko-arabe, është edhe nëpër duar të atyreve që së shpejti do t’i zbërthejnë një nga një! Janë siguruar prej çdo fakulteti se kush ka mbaruar fakultet, kush ka vazhduar me studime post-universitare dhe kush ka mbaruar, kush ka sjellë dokumente false, cilin e kanë toleruar pas një kolonë kamionash me gënjeshtër; kush sa ka paguar për t’ia shkruar temat e titujve “akademikë”; kush i ka plagjiaturë, kush i ka kompilacione etj.! Shumica absolute e këtyre matrapazëve të “diturisë” sot e rrethojnë Shaqir Fetain, ndërsa ky hiç se ka për dert kur i prezanton para xhematit duke i përshëndetur filan “mr” e filan “dr”, ndonëse i ka informatat për secilin se kush është dhe si ka arritur deri te titujt!

Me këtë gjest, në fakt, Shaqir Fetai tallet dhe e nënçmon islamin, sepse, “nëpunës” të vetë i merr njerëzit e falsifikuar ndërsa rrugëve

bredhin persona që kanë diplomuar, që kanë vazhduar studimet e larta, që kanë marrur tituj, e që janë krenaria e familjes dhe shoqërisë. Këta bredhin rrugëve sepse nuk pajtohen me injorancën, hipokrizinë dhe me intrigat e Shaqir Fetait. Ata nuk kanë investuar kaq shumë që një ditë të “drejtohen” prej injorantëve.

Natyrisht, edhe organet adekuate të shtetit e dinë saktësisht për secilin manipulant, injoran e blerës të diplomave dhe të titujve që vepron në BFI! Me këtë dobësi të tyre i shantazhojnë dhe, në këmbim të përkrahjes, ua kërkojnë “lojalitetin absolut”! Fundja, kujt do t’i interesonte fati i Bashkësisë Fetare Islame nëse nuk u intereson vetë myslimanëve. Nëse vetë myslimanët pajtohen që të përfaqësohen nga puçistët, intrigantët, spiunët, tradhëtarët, nga injorantët, nga “alimat” me diploma, tema e tituj të blerë, atëherë, le të vrapojnë se, në përqaftimin e Shaqir Fetai ka vend për gjithë sojin e tij! /Mileniumi3/01.04.2022

Kush po e tundon Shaqir Fetain

Këto ditë, Shaqir Fetai, ishtalacioni i dhunshëm i pushtetit maqedonas në krye të BFI-së, ndonëse fillimi i Muajit të Shenjtë të Ramazanit, sërish doli nëpër media me një potpuri rrenash, trillimesh dhe përpjekjesh për ta zhdukur një kontinuitet tridekadësh të BFI-së së pavarur! Është e habitshme përpjekja naive e këtij farë soji për ta fshirë një histori të tërë dhe për ta paraqitur BFI-në si institucion i këtyre dy viteve prej kur atij dikush i tha “çup” në kolltukun e pamerituar

Nga Idriz Fazliu

Shaqir Fetai tallet me Institucionin e BFI-së, me një lehtësi prej djalli nxjerr nga goja rrena të pakripta sa, këtë veprim nuk do të ishte në gjendje ta bënte asnjë mysliman i vendit. Shaqir Fetai flet sikur myslimanizmi në këtë vend të ketë filluar nga 27 maji i vitit 2020, sikur këtu nuk ekziston një histori përplot me vuajtje, me trishtime, me ngadhnjime, me suksese, me trimëri e me krenari përgjatë zhvillimit tridekadësh të BFI-së.

Shaqir Fetai thotë se, tashmë BFI-ja është e hapur, ka vënë bashkëpunim me botën turko-arabe, BFI ftohet nëpër konferenca, siç ishte ky i Egjiptit, se vizitohet prej personaliteteve të njohur në botën islame, vizitohet nga ambasadorë e nga shumë qytetarë! Ftohet si turist i thjeshtë për t'i vizituar muzetë dhe institucionet shkencore etj. Do me thënë që nga ardhja e Shaqir Fetait BFI po lulëzon! Po më parë ishte situatë katastrofale, ë? Kur përpara?! Kur përfaqësues organi ishte edhe Shaqir Fetai? A ka ndojë prononcim, ndonjë deklaratë, ndonjë fjali nëpër procesverbalet e

BFI-së kur Shaqir Fetai ka ngriur ndonjë shqetësim, kur ka kritikuar apo kur nuk është pajtuar me situatën e mjerë të BFI-së? Përkundrazi, ekziston deklarata e fundit e Shaqir Fetait, e thënë publikisht, një javë para se ta ndërmernte aktin e tradhëtisë për ta shkatërruar BFI-në! Kjo deklaratë e Shaqir Fetait thotë kështu: “Kryetarin e Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Reisul Ulemanë Haxhi Sulejman efendi Rexhepin, jo vetëm që e njoh më tepër se dy dekada e gjysëm, por edhe kam qenë bashkëpunëtor i gushtë i tij në funksione dhe pozicione të ndryshme në Bashkësinë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Vërtet Kryetari Sulejman efendi Rexhepi ka qenë, është dhe do të ngelë një figurë markante e zhvillimit të mendimit islam, edhe si ide por edhe në aspektin institucional. Ardhja e tij në krye të BFI vërtetë paraqiti një kthesë të madhe në historinë e myslimanëve dhe BFI-së këtu në këtë nënqiell. Mendimi i tij i pastër, i çiltër dhe reformues bëri që organizimi i myslimanëve në këtë nënqiell vërtet të jetë në nivelin e duhur konform kohës dhe rrjedhave të kohës në të cilën ka jetuar dhe vepruar me qëllim që islami të merr karakter të nivelit të lartë. Është një personalitet që qëllim kryesor e pati themelimin e institucioneve fetare arsimore, duke filluar nga Medreseja Isa Beu, pastaj degët e saj, por Kryetari i BFI-së, Sulejman efendi Rexhepi, dëshirë të madhe kishte që të hapë një institucion edhe më të lartë fetaro-shkencor, kështu që arriti të themelojë dhe të ndërtojë Fakultetin e Shkencave Islame, nga i cili institucion vërtet dalin kuadër të mirëfillta për shpjegimin dhe prezantimin e jetes fetare islame. Sulejman Rexhepi është një personalitet me karizëm të fuqishme fetaro-shkencore por edhe kombëtare. Më kujtohet në momentet e para kur, me ardhjen e tij, automatikisht dha urdhërin dhe vendimin që të gjithë institucionet fetaro arsimor, duke filluar nga administrata e BFI-së, të vendoset barazia gjuhësore e këtij Institucioni, kështu, që në momentet e para menjëherë dha urdhër që krejt mësimi të zhvillohet në gjuhën shqipe, të shkruhet administrativisht gjuha shqipe, duke dhënë hapësirë të fuqishme që edhe në institucionet fetaro-arsimore por edhe në BFI, edhe nacionalitetet e tjera që i takojnë fesë islame, ta gjejnë veten e vet, dinjitetin e tyre fetaro-kulturor dhe kombëtar”! Pra, në këtë deklaratë të Shaqirit të mjerë ka përplotë histori fetare e kombëtare, ka përplotë aktivitete gjigante që kanë rezultuar me famë të hatashme të BFI-së, ka përplotë ngjarje sa, Shaqir Fetai

është tepër shumë i vogël, shumëfish i pafuqishëm, i patalentuar, për t'i zhbërë të gjitha ato dhe për të filluar nga e para, nga 27 maji i vitit 2020, momenti që në fakt shënon tradhëtinë dhe komplotit më të turpshëm që ndonjëherë një musliman ia ka bërë tjetrit në këtë nënqiell, siç ia bëri Shaqir Fetai tërë BFI-së.

Ky aktivitet i Shaqir Fetait pa dyshim që është mision me të cilin ai është ngarkuar, ndaj dhe, për të dalur i suksesshëm duhet të gënjejë, duhet të sajtojë, duhet të jetë me fytyrë pesëhektarësh, duhet mos t'i dridhet qerpiku nga frika prej Allahut Fuqiptotë, duhet të jetë hipokrit e zemërzi!

Shaqir Fetai e di fort mirë se nuk është ashtu siç përpigjet ta nxjerrë veten si nismëtarë i BFI-së, sepse për këto tri dekada nga pavarësimi i BFI-së prej “bashkësive” komuniste, ky Institucion është ftuar dhe ka prezantuar aktivisht në:

- 192 konferenca kombëtare e ndërkombëtare të organizuara anekënd botës
- e përfshirë në dhjetra e dhjetra organizata islame në të cilat, nuk ka qenë vetëm anëtarë e rëndomtë por, ka pasur edhe pozita drejtuese në kierarkinë e këtyre organizatave.

Po a mundet me aq lehtësi të mohohet angazhimi i natëeditshëm i BFI-së në sensibilizimin e organizatave islame, institucioneve shtetërore të botës muslimane për çështjen shqiptare në viset etnike! Urrejtja e Shaqir Fetait kundër H. Sulejman ef. Rexhepit, në fakt është urrejtje kundër veprimtarisë së tij të bujshme kombëtare e fetare, kundër angazhimit të efendi Rexhepit për t'ia siguruar BFI-së fanaret e ndriçimit në faqet e historisë kombëtare! Kjo i pengon Shaqir Fetait, ndaj dhe nuk lejon askë që para tij madje as ta përmendë emrin e Sulejman Rexhepit! Historia nuk bazohet në thashetheme të Shaqir Fetait, Qenan Ismailit apo Salim Sulejmanit, por, në veprat madhore kombëtare e fetare të Sulejman Rexhepit!

Po a mundet që me aq lehtësi të harrohen përfshirja në delegacion të BFI-së edhe i përfaqësuesve të subjekteve politike shqiptare me qëllim për të vënë kontakte me faktorë të rëndësishëm nga bota turko-arabe!

Po a mundet me aq lehtësi ta shlyej Shaqir Fetai vizitën e burrështetasve, siç ishte Turgut Ozal, Sulejman Demireli, të cilët qëndruan në BFI jo vetëm se iu kujtua atyre! Si mund të bëhen

përpjekje për t'i fshirë kohërat kur BFI thjesht ishte shndërruar në një "zyre shtetërore" alternative ku personalitete të kombit, që po drejtonin Kosovën, takoheshin me burrshtetas e me personalitete të ndryshme (Fehmi Agani dhe Ali Aliu me Turgut Ozal)!

Lidhjet e BFI-së me botën perëndimore nuk mund t'i mohojë askush. Falë bashkëpunimit me organizma botërorë në BFI qëndroi edhe Tadeush Mazovjetski, Raportuesi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut pranë OKB-së si dhe luftëtar i denjë për të vërtetën e luftës së Bosnjë-Hercegovinës!

Për këto tri dekada, selia e Rijastit të BFI-së u vizitua 410 herë prej të gjithë ambasadorëve dhe diplomatëve në vend.

Pra, siç u nënvizua më sipër, BFI-ja ishte e ftuara permanente në kongrese të ndryshme, si:

- Konferenca ndërkombëtare në Mekke, organizuar nga Liga Botërore Islame me temë "Uniteti i muslimanëve – rreziku i fraktionimeve të ndryshme dhe ndarësitë";
- Konferenca ndërkombëtare në New York, nën organizimin e Rabita Alemu Islami me moton "Vijëmësia e lidhjeve midis SHBA-ve dhe Botës Islame";
- Konferenca ndërkombëtare mbi diversitetin në Egjipt, organizuar nga Ez'heri Sherifi me temë: Temë boshte ishte "Liria, atdhetaria, diversiteti dhe integritet";
- Takimi i Shurës Islame të Shteteve Euro-Aziatike Tetore, Stamboll;
- Samiti Rajonal për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, Tiranë;
- Konferencë shkencore organizuar nga Universiteti Shtetëror i Tetovës me temë: "Religjioni dhe dhuna";
- Takimi i Shuras Euro-Aziatike, Bruksel-Belgjikë;
- Konferencë ndërkombëtare me temë:
 - Konfrontimi i ekstremizmit dhe terrorizmit", Kajro;
 - Konferenca Muslimane në Sofja;
 - Takimi i Liderëve Myslimanë të Ballkanit, Shkup;
 - Konferenca e Këshillit të Lartë për Çështje Islame, Kajro;
 - Konferenca botërore për dialog ndërfetar dhe ndërcivilizues, Ohër;
 - Kongresi botëror Islam;
 - Takimi i Shurës Islame të Shteteve Euro-Aziatike, Stamboll;
 - Kongresi për çështje islame, Kajro;

- Konferenca Botërore Islame për Dialog, Mekë;
- Kongresi ndërkombëtar i intelektualëve myslimanë organizuar nga Universiteti "Al el Bejt", Jordan;
- Kongresi i muslimaneve të Evropës, Basel;
- Konferenca ndërkombëtare për Ballkanin, Stamboll;
- Konferenca e Kuvendit të përgjithshëm për çështje islamike, Aleksandri, Egjipt;
- Dejtuesi historik dhe i papërsëritshëm i BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi, falë menaxhimit brilant dhe faktorizimit të papërsëritshëm të BFI-së, u përfshi nëpër organizma botërorë islam edhe atë në cilësi të:
 - anëtarë i rregullt i Kuvendit të lartë për çështje islame me seli në Kajro;
 - anëtarë i rregullt i Kongresit botëror Islam me seli në Tripoli;
 - anëtar i rregullt i Unionit Islamik për Evropën;
 - zëvendës i sekretarit gjeneral të Kuvendit të këshillit për Evropën Lindore me seli në Stamboll;
 - anëtar i forumit të shkencëtarëve Islam me seli në Rabat;
 - themelues dhe zëvendës Kryetar i Shurës Euro Aziatike me seli në Ankara.
 - anëtar i Këshillit Botues të Kolanës "Zani i Naltë" (1923-1939)
- Gjithashtu, ai do të dallohet për një varg kontributesh të veçanta, nërsa këtu do t'i nënvizojmë ato që na kujtohen për momentin:
 - Zyrtarizon gjuhën shqipe në institucionin e Bashkësisë Fetare Islame në RM si dhe krahas flamurit mysliman ngre edhe flamurin shqiptar të valvitet në të gjitha institucionet e BFI;
 - Advokues i flaktë për sigurimin e bursave për mbi 140 studentë të shkencave të natyrës;
 - Themelues i Revistës Hana e Re, që botohet në tre gjuhë;
 - Themelues i O.H El Hialal (sot HILAL) – organizatë humanitare me synim të mbështetjes së shtresave të varfëra të shoqërisë;
 - Themelues i Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup dhe dekan i parë i kësaj vatre akademike;
 - Kontribut të veçantë në menaxhimin e krizës humanitare të shkaktuar nga refugjatët e Bosnjës;
 - Nënshkrues i Grupit nismëtar për themelimin e Univesitetit të Tetovës;
 - Iniciator për themelimin e këshillit koordinativ mes BI Shqipëri-Kosovë-Maqedoni;
 - Pritja e refugjatëve nga Kosova ku BIM përmes O.H El Hilal ishte

organizata më e zëshme deri në Kombet e Bashkuara;
 – Raportues i BBC në Londër në gjuhën Arabe rreth konfliktit në Maqedoni, promotor në botën arabe i luftës së drejtë të UÇK;
 – Themelimin e Medresesë së Vajzave në Tetovë;
 – Themelimin i Medresesë së djemve në Shtip;
 – Themelues i Medresesë së Vajzave në Shkup;
 – Themelues i Medresesë së Vajzave në Gostivar;
 – Organizator i simpoziumit me rastin e 100 vjetorit të shtetit shqiptar “Kontributi i ulemave në ngritjen e vetëdijes kombëtare“;
 – Ideator për themelimin e Agjencionit për Standardin Hallall;
 – Ideator i Projektit Stop RedTer, project inovator në parandalimin e terrorizmit dhe radikalizimit në Maqedoni;
 Ideator i Konferencës mbarëkombëtare “Medhhebi Hanefi, prioritetet dhe sfidat”, Shkup
 Ideator i themelimit të Mexhllisit për fetva në Maqedoni;
 Dhe, tani vogëlsia prej bubërreci të papërfillshëm e Shaqir Fetait ta mohojë tërë këtë histori të begatshme dhe të thotë se “tash e dy vjetë BFI-ja është e hapur dhe tashmë jemi edhe antare e Konferencës islamike me seli në Kajro”...
 Po pse Shaqir Fetai nuk futet më poshtë viteve të BFI-së dhe për ta përmendur emrin e njeriut që është meritori absolut (me lejen dhe me ndihmën e Allahut Fuqiptotë) për këtë histori kaq të bujshme të BFI-së? Sepse duhet do t'i duhet ta zë ngojë emrin H. Sulejman ef. Rexhepi! Po pse i druhet kësaj! Çfarë mëkati e çfarë krimi ka bërë ndaj këtij personaliteti kombëtar e fetar? Çfarë borxhi apo çka i ka bërë efendi Rexhepi këtij farë Shaqir Fetait që ky ta urrejë deri në mospërmendje të emrit, madje edhe në kërcënim të të gjithë atyre bashkëveprimtarëve të vet që e përshëndesin në rrugë apo me telefon H. Sulejman ef. Rexhepin!
 Shaqir Fetai është i kompleksuar, shpirtërisht është i vetëlënduar, i parahatshëm, e di që kurrë nuk do ta falin myslimanët e vendit, bashkëfshatarët e tij, familja e tij! Sepse ka bërë krim kundër atij që e ka rritur në prehër, si një foshnje të llastuar!
 Për dallim prej këtij skuthi, H. Sulejman ef. Rexhepi ka qenë gjallë i interesuar që të ndriçohen personalitetet e kaluara të jetës fetare, sidomos udhëheqësit e BFI-së. Ai, për shembull, ka kërkuar me ngulmë që të sigurohen sa më shumë dokumenta nga Arkivi shtetëror i Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Shqipërisë që flasin mbi veprimtarinë patriotike dhe fetare të ish-udhëheqësit të BFI-së, Hfz. Bedri ef. Hamidi, të ndriçohet personaliteti i tij dhe të

botohet libër! Po kaq krenar ka qenë edhe kur e kishte bashkpunëtorë të ngushtë ish-reisin H. Jakup ef. Selimovskin, ndonëse në situata të caktuara ishin “armiq” të përbetuar! Shaqir Fetai nuk guxon që ta kujtojë të kaluarën, jo më thellë se deri më 27 maj të vitit 2020, sepse, tmerrohet, sepse harron të marrë frymë nga fakti se është ngarkuar me mision për ta zhbërë tërë atë histori të lavdishme komëtare e fetare të BFI-së për tri dekadat e pavarësimit të saj.

Krejt në fund, Shaqir Fetai po paralajmëron nëpër intervista të kurdisura në mediat që i sponsoron se, sivjet, paska vendosur që të prezantojë në të gjitha xhamitë e të mbajë ligjerata mbi familjen e myslimanëve të Maqedonisë së Veriut, sepse paska konstatuar se, familja myslimane, respektivisht, familja shqiptare qenka fuqishëm në tatëpjetën e degjenerimit! Kush e ka porositur dhe kush e paguan Shaqir Fetain që të dalë me konstatime të tilla?! Familjet shqiptare sot në Maqedoninë e Veriut me “pesë” Medrese, me FSHI, me mbi 800 xhami, me mbi 1000-2000 “hoxhollarë” (kështu tallet Shaqir Fetai me termin “hoxhollarë”), me tri-katër universitete shqiptare, me një numër të madh intelektualësh dhe, megjithatë, sipas Shaqir Fetait, familja shqiptare qenka në degjenerim e sipër!

Po çka do t’ju thotë Shaqir Fetai atyre familjeve që i shkatërroi, që i theu në shpirtë! Që i la pa bukën e gojës duke sajuar “argumenta” në mënyrë policeske! Janë të shumtë, si në periudhën kur funksiononte si “ORAO”, si kur ishte këlysh i Temellko Boshkovskit, por edhe si “myfti” e “reis”!

Sa i përket vakëfit, nuk ka se çfarë të pallamudë duke na ofruar definicione mbi vakëfin, të na thotë se si qenka vlerë islame që nuk guxon të tjetërsohet e të shkatërrohet! Ndërsa nuk e thotë se vakëfin në mënyrë islamike e ka definuar edhe Kushtetuta e BFI-së! Nuk e pranon këtë akt normativ, sepse vetë është jashtëkushtetutar! Mos të na flasë për vakëfin e kthyer si pronë por, le të na thotë se çfarë i bëri vakëfit të kthyer si vlerë monetare! Ku i çoi ato para, a mos bleu vakëf tjetër apo i kullufiti në gushë, siç po i kullufitë edhe fitrin dhe zeqatin të cilin e kërkon si financim ekskluzivisht të Medreseve. Rrenë! Sepse, nuk besojmë që pushteti i jep rrogat e nëpunësve të BFI-së nga buxheti shtetëror, porse kjo jepet nga buxheti i krijuar prej fitrit, zeqatit dhe kontributeve të ndryshme të myslimanëve të vendit. Shaqir Fetai herdokur publikisht, para opinionit të gjërë, do t’i tregojë të gjitha

hajnitë, vjedhjet dhe zhvatjet që ia ka bërë vakëfit! Sepse te ky narrativ kanë ardhur të gjithë ata që kanë lejuar të joshen nga ofertat tunduese të djallit. Pse a mos i tha ndonjë MELAQE Shaqir Fetait që të tradhëtojë, të komplotojë, të gënjejë, të shkelë mbi parimet islame, ta shkatërrojë Bashkësinë Fetare Islame vetëm e vetëm që b... e tij ta shijojë kolltukun e të parit të BFI-së. Karriera e sëmurë nuk është asgjë tjetër përveçse tundim djalli!/Lajme7/05.04.2022

Bamirësia institucionale

Fatkeqësisht, sot Bashkësia Fetare Islame në RMV është pasqyra më e shëmtuar e veprimit “human”! A ka më trishtim për një institucion islam i cili kujtohet vetëm një herë në vit që të veprojë duke ia shtrirë dorën “humane” të varfërit dhe jetimit, ashtu siç na porositë i Madhi Zot

Nga Afrim Tahiri

Allahu mëshirëplotë e krijoi njeriun që të jetë në çdo sjellje të tij, në çdo gjykim e veprim – në mënyë të pandërperë të jetë bamirës. Njeriu duhet të jetë bamirës, nëse do që të duhet prej Krijuesit të vet, sepse është urdhër i Fuqiplotit “...do të silleni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët dhe të varfrit...” (El Bekare: 83); sepse është kërkesë e prerë e Krijuesit të çdo gjëje në Tokë e në Univers, “Bëhuni bamirës, sepse vërtet Allahu i do bamirësit.” (El Bekare: 195)!

Bamirësia, a është urdhëruar vetëm për njeriun apo edhe për institucionet që drejtohen prej njerëzve, sidomos për ato institucione që kanë marrur mbi vete misionin e zhvillimit të islamit si dhe të praktikimit të mësimave islame në raport me njeriun, krijesën më të dashur të Zotit Fuqiplotë! Çka flet e përditshmja jonë!

“Institucioni humanitar” i shpifur

A duhet që të shpërfaqemi si të devotshëm vetëm një muaj në vit?
A duhet t’i përkushtohemi lutjeve dhe ibadeteve vetëm një muaj në

vit? A duhet që të merremi me humanitet e bamirësi vetëm një muaj në vit – gjatë Muajit të Bekuar të Ramazanit? Njeriu mundohet të kryej ndonjë vepër bamirësie sipas mundësive që i ka. Por ai kërkon që të organizohet, të jetë më i motivuar, të jetë i cytur dhe gjithë jetës në aktivitete bamirësie. Pra, njeriu kërkon që në vepër bamirësie të drejtohet nga një institucion, asociacion, organ fetar islam, i cili, nuk do të jetë zbatues sezonal i porosisë së Allahut xh.sh. “...të silleni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët dhe të varfrit...” , sepse, kategoria e jetimëve dhe të varfërve nuk “mbijnë” vetëm për Ramazan, por ata bashkëjetojnë me ne në çdo sekond, përjetë!

Fatkeqësisht, sot Bashkësia Fetare Islame në RMV është pasqyra më e shëmtuar e veprimit “human”! A ka më trishtim për një institucion islam i cili kujtohet vetëm një herë në vit që të veprojë për ta përjetuar dashurinë e Allahut Mëshirëplotë (“Allahu i do bamirësit”)! Nënshkruhen marrëveshje me “produksione” të ndryshme humanitare të tipit “shporta e Ramazanit” apo, mezi presin të bëhen servis për shpërndarje të ndihmave të donuara një herë në vit, ekskluzivisht gjatë Ramazanit, për t’i përvetësuar meritat që sigurojnë emrin “institucion humanitar”! Pa dyshim, fitri dhe zeqati të cilin e japin myslimanët e vendit në BFI, është ndihmesë e pakompensueshme në zhvillimin e jetës fetare islame në vend si dhe për mirëmbajtjen e institucioneve arsimore të BFI-së? BFI-ja zhvillon edhe aksione të tjera fetare që gjenerojnë të ardhura dhe që kontribuojnë në buxhetin vjetor të këtij Institucioni! Janë kurbanët, lëkurat, është haxhi, të hyrat nga vakëfi, është anëtarësia, janë kontributet e ndryshme vullnetare të myslimanëve të vendit. BFI-ja si institucion serioz, kompetent dhe i nënshtruar të punojë vetëm sipas urdhërave të Zotit Fuqipotë duhet që, nga këto të hyra të hartojë buxhetin, të caktojë zërat e buxhetit dhe, teprica e të hollave t’i kthehet si bamirësi të varfërve, të pamundurëve, skamnorrëve, jetimëve dhe atyre që janë në nevojë!

BFI sot nuk e ka besimin e partnerëve si institucion humanitar

BFI-ja duhet të ketë objektet e veta dedikuar magazinimit të produkteve të ndryshme për bamirësi! Ky Institucion duhet të ketë magazet e veta dhe të jenë gjithnjë plotë. Duhet të ketë magazet e veta frigoriferike për ruajtjen e mishit dhe të produkteve që nuk i rezistojnë kohëve me diell e të ngrohta. Në këtë aspekt, duhet të ketë edhe fermat dhe fermerët e vet që do të përkujdesen për ruajtjen dhe rritjen e bagëtisë sipas Standardit Hallall.

Bashkësisë Islame nuk i duhet një “organizatë humanitare”-individ! Një “drejtor” që do të tallet me trembëdhjetë myftinj duke i përdorur si plaf që do t’ia mbulojnë matrapazllëqet e tij në emër të “bamirësisë islame”!

Aktivitetet humanitare duhet të drejtohen dhe të kryhen nga një organizatë gjigante, si në organizim ashtu edhe në staf. A mund të quhet “organizatë” një individ, i cili nuk ka as bord, as kuvend dhe kurrfarë organi të “organizatës humanitare” para të cilit do të raportonte mbi punën vjetore në bamirësi institucionale!

Fatkeqësisht, sot BFI-ja nuk ka fytyrë që të trokasë në dyert e biznesit, të fabrikave, të bujqëve, për të kërkuar produkte, donacione, për t’i maganizuar si rezervë me qëllim që të jetë çdo ditë dorë e zgjatur për të gjithë ata që janë në nevojë. Nuk ka strategji si të bëhet promotor i bamirësisë dhe të jetë çdo ditë të lume në shërbim të të varfërve dhe jetimëve, ashtu siç porositë Krijuesi Mëshirëplotë. BFI-së i duhet databazi i vet në të cilin do t’i kishte të evidentuar të gjitha partnerët, produktet rezervë, por edhe kategoritë e nevojtarëve për bamirësi, në tërë vendin, madje edhe jasht, duke synuar që të jetë qendër bamirësie që aktivitetin e vet e shtrinë përtej vendit, në rajon.

BFI-ja pa stoke rezervë të ndihmave humanitare si një trup pa shpirt

Një sektor për bamirësi pran BFI-së, do t’i mbikëqyrte punët e bamirësisë të organizatës humanitare por edhe të menaxhimit të ndihmave humanitare, me më së paku dy komisione, do të ishte një hap serioze i BFI-së në bamirësi. Komisionet kontaktuese, një për brenda dhe një për jasht, do të duhej të ishin me njerëz të

përzgjedhur dhe, pa dyshim, skajshmërisht të devotshëm, me personalitete plotë autoritet e integritet të pacënueshëm dhe të përlulur para secilit subjekt e person human në vend dhe jasht vendit. Puna e tyre e përditshme do të ishte mbajtja në kontakt e subjekteve që kanë mundësinë dhe vullnetin e donimit të produkteve të ndryshme, apo edhe të mjeteve financiare për humanitet të përditshëm. Natyrisht, mbushja e magazeve dhe shpërndarja e tyre në kohë e në vend, do të ishte e vështirë pa shtrirjen e një bashkëpunimi me çdo organizatë e me çdo grup të organizuar e të sinqertë që përpiqen të bëjnë aktivitete humane. Në Maqedoninë e Veriut janë me dhjetra shoqata e organizata humanitare, të cilat, me punën e tyre të sinqerë dhe me përkushtimin që kanë, ia dalin që të zhvillojnë shumëfish më tepër humanitet se sa krejt Institucioi i BFI-së! Kjo është skandaloze por, shumë e vërtetë!

Në rrafshin e humanitetit BFI duhet të veprojë gjithnjë me partnerë humanë

Bashkësia Fetare Islame këto organizata humanitare nuk duhet t'i shikojë si konkurrencë por si partnerë të denjë për shtrirjen e humanitetit. BFI-ja duhet të ketë vazhdimisht thirrje për projekte që konsistojnë në shpërndarje të ndihmave humanitare dhe, t'i furnizojë të gjitha organizatat humanitare dhe subjektet e ndryshëm të kësaj kategorie që veprojnë në vend dhe më gjërë. Është jo logjike që sot, një organizatë humanitare në vend, të ketë kapacitete humanitare, njerëz e ndihma dhjetëfish më shumë se sa vetë BFI-ja! Natyrisht, për të qenë problemi edhe më skandaloz, shoqatat e pavarura arrijnë të krijojnë besim, arrijnë të gjejnë partnerë si donatorë humanistë, arrijnë t'i gjejnë dyert hapur nëpër botën islame ndërsa BFI-ja, si institucion shekullor, të përvjelë mëngët për shpërndarje të ndihmave të donuara një herë në vit! Kjo, mbi të gjitha, flet se, Bashkësia Fetare Islame ka humbur besimin tek humanistët e botës islame, nuk kundrohet si organizatë serioze dhe se, raportet e dërguara nga vendi ynë tek ata flasin për keqpërdorime flagrante, për përvetësime, madje

edhe për shitje të ndihmave të donuara për shpërndarje përmes “organizatës humanitare” të BFI-së, flasin për keqpërdorimin dhe keqmenaxhimin në ç’gjë përfshihen madje edhe organe të BFI-së. Kjo do të jetë ajo reformë e domosdoshme, e thellë dhe gjithëpërfshirëse, së cilës, edhe në rrafshin e bamirësisë do t’i nënshtrohet Institucioni i BFI-së në një të ardhme shumë të afërt./TetovaSot/07.04.2022

Shaqir Fetai shkelës i vlerave tradicionale

Shaqir Fetai paska përjetuar (!!!) një iftar të këndshëm! Çfarë gurmazi, çfarë debilli, vdes për pak “respekt”! Tamam si udbashët e dikurshëm që marginalizohen në shoqërinë shqiptare dhe që vdesin për pak dashuri njerëzore

Nga Milaim Aliu

Kohëve të fundit, Shaqir Fetai, i trishtuar nga e kaluara e vet, seç i shpreh ca lutje që Zoti t’ia pranojë veprat (sidomos të këtyre dy viteve të fundit)! Pse lutet publikisht, ndërsa asnjherë nuk pendohet publikisht! Shaqir Fetai ka kryer një seri veprimesh të tmerrshme dhe akoma nuk u pendua publikisht, akoma nuk u pendua për hirë të Zotit dhe të kthehet në Rrugë të Zotit! Shaqir Fetai mendon se me këto lutje do ta “manipulojë” edhe Zotin, siç arriti t’i manipulojë disa bashkëveprimtarë të vet të njëjtit nivel shpirtëror, moral e hipokrizie dhe, pse jo, të falet! Vetëm i Madhi Zot e di, mbase edhe mund t’ia pranojë lutjet por ama, duke e ditur se “lutjet” pa pendesë janë hipokrizi, dyshojmë se do t’ia shërojnë shpirtin këto lutje! Nuk mundet me devotshmëri fallce që të krjohet imazhi pozitiv në opinion. Sepse, tashmë është krijuar opinion i realtë mbi Shaqir Fetain, si për një person jashtëzakonisht i ligë në historinë e BFI-së!

Dhe, në mesin e këtyre “lutjeve” Shaqir Fetai, e paska përjetuar, bre, një iftarë të këndshëm! Edhe një përpjekje e tij manipulative, e pistë! Iftarin e paskëshin shtruar dy djemtë e Haxhi Ganiut dhe nipërit e tij. Natyrisht, pasardhësit e shëndetshëm kështu veprojnë, për ta përkujtuar gjestin e babait, të gjyshit, altruistit më

të madh që kanë njohur ndonjëherë myslimanët e vendit!
Haxhi Ganiu ishte shok i ngushtë dhe i pandashëm i ish-reisul
ulemasë H. Sulejman ef. Rexhepit. Haxhi Ganiu çdo vit shtronte
iftar në shenjë respekti të ulemasë më në krye mikun e vet të
ngushtë, efendi Rexhepin! Kjo traditë nuk bën të ndalet, pa
dyshim. Duhet të vazhdojë me traditat e trashëguara nga
kryefamiljari. Por, shtrohet pyetja: pse në mesin e atyre
“personaliteteve” mungon edhe miku i ngushtë i Babait, H.
Sulejman ef. Rexhepi? Vetëm sa për t’ia lezetosur iftarin Shaqir
Fetai?

Shaqir Fetai e di fare mirë se Haxhi Ganiu ishte mik shtëpie i H.
Sulejman ef. Rexhepit! Shaqir Fetai e di fare mirë se sa herë që
është ftuar efendi Rexhepi në gostitë e Haxhi Ganiut, ai asnjëherë
nuk ka prezantuar në to pa i marrur me vete edhe
bashkëpunëtorët e vet, pra edhe Shaqir Fetain. Pra, Shaqir Fetai
ka hëngër iftarin e Haxhi Ganiut në kurriz të H. Sulejman ef.
Rexhepit dhe, këtë fakt e di tërë “bota teologjike” në Maqedoninë e
Veriut! Është shumë e kuptueshme nga ana e djemve të Haxhi
Ganiut që të shtrojnë iftar për ulemanë pa e pasur në mesin e tyre
edhe ish-reisin. Iftari nuk është tubim për pajtesë apo për
konfrontim edhe më të ashpër, iftari është dhe do të jetë respektim
i dëshirës së Kryefamiljarit, Haxhi Ganiut. Por, nuk është e
kuptueshme se si prezanton Shaqir Fetai me honxho-bonxhot e vet
në një darkë që shtrohet në emër të mikut të pandashëm të
Sulejman Rexhepit, të cilit mik Shaqir Fetai do t’ia ngulë thikën
pas shpine, me komplot të pistë do t’ia marrë pozitën duke e
“zhvleftësuar” deri në leckë! Pse a ishte për leckë miku i ngushtë i
Haxhi Ganiut, të cilit Shaqir Fetai ia ha bukën dhe përjeton (si
kafshë) një iftar të këndshëm?! Ia do gurmazi që t’ia hajë iftarin
rahmetliut, H. Ganiut, por nuk pranon që t’ia respektojë vullnetin,
pëcaktimin personal të Haxhi Ganiut për ta pasur mik të shtëpisë
Haxhi Sulejman ef. Rexhepin, të cilin vend kurrë nuk do të mund
ta arrinte Shaqir Fetai në të gjallë të Haxhi Ganiut!

Natën kur u shtrua iftari, Haxhi Ganiu mbase ka qarë nga
trishtimi, sepse, në krye të tavolinës ka parë “vrasësin” e shokët të
vet të jetës, ka parë hipokritin se si e ha (duke u përjargur) bukën
e shtruar nga dosti i përjetshëm i H. Sulejman ef. Rexhepit!
A e di Shaqir Fetai se çka do të thotë dost! A e di Shaqir Fetai se
nëse bie në hasmëri me një dost, është në hasmëri me familjen por
edhe me dostllarët e tij! Kjo është tradita shqiptare, ndërsa Shaqir

Fetai është dëshmuar si nëpërkëmbës i të gjitha vlerave tradicionale kombëtare. Prandaj nuk e ka të rëndë që të shkojë e të ulet në sofër të mikut të ngushtë të H. Sulejman ef. Rexhepit dhe të shitet si i pafajshëm, si i ndershëm! Apo dëshiron që t'i bëjë karshillëk Sulejman Rexhepit: t'i mora bashkëpunëtorët, po t'i marr edhe miqtë!

Vërtet, pse Shaqir Fetai nuk pranon asnjë përballje publike me atë të cilit ia nguli thikën pas shpine? Nuk pranon asnjë kafe, asnjë ndejë, asnjë takim qoftë dy-tre sekondëshe! Sepse, e ka frikën në shpirt: e di fare mirë se çfarë ka bërë dhe, ndonj përballje eventuale do të rezultonte me ndonjë shpullë të fuqishme sa përjetë do t'i fluturonte shalli i hoxhës me të cilën mundohet ta mbulojë trurin e fëlliqtë të një apostati të vlerave njerëzore, me theks të veçantë, të dostllëkut! / 1KlikLarg/08.04.2022

Mysliman në pesë ditë pune

Shaqir Fetai në të shumtën e rasteve bën lajm për vete apo për bashkësinë “fetare” të vet nisur edhe nga sukseset e të tjerëve; duke ua vjedhur sukseset, duke ua personalizuar sukseset e tyre por edhe duke u ndjerë i lumtur se u takua me një “të suksesshëm”! Kjo, sepse, vetë është jashtëzakonisht i pasuksesshëm, tepër i hutuar, tepër i humbur, tepër apatik, sepse, e vuan tërë atë që e bëri e që po i kushton shumë shtrenjt vetë BFI-së

Nga Majlinda Gashi

Si ndjekëse e faqeve zyrtare të institucioneve dhe personaliteteve fetare, gjithnjë e etur për të mësuar gjëra të reja, më ka bërë shumë përshtypje ndryshimi në faqen e Bashkësisë Fetare Islame që kur Shaqir Fetain, siç po flitet, e caktuan politikant antishqitare e antifetare që të drejtojë me të.

Për dallim nga koha e ish-reisit, kur faqja zyrtare e BFI-së përditësohej pesë-gjashtë herë në ditë, pastaj edhe gjatë natës, madje ditë për ditë, në këtë periudhë të Shaqir Fetait lajmet publikohen pas orarit të punës, sikur të fabrikohen diku dhe, çuditërisht, lajme kemi vetëm pesë ditët e punës gjatë javës. Do me thënë, Shaqir Fetai “merret” me aktivitete publike islame vetëm pesë ditë, pastaj dy ditët e javës shkyqet nga kjo dynja, nuk i intereson asgjë, mund të shkojë vetëm në ato aktivitete ku mund

të ketë drekë apo drakë, ndryshe, punë publike institucionale nuk ka!

Sa herë në javë Shaqir Fetai është mysliman? Vetëm pesë ditë në javë! Po dy ditët tjera, çka është! Nuk po dyshojmë që nuk është mysliman, por, që është një i ngratë, që është një amator i çelikosur, që është një njeri pa program e pa platformë, këtë tashmë e ka dëshmuar katëcipërisht. Shaqir Fetai i do dy ditë në javë pushim, i do pasivizim total të islamit, sepse ai është “zotni”, pesë ditë “mysliman” e dy ditë “shqiptar”!

Pra, pse ndodhë kjo? Sepse Shaqir Fetai nuk di si të zhvillohet jeta fetare islame në vend, nuk ka program, nuk ka të hartuar planin zhvillimor vjetor, të detajuar me të gjitha aktivitetet ditore, të nateditshëm. Në mungesë të këtij planifikimi, ai i lëshohet stihisë, çfarë të sjellë dita, nëse bën rahmet e vjen të na vizitojë dikush, e shënojmë “aktivitetin”, nëse na thërret dikush në darka e dreka, në racion “qevabpççi”, bëjmë aktivitet, ndryshe, çfarë të bëhet?

Shaqir Fetai, nëse ia keni përcjellë intervistën në RTVM2 thotë se, ja, që nesër do të nisim me aktivitete humanitare, me bamirësi, pra, që një ditë para Ramazanit. Nga ajo intervistë e deri më sot kaluan gati dhjetë ditë, brenda të cilave tetë janë me ramazan, me agjërime. Çka kanë shtruar këta myslimanë në sofrat e tyre! Atë pak mish që ua shpërndau në fillim, desh i mori më qafë. I mirë qëllon vetëm ai mish që e morën ga frigoriferi e drejt e në shtëpi ata (nëpunësit) që qenë më parë pakove me mish të kurbanit që duhej të shpërndahej qysh vitin e kaluar, sepse nijeti i myslimnëve ka qenë për vitin e vjetshëm kur kanë therrur kurban!

Shaqir Fetai, për më keq, e paralizon tërë BFI-në, sepse i ka dy ditë pushim! Nuk duhet të punojë as “rijaseti” i tij, nuk duhet të punojnë as organet, të gjithë duhet të flejnë e të pushojnë, ngjashëm si Shaqir Fetai, sepse, nga e hëna fillon një javë “përplot me aktivitete” të Shaqir Fetait! E cilat janë ato aktivitete? Shkon nëpër dua hatme, sepse shtrohet drekë e darkë, ka shumë mishë të mirë pas së cilit vdes Shaqir Fetai (flitet se është gurmazi më i madh që e ka BFI-ja)! Shkon në ndonjë dua hifzi, sepse edhe aty ka dreka e darka, shkon në ndonjë gurthemel, sepse edhe aty ka

ushqim ku mund ta rrasë kokën Shaqir Fetait dhe të mos ngopet, të ngelë i pangopshëm përherë, sepse, nëse ngopet nuk do të mund të hajë më! Shaqir Fetai fton ndonjë këngëtarë ilahishë dhe u jep mirënjohje, duke informuar se u takuam me një këngëtarë ilahishë të cilin gjeneratat e reja as që e njohin, sepse ai kurrë nuk ka bërë asgjë as për BFI-ne dhe as për myslimanët e vendit, kurse ky i jep “dekoracion” me motivacione idiotike.

Kurrë më e radikalizur nuk ka qenë BFI-ja se sa në këto kohë të Shaqir Fetait dhe, mahluku hesht, nuk brengoset, ndonëse natën duhet ta bëjë ditë duke u angazhuar për ruajtjen e traditave si në komb ashtu edhe në fe. Këto gjëra nuk i interesojnë Shaqir Fetait. Këtij i interesojnë vetëm dy ditë vikend kur do të ketë rast të karikohet me bateri, por me karikuesin e huaj, i interesojnë dy ditë kur mbushet me këshilla nga ata që e instalojnë dhe pa sygjerimet e të cilëve Shaqir Fetai do të ngjante në një cung të kalbur që e pengon lërimin e arës.

Dikur, ish-reisi thoshte se Maqedonia e Veriut ka më shumë se një milion myslimanë, se myslimanët janë më shumë në krahasim me ortodoksët! Sot Shaqir Fetait i dalin “zyrtarisht” vetë 34% apo rreth 600 mijë! Dhe, këtë dallim prej 400 mij myslimanë më pakë Shaqir Fetai e heshtë! Asnjë reagim, asnjë prononcim, asnjë qëndrim e debat mbi atë se çka u bë me këtë numër. Shaqir Fetait i takon që në asnjë mënyrë të pajtohet me rezultatet manipulative, duke ofruar masa alternative se si do ta arrijë numrin e saktë të myslimanëve të vendit, siç bëhej dikur dhe siç dihej gati “saktësisht”! Shaqir Fetai vepron vetëm ashtu siç do ta mësojnë gjatë dy ditëve të vikendit. Mjerë ne! / 1KlikLarg/09.04.2022

Keqpërdorimi i fitrit për “dashuri dhe respekt”

A mund të kontrabandohet fitri, kafshata e gojës së myslimanit të ngratë dhe ato të kalojnë në prioritete kafshërore të Qenanave e Shaqirave që të dëshmohen se sa “të respektuar” që janë?! Bukën ta hanë të gjithë, por kjo nuk do të thotë se kjo bukë ta siguron respektin dhe dashurinë e të gjithëve. Është vetëm një mashtrim optik që paguhet me paratë e fitrit dhe të zeqatit të myslimanëve të vendit

Nga Mr. Eset Shaqiri

“Gjëja më e vështirë është të përgatitesh moralisht dhe shpirtërisht. Dua të lexoj më shumë Kuran dhe të falem. Por, nuk mund të përqendrohem në lutjet e mia për shkak të tensionit. Sigurisht, ne gjejmë kohë për adhurim. Ka disa përjashtime në kohë lufte. Mund të luteni së bashku. Në këtë mënyrë, ne mund të përmbushim detyrat tona fetare”, shprehet në një media bootërore një motër myslimane nga fronti i luftës në Ukrainë!

Të kthehemi në lluksin e sotshëm jonjerëzor, jofetar e jologjik të bashkësisë “fetare” të Shaqir Fetait!

Jemi dëshmtarë të organizimit të iftareve gllamuroze, me shumë pompozitet, me shumë persona dhe me shumë fytyra që nuk kanë lidhje as me iftar, as me Ramazan, as me islam! A është organizimi i “iftareve” të tilla detyrë fetare? Kush i paguan ato iftare! Prej nga paratë “myftiu” i Gostivarit, Sabahudin Zendeli, dhe ai i Shkupit,

Qenan Ismaili, që në kohë krize, në kohën kur jemi çdo ditë të përbotur nga ai krim rus që po ndodhë në Ukrainë, ku po bien terror edhe myslimanët e këtij shteti, pra, në këtë kohë kur e tërë bota e civilizuar po solidarizohet me vuajtjet e këtij shteti, këta “myftinj” organizojnë “iftare” marramendëse! Pse? A vetëm që t’ia plotësojnë dëshirat e smura “liderit” të tyre, Shaqir Fetait, që ky të paraqitet si “person i dashur e i rrethuar” me dashamirë!

Natyrisht, askush nuk do të mund ta mohojë se kjo “dashuri” për Shaqir Fetain është me para, blihet me paratë e grumbulluara nga fitrat dhe zeqati i myslimanëve të vendit, të cilët i japin ekskluzivisht për mirëmbajtjen e Medresesë “Isa Beu”!

A mund të kontrabandohet fitri, kafshata e gojës së myslimanit të ngratë dhe ato të kalojnë në prioritete kafshërore të Qenanave e Shaqirave që të dëshimohen se sa “të respektuar” që janë?!

A u shkon në mend këtyre farë “myslimanëve me bateri” që, pak më tutje, janë disa motra e vëllezër që po agjërojnë e nuk po munden të hanë as iftar të zakonit e as syfyr për shkak të raketave dhe gjyleve që po hidhen mbi ta si mbi guralecë të papërfillshëm!

Ku e gjejnë atë të drejtë morale, atë leje fetare islame, atë njerëzillëk, që të organizojnë “iftare kolektive” dhe aq të shtrenjta!

Në krahasim me vitin e kaluar ky Ramazan na gjeti edhe me shtrenjtësi enorme, të cilët kanë prekur edhe menytë e restoranteve të zakonshme, duke i ngritur çmimet në stratosferë. T’i mbledhish sot 200-300 vetë në një iftar, kjo padyshim që kushton shumë! Në cilin zë të buxhetit bashkësia “fetare” e Shaqir Fetait ka paraparë shpenzime për iftare gllamuroze dhe, natyrisht, kush e mbulon këtë lluks të panevojshëm, këtë bidat dhe këtë idiotizëm?!

Janë paratë e myslimanëve të ngratë, të atyreve që nuk kanë arritur t’i gëzojnë fëmijët me ndonjë dhuratë për Bajram, ngase është dashur të paguajnë fitrin; janë paratë e myslimanëve të fituar me djersën e ballit dhe që e shton krenarinë dhe besimin e tyre teksa i paguajnë detyrimet fetare, janë paratë e të devotshmëve që japin kontributin e tyre pa u imponuar si të kamur, ndërsa, varfanjakët shpirtëror të bashkësisë “fetare” të

Shaqir Fetait i shpenzojnë sikur kartelët paratë e drogës!
Për çka gjithë ato iftare gllamuroze? Kujt i duhet iftari i Qenan Ismailit dhe i Qenanave të tjerë të Shaqir Fetait, të cilët me aq mospërfillje janë në gjendje që ta shpenzojnë fitrin e myslimanit!
Pse? Vetëm që ta “lartësojnë” “liderin” e pamoralshëm të tyre, Shaqir Fetain, në mesin e politikanëve dhe të strukturave të ndryshme shoqërore! Po cili është kontributi i këtyre strukturave politiko-shoqëror në raport me BFI-në, në raport me myslimanët e vendit, të cilët janë në gjendje t’i zhdukin nga faqa e dheut vetëm e vetëm që numri i tyre të zbresë në përqindjen e projektuar nga strukturat politike e që nuk duhet të jetë hiq më shumë se 34%?
Duke e njohur mentalitetin antifetar të honxho-bonxhove të Shaqir Fetait, edhe në vazhdim do të ketë “iftare” të këtilla, sepse, instikti i tyre (që nuk dallon nga ai i bishave të uritura) tregon se, ky është momenti ideal kur mund të “lartësohet” Shaqir Fetai dhe kur ai mund të paraqitet si i dashur dhe i respektuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë!
Bukën ta hanë të gjithë, por kjo nuk do të thotë se kjo bukë ta siguron respektin dhe dashurinë e të gjithëve. Është vetëm një mashtrim optik që paguhet me paratë e fitrit dhe të zeqatit të myslimanëve të vendit! Asnjë prej myslimanëve të Maqedonisë së Veriut nuk jep para për t’ju paguar iftar për shumicën e fytyrave që shihen nëpër “evente” të tilla kryekëput bidat!/Top24/11.04.2022

Kush t'i ndëshkojë “teologët” e fallcifikuar

Për studentët e Universitetit të Tetovës, sikundër për mbarë popullatën apo për çdo profil kombëtar, shumë herë më tepër duhet të jetë shqetësuese, trishtuese dhe e papranueshme të helmohen “fetarisht” nga hipokritët, tradhëtarët e spiunët e UDB-së, se sa të “qortohen”, “të bëhen për spital” e “të bullizohen” nga një profesioniste me vulën e vlerës kombëtare

Nga Shaban Aziri

Këto ditë mediat ranë në provim! Nuk patën respekt ndaj personalitetit, ndaj vlerave dhe profesionit të një artiste të kombit, profesoreshë Besiana Mehmeti. U ngritën një grup studentësh dhe, me arsyet e tyre kërkuan largimin e saj nga UT-ja, duke e akuzuar publikisht: e pasjellshme, arrogante, bullizuese dhe pa kritere në notim! Kësaj kërkese mediat iu bashkangjitën duke insistuar që me çdo kush të devalvohet, të kompromitohet dhe të njolloset një aset kombëtar nga sfera e artit muzikor. Më në fund, të frikësuar nga tallasi i protestave studentore, edhe struktura e lartë universitare u pajtua t'ua plotësojë kërkesën studentëve dhe të marrin masa ndaj profesoreshës së nderuar! Me këtë u dëshmuar se këta struktura nuk e paskan njohur karakterin e kësaj zonje, nuk e paskan njohur shpirtin, edukatën, kulturën dhe personalitetin e Besiana Mehmetit. U desht që ta zbulujnë një grup

studentësh që menjëhere të aktivizohen masat ndëshkuese kundër kësaj profesoreshës!

Mediave të vendit tash e një kohë më të gjatë ju serviren fakte e dokumenta kundër personave me profil “teologjik” të cilët janë me shkollim të blerë, janë magjistra e doktorë pa përgatitje adekuate, me punime disertacioni të blerë, të falcifikuar, të kompiluar e me diploma fallco. Po qarkullojnë emrat e teologëve të diskutueshëm të cilët kanë fallcifikuar diploma si nëpër fakultete arabe po ashtu edhe nëpër ato të vendit e në rajon. Si është e mundur që këto skandale që po e dëmtojnë së tepërmi, si imazhin kombëtar po ashtu edhe atë teologjik-fetar, deri më sot nuk ngritën shqetësim asnjë redaksi si dhe asnjë strukturë e BFI-së dhe asnjë institucion shtetëror? Pse kur është në pyetje një vlerë kombëtare, si rasti i Besiana Mehmetit, miza bëhet buall, kurse kur janë në pyetje devalvimet e tmerrshme në rrafshin fetar, si “teologët” e fallcifikuar, rastet heshten, madje edhe ju jepet hapësirë që të dëshmohen si “vlera të paarritshme”!

Në të ashtëquajturin rijaset të Shaqir Fetait ka plotë të bullizuar, të shantazhuar e të kërcënuar me largim nga puna nëse përshëndeten apo ia bëjnë një “llajk” ish-reisul ulemasë H. Sulejman ef. Rexhepit, apo ish-sekretarit historik të BFI-së Afrim ef. Tahirit. Nga rijaseti i Shaqir Fetait nën vëzhgim si nën syrin e big bradhërit janë edhe nëpunësit e tjerë si dhe profesorët e institucioneve arsimore të cilët do të përballëshin me sanksionim largim nga puna nëse vetëm ua përmendin emrat personaliteteve fetare e kombëtare të përmendur më sipër. Nën këtë trysni janë edhe studentët dhe nxënësit e BFI-së.

Pse a nuk munden që të ngriten në protestë edhe këta kundër syrit çatall të big bradherit të bashkësisë “fetare” të Shaqir Fetait?

Natyrisht që munden por, rezultati paraprakisht dihet: organet shtetërore nuk do të pranoinin ndëshkrime ndaj kësaj strukture të turpshme e të mëkatshme që thirren dhe veprojnë në emër të feste. Pushtetit aktual i konvenon një llum i këtille “fetar”, ndërsa do t'i pengonte çdo vlerë e mirëfilltë kulturore kombëtare.

Për studentët e Universitetit të Tetovës, sikundër për çdo profil

kombëtar, shumë here më tepër duhet të jetë shqetësuese, trishtuese dhe e papranueshme të “helmohen” fetarish nga hipokritët, tradhëtarët e spiunët e UDB-së, se sa që “qortohen”, “të bëhen për spital” e “të bullizohen” nga një profesioniste me vulën e vlerës kombëtare. Kjo vlenë edhe për disa “personalitete” që iu bashkangjitën iniciativave të çuditshme për ta stigmatizuar një muzikologe, kuadër deficitar ndër ne!/BotaSot/14.04.2022

Kakofoni aktivitetesh të të paudhëve

Zoti mos e bëftë kurrë më që të përsëritet ky “organizim” totalisht i bajatshëm i “organeve” të kapura të bashkësisë “fetare” të Shaqir Fetait! Një grup puçistësh “avangardë” kishin kryer një mision të huaj antiislam duke premtuar se do të ketë një zhvillim të hovshëm të jetës islame në RMV! Ajo që po shohim po dëshmon për një dezorganizim fatal nga strukturat e paudha që po tallen me Institucionin e vetëm islam në këtë vend; po shohim një degradim dhe një dehumanizim lemeritës

Nga Lumnie Doko

Me gjasë Shaqir Fetai është shpallur “persona non grata” në territoret e disa myftinive ndaj dhe, mungesën e vet nëpër ato vende mundohet ta plotësojë me medresante të cilat, në vend se të pushojnë nëpër shtëpitë e veta dhe ta shijojnë maksimalisht agjërimin e Muajit Ramazan në gjirin familjar, po barten me furgona nga një cep në tjetrin, duke u përdorur si kamuflazhë e raporteve katastrofale të Shaqir Fetait me organet e BFI-së si dhe me teologët e gjërë të vendit!

Shaqir Fetai ka hetuar mungesën e respektit ndaj dhe e kërkon dhunshëm nga teologët e vendit, dhe, për ta kamufluar këtë mosrespektim të gjërë që po i shprehet nga qindra teologë të vendit, shpëtimin e gjenë në medresantë duke i detyruar në

organizim të koncerteve me ilahi e ashere! Madje, për t'ia dëshmuar se është tërësisht në aut, Myftinia e Tetovës këto ditë, po me nxënës nga Medresja, organizoi “manifestim qendror” për Muajin e Ramazanit! Në fakt, këta të bashkësisë “fetare” të Shaqir Fetait kishin informuar se në Tetovë u mbajt “Manifestimi qendror i muajt të Bekuar të Ramazanit”!!!

Muaji i Bekuar i Ramazanit është përsosshmërisht i organizuar nga Allahu Mëshirëplotë! Muaji i Bekuar i Ramazanit nuk merret “me organizim të manifestimeve qendrore”, porse, manifestimet e tilla organizohen në prag të Muajit të Ramazanit! Po kush merret me organizim të manifestimeve qendrore, nën patronatin e kujt organizohen manifestimet e tilla? Natyrisht, sipas traditës, sipas kuadrit logjik, manifestimet qendrore organizohen nga Institucioni dhe nën patronat të drejtuesit të Institucionit! Pasi kaloi një e treta e Muajit të Bekuar, dikujt iu kujua që ta organizojë “manifestimin qendror” në “vigjile” të këtij Muaji?! Dhe, pse jo “rijaseti” por Myftinia e Tetovës!

Më parë, medresantët caktoheshin si “ndihmës” imamësh dhe shpërndaheshin në tërë territorin e Maqedonisë së Veriut, si dhe anekënd botës ku jetonin dhe vepronin bashkëatdhetarët tanë. Muaji i Ramazanit ishte një mundësi ideale për praktikimin e medresantëve, për përfshirjen e tyre në aktivitete fetare publike! Ata, ose mbanin ligjerata, ose, ose falnin teravitë, pastaj shpërndaheshin nëpër familjet myslimane, vazhdonin ndejat, pyetjet, përgjigjet, debatet, diskutimet dhe, natyrisht, tërë ky aktivitet i përmbushte shpirtërisht xhematet tona, i bënte të ndjehen krenarë me nxënësit e kësaj vatre mësimore që do të jenë bartës të suksesshëm të jetës fetare islame në këtë vend! Çka po bëhet sot? A mos e ka shndërruar Shaqir Fetai me honxhobonxhot e vet Medresenë në një “shkollë muzikore” prej nga nxënësit me zërin e bukur duhet t'i argëtojnë shpirtërisht xhematet e vendit! Tërë jeta fetare është kapur dhe po drejtohet nga një grusht manipulantësh, diletantësh, të pandershëm, të pamoralshëm, sepse, vetëm këta mund t'ia ruajnë interesin dhe t'i shprehin besnikëri të plotë Shaqir Fetait, i cili, as gjumin nuk po e

bën rehat nga makthi që tash e disa kohë po e mundon, sepse po e ndjenë dhe po e përcepton tërë atë “urrejtje teologjike” që po manifestohet kundër tij!

Për të ikur nga kjo atmosferë, për të gjetur ndonjë gastronom të suksesshëm që do ta qeraste me ndonjë “pet qevabçi”, për t’u dehur me tavolina të begata me ushqim të llojllojshëm që është tjetërfarësh nga tavolina modeste e myslimanëve të vendit me ekonomi në prag të varfërisë, për të takuar ndonjë ambasador maqedonas e ndonjë afarist që për hirë të Zotit Fuqiplotë është në gjendje ta shkrijë edhe pasurinë, manipulatori Shaqir Fetai ikë në shtetet e Perëndimit! Me vete ka marrur edhe një çantë të madhe me “dekoracione” e mirënjohje, me të clat ai mundohet që ta kamuflojë ligësinë e tij, veset antiislame të tij, të shkuarën e trishtë të tij, “dekoracione” këto që mbase (?) do t’i përkthehen në fitra e zeqat!

Atmosfera dhe opinioni i krijuar tashmë në disfavor të tij, nuk i jep shpresë se financiarisht do t’ia dalë mirë në vend, ndaj ik që këtë boshllëk ta mbushë duke provuar përmes manipulimeve të tij në mesin e xhematit tonë në diasporë. Shaqir Fetai edhe në diasporë do të hasë në një problem të madh! Ata po i kërkojnë gjithnjë e më shumë sqarim mbi deklaratat e tij të tipit “BFI-ja ka organet e veta, institucionet veta në vend si dhe mbi 250 qendra në diasporë”!!! Epo cili është kontributi i BFI-së që të themelojë e të ketë “qendra” në diasporë? Si guxon Shaqir Fetai që ta minimizojë deri në mohim tërë atë angazhim, atë kontribut fizik e financiar dhe atë përpjekje të vëllëzërve tanë për të pasur një qendër të veten fetare, kulturore, sociale etj. Si po i organizuaka këto qendra bashkësia “fetare” e Shaqir Fetait nga “vatani” (dhe kur nuk ia tregoi emrin këtij “vatani” të vet)?!

Shaqir Fetai iku që të përjetojë pak atmosferë, të përjetojë angazhim popullor, pak “dashuri” nga bashkëvendasit e vet, sepse, këtu në Maqedoninë e Veriut po i mungon dukshëm, madje edhe trishtueshëm! Shaqir Fetai edhe mund të mbledhë ndonjë lekë dhe, me to pastaj, të vijë në Shkup dhe t’ju thotë bashkëveprimtarëve të vet se, ja kush është “baba”, ja kush ju

shpëton juve, sa të gjithë ju kam grumbulluar lekë vetëm unë!
Shaqir Fetai tashmë është dëshmuar si njeri i rrezikshëm, veç
kësaj, edhe si cinik, i ulët, nënçmues dhe me prirje për t'i ofenduar
të gjithë ata që nuk "ia puthin dorën"! Dhe, kujt? ORAO-s?! Këtij
udbashi të putinizuar me mision për ta përmbushur "premtimin
islam" që ia dha ish-deputetit rus të partisë së Putinit? Amaneti
duhet kryer! Nëse jo Komuna e Tetovës, vetë Shaqir Fetai do të
mbledhë para nga myslimanët e vendit dhe të diasporës dhe, ashtu
siç premtoi për ta kryer urdhërin që iu dha, do t'ia ngrisë
përmendoren e babait të Ramazan Ahmedovit, këtij aleati dhe
kasapi të Vladimir Putinit që po bënë kërدينë në Ukrainë ku po
vriten edhe vëllezërit dhe motrat myslimane madje, agjërueshëm,
duke qenë nën adhurim të të Madhit Zot!
Ky premtim kriminel e bën të mëkatshëm Shaqir Fetain, e bën të
kapur nga një "hije misterioze" ruse ndaj dhe, duhet pasur kujdes
sepse është shumë "altruist", fatmirësisht, lehtësisht i
lexueshëm! / 1KlikLarg / 14.04.2022

Karrieristi me bishtin e zënë

Dhembje të tmerrshme do të ndjejë macja kur i zihet bishti me derë! Përpëlitet tmerrshëm, hidhet sa anash sa përpjetë, lëshon një mjaullimë të trishtueshme dhe, sapo të hapet dera ik vrapthi dhe futet në një skutë prej nga nuk del derisa t'i zbutet dhembja. Situatë e trishtë kjo ë?! Pyeteni macen

Nga Mr. Abaz Islami

Kjo alegori zakonisht përdoret kur flitet për një karrierist të ngelur me dy këmbë në baltë! Pyeteni se si ndjehet Shaqir Fetai, i cili, nuk lë “magji” pa përdorur vetëm e vetëm që situatën e vet ta paraqesë “parajsë”! “Parajsë” me baltë dhe brenda baltës së pistë Shaqir Fetai i zhytur me dy këmbë!

Shaqir Fetai, ky instalacion i pushtetit maqedonas në krye të Bashkësisë Ftetare Islame në RMV, po e ndjenë se po i ikë situata prej duarve, sepse, po mbarojnë gënjshtat, po mbaron durimi, po zvetënohen premtimet boshe nga repertoari i djallit! Shaqir Fetai është shumë i vetëdëshëm se nuk është më ai zell i mëparshëm i punës, nuk është ai seriozitet dhe ai përkushtim në punë, nuk është ai respekt e ajo devotshmëri në punë (qoftë edhe prej frikës nga i pari)! Sot, “të parit” të BFI-së nuk ia çokë askush, nuk e bën hesap më...

Shaqir Fetai erdhi e u instalua nga qarqet antiislame duke premtuar se do ta bëj “fet”, se do t'i vërë gjërat në binare të duhur! Sot për sot, vetëm shkatërrimi, degradimi, deinstitutionalizimi dhe defetarizmi i këtij Institucioni janë vënë në binare, edhe atë sipas

projeksionit të Shaqir Fetait, ndihmuar nga qarqet tashmë të ditura antikombëtare e antifetare në vend dhe më gjërë.

Shaqir Fetai ishte vetëm një vegël e thjeshë në duart e një shërbimi sa për ta degjeneruar frymën kombëtare dhe fetare që e kishte BFI-ja nën drejtimin e ish-Reisit! Rrezik për planet e “të tjerëve” paraqiste vetëm efendi Rexhepi dhe jo stafi i tij që, deri në ditën e tradhëtisë, ishin lojalë të pakompromisë të kësaj “viktime” të djallëzive të Shaqir Fetait.

Kurrë nuk do të mund të pulsojë BFI sipas frymës “Shaqiriste” siç pulsonte me frymën e “sulizmit”! Shaqir Fetai kurrë nuk do të mund ta arrijë atë peshë, atë rëndësi dhe atë rol që e pati efendi Rexhepi dhe, BFI-ja kurrë nuk do të mund ta ketë atë filozofi veprimi, atë mentalitet e atë logjikë përkushtimi siç e pati në kohën e efendi Rexhepit.

Kjo është shumë pak e rëndësishme për Shaqir Fetain, sepse ai nuk e mëton këtë peshë, nuk e synon këtë rol, roli i tij ishte vetëm ta “vrasë” Sulejman ef. Rexhepin, dhe jo ta largoje frymën e tij nga BFI-ja, sepse, as për këtë nuk kishte këllqe dhe as që do të guxonte t’i futej kësaj aventure.

Këta, luajalistët e dikurshëm të ish-reisit, që iu bashkangjitën aventurës tradhëtuese të Shaqir Fetait, paraprakisht ishin të garantuar se nuk do të preken nga Shaqir Fetai, madje disa prej tyre edhe do të avancohen. Kushti i vetëm ishte që t’i bashkangjiteshin Shaqir Fetait i cili kishte mision dekombëtarizimin dhe defetarizimin e BFI-së në të mirë të partizimit të Institucionit.

Se ishte ky mision i vetëm i Shaqir Fetait dëshmon edhe vetë struktura përbërëse e “rijasetit” të tij! Asnjë masë ndaj bashkëpunëtorëve lojalistë të ish-Reisit, avancimi i tyre pa kurrfarë kriteri dhe shumë i turpshëm si dhe, përmes kësaj, ruajtja e “tradiës tradhëtuese” brenda BFI-së!

E tërë loja ishte: le të vazhdojnë “sulistët” në BFI, e rëndësishme është që ata të jenë në “hyqmin” e Shaqir Fetait, i cili mision e ka t’i shpiejë që të gjithë atje ku ishte vetë ai – në atë “jaz” që ujtë e dërgon në mulli të huaj!

Nga ana tjetër, edhe këta “pacova” të gjirizave të huaj e dinë fort mirë se Shaqir Fetai nuk mund të marrë frymë pa këtë strukturë fotosintezë të ngritur nga efendi Rexhepi! Pra, frymëdhënës që ia zgjatin jetën Shaqir Fetait janë pikërisht këta bashkëpunëtorë të ngushtë të dikurshmë të ish-Reisit, dhe kjo ia bën tepër shumë qejfin Shaqir Fetait! Të gjithë po shërbejnë vetëm si qefbërës të Shaqir Fetait, si pilulë që ndihmon jashtëqitjen gjatë kapsllëkut! Mund të jenë të pavetëdishëm për faktin që po ia zgjasin jetën Shaqir Fetait, ndaj dhe një ditë mund të mos përgjigjen për këtë veprim të pavetëdishëm dhe të pavullnetshëm në jetëgjatësinë e katastrofës që po godet BFI-në. Por, ata që do të dëshmohen se me vetëdije kanë qenë në shërbim të Shaqir Fetait, do të jenë historikish të fajësuar si shkatërrues të rolit të BFI-së që e pati në rrafshin fetar e kombëtar!

Me frymën e Sulejman ef. Rexhepit nuk mund të bëhet “desulizmi” i BFI-së! Me Shaqir Fetain i cili një jetë të tërë e ka kaluar si parazit në b... e Sulejman ef. Rexhepit, nuk mund të “shpëtohet BFI nga Sulejman Rexhepi”! Sulejman Rexhepi ka krijuar bazat e një BFI-je të fuqishme dhe stabile, me Shaqir Fetain BFI-ja jo që po ngelë pa kulm, por po ngelë edhe pa këtë bazë!

Ky është ai moment i maces kur dera ia zë bishtin! Shaqir Fetait i është zënë bishti me derë. Nuk ka koncept profesional për ta ruajtur dhe avancar peshën e një Institucioni, sepse, vizioni i tij është mbi baza të tradhëtisë kombëtare e fetare! Ai nuk erdhi për të mirë, ai erdhi për të keq, duke kryer krimin e pafalshëm “mbi babain e tij shpirtëror”!

Shaqir Fetai është reja e zezë dhe fatale që po rri pezull mbi kulmin e BFI-së! Dhe, kjo re me jone negative do të kërcënohet derisa të goditet nga një re tjetër me jone pozitive. Ky çast po afrohet! Kjo pamje shumë shpejt do të shihet! Horizonti i BFI-së duhet të kthejllohet, me patjetër! /TetovaSot/16.04.2022

Komplekset e tradhëtarit

Shaqir Fetai, vetëm i urryer nga xhematet e vendit, mund të ikë disa ditë radhazi e të gjejë "dashuri" gjetiu! I kapur ngusht deri në asfiksi nga realiteti vendor, nisat për një vizitë xhematave në diasporë, të cilat ai i shpjegon si "shumë vizita"! Vizita e parë, vizita e dytë, vizita e tretë... sepse dëshiron të krijojë përshtypje të rrejshme se, shumë shpesh është në Perëndim, po e ftojnë e po e kërkojnë gjithandej në botë. Kërkon fitra për të vizituar ambasadorë maqedonasë, lokale gastronomike dhe "qevabçilnici", sepse janë skuta ku realisht ndjenë kënaqësinë idiotime. Tipike kjo sjellje e spiunëve dhe e tradhëtarëve. Shaqir Fetai është në një vizitë private me ç'rast po prezanton në një, dy, tre xhemate-xhamishë ku po provokon respekt e dashuri të dhunshme. Ai tallet me xhematin mysliman, Shaqir Fetai provokon mu në mes të Muajit të Agjërimit, duke u thënë myslimanëve "keni çfarë të më bëni? Jam po ai që ju spiunoj, ju tradhëtoj dhe ju detyroj të më respektoni"! Myslimanët shqiptar kanë respekt të paluhatshëm ndaj institucionit hoxhë, dhe jo respekt ndaj turlifarë fytyre që gjendet nën çallmën e hoxhës. Këtë fakt Shaqir Fetai nuk dëshiron ta kuptojë sepse e ka edukatë profesionale të arritur nëpër zyret e UDB-së.

I numëron "vizitat" sikur raportimet spiuneske në zyren e UDB-së para oficerit serb, Stanko Dragoviçit, "raportimi i parë, raportimi i dytë, raportimi i tretë..."! Këtu po që ka shumë raportime spiuneske, me qindra, kurse për këtë Ramazan ka ndërmarre një vizitë nëpër xhemate-xhami të myslimanëve tanë në diasporë. Dhe, na paska prezantu edhe në mesin e një Xhamie të cilën e ofendon me vlerësime që di t'i bëjë vetëm një dubash. Shaqir Fetai jep këtë vlerësim tërësisht antifetar: "Imami i njohur nga

Kumanova H. Ibrahim ef. Sulejmani dhe Hafizi Ensar ef.
Fejzullahu ishin inspirimi dhe esenca e vlerave fetare të kësaj
Xhamie"!

Një "margaritar" të këtillë mund ta nxjerrë vetëm goja e një
udbashi që inspirohet nga tradhëtia dhe spiunimi e që esence e
vlerës së tij "fetare" është hipokrizia e pistë e
tij./Debat/17.04.2022

Letër publike: Qenan Ismaili dhe Shaqir Fetai na e dëbuan xhematin nga xhamitë

Edhe sivjet gati i kalova të gjitha xhamitë më të mëdha të Shkupit, të Tetovës, Gostivarit, Kumanovës, Dibrës, Strugës! Gjithandej e njëjta pamje që po më trishton. Nuk ka namaz ku nuk po më mbushen sytë me lotë nga një pamje e trishtueshme – NUK KA XHEMAT, XEMATI PO PAKËSOHET, XHEMATI NUK DO TË LIDHET PAS HOXHALLARËVE. Sa më ka marrë malli për islamin e gjyshit tim

Nga Shaqir Kamberi

Jam përtej moshës së mesme, me familje mirë të konsoliduar, me djem të mbarë, kushtet si asnjë më mirë dhe, kam kaluar një jetë të tërë duke punuar me nder e me djersë, duke falënderuar, mbi të gjitha, të Madhin Zot që më mundësoi një jetë solide. Dhe, ky falënderim nuk është shprehur vetëm si fjalë goje, por me një devotshmëri e me përkushtim të lartë në kryerjen e çdo detyre që e njoh si detyrë, si obligim, si parim islam.

Kam një traditë të cilën nuk do ta kisha ndërruar me asnjë traditë tjetër! Çdo Muaj të Ramazanit e pres me padurim, kërkoj vetëm atmosferë të lumtur e të devotshëm brenda familjes, nuk dua zënka, zë të ngritur apo mospajtime. Çdo gjë dua të shkojë në harmoni të përkryer, me lutje e me madhërim të Allahut Mëshirëplotë.

Veç kësaj, tash e njëzet vite praktikoj që, drekën, ikindinë dhe teravitë t'i falë nëpër xhami të ndryshme. Një muaj të tërë jam në

teren, famirësisht, tashmë falë edhe mirëkuptimit të djemve që më shoqërojnë në këtë “rrugëtim”!

Edhe sivjet gati i kalova të gjitha xhamitë më të mëdha të Shkupit, të Tetovës, Gostivarit, Kumanovës, madje para dy ditësh isha edhe në Dibër dhe Strugë! Gjithandej e njëjta pamje që po më trishton. Nuk ka namaz ku nuk po më mbushen sytë me lotë nga një pamje e trishtueshme – NUK KA XHEMAT, XEMATI PO PAKËSOHET, XHEMATI NUK DO TË LIDHET PAS HOXHALLARËVE!

Xhamitë e Shkupit kurrë në historinë e vet nuk kanë qenë kaq të pakta me xhemat. Dikur xhamitë pëlcisnin nga xhemati, të paktën për teravi, kurse sot, hej, merreni me mend, xhamitë Jahja Pasha, Isa Beu, Sulltan Murat...me dy-tre safe! Nuk po flas për ato xhami që i mbush me urdhër megalomani myftiu i dobët Qenan Ismaili sa për të bërë ndonjë fotografi e për t'i bërë qejf vetes se sa shumë xhemat që ka pasur! Islami nuk praktikohet me dhunë e me hatër, islami praktikohet vetëm me bindje, me shpirt dhe në situata të pastra. Aty ku ka llum e plehra nuk mund të biesh në sexhde! Trishtimi tjetër që po më zë është edhe mënyra e praktikimit të namazit, të cilin nuk ma ka falur si të rinjtë e sotit, as babë e gjysh, as stërgjysh e katragjysh. Po kaq trishtuese janë edhe pamjet e “imamlerëve”, të cilët, janë kilometra larg esencës së islamit dhe janë të kryqëzuar për forma që i ofrojnë në emër të islamit. Në ligjeratat e tyre ka hile, ka hipokrizi, madje kam dëgjuar “hoXHën” që i thotë dy-tre vetëve “e keni detyrë t'm'i bani nja 100 fotografi deri sa mbaj vaz”! “Hoxhallarët”, qofshin ata të drejtimit hanefij ose të ashtuquajturit selefij, vehabi... më shumë po pozojnë se sa po ligjërojnë! Mazalla që fillojnë me vazet pa u ardhur kamerat! Mbase faktet u duhen t'i dërgojnë në qendrën që i paguan, por, nuk e kam të qartë se cili është fitimi i Qenan Ismailit që na i ka ba tullusum xhamitë me lloj të sektarizuar, që ua ka falë sikur të ishin prona të babës së vet! Bile edhe kur organizon tribuna, xhematit tonë ua imponon ndonjë të atillë edhe nga jashtë vendit – thuaja se këtu po na mungojnë! Më ka marrë malli për një islam të gjyshit tim, për një ders si të tij për namaz si të tij, të trashëguar denbabaden! Xhemati më shumë po shpërndahe nëpër

objekte, nëpër shtëpi, nëpër sallone, ku po i falin familjarisht teravitë, duke e ruajtur atë formë të faljes që e kanë trashëguar nga të parët e tyre! Druaj që kjo pamje do të reflektohet edhe në tubimin e fitrit, sepse, sivjet shumë pak fitra do të paguhen nëpër xhami e për Medrese! Nuk është alamet aktiviteti t'i mbushish xhamitë me medresante, t'i shëtisish në këtë agjërim nga një cep i vendit e në cepin tjetër, të kërkoshë prej tyre që të pozojnë sa më masovikisht që të shihet "angazhimi i madh i myftinisë së Qenan Ismailit"! Kjo është tallje me këto vajza, unë nuk di a kanë ato baballarë, a kanë vëllezër, a kanë familje! Nuk po na intereson që të shohim a dinë të këndojnë ato apo jo! Mua personaisht dhe xhematit na intereson se si, për shembull, Qenan Ismaili do ta ndalojë këtë dallavere të ortodoksëve që të na e mbushin Shkupin me kryqa! Na intereson të dimë se cilat janë politikat e Qenan Ismailit për ta drejtuar jetën fetare në Kryeqytet dhe hiç nuk na intereson se a do t'i përgjigjet atij drejtori duke ia lëshu një kontigjent medresantesh "këngëtare"! Na intereson të dijmë se çfarë po bëhet me vakëfin, ku i harxhoi paratë e vakëfit që ia dhanë si letra në vlerë gjatë procesit të denacionalizimit të vakëfit! Na intereson të dijmë se çka u bë me "Ibni Pajkon", me ish-objektin e Myftinisë së Shkupit që ka degraduar deri në kolybe të bostanaxhinjëve! Na intereson të dijmë se cila është strategjia e tij për ta çuar përpara islamin burimor, atë që historikisht është kultivuar në këtë hapësirë e që sot po i thonë "islam tradicional" i myslimanëve të ktyre anëve! Kjo na intereson neve, xhematit të Shkupit, kurse kjo më së paku, madje fare nuk i intereson Qenan Ismailit!

Po ashtu, e njëjta fotografi e shkretë vërehet anekënd vendit, edhe nëpër xhamitë e mëdha të qendrave tona. Dy-tre safe xhemat! Çka është kjo ikje e myslimanëve nga xhamitë? Çka është ky dëshpërim, ky zhgënjim, kjo mosdëshirë për ta lakuar kokën nga xhamitë!

Ja, sapo lexova se si Shaqir Fetai, ky farë bilmezi, u shpreh fëlënderime xhematit të një xhamie në Zvicër të cilët e paskan nderuar dhe e paskan mbushur përplot xhaminë, pamje kjo që e

paska “fascinuar” Shaqir Fetain e “nderuar”! Ky është kryeidioti! Ky pis i nënçmon, i poshtron, tallet me ata myslimanë që janë përplot mallë e devotshmëri! Ata mbledhen në shumicë edhe kur nuk është Shaqir Fetai. Ata janë besimtarë të sinqertë e të mirë. Ata nuk shkojnë në xhami për hatër të Shaqir Fetait, këtij farë spiuni. Ata në xhami shkojnë se e ndjejnë detyrim islam, se e ndjejnë obligim të shenjtë për t’u falur e lutur e jo për t’u fotografuar me Shaqir Fetain. Ata shkojnë me shumicë nëpër xhami, ndonëse e dinë se ka edhe aty spiunë e tradhëtarë, por ata shkojnë për Allah!

Shaqir Fetai duhet mos të na flasë për “fascinimet” e veta që po i përjeton në diasporë si barkmadhi pas kapsllëkut! Shaqir Fetai duhet të na tregojë se çfarë po bëhet, pse xhamitë tona po zbrazen! Duhet të na thotë se a është i vetëdijshëm se që kur erdhi me dallavere në krye të BFI-së xhemati “po tjetërsohet”, nuk po do të përzihet me të pabesë e tradhëtarë. Shaqir Fetai dhe soji i tij mund të kenë xhemat porse, xhemati i tyre prej spiunëve, tradhëtarëve, munafikëve, hipokritëve, është minoritet, është shumë i vogël në krahasim me myslimanët e devotshëm të vendit. Këta për momentin janë në defansivë. Të shashtisur dhe, vetëm po kundrojnë se çfarë po bëjnë soji i Shaqirave dhe Qenanave por ama, nëse lëshohen në ofensivë atëherë Shaqirat e Qenanat vetëm në u futshin në birë të miut të gjerizit! Dhe, patjetër që do të lëshohen, shumë shpejt!

Para tre – katër vitesh në kohë teravishë ziheshin edhe rrugët kryesore të shumë lagjeve të Shkupit, ziheshin me xhemat e me makina, ziheshin trotuare, sepse, xhemati ishte në numër tepër të madh. O Zot, kurrë mos e përsërit këtë pamje që e kemi nëpër xhami në këtë Ramazan të sivjemë! Me t’u copëtu edhe shpirti nga trishtimi! E kjo si duket po e lumturon Qenan Ismailin, Shaqir Fetain dhe sojin e ndytë të këtyre dyve!/Vatra/19.04.2022

Shaqir Fetai i duhet Kishës Ortodokse Maqedonase

Ka disa ditë që është hedhur një “pilot provë”, edhe atë pikërisht në Muajin e Agjërimin, që edhe në një komunë maqedonase ku nuk lejohet ndërtimi i një xhamie të vogël të hidhet gurthemeli i një kryqi gjigant! Ky provokim i Kishës Ortodokse Maqedonase me gjasë është në pajtim me instalacionin e pushtetit maqedonas në krye të BFI-së, Shaqir Fetain, i cili, sipas të gjitha gjasave u lut që këtë hap mos ta ndërmarrin para se të ikte ai në Zvicër! Pse ky provokim pikërisht në Ramazan! Dikujt i duhet një destabilizim i madh ndëretnik e ndërretar, “dikujt” (qytetarët maqedonasë) që këto ditë është prononcuar në masë prej 67 për qind në favor të politikave nacistë ruse! Jo vetëm populli maqedonas po shpreh simpati të haptë për Rusinë por, edhe vetë Shaqir Fetai pret “deputetë” rusë madje duke u premtuar se aleatit dhe besnikut më të ngushtë të Putinit do t’i ngrisin përmendore diku nëpër parqet e Tetovës (po ama jo të Gostivarit!!!) Tani Shaqir Fetai po e shijon agjërimin “nën respektin” që po ia treguakan myslimanët e diasporës, ndërsa myslimanët e vendit i ka lënë në një pozitë tepër të disfavorshme dhe inferiore. Nuk e tha asnjë fjalë për statistikën e manipuluar në raport me popullatën myslimane të vendit! E mbylli gojën me shtatë palë dryrë, duke e miratuar tërë atë “planifikim” të qarqeve antishqiptare e antimyslimane. Flet e lavdërohet për një “harmoni ndërretare” për ç’gjë kontribut të jashtëzakonshëm paska dhënë Shaqir Fetai, kurse nuk sheh se (ose e sheh dhe e miraton!) në çdo hap të vendit po mbijnë kryqet ortodokse!

Çka i duhet kryqi gjigant prej 63 metrove maqedonasëve të

Draçevës, e cila është në gjysmën e rrugës që shpie nga qyteti për në dhjetra fshatra shqiptare e myslimane? Çka është kjo aventurë maqedonase për të ngritur lapidare në formë të kryqeve gjigante! Pse nuk ndërtojnë kisha por kryqe? A ta mbushim Maqedoninë edhe me gjysëm hënë!

Për herë të parë ndodhë që këtij provokimi shumë të rrezikshëm, i cili bëhet me sugjerim të atyre që planikojnë shtrije të mundshme të konfliktit nga Ukraina edhe në zonat e tjera, sidomos në Ballkan, askush nuk i kundërvihet, asnjë element mysliman i vendit! Heshtin partitë në pushtet por, mbi të gjitha, hesht “rijaseti”, hesht Shaqir Fetai që me puçin më të ndyrë në hisorinë e njerëzimit i ka dalur Instiucionit “për zot”!

Herave të tjera, në provokime të tilla, siç ndodhi në provokimin e fundit në Butel ku u përpoqën të ngrisin një kryq të po këtyre përmasave, u mblodh Rijaseti dhe po atë ditë reagoi duke tërhequr vërejtjen me sërë masash që nuk do të ishin në të mirë të koekzistencës ndërfaqetare e ndërretnike në vend. Kërkoi që protestës t’i bashkangjiten edhe subjektet politike në qeveri dhe, kështu ndodhi! Vendimet e Rijasetit janë vendime të prera me synime që të realizohen një për një! Reagimi privat e personal i një personi që thirret në emër të BFI-së është vetëm tallje me këtë Institucion! Shaqir Fetai, nëse nuk është i Kishës Ortodokse Maqedonase, deri më tani do të duhej ta kishte mbajtur mbledhjen e Rijasetit dhe të dalë me një pako qëndrimesh jo vetëm për opinionin e brendshëm por edhe për faktorët ndërkombëtarë në vend, duke tërhequr vërejtjen për pasoja evetnuale që mund të shkaktoheshin nga një provokim i tillë ortodoks.

Maqedonia nuk mund të rrezatojë ortodoksizëm nga çdo cep e nga çdo maje e lartë. Në Maqedoni askush nuk është kundër kishave, kundër Shtëpiave të Zotit, le të ndërtohen aty ku ka nevojë që të luten qytetarët, por ama, të ngriten simbole fetare ky po që është provokim i pastër, që është një skenar jasht të cilit, kësaj radhe, nuk duket që është edhe Shaqir Fetai. /Kombetare/20.04.2022

Dështimet e njëpasnjëshme të Shaqir Fetait

Fiks një vit më parë, pra më 22 prill të vitit 2021, Shaqir Fetai në Sarajevë nënshkroi memorandumimin “Shporta e Ramazanit”, me Drejtorin e Zyrës Rajonale të Ligës Botërore Islame (RABITA) në Bosnjë-Hercegovinë, Abdullah bin Rahmatullah Qari-n! Dhe, ku shkuan ato “shporta”? A i pa dikush? Ku i treti Shaqir Fetai, apo, edhe këta, që në fillim e hetuan se kanë të bëjnë me një manipulant dhe me një mediokër i cili vdes për të vjedhur merita të huaja

Nga Visar Ibraimi

Si pasojë e mostransparencës, si pasojë e keqpërdorimit dhe vjedhjes së ndihmave humanitare që tash e disa vite vijnë nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfit të Turqisë, sivjet ndryshoi “taktika e veprimit”! Gjithnjë ndihmat vinin dhe dorëzoheshin në BFI disa ditë para Muajit të Ramazanit. Vinin nga 5000 pako dhe “shpërdaheshin” gjatë ditëve të Ramazanit! Natyrisht, raportime mbi atë se si u shpërndanë dhe ku u shpërndanë nuk pati asnjëherë, ndërsa tek donatori turk vazhdimisht deponoheshin fakte e argumenta për keqpërdorim të ndihmave humanitare, madje edhe për shitje të artikujve të veçantë të nxjerrur nga pakot e donuara për ndihmë.

Ky matrapazllëk u vërejt fuqishëm edhe vitin e kaluar, prandaj, turqët “e ndëshkuan” bashkësinë “fetare” të Shaqir Fetait, nuk dorëzuan asgjë!

E vetmja bashkësi fetare islame në rajon ishte BFI-ja e cila nuk

arriti të kryej asnjë aksion humanitar. E vetmja BFI-ja e uzurpuar prej aletit të pushtetit maqedonas, Shaqir Fetait, nuk ka kurrfarë programi për humanizëm, nuk ka kurrfarë lëvizje për të realizuar ndonjë projekt vetanak humanitar, nuk ka kurrfarë aksioni për mbledhjen e ndihmave humanitare për të varfër! Iku dy e treta e Muajit të Ramazanit, ndërsa BFI-ja e nënshtruar nuk u kujtua në asnjë sekond për të varfërit e Maqedonisë së Veriut që janë mbi 46.300 që jetojnë në mjerim të paimagjineshëm!

Megjithatë, Vakëfi i Turqisë dhjetë ditë para përfundimit të Muajit të Mëshirës, pasi sanksionoi BFI-në duke e përjashtuar nga programi i vet për ndihma humanitare, vendosi që të solidarizohet me myslimanët e varfër të këtij vendi duke ofruar 4000 pako me ndihma humanitare, nga kontigjenti humanitar i shpërndarë nëpër shtete të ndryshme të botës. Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfit të Turqisë zgjodhi që edhe sivjet shpërndarës teknik të kësaj ndihme të jenë organet e BFI-së dhe, Shaqir Fetai, në vend se të zotohet se kësaj radhe nuk do të ketë manipulim, keqpërdorim dhe vjedhje të ndihmave të vëllezërve turq dedikuar bashkëqytetarëve tanë të varfërve, të skamur e në nevojë, ai u del zot ndihmave të huaja duke thënë se “BFI-ja filloi me etapën e dytë të ndarjes së ndihmave humanitare”.

Pra, duhet fuqishëm të nënvizohet fakti se, këto pako me arikuj ushqimorë e higjienik, nuk janë të Shaqir Fetait, nuk janë të “bashkësisë” së tij, nuk janë produkt i aksionit humanitar të inicuar prej tij, thjesht, janë ndihma humanitare nga Turqia, të cilat, në cilësinë e aktivistëve “humanitarë” do t’i shpërndajnë honxho-bonxhot e Shaqir Fetait. Kaq!

Fiks një vit më parë, pra më 22 prill të vitit 2021, Shaqir Fetai në Sarajevë nënshkroi memorandumimin “Shporta e Ramazanit”, me Drejtorin e Zyrës Rajonale të Ligës Botërore Islame (RABITA) në Bosnjë dhe Hercegovinë, Abdullah bin Rahmatullah Qari-n! Dhe, ku shkuan ato “shporta”? A i pa dikush? Ku i treti Shaqir Fetai, apo, edhe këta e hetuan që në fillim se kanë të bëjnë me një manipulant dhe me një mediokër i cili vdes për të vjedhur merita të huaja!

Shaqir Fetait nuk e ka dert humanitetin, nuk i intereson asnjë i varfër në Maqedoninë e Veriut, mjafton që të pallohet vetë, si i babzitur, me “qevabçiçi” dhe të tallet me kë të ketë përpara! Po si erdhën këto ndihma nga Turqia! Në mënyrë të befasishme? Nuk i priste Shaqir Fetai, apo e gjetën të papërgatitur! Cila është

logjika që “aksionin” ta nisë me bashkëhajnin e vet Qenan Ismailin, të cilin e mburrë deri në kupë të qiellit, ndërkohë që nuk ka mysliman në Shkup që nuk e njeh si prepotent dhe si shpirtzi në sy të të varfërve! Po të tjerët! Pse mos të fillojë aksioni në prani të të gjithë myftinjëve, të cilët, sot do të duhej të ishin të përgatitur, me mjetet e tyre transportuese, të ngarkonin pakot dhe nesër të shpërndaheshin njëherazi të gjitha, në çdo shtëpi të të varfërve! Pra, në shtëpi të të varfërve dhe jo të anëtarëve të myftinive dhe të “nëpunësve” të papërgjegjshëm! Pakot turke brenda vetes nuk përmbajnë një “iftar”, por, janë mbushur e planifikuar për tërë Ramazanin! Askujt, pra, as Shaqir Fetait nuk i lejohet që të tallet me ata që janë në nevoj, që t’u bëjë humanizëm duke ua dhën sot një pako, nesër një pako, pasnesër një pako dhe, kështu, të presin në radhë të varfërit kur t’u vie radha të marrin pakon e të pashpirtit, Shaqir Fetait!

Ja pra, sikur mos të ishte ky kontigjent ndihmash nga Vakëfi i Turqisë, cili do të ishte aktiviteti humanitar i Shaqir Fetait dhe i “bashkësisë” së tij! Jo ai “aktivitet” i shtrimit të iftareve të majme për turlifarë mahluku, por, për skamnorët! A ka fytyrë Shaqir Fetait që të kërkojë ndihma, të grumbullojë e të maganizojë artikuj qindra tonëshe, të jetë i gatshëm në çdo moment për të ndihmuar skamnorë, sidomos gjatë Muajit të Mëshirës – Ramazanit? A ka guxim Shaqir Fetait që ta dëshmojë “mirësinë” e vet! Jo, sepse nuk e ka!

Shaqir Fetait është antihumanisti më i madhë i këtij nënqielli, sepse, kështu është gatuar, kështu është formuar! Nuk mund të jeshë i sukseshëm në punët e UDB-së ndërsa të jeshë shpirtmirë! Spiunimi, marrja më qafë e njerëzve nuk shkon me humanitet!/In7/21.04.20022

“Iftaret” e ideologjizuara dhe të partizuara të Shaqir Fetait

Për hirë të delegacionit arab që e paska realizuar “Shportën e Ramazanit”, Shaqir Fetai paska shtruar iftar gllamuroz në të cilën paskan marrur pjesë shumë bashkëpunëtorë të tij si dhe shumë personalitete dhe përfaqësues të partisë që ia shpërblyen spiunimin profesional duke e katapultuar në një vend të pamerituar që e ka shpërfaqur tërësisht në palaço! Për 400 pako “dhuratë nga Mbreti”, Shaqir Fetai shtron iftar gllamuroz, kurse nuk shtroi iftar për Ambasadën Turke në Shkup e në Tiranë për 4000 pakot si dhe për 40 000 pakot e tjera turke të donuara si “Shporta e Rmazanit” për një dekadë me radhë

Nga Valbon Osmani

Dje u publikua një shkrim lidhur me pasivitetin total të bashkësisë “fetare” të Shaqir Fetait në aspekt të humanizmit. Në këtë drejtim, Shaqir Fetai është larg të qenurit mysliman i vërtetë! U kritikua edhe për një memorandum të nënshkruar në Ramazanin e vitit të kaluar në mes tij dhe “përfaqësuesve” të Arabisë Saudite! Meqë ky vend u përmend në aspekt të mospërmbushjes së detyrimit vëllazëror edhe ndaj myslimanëve të varfër në Maqedoninë e Veriut, sakaq ka reaguar ambasda e kësaj Mbretërie në Tiranë, e cila, me vërtetë do të vie në Maqedoninë e Veriut dhe, do ta realizojë premtimin e vitit të kaluar. Do t’ia dorëzojë Shaqir Fetait 450 pako me ndihma humanitare, të cilat Shaqir Fetai i përkthen si “dhurata

të Mbretit” për të varfërit tanë. Do me thënë, jo ndihmë humanitare por “dhuratë”, sepse ndihma dhe dhurata dallojnë si toka me qiellin!

Sido qoftë, faleminderit për këtë “dhuratë” dhe Mbretit të Arabisë Saudite iu bëft dritë në atë dynja! Po pse nuk ishte ndihmë por “dhuratë”?

Sepse, si ndihmë humanitare natyrisht që Mbretit nuk do t’i bënte aq nder “pompoziteti” që iu bë! Ndhimë bëhet pa propagandë! Kurse, në rastin e shpërndarjes së “dhuratave mbretërore” këtu po që lejohet propaganda, e cila, aq shumë i duhet Shaqir Fetait! Një ambasadë e tërë, një institucion shtetëror arab u vu në shërbim të propagandës së Shaqir Fetait!

Shaqir Fetai i ka punë si mos më keq! Shaqir Fetai po e ndjenë nën lëkurë bojkotin, nonshalancën dhe mos-honopsjen nga bashkëpunëtorët e tij të deridjeshëm! E ka zënë një panik i tmerrshëm. Po i dëgjon të gjitha bisedat, anekënd Maqedonisë së Veriu dhe, asnjë bisedë nuk është për “Shaqir Fetain e suksesshëm”, porse që të gjitha janë për një katandisje të tmerrshme të BFI-së që kur ajo u kap nga i papërmirësueshmi Shaqir Fetai!

Hala pa dalë nga objekti i Mdresesë ku u bë pranim-dorëzimi i 400 pakove nga “Shporta e Ramazanit”, ky aktivitet ishte shënuar në media të afërt me pushtetin arab, sepse “gazetari” ishte shoqërues i delegacionit arab! Por, fatkeqësisht, për skak të ngutisë profesionale, nuk ia doli gazetari që ta ilustronte aktivitetin siç e ilustroi Shaqir Fetai, me mbi 25 fotografi! I drejtonte pakot sikur të kishin qenë foto-modele, manikenë, sikur të ishin plaçka marketungu. Radhitje horizontale, si një “mur kinez” me pakot, prapavijë për fotografimin e Shaqir Fetait me delegacionin arab! Pastaj fotografi duke i ngritur përpyetë e duke ia dhënë të varfërit (nuk ishin më tepër se nja 3-4 persona). Me rëndësi të shënohet shpërndarja, ndërsa se ku do të përfundojnë të gjitha, këtë mund ta dijë vetëm Shaqir Fetai! Kulmi i idiotizmit të Shaqir Fetait, tallja e pashpirt e tij me ndihmat humanitare, me “dhuratat e Mbretit”,

ishte insistimi i tij që të radhiten në sipërfaqe më të madhe të parkut të Medresesë, ndërsa kjo pamje ta përkujtonte lokalitetin e “Varrezave franceze” në Kala të Shkupit!

Do me thënë, Shaqir Fetai kishte nevojë për propagandë e për reklamë dhe jo se kishte gatishmërti e mirësi për të bërë sa më parë aktivitet humanitar!

Shaqir Fetai në fb-un e vet shkruan edhe të tilla “margaritarë” që shpërthejnë vetëm nga një kokë pa mend: “Ambasadori i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë i nderuari Fejsal Gazi El Hifdhi ishte mysafirë i BFI-së së RMV-së të cilës ia kushtoi një ambijent të Iftarit në shenjë respekti ndaj të gjithë besimtarëve të BFI-së”! Ia paska kushtuar një ambient iftarit? Kjo fjali as në serbishten e Shaqir Fetait nuk ka kuptim! Po kush qenkan ata “besimtarë të BFI”! Po ata besimtarë që nuk e ndjejnë veten si besimtarë të “BFI-së” së Shaqir Fetait e që janë në masë më shumë se 90 për qind! Të jeshë sot besimtar i “BFI-së” së Shaqir Fetait, është më se turp i rëndë! Këtë e thonë, madje gjithnjë e më shumë, vetë hoxhallarët e vendit!

Dhe, për hirë të delegacionit arab që e paska realizuar këtë “Shportë të Ramazanit”, Shaqir Fetai paska shtruar iftar gllamuroz në të cilën paskan marrur pjesë shumë bashkëpunëtorë të Shaqir Fetait si dhe shumë personalitete dhe përfaqësues të parisë që ia shpërblyen spiunimin Shaqir Fetait duke e katapultuar në një vend të pamerituar që e ka shpërfaqur tërësisht në palaço!

Për 400 pako dhuratë nga Mbreti, Shaqir Fetai shtron iftar gllamuroz! Më shtrenjt ka kushtuar iftari se të gjitha pakot e “Shportës së Ramazanit”! Më i madh zarari se qari! Po pe Shaqir Fetai nuk shtroi iftar për Ambasadën Turke në Shkup e në Tiranë për 4000 pakot si dhe për 40 000 pakot e tjera turke të donuara si “Shporta e Rmazanit” për një dekadë me radhë! Pse kaq shumë reklamë e pompozitet nga Shaqir Fetai për “dhuratat arabe”, ndërsa heshtje nonshalante e tij për ndihmat humanitare turke! Madje, pas iftarit Shaqir Fetai e paska telefonuar ministrin e vakëfit të Aranbisë Saudite dhe e paska falënderuar personalisht!

A thua në çfarë gjuhe foli Shaqir Fetai? Ky farë anafabeti nuk e di arabishten, apo ndoshta Ministri arab e dinte serbishten e Shaqir Fetait!/Top24/23.04.2022

Shaqir Fetait duhet t'ia pëshurrin “autorizimet”!

“Hoxhallarë” të ndryshëm të Shaqir Fetait na kanë dalur në terren, në rolin e inkasantëve, ndërsa Shaqir Fetait thotë se do të jemi në mesin e xhemateve tona për t'ua shpjeguar sa më mirë islamin! Do me thënë, mos me qenë këta honxho-bonxhot e Shaqir Fetait, xhematet nëpër xhamitë tona, do të ngelin me interpretime të dobëta, të cunguara, të islamit

Nga Nermin Ahmeti

A i keni vërejtur komunikatat e injorantëve të bashkësisë “fetare” të Shaqir Fetait? Komunikatat që kanë të bëjnë me shëtitjet e kota të komisioneve që i formon aty për aty Shaqir Fetait dhe që i lëshon si inkasantë të fitrit nëpër dynjallëk! Asnjë komision nuk guxon ta hedhë hapin pa “autorizimin” e Shaqir Fetait!

Me të drejtë kritikohej Shaqir Fetait që për një vit a i kishte mbajtur dy-tre mbledhje të “rijasetit” të tij a jo! I zënur në kapsllëk nga këto kritika, sikur tha se e kishte mbajtur një në prag të Muajit të Ramazanit dhe ku kishte sjellë “konkluzë bazë”! U lavdërua nëpër media se kishte bërë një program e një “plan zhvëllimor” të aktiviteteve gjatë këtij Muaji të Bekuar. Natyrisht, “ekipi” i Shaqir Fetait i ka marrur detyrat dhe obligimet që duhet të kryen gjatë këtij Muaji dhe të gjithë duhet të jenë në “akcion”!

Pse atëherë “me autorizim të reisit”! Kë e tallë Shaqir Fetait? Si çka dëshiron të paraqitet Shaqir Fetait? Si u bëka që ekipi i hoxhallarëve të shkoj në Myftininë e Kumanovës “me autorizim të Shaqir Fetait”! Nëse nuk është ky “autorizim” asnjë hoxhë nuk

guxon të shkojë në Kumanovë, ë! Apo t'ju tregojë kumanovarëve se i do Shaqir Fetai ndaj dhe me autorizim dërgon ekipin e vet që ta bëjë fet Kumanovën! Ja, ja, sa shpirtmir na qenka “reisi” Shaqir Fetai, aq i mëshirshëm sa ka lëshuar dorën dhe vetëm jep autorizime! Madje edhe në diasporë hoxhallarët nga Maqedonia e Veriut prezantojnë dhe “shpjegojnë islam” me autorizim të Shaqir Fetait!!! Do me thënë, nuk vlejné vendimet e “rijasetit” të tij, nuk vlejné mbledhjet, nuk vlejné “konkuzat bazë”! Ato ishin formalisht, vetëm sa të aktrojmë para opinionit se kemi mbajtur mbledhje dhe se jemi dakortësuar që të jemi të gjithë në terren gjatë Ramazanit. Në terren hoxhallarët do të guxojné të dalin vetëm nëse e kanë “autorizimin” e Shaqir Fetait dhe, nëse nuk e kanë nuk guxojné të lëvizin! Do me thënë që xhamitë që na u “uzurpuan” nga persona të njohur për nga angazhimi sektashian e ideologjik e që po na i zbrazin xhamitë prej xhemateve, të gjitha këto janë me autorizime të Shaqir Fetait? Po pse a nuk bën që hoxhallarët t’ia pëshurrin krejt këto autorizime Shaqir Fetait, a! A nuk po shohin se ky farë pisi po tallet me ta!

Shaqir Fetai po tenton të shkruajë “histori”! Dhe, kjo histori, pas 30-40-50 viteve do të lexohet si kohë e një institucioni autokrat, me një diktaturë kur ka vendosur vetëm një individ, i cili ka pasur aq shumë fuqi sa, as zogjtë e malit nuk kanë guxuar të lëvizin nga një degë në tjetrën pa autorizimin e Shaqir Fetait, dhe se, në Maqedoni e në diasporë islam është bërë e shpjeguar vetëm me autorizim të këtij farë bilmezi!

Po si bëhet lëvizja e hoxhallarëve nëpër xhami e nëpër xhemate ekskluzivisht me “autorizim” të Shaqir Fetait. Hoxhallarë qenkan sjellë deri në atë derexhe sa, as këmbën mos të guxojné ta hedhin pa këtë “autorizim” të pëshurrtë? Hoxhallarët të zhvillojnë jetë fetare islame vetëm sipas diktatit të Shaqir Fetait?!

Shaqir Fetai e di që as 5 për qind e teologëve në Maqedoninë e Veriut nuk e bëjnë mall! Shaqir Fetai e di fare mirë se është karikaturë e gjallë prej “teologut” të dështuar! Shaqir Fetai e di fare mirë se ka uzurpuar një post me tradhëti e spiunllëk. Shaqir Fetai e di fare mirë se ai post nuk i ka aspak hije, prandaj, ai lë “gjurmë

me shkrim”: disiplinë autokrate, drejtim diktatorial, shpjegim të fesë vetëm me autorizim të Shaqir Fetait! Kështu do të lexohet kjo histori pas shumë kohësh. Do të habiten të gjithë dhe do të pyesin se a ka pasur hoxhallarë me personalitet, me autoritet dhe me guxim fetar, apo, që të gjithë kanë qenë të kurdisur dhe kanë vepruar nën hyqmin e Shaqir Fetait, vetëm me “autorizim” të tij! Këtë ëndërr të budallakaftë sa më parë duhet t’ia prishin Shaqir Fetait dhe t’ia tregojnë vendin që e ka, aty ku e ka pasur gjithmonë, te pragu i zyreve të Temellko Boshkovskave e të Stanko Dragoviqëve!

Ky këto gafa nuk i bën se është injorant apo se aq di, porse sepse është cinik, është tallës, e ka për shpirti që t’i vë në lojë teologët dhe t’i paraqesë lolo! Delegacioni i caktuar nga rijaseti po qëndron në Kërçovë, në Kumanovë, në Dibër, në Strugë, në Amerikë, në Zvicër, në Austri, me “autorizim” të Shaqir Fetait! Po ku vlenë autorizimi i tij? Kush e kërkon dhe ku është valid “autorizimi i Shaqir Fetait”? Vetëm në WC-të publike, askund tjetër! Por, siç u theksua, ai këtë e bën për llogari të veten, sepse, kështu dëshiron të lexohet në histori pas disa dekadave. Shaqir Fetai na ishte një “personalitet me integritet me respekt të lartë” dhe, pa autorizimet e tij asnjë hoxhë nuk e hidhte hapin nëpër xhami! Pra, xhamitë funksioninin vetëm në saje të “autorizimeve të Shaqir Fetait”! Vetëm medresantet mund të zhvillojnë aktivitete nëpër xhami pa “autorizimin e Shaqir Fetait”, sepse, ky edepsëz medresantet nuk i llogarit si pjesëtarë të komunitetit të teologëve. Teologët mund të prezantojnë vetëm me “autorizim të Shaqir Fetait”! O sa shumë poshtë u ka rënë vlera hoxhallarëve të Maqedonisë së Veriut. Një ditë edhe këta do të zemërohen si devetë që u zemëruan me pronarin e tyre duke i thënë: ”Po ti ç’pate që na e vure në krye të karavanit gomarin”!/Kombetare/24.04.2022

Vazet manipulative

Fatkeqësisht, “ligjërimi fetar” nga hoxhallarët po përdoret për të prekur emocionet, ndjeshmërinë e besimtarit, po e nënçmojnë intelegjencën e tij! Hoxhallarët ndër ne kanë nisur të bëjnë gara se kush do të qajë më shumë gjatë “ligjeratës fetare”, apo kush do të shkaktojë të qara në mesin e xhematit dhe, natyrisht, tërë kjo pamje, sy të përlotur e dridhje trupi nga emocionet, të fotografohet e të filmohet. Kjo për të vetmin qëllim që para “punëdhënësve misteriozë” të dëshmohet ndikimi i tyre në masë

Nga Afrim Tahiri

Ligjeratë do të thotë një fjalim shkencor, politik, ideologjik, fetar, që mbahet para një auditori! Ligjerata duhet të jetë e zgjedhur, mirë e përpunuar, mund të jetë përkujtuse por edhe aktuale; ligjerata nuk guxon të jetë e mërzitshme, e bajatshme, në vetëvete e përsëritshme, monotone; ligjeratat që prekin aktualitetin gjithmonë tërheqin vëmendjen e auditorit, e shtojnë përqëndrimin e tij, sepse sjellin informacione të reja, shprehin përpjekje, forma, mënyra shkencore e praktike si të tejkalohen problemet.

Një prej vendeve ku më së shumti mbahen ligjeratat është xhamia! Në gjuhën fetare ligjeratat quhen vazet! Ato, të ligjeruara gati njëkohësisht prej qindra teologëve, ndiqen nga mijëra e mijëra besimtarë! Është krijuar një traditë që ligjeratat fetare, vazet, të

jenë më të shpeshta, më të sistemuara e më të tipizuara sidomos gjatë Muajit të Ramazanit!

Po çka dëgjojnë xhematet tona gjatë ligjërimit të hoxhallarëve të ndryshëm! A ka Bashkësia Fetare Islame një udhëzues, një program vjetor, me tema e nëntema të caktuara që janë të domosdoshme të ligjërohen e që janë në të njëjtën korrelacion me nevojat e auditorit, por edhe me problemet bashkëkohore që kërkojnë mbarështrim!

Fatkeqësisht, “ligjërimi fetar” po përdoret për të prekur emocionet, ndjeshmërinë e besimtarit dhe nuk mëton për ta ngritur vetëdijen fetare e shkencore të tij, konform rrjedhave bashkëkohore.

Hoxhallarët ndër ne kanë nisur të bëjnë gara se kush do të qajë më shumë gjatë ligjeratës fetare, apo kush do të shkaktojë të qara në mesin e xhematit dhe, natyrisht, tërë kjo pamje, sy të përlotur e trup duke u dridhur nga emocionet e papërmbajtura, të fotografohet e të filmohet. Kjo për të vetmin qëllim që para “punëdhënësve misteriozë” të dëshmohet ndikimi i tyre në masë! Të shkaktuarit e përlotjes dhe të vajtimit por edhe të euforisë gjatë një ligjerate, ky po që është ndikim!

Hoxhallarët tanë po i “spiunojnë” famijet tona që mund të kenë probleme të ndryshme njerëzore! Nuk rregullohet mardhënia e vjehrrës me nusen, nëse ky problem ngritet në motiv ligjërimi në xhami! Kjo është përfolje e problemeve familjare që mund t’i ketë çdo kush! Ky tip i ligjeratës pa dyshim që është krejtësisht i kotë dhe pa kurrfarë rëndësie!

Dramatizimi i stisur i raporteve vjehërr-nuse, me një zë vajtues prej një aktori patetik, pa dyshim që do të prekë emocionalisht persona nga auditori që ndjek ligjeratë të tillë! Apo, një hoxhë e paska parë se si djali e paska rrahur nënën, tjetri e paska parë një nënë të dëbuar nga shtëpia, dhe, tani, këto probleme ngritet në nivel të ligjeratës edukative duke “e mësuar” xhematin se si nuk duhet të rihet nëna! A nuk është ky një idioizëm i llojit të vet i përdorur nga “hoxha” me qëllim që të shkaktojë përlotje që do të futen në kuadrin filmik! Është shumë interesante se si këto dukuri tepër të shëmtuara i vërejnë vetëm “hoxhallarët” dhe nuk i vëren

polici, punëtori social, familjarët, fqiu, fëmijët e tjerë të nënës etj. Hoxhallarët tanë kurrë nuk kanë qenë në Rusi e Ukrainë, kurrë nuk kanë lexuar një faqe mbi atë se si u formua Rusia si shtet, si u formua pastaj Bashkimi Sovjetik, kush janë ukrainezët, ndërsa, i japin vetes të drejtë ta lodhin xhematin duke ndarë “fetva”, se kush është në të drejtë në këtë luftë të tmerrshme, kush duhet të fitojë e kush duhet të pësojë, kush ka qenë me myslimanët e kush ka qenë kundër myslimanëve, kush është me shqiptarë e kush është kundër shqiptarëve. Në mënyrë të pashpjegueshme marin rolin e propagandës proruse, sepse me ta qenka një “tog çeçenësh myslimanë” pa e ditur fare se Ukraina ka qenë me qindra vite strehë dhe shtet edhe i nja katër mij shqiptarëve.

A keni dëgjuar ndonjë hoxhë deri më sot që ka mbajtur ligjeratë mbi problemet e dukshme që i ka në “prag të derës” së vet, mbi dezorganizimin total të Institucionit të Bashkësisë Fetare Islame? A keni dëgjuar ndonjë vaz nga “hoxhallarët” tanë lidhur me keqpërdorimin dhe vjedhjen e fitrit, të zeqatit, të anëtarësisë që ua bën “paria” e tyre? A ka folur deri më sot ndonjë hoxhë para xhematit mbi shkeljet e përditshme kushtetuese që i bën “paria” e tij? A ka ligjeruar dikush mbi formën, mënyrën dhe metodën e instalimit të “të parit” nga pushteti maqedonas në krye të BFI-së! A e dinë hoxhallarët tanë se vakëfi është lënë dhe që duhet të shtohet me qëllim të zhvillimit dhe avansimit të jetës fetare, e cila varet kryekëput nga angazhimi i hoxhallarëve, pra, a e dinë ata se vakëfi duhet të gjenerojë të ardhura për mirëmbajtje të objekteve fetare, për paga mujore dhe për kontribute pensiono-shëndetësor për vetë hoxhallarët! Së këndejmi, jemi dëshmitarë të dhjetra skandaleve rreth vakëfit, të abuzimeve me letra në vlerë, të keqpërdorimit të vakëfit për interesa meskine, por, jemi edhe dëshmitarë të hoxhallarëve që kurrë nuk i prekin këto çështje që i tangojnë vetë problemet jetësore të tyre! A ka folur deri më sot ndonjë hoxhë rreth “Ibni Pajkos”, “minieres” së vakëfit të Myftinisë së Shkupit; a ka folur ndonjë hoxhë për dallaveret që bëhen me subjektet e papërgjegjshme politike në dëm të vakëfit; a është dëgjuar ndonjëherë ndonjë hoxhë që ka shprehur brengë për

vakëfin që deri më vitin 2018 ishte seli e Myftinisë së Shkupit, si hoqi dorë Myftinia e Shkupit nga ajo seli me qëllim që të futet qiraxhi në BFI! Çka u bë me selinë, kujt iu fal, kujt iu la “vakëf”! Cili hoxhë ligjëroi mbi manipulimin e “parisë” me letrat në vlerë, formë e denacionalizimit të vakëfit! Çka po ndodhë me atë kompensim, ku po tretet kur dihet se ato, islamikisht duhet të harxhohen në blerje dhe zëvendësim të vakëfit të uzurpuar si “interes nacional e shtetëror”! A nuk po ruhet interesi i huaj në dëm të vakëfit, në dëm të jetës më dinjitoze të vetë hoxhallarëve! A nuk është kjo çështje që duhet të ngritet përmes ligjeratave të hoxhallarëve?! Asnjë ligjeratë e hoxhallarëve mbi “teologët e fallcifikuar”, mbi “kuadrin deficitar” që arrinë deri te titujt akademik duke blerë diploma e disertacione, ndërkohë që me dhjetra të tjerë bredhin rrugëve ndonëse kanë kryer nëpër universitete prestigjioze të botës arabe por edhe në Fakultetin tonë! Pa dyshim, të gjitha këto tema për ligjërime mund të jenë të “sanskionueshme”, sepse mund të jenë jashtë “programit ligjërues” të hartuar (!) nga BFI! Megjithatë, për çdo hoxhë do të duhej të ishin miliona herë më të rëndësishme, islamikisht më të qëndrueshme, se sa të merremi me problemet e nuses me vjehrrën, apo të imgjinojmë “ngjarje” të parapara nëpër skenare të huaja, ose edhe ta “ngrisim veten” në nivel akademik duke ligjëruar mbi problemet e Rusisë dhe Ukrainës.

Ta ruajmë dhe ta riparojmë gjithmonë Shtëpinë tonë dhe mos të na interesojë oborri i huaj! Përzgjedhja e temave për ligjërime me qëllim të ruajtjes dhe renovimit të Shtëpisë sonë, është përkushtim, është angazhim intelektual që shpreh me devotshmëri përkujdesin ndaj parimeve islame, është respekt ndaj auditorit që është shumë më në nivel se sa mendojnë “hoxhallarët” tanë!/Top24/24.04.2022

Të kapurit gjithnjë heshtin nënshtrueshëm

Edhe kah fundi i muajit janar të vitit 2016, strukturat udhëheqëse grueviste të Komunës së Butelit deshtën të provokojnë një konflikt ndërjetar duke vendosur që në rotullamen e Komunës të ngrisin kryq gjigant. Megjithatë, reagimi i BFI-së më në krye Reisul Ulemanë H. Sulejman ef. Rexhepi ishte aq i ashpër sa, po vinte në pikëpyetje ekzistimi i shtetit për një kryq! U zbrapsën nga ideja e mbrapsht dhe nuk u lejua përpjekja për dominim fetar në një komunë multikonfesionale. Sot asnjë fjalë nga BFI-ja e rrënuar trishtueshëm për provokimin me ngritjen e kryqit 63 metrësh në Draçevë! Të kapurit nga qarqet politike që kërkojnë vasalitet gjithmonë heshtin nënshtrueshëm.

Më poshtë po e sjellim reagimin e BFI-së së vitit 2016:

Komunikatë

Bashkësia Islame në Maqedoni me indinjatë po i përcjellë zhvillimet e fundit lidhur me iniciativën e ndërmarë për vendosjen e një kryqi grandioz në lagjen Butel të Shkupit. Thjeshtë, jemi të habitur nga papërgjegjësia e atyre që me aq lehtësi e kanë nisur këtë provokim të radhës i cili po i shqetëson tej mase besimtarët muslimanë në tërë vendin. Aq më tepër, po na habitë fakti se pushteti qendror dhe një pjesë e mediave janë tërësisht indiferentë ndaj këtij akti që prekë thellë në raportet ndërjetare në këto kohë të një paqartësie politike që ka kapluar vendin.

Me qëllim që të mënjanohet tensionimet e krijuara pa nevojë nga

ky provokim i dikujt që nuk e dëshiron të mirën e këtij vendi e që simbolet fetare po i keqpërdorë për të destabilizuar marrëdhëniet ndërjetare e ndërnacionale, po apelojmë që urgjentisht të shfuqizohet vendimi për vendosjen e kryqit në lagjen Butel. Po përkujtojmë se në komunën Butel, gadi gjysma e banorëve i takojnë besimit Islam kurse përbërja nacionale e tyre është e shumëllojshme. Nëse dikush ka pasur për qëllim që me ndërtimin e kryqit të “revanshohet” për vendosjen e shqiponjës në komunën e Cairit, po theksojmë se shqiponja është simbol kombëtar kurse kryqi është simbol fetar, andaj nuk paraqet “kundërpërgjegje” adekuate.

Bëjmë thirrje deri te të gjithë njerëzit qëllim mirë, te Qeveria e RM, organet komunale të Butelit dhe të qytetit të Shkupit, te partitë politike të të gjitha orientimeve dhe veçanërisht i drejtohem korit diplomatik në vend që të bëjnë përpjekje maksimale për të parandaluar eskalimin e pakënaqësisë që ka përfshirë besimtarët muslimanë të vendit.

Mbetemi me shpresë se zëri i arsyes të cilin po e ngrit Bashkësia Islame në Maqedoni, do depërtojë deri te faktorët që mund të parandalojnë zhvillimet e pa parashikueshme që mund të lindin. Ne edhe me këtë rast shprehim respektin për të gjitha fetë dhe për simbolet e tyre fetare por jemi të bindur se ato i kanë vendet e tyre të caktuara ku mund të vendosen.

Reisul Ulema i BFI në RM
H. Sulejam ef. Rexhepi

Shkup, 26.02.2016

/Lajme7/

Pse ike katër ditë më herët nga ç’kishe planifikuar qëndrimin në Zvicër?

LETËR E HAPUR SHAQIR FETAIT, “REISIT” TË INSTALUAR

Nga Endrit Limani

Jemi në përfundim të Muajit të shenjtë të Agjërit dhe mbetemi me shpresë që Zoti i Madhërisë t’i ketë pranuar lutjet e gjithë besimtarëve kudo që gjenden nëpër botë e sidomos i lutemi Madhërisë së Tij që bekimet e Tija t’i lëshojë mbi popullin shqiptarë kudo që jeton.

Ditë më parë, këtu në Zvicër, kishim një delegacion të Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut i udhëhequr nga “reis” i instaluar në krye të BFI nga qarqet politike të pushtetit maqedonas, Shaqir Fetai. Iu gëzuam ardhjes së këtyre vëllezërve nga Atdheu, me shpresë se do ta shuanim mallin me bisedat nga afër me këta vëllezër, në iftare të përbashkët duke biseduar për hallet e përbashkëta, për zhvillimin e jetës fetare këtu dhe atje në vendlindje. Isha njëri nga ata ata që mezi prisja ta takojë nga afër “reisin” e ri, të dëgjonim ndonjë sugjerim, udhëzim, apo të na tregojë për zhvillimet më të reja në Bashkësinë Fetare Islame pas ndryshimeve të fundit, të na tregojë për pritshmëritë e reja nga ky

institucion, të na tregojë për situatën në vendë lindje, sidomos rreth informacioneve në medime për vendosjen e kryqit gjiganë në hapësirën ku jetojnë edhe shqiptarët, me një fjalë të na tregojë diç të re, të mirë, që do t'na gëzonte në këtë periudhë pas korona virusit që na ndau nga vendë lindja.

Ky "resi" i ri, Shaqir Fetai, vizitoi edhe Xhaminë Mesxhidi-nur në Frauenfeld këtu në Zvicër, ku pata rastin të jem pjesëmarrës në lutjen e mbrëmjes dhe ndejën e zakonshme që organizohet përgjatë ramazanit pas lutjeve të mbrëmjes. Dhe, në vend që të dëgjojmë diçka të re, sidomos reth pikave të sipërpërmendura, mësuam diçka që nuk do të dishiroja ta dija kurrë. U zhgënjyem dhe më vie turp që kemi një udhëheqës të këtillë. Duke u nisur nga kjo, publikisht dua t'i shtroj vërejtjet dhe indinjatën time që i adresohet Shaqir Fetaut.

E para, ju Shaqir Fetai bashkë me delegacionin tëndë, në bazë të muhabetëve që dëgjuam nga ju, në Zvicër nuk kishit ardhur për t'na takuar si vëllezër, për të ndarë mes vete mendime e për t'na informuar për ndonjë iniciativë të re të Bashkësisë Fetare, natyrisht nëse ka, por doli në shesh se kishit ardhur më tepër në rolin e inkasantëve, vetëm për t'na kërkuar para (fitra dhe zekat) e asesi për t'na vizituar si vëllezër. Asnjë fjalë nuk e tha për ndonjë projekt, për ndonjë iniciativë, për fatin e nxënësve të Medresesë (djem dhe vajza) që po përjashtohen nga Fakultetet e shtetit me arsyetim se Medreseja nuk është e akredituar. Shaqir Fetai, paraja kërkohet vetëm atëherë kur njerëzve përballë ua tregon projektet, planet, aspiratat dhe idetë.

Shaqir Fetai, diaspora në mënyrë permanente dërgoi ndihma dhe para vendë lindjes dhe atë vetëm përmes jush duke ju konsideruar institucion i shenjtë dhe besnik, por gabuam dhe u mashtrua. U mashtruam kur diaspora zvicërane dërgoi ndihma në vlerë prej më shumë se njëqindmijë CHF për "lagjen e trimave" në Kumanovë që ndodhi më 9 dhe 10 maj të vitit 2015. Çfarë ndodhi pjesa dërmuese u vodhën nga ju dhe imami juaj Imran Ameti. Vallë a nuk ia keni borxh muslimanëve të diaporës t'ia jepni një shpjegim rreth fatit të këtyre parave. Së këndejmi, pse deri më sot Xhamisë

së Madhe në Winterthur nuk i dhatë kurrfarë sqarimi për paratë e vjedhura në vlerë prej 7.690 CHF dhe 50 euro nga dy referentët tuaj të Myftinisë së Kumanovës.

E dyta, ardhja yte Shaqir Fetai në Xhaminë Mesxhidi-nur në Frauenfeld nxori në shesh edhe mistere tjera që pa dyshim janë vepra të djallit. Ju e dini se në këtë xhami imam i deritanishëm ka qenë i nderuari hoxhë Sami ef. Misini nga Tetova. Ky teolog i nderuar ndër xhematin e Frauenfeldit njihet si veteran i palodhshëm, iniciatori kryesor në themelimin dhe ndërtimin e kësaj Qendre islamike. Gjithashtu, njihet me sjelljen e tij të butë, miqësinë e mirë me hoxhallarët tjerë këtu në diasporë, modestinë dhe thjeshtësinë. Shkuarja e tij në pension brenda pak ditëve dhe ardhja në vend të tij e imamatit të ri, Fejsal Fetai, ishte misterioze për xhematin e kësaj Qendre. Ndërkohë, është bërë e ditur se edhe vetë ish Imami nuk kishte njohuri të bollshme për ardhjen e imamatit të ri.

Shaqir Fetai, qëndrimi yt në mesin tonë nxori shumë mistere, pislleqe dhe idiotësi që po i bëni në dëm të diasporës shqiptare, pra përçarjes së saj, përmes formave të ndryshme. Lexo faktet në vijim: Imami i ri i instaluar, siç jeni ju instalacion i pushtetit, nuk qenka bërë përmes procedurave të rregullta, përmes konkursit, sepse konkursi as që është vendosur ndonjëherë në tabelën e informacioneve në objektin e xhamisë, dhe as nuk është publikuar në faqen zyrtare të BFI-së, por sipas informacioneve të sakta, emërimi Fejsal Fetait qenka vendosur në zyrën tënde në Shkup, bashkë me Ministrin e Ekonomisë Kreshnik Bekteshi (kuadër i BDI-së).

Shaqir Fetai, a nuk është turp për ju, deklarata që rrëshqiti nga goja e juaj: “ E arritëm një sukses, ia arritëm qëllimit, e larguam tetovarin, xhaminë e Frauenfeldit e mori Gostivari”. Turp për ty Shaqir Fetai. Ju ia arritët ta përçani xhematin e Frauenfeldit dhe e futët në lojë për interesa mesquine tuajat një djalë të ri, Fejsal Fetain, i cili rrugëtimin e tij të jetës si teolog do ta ketë me paqartësi dhe peripeci shkaku i juaj.

E treta, Shaqir Fetai, me që gjithandej kah sillesh e pështilles, jep mirënjohje gjithçfarë njeriut në emër të Bashkësisë Islame, të cilët as që ia dinë adresën institucionin fetarë, atëherë së paku karshi xhematit të Frauenfeldit, apo sa për sy e faqe, pse nuk i dhe mirënjohje Imamit të nderuar Sami Misinit për punën e tij 37 vjeçare në shërbim të fesë. Pse së paku gojarisht, karshi xhematit, nuk e falënderova, pse nuk ja përmende emrin, aha, vetëm pse qenka tetovarë sipas jush. Sjellje tipike kjo e juaja prej udbashi!

E katërta, Shaqir Fetai, në opinionin publik (portale dhe gazeta) po qakullon dosja yte prej UDB-ashi derisa paskëshit qenë student në Sarajevë e dalur nga oficeri Stanko Dragović. Ju me pseodonimin “Orao” rëndë i paskeni dëmtuar shokët e Fakultetit, sidomos Nexhat Ibrahimit nga Prizreni dhe Ramiz Alinë nga Tetova i cili si rezultat i spiunimit tëndë u përjashtua nga Fakulteti dhe mbeti pa shkollim. Ndërsa sa i përket Nexhat Ibrahimit dihen vuajtjet e tija nëpër burgjet e Jugosllavisë.

Shaqir Fetai ju kurr nuk u prononcuat për këtë dosje dhe as që e demantuat. Ju nuk e demantuat as dosjen që ua publikuan shërbimet sekrete maqedonase. Ju në bashkëpunim me shërbimet dhe policinë maqedonase i ngritët kurth Sulejman Rexhepit duke u thirrur në faktin siç thoni ju, “plaku matuf qenka martuar me një femër shumë më të re se ai”. Po të pyes, cila vepër është më e shëmtuar, më djallëzore, martesë sipas parimeve islame e “plakut”, apo veprimtaria yte prej UDB-ashi e cila ka bërë që shumë persona të dergjen nëpër burgje, shokët e tu të mbeten pa arsim e shumë zarare tjera që vetëm ti i di.

Na hetove Shaqir Fetai, tamam me atë mprehtësi prej udbashi na hetove, sepse ishim autorizuar një grup prej xhemateve të ndryshme, që kishim vendosur të të mbështesim për muri dhe të na i tregojë të gjitha djallëzitë e tua por, ja që na hetove dhe ike katër ditë më herët nga ç’kishit planifikuar të qëndronit në Zvicër!

E pesta, Shaqir Fetai, populli ynë fisnik e buajr, të cilin golgota, gjakderdhja dhe përpjekja sizife e përcollën ndër dekada për të arritur këtu ku është, nuk e meriton që një UDB-ash të jetë në

krye të Bashkësisë Fetare Islame, e sidomos teologët e vendit.
Vazhdimësia juaj, është nënçmim për komunitetin, është përçmim
për Bashkësinë Fetare islame, për hoxhallarët dhe shqiptarët në
përgjithësi. Bashkimi Demokratik për Integrim që është në pushtet
e që thirret në emër të luftës duhet ta korigjojë veprimin e vet me
ty, ta korigjojë veten se kujt ia vë gishtin për të qenë reis ulema,
sepse do ta mallkojë Zoti dhe historia. Hoxhallarët duhet
përfundimisht të çelin sytë e zemrës, të zgjohen nga gjumi dhe
apatia disa vjeçare, duhet ta ngrejnë zyrin e tyre për këtë garniturë
të tuhajësuar, ta ngrejnë zërin kundër vjedhjes, kundër shitjes së
vakfit, kundër keqpërdorimit të fitrit dhe zekatit. Zoti na
mbarësoftë si popull! Zoti ta bekoj popullin
shqiptarë!/Tetova1/27.04.2022

Kështu foli Shaqir Fetai (31)

A mund të konsiderohen “lëvizjet-vizita” jasht-protokolare si aktivitet! Shaqir Fetai ka pasur nja dhjetë vizita të kota që ia kanë bërë e që i ka bërë. Ky ishte ai “aktivitet” i planifikuar për Muajin e Mëshirës?! Vizitat e rëndomta asnjë njeri normal në botë nuk do t’i konsideronte aktivitet për t’u shënuar! Shënohet vetëm ajo vizitë e nivelit shumë të lartë, ajo vizitë që gjeneron ndonjë lëvizje kah e mbara dhe e mira, që rezulton me fryte të pritshme për të mirën e komunitetit

Nga Faik Shahinbejlliu

Ta vizitoshë një “gazetar” apo të të vizitohë një gazetar tashmë i harruar (sepse jeta e tij prej gazetari nuk ka lënë kurrfarë gjurme në shoqëri); të vizitohesh prej një imami të rëndomtë, apo ta punësoshë një imam, të vizitohesh prej Stojançe Angelovskit, apo ta vizitoshë kryetarin e shtetit tënd, nuk llogaritet kurrfarë aktiviteti; vizitat e tilla nuk sjellin kurrfarë dobie, nuk rezultojnë me asnjë të mirë të parapara në planet zhvëllimore të pogramëve vjetore! Këtyre “pordhave të ftohta” u gëzohet dhe u kënaqet vetëm Shaqir Fetai.

1.

Vetëm një hipokrit si Shaqir Fetai mund t’i lejojë vetes që të nisë një “letër falënderimi” për diasporën tonë! Ka qenë në Zvicër, ekskluzivisht për ta punësuar një njeri të tij, madje pa kurrfarë konkursi, dhe, me këtë rast, provon të hajë disa iftare duke prezantuar nëpër do qendra të dy-tre qytetave! Dhe, Shaqir Fetai

këto qendra i llogaritë “diasporë” e tërë të cilës i drejtohet me “letër falënderimi për pritjen e ngrohtë dhe vëllazërore”! Këtë hap e ndërmerr për të provuar nëse do t’ia dalë ta ngulfasë pakënaqësinë e diasporës, e cila është ndarë tepër e zhgënjyer dhe e revoltuar nga Shaqir Fetai, i cili, në një odë, në prezencë të njerëzve thotë “ua futëm tetovarve! Gostivari ia mori edhe një xhami” (duke aluduar në pensionimin e imamit nga Tetova dhe në zëvendësimin e tij me një teolog nga Gostivari)! E ndjenë revoltën e mërgimtarëve tanë ndaj dhe, katër ditë para kohe të cilën e kishte paraparë për ta ndarë me mërgimtarët tanë, ikë e kthehet në “vatan”! Këtu pastaj e bën “fet”! Sillet e vepron si “qurat në mjegull”! Janë pjekur të gjitha kushtet që të këndellet dhe të ikë, sepse, tashmë duhet të vërejtë se është dëm kolateral me përmasës së katastrofës! Shaqir Fetai duhet të kuptojë (nëse jo, duhet t’i thonë bashkëvepruesit e tij) se, është jashtë orbitës së BFI-së, sjelljet e tij janë si të një sklerotipi të rëndë i cili nuk është në tokë të bukës! Rijasti i mëparshmëm ka vepruar për dy orë atë çka ky nuk po ia del tash e dy vjet ta bëjë – ta institucionalizojë jetën fetare islame në Maqedoni! Ish-Rijaseti tmerrohej nëse i dilte një xhami jashtë kontrollit; e pat sensibiliuar krejt opinionin e vendit dhe atë botëror për katër xhami që nuk po ia dilte t’i fusë nën kontrollë. Sot, “rijasetit” të Shaqir Fetai i veprojnë në nivel shteti me qindra xhami që nuk i ka nën kontrollë, madje ka “bekuar” edhe “xhami” të atillë e cila jo vetëm që nuk është pjesë e familjes së xhamive të vendit por, punon krye më vete e për llogari të atyreve që nuk e duan unitetin e xhematit tonë si dhe islamit që tradicionalisht e kanë kultivuar myslimanët e vendit. A mos është mision i Shaqir Fetait ky çorientim i xhematit tonë, kjo përçarje e xhematit (edhe një sukses i moodh: Gostivari ia mori një xhami Tetovës!!!) Veprimet e tij gjithnjë e më fuqishëm po e dëshmojnë këtë konstatim. Mjerisht!

2.

Pasi do të kritikohet Shaqir Fetai për pasivitetin e tij total në aspekt të humanizmit përgjatë Muajit të Mëshirës, pasi do të pyetet se ku ngeli “protokoli” i vitit të kaluar për “Shportën e Ramazanit”, sakaq, do të turpërohen për këtë harresë dhe, “saudianët” do të vijnë te Shaqir Fetai me 400 pako ndihmë humanitare! Askush nuk i pa tek i shpërndanë, me përjashtim të natës së parë, kur nja dhjetë “të varfër” e morën nga një pako sa për t’u fotografuar tek

shpërndajnë ndihma ambasadori saudit në Tiranë dhe Shaqir Fetai antihumanisti më i madh që e njeh kjo shoqëri! Pastaj i merr dhe i çon në iftar në një restorant reprezentativ me ç'rast pagaun për një 100 mysafirë rrafsh sa kushtonin 200 pako me ndihma saudite! Shaqir Feta në shënimin e këtij “informacioni” në fb-un e vet tha: “Edhe Ambasadori shprehu përzemërsisht kënaqësinë e tij për organizimin e mirëfilltë të pritjen nga ana e BFI-së së RMV-së...” Pra, ky “gjest” e ka inspiruar ambasadorin e nderuar dhe jo organizimi i bashkësisë “fetare” të Shaqir Fetait në pranimin dhe distribuimin e ndihmave në ato famije që kanë nevojë urgjente për një kafshatë bukë!

Më interesant ishte këmbëngulja e avdallit Shaqir Fetai për të na treguar se tërë këtë aktivitet e paska regjistruar edhe një media saudite dhe na e çon linkun që të vërtetohemi të gjithë! Po, natyrisht që do ta regjistrojnë këtë aktivitet mediat e afërta me Ministrinë e Vakëfit të Arabisë Saudite, sepse është aktivitet i tyre. Po çka regjistroi në këtë plan Shaqir Fetai si aktivitet të tij në rrafshin humanitar?

Përkundër kësaj, a i pa ndonjë mysliman i vendit se kah shkuan edhe ato 4000 pako që u donuan nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfit të Turqisë? Kah shkuan, si u shpërndanë, kush i mori...

3.

Shaqir Fetai realizoi edhe disa vizita nëpër xhamitë e myftinive të vendit të cilat, me atë rast, shtronin edhe “iftar kolektiv”! Aty ku ka iftar “qelepur” aty do ta keshë edhe Shaqir Fetain, me patjetër. Po pse shkon Shaqir Fetai nëpër këta Myftini? Vetëm për ta kollofitur racionin “pet qevabçiçi”? Jo! Por, siç e thotë ai plotë shend e verë: “që në fllim të fjalës sime i falënderova për pritjen kaq të ngrohtë dhe vëllzërore”! Ky është derti i Shaqir Fetait, dhe jo vizita “fise bililah”! Ai po e ndjenë ftohjen e organeve dhe të institucioneve prej tij, ai po e ndjenë urrejtjen e tyre, daj dhe, për ta “relativizuar” këtë fak, ai “përjeton” (!) “pritje të ngrohtë dhe vëllazërore”! Po a kishte deklaratë më të ngrohtë dhe më vëllazërore, a kishte dashuri më të sinqertë, a kishte respekt të përkorë më shumë se sa ajo që e shprehu Shaqir Fetai bashkë me shokët e vet për H. Sulejman ef. Rexhepin një javë para se t’ia ngulin thikën pas shpine! Këtë e ka shumë të qartë Shaqir Fetai, është më se i bindur se do ta gjejë edhe atë ky fat, çka do mbjellësh atë do korrësh, ndaj dhe kërkon

vetëm t'i organizojnë "pritje të ngrohta dhe vëllazërore"! Nuk ka nevojë për dashurinë e tyre, nuk ka nevojë për respektin, le ta urrejnë, mos ta duan, por ama, të paktën, le t'ia organizojnë "pritjen e ngrohtë dhe vëllazërore"! Bujku shqiptar edhe kalit në arë i drejtohet: "Në brazdë bir", "ec bir", "qetësohu bir"...

4.

Strugës dhe Dollogozhdës i shtrohet edhe nga një vakëfi i ri! Shumë mirë! I lumtë myslimanëve si dhe të parëve tanë që i kanë lënë vakëfet! Dhe ky fakt e paska cytyr Shaqir Fetain që me vrap të shkojë atje dhe të krekoset tamam si gjeldet për një vakëf për të cilin ai nuk ka asnjë gram meritë! Apo, përmes kësaj hipokrizie mundohet që ta fshehë masakrën që ia ka bërë vakëfit të Shkupit! Miliona euro të decentraizura po zhduken, asnjë vakëf i ri nuk është blerë e shtuar në këtë Myftini, përkundrazi, janë tjetërsuar vakëfe me vlerë mliona euro për një shumë qesharake të clët mund ta gëlltisë vetëm Shaqir Fetai! Një ditë para drejtësisë do të përgjigjen të gjithë hajnat e vakëfit! Harxhimi i tyre jashtë destinacionit do të jetë motiv për dhjetra padi penale!

5.

Paramendoni se çfarë "lajmi" na kumton Shaqir Fetai në fb-un e vet! Përurohen dy vakëfe të reja, një në Strugë dhe tjetri në një fshat të cilin, Shaqir Fetai, benda "inforatës" së vet e gabon dy herë, madje edhe në titull të "lajmit".

Dollogozhdën Shaqir Fetai e quan DOLLIGOZGFË, pastaj, DILLUFOZHDË! Jo është karakteristikë e personave me defekt mental, prandaj, nuk është keq që të vizitohet në psikiatër! Në të kundërtën, kjo sjellje e Shaqir Fetait do të flasë për interesin e tij që ka ndaj këtij vendbanimi myslimanësh dhe ndaj banorëve të Dollogozhdës!

6.

Shaqir Fetai na "informon" në fb-un e vet se Këshilli i xhamisë së fshatiit Llabunisht i paska ndarë "reisit" mirënjohje! Heeej, "reisi" merr "dekoracion" një mirënjohje nga këshilli i xhamisë! Dhe, pa pikë turpi Shaqir Fetai e nënvizon këtë "ngjarje"! Vërtet a i kujtohet

ndonjëherë në jetë Shaqir Fetait se cila ishte merita e tij që të “shpërblehet” nga këshilli i xhamisë së Llabunishtit! Çka ka bërë në jetën e vet për këtë xhami! Nëse i ka ndarë këshilli organizativ i Mbrëmjes Kuranore, e cila mbahet tash e 26 vite me radhë, a mund të kujtohet në ndonjë meritë Shaqir Fetai? Çka ka bërë për këtë manifestim fetar? Po, ekzistojnë tri deklaratat në dosjen e Temellko Boshkovskit që ka folur për këtë manifestim dhe për këta organizatorë! Mbase vitin tjetër, në vigjile të Mbrëmjes edhe mund t'i botohen ato deklaratat spiuneske!

7.

Shaqir Fetai, tri-katër ditë më vonë, qenka kujtuar për ta pritur mysafirin, imamin e Abu Dabit, i cili në Maqedoninë e Veriut paska qëndruar me ftesën e bashkëpunëtorit të tij të ngushtë, që njëherit është edhe nëpunës i BFI-së por ama bashkëpunëtorë i arabëve!!!), e me rastin e Mbrëmjeve Kuranore organizuar në Llabunisht! Për mysafirin në fjalë Shaqir Fetai shkruan në fb-un e vet edhe këtë: “Prezenca e tij në mesin e besimtarëve ka sjellë një frymë të re”! Në kushte normale, në një shoqëri më të ndërgjegjësuar, Shaqir Fetai do të merrej në pyetje dhe, për një gafë të tillë jo që do të përjashtohet, por edhe do të gurëzohet, si lanet! Për katër ditë qëndrim në Maqedoninë e Veriut arabi paska sjellë frymë të re?! Kur do Shaqir Fetai ta bëjë “pordhën bombë atomike”, ai do ta thotë edhe një fjali të tillë! Sepse, “lëvizjet” e tij protokolora duhet të kenë karaktere të tilla të suksesit vetanak! Ndonëse është dështim flagrant, fund e krye! Po çfarë fryme paska mbisunduar në mesin e mysimanëve të Maqedonisë së Veriut para se të vijë ky imam arab? Apo kjo nuk i kujtohet Shaqir Fetait, sepse ai në jetën e vet as që është marrur me frymën islame në këtë nënqiell. Ose, e ka parë si frymë ngulfatëse dhe, e ardhjen e arabit, ndjenë tjetër fryme. Po tjetër, çka njenë Shaqir Fetai? Helbete, ndonje gisht...

8.

Një ditë përpara, pra në ditën e 26 të Ramazanit, Shaqir Fetai del me “kumtesën” e vet duke ua uruar myslimanëve Natën e Kadrit! Përmes një gjesti prej idioti Shaqir Fetai i bie mohit edhe hadithit edhe ajetit kuranor. Pejgamberi na ka porositur që të lutemi dhe Natën e Kadrit ta kërkojmë në netët tek të dhjetëditëshit të fundit

të Ramazanit!

Shaqir Fetai thotë: “ku çdo vepër në këtë natë vlenë sa një mijë muaj”! Ndërsa Kurani Fisnik në gjuhën shqipe thotë: “Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj.” (3:97)! Kështu thotë edhe në gjuhën arabe të cilin nuk e di Shaqir Fetai, por kështu thotë edhe në të gjitha gjuhët e botës në të cilat është përkthyer Kurani i Madhërishëm! Mbase në “gjuhën” e bastarduar të Shaqir Fetait thuhet ashtu siç e interpreton avdalli!

9.

Seç u lexua dikund se Shaqir Fetai edhe në këtë Muaj ka qenë mjaft dorëshirë në shpërndarjen e “dekoracioneve” të tij! Në mesin e të gjithëve që i paska “shpërblyer”, paska qenë edhe një pronar i një restoranti (nuk po e përmendim për efekt reklame!) Motivi paska qenë “për përgatitjen e darkave të lezetshme”, sepse tjetër motiv nuk ka! Pse i jepet një restoranti i cili nuk ka kurrfarë merite në sferën fetare! Pronarët mund të jenë fetarë të mirë dhe aq! Kjo është për veten e tyre dhe, po kaq të mirë janë të gjithë myslimanët e vendit! Restoranti “dekorohet” vetëm për mikrpritje turistike, për gatime të shijshme dhe për shërbime të mira, dhe këto mirënjohje vinë nga të tjera organizata dhe institucione dhe jo nga ato fetare. E çka ka islam në një vakt të “shijshëm” që një organizatë islame ta dekorojë! Ka hëngër Shaqir Fetai ndonjë darkë gratis dhe mule ta dekoroj pronarin me “dekoracion”, dhe, nëse edhe restorantet e tjera dëshirojnë mirënjohje të tilla, le ta servirin ndonjë darkë gratis për Shaqir Fetain sepse vdes për t’u palluar deri në frymëmarrje të vështirësuar!

10.

Dikush nga xhemati në prag të iftarit kishte pyetur: ky farë “reisi” i hamamit a aq shumë e ka të nxënë grykën me “qevabçiçi” sa mos të mundet ta thotë asnjë fjalë as për provokimin kundër myslimanëve të vendit që po përgatitet të bëhet me kryqin 63 metërsh në Draçevë, as për myslimanët e ngratë që po vriten nëpër objekte fetare në Ukrainë por as edhe për palistinezët që po vriten duke u lutur në Xhaminë e Al Aksasë? Apo përzierja në këto punë

nuk i shkon në të mirë miqësisë së Shaqitr Fetait që e ka me elementë rusë që vdesin për Putinin!

11.

Dhe, e fundit, e cila, si konstatim i pamohueshëm dhe i faktuar me qindra argumenta, do të përmbyllë çdo shkrim të kësaj natyre dhe të kësaj rubrike!

Kështu foli Shaqir Fetai! Vërtet, çka tha Shaqir Fetai? Kush e injoron ka sevape të mëdha! Sepse ai nuk përfaqëson unitetin e myslimanëve të nënqiellit tonë, sepse ai nuk erdhi me propozim dhe me dëshirë të ulemasë sonë, sepse ai paraprakisht kreu tradhëti e komplot, sepse ai është instalacion i ardhur nga nëntoka e shërbimeve që nuk ia duan të mirën as shqiptarëve dhe as myslimanëve të vendit tonë!/Kombetare/29.04.2022

Shaqir Fetait i villet nga të varfërit

Ra ky Ramazan dhe u shtuan edhe më shumë dyshimet në përkatësinë fetare të Shaqir Fetait! A mund të jetë mysliman, i përkatësisë fetare islame, një njeri si puna e Shaqir Fetait, që: rrenë, tradhëton, spiunon, nuk ka një gram sensi për humanizëm, shkelë parimet islame, e dërmon vakëfin, fitnexhi, përçarës, i pashpirt, një njeri me njëqind hektar fytyrë, që nuk skuqet fare, pa gjakë e pa lotë dhembshurie

Nga Valbon Osmani

Shaqir Fetrai na paska hëngër një iftar me kryeministrin e Maqedonisë, madje, këtë “ngjarje historike” e bën edhe “lajm” duke e titulluar “Një iftar te kryeministri”! Paska hëngër një iftar së bashku me kryeministrin, heeej! Çfarë lezeti ky për Shaqir Fetain! Shaqir Fetai vdes për nderja me “të mëdhenjtë”! Ai akoma e përmend drekën që e ka hëngër së bashku me delegacionin e Putinit që ka ardhu ta urojë Shaquan për postin e “reisit”, dhe që janë interesuar për shëndetin e tij!

Të gjitha problemet qenkan relativizuar me këtë “iftar të bekuar” me prezencën e Shaqir Fetait e të shtruar nga Dimitar Kovaçevski! Uh, Shaqir Fetai për një iftar, është në gjendje të konvertohet në fe tjetër, është në gjendje të dalë edhe prej islamit! Po pse a nuk është konvertuar deri më sot dhjetra herë, a nuk ka shkelur parime islame me qindra herë deri më sot Shaqir Fetai? Pa dyshim që po! Prandaj, hiç nuk e ka dert për probleme fetare e kombëtare, pse a ky ka për t’i zgjedhur a! Ky është vetëm për “bekim të iftareve”,

vetëm shtronia një iftar, një drekë apo darkë, ky i hap të gjitha “gurmazet” që i ka!

Një iftar me kryeministrin! Pse Shaqir Fetai nuk ia kushtëzoi këtë iftar kryeministrit me një “iftar gjigand” për të varfërit myslimanë të Maqedonisë së Veriut!

Vërtet, pse Shaqir Fetai nuk e hëngër asnjë iftar me të varfërit e vendit, me skamnorët, me fukaratë, me njerëzit në nevojë! Jo vetëm që nuk u doli në ndihmë me ndonjë aksion vetanak humanitar, porse nuk e organizoi asnjë iftar së bashku me të varfërit myslimanë që i ke gjithandej në territorin e Maqedonisë së Veriut!

Nuk i hahet Shaqir Fetait me të varfërit, nuk e duron këtë kategori njerëzish, sepse ai nuk e di se çka është varfëria, ai ka pasur me bollëk, i furnizuar sa nga xhemati aq edhe nga UDB-ja! Kur UDB ka shprehur për dikë qoftë më të voglën mëshirë?!

Shaqir Fetai do të thotë që nuk ka pasur para dhe se këtë iftar me kryeministrin nuk e ka shtruar ai vetë por kryeministri? Dakord! Por ama, Shaqir Fetai iftare me “atmosfera madhëshotore” ka ditur të shtrojë nëpër restorante reprezentative për turlifarë “myslimani” e mahluku!

Ra ky Ramazan dhe u shtuan edhe më shumë dyshimet në përkatësinë fetare të Shaqir Fetait! A mund të jetë mysliman, i përkatësisë fetare islame, një neri si puna e Shaqir Fetait: një njeri që rrenë, që tradhëton, që spiunon, që nuk ka një gram sensi për humanizëm, që shkelë parimet islame, që shitet si “reis” ndonëse është shumë i vetëdëshëm se kush e instaloi në këtë post; një njeri që e dërmon vakëfin, një njeri mburravec, një njeri fitnexhi, përçarës, i pashpirt, një njeri me njëqind hektar fytyrë, që nuk skuqet fare, pa gjakë e pa lotë dhembshurie! Një njeri i këtillë, me të gjitha këto tipare që i ka Shaqir Fetai, assesi nuk mund të jetë mysliman, aq më pak t’i thotë vetes “teolog” ndërsa kahdo që rrotullohet fallcifikon “ajete” e “haithe”!

Edhe Dimitar Kovaçevski i gjorë mendon se ka bërë sevap duke i shtruar iftar dy “teolopëve”! Ajo darkë mund të llogaritet për “iftar” aq sa mund të llogaritet Shaqir Fetai e Qenan Ismaili “myslimanë”

të devotshëm!

Përfshirja e “parisë fetare” në evente të organizuara nga strukturat që tallen me islamin dhe me myslimanët e vendit është, thjesht, legjitimim dhe institucionalizim i planeve dhe projekteve të tallësve! Meqë na dhe iftar, kaja nanën, ngriteni kryqin në Draçevë, ne do rrimë “sus”! Ky marifet është gjest i hipokritëve, i edepsëzave, i dinsëzav.../Tetova1/30.04.2022

Bakllava nga Shaqir Fetai me fitrat e BFI-së

“Event” i Shaqir Fetait bëhet ekskluzivisht për interes të tij, me atë nuk fiton asgjë as islami, as shqiptaria, as BFI-ja, por, thjesht, fiton bakllavaxhiu i Shaqir Fetait, fiton restoranti glamuroz, fitojnë pak “populizëm” edhe partiashët e Shaqir Fetait dhe, tërë kjo në dëm të fitrave dh zeqatit që janë mbledhur në emër të Medresesë Isa Beu. Paguaj myslimanët e ngratë, harxho Shaqir Fetai për të “blerë” pak përkrahje “politike e diplomatike”

Nga Kastriot Berisha

Manipulatori unikat që e ka RMV-ja, Shaqir Fetai, as pas tridhjetë ditëve të Ramazanit (nëse i ka agjëruar!), as në ditën e festimit të Fitër Bajramit, as para strukturave më të larta shtetërore, as para opinionit të gjërë të myslimanëve nuk skuqet por, vazhdon me përpjekjet për të manipuluar gjithësecilin! Shfrytëzon rastin për ta lular “madhështinë” e vet duke shitur pallavra, duke rrejtur e duke prezantuar hipokrizi para mjeshtëreve të deshifimit të hipokrizisë!

Po si nuk i vie turp që të organizojë “manifestim” glamuroz, me qindra të ftuar, të hurit e të konopit, dhe që të gjithë t’i gosisë me “Bakllavën e Bajramit”, në një sallë e me ambient që kushton po aq lekë sa ka mbledhur “fitra për Medresenë”! Tani, a i ka mbledhur ato fitra për nxënësit e Medresesë apo për ta gostitur tërë strukturën e BDI-së, e cila, natyrisht, ka shfrytëzuar rastin që të dëshmojë se, si parti, në vorbullën e mijëra kritikave anti-bdi, dinë

t'i respektojnë edhe vlerat kombëtare e patriotike, por edhe vlerat fetare, siç është, pa dyshim, Fitër Bajrami! Shaqir Fetai e keqpërdorë këtë respekt partiak ndaj institucionit duke thënë: “ja, ja sa më do mua BDI-ja”! Kurse BDI, sa më parë që do të lirohet nga kjo hipotekë, nga ky medalion i UDB-së që mirë po u rri në kraharorë, aq më mirë do t'i kenë punët!

Shaqir Fetai pranon të bëhet personazh i skenareve të huaja në përpjekje për ta shkatërruar krejt BFI-në pasi që ta “vrasë” ish-resiul ulemanë, ndërsa nuk pranon që t'ia “vrasë” recidivistët e tij që ishin bashkëpunëtorë më të ngushtë në çdo veprim të tij, si dhe nuk pranon që të heqë dorë nga mënyra dhe metedat e tij si mjete recidive për ta shitur si përkrahje e bashkëpunim çdo vizitë e kontakt! Megjithatë, ish-reisi ka pasur pak më shumë cipë, ka pasur më të trashë perden e turp, nuk i ka bërë gjërat siç i bënë Shaqir Fetai në mënyrë kaq të pistë. Ishte ide e H. Sulejman ef. Rexhepit për të organizuar “Bakllavën e Bajramit” për miq dhe për të gjithë ata që shprehnin dëshirë për të ardhur në kabinetin e tij dhe për ta uruar! Kah fundi, ata që shprehnin dëshirë për të ardhur tek ai ishin gjithnjë e më të paktë, strukturat shtetërore, partiake e diplomatike nuk dëshironin që ta legjitimojnë veprimin e “Rijasetit” ku aderonte si gjelDET edhe Shaqir Fetai. Duke e kuptuar këtë gjest, “erdhi ideja” që t'u bëhet një ftesë strukturave të caktuara për t'u qerasur me “bakllavën e bajramit”. Nuk ftoheshin më shumë se nja 50-60 vetë dhe, ndeja ishte i formatit “ketering”, në këmbë, përshteteshin, uroheshin, nga një copë bakllave dhe, iknin. Në këtë takim vinin edhe ata përfaqësues të faktorëve të ndryshëm, të cilët, megjithatë, shprehnin respektin ndaj institucionit, ndaj fesë islame dhe ndaj vlerës islame. Këtë e di shumë mirë edhe Shaqir Fetai.

Shaqir Fetai, duke e parë se legjitimiteti po i bie përdhe, duke e parë se po bojkotohet ditë e më shumë, duke e parë se askush nga faktorët e rëndësishëm nuk po ia shkelë pragun e zyres, vendosi që ta përdorë metodën e “babait shpirtëror” të tij, H. Sulejman ef. Rexhepit dhe të organizojë diçka ngjashëm çka organizonte ai për qëllime personale! “Bakllava e Bajramit”! Por ama, shumë më

“spetakolare” nga ajo që e organizonte efendi Rexhepi!
I kishte ardhur tërë ajo strukturë që realisht ndjehen të turpëruar me skandalin që e bënë duke e instaluar Shaqir Fetain në krye të BFI-së; të gjithë ata që nuk pranojnë t’i hynë në zyrën manipulative të Shaqir Fetait dhe, me qëllim që myslimanët e vendit mos t’i konsiderojnë si anti-fetarë e anti-islamistë, vendosin që ta dëshmojnë respektin ndaj vlerave të islamit, duke iu përgjigjur “manifestimit fetar”! Kësisoj i bie që, bakllava të ketë qenë e BDI-së por e blerë dhe e shtruar me paratë e BFI-së të grumbulluar nga fitri dhe zeqati i myslimanëve.

Të shkretët myslimanë, ndajnë nga kafshata e gojës për të dhënë fitrat, ndërsa Shaqir Fetai i harxhon në lluks dhe me njerëz të lluksit.

Të pranishmëve Shaqir Fetai i drejtohet me përshendetje prej arlekini:

“I nderuar zëvendës kryeministër i RMV-së, zotëri Artan Grubi”,
“Të nderuar ministra në ministritë e Qeverisë së RMV-së”! – Të nderuar ministra në ministritë!!! Plus dhe të qeverisë! Sjellje dhe logjikë kjo e hipokritëve më të poshtër! Qeveria e Maqedonisë ka shumë ministra! Pse nuk i nënvizon “ministra shqiptarë”, apo “myslimanë”? Sepse, ishin vtëm ministrat e BDI-së dhe, të mendojnë qytetarët se te Shaqua ishin të gjithë ministrat, absolutisht të gjithë! Ngjashëm si ato putanet që e kanë qejf lavdërimin e përdorimit të të gjithë meshkujve të mëhallës apo të katundit!

“Të nderuar deputetë të Parlamentit të RMV-së”! Sa deputetë? Të gjithë? 120 deputetë, apo, vetëm ata myslimanë, ose deputetët e BDI-së? Do me thënë, Shaqir Fetai i përshëndetë “të gjithë deputetët e Parlamentit” të pranishëm (!) në event, me qëllim që t’i ikë bdizimit të “eventit”!

“I nderuari kryetar i Bashkimit Demokratik, zotëri Ali Ahmeti”
“Të dreruar... kryetarë... që jeni prezent këtu të partive të tjera politike”! Asnjë nuk e përshendeti me emër e mbiemër, sepse, realisht nuk ishte asnjë kryetar tjetër përveç Ali Ahmetit! (Kur e pyetën Shaqir Fetain se cilët kryetarëtë tjerë i përshendeti, u tha që

qëllimisht e bëri këtë përshëndetje, që Ali Ahmeti mos të ndjehet i vetmuar si kryetar, por edhe me qëllim që të tjerët të mos mendojnë se neve na do vetëm Ali Ahmeti, por na duan “të gjithë kryetarët e partive të tjera që ishin prezent këtu”!

“Te nderuar drejtorë në digasteret e ndryshme në qeverinë e RMV-së”! Ky është kulmi i hipokizisë së Shaqir Fetait! Me këtë përshëndetje deshifrohet tërë ajo përpjekje e tij për të shitur “mastrapalla” para auditoriumit dhe para opinionit! Qeveria e Maqedonisë së Veriut ka mbi 100 digastere e drejtorë të nivelit të parë, ka mbi 2-300 të tjerë të nivelit të dytë dhe me mijëra të tjerë të nivelit të tretë! Pse Shaqir Fetai bëhet avdall në ditë me diell!

“Të nderuar kyetarë të komunave nga tërë territori i RMV-së”! Thotë njeriu që aty ishin prezentë 80 kryetarë të komunave të RMV-së dhe Shaqir Fetai, ashtu, toptan, i përshëndeti të gjithë, sepse para tij ishin “që të gjithë” (nuk është me rëndësi nëse i ka parë auditoriumi dhe opinionin apo jo)!

Përshëndeti lloj-lloj mahlukati por nuk i përshëndeti njerëzit e rëndomtë që i kishte ftuar aty për t’ia mbushur sallën e madhe! Nuk përshëndeti as profesorë, as gazetarë, as profile të ndryshëm nga shoqëria civile, as filantropë! Dhe, tërë kjo përshëndetje, me atë tempo-ritëm të hipokritit të pederakaftë zgjati hiç më pakë se fiks gjashtë (6) minuta! Për ta vazhduar pastaj fjalimin, fillimisht në gjuhën maqedonase! Plus pastaj edhe tetë minuta fjalim! A e kupton Shaqir Fetai se të gjithë të pranishmëve ua ka thinjur me përshëndetje prej gjashtë minutave! A e di që edhe bakllavën ua ka bërë me “krip”! A ka respekt Shaqir Fetai të paktën për kohën e diplomatëve e cila, në këto çaste të turbullta, një sekond u bëhet një shekull! Nëse ka kohë Shaqir Fetai për të shitur “bakllavë me kopalla”, të tjerët nuk kanë kohë për t’ia dëgjuar diksionin prej arlekini një të poshtri, i cili, eventet i organizon për llogari të veten, ndërsa i paguan me paratë e fitrit!

Pra, tërë ai “event” i Shaqir Fetait bëhet ekskluzivisht për interes të tij, me atë event nuk fiton asgjë as islami, as shqiptaria, as BFI-ja, por, thjesht, fiton bakllavaxhiu i Shaqir Fetait, fiton restoranti i hotelit, fitojnë pak “popullizëm” edhe partiashët e Shaqir Fetait

dhe, tërë kjo në dëm të fitrave dh zeqatit që janë mbledhur në emër të Medresesë Isa Beu. Paguaj myslimanët e ngratë, harxho Shaqir Fetai për të “blerë” pak përkrahje “politike e dilomatike”! Shaqir Fetain nuk e shpëton as Vetë Zoti, sepse, përfundimisht, Ai nuk e do! Nuk mund të ketë mëshirë ndaj faqeziut që shpenzon fitrin për “autoritet” personal!/Koha/03.05.2022

Kur gënjeshtër të bëhet “shpëtim” (1)

(Lidhur me një intervistë të Shaqir Fetait, instalacionit të pushtetit maqedonas në krye të BFI-së, që e dha në ditën e Fitër Bajramit në një televizion nacional në RMV. Në vazhdim do t’ia analizojmë përgjigje për përgjigje)

Nga Demir Zimeri

Dikur, pas periudhës së Pushtetit Osman, në hapësirat ballkanike Dita e Bajramit përveçse që paraqiste ditë feste, njëkohësisht ishte edhe një ditë që sinjalizonte në hata, në tmerr, në pritje të ndonjë goditje të trishtueshme. Në peridhën pas-Osmane pushtuesit serbë e përdornin këtë ditë për të sulmuar ndonjë xhami, për të bërë ndonjë krim mbi myslimanët vendasë, për të bërë ndonjë masakër, me të vetmin qëllim që ditën festive t’ua nxijnë myslimanëve dhe të detyroheshin ose të heqin dorë nga feja islame duke u konvertuar në fe të tjera, ose t’i mblidhnin plçkat dhe të heqnin dorë nga atdheu!

Shumë myslimanëve të vendit, intervista e fundit e Shaqir Fetait dhënë në një televizion nacional në RMV, ia ka përkujtuar këtë fakt të trishtë. Shaqir Fetai e përdor këtë ditë për të rrejtur sa më shumë, për të na e shpifur përkatësinë fetare, për të të detyruar ta thyesh copë-copë kutinë e informimit dhe të ngelësh në terr, të mos marrësh vesh, veç tëtjerash, as atë që po bën në dëm të islamit Shaqir Fetai!

Që në përgjigjen e parë Shaqir Fetai shihet që tërë Muajin e Agjërimit e ka përdorur për ta gatuar rrenën, për të pasur sa më

shumë rrenë të gjatë me qëllim që rrenën ta përdor si ushqim artificial për vetëmburrjen e tij.

Shaqir Fetai, si një mynafik i veçantë, jep kumtin për të gjithë besimtarët e vendit: që të gjithë e kanë dhënë provimin që e kishin ndaj të Madhit Zot gjatë tërë Muajit të Ramazanit! Në këtë “që të gjithë” Shaqir Fetai e përfshinë edhe veten! Ky që gjatë tërë Muajit të Ramazanit është marrur me përçarje, me rrena, me hajni, me përçmim të të varfërve – ky ta ketë dhënë provimin ndaj të Madhit Zot! Kurrë, për më të madhin kjamet, jo!

Shaqir Fetai thotë se, me të kuptuar në prag të Ramazanit se Kovodi 19 po zbutet, sakaq qenka rizgjuar “rijaseti” i tij dhe paskan filluar me përgatitjen “profesionale” për programin e Muajit të Bekuar! Shaqir Fetai deri dy-tre ditë para Ramazanit as që ka guxuar ta thërrasë mbledhjen, sepse ka pasur informacione tallëse se dikush do t’i “bëjë puç”! Shaqir Fetai, siç e di krejt bota, ka mbajtur mbledhje dhe ka miratuar disa “konkuzione bazë”, të cilat as që mbajnë erë konkluze, sepse aq di i shkreti!

Megjithatë, në intervistën e fundit Shaqir Fetai ka dëshirë që të mburret, që të paraqitet “vigilent” duke nënvizuar se “paska pasur një përgatije të jashtëzakonshme”! Ku konsiston kjo përgatitje sipas rrenave të Shaqir Fetait? Heeeej, si e para, i paska përgatitur objektet fetare!!! A ka turp e rrenë më të madhe se kjo! Objektet fetare në këtë nënqiell ekzistojnë hiç pa i përgatitur Shaqir Fetai tash e gjashtë shekuj, ekzistojnë metë organizuara sidomos në prag të Ramazanit, gjithnjë kanë ekzistuar në gatishmëri të plotë, sepse, jo që i ka kërkuar “reisi” por ky është obligim i çdo imami të çdo xhamie! Me përgatitjen e xhamive nga ana e Shaqir Fetait me këtë minimizohet roli i imamëve dhe nevoja e domosdoshme për të qenë ata bartës të jetës fetare islame në vend. E me se i paska përgatitur Shaqir Fetai objektet fetare? Çka u paska bërë? I ka ndërtuar, i ka meremetuar, i ka hapur për opinion?! I ka shtruar, i ka lyer, ua ka falur nga një palë tespah (të paktën një palë tespah!)? I paska përgatitur vendet ku do të ligjërohet! Xhamitë nuk paskan pasur vende të tilla dhe, ja që mos me qen Shaqir Fetai, ato vende kurrë nuk përgatiten dhe nëpër xhami nuk ka vende për ligjerata. Ooo, shihni mrekullinë: Shaqir Fetai paska përgatitur hapësirë për gjininë mashkullore në veçanti për gjiniinë femërore! Ky edhe rrenë edhe ofendon, edhe e mohon traditën, edhe e shtrembëron atë, ves ky tipik i armiqve të islamit. Paramendoni, “rijaseti” i Shaqir Fetait dhe vetë Shaqir Fetai sivjet paskan vendosur që edhe gruas

muslimane t'i bënë hapësirë nëpër xhami për të ndjekur ligjërata. Kjo praktikë këtu në Shkup është traditë tashmë mbi 30 vjeçare dhe, ta mohojë këtë fakt Shaqir Fetai, kjo po që i tejkalon të gjitha limitet e njerëzores. Pastaj paska përgatitur pogramë të niveleve të ndryshme! Shikojeni megallomanin! Pogramë të niveleve të ndryshme, ky i cili nuk pati qoftë vetëm një program për ta shënuar sa më denjësisht dhe sa më profesionalisht Muajin e Bekuar të Ramazanit!

U përgatitëm mirë, thotë Shaqir Fetai, “u përgatitëm me kuadro të reja”! Të vetmit “kuadro të reja” për këtë Muaj të Ramazanit ishin, pa dyshim, kuadrot e brymosur me “ideologji sektariane” të cilët, me “pembele” nga përçarësi Shaqir Fetai u lejuan dhe u caktuan që në xhami të cakura të “helmojnë” sa më shumë xhemate, përmes “risive ideologjike” duke i praktikuar gjatë kryerjes së ibadeteve që nuk përkonin askund me tradicionalen! Më mirë xhematet të merren me këtë dukuri ideologjike se sa me shkatërimin e vakëfit që po e bë Shaqir Fetai me honxho-bonxhot e vet.

Qenka përgatitur me kuadro të reja? Po me kuadrot e vjetra, me ata që kanë përvojë, që janë shtyllë e fuqishme e islamit sot në këtë nënqiell – ç'ka u bë me ata! Nuk u ftuan në këtë program fare? U refuzuan si të padëgjueshëm, si refuzues të Shaqir Fetait të partizuar, gënjeshtar e manipulator, ndaj dhe u deshtën kuadrot e reja?!

Shaqir Fetai, pa pikë turpi përmend edhe “tre tribuna shkencore”, të cilat i kanë organzuar për vetëvete: anëtarët e “rijasetit”, profesorët, janë shyer në mes vete se kush ka aftësi më të madhe në një çështje të caktuar! Këto tribuna nuk kanë qenë në opinion, në publik, nuk janë ndjekur nga shtresa të ndryshme, nuk janë mbajtur në vende publike por, thjesht, myftiu i ka ligjëruar myftiut, profesori-profesorit, një kamerë lokale përpara dhe, ja, “tre tribuna shkencore”, pa kurrfarë përfundimi, pa kurrfarë konkluze, pa kurrfarë imputi e levërdije prej tyre!

Për ta përmbyllur këtë potpuri plotë me rrena idiotike nga Shaqir Fetai, po nënvizojmë se Shaqir Fetai qenka përkujdesur për një “atmosferë ramazaneske”! Ja një sintagmë për akademikët kombëtarë për ta futu në fjalorin terminologjik! Nëse u duket idiotike le t'ia thonë Shaqir Fetait!

E tash – do të dalim te agresioni rus në Ukrainë! Tani me njohuritë diletanteske të Shaqir Fetait do të mundohet që të hedhë plaf mbi

dështimet programore të tij gjatë Muajit të Ramazanit. Ky rrenë sa është vetë i trashë se “rijaseti” e ka dënuar këtë agresion! Ky në prag të luftës është solidarizuar me Putinin, përmes delegacionit të tij, të cilin e pret në zyret e BFI-së dhe, të cilit i premtan përmendore për “mikun e Putinit” në parkun e Tetovës! Ky asnjëherë nuk e mblodhi “rijasetin” e vet për të debatuar dhe për të marrur qëndrime lidhur me këtë agresion. Për pasojë nëpër shumë xhami, nga shumë “imamë të rinj” është kritikuar presidenti ukrainas dhe është mburrur presidenti rus, derisa Shaqir Fetain nuk e gozhduan ndërkombëtarët në kryq të qëndrimit personal. Shaqir Fetai mendon se me deklarin e vet të stisur kundër agresionit të Putinit, aty ka marrur fund lufta! Kush e dëgjon me kujdes “intervistën” e bajatshme të Shaqir Fetait, do të vërejë se ai flet në kohën e shkuar, flet për një luftë që ka ndodhur e që tashmë ka përfunduar! Për Shaqir Fetain tashmë nuk ka agresion rus mbi Ukrainën! “Ishte një luftë e tmerrshme”, “kjo luftë kishte mundësi të përhapet edhe në vendet e tjera”! Shaqir Fetain e paska gëzuar shumë fakti që më në fund Bashkimi Evropian si dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës e paskan kuptuar rrezikun e kësaj lufte dhe se tashmë do ta ndalin, në veçanti në aspektin fetar! Këtu Shaqir Fetai del prej shinave dhe e humb kontrollin... e humbi kontrollin, e hu-mbi kontrollin! Vërtet çka do të thotë për Shaqir Fetain të mbysësh një njeri? Si mbytet ai njeri? A flet ajeti kuranor që e citon Shaqir Fetai vetëm për mbytjen me plumb e me thikë, apo me raketa, me bombë bërthamore të një njeriu, apo edhe t’ia bëshë kurthin që t’ia shkatërroshë jetën! A është mbyetje për Shaqir Fetain tradhëtia, komploti, eliminimi i një njeriu, shkatërrimi psikik i tij, siç ka bërë shpesh në jetën e vet Shaqir Fetai, a mund të quhet ky tip njeriu kiminel, apo, meqë Shaqir Fetai nuk i ka nxjerrur gjak asnjërit me thikë apo me plumb, nuk mund të quhet KRIMINEL! Shaqir Fetai aq shumë ka bërë krime në jetën e vet sa, një Zot e di se si do t’i dalë dhe nga do t’i dalë ai shpirt i zi!/Kombetare/04.05.2022

Shaqir Fetai versioni karikatival i Robin Hudit (2)

(Rreth një paraqitje publike të Shaqir Fetait, instalacionit të pushtetit maqedonas në krye të BFI-së, në një televizion nacional në RMV, në ditën e Fitër Bajramit. Në vazhdim do ta analizojmë përgjigje për përgjigje)

Nga Demir Zimeri

Në pyetjen e radhës Shaqir Fetai flet për “humanizëm”! Njeriu më anti-human të flasë për humanitet?! Pa fije turpi Shaqir Fetai thotë se “ne kemi pasur program, brenda programit të përgjithshëm, për ndihma humanitare”! Si nuk turpërohet para bashkëveprimtarëve të vet në shkatërrim të BFI-së kur thotë se “kemi pasur program”, ndërkohë që e di se honxho-bonxhot e tij as që kanë parë program e as që kanë miratur ndonjë program të tillë. Pra, Shaqir Fetai nuk e ka dert që të dalë rrenc edhe para marionetave të tij! Kur shefi rrenë e vjedh, pse jo “ithtarët” e tij!

Paska ndarë me tonelata e tonelata mish! Ai nuk ka ndarë, por, thjesht, ka aktruar rolin e Robin Hudit! Robin Hudi u vidhte të pasurve dhe u jepte të varfëve. Shaqir Fetai ka vjedhur Medresenë Isa Beu për t’u paraqitur si Robin Hud! Ai ka vjedhur mishin e kurbanëve të donuar për medresantë dhe, me mishin e huaj “bën” humanitet! Kurbanët që dikush i ka dhuruar e i ka paguar që sevapi t’i shkojë në vend po atë ditë, Shaqir Fetai një vit më vonë bën “sevape” për vetel! A nuk është kjo e turpshme? A nuk është anti-humanitet, a nuk është antiislame!

Që në fillim, thotë rrencak Shaqir Fetai, kemi ndarë 4000 pako me ndihma humanitare, të cilat, në fakt, nga Drejtoria e Vakëfit të Turqisë vinë mu në mes të Ramazanit! Tani, kur i ka ndarë këto

pako Shaqir Fetai: në fillim apo kah fundi i Ramazanit? Ato pako duhet të tregojë Shaqir Fetai se të kujt ishin, kush i kishte dërguar këtu hejdije dhe, në çfarë roli ishte Shaqir Fetai rreth këtyre pakove! Mos i mblodhi vetë? Mos i bleu vetë? Mos i paktoi vetë? Jo, që të gjitha i erdhën nga Turqia me kusht që Shaqir Fetai të marrë rolin teknik të distribuimit të tyre! Dhe, kush i pa se nga i dërgoi, si i shpërndau dhe ku i shpërndau ato Shaqir Feta? Asnjë shënim publik mbi shpërndarjen e këtyre pakove! Mbase akoma janë të magazinuar dhe pret Shaqir Fetai që në muajt në vazhdim të shpërndajë ndihma e të tregohet se sa “bujar” që është! Tamam Robin Hud: vjedh nga pakot e turqëve dhe ua “shpërndanë” të varfërve! Paska shpërndarë mijëra e mijëra pako madje, edhe në ditën e Bajramit paska ndarë mbi 2000 pako për myslimanët dhe jomyslimanët! I di Shaqir Fetai, i njeh të gjithë, i di ai se ku i ka dërguar pakot që janë donuar nga myslimanët për të varfërit myslimanë të vendit!

Ky nuk pyet për të tjerët, ky interesohet vetëm për gushën e vet, për interesat e veta të ulëta, për karrierën e vet të pistë. Për këtë qëllim, ai është në gjendje që të bashkëveprojë edhe me djallin dhe kundër të gjithë myslimanëve! Të gjithë le të vdesin, vetëm Shaqir Fetai jo, sepse si mercenar ka marrur obligim për ta bërë “fet” BFI-në dhe mbarë Republikën e Maqedonisë së Veriut (mundohuni që këtë emërtim gjeografik ta shqiptoni me sinkopa siç e shqipton Shaqir Fetai, duke i përplasur buzët si pela kur mllaçit nën hije në pikun e etjes)!/Kombetare/05.05.2022

Shkaku i Shaqir Fetait, sivjet buxheti i Medresesë do të jetë katastrofal (3)

(Në ditën e Bajramit, si rekapitulim të “aktiviteteve” gjatë Ramazanit, Shaqir Fetai pati një paraqitje në një televizion nacional në RMV, ku lëshoi një mori rrenash, ofendimesh e përçmimesh. Në vazhdim do ta analizojmë përgjigje për përgjigje)

Nga Demir Zimeri

Në pyetjen se si ishte realisht situata në terren, Shaqir Fetai shpërthen, shpërthen me një potpuri rrenash të cilat i vinte në funksion të ofendimit, të mohimit të traditës dhe të nënçmimit të kolegëve të vet.

Ne, thotë Shaqir Fetai, në prag të Ramazanit kemi pasur dy objektiva: të mbulojmë xhamitë tona me kuadër, do me thënë, nëpër xhami ku nuk ka imamlerë t'i dërgojë Shaqir Fetai, si dhe ta mbulojë diasporën ku veç më Shaqir Fetai paska mbi 200 qendra të vetat!

Njohësit e situatave, dhe fatmirësisht këta njohës janë në masë të konsiderueshme, sakaq do ta kapin në rrenë Shaqir Fetain. Le të na e thotë Shaqir Fetai vetëm një xhami në Maqedoninë e Veriut që nuk paska pasur imamë e që paska pasur nevoja të mbulohet me “imamët” e Shaqir Fetait! Po edhe sikur të jetë e vërtetë, a nuk është i turpshëm mobilizimi i Shaqir Fetait vetëm për Muajin e Ramazanit? Muajve të tjerë, gjatë tërë vitit do të rrinë mbyllur xhamitë, xhematet pa imamë, ë?

Rrena më e pështirë të cilën Shaqir Fetai e përdorë tash e disa herë, që kur u instalua nga pushteti maqedonas në krye të BFI-së

është se bashkësia “fetare” e tij tashmë paska me qindra qendra islamike në diasporë! Po si i paska BFI-ja 200 qendra të veta në shtetet perëndimore?! A e kupton Shaqir Fetai fjalën qendër? Po supozojmë se ekzistojnë këto qendra dhe, pa dyshim që diaspora jonë, të të gjitha komuniteteve, e ndjejnë shumë të nevojshme që të themelojnë faltore, xhami, vendlutje, të kenë një Shtëpi të Zotit ku do të luten dhe, për këtë qëllim, myslimanët tanë të devotshëm kanë ndjekur fillimisht xhami ku imamlerët kanë qenë të huaj, nuk kanë pasur mundësi të kuptojnë vazet, nuk kanë pasur mundësi të ngrisin probleme, të zgjidhin çështje, të shtrojnë pyetje dhe, si rrjedhojë e kësaj, është arritur ai ndërgjegjësim që secili, sipas mundësive, të bëjë xhamitë e veta! Tani shqiptarët në Perëndim i kanë “qendrat” e veta, ka xhami me kompleks objektësh ndihmës, i kanë themeluar vetë, i kanë ndërtuar vetë, i kanë blerë vetë, kanë angazhuar teologë vetë, kanë kërkuar nga bashkësitë fetare të vendeve respektive! Tani, t’ia vjedhësh këtë djersë mërgimtarëve tanë dhe ta paraqesësh si “pasuri” personale, apo si qendër të Institucionit tënd, kjo po që është më tepër se ndyrësi, se idiotësi! Shaqir Fetai dhe “bashkësia” e tij me asgjë nuk kanë kontribuar për këto qendra, me përjashtim të kontributit të tyre në shpërnguljen masovik të myslimanëve tanë të cilët një ditë, do të kenë nevojë edhe për xhamitë e tyre! Ato 200 qendrat e Shaqir Fetait janë vetëmse 200 xhemate, komunitete myslimanësh prej viseve tona, të cilët, me vetëkontribut kanë arritur të ngrisin Shtëpi të Zotit dhe që përmes këtyre Shtëpive vetë ata kërkojnë që të ruajnë lidhshmërinë me atdheun, duke punësuar aty-këtu imamlerë nga vendlindja ose, herë pas here me propozim të BFI-së. Kjo është, mbi të gjitha, edukatë e myslimanëve tanë, ky është një gjest modest patriotik e kombëtar dhe, në këtë gjest, nuk mund të ketë hise asnjë gram Shaqir Fetai. Prandaj, mos t’ua nëpërkëmbë djersën dhe imanin, duke i përvetësuar ato qendra sikur të jenë të tij, sikur ky ua ka shpërndarë, ngjashëm siç shpërndanë avdalli mirënjohje “e dekoracione” kot e kot!

Fundja, ato 200 qendra kësaj radhe haptazi dëshmuar fuqishëm se nuk janë të Shaqir Fetait, se nuk e respektojnë këtë mahluk dhe se nuk e duan, ndaj dhe, ia doli mezi që të pranohet në 4-5 qendra dhe, të shkurtojë axhendën për katër ditë, sepse, e nuhati “pit-bulli” se nuk ishte puna mirë! Këto 200 qendra, duke e ditur se kanë të bëjnë punë me një munafik e përçarës të madh, me një hajn që në emër të islamit përpiqet që t’i rjepë mërgimtarët, t’ua

marrë paratë dhe t'i shpenzojë nëpër lezete partiake, kësaj radhe më se 80 për qind të fitrave dhe zeqatit e orientuan nëpër organizata të ndryshme humanitare dhe, vetëm shkaku i Shaqir Fetai, Medresja "Isa Beu" u dëmtua për një buxhet shumë të konsiderueshëm!

Shaqir Fetai i ofendon mërgimtarët tanë! U thotë se ua ka mbuluar të gjitha qendrat islamike në perëndim, në SHBA madje edhe në Australi ku i paska. Do me thënë, muslimanët tanë nuk janë falur, nuk kanë pasur imamlerë derisa ua ka "themeluar" qendrat islamike ky farë avdalli dhe se, sot i paska mbuluar të gjitha ato me imamlerë. Po më përpara, a kanë pasur imamlerë këta myslimanë, a janë lutur, apo, në myslimanizëm kanë hyrë pasi ua ka krijuar kushtet Shaqir Fetai! Djallëzi e llojit që mund ta bluaj vetëm Shaqir Fetai!

Të gjithë medresantët, të gjithë studentët e Fakultetit të Shkencave Islame, të gjithë profesorët kësaj radhe paskan qenë në shërbim të xhamive, kuadër që paska mbuluar xhamitë, me qëllim që t'iu shërbejnë xhematlinjëve!!! Po kush i ka shërbyer këta "të shkretë" para se të "zgjohet" Shaqir Fetai! Kush i shërben këta xhematlinjë jasht Muajit të Ramazanit, a funksionojnë xhamitë apo jo, ose, vetëm gjatë Ramazanit funksionojnë xhamitë tona që kanë nevojë për shërbimin e "kuadrit" të Shaqir Fetait? Ky sa herë të flasë meriton gojës "papuçe të kupatillës"!

Shaqir Fetai na qenka habitur! Ndonëse popullata jonë po ikë nga vendi i vet si pasojë e hajnave të tipit të Shaqir Fetait, ai kësaj radhe është habitur se si xhamitë kanë qenë plotë! Do me thënë ai konstaton se hala paska mundësi të ikë popullata jonë, derisa të përgjysmohen xhamitë!

A ka qenë ndonjëherë Shaqir Fetai nëpër xhami gjatë Muajit të Ramazanit! A ka zbritur ndonjëherë në Shkup e të shohë se si janë bllokuar edhe rrugët qendrore gjatë faljes së teravisë. A ka dalur më herët nëpër xhami e të shikojë se çfarë atmosfere mbretëronte nëpër xhamitë e Shkupit gjatë Muajit të Ramazanit!

Megjithatë, Shaqir Fetai rrenë, bënë politikën e atyreve që e fshehin shpërnguljen masovike të myslimanëve të vendit. Shaqir Fetai nuk e tregon të vërtetën, apo, nuk ka pasqyrë se si ka qenë më herët ndaj dhe nuk mund të tërheqë paralele por, i mjafton që xhamitë për Ramazan paskan qenë plotë! Rrenë, sepse, ka xhami nëpër qytetet e ndryshme, madje ka pasur xhami në Shkup që kësaj radhe nuk ka pasur më shumë se dy-tre safe, sepse, nuk

kanë pranuar që të falen pas “imamlerëve të ideologjizuar” të Shaqir Fetait. I kan bojkotuar lutjet fetare, sepse nuk kanë dashur që të ndikohen dhe të devijojnë nga praktikimi i islamit ashtu siç e kanë trashëguar qysh nga vitet e para të Pushtetit Osman! Ata nuk i pranojnë “imamlerët” e Shaqir Fetait të cilët dekretohen prej këtij farë avdalli, sepse, i duhen, pa tipat e tillë nuk mund ta përfundojë misionin – përçarjen dhe dezorientimin e xhematlinjëve tanë! Shaqir Fetai deri në këtë Bajram nuk paska pasur kurrfarë pikëtakimi me atmosferën e Fitër Bajramit gjatë viteve të mëparshme! Ai as nuk di ndaj dhe as nuk mund të mbajë në mend se si ka qenë më herët! Ai e kujton “pamjen imponante” vetëm të ditës së këtij Fitër Bajrami, pamje kjo që as për së afërmi nuk është si ajo e para 30-25-20-15-10 viteve të fundit! Në krahasim me pamjet dhe atmosferën e më hershme, kjo e këtij Fitër Bajrami të cilës i gëzohet Shaqir Fetai, është e mjerë, është e dhimbshme, është e trishtueshme.

Shaqir Fetai ka bindjen se “ka formuar një ambient të jashtëzakonshëm”! I gjori ia merr mendja se është magjistar! Ia paska dalur që të shikojë fytyrat e të gjithë xhemateve tona, paskan qenë të lumtur e të buzëqeshur, kjo për faktin se ai dhe honxho-bonxhot e tij paskan formuar “ambient të jashtëzakonshëm”! Kjo nuk është shkurtpamësi! Kjo nuk është vetëm përpjekje për ta deformuar realitetin e mjerë në terren, kjo është, mbi të gjitha, kënaqësi e brendshme e Shaqir Fetait që ia ka arritur ta dezorientojë xhematin tonë, ndaj, mosshkatërrimin total të BFI-së ai e konsideron “ambient të jashtëzakonshëm, imponant”! Kjo është pasqyra psikike e Shaqir Fetait që reflekton misionin mercenarik të tij! Ai i shënjëzoi sidomos dy shtresa: shtresën intelektuale dhe atë studentore (jo-intelektuale!), të cilët masovikisht i paskan mbushur xhamitë, do me thënë, akoma janë këtu, akoma nuk kanë ikur që të gjithë! Mision i djallit ky i Shaqir Fetait! /Kombetare/05.05.2022

Shaqir Fetai e keqinterpreton dashurinë dhe respektin e popullatës (4)

(Në paraqitejn e vet të fundit në opinion, përmes një “interviste” në një televizion nacional, Shaqir Fetai, veç të tjerash, mundohet të na rrëfejë se si po e dashkëkan tepër shumë myslimanët e vendit. Mbi njëmilion myslimanë (!) po “vdiskan” për të! Atëherë pse përhap lajme se ndjehet i kërcnuar? Nga kush? Në vazhdim do ta analizojmë përgjigje për përgjigje)

Nga Demir Zimeri

Për herë të parë përmes kësaj paraqitje opinionit merr vesh se dikush na e paska kërcnuar Shaqir Fetain? Po pse të kërcënohet? Nga kush të kërcënohet? Pse nuk del me emër e mbiemër? Kush e ka kërcënuar? Natyrisht, askush, porse, meqë ky e ndjenë veten se gjithnjë e më shumë po bëhet i padëshirueshëm si instalacion i pushtetit maqedonas, meqë ndjenë se diku do t'i tëkërlitet shalli, atëherë kërkon mbrojtje fizike, siguri policore!

Dhe, tani, meqë qenka i siguruar nga policia maqedonase, Shaqir Fetai si “qura në mjegull” del dhe krekoset nëpër xhemat, të porositur që të dalin e ta presin! Shkon në një katund me 1500 banorë, ndërsa dalin dhe e presin nja 30 persona (le të jenë edhe 200!) dhe ky pastaj ta trajtojë si “atmosferë imponante”, “pritje e ngrohtë vëllazërore” etj. Janë xhemat i stisur, i porositur, i përbërë

nga pjesëtarë të familjeve të mëdha me të cilët i lidhë ndonjë interes meskin, ata dhe Shaqir Fetain!

Ku po shkuaka Shaqir Fetai po u formuaka (!!!) “ambient madhështor”! Po pse, Shaqir Fetai, gjatë muajit Ramazan, nuk ishte asnjë sekond, bie fjala, në terrenin e Myftinisë së Kumanovës, edhe pse rrenë dhe thotë se ishte?

Shaqir Fetai keqpërdor edhe televizionin nacional për të dëshmuar se është në “union” me Sulejman ef. Rexhepin për sa i përket vlerësimit të numrit të myslimanëve në Maqedoninë e Veriut.

Efendi Rexhepi gjithnjë ka këmbëngulur që në këtë shtet jetojnë më se 1 milion myslimanë dhe se kurrë nuk ka pranuar kurrfarë statestike dhe as vlerësimesh “zyrtare” që i kanë nxjerrë myslimanët e vendit nën 1 milion! Statistikat e fundit zyrtare, të cilat nuk i komentoi i vetëm Shaqir Fetai, myslimanë në vend nuk nxjerrin më shumë se 700 e ca mijë! Kurse Shaqir Fetai thotë se vlerësohet dhe pritët “ngrohtësisht” nga më shumë se një milion myslimanë në vend (këtë nuk e nxjerr nga goja si konstatim dhe si analizë e tij apo institucionit të tij, por e nxjerr si “gafë”!

Respektin e myslimanëve të vendit ndaj BFI-së si Institucion dhe ndaj institucionit hoxhë, Shaqir Fetai nuk guxon ta keqpërdorë dhe të manipulojë se ja, sa po e duakan! Nuk ka shqiptar në Maqedoninë e Veriut, nuk ka mysliman në këtë shtet që e do një recidivë të UDB-së, që e do një mynafik, që e do një tradhëtar dhe një ngulës të thikës pas shpine! Këtë e di edhe Shaqir Fetai, prandaj, pikërisht në këtë njohje të personalitetit të vet, ka bazën ajo frikë e tij se do të sulmohet ndonjë ditë dhe se, më mirë është që të ruhet dhe të sigurohet. Me këtë gjest Shaqir Fetai ka vulosur shoqërinë tonë myslimane si “shoqëri ekstremiste” prej së cilës duhet të ruhet me polici! Një teolog i pahipotekuar, i pa ngarkuar me djallëzira e me spiunllëqe, me akte amorale e me shigjetime të eprorëve të vet, nuk ka pse të kërkojë mbrojtje policore, sepse, natyrisht që ai duhet dhe respektohet prej të gjithëve!

Në mesin e myslimanëve, dikur, po të futej edhe një udbash, “të gjithë” dilnin e pritnin, me flamuj e me lule, sepse kjo ishte porosi e prerë, duhej të respektohej “instucioni” ndonëse urrehej personi! Myslimanët sot e respektojnë Institucionin hoxhë, kurse Shaqir Fetai antihoxhë, e keqpërdorë këtë mirësjellje dhe e paraqet si dashuri e respekt “të maaadh” që paska xhemati për të!

Shaqir Fetai qenka habitur për të mirë sepse në “lëvizjet e tij gjatë Ramazanit” xhematlinjtë e paskan pritur mirë, në çdo xhami ku

qenka futur! Po çka paska pritur Shaqir Fetai, të zhgënjehet, të dëbohet apo edhe ta hajë ndonjë shqelëm bythës në xhami! Shkupjanët kur shkojnë në xhami ata shkojnë për t'u lidhur pas imamit e për t'iu dorëzuar tërësisht Zotit, pra, ata në xhami shkojnë për atë lidhshmëri të shenjtë në mes të tyre dhe Zotit të tyre, e nuk shkojnë për ta pritur apo për ta zhgënjyer Shaqir Fetain! Ky po që është tërësisht i shkalluar nga trutë!

Xhemati i Kavadarit qenka nderuar shumë me prezencën e avdallit në mesin e tyre, paska qenë ëndërr që ta shohin “reisin” e tyre! Po sa herë ka qenë në jetën e vet Shaqir Fetai në mesin e kësaj “pakice myslimanësh” në Kavadar? Po pse kjo ëndërr kaq e gjatë? Sepse po lëvizkëka shumë, çdo ditë Gostivar-Shkup dhe anasjelltas! Po le të dalë në opinion Shaqir Fetai dhe le t'ua tregojë myslimanëve të vendit se cila është ajo shumë nga fitrat e tyre që ia mbulon këtë lëvizje të kotë Shaqir Fetait! Çdo ditë minimum nga 100 euro, ardhje nga Gostivari në Shkup, për të pritur dashamirë të çajit që ky duhet t'u japë “dekoracione” kot e kot, që ky t'i takojë bashkëveprimtarët e vet në rrënimin ditë e nga pak të Institucionit të BFI-së, që ky ta dezorientojë xhematin mysliman, edhe atë, duke filluar nga Shkupi (ndonëse dhe më herët u përpoq që ta destabilizojë nga Tetova dhe Kumanova por që nuk ia doli!!!)

Përgjigjen e rrumbullakson me një përpjekje për ta fshehur një krim për të cilin Shaqir Fetai gjithësesi që do të përgjigjet! Thotë se, ndjehet shumë i lumtur që në vitin 2021 e paska stabilizuar ekonomikisht BFI-në! Po si e stabilizoi kur dihet që fitri dhe zeqati ishte përgjysëm më i vogël në krahasim me vitet e më parshme, për të cilat Shaqir Fetai thotë se kanë qenë vite të krizave të rënda ekonomike si pasojë e keqmenaxhimit dhe hajnisë, ndonëse i ka legjitimuar dhe përkrahur që të gjitha dukuritë e shëmtuara vetë Shaqir Fetai!

Shaqir Fetai, letrat në vlerë, të dhëna përgjatë procesit të decentralizimit të vakëfit, i quan “stabilitet ekonomik”! Janë me miliona euro, që pushteti i cili e instaloi, ia dha pikësisht këtij që ky t'ia dalë ta blejë mirëqenien në BFI! Shaqir Fetai me ato para deri më sot nuk ka blerë asnjë centimetër katror vakëf të ri. Aktet normative të BFI-së por edhe parimet islame thonë se vakëfi mund të tjetërsohet e të shitet vetëm për një vakëf më të mirë! Sa vakëf shtoi Shaqir Fetai në Shkup? Sa para i mori? Ku i la ato para? Kjo është “mirëqenie ekonomike”? Kjo është grabitje, Shaqir Fetai dhe, për këtë grabitje pa dyshim që një ditë do të ketë përgjegjësi

penale! Myftinia e Shkupit deri më sot është dashur të pajiset me mijëra e mirjëra metra katëror në objekte dhe jo në fusha djerrina ku as djalli nuk i bën vezët! Paratë e vakëfit i hëngër Shaqir Fetai, e bleu “mirëqenien” dhe “revoltën” e të tjerëve. Por, çka do të bëjë tani kur do t’i shpenzojë të gjitha letrat në vlerë?! Do me thënë, do të dorëzohet para revoltës masovike të hoxhallarëve dhe të opinionit, e! Kjo do ta gjejë shumë shpejt hipokritin!/Kombetare/06.05.2022

Xhemati pa lidhje, pyet gjëra palidhje! Kjo e nervozon Shaqir Fetain (5)

(Shaqir Fetai në vazhden e një “interviste” në një televizion nacional, veç tjerash përgjigjet edhe për “premtimet” që i paska dhënë kur u instalua nga pushteti maqedonas në krye të BFI-së. Ndonëse insiston në pyetje nga xhemati për çdo gjë që u intereson atyre, ja që xhemati nuk interesohet por shtron pyetje palidhje! Kështu pallamudë Shaqir Fetai! Në vazhdim do ta analizojmë përgjigje për përgjigje)

Nga Demir Zimeri

A është në vijë të asaj që e paska premtuar Shaqir Fetai kur u instalua nga qarqet antiislame në krye të BFI-së, kur BFI-ja u bë për herë të parë në historinë e vet me “reis” të instaluar nga qarqet që nuk ia duan të mirën as fesë dhe as kombit! Jo se qenka në vijë të plotë por, ai gjithkund, në çdo takim me xhematin, po e lutkëka që të pyesin gjithçka që u intereson atyre si dhe të kërkojnë që të ofrojnë propozime e projekte që të përmirësohet jeta fetare në Maqedoninë e Veriut. Madje edhe jashtë, e paska provuar këtë gjë! Këto ditë paska qenë gjithandej nëpër botë, në Itali, në Zvicër (dhe, këtu përfundon bota e Shaqir Fetait, në pjatën e “qevabçiqi”!) dhe, pas çdo ligjerate që i paska mbajtur ai, paska instituar që të pyetet nga xhemati për çdo gjë që u intereson atyre! Por, ja që, xhemati, si duket palidhje, nuk pyet gjëra çfarë pret Shaqir Fetai por, pyesin gjëra palidhje!

Shaqir Fetai nuk do të bindet se xhemati e lexon dhe e njeh më

mirë se sa që pretendon se e njeh ai vetëveten! Xhemati e nuhat se Shaqir Fetai flet sikur i dehur, flet si i përhanë, flet kopalla dhe, xhemati bindet se ai nuk di gjë por vetëm “verglletë” pallavra! Xhemati nuk dëshiron që ta vërë në pozita të rënda injorantin dhe hipokritin që nuk ka lidhje me atë se çfarë flet! Prandaj, edhe xhemati luan “mastrapalla” me Shaqir Fetain, duke e pyetur gjëra krejt palidhje! Shaqir Fetai edhe nuk mund ta kuptojë veten se është totalisht duður edhe ofendon se pse xhemati nuk ia provokon “intelegjencën” por e lodhin me gjëra të kota! Kjo qetësi totale paska depërtuar edhe te xhematlinjtë tanë, thotë Shaqir Fetai! Qetësi totale i duket kjo! Mosreagimi i myslimanëve për instalimin e tij nga qarqet antiislame i duket qetësi totale! Ndërsa po vlon, brenda BFI-së po vlon, janë shfaqur grupe e grupacione, secili tërheq kah vetëvetja, secili refuzon, bojkoton e shantazhon njëri tjetrin, xhamitë po i rrëshqasin nga duart, xhemati gjithnjë e më shumë po defunksionalizohet dhe po dezorientohet tërësisht! Dhe krejt kjo, Shaqir Fetait i duket heshtje totale!

Megjithatë, kur myslimanët (në veçanti shqiptarët) e Maqedonisë së Veriut kanë reaguar kundër një kuadri që e ka emërtuar pushteti politik në çfarëdo pozite? Kur shqiptarët e këtushëm kanë refuzuar apo janë ngritur kundër një kuadri të emërtuar pa dëshirën dhe pa miratimin e tyre? Asnjëherë, sepse, gjithmonë kanë qenë të shtypur e të keqtrajtuar nga pushtetet antishqiptare, kësisoj, nuk kanë reaguar as kundër çfarëdo caktimi të personave në krye të tyre. Thjesht, me mjeshtri e kanë refuzuar! E kanë pritur, e kanë gostitur, i kanë buzëqershur por, thjesht, e kanë injoruar. Nuk i kanë shtruar pyetje që u ka interesuar atyre, por e kanë pyetur, për shembull, për lakrat e Radivojcit, për specat e Presillës etj. Shqiptarët mezi kanë pritur qetësi dhe rehati nga pushtetet antishqiptare.

Me gjasë, Shaqir Fetai do ta thyej këtë traditë! Do të bëhet viktimë e parë e protestave myslimane me qëllim që pushteteve t’u bëhet me dije që kurrë më mos të provojnë që popullit mysliman dhe popullit shqiptar t’ia imponojnë si “gomarin në krye të karavanit me deve”!

Kjo heshtje totale e myslimanëve, sipas Shaqir Fetait, qenka shpërblyer me 68 për qind të hyra më shumë se një vit më parë në arkën e BFI-së! Nga hynë këto të ardhura? Nga lumturia e xhematit? Ngase xhemati shumë të kënaqur me Shaqir Fetain dhe,

hajde, thanë, ta darovisim Shaquan, me sa më shumë para! Po pse rrenë Shaqir Fetai? Pse rrenë sa është i rrumbullaktë! Pse nuk e tregon të vërtetën se, ato të hyra ishin kryekëput nga denacionalizimi i vakëfit të Shkupit, i cili, i ktheyer në letra me vlerë, gati gjysmën ia mori Shaqir Fetai, si shantazh për këtë kthim! Shaqir Fetai, meqë është njeri i pushtetit maqedonas, meqë po ia arrinë që t'i marrë ato letra me vlerë të cilat duhej të jepeshin që nga viti 2010, ai ua merr haraçin myftinive për këtë pelivanllëk dhe, thotë pastaj, shikoni sa më do xhemati, për 68 për qind më shumë. Dashurinë e xhematit Shaqir Fetai e llogaritë me para: sa më shumë para, dashuria aq më e madhe dhe, nuk e llogaritë këtë "dashur" si përgjigje ndaj obligimeve fetare që e ndjenë xhemati. Fakti që niveli i pagesës së fitrit dhe zeqatit në BFI ka një rënie të dukshme kjo nuk do të thotë se po bie dhe dashuria e xhematit, sepse xhemati është i kujdesshëm që me paratë e veta mos ta trashë edhe më shumë haramin, mos t'ia krijojë mundësinë Shaqir Fetait që të tallet me djersën e xhematit. Edhe diçka, po pse bëhët kaq pis burrë dhe nuk e pranon se gjatë viteve të krizës, si pasojë e koronavirusit, Shaqir Fetai është paguar nga buxheti i shtetit? Kanë hyrë qindra mijëra euro në BFI pas kërkesës këmbëngulëse të Sulejman ef. Rexhepit që me rastin e mbylljes së xhamive të paguhen të gjithë hoxhallarët, me rrogë, nga paketat ekonomike që i përgatiste shteti si ndihmë sociale për organizata, firma e subjekte të ndryshme të vendit, që prekeshin më së shumti nga Kovid 19! Këto, pra, janë ato para të cilat Shaqir Fetait ia kanë rritur buxhetin për 68 më shumë se në vitet e kaluara! Shërbimi paguhet, normalisht! Paguhet edhe instalacioni i pushtetit, i cili nuk guxon të dështojë, sado që mund të kushtojë kjo përzierje e ndytë e pushtetit politik në institucionet fetare. Në një intervistë të parafundit Shaqir Fetai vetë pranon (si avdall) se shteti tash e gjashtë muaj po i ndihmon financiarisht! Thotë se BFI vitin që e lamë pas e ka kaluar pa fije borxhi! I ka hije të rrejë një "hoxhë"?! Po objekti i ish-selisë së Muftinisë së Shkupit! A nuk është në hipotekë bankare për një borxh të madh ë? Po mospagimi i sigurimeve pensionalo-invalidore ndaj hoxhallarëve, a nuk është edhe ky një borxh i trishtueshëm ! Po borxhi i tmerrshëm në ujë e në rrymë si dhe në pastrim higjienik. Apo këto nuk i llogarit borxhe Shaqir Fetai por, borxhe i llogaritë vetëm pagesat e honorareve të majme si dhe të mëditjeve që i vinë duke shëtitur b... poshtë e lartë krejt në emër të BFI-së?!

Në mungesë të këtj borxhi, Shaqir Fetait po u hapkan dyert drejt realizimit të programeve! Aman, plasi, vdiq opinionin e gjërë që të njohtohet vetëm me fjalën “program” të programeve të Shaqir Fetait! Kurrë nuk ia tha opinionit se kush janë ato programe, si duken ato programe, sa janë të kushtueshme ato programe, kush janë menaxherët e atyre programeve, ku realizohen ato programe... Heeej kaq shumë paska dalur i susesshëm, madje ballëllartë po i shkuaka xhematit “ja ku jam para jush” që t’ju falënderoj për kontributin e juaj për mirëmbajtjen e Medresesë Isë Beu me katë nëndegët e saj (nacion partiak!), për mirëmbajtjen e mbi 800 xhamive si dhe të 1200 nëpunësve të BFI-së! Po më herët si ka qenë vallë? Nuk ka qenë po ky xhema donatori i vetëm i zhvillimit dhe avancimit të jetës fetare? Apo, krejt kjo po ndodhkëka vetëm në kohën që kur u instalua Shaqir Fetai nga qarqet antiislame në krye të BFI-së!

Shaqir Fetai ashtu siç është shembulli më tipik antiislam, ashtu edhe përçon shembull më antiislam! Shaqir Fetai u desht që të tradhëtojë, që t’i rrejë bashkëveprimtarët e vet dhe, krejt në fund, u desht që t’ia fusë thikën pas shpine njeriut më meritues për “karrierën” e tij dhe, tashti nis e mburret se si po i shkoka vaj në sferën ekonomike! Do me thënë, mundohet ta imponojë shembullin më të poshtër – gjithkush që dëshiron ta ketë krejt vaj, duhet që të tradhëtojë, të spiunojë, të bëjë vepra kriminale! Shaqir Fetai e përçon këtë mesazh fare pa u frikësuar se dikush mund ta trasojë rrugën e tij dhe ta spostojë nga kolltuku, sepse, ai ka nevojë që mos të ngelë vetë në historinë e BFI-së, mos të ngelë ky shembull i turpër dhe i mëkatit porse në këtë vorbull dëshiron të tërheqë sa më shumë!

E vemtja detyrë e Shaqir Fetait qenka që të dalë para xhematit dhe t’i falënderojë ata për këtë kontribut! Nuk po kërkuaka asgjë nga xhema, ai po dilkëka para tij për falënderime! Sërish po rrenë, sepse ai nuk del para xhematit, ai kurrë nuk falënderon, ai është hipokrit, ai del me plane mirë të paramenduara: kryerjen e “namazit” dhe ikje në “çerdhen” e vet, ose, kur është i sigurtë me xhemin (që është i sojtë i tij) e shtron paksa muhabetin edhe më gjatë!

Falënderimet e BFI-së, e të gjitha organeve të Institucionit janë të përjetshme ndaj xhematit, për çdo kontribut të tyre madje edhe portiri më i fundit falënderon “Zoti kabull ua bëftë”, “Zoti sevap ua shkroftë”, “Zoti ju pafte me të mira e ua shtoftë bereqetin”, “Zoti

gjithmonë ju dhashtë”... Pra, BFI-ja nuk e pret Shaqir Fetain që të “falnderohet” ku t’i teket atij por, ky falënderim është i nënkuptueshëm edhe fare pa ekzistuar Shaqir Fetai.

Vetëm një hipokrit si Shaqir Fetai, vetëm një faqezi si ky mahluk mund të thotë se gjërat janë “transparente” se, çdo gjë regjistrohet dhe se çdo gjë e di xhemati! Pse a Shaqir Fetai po e kaluaka ditën duke raportuar për shpenzimet ditore të BFI-së? Po ku e raporton këtë gjë, sepse, një është më se e sigurtë, para xhematit kurrë nuk ka dalur me asnjë pasqyrë financiare, me asnjë llogari përfundimtare, kurrë! Një Zot e di se ku mund të raportojë!

Unë, edhe tani u them xhematit, thotë Shaqir Fetai, urdhëroni, pyetni! Por, kur u vendos që të pyetet kësaj radhe në Zvicër, sapo e hetoi se puna ishte shumë serioze, u detyrua të ikë dhe ta shkurtojë axhendët e vet për katër ditë më herët! Ndërsa, nga ana tjetër, krejt bota e di se Shaqir Fetai tmerrohet nga debatet publike, shashtiset me ba e me e detyru dikush të dalë në një debat televiziv me oponentin e tij, e cila, është me fakte e argumente po aq sa është i rëndë vetë Shaqir Fetai! Transparencë sot llogaritet debati publik dhe jo, rrenat se ky po shkuaka xhami më xhami duke i njohtur xhematlinjtë me atë se çfarë ndodhë në BFI.

Po ta dinë xhematlinjtë se çfarë ndodhë në BFI do të ishin lodhur duke e pështyrë në fytyrë, ashtu siç po lodhen duke ia sharë emrin e shallin!/Kombetare/06.05.2022

Shaqir Fetai si pejgamberët e Zotit ndaj të cilëve qenka shpikur shumë!!! (6)

(Në ditën e Fitër Bajramit, si rekapitulim të “aktiviteteve” gjatë Ramazanit, Shaqir Fetai pati një paraqitje në një televizion nacional në RMV, ku veç tjerash u mundua të flasë mbi atë se çfarë ka ndryshuar me instalimin e tij në krye të BFI-së nga qarqet politike maqedonase. Vazhdon analizimi i kësaj pseudo-bisede, përgjigje për përgjigje)

Nga Demir Zimeri

Shaqir Fetai thotë se çdo strukturë e re që vie ka strategjinë e vet! Po cila strukturë e re na erdhi me instalimin e Shaqir Fetait në krye të BFI-së? Shaqir Fetai as që i bën hesap të tjerët! Strukturë e re ai e konsideron vetëveten, ndërsa se cila është strategjia e tij, dëshmon veprimi i tij i deritanishëm – shkatërrimi deri në themel i BFI-së, devalvimi i tërë asaj tradite më se tridekadëshe që e mbajtën BFI-në në krye të Institucioneve më të rëndësishme në shtet. Pati vetëm një strategji të vetme: ta devalvojë BFI-në, rolin e saj në shumë çështje kombëtare dhe, pikësynimet e Institucionit përgjatë zhvillimit të jetës fetare islame, e që ishte ruajtja e islamit tradicional dhe mbyllja e të gjitha poreve prej nga në trungun e unitetit të myslimanëve, si pyka, mundoheshin të futen levizje sektariane e “islame” të ideologjizuara. Sot, ky trung, mjerisht, është përplotë me pyka, të cilave hizmetin ua bën vetëm Shaqir Fetai!

Shaqir Fetai e paska zhvilluar transparencën si dhe për herë të parë lirinë e mediave duke kërkuar prej tyre që ja, le të urdhërojnë e të pyesin çfarë të duan.

Janë dhjetra portale, dhjetra mjete të informimit kombëtar e ndërkombëtar, që Shaqir Fetain e pyesin:

- Pse nuk del në debat televiziv?
- Pse nuk tregon se kush e instaloi në krye të BFI-së?
- Pse nuk tregon se cili ishte ai çmim për thikën që ia nguli pas shpine ish-reisit të vet, të cilin deri një natë para komplotit e lavdëronte duke e ngritur në kupë të qiellit?
- Sa centimetra katëror bleu për ta shtuar vakëfin e Shkupit nga paratë që i mori prej shtetit si dëmshpërblim nga denacionalizimi i pronave të BFI-së?
- Çka u bëri këtyre lekëve? Ku i la? Si i shpenzoi? Sa para i dha shteti si ndihmë financiare që të nisë të mbarën pas komplotit dhe tradhëtisë që e bëri?
- A është e vërtetë se ai ka qenë mjet përpunimi nga UDB-ja që kur ishte në shkollë të mesme?
- Kur do ta ngrisë përmendoren të cilin ia premtoi misionarit të Putinit që e pati në zyre?
- Cili është kontributi i tij në regjistrimin e disa “komuniteteve fetare” që me të madhe po ushtrojnë ndër ne “islam” të ideologjizuar?
- Cilat janë reformat që i bëri në bashkësinë “fetare” të tij që e dallojnë dukshëm nga BFI-ja e H. Sulejman ef. Rexhepit?
- Kush po e mban peng dhe nuk po e lënë të bëj reforma të thella dhe gjithëpërfshirëse në BFI?
- Pse opozita e tij është makthi më i tmerrshëm i gjumit të tij?
- Sa e ka dëmtuar financiarisht BFI-në duke shpërndarë “dekoracione” turlifarë njeriu që vjen dhe e uron për kolltukun që e ka vjedhur?
- Pse Shaqir Fetai nuk mund të funksionojë asnjë sekond pa gënjyer?
- Pse Shaqir Fetai është me një shpirt të djallëzuar i cili nuk mund të jetë karakteristikë kryesore e një teologu? Etj. etj.

Ky vërtet ka lajthitur fare? Thotë se paska dhënë një kontribut të “moooth” në tejkalimin e koronavirusit! Ky me gjasë paska pasur ndonjë laborator ku paska shpikur ilaçe e shërim tak-fak të virusit!

I shkreti vetëm ai i është nënshtruar masave të marra nga OBSH si dhe nga trupa qeveritare për realizimin e masave shtetërore për parandalimin e kësaj sëmundje! Shaqir Fetai mendon se ka kontribut të madh në këtë tejkalim të kësaj krize? Shaqir Fetai sigurisht që do të thotë se ka kontribut të madh edhe në mundjen e Real Madridit kundër Mançester Sitit! Ky është i bindur se projekti TAP është ekskluzivisht sukses i tij! Kështu mund të mendojë vetëm një i lajthitur si Shaqir Fetai! Vetëm ky i paska parë dy-tre komisione nga shëndetësia botërore që e paskan vizituar dhe i paskan shprehur falënderimin për kontributin në tejkalimin e koronavirusit.

Shaqir Fetai qenka lavdëruar dhe, madje edhe vetëlavdërohet, për kultivimin e dialogut ndërfaqetor në Maqedoninë e Veriut! E vodhi BFI-në, e demoloi deri në bubërrec, ia zhduku tërë atë peshë dhe atë rol në shoqëri, ia mbylli gojën duke e zbutur deri në mumie BFI-në, e cila, sot, po sulmohet, po gërryhet, po njolloset deri në shkatërrim total! A e di Shaqir Fetai se ku ka qenë BFI para se ta uzurpojë ai dhe ku është tani? Shaqir Fetai për momentin mund t'ia bëjë qejfin vetes, të përjetojë orgazëm truri, por ama, assesi nuk do të mund t'i ikë përgjegjësisë për faktin se në ç'derexhe e solli Institucionin tonë! Honxho-bonxhot e tij shumë shpejt do ta shohin veten të zbërthyer në faqet e librit të H. Sulejman ef. Rexhepit që është nga fundi dhe që do ta dridhë mbarë opinionin! Do ta shohë Shaqir Fetai se cili ishte roli i tij dhe se çfarë bëri me “ekipin” e tij të shantazhuar e të dirigjuar nga shërbimet inteligjente të ndryshme: maqedonase, serbe, ruse, turke, bullgare etj.

I gjori flet për “një sërë” takimesh që paska me korin diplomatik në vendin tonë, që nga ambasada e SHBA-së, BE-së, OSBE-së etj. Shaqir Fetai nuk është në gjendje të kuptojë takimet me karakter bashkëpunimi, takimet me karakter “investigativ”, takime me karakter sugjerues (vinë e të rrahin dajak duke të sugjeruar që kah të ecësh dhe cilat veprime t'i harroshë përjetë)! Shaqir Fetai nuk e ka atë kapacitet të trurit që t'i kapë mesazhet e ndërkombëtarëve. Ai ata i sheh si subjekte të mahnitur me “punën” e Shaqir Fetait të cilin vinë dhe e përgëzojnë! Vizitat ai i percepton dhe i interpreton si përgëzim! Mbi 90 për qind e viziave të ndërkombëtarëve realizohen për ta dedektuar problemin nga dora e parë, për ta investiguar problemin përmes dy-tre pyetjeve që i shtrojnë te “i pari” dhe për të dhënë këshilla se si është më së mbari të veprohet! Të gjithë e dinë

që Shaqir Fetai nuk mundet të veprojë sipas këshillave ndërkombëtare, sepse nuk e lënë shërbimet ku është ngulur, i mjeri ai!

Jo more! E keni dëgjuar Shaqir Fetain të fliste më herët si në këtë pyetje? Shaqir Fetai nuk e paska gjetur pa infrastrukturë një BFI, e paska gjetur një Institucion të fuqishëm që e paska ndërtuar ish-reisul ulema (tmerrohet t'ia zë emrin në gojë! I bie pika nga frika!) në të cilin rrugëtim bashkë me të paska qenë dhe vetë ai! Po atëherë, ç'ju desht që t'ia ngulë thikën pas shpine? Kush i tha që ta "vrasë" Sulejman ef. Rexhepin! Nëse ka bërë ndonjë gaf të rëndë fetar e kombëtar, atëherë, në atë rrugëtim të gafeve bashkë me të paska qenë edhe Shaqir Fetai! Si mundet që Sulejman Rexhepi të jetë "ujku" ndërsa në udhëtim me të, Shaqir Fetai të jetë "qengji"?! Po Sulejman ef. Rexhepi e paska themeluar Medresenë, paska themeluar dhe ndërtuar Fakultetin e Shkencave Islame, paska hapur pesë paralele të Medresesë Isa Beu, e paska bërë edhe "renovimin e kuadrove të ndryshëm" (hahaha, çfarë fjalie idiotike)! Thënë shkurt: Shaqir Fetai nuk e paska gjetur një BFI ku nuk do të mund t'ia dilte! Por, meqë paska qenë koha e krizës ekonomike si dhe koha e krizës së kovidit, e paska gjetur BFI-në si një "anije që luhetet"! Tha shumë çka Shaqir Fetai, veçse assesi t'i dalë nga goja se cili shërbim intelegjent e futi në këtë lojë!

Shaqir Fetai rrenë sa është i trashë kur thot se në BFI nuk ka përçarje! Në fakt, sot, në BFI funksionojnë ter grupe, të cilët as që duan t'ia dinë për Shaqir Fetain, ndërsa jashtë Institucionit ka dhjetra xhami që funksionojnë krye më vete dhe për vete, që nuk kanë të bëjnë asgjë me BFI-në e që motivohen nga djallëzitë e Shaqir Fetait! Shaqir Fetai nuk paska kohë të merret me media e me portale që po shkruakan kundër tij! Të gjitha portalet e mediat qenka idiotë që merren me Shaqir Fetain! Do të merren e do ta krijojnë opinionin, sepse, kjo është puna e portaleve dhe mediave kombëtare, të cilat Shaqir Fetai nuk mund t'i blejë me paratë e fitrit. Shaqir Fetai me hipokrizinë e vet nuk mund të bëjë asnjë faqe të historisë, historinë do ta bëjnë portalet e mediat, pa dyshim! Shaqir Fetai e pranon se kundër tij paska shumë "shpifje", ngjashëm si dikur që paska pasur edhe për të dërguarit e Zotit Mëshirëplotë! Pra a mund të jetë shpifje konstatimi i Shaqir Fetait se qenka ngjashëm si pejgamberët e Zotit në shënjestrën e kritikës! Le të dalë në debat publik dhe le t'i kundërshtojë një për një të gjitha ato "shpifje e ofendime" që i bëhen! Po sikur në atë debat të

shpalosen edhe më shumë dokumente, fakte e argumente që flasin për prishurinë e tmerrshme të Shaqir Fetait? Kësaj i druhet Shaqir Fetai, dhe jo se nuk dëshiron të bie në nivel të “shpifësve”. E di luga çka ka vekshi!/Kombetare/07.05.2022

Shaqir Fetai mbështetës institucional i përçarjes, radikalizmit, ekstremizmit...(7)

(Në një bisedë të niveli adoleshent, në një televizion nacional, Shaqir Fetai flet edhe për atë se a i ka të gjitha xhamitë nën kontroll dhe se a ka estremizëm e radikalizëm ndër myslmanët e Maqedonisë së Veriut! Me këtë bisedë ai në fakt e dëshmon hipokrizinë e tij si dhe dëshmon se nuk është në tokë të bukës. Ne do të vazhdojmë t'ia analizojmë përgjigje për përgjigje atë farë pseudo-interviste)

Nga Demir Zimeri

Shaqir Fetai thotë se 99 për qind të xhamive i paska nën kontroll, ndërsa as që guxon të futet në të ashtuquajturat “xhami provinciale”! Një për qind e 800 xhamive bëjnë tetë! Shaqir Fetai deklaroi se të paktën 8 xhami nuk i ka nën kontroll! Po pse? Nuk e njohin? Janë radikalistë e ekstremistë? Janë objekte ku ushtrohet “islami” i ideologjizuar? Si u bë që nga koha e H. Sulejman ef. Rexhepit kur jashtë kontrollit ishin vetëm 4 xhami, sot na qenkan shtuar në tetë! Shaqir Fetai, jo vetëm xhami, por nuk ka nën kontroll as organe e ente të BFI-së!

Shaqir Fetai e përmend me nonshalancë se një xhami (që nuk qenka xhami por objekt!!!), në Kumanovë nuk qenka nën kontroll dhe se po funksionuaka për vete, dhe pse Shaqir Fetai dhe bashkësia “fetare” e tij qenkan që të gjithë të veprojnë nën ombrellën e BFI-së, pa çka që mund të jenë vetë trishtimi dhe turpi i BFI-së! Nuk është me rëndësi veprimi i këtij “grupacioni”,

me rëndësi është që të futen nën ombrellën e “bashkësisë fetare” të Shaqir Fetait dhe mos t’ia turbullojnë ujin deri sa të dalë ky në pension dhe, pastaj, nesër, copa u bëfshin! Kjo është strategjia e Shaqir Fetait, i cili, erdhi mbi shkeljet flagrante kushtetutare, që po “funksionon” mbi këto shkelje kushtetutare dhe që i bëhet shumë qejfi që të shtohen subjektet që nuk do të pranojnë kurrfarë norme juridike të BFI-së.

Shaqir Fetai thotë se paska reaguoi për një “bashkësi fetare” që e paska regjistruar një gjyqtare maqedonase! Në fakt, kjo “bashkësi” që kur është regjistruar nuk ka tejkalluar forcën e “bashkësisë” individ, i cili, tërësisht është pasiv! Po a e tha ndonjë fjalë e ndonjë reagim Shaqir Fetai për “bashkësinë fetare të sunetit dhe xhematit”? Nuk e tha asnjë fjalë sepse, sipas tij, edhe ish-reisi paska bashkëpunuar me themeluesin e kësaj “bashkësie”? Shaqir Fetai rrenë, pa pikë turpi rrenë, sepse ish-reisi themeluesin e kësaj “bashkësie” publikisht e ka quajtur “satanë”? Këtë konstatim atëherë ia ka miratuar edhe Shaqir Fetai porse, ja që sot, paska konstatuar se ai është “bërqet” ndaj as nuk reagon kundër tij, as kundër “bashkësisë fetare” të tij dhe as kundër veprimit ofendues që ia bën tërë myslimanëve të vendit! Sepse, ky farë themeluesi i kësaj “bashkësie” në fakt e ka regjistruar “firmën tregëtare” të tij nën paragrafin “religjion” dhe përmes këtij religjioni ai mëton të mbledhë myslimanë që janë të “ehli sunetit dhe xhematit”, të xhematit të Pejgamberit a.s. dhe jo të xhemateve të xhamive të BFI-së. Prandaj ai ka nisur të themelojë e të hapë edhe xhami të tjera në terrtorin e Maqedonisë së Veriut.

Ky veprim nuk qenka ekstremizëm! Prandaj Shaqir Fetai thotë se në Maqedoni nuk ka as ekstremizëm dhe as radikalizëm! Po disa të rinjë që po mbahen në burg, të dënuar për “terrorizëm islamik”, veprimtaria e të cilëve u zbulua dhe u dekonspirua nga disa faktorë me relevancë botërore që veprojnë në shtetin tonë? Apo, këta që të gjithë i demanton Shaqir Fetai (sepse, nëse e pranon atëherë i bie që edhe vetë Shaqir Fetai, me dy këmbë është brenda aktiviteteve radikaliste dhe ekstremiste)!

Shaqir Fetait i duket shumë normale ligjërimet e disa “nëpunësve” të tij që proklamojnë qëndrime ekstremiste, përtej trurit normal, kur përkrahin nga qyrsia luftën e Putinit!

Shaqir Fetai disa herë ka nënvizuar se ai dhe bashkëpunëtorët e tij kanë dhënë kontribut të madh në zbutjen e ekstremizmit dhe radikalizmit fetar në vendin tonë. Ai mburret se BFI-ja ka një

strategji dhe projekt (të hartuar nga Afrim Tahri dhe Avni Halimi) për sa i përket ekstremistëve, radikalistëve, të atyreve që kthehen si mercenarë nga vatrat e luftërave dhe se si të rehabilitohen dhe sërish të etablohen në shoqërinë tonë!

Të mos e pranoshë traditën 600 vjeçare të BFI-së dhe të ngrisësh xhami personale me qëllim që të shkëpusësh sa më shumë xhematë që janë 100 për qind të mez'hebit hanefij, a nuk është ky një ekstremizëm që mund të prodhojë radikalizëm të tmerrshëm! Shaqir Fetait, derisa i lejon dhe nuk alarmon për këto tentativa, e ka rreptësisht të ndalur që të flasë për çështjet kombëtare, për më tepër që ai dhe kombi kufirin e kanë në pragun e UDB-së! Megjithatë, Shaqir Fetai e pranon duke thënë: “çdo grup që themelohet, që legjitimohet, ka për qëllim dobësimin e BFI-së dhe të unitetit të xhematit tonë”! Po themelimi i këtyre grupeve religjioze, sidomos ky i “hoxhës” së Kumanovës, të cilët po legjitimohen dhe po institucionalizohen edhe nga organet dhe bashkëveprimtarët e Shaqir Fetait? Në promovimin e xhamisë (të cilën Shaqir Fetai e quan objekt i kotë) kanë marrur pjesë dhjetra nëpunës të Shaqir Fetait, madje edhe myfti!!! Tani, me këtë fakt të pamohueshëm a nuk po dëshmohet se vetë Shaqir Fetai është në funksion të shkatërrimit të BFI-së dhe të unitetit të xhematit të vendit?! A mund të jenë shpifje fotografitë e hoxhës që janë me qindra dhe, i cili, në një emision televiziv të një televizioni kosovar, pranoi haptazi se ndonëse nuk bën të fotografohemi, megjithatë, fotografitë na duhen për të dëshmuar para donatorit të huaj! Subjektin “fetar” të këtij hoxhe e paskan regjistruar qarqet antifetare e antikombëtare ndaj dhe, të gjithë duhet ta dinë se çdo subjekt i këtillë është kundër çështjeve kombëtare dhe atyre fetare! Po Shaqir Fertain, kush e solli në krye të BFI-së? Kush e regjistroi këtë mahluk? Nuk e sollën po ata struktura që po i regjistrojnë “religjionet islamike” të cilat do ta dëmtojnë çështjen kombëtare dhe fetare! Pra, Shaqir Fetai e kupton se çfarë dëmi kombëtar e fetar që është bërë, sepse edhe atë e sollën po këto struktura që merren me dëmtimin e këtyre çështjeve për të cilat flet Shaqir Fetai, sikur të ishte ndonjë alamet fetari e alamet kombëtari! Deri më sot është provuar vetëm e kundërta!

Lidhur me këtë “grupacion kumanovar” që qenka themeluar dhe regjistruar, Shaqir Fetai nënvizon se është ankuar gjithandej, sepse e sheh si të dyshimtë, të rrezikshme dhe nesër të mos thonë se çfarë struktura veprojnë në BFI! Po organet e bashkësisë “fetare”

të Shaqir Fetait, po bashkëpunëtorët e tij, nëpunësit e tij, hoxhallarë që veprojnë me dekretin e Shaqir Fetait – të gjithë këta që e vizitojnë dhe marrin pjesë në inagurimin e xhamive të tij nëpër Maqedoninë e Veriut? Kësaj të vërtete si do t'i shmenaget Shaqir Fetai! Assesi, sepse me dy këmbë është i involvuar në strategji të tilla! Shaqir Fetai thotë se, gjithkund ku prezantojnë bashkëpunëtorët e tij, aty janë me autorizim të Shaqir Fetait si dhe e përfaqësojnë “prijësin” e tyre!

Nëse çdo ndarje e xhematit qenka atikombëtare dhe antifetare, çfarë ka bërë Shaqir Fetai që ta pengojë këtë ndarje, cili është angazhimi i tij për të kërkuar ndihmë prej të gjitha palëve që ta pengojë këtë ndarje, cila është strategjia e Shaqir Fetait për ta penguar këtë ndarje? Nuk ka, sepse interes i Shaqir Fetait është që BFI dhe uniteti i myslimanëve sa më parë të bëhet copë-copë, jo përmes ndarjes së organeve që nuk duan të jenë nën “hyqmin” e Shaqir Fetait por, përmes daljes në sipërfaqe të elementit ekstremist dhe radiklist i cili nuk i heziton ndarjes dhe përçarjes. Prandaj, i përkrah Shaqir Fetai, i përgëzon, i institucionalizon! Këtë fakt tashmë e dinë të gjithë faktorët me relevancë si të vendit ashtu edhe ata ndërkombëtar në vendin tonë./Kombetare/07.05.2022

Të gjitha punët zyrtare të BFI-së lëvizin përmes pushtetit lokal dhe atij qendror!!!(8)

(Në bisedën në një televizion nacional, me rastin e Ditës së Fitër Bajramit, Shaqir Fetai paraqitet si një fakir, si një i mjerë i cili, edhe një herë dëshmon se ia do shumë qejfi që të mburret me sukseset e huaja. Gazetarja e pyet për Xhaminë e Prilepit ky përgjigjet për pazarin e Kërçovës, gazetarja kërkon të flitet për Xhaminë e Llazhecit, ky përgjigjet për tokë djerrinë që paska kthyer në Gostivar! Pse nuk flet për qendrën tregtare që do ta finansonte banka islamike e që do ta linte vakëf miliona dollarë për Gostivarin)

Nga Demir Zimeri

Shaqir Fetai më në fund e ka kuptuar që pa u mbështetur në të arriturat e BFI-së për 25 vitet udhëhequr nga H. Sulejman ef. Rexhepi, “sukseset” e tij janë fare të papërfillshme. Më shumë ka bërë dëm se sa ka sjellë ndonjë sukses. Më tepër e ka poshtëruar BFI-në se sa i ka dhënë drejtim kah e mbara. Më shumë e ka dezorientuar tërë xhematin e vendit se sa ka ndikuar në përforcimin e atij uniteti që e gjeti në çastin kur ia nguli thikën pas shpine efendi Rexhepit dhe kur ia uzurpoi kolltukun! Shaqir Fetai e sheh se, pa u mbështetur në sukseset e së kaluarës, ai në kolltukun e uzurpuar duket vetëm një qyp bosh! Pak para fundit të bisedës gazetarja insiston që të flasë për Xhaminë e Prilepit, për objektet fetare të dëmtuar që nga konflikti i

vitit 2001, ndërsa ky nis e flet për të arriturat e paimagjinueshme për trurin e Shaqir Fetait që i kapi BFI për më se 25 vite drejtuar nga ish-reisi i tij H. Sulejman ef. Rexhepi. Pa fije turpi lavdërohet se i paska dalur “t’i kthejë” tre vakëfe gjigante në Shkup, në tokë djerrinë e me shkurra në Gostivar si dhe pazarin e Kërçovës! Pse e pranon Shaqir Fetai se kto objekte në fakt janë “peshqesh” për Shaqir Fetain që e pranoi rolin e pushtetit maqedonas për ta dëmtuar unitetin dhe tërë BFI-në! Kërkesa për kthimin e këtyre objekteve paska qenë që nga 1998! A e kupton Shaqir Fetai se sa punë është dashur, sa kompletim dokumentesh, sa pagesa e sa procese gjyqësore, derisa janë sjellë vendimet për t’i denacionalizuar ato objekte, por që shteti nuk dëshironte që t’ia kthejë “strukturës nacionaliste” të BFI-së por, priti një lojalist me veti të marionetës deri në përkulje pa “kiçmë” siç doli të jetë Shaqir Fetai!

Shaqir Fetai i ikë bisedës për objektin e ish-myftinisë së Shkupit, nuk ka qejf të flasë asnjë fjalë për objektin “Ibni Pajko” nga e cila hoqi dorë për 300 mij euro, ndërsa i thekson që i paska nxjerrë nja 20-30 metra katëror objekte të reja! Asnjë fjalë nuk e thotë për korrupsionin e tij për shkak të të cilit Myftinia e Gostivarit ngeli pa një objekt miliona dollarëshe investim nga banka islamike! Shaqir Fetai është dëmi më katastrofal që ka mundur t’i ndodhë BFI-së. Shaqir Fetai është i gjunjëzuar para këtyre fakteve, ndërsa “heshtjen” e paraqet si urdhër të tij! Le të provojë e le të urdhërojë që dikush nga honxho-bonxhot e tij ta mbrojë nga faktet e pamohueshme! Nuk del askush, madje nuk del as ta lavdërojë për eventualisht “të arriturat” e Shaqir Fetait! Sepse, as honxho-bonxhot e tij nuk pranojnë që të “gënjejnë” për Shaqir Fetain! Prandaj, vetëm Shaqir Fetai vetëlavdërohet nëpër intervista të paguara e të kurdisura për “suksese” të cilat mund të përkthehen vetë në sukseset e tij në shkelje të turpshme mbi aktet normative të BFI-së, për “sukseset” e tij në devalvim të personalitetit të BFI-së, për “sukseset” e tij në minimizim të shkajshëm të rolit dhe të peshës të BFI-së në të gjitha proceset jetike të shtetit e të shoqërisë. A e di Shaqir Fetai se në çnivele ishte dikur BFI-ja dhe ku ka përfunduar sot që kur e uzurpoi me komplot klasik dhe me tradhëti nga më të rëndat?

Shaqir Fetai si hajn klasik e vjedh tërë kontributin si dhe financimin e institucioneve turke në renovimin e xhamive të periudhës Osmane kur flet për renovimin e tyre. E paraqet si vepër

të tij, ndërsa nuk ia zë goja ta theksojë asnjë donatorë në këtë proces! Me dhjetra objekte ka renovuar TIKA por edhe Dijaneti i Turqisë, ndërsa ky flet duke thënë “po i renovojmë xhamitë e periudhës Osmane!

Sakaq, ia zë goja edhe “kopleksin e Arabati Teqes”! H. Sulejman ef. Rexhepi kishte nënshkruar marrëveshjen me një organizatë turke që vlente miliona dollarë për meremetimin e Teqes! Puna duhej të fillonte qysh para se ta dhiente fare Shaqir Fetai! A mund të thotë diçka Shaqir Fetai se pse “Arabati Teqe” tashmë është bërë lëndë e Gjyqit të Apelit të Gostivarit?! Ka qarkulluar një “dezinformatë” e këtillë në opinion dhe është mirë që ta sqarojë Shaqir Fetai!

Kur gazetarja insiston që mos t’i ikë pyetjes Shaqir Fetai por të përgjigjet konkretisht se çfarë po bëhet me Xhaminë e Prilepit, Shaqir Fetai ia nisë të flasë se edhe më herët, (por nga kush nuk e thotë!) qenka punuar shumë për rindërtimin e kësaj Xhamie dhe se ky vetëmsa po e vazhdonte atë punë, por që nuk po ia del!

Në një paraqitje para disa muajve Shaqir Fetai tha se ka qenë në rrethinën e Prilepit ku xhemateve u ka folur për projektin e rinërtimit dhe se ky fakt tashmë është në proces që do të kryhet shumë shpejt! Tani, i shkreti, na tregon se Xhamia e Prilepit qenka akoma e prishur sepse nuk paska gatishmëri politike për ta rindërtuar! Në këtë pikë bie poshtë tërë krekosja e avdallit se qenka faktor i bashkëjetesës ndërjetare dhe si kontribues në dialogun ndërjetar! Ja ku del në breg të rrenës Shaqir Fetai! Sipas Shaqir Fetait edhe ish-kryetari i BFI-së paska bërë shumë përpjekje, i paskan premtuar shumë subjekte se do ta përkrahin renovimin e Xhamisë, porse asnjëherë nuk ia paska dalur!

Gazetarja insiston që të flasë ky për vete, konkretisht ai çfarë ka arritur, avdalli vazhdon: “Ja çfarë kemi bërë! Ne që në fillim e kemi vizituar! Kemi kërkuar që menjëherë projekti të kryhet (pse a nuk paska pasur projekt më herët? Pse rrenë Shaqir Fetai?) dhe që tani, ky projekt, po iu dorëzuaka Ministrisë së Kulturës, sepse, meqë kjo Xhami do të rindërtohet si objekt i kulturës, kjo qenka nën kompetenca të kësaj Ministrie! Shaqir Fetai ose është i trashë nga truri, ose po e përgatit edhe një tradhëti të rëndë, në shenjë falënderimi ndaj pushtetit maqedonas që e instaloi në krye të BFI-së! Xhamia e Prilepit edhe më herët është ofruar që të ndërtohet si objekt kulture, por që këmbëngulja e H. Sulejman ef. Rexhepit ka qenë, ose të ndërtohet Objekt Fetar në shërbim të xhematit mysliman siç ka qenë, ose dialog ndërjetar nuk ka dhe me këtë,

edhe harmonia ndërftare do të jetë shumë e brishtë! Projektin nuk e paska gati BFI-ja, por do ta bëjë Drejtoria për Trashëgimi Kulturore!!! Atëherë, kë e paska urdhëruar Shaqir Fetai që ta bëjnë menjëherë projektin! Brenda 30 sekondave bisedë, Shaqir Fetai gënjenë 30 herë! Dhe, fare në fund, bisedën për marrëveshje me Drejtorinë e Ministrisë së Kulturës do ta nënshkruaka TIKA, sepse, këta do ta ndërtojnë Xhaminë! Nga ana tjetër, projektin e paska përgatitur Drejtoria, atëherë, ku është këtu kontributi dhe angazhimi i Shaqir Fetait! Meqë na u paska ndërruar kryetari i Komunës së Prilepit, tani Shaqir Fetait po iu dashka fare prej fillimit të nisin bisedimet me këtë kryetar të ri! E pra, a mund të gjendet njeri më pështjellan se sa Shaqir Fetai!

Ky avdall i jep vetes të drejtë për t'u tallur me të gjithë myslimanët e vendit, i përçmon deri në lolo, sepse nuk qenkan në gjendje për ta kuptuar se BFI-ja qenka "instucion zyrtar"! Ja si e zbuloi Shaqir Fetai ujin e ngrohtë! A ka fjalë më boshe se kjo, a ka fjalë me boshllëkun e vet më ofenduese se sa kjo që e nxjerr nga goja Shaqir Fetai! Paramendoni, të gjitha punët zyrtare të BFI-së po lëvizkëkan përmes pushtetit lokal dhe atij republikan! Nëse kjo është e vërtetë, atëherë na paska hëngër dreqi, kjo është jashtëzakonisht shqetësuese! BFI-ja qenka e obliguar të bashkëpunojë edhe me pushtetin lokal por edhe me pushtetin qendror, me qeverinë maqedonase, sepse si ndryshe BFI të marrë leje për parcela e për objekte! Dikur, në kohën e H. Sulejman ef. Rexhepit, vetë shteti ofrohej me kërkesa për bashkëpunim, sepse strukturat e drejuara nga efendi Rexhepi as që e lutnin dikë për leje për të ndërtouar xhami. Xhamitë ndërtoheshin aty ku ishte nevojë dhe, këtyre nevojave pushtetet lokale apo qendrore i nënshtroheshin duke i bërë fakt të kryer e të domosdoshëm të gjitha ato objekte që ndërtoheshin pa kurrfarë lejesh paraprake! Me qindra xhami janë ndërtoar në këtë mënyrë! Nëse pushteti lokal apo qendror dilte pengesë, BFI sakaq e ndërpriste dialogun ndërftar, nuk garantonte harmoni ndërftare, i bojkotonte të gjitha organizimet e shtetit me karakter ndërkombëtar dhe, aty ku nuk merrte pjesë BFI e që i përkisnin organizimeve fetare, konferencat dështonin, ishin të pakuptimta!

Dëshmi për Shaqir Fetain se paska bashkëpunim të mirë me qeverinë maqedonase qenka kthimi i pronave të vakëfit, ndërsa nuk e llogarit këtë si obligim ligjor të shtetit për ta rikthyer çdo centimetër të pronës së nacionlizuar, ndaj dhe këtu nuk ka se

çfarë hy në punë “bashkëpunimi i BFI-së me qeverinë për këtë qëllim”, sepse, kjo përkthehet, thjesht, në sabotazh apo, në premtim për shpërblim qeveritar për koncesione të majme të BFI-së!

Dhe, fare në fund, Shaqir Fetai tani po e pritkëka akreditimin e Medresesë Isa Beu! Edhe ky proces do t’i dalë si “Xhamia e Prilepit”, pa dyshim dhe, edhe për këtë Shaqir Fetai do ta akuzojë “ndonjë kryetar komunash” dhe jo qeverinë maqedonase e cila e instaloi në krye të BFI-së! Shaqir Fetai nuk guxon t’ia turbullojë ujin ujkut, sepse, pastaj, ose do të kollofitet ose do t’i duhet të ikë si ai me bisht nën shalë!

Shaqir Fetai, kjo farë “melaqe e Stançicit”, në përgjigjen paraprake tha se shumë po shpifet kundër tij, ndërsa në këtë përgjigje, ai desh e nxori nga takti gazetaren e cila e kuptoi se ai veç po e gënjente, veç po e sillte kodër pas bregu, dhe vetëm po përpiquej që të vetëlavdërohej duke “verglletë”. Avdallin mos e vet se të tregon vet’!/Kombetare/08.05.2022

Shaqir Fetai akuzon partitë që po përpiqet të fetarizohen! Ai kërkon që partitë mos të kërkojnë angazhim institucional të BFI-së nëpër skena të fushatave partiake !!! (9)

(Në bisedën në një televizion nacional, me rastin e Ditës së Fitër Bajramit, Shaqir Fetai paraqitet mundohet t'i qortojë partitë që po lejojnë të fetarizohen. Ai, po ashtu, i hedh poshte shpifjet se BFI-ja po politizohet, sepse, sipas tij, për t'u politizuar ky Institucion duhet që Shaqir Fetai, me xhube e me shall, të ngjitet në një skenë partiake gjatë fushatave. Hoxhallarët qenka në të drejtën e tyre individuale për t'u marrur me politikë e për të agjituuar për parti të ndryshme! Ec e mos ia bukos gojën në papçe, avdallit)

Nga Demir Zimeri

Shaqir Fetai, kah fundi i intervistës së porositur për të thënë kopalla në një televizion nacional fill pas Muajit të Ramazanit, muaj ky nga më të dështuarit në historinë e BFI-së për sa i përket aktiviteteve programore që e shënojnë bujshëm për çdo vit Muajin e Mëshirës (nuk kishte përmbajtje tematike, pa përmbajtje artistike, kreative, humane, pa aktivitete të reja, përtej atyreve të klishezizuara dhe monotone), pra, kah fundi i intervistës flet edhe për akreditimin e Medresesë! Garanton fuqishëm se do të bëhet akreditimi, meqë e paska marrur në shqyrtim Parl(l)amenti i Maqedonisë së Veriut, ndonëse nuk paska marrëveshje qeveriare,

por ama paska marrëveshje dhe gatishmëri për përkrahje nga të gjithë subjektet shqiptare-myslimane si dhe, përkundër faktit se Kisha Ortodokse Maqedonase nuk paska interesim për ta akredituar shkollën e tyre të mesme. Tani, shiheni avdallin, meqë duhet të ndërrohet dhe Kushtetuta, gjithësesi, madje edhe për akreditim të Medresesë, në Kushtetutën e re si dhe në ligjin e ri për arsim, konform ndryshimeve kushtetutare, sipas Shaqir Fetait, do të evidentohet vetëmse Medresja, sepse të tjerat nuk paskan shprehur dëshirë. Kur të shprehin dëshirë ata, do t'i hymë edhe një herë procedurës të ngjashme si për Medresenë! A është i qartë se çka pallamudë Shaqir Fetai? A është i vetëdëshëm se çka premton?

Shaqir Fetai madje e pranon se Medresantët nuk mund të regjistrohen as në Fakultetin e Shencave Islame, ndërsa nga ana tjetër, medresantët participojnë për shkollimin e tyre, kurse Shaqir Fetai e çanë gurmazin duke kërkuar fitra e zeqat për medresantët e Medresesë "Isa Beu"!

Shaqir Fetai e pranon që nuk është i "kërcënimeve", e pranon se nuk ka forcë, (është shtalb), pa gjakë, për t'i rënë grusht tavolinës dhe për ta përshpejtuar këtë nevojë imediate për fëmijët tanë! Nuk jam i reagimeve, thotë, por ama, nëse dështon iniciativa, atëherë, thotë Shaqir Fetai, do të ulemi, do t'i analizojmë shkaqet, arsyet, dhe do të shohim se çfarë hapa duhet të ndërmarrin që sërish ta ngrisin iniciativën për ta akredituar! Deri atëherë, sërish dhe sërish, myslimanët e vendit vetëm duhet të japin fitra e zeqate për medresantët, të cilët, vetë more e paguajnë shkollimin, prej xhepit të tyre dhe, tipat si Shaqir Fetai, ua cungojnë mundësinë e shkollimit të mëtejshëm, i këpusin në kurriz, i lënë në baltë, pa të drejtën për t'u avancuar me shkollim sipëror!

Aaa, herave të mëparshme regjistrimi i medresantëve paska ndodhur me urdhër të ministrit të arsimit! Epo kush ishte ai që ia fuste dy këmbë në një këpucë ministrave? Në fakt, cilët ishin ata ministra që kishin respekt të paluhatshtëm ndaj kërkesës së reisul ulemasë H. Sulejman ef. Rexhepi që medresantët mos të pengohen në regjistrim nëpër fakultete ku të dëshirojnë vetë ata? Po pse një kërkesë të tillë eventuale nuk e përfillin ministrat aktualë që "bashkëpunojnë" ngushtë dhe ngrohtësisht me Shaqir Fetin? Apo është kërkesë interne e vetë Shaqir Fetait që ta pengojnë akreditimin!

Tërë ky idiotizëm i Shaqir Fetait, ky deklaram i pafuqisë së tij, kjo

tallje me medresantët, nën refrenin monoton “pas Bajrami, pas Bajramit”, duhet të merret frymëzim prej medresantëve dhe të ngriten vetë në këmbë, vetë të marrin masa deri në akreditim dhe, si kërkesë të dyt, ta kenë heqjen e participimit, të sigurojnë shkollimi falas, si dikur, sepse, për çka po jepen fitri dhe zeqati si dhe kontributet e tjera të myslimanëve të vendit! E drejta për shkollim nuk guxon të premtohet pas çdo bajrami, e drejta për shkollim, në të gjitha nivelet, duhet të garantohet në themel të shtetit, e as të jetë meritë e Shaqir Fetahave por, thjesht, duhet të fitohet nga vetë nxënësit, si shkollimi ashtu edhe garancat e paluhatshme institucionale për shkollim!

Gazetarja e pyet bashkëbiseduesin e vet cunq se si qëndron puna me financa, ka Bashkësia fetare Islame financa për t’i paguar hoxhallarët, Shaqir Fetai ndërhyrë me cinizmin e vet dhe kërkon që mos të brengoset askush se përpara e paskemi edhe organizimin e Haxhit që qenka burim ndër kryesoret financiare për BFI-në!

Shaqir Fetait sivjet i kanë rrjedhur burimet financiare, i kanë ikur, sepse është i shantazhuar, sepse është i injoruar, ai nuk e pranon këtë por, shumë shpejt do ta ndjejë! Sepse, ka nga “bashkëpunëtorët” e vet (fërëistë, vehabistë, selefistë, sektashistë të ndryshëm) që 20-30 vite kanë vepruar dhe janë angazhuar kundër BFI-së dhe kundër jetës institucionale islame. Kanë vepruar vetëm në interes të shoqatave dhe ideologjive të tyre. Tani ata janë katapultuar në sistem, por ama, nuk kanë më të voglën dëshirë për të punuar për BFI-në, ata vetëmsa e përdorin institucionin për t’i përforcuar shoqatat e veta prej nga janë futur në BFI. Sivjet, fitrat, zeqati, kontributet vullnetare të myslimanëve tanë që i kanë dhënë në emër të Medresesë dhe jetës fetare institucionale, do të pësojnë “hemorogji” dhe, më se 80 për qind e të hyrave të dikurshme të BFI-së tani do të jenë bazë financiare e këtyre shoqatave të diskutueshme dhe anti-BFI!

Shaqir Fetai nuk e korrigjon gazetaren dhe nuk i thotë që mos të manipulohet nga rrenat e tij kur i thotë se BFI-ja paska 800 xhami e mbi 1200 “hoxhollarë” që po i paguaka! Gazetarja e pyet se a ka buxhet për t’i paguar hoxhallarët! Asnjë hoxhë nuk paguhet nga Shaqir Fetai! Le të tregojë cilin e paguan, le të tregojë se cilit hoxhë ia paguan kontributet pensionale-invalidore! Cili prej hoxhallarëve të Shaqir Fetait është me kartelë bankare dhe rrogën e tërheq nga sportelet apo nga bankomatet! Asnjë! Se mos të harrojmë, Shaqir

Fetai i ka edhe nja 200 qendra islamike në diasporë që i mirëmbanë ky farë avdalli që, sipas tij, të gjithë ata i detyrohen financiarisht BFI-së!

Në mungesë të gjërave konkrete, Shaqir Fetait i ngelë të lavdërohet vetëm me “suksese imagjinate” dhe me projekte që nuk di as si hartohen, as si realizohen dhe as si materializohen! Po le t’i pyes bashkëpunëtorët e vet të cilët, ujin e mullirit financiar të BFI-së po e çojnë në jazin e “shoqatave” dhe “bashkësive fetare” të tyre!

Përkundër mbylljes totale për shkak të Kovidit 19, Shaqir Fetai ia paska dalur që t’i rrisë rrogat në FSHI me më shumë se 20 %, po ashtu po kaq i paska rritur edhe për stafin edukativo-arsmor në Medrese, po ashtu edhe myftinitë paskan funksionuar pa probleme financiare! Po ku i mori atë para ky farë “ekonomisti”? Hej, për 63 për qind paska dalur më i suksesshëm financiarisht se një vit më parë! Të dhënat flasin se me fitër dhe zeqat vitin e kaluar ishte për 46 për qind më pak se një vit më parë! Atëherë, prej nga financat? Mos ishin para nga buxheti shtetëror në shenjë përkrahje për tradhëtinë e madhe që e bëri? Apo, ishin para nga decentralizimi i objekteve që kushtuan miliona dollarë e që i bëri rrush e kumbulla! Është, pa dyshim, ndërhyrja e shtetit, e qarqeve që e instaluan në krye të BFI-së, e atyreve që turpëroheshin e po çmendeshin nga dështimet dhe sjelljet idiotike të “instalacionit” të tyre dhe, meqë u vine inatë të dështojnë në “projektin ORAO”, i dhanë sa deshti lekë dhe, më në fund u ngrit në “lapidaren e budallallëqeve” të tyre!

Shaqir Fetai mendon se sivjet, meqë u hapën dyert e Haxhit, do ta ketë më të lehtë! A ka bërë analizë Shaqir Fetai, para se të flasë budallallëqe se, cila është mosha e haxhilerëve tanë? Sa për qind e myslimanëve tanë shkojnë në haxh në moshën mbi 65 vjeçe. A ka ndonjë pasqyrë se sa prej këtyre që janë të gatshëm për të shkuar do t’i kenë marrur të dyja vaksinat! Po nëse nuk i kanë marrur dhe nisin e marrin tani të parën vaksinë, kur do ta marrin të dytën dhe, cilat do të jenë pasojat shëndetësore të atyreve që do të mnguten me “ryshfet” për ta marrur edhe të dytën! Po cila ishte kuota e caktuar për sivjet për haxhilerët nga Maqedonia Veriut! Janë një sërë faktorësh që nuk premtojnë se sivjet haxhi do të jetë optimizues për Shaqir Fetain! Mos do të ndikojë në ulje të numrit të haxhilerëve të sivjemë edhe kriza botërore ekonomike! Shaqir Fetai edhe më tej është i bindur se sivjet do të ketë haxhilerë si asnjë herë më parë përgjatë këtyre 30 viteve.

Shaqir Fetai me gjasë shpreson se do ta marrë ndonjë donacion të

dyshimtë financiar, ndërsa opinionin që tani dëshiron ta përgatisë se i ka nga “haxhi” dhe nga anëtarësia e të cilin e ka më të lartë në rajon! Duhet të përcillet veprimtaria e dyshimtë e këtij avdalli sepse, do të na marrë më qafë si fetarë të devotshëm por edhe si kombëtarë! Shaqir Fetai nuk i njeh limitet e budallallëqeve por as të vetëlavdërimeve prej mediokri!/Kombetare/11.05.2022

Dy vite devalvim e shkatërrim të BFI-së

Po bëhen dy vite (më 27 maj) që kur Shaqir Fetai zhvilloi një komplot dhe një tradhëti që goditi rëndë mbi njerëzillëkun si vlerë, mbi kolegialitetin si normë njerëzore, mbi profesionalizmin si vlerë e ndërtuar me shumë mund e djersë. Shaqir Fetai e ndërmori këtë “veprimtari” jo njerëzore për t’u ngjitur në front prej nga do të mund t’i shpalosë “vlerat” e veta! Po pse përmes tradhëtisë?

Nga Shaban Aziri

Shpesh herë, në paraqitjet e veta publike, Shaqir Fetai ndjenë thellësisht nevojë që të nënvizojë se po përfaqëson BFI-në! Po pse këtë nevojë kur dihet që, në çdo prezantim “i pari” gjithnjë e prezanton institucionin që e drejton, si përfaqësues reprezentativ i popullit!

Ky kompleks tashmë Shaqir Fetait i është bërë ves! Sepse, dorën në zemër, thellë në ndërgjegjen e vet, thellë në shpirtin e vet, ai intimisht e ndjenë se nuk përfaqëson asgjë, sepse nuk është i denjë të përfaqësojë asgjë, sepse, me “sallto mortale”, me rrotullime e praptime, me ndërkëmbëza e, me mohime, me shkelje të normave morale e juridike, nuk mund të jeshë përfaqësues i askujt! Njeri normal nuk mund të lejojë që vlerat e veta të përfaqësohen nga

“djalli”. Nuk ka njeri normal që nuk e ndjenë problem të madh, që nuk e ndjenë veten “djall”, nëse pretendon që me dallavera dhe mbi hakun e tjetrit ta kapë “primatin”!

Shaqir Fetain e brenë ndërgjegja, natë e ditë, sepse, ai e di që karrierën e nisi mbi një “platformë” që nuk është as kombëtare, as fetare dhe as shtetërore. Karrierën e tij e nisi mbi formulën e komplotit dhe puçit klasik dhe, derisa nuk ka ndryshime, natyrisht që ai do të pranohet si “i mirëqenmë”, si “përfaqësues”! Prandaj, edhe në këtë moment moral, Shaqir Fetai nuk ka nevojë që ta nënvizojë përfaqësimin e vet në emër të BFI-së, sepse, ashtu e kanë ftuar dhe e kanë pranuar! Organizatorëve të eventeve të ndryshëm Shaqir Fetai u duhet si “përfaqësues i diçkafit” dhe jo si pacient që ka nevojë t’i shërojë kompleksët e veta, sepse, organizatorët i nxjerr në situata të pavolitshme!

Po pse këtë kompleks Shaqir Fetai? A mund ta harrojë “momentin e tradhëtisë”, a mund ta fshijë nga mendja pikën e gjakut në maje të thikës së tradhëtisë?

Pse Shaqir Fetai me honxho-bonxhët e vet asnjëherë nuk ngriti shqetësim për kahet shqetësuese drejtë të cilave paska udhëtuar BFI-ja? Pse asnjëherë nuk i doli publikisht ish-reisul ulemasë, pse asnjëherë nuk i kërkoi debat, pse asnjëherë nuk ngriti zërin për “vakitë” që i paska shënjuar Shaqir Fetai? Apo, Shaqir Fetai do të na thotë tani se paska pas punuar “nën hije”, për kohë të gjatë dhe se, gjesti i tij paska qenë si rezultat i një analize më të thellë! Po kur e bëri këtë analizë Shaqir Fetai i cili, një javë para tradhëtisë, e ngriti në kupë të qiellit Sulejman ef. Rexhepin në një prononcim televiziv!

Ne, njohësit e rrethanave në BFI, e kemi ditur që të gjithë se cila është fuqia drejtuese e Sulejman Rexhepit, e kemi ditur që një sekond nuk mund të punojmë prapa shpinës së tij, sepse ka pasur “informatore” që natë e ditë e kanë bërë syçelë dhe të vëmendshëm. Asnjë nga bashkëpunëtorët e tij, në asnjë sekond, nuk kanë shprehur lodhje, irritim, mërzitje prej punëve të Sulejman ef. Rexhepit. Të gjithë kanë qenë të kënaqur e të stërlumur! Sakaq, një ditë të bukur, e shohim Shaqir Fetain me honxho-bonxhot e tij

në televizion tek ia kumton ish-reisit të tij, rrëzimin, tek ia demonstroi fuqishëm komplotin, tradhëtinë dhe puçin! Shaqir Fetaj nuk e ka pasur atë karizëm që t'i ketë pasur të radhitur pas vete dy njerëz? Shaqir Fetaj nuk e ka pasur atë fuqi "prej lideri" që të kapë dikë për hunde dhe ta orientojë atje ku do vetë! Shaqir Fetaj për herë të parë në historinë e BFI-së pranoi të dalë publikisht dhe të dëshmojë se Institucioni i BFI-së është përplot me "të dëgjueshëm", "servilë" dhe "të lakueshëm" të cilët janë militantë të shërbimeve inteligjente dhe të gatshëm të veprojnë në çdo sekond, pas çdo vendimi dhe thirrje të shërbimeve të caktuara!

Vërtet, si u mblodhën të gjithë, si ia doli Shaqir Fetaj që t'i mbledhë të gjithë bashkëpunëtorët e Sulejman ef. Rexhepit, të cilët deri një orë më parë, madje edhe flinin shtrirë te prapanica e tij! Pa dyshim, është një "fuqi e një bashkësie absolute" ku aderën Shaqir Fetaj dhe "bashkëpunëtorët" e tij, të cilët, me një sinjal mund të tubohen në një vend dhe në të njëjtën kohë! Nuk e ka pasur fuqinë e "tubimit" destruktiviteti i Sulejman ef. Rexhepit. Fuqinë e tubimit e ka pasur dhe e ka vetëm shërbimi inteligjent, cilido qoftë ai! Me frena në gojë mund të komandohesh vetëm prej atij "pronari" që t'i ka vënë frerët turive!

Rezultati i tërë kësaj loje ishte qëllimi i strukturave të caktuara për ta njollosur, devaluuar dhe kompromituar të kaluarën e BFI-së! Sepse, një Institucion me të parin e vet të shkarkuar nuk mund të mburret në historikun e vet! Rezultati i tërë kësaj loje ishte qëllimi i strukturave të caktuara për ta kapur për shumë qëllime meskine BFI-në! Për ta dobësuar e për ta bërë të varshme sa më shumë nga "institucione" të caktuara larg selisë së BFI-së! Fare në fund, qëllimi jetik i shërbimeve të caktuara që nuk ia duan të mirën as Institucionit dhe as kombit është që të instalohet një praktikë e "komplotit dhe puçit", që kurrë BFI të mos bëhet rehat! Deri më sot, shyqyr Zotit, asnjë njeri me tru normal nuk është joshur nga kjo ofertë e djallit! Kështu që, në historinë e BFI-së i vetmi i cili u josh pas ofertës së djallit do të ngelë, mjersiht, Shaqir Fetaj! Me qëllim që sado pak ta "thyejë" mitin e çelikosur se Shaqir Fetaj

si instalacion mund të përfaqësojë vetëm strukturat që e instaluan turpshëm në krye të BFI-së, ai gjithnjë, në postimet e veta thotë: “në këtë event reisul ulema e përfaqësoi BFI-në”!!! Po në ndonjë event tjetër? A mund të jetë përfaqësues i “klubit të djallit”? Vaftë në djall para se BFI-ja të vejë në fund të pusit!

Shaqir Fetai, duhet të veprojë, sa më parë të tërhiqet në vetminë e plotë të tij, jo sa për t’u rehabilituar ish-reisi i dëmtuar, jo sepse ia arriti qëllimeve të veta, sepse, ai kurrë nuk ka pasur qëllime të veta, jo se e dha më të mirën e tij dhe tani nuk ka se çfarë të japë, porse, thjesh, duhet ta çlirojë BFI-në nga një turp i tmerrshëm që ia shkaktoi, turp ky që po peshon shumë rëndë mbi themelet e të vetmit Institucion fetar islam në vend! Shaqir Fetai, duhet të shpërthejë dhe të lirohet nga ato pranga ku dhunshëm po e mbajnë të ngujuar “shërbime” të ndryshëm që nuk u intereson “karriera” e Shaqir Fetait sa shkatërrimi i BFI-së! Shaqir Fetai duhet të ndërjegjesohet dhe një herë në jetën e vet të ulurasë kundër dirigjuesve të tij: “Mjaft më përdorët për shkatërrim të institucionit”! Këtë nuk ia ka borxh as BFI-së, as myslimanëve të vendit, por, borxh ia ka vetëm profesionit “hoxhë” në emër të të cilit është thirrur kaq shumë, ndërkohë që fundi po i del t’i jetë katastrofal!/In7/15.05.2022

Cinizmi i Shaqir Fetait nuk ka të sosur

Nga Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI

Hurmat janë sinonim i Muajit të Agjërimit. Sa herë që përmenden hurmat menjëherë mendja shkon te ky Muaj. Myslimanët tanë këtë frut të bekuar e lidhin me Ramazanin dhe, pa dyshim, e konsumojnë pothuajse ekskluzivisht gjatë këtij Muaji! Po kaq i konsumueshëm është edhe në vendet e tjera myslimane. Nuk ka sofër që shtrohet për iftar e të mungojë ky frut. Hurmat shpërndahet e shiten gjatë këtij Muaji

Organizata humanitare gati e shuar, Hilal që vepron në mënyrë incidentale në bashkësinë “fetare” të Shaqir Fetait, paska ndërmarrur një aksion të gjërë humanitar, për shpërndarjen e 25 ton të hurmave që paskan ardhur hejdije (dhuratë) nga Mbretëria e Arabisë Saudite! Pakot me hurma qenkan humanitet?! Mileti ynë i varfër po vdiska për hurma dhe, mule Shaqir Fetait t’ju dalë në ndihmë përmes një aksioni humanitar!

A nuk është edhe kjo një prej shumë talljeve të Shaqir Fetait me myslimanët e vendit. Porse, tallja, cinizmi i tij, kësaj radhe shkon përtej myslimanëve të vendit. Ai tallet edhe me Mbretërinë e Arabisë Saudite e cila paska dërguar këto ditë hurma në bashkësinë “fetare” të Shaqir Fetait për të zhvilluar aksion humanitar!

Cila mbretëri, cila organizatë botërore, cila organizatë fetare ndanë pako me hurma si pako humanitare për të varfërit! Këtë e paska bërë Mbretëria e Arabisë Saudite? Mbretëria e Arabisë Saudite

kurrë në jetë nuk do të bënte humanitet me hurma, sepse, e di shumë mirë se hurma nuk e zë vendin e produkteve ushqimore të nevojshme për të varfërit! Me këtë gjest, Shaqir Fetai në fakt e tallë këtë Mbretëri!

Kjo Mbretëri, pa dyshim që ka dërguar hurma për t'u shpërndarë gratis për myslimanët e vendit gjatë Muajit të Ramazanit. Porse, meqë këtë shpërndarje nuk mund ta bëjë “organizata-individ”, meqë nuk kanë mundur as ta shpërndajnë këtë kontigjent me hurma, as ta shesin dhe as ta këmbejnë me ndonjë produkt ushqimor për të cilën kanë nevojë myslimanët tanë, që mos t'u myken e krimben, Shaqir Fetai ka vendosur që dy javë pas Ramazanit të organizojë një “aksion humanitar” me hurma për nevojtarët tanë! Sepse, është dashur të ketë edhe fotografi e raporte narrative mbi shpërndarjen e dhuratës së Mbretit por te i cili mund të manipulohet data e shpërndarjes! Në momentin që do të marrë vesh Mbreti i Arabisë Saudite se si janë sjellë në mënyrë kaq të poshtër me hejdiën e tij për myslimanët e vendit, një Zot e di se cili mund të jetë reagimi Lartmadhnisë së tij!

Pa dyshim, ky është edhe një veprim i Shaqir Fetait i cili e devalvon peshën dhe rolin e BFI-së deri në një “shoqatë humoristike” e cila vë në tallje mbretër e pushtetarë! Deri në këtë derexhe është devaluuar BFI-ja sa të ketë rolin e distributorit të hurmave si “produkt humanitar” ndërkohë që, hiç më larg se në Gostivarin e Shaqir Fetait, po vdesin urie tre familje që flejnë nën najllona qysh para gjashtë muajve kur i doli flaka banesave të tyre! Këta familje këto ditë kërkuan ndihmë përmes mediave të vendit! Paramendoni sikur këtyre familjeve Shaqir Fetai t'ju nisë pako me hurma!

Është mirë që organet e BFI-së, të kapur nga ky instalacion i pushtetit maqedonas, të ndërgjegjësohen, të këndellen dhe t'i thonë STOP Shaqir Fetait me talljet, me cinizmin dhe me devalvimin prej avdalli që po ia bën BFI-së. Jo vetëm këta por, të gjithë ata që e kanë përmbajtur deri më sot këtë avdall, është koha që ta spostojnë në ndonjë nga inceneratorët e vendit sepse, po na turpëron dhe po na e nxinë fytyrën shumë keq. A do të ketë më turp se kjo, kur një ditë do të lexohet e do të përfolet se organizata humanitare paska zhvilluar humanitet duke shpërndarë për të

varfërit pako me hurma! Turp për shpirtin human të shqiptarëve të njohur e të pranuar anekënd botës. Dhe, ky shpirt të bëjë aktivitet humanitar me hurma?! Këtë njollë mbi këtë shpirt mund ta hedhë vetëm faqeziu, Shaqir Fetai! Marre!/ 1KlikLarg/19.05.2022

A po kërcënohen shqiptarët nga sektarizimi fetar

Nëse në Maqedoninë e Veriut shërbimet antiislame ndihmojnë çdo dukuri që do të fuste destabilizim dhe përçarje brendashqiptare, do të jetë detyrë kombëtare e organeve shtetërore të Shqipërisë dhe Kosovës të jenë më vigjilentë ndaj këtyre synimeve që drejtohen nga “fryma myslimane” e çeçenëve putinianë

Nga Ilir Topi

Ish-Reisul ulema i BFI-së, H. Sulejman Rexhepi, i cili, dy vite më vonë pasi u dekorua nga Presidenti Shqiptar me urdhërin “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut”, do të rrënohet nga froni i Kryetarit të BFI-së, veç tejrash, do të kujtohet edhe si luftëtar i denjë kundër “fesë” së ideologjiozuar, të cilën mundoheshin ta shtrijnë në tërë rajonin të ashtuquajturit “vahabi”! Të tillët ai gjithnjë i sulmonte dhe i quante si vegla të pushtetit si dhe të shërbimeve që nuk ia duan të mirën as fesë islame tradicionale por as shqiptarëve myslimanë! Aty ku nuk kishte “forcë”, apo aty ku “ekstremistët” ishin më shumë të përqëndruar dhe më shumë të radikalizuar, efendi Rexhepi kërkonte publikisht që të intervenojë policia e shtetit dhe, t’ia rikthejë Bashkësisë Fetare Islame xhamitë e uzurpuara, dhe të dëshmojnë se nuk po e përdorin këtë segment radikal për ta destabilizuar Institucionin e vetëm islam në Maqedoninë e Veriut.

Sulejman Rexhepi kishte provuar edhe që t’i fusë në sistem, në një farë forme t’i “institucionalizojë”, por shumë shpejt i hetoi se janë të papërmirësueshëm, se janë keqpërdorues të organeve dhe

institucioneve të BFI-së në realizim të interesave të huaja dhe të vetë atyre. Ishte një grup ekstremistësh shumë i radikalizuar në raport me BFI-në, respektivisht, tepër “besnikë” ndaj punëdhënësve të tyre! Këta assesi nuk pranonin që të veprojnë sipas strategjisë së efendi Rexhepit dhe nën ombrellën e BFI-së! Një prej më të rrezikshmëve Rexhepi e konsideronte “hoxhën”, kumanovar, Sadulla Bajrami, të cilin e patë sulmuar duke e quajtur edhe “satanë”! Këtë grup si dhe “Forumin Rinor Islam”, Sulejman Rexhepi i quante si “vegla të shërbimeve sekrete të UDB-së”!

Xhamia e parë private në Maqedoninë e Veriut

Në prag të muajit Ramazan, Sadulla Bajrami u bë “hoxha” i parë në rajon që arriti të ndërtojë xhami të veten! Me qëllim që mos të përhapet dukuria e ndërtimit të xhamive për secilin hoxhë, por që xhamitë të jenë pronë e një subjekti juridik, shtetit maqedonas iu kujtua që t’ia regjistrojë një “bashkësi fetare islame”, ndonëse ligji është kategorik: nuk mund të ekzistojnë dy e më shumë bashkësi të cilët për fe, për Libër të shenjtë dhe burimet financiare i kanë të njëjtë! Kjo iu mundësua Sadulla Bajramit i cili sot e ka të regjistruar një “bashkësi” me fjalë shqipe por me alfabet maqedonas “БАШКСИА Е ЕХЛИ СУНЕТИТ Е ЦЕМАТИТ – КУМАНОВО” (Bashkësia e Ehli Sunetit dhe Xhematit – Kumanovë)! Ç’është e vërteta, për t’i ikur përgjegjësisë ligjore, gjykata nuk e regjistron si bashkësi fetare (si komunitet fetar) por si grup religjioz! Kjo nuk i pengon aspak Sadulla Bajramit, ose mbase ai nuk di të bëj dallimin në mes të fesë dhe religjionit! Nuk i intereson, sepse, ai aktivitetin e vet duhet ta zhvillojë institucionalisht, të nisë të ndërtojë objekte fetare (xhami) për “religjionin” e vet si dhe të hapë sa më shumë filiale të “qendrës” e cila e dirigjon dhe i ndihmon që të shtrihet sa më gjërësisht! Kohë më parë, Sadulla Bajrami ka përruruar xhaminë e parë të religjionit të vet, aktivitet këtë që e legalizoi edhe bashkësia “fetare” e Shaqir Fetait, “reisit” aktual i cili u soll në këtë post nga koniukturat politike maqedonase e që, paraprakisht, shërbimet sekrete të tradhëtuarra prej tij ia publikuan një faqe nga dosja e tij policore që paraqiste raportimin e tij nën nofkën “ORAO” (Shqiponja) tek oficerët e UDB-së kundër studentëve shqiptarë që atëbotë studionin në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë,

ku po “studionte” edhe Shaqir Fetai, dhëndri i Mulla Hasan Zendelit të Çegranit, i cili kishte qenë bashkëpunëtorë i përjetshëm i Temellko Boshkovskit, një prej udbashëve që specialitet e kishte “tredhjen e nacionalistëve shqiptarë” në Pollog!

Në ditën kur Sadulla Bajrami e përuroi xhaminë e vet, aty prezantuan edhe përfaqësues të organeve të BFI-së, prezantuan nëpunës të Shaqir Fetait, hoxhallarë të dekretuar në detyrë nga Shaqir Fetai, prezantuan shumë radikalistë që sot shtiren si përkrahës besnikë të Shaqir Fetait. Pati edhe nga ata që nuk duhen në mes vete, që urrehen, që nuk kanë kurrfarë respekti për Sadulla Bajramin porse, ja që një “urdhër misterioz” i bashkoi të gjithë në një “event”!

Koha e legalizimit të radikalizmit dhe ekstremizmit

Analistët e çështjeve islame si dhe të organizimit fetar në Maqedoninë e Veriut thonë se, ky shembull i paprecedent me gjasë shumë shpejt do të shndërrohet në një dukuri shumë të rrezikshme për shoqërinë myslimane dhe, sidomos për shqiptarët myslimanë! E këtë gjest hapet mundësia që secili “radikalist” që ka uzurpuar një xhami, apo, secili “hoxhë” që nuk i nënshtrohet akteve normative si dhe Kushtetutës së BFI-së, të veprojë krye më vete, madje rrugët i ka të hapura që të regjistrojë një grup religjioz të pavarur dhe punën, bashkë me xhematin e vet, ta vazhdojë në të njëjtën xhami, derisa të mbledhin para për një xhami vetanake! Ky është një skenar ideal i huaji për ta përçarë shoqërinë myslimane të Maqedonisë së Veriut. Veç tjerash, Bashkësia Fetare Islame nuk do të ketë të drejtë që të kërkojë mbikëqyrje dhe të vendosë mbi këto “xhami religjioze”!

Bashkësia Fetare Islame e uzurpuar nga Shaqir Fetai me honxho-bonxhot e vet po ecë në drejtim të shkatërrimit të vakëfit, të harxhimit të saj, të zhvatjës së saj, të përdorjes së saj për të korruptuar segmente të caktuar politikanësh të pushtetit. Burim financiar i kësaj Bashkësie është zhvatja e myslimanëve të vendit dhe të diasporës në emër të fesë islame, kontributet e ndryshme fetare, të cilat, realisht, kështu siç po zgjerohet pa kontrollë dhe pa strategji BFI-ja, nuk ka mundësi as për tre-katër muaj të funksionojë e pavarur.

“Bashkësitë fetare” të sojit të Sadulla Bajramit kanë finacues të fuqishëm, shumë shpejt do të bëhen me prona të veta vakufore,

fare lehtë do të ndërhyjnë edhe në burimet financiare të BFI-së, dhe do ta shkatërrojnë këtë burim tradicional islam, sepse, do të formojnë xhemate të veta, të cilët, do të apelojnë që fitrin e zeqatin, kurbanët e haxhin, t'i orientojnë te “religjioni më i besueshëm” i Sadulla Bajramit! Këtë fat tragjik e ka të qartë edhe Shaqir Fetai, këtë trishtim po e ndjejnë edhe teologët e vendit porse, deri më sot, asnjë reagim prej tyre, asnjë shqetësim publik, asnjë debat mbi përpjekjet djallëzore për ta futur pykën e përçarjen në trungun fetar e kombëtar!

Nga ana tjetër, nuk është shqetësim vetëm Sadulla Bajrami! Problem edhe më i madh është kjo që ndodhi në prag të Muajit të Bekuar të Ramazanit në Myftininë e Shkupit! “Myftiu” i ardhur nga radhët e “Forumit Rinor Islam”, Qenan Ismaili, ia dorëzoi njërën prej xhamive më reprezentative “hoxhës” Omer Bajrami, njërit nga radikalistët dhe ekstremistët më të rrezikshëm në Maqedoninë e Veriut, i cili, për veprimtarinë e tij të dyshimtë ka qenë edhe i arrestuar nga policia maqedonase por që, për çudi të të gjithëve, pas disa javësh u la në liri! Pikërisht për Ramazan, atij iu nda Xhamia me dy minare e Sarajit, në të cilën tërë kohës ka mbisunduar një situatë shumë e ndjerë në mes të xhematit të Sarajit dhe kësaj Myftinie, faqa zyrtare e së cilës gëlon nga “ligjeratat fetare” dhe nga fytyrat e dyshimta radikaliste! Këto ditë, në Çairin e shqiptarëve të Shkupit u përrua një xhami e re, e cila, nga elementët e dyshimtë më në krye “hoxhë” Sadulla Bajramin dhe myftiun e diskutueshëm të Shkupit, Qenan Ismailin, u emërtua si Xhamia e “Bujar Shabanit”! Bujar Shabani është një shkupjan që mori pjesë vullnetarisht në luftën e Sirisë ku edhe u vra!

Vigilencë më serioze nga organet gjegjëse shtetërore shqiptare

Duke e ditur se puna e këtij “religjioni të ri” që po metastazon frikshëm në mes të shqiptarëve, duke e ditur fuqinë e tyre financiare, duke e ditur trurin e tyre lehtësisht të influencuar nga shërbimet dhe ideologjitë e ndryshme që veprojnë në emër të “islamit”, në njërën anë dhe, në anën tjetër, duke e ditur se ky “poligon” (RMV-ja) gjithnjë është përdorur si testim të strategjisë kompromituese që përfshinë edhe shqiptarët e Kosovës dhe Shqipërisë, duhet pritur që shumë shpejt ky “religjion” që bartë vulën e Sadulla Bajramit, hoxhes “satanë” nga Kumanova, por të

bekuar nga Shaqir Fetai dhe shërbimt prej nga dalin që të dy, të shtrihet edhe në këta dy shtete shqiptare. Andaj, nëse në Maqedoninë e Veriut shërbimet antiislame ndihmojnë çdo dukuri që do të fuste destabilizim dhe përçarje brendashqiptare, do të jetë detyrë kombëtare e organeve shtetërore të Shqipërisë dhe Kosovës të jenë më vigjilentë ndaj këtyre synimeve që drejtohen nga “fryma myslimane” e çeçeneve putinianë.

Lidhja e politikave ruse me fytyra të tilla pseudokombëtare e pseudofetare është UDB-ja si dhe elementët e saj që janë ngjallur e janë fuqizuar në veprim falë edhe heshtjes së strukturave përgjegjëse shtetërore që tashmë po e konsiderojnë të “vdekur” këtë shërbim të ngritur e të specilizuar mbi kurriz të shqiptarëve! A nuk ishte po ky Shaqir Fetai ai i cili e priti një delegacion rus më në krye Abdul-Vahid Niyazov, deputet në Dumën ruse i deleguar nga Partia e Putinit, miku i ngushtë i Ramazan Kadyrovit, aleatit të vetëm çeçen që po masakron krah për krah me Putinin në Ukrainë! Shaqir Fetai u dakortësua që bashkë me Niyazovin të ndikojnë që në ndonjë park të Tetovës të ngritet një përmendore e babait të Ramazanovit, Ahmed Kadyrov, ish-kryetarit pro-rus të Çeçenisë! Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut nuk guxon të trajtohen si “komunitet” provincial e i lokalizuar brenda një kufiri ku bëjnë jetë nomade! Brenda natës shërbimi sekret maqedonas urdhëroi që të tubohet “elita myslimane” dhe ta kapin BFI-në, duke e eliminuar H. Sulejman ef. Rexhepin. Këta që u mblodhën e respektuan më shumë urdhërin e shërbimeve sekrete se sa strategjinë kombëtare! Këta që tashmë e “kontrollojnë” BFI-në do të shtrijnë bashkëpunim kontaminues institucional edhe në Kosovë dhe Shqipëri. Kësisoj, këta udbashë dal nga dal do të legjitimohen dhe do të organizojnë takime edhe me personalitete të rëndësishme kombëtare! Atëherë nuk do të dihet më se cili është më udbash se tjetri, kush ishte e kush nuk ishte udbash! Ky është mision i dikujt për ta realizuar vetëm një qëllim: sa më shumë radikalizim, ekstremizim, hasmëri e vëllavrasje në mesin e shqiptarëve! Populli shqiptar ka nevojë për kujdes shtetëror./BotaSot/20.05.2022

Pse i mëshohet samarit dhe jo gomarit

Disa struktura opozitare ia kanë mësyer ta bllokojnë Kuvendin e RMV-së me qëllim që të shkaktojnë krizë parlamentare dhe vendi të shkojë në zgjedhje të parakohëshme. Në qafë i janë hedhur kryeparlamentarit, z. Talat Xhaferit

Nga Jasir Jashari

Këto ditë, që kur opozita e vendit u bind se e ka të vështirë t'i grumbullojë votat për ta çuar vendin në zgjedhje të parakohëshme, në shënjestrën e pikados po mundohen ta mbajnë kryeparlamentarin, z. Talat Xhaferin. Me sabotazhe e shantazhe është përpjekje shumë e kotë për ta nënshtruar Talat Xhaferin. Së fundmi kryeparlamentari po sulmohet për një pritje në parlament të një "delegacioni çeçen", të cilët në Maqedoninë e Veriut qëndruan si udhëheqës të një "asociacioni evropian mysliman" me seli në Bruksel. Delegacioni çeçen drejtohej nga Abdul-Wahed Niyazov, një kukull e Kremlinit në Qendrën Kulturore Islame, një ish-deputet i Dumës dhe themelues i Shoqatës Myslimane në Mbështetje të Presidentit Putin. Në fakt, ky delegacion ishte mysafir i të vetëquajturit "reis" i BFI-së, Shaqir Fetait. Tani, kryeparlamentari, Talat Xhaferi, duke

pasur respekt rezervë ndaj këtij farë “reisi”, duke i besuar si “kryefetar” por edhe si bashkëvendas, duke dashur që ta demonstrojë fuqishëm respektin e Kuvendit ndaj Institucionit Fetar, pa kurrëfarë rezerve do ta pranojë propozimin manipulativ të Shaqir Fetait për t’i pranuar mysafirët e të “parit” të fesë. Kështu do të vepronte çdo shqiptar e mysliman që ka respekt ndaj institucionit BFI. Talat Xhaferi në asnjë moment nuk do të besonte se do të manipulohet nga Shaqir Fetai; Talat Xhaferi, duke mos u marrur me kompleksët e Shaqir Fetait, duke mos u marrur me fobinë nga frika e thellësisë së njollës kombëtare e fetare të cilën mundohet ta mbushë me sa më shumë persona që do t’ia dalë t’i manipulojë, do t’ia pranojë edhe mysafirët rusë me të cilët koketonte Shaqir Fetai.

Nuk është e vërtetë se Talat Xhaferi e ka pasur këtë takim të fshehte. E ka publikuar, madje edhe publikisht ka reaguar nëpër portale shqiptare rreth asaj se si erdhi deri te ky takim.

Nëse në Maqedoninë e Veriut hy një “delegacion armiqësor” duke i kaluar të gjitha filtrat e institucioneve shtetërore, nëse atë delegacion e pret edhe një Institucion me relevancë të madhe në shtet, atëherë ku është problemi në takimin e Talat Xhaferit që paska pasur me këtë delegacion?! Institucionet më të larta të shtetit nuk mbrohen duke i goditur të njëjtit, por duke i goditur sabotuesit dhe manipulorët që kanë detyrë për t’i devaluuar këta institucione shtetërore.

Të goditet Talat Xhaferi ndërsa të amnistohet Shaqir Fetai, është njëjtë sikur të hidhërohesh në gomarin e ta godasësh samarin! Fundja, përcaktimet, orientimet personale e shtetërore, i dëshmoi Talat Xhaferi me vizitën që ia bëri Volodomir Zelenskit në mes të Ukrainës, nën breshërinë e arsenalit rus. Aty Xhaferi i tha kryetarit ukrainas se bashkëndjenë me çdo ukrainas dhembjen dhe trishtimin e këtyre çasteve, të cilët shqiptarët dhe vetë ai i përjetuan në konfliktin shqiptaro-maqedonas më vitin 2001. Xhaferi i shprehu edhe përkrahjet e të gjithë shqiptarëve (por jo të manipulantëve) për popullin ukrainas. Prandaj janë shumë të kota goditjet që mundohen t’ia japin Talat Xhaferit që paska pritur në

Parlament një “deoegacion çëçen”, siç ishte e kotë edhe sabotazhi i orkestruar i Shaqir Fetait për ta diskredituar Talat Xhaferin, për momentin krahun e djathtë të liderit shqiptar, Ali Ahmetit./Aktuale/22.05.2022

Institucioni që legalizon dhe legjitimon ekstremizmin dhe radikalizmin

A po kërcënohet vendi nga radikalizmi, ekstremizmi i dhunshëm fetar dhe nga terrorizmi? Në Raportin e Progresit për RMV nga BE nënvizohet se vendi ka indikatorë realë që dëshmojnë rrezikun nga veprimtaritë ekstreme dhe terroriste (gjithnjë në emër të fesë islame)! Raporti tërheq vërejtjen se vendi duhet të bëjë më shumë në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Kërkon që gjatë vitit 2022 vendi t'i përmbush të gjitha rekomandimet e Komisionit Evropian për sa i përket kësaj çështje dhe këtij rreziku real

Nga Valbon Osmani

Në një paraqitje të fundit televiziv, Shaqir Fetaj, i vetëquajhuri “reis” i BFI-së, mohon plotsisht se në Maqedoni ekziston kjo dukuri, ndërkohë që ka pasur arrestime dhe gjykime të personave radikalë që janë akuzuar për veprat e tyre terroriste në tentativë për të ngritur në ajër vende publike!

Në Maqedoninë e Veriut pjesa dërmuese e myslimanëve janë shqiptarë. Prej tyre, një numër i konsiderueshëm kanë marrur pjesë nëpër luftëra të huaja, në Siri e gjetiu! Sipas disa të dhënave thuhet se nga viti 2012 në zonat e konfliktit, janë larguar 143 shtetas të RMV-së, nga këta 69 janë kthyer ndërsa 38 janë vrarë. Janë pesë luftëtarë aktivë në zonat e konfliktit, ndërsa katër janë

të burgosur në Siri. Në korrik të vitit 2021, 23 persona (katër burra, pesë gra dhe 14 fëmijë) u riatdhesuan nga Siria dhe Iraku. Aktualisht janë 11 luftëtarë të huaj terroristë në burg, 6 janë liruar nga burgu në vitin 2020 dhe asnjë në 2021!

Po pse Shaqir Fetai mundohet që t'i fshehë këto fakte, madje edhe publikisht të deklarojë të kundërtën e raporteve që përgatiten nga qendrat ndërkombëtare me relevancë të pamohueshme?

Pa dyshim që, ardhja e Shaqir Fetait në krye të BFI-së është realizuar ekskluzivisht përmes frymës ekstremiste dhe radikale, duke shkelur të gjitha aktet normative të Institucionit të vetëm islam në Maqedoninë e Veriut. Ç'është e vërteta, ky Institucion është i pari në rajon dhe më gjërë që doli me një Projekt të qartë dhe të përkrahur nga shumë faktorë ndërkombëtarë që kishte të bëjë me parandalimin e këtyre dukurive, me zhvillimin e fushatave sensibilizuese kundër pëfshirjes së myslimanëve të vendit në luftëra që nuk janë as interes fetar dhe as interes kombëtar si dhe të ngriten mekanizma dhe kapacitete që do të merren me risocializimin e të gjithë atyreve që do të kthehen nga këto vatra! Për këtë Projekt të vitit 2015 u fol me pietet madje edhe në Këshill të Evropës! Projekti u stopua, madje nga Shaqir Fetai as që zihet në gojë, pikërisht për faktin se dy projektuesit e tij u dëbuan nga puna falë hipokrizisë dhe strategjive neveritëse të Shaqir Fetait. Në intervistën e fundit të Shaqir Fetait në një televizion nacional, ai pra, e mohoi kategorikisht se në vendin tonë ka ekstremizëm dhe radikalizëm fetar! E mohoi sepse është kjo periudha kur Shaqir Fetai, për ta shpëtuar pozitën e vet të kapur me tradhëti dhe komplot, do të nisë t'i legjitimojë dhe institucionalizojë turlifare strukturash që në esencë dhe në veprim janë ekstremiste dhe shumë radikaliste duke mohuar organizimin institucional të jetës fetare, bazuar në aktet normative të Institucionit! Shaqir Fetai, duke e ndjerë veten të rrezikuar, i legjitimon ata, bashkëpunon me të njëjtit, ndaj dhe, mundohet ta ruaj "filozofinë" e tyre, duke kundërshtuar në mënyrë kategorike se në mesin e shoqërisë sonë vlojnë strukturat ekstreme!

Raportet ndërkombëtare me të tilla vërejtje, më së paku u bëjnë

nder shqiptarëve myslimanë si dhe partive të tyre!
Mosangazhimi i të gjitha strukturave kombëtare dhe fetare në dedektimin dhe eliminimin e këtyre dukurive, përpjekja nonshalante për t'i legjitimuar dhe institucionalizuar, si nga ana e Shaqir Fetait, por edhe nga “myftiu” i Shkupit, Qenan Ismaili, është një sjellje që do ta dëmtojë rëndë çështjen shqiptare në vend dhe në rajon! Sepse, interesat e grupeve ekstremiste, interesat meskine të Shaqir Fetahave dhe të Qenan Ismailave, nuk puçen në asnjë element me interesat dhe strategjinë kombëtare të shqiptarëve por edhe të myslimanëve të rajonit.

Fakti që Shaqir Fetai, si “reis” fetar i një Institucioni me relevancë të pamohueshme, nuk është në një vijë me analizat dhe raportet e instancave më të larta evropiane, flet se ai dhe bashkëpunëtorët e tij aktualë janë me dy këmbë në atë “kazan” për të cilin flet edhe Raporti i fundit i Progresit të BE-së për RMV-në.

Shaqir Fetai, duke qenë i handikapuar nga mënyra se si u katapultua në krye të BFI-së, duke qenë tërësisht i angazhuar në pritje dhe përcjellje të qytetarëve të rëndomtë “përkrahës” të tij, ai nuk e di se Maqedonia e Veriut ka një Strategji kombëtare për luftën kundër terrorizmit (2018-2022) dhe një Strategji për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm (2018-2022)! Po çka i duhen Maqedonisë së Veriut këto dy dokumente strategjike nëse është e vërtetë ajo që e thotë Shaqir Fetai se në vend nuk ka as ekstremizëm të dhunshëm dhe as radikalizëm! A e ka lexuar ndonjëherë Projektin STOP RadTerr i përgatitur qysh më vitin 2015 dhe që është absolutisht në një linjë me Planin Kombëtar për ri-integrimin, risocializimin dhe rehabilitimin e luftëtarëve të huaj të kthyer dhe anëtarëve të familjeve të tyre (gra dhe fëmijë), të miratuar në qershor të vitit 2020? Me gjasë, Shaqir Fetai e ka habitatin e vet ku jeton, ku e ndjenë veten se po rritet dhe se, për asgjë tjetër nuk i intereson!

Asnjë faktor relevant ndërkombëtar nuk flet për ndonjë punë konkrete të BFI-së as për angazhimin dhe përfshirjen e saj në luftimin dhe zhdukjen e këtyre dukurive. Nga ana tjetër, Raporti flet për angazhimet e institucioneve shtetërore: “Është bërë njëfarë

përparimi në luftën kundër terrorizmit dhe parandalimin/goditjen e ekstremizmit të dhunshëm në përputhje me objektivat e përcaktuara në Planin e Përbashkët të Veprimit kundër terrorizmit për Ballkanin Perëndimor dhe marrëveshjen dypalëshe zbatuese. Një plan kombëtar për riintegrimin, risocializimin dhe rehabilitimin e luftëtarëve të huaj të kthyer dhe anëtarëve të familjeve të tyre u miratua në qershor 2020, me qëllim zbatimin e prioriteteve të identifikuara për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit”, thuhet mes tjerash në Raportin e Progresit për Maqedoninë e Veriut.

Shaqir Fetai, në dëm të çështjes kombëtare, me vetëdije të plotë po e shndërron BFI-në në strumbullar të elementëve ekstremistë që e dëmtojnë shumë rëndë si çështjen kombëtare po ashtu edhe çështjen fetare islame në vend e më gjërë!

A mundet një njeri normal të dalë e të thotë se në Maqedoninë e Veriut nuk ka radikalizëm dhe ekstremizëm, ndërkohë që vendi, në përputhje me rekomandimet evropiane, ka ndërmarrur një sërë veprimesh!

A e di Shaqir Fetai se Qeveria e RMV-së, në seancën e mbajtur më 30 korrik 2021, ka sjellë Vendim për emërimin e Koordinatorit të ri nacional për luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe zëvendës koordinator të ri nacional për luftimin e terrorizmit. Funksionet e tyre kanë nisur më 1 gusht 2021. Po pse, kur Shaqir Fetai e mohon se ka elemente të tillë për të cilat brengoset dhe angazhohet Qeveria?

Shaqir Fetai nuk e di, sepse është tërësisht në aut, se, janë formuar katër ekipe aksionale në njësitë lokale: Shkup-Çair, Gostivar, Kërçovë dhe Kumanovë (vendbanime shqiptare-myslimane) të cilët realizuan aktivitet vijuese:

- Janë mbajtur debate lokale për të rinjtë
- Janë përgatitur punime për analizën e politikave të vendit për ndërtimin e lidhjeve ndërmjet pushtetit qendror dhe lokal dhe liderëve fetarë
- Është mbajtur trajnim për ngritjen e kapaciteteve për pushtetet lokale, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e shërbimeve të sigurisë

- Janë mbajtur dialogje për ndërtimin e besimit ndërmjet pushteteve lokale, shërbimeve për siguri të Qeverisë dhe udhëheqësve fetarë dhe komuniteteve fetare
- Është zhvilluar modul trajnimi për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm për ngritjen e kapaciteteve të organizatave lokale të shoqërisë civile dhe shoqatave rinore dhe sportive
- Janë mbajtur trajnime për ngritjen e kapaciteteve lokale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm për shoqatat rinore dhe sportive të organizatave të shoqërisë civile
- Është krijuar platformë e mbyllur online që u mundëson përdoruesve të dërgojnë, lexojnë dhe shpërndajnë dokumente përkatëse, punime kërkimore, ngjarje dhe të ngjashme.

Gjithë ky aktivitet, gjitha këto strategji e plane veprimi, madje, në Raportin e Progresit i sugjerohet RMV-së që për vitin 2022 të ndër marrë edhe një sërë veprimesh ligjore e humane, kurse Shaqir Fetai thotë se në RMV “nuk ka as ekstremizëm dhe as radikalizëm”! Nuk ka sepse i ka legjitimuar duke i bërë pjesë të “institucionit” që e ka uzurpuar dhe që ka konstatuar se “BFI-ja qonka Institucion shumë i modh”, por, asesi të ndërgjegjësohet dhe të kuptojë se nuk ka kurrfarë kaçiku për ta drejtuar këtë Institucion! Megalomania dhe hipokrizia e tij tashmë ka nisur të bëhet edhe problem kombëtar, por edhe ndërkombëtar!/in7/22.05.2022

Shaqir Fetai Ramazanin e sheh si para

Shaqir Fetai, ky farë halldupi që kohëve të fundit ka nisur të na lë edhe “emanete”, paska publikuar një “informatë” në fb-un e vet si dhe në faqen publike të bashkësisë “fetare” të tij që e ka shndërruar në paçavurë të thjeshtë!

Sipas kësaj “informatë” Shaqir Fetai mundohet të na e transponojë “kënaqësinë shpirtërore” të tij meqë ia paska dalur që nga ky Ramazan të nxjerrë aq shumë para prej myslimanëve të vendit sa, gati paska rënë në trans! Se ku e mori këtë informacion, se kush i raportoi dhe ku e raportoi, këtë e di vetëm Shaqir Fetai! Ia paska thënë “drejtori” i financave! Ku e tha? Në mbledhjen e “rijasetit”, apo këtë ia kumtoi në telefon!

Mbi të gjitha, përmes këtij interesi meskin të Shaqir Fetait, në pah del afiniteti i tij për ta përceptuar Muajin e Mëshirës si para që do ta shpëtojë atë edhe nja një apo dy muaj!

Pa dyshim, mund të jetë edhe i saktë ky kontribut i myslimanëve të vendit për këtë Muaj, sepse, kjo është traditë e pathyeshme e myslimanëve tanë të devotshëm. Po a foli diçka Shaqir Fetai për politikën e tij përçarëse, devijante, dezorientuese, të rrezikshme kombëtarisht e fetarisht, të ndërmarrra prej tij pikërisht gjatë Muajit të Raazanit!

A foli ai se cili ishte kontributi cilësor i bashkësisë “fetare” të tij në ngritjen shpirtërore të myslimanëve të vendit që spikat pikërisht gjatë këtij Muaji të Rahmetit! Cili ishte programi i bashkësisë “fetare” të tij për ta shënuar sa më denjësisht këtë Muaj? Zero aktivitet! Prandaj, Shaqir Fetai falënderon të gjithë honxho-bonxhot e tij që ia dolën që të sigurojnë sa më shumë mjete financiare për mirëmbajtjen e institucioneve arsimore fetare! Pra, i

vetmi falënderim do të ishte ky, sepse, falënderim tjetër nuk pati, sepse nuk i kishte angazhuar me asnjë aktivitet konkret, përtej detyrimeve ditore për falje të namazeve.

Shaqir Fetai rrenë sa është i trashë se e paska kaluar me fitër e zeqat vitin 2021! Fundja, ai vit nuk është kurrfarë matësi cilësor, sepse ishte vit i shumë restriksioneve dhe krizave! Pse Shaqir Fetai nuk e bën një krahasim të këtij kontributi me vitet para se ai të vendosë të zhytet në komplete e në tradhëti? Tradhëtarit sikur edhe të gjitha bankat popullore t'i falen, ai ngelë tradhëtarë, pa respektin e popullit, pa dashurinë e sinqertë të bashkëpunëtorëve. Të gjithë kanë vetëm një interes: si ta zhvasin e ta grabisin pasurinë; edhe pse vlerësohen si tradhëtarë, të paktën, të kualifikohen “tradhëtarë të pasur”! Ky është synimi i vetëm i Shaqir Fetait.

Shaqir Fetai nuk mund të flasë për një Ramazan të begatë me aktivitete kulturo-artistike-fetare e humanitare. Ai mund t'i kënaqet vetëm parave që kanë hyrë në “bashkësinë” e tij, qoftë si fitër, qoftë si zeqat! Me këtë ai dëshiron të na tregojë se ja, populli po e do dhe po e paguan, ndërsa në këtë disiplinë fetare ai nuk e sheh devotshmërinë e popullit tonë! Turp e për faqe tëzezë! /Opinione/24.05.2022

Çka e ka gjetur Shaqir Fetain?

Në fb-un e vet “turli-tavë”, Shaqir Fetai paska nisur të na lë edhe “amanete”! Amanete lë vetëm ai që e ndjenë apo që niset për nga fundi i vet! I gjori për nga shpirti dhe i madhi për nga hipokriza, duke e menduar veten si “alim” nis e ndanë këshilla! Myslimanët e vendit e dinë cili dhëmb i dhemb dhe ku po i shkon gjuha, por, myslimanët e vendit dinë edhe më tepër se sa ka kapacitet Shaqir Fetai për t’i besuar gjenialitetit të popullit! Populli nuk e ka hall Shaqir Fetain, populli e ka hall BFI-në, prandaj, respekti dhe detyrimet që populli i ka ndaj Institucionit nuk mund të konceptohen si “nënshtrim” i popullit para këmbëve të pista të Shaqir Fetait.

Shaqir Fetai u mbyt në përjekjet e tij, si ai bishti i këputur i xhapinit, për ta bindur popullin që mos t’i besojnë shpifësve dhe gojakëqinjëve që po flasin kundër tij, kurse, kurrë nuk pati guximin që të dalë në debat publik për t’i bllofuar faktet dhe argumentat të cilët Shaqir Fetain e nxjerrin si komplotist, si tradhëtarë, si bukëshkelës, si manipulatorë, si thyes i të gjitha normave të miqësisë së ndershme! Shaqir Fetai është me zero vlera dhe nuk ka të drejtë që ta ofendoj popullin me “këshilla” e “amanete” perverse!

Këshillat Shaqir Fetai po i jepka nga përvoja e tij dhe nga fryma edukuese kuranore! Ai sa herë që i duhet ta kamuflojë shpirtin e tij katran, si dhe pasionin e tij për tradhëti e komplot, thirret në frymën kuranore sipas të cilës qenka edukuar! Po cila frymë kuranore thotë se mund të bëhesh komplotist, tradhëtar e

bukëshkelës? Shaqir Fetai asnjëherë nuk ka përtuar që të tallet me Kuranin e Madhërishëm, madje që kur ka hyrë në “bylyk ai ka pasur krejtësisht misionë të tjera, pa dyshim, që të gjitha jashtë frymës kuranore! I di ai, por, shumë mirë i di edhe populli! Veprimet, përcaktimet dhe praktikimet në jetën e tij e demantojnë Shaqir Fetain në përpjekjet e veta për ta bindur popullin se qenka edukuar në frymën kuranore. Mbase po por, kurrë nuk mund ta mohojë faktin se është tallur shumë keq me këtë frymë kuranore! Hipokrizia, injoranca, spiunimi, tradhëtia, komploti, shkelja e besimit që e gëzon nga tjetri – këto nuk janë frymë kuranore, por, janë shkathhtësi që mësohen nëpër kanalizime antikombëtare e antifetare!

Një këshillë kuranore për këtë tallës: “Juve ju ka zbritur në librin (Kuranin), që kur të dëgjoni se po mohohet Kurani i Allahut dhe po bëhet tallje me të, mos rrini me ata derisa të mos hyjnë në bisedë tjetër, përndryshe ju do të jeni si ata. Allahu do t’i tubojë hipokritët dhe jobesimtarët, që të gjithë në xhehenem”. (En-Nsa, 140)/Debat/24.05.2022

A ta themi të vërtetën

Nuk do të më mbyllen sytë pa e përfunduar librin tim që do të zbardhë me fakte e me argumenta, me dokumenta e me rrëfime autentike, tërë atë që ndodhi në BFI, dhe kush janë këta “ish-bashkëpunëtorë” që sot mburren se më largun në “emër të Allahut” dhe se sot po punuakan “për Allah”! Është e pakontestueshme se vetëm Allahu e di të vërtetën! Unë do ta them

Nga H. Sulejman ef. Rexhepi

Si tash dy vjet më parë, bashkëpunëtorët e mi, të cilët i kisha përkrahur në karrierë, ua kisha dhënë të gjitha mundësitë që të bëjnë emër, tradhëtisht “më eliminuan”, më bënë puç klasik! Më shkarkuan për shkak se, sipas tyre, kisha shkelur Nenin 59 të Kushtetutës së BFI-së!

Kurrë, në asnjë mbledhje Rijaseti që ishin aq të shpeshta, në asnjë takim, në asnjë tubim nëpër myftini për raporte financiare e për miratim të planeve organizative në ngritje dhe avancim të jetës fetare, pra, në asnjë moment nuk ma tërhoqën vërejtjen, qoftë edhe miqësisht, për çfarëdo shkelje që mund të kisha bërë! Kurrë nuk e ngriti zërin asnjëri, kurrë asnjëri nuk inicoi ndonjë komision disiplinor e t’m’i thonin të gjitha problemet antikushtetuese që mund t’i kem shkaktuar! Dhe, në një ditë të bukur, bashkëpunëtorët e mi që paskan “hetuar” se unë paskam shkelur Nenin 59 të Kushtetutës së BFI-së, në mënyrë krejt

antikushtetutare, duke i shkelur të gjitha nenet e kësaj Kushtetute, pa dijeninë time ishin mbledhur dhe, thanë: shkarkohesh!

Kush i tuboi, cili qe ai udhër që i tuboi brenda natës, kjo edhe më tej ngelë “enigmë” (por jo edhe për mua!!!). Kush ishte ajo “hije” që pati fuqinë e tubimit më të madhe se të Resil Ulemasë, se të Rijasetit? Kush ishte ajo “hije” që pati nevojë për t’i mbledhur bashkëpunëtorët e mi dhe për ta dekonstruktuar tërë atë projekt që e kishim bërë më se tri dekada me radhë! Detronizimi deri në atë përmasë i BFI-së nuk ka pasur kurrfarë qëllimi përveçse të mohohet një histori e tërë suksesi, të minohet një bagazh i paprekshëm kombëtar e fetar që ishte bërë shtyllë e palakueshme e Bashkësisë Fetare Islame bashkëkohore, e cila, jo vetëm që ishte vëzhguese e proceseve të reja historike dhe shoqërore por, ia doli me sukses që të jetë dhe të respektohet gjithmonë në krye të këtyre proceseve. Kujt i pengoi ky sukses i jashtëzakonshëm i BFI-së? Kush u tremb nga ai trung i çeliktë i unitetit kombëtar e fetar që e kishte ngritur me aq mund ndër vite BFI-ja!

Çuditërisht, jo më shumë se një javë përpara komlotit dhe tradhëtisë, në një përpjekje gazetareske për një dokumentar mbi këto të arritura dhe mbi mua si prijës në këto suksese të pakontestueshme, funksionarët e organeve më me relevancë në BFI kishin folur në superlativ për mua! Një javë më vonë, brenda natës, dikush i tubon dhe këta konstatojnë se unë paskam shkelur Nenin 59 të Kushtetutës së BFI-së!

Kurrë nuk u zbërthye kjo shkelje, kurrë nuk u argumentua, ndërsa gjesti tradhëtues si dhe synimet e “bashkëpunëtorëve” të mi tashmë i dinë të gjithë, i madh e i vogël, në vend e më gjërë!

Ja ku jemi sot: një Bashkësi Islame tërësisht e dezorganizuar, një shoqëri myslimane tërësisht e demotivuar, e dezorientuar dhe e përçarë si mos më keq!

Sot, çuditërisht, bashkëpunëtorët e mi të deridjeshëm, nuk më flasin, nuk më bëjnë asnjë telefonatë, nuk më urojnë asnjë festë fetare, (ndërsa këtu e një kohë më parë luanin “çoçek“ para meje, tërthorazi më kërkojnë falje dhe më informojnë se e kanë të ndaluar rreptësisht nga Shaqir Fetai që të komunikojnë me mua! Bashkëpunëtorët e mi të deridjeshëm sot janë shndërruar në “besnikë të sinqertë” nën frenat e Shaqir Fetait! Ish-formacioni im, prej myftinjësh, dekan, drejtor e kordinatorë, të cilëve ua dhashë të gjitha mundësitë dhe përkrahjen për karrierë, për të cilët kërkoja

dhe këmbëngulja në respekt të gjërë prej myslimanëve të vendit, sot në krah të atij pë të cilin më ishin lodhur nofullat duke e lavdëruar në opinion, më ishin topitur fuqitë duke e përkrahur dhe duke e ruajtur nga “lojërat e pandershme” që luheshin kundër tij, sot fshihen dhe ruhen prej meje! Thua të jetë problem vetëm Shaqir Fetai, apo, problem është fakti që, unë e di se kush janë, që nga portiri e deri te Shaqiri!

Të gjithë me mua kanë histori të ndryshme, të gjithë e dinë se unë jam arkivi i gjallë i çdo njerit prej tyre, të gjithë e dinë se çka kemi realizuar, çka kemi bërë, çka kemi nënshkruar, së këndejmi, të gjithë e dinë se unë për secilin prej tyre kam nga një thes dokumentash! Unë nuk jam person që heshti para padrejtësisë! Nuk jam person që i nënshtrohem tradhëtisë dhe as që i duartrokas asaj! Nuk jam person që mund ta durojë që tjetri të ma hajë bukën e të ma përplasë kupën! Nuk jam mirënjohës ndaj të pandershmëve dhe as i shantazhueshëm, qoftë edhe nga veprat e mia “të pandershme”! Fundi im u pa, por cili do të jetë fundi i ish-bashkëpunëtorëve të mi, kjo do të shihet pas dorëshkrimit tim që jam duke e përpunuar! Unë i pandershëm e ish-bashkëpunëtorët e mi të ndershëm?! Do të flas për ndershmërinë e tyre!

Shaqir Fetai e di se ç’fakte posedoj unë për ta diskredituar deri në varrosje për së gjalli!

Qenan Ismaili e di fort mirë se cili ishte muhabeti ynë dhe besatimi para se ta emërtoj myfti të Shkupit duke i shkelur të gjitha normat juridike të BFI-së!

Dhe të tjerët janë shumë të vetëdishëm se çka posedoj unë për ta dhe si mund të ngelin “golltarë” nëse nisi dhe flas unë!

Të gjithë e dinë se janë të turpëruar para meje, ndaj dhe i ikin komunikimit dhe jo se pengesë qenka Shaqir Fetai, sepse, realisht e di që të gjithë ata, nuk e llogarisin për pesë para këtë farë “reisi” të instaluar nga nëntoka e politikave maqedonase.

BFI-ja, shoqëria shqiptare, myslimanët e vedit, nuk kanë perspektivë me një “garniturë” të këtillë me në krye rrobaqepsin Shaqir Fetai! BFI-ja ka ngelur pa personalitet, ka ngelur pa dinjitet dhe pa rolin kryesor në procese të vendit!

E unë, aktualisht, kam ngelur nën inercionin e moshësh, me një dhembje të trishtë në shpirt për tërë atë që po i ndodhë BFI-së, me një shqetësim njerëzor për hullijtë e arave të huaja ku është futur ky Institucion, i cili dikur ishte “ëndërr” e hijenave ndërsa sot është shndërruar në kërm të hijenave! Dhe, nuk do të më mbyllen

sytë pa e përfunduar librin tim që do të zbardhë me fakte e me argumenta, me dokumenta e me rrëfime autentike, tërë atë që ndodhi në BFI, dhe kush janë këta “ish-bashkëpunëtorë” që sot mburren se më largun në “emër të Allahut” dhe se sot po punuakan “për Allah”! Është e pakontestueshme se vetëm Allahu e di të vërtetën! Unë do ta them!/BotaSot/27.05.2022

Përcjellja e gjeneratave dhe defilimi i hajnave

Kah fundi i vitit të kaluar medresantët e paraleleve të dispersuara të Medresesë Isa Beu, u ngritën në protestë kundër një vendimi qeveritar që ua ndalon këtyre nxënësve shkollimin e më tej, madje, e kanë të ndaluar të shkollohen edhe në Fakultetin e Shkencave Islame! Medresja Isa Beu është Shkollë e Mesme profesionale, që prodhon kuadro vetëm për nevoja të BFI-së! Së këndejmi, medresantët mbase edhe mund të punësohen nëpër xhami, por, çfarë do të bëhet me medresantet që janë të shumta nëpër paralelet e vajzave

Nga Mirjeta Shaqiri

Këto ditë Shaqir Fetai, pa pikë turpi, prezanton në përfundimin e shkollimit të maturantëve të kësaj Medrese. Ai shkruan: “Përcollëm gjeneratën e XV të paraleleve të vajzave pranë Medresesë Isa Beu, Tetovë”, “Përcollëm medresantet e Gostivarit”, “Përcollëm gjeneratën e XIII të paraleles së medresanteve në Shkup”! Me sa nonshalancë thotë: “Përcollëm”! Për ku i përcolle o avdall? Madje paska përjetuar “ambient imponant”! Ku di Shaqir Fetai se çka është e si duket “ambienti imponant”! Nëse e di, aq shumë paska nevojë që këtë ambient t’ia krijojë medresantet tona! Po vetë Shaqir Fetai çfarë “ambient imponant” u krijoi për të ardhmen e këtyre vajzave për periudhën post-medrese! I ftoi të shkollohen, ua mori paratë (se ato u shkolluan me paratë e veta), ua vjeli taksat myslimanëve në emër të medresesë dhe, në fund, i përcolli për në zero perspektivë! Tamam si dhelpira pasardhësit e vet!

Përcjellja si sharje dhe mallkim

Shaqir Fetai, si një cinik i patejkalueshëm, përkujdeset, i merr të gjitha masat që, medresantet e paralaleve të vajzave, por edhe medresantët, katër vite të mësojnë dhe ta presin momentin kur “kryetari” i BFI-së do t’ju organizojë eventin e përcjelljes! Ky është angazhimi jetik i manjakut Shaqir Fetai! I përcolla! Për ku? Për brenda katër mureve! Sepse, e humbi edhe atë fuqinë e cila nuk pyeste për ligje e për vendime qeveritare, por i biente grusht tavolinës që të regjistrohesh të gjithë medresantët atje ku dëshirojnë! Shaqir Fetai thotë publikisht se nuk është nga ata që mund të grisë zërin e të revoltohet, por, do të mbledhë bashkëpunëtorët e tij që të analizojnë se ku është problemi që këta medresantë, sidomos vajzat, ligjërisht nuk mund të shkollohen tutje! Dhe, Shaqir Fetai – i përcjell?

I uron që kanë mbaruar shkollim të mesëm, që jan formuar e që do të bëhen nëna të mira e shembullorë! Po nënat tona, gratë e motrat që nuk ia dolën të kryejnë asnjë shkollë, asnjë klasë, pra, as medresenë e Shaqir Fetait, këto a nuk janë nëna, motra, gra të mira, shembullorë, a nuk ditën të hapërojnë drejt kalitjes së një shoqërie shqiptare të ndershme, të moralshme e të pathyeshme para çfarëdo sfide jetësore! Ky farë avdalli sikur e ka mision që të na i ofendojë e shajë nënat që nuk ia dolën t’i krijojnë “ambient impozant”! Ai i hedh fjalët si bualli bajgat!

Çfarë sihariqi ju kumtoi Shaqir Fetai medresanteve? A ua tregoi fakultetet të cilat janë të gatshme t’i regjistrojnë medresantet të cilat, me gjasë investuan kohë e mund, para e gjithçka, vetëm që ta “përfundojnë” shkollimin në gjysëm të rrugës, sepse, “kryetarin” e tyre e kanë analfabet, të kapur, të shantazhuar, përkrahës të kriminit e të kushtëzuar dhe, së këndejmi, të pafuqishëm që t’ua hapë dyert e shkollimit qoftë edhe në Fakultetin “e vet”!

“Hej, po ja se, draft-propozimi ynë është në duar të deputetëve tanë dhe kam shpresë se shumë shpejt do ta zgjidhin problemin e akreditimit të Medresesë”, u tha Shaqir Fetai ca medresanteve që me etjen e pashueshme për dituri e pyetën atë! Po pse meritat apo fajin ua lë deputetëve tanë? Do me thënë që, participantët

shqiptarë në pushtet na tradhëtuan edhe kësaj radhe! Qëllimisht po e dëmtojnë Medresenë! Janë pa fe dhe të paaftë për t'i realizuar interesat e popullit, do të shfryhet Shaqir Fetai!

Të gjithë faktorë, të gjithë të paaftë, të gjithë tradhëtarë, vetëm Shaqir Fetai “melaqe”?!
“I përcollëm”, thotë Shaqir Fetai? Për ku, o avdall!

“Ambient putinian” i Shaqir Fetait

Dhe, duke i përcjellë medresantet, sakaq Shaqir Fetai për herë të parë në jetë të vet viziton Bezistenin dhe Kapan Hanin! Lajm senzacional! Paramendoni, Shaqir Fetai nënvizon se këto dy prona të mëdha të vakëfit qenkan denacionalizuar në vitin 2021, me demek, një vit pasi u instalua Shaqir Fetai në krye të BFI-së nga segmentet e caktuara të pushtetit maqedonas!

Shqir Fetai duhet të lavdërohet me diçka në këto momente kur punët i ka berbat! Askush, madje as armiku më i keq, mos qoftë aktualisht nën lëkurën e tij! Shaqir Fetai po ndjenë se po fundoset! Po fundoset ligjërisht, moralisht, shoqërisht, miqësisht, në drejtësi – në çdo aspekt! Ka nevojë për një fije kashte ku të kapet! Procesi i denacionalizimit të vakëfit ka një historik të veten, ka një arkiv i cili, nëse shfrytëzohet për tezë doktrature që do ta trajtonte ecurinë, procesin, proceset gjyqësore, ndër-këmbëzat që të tjerët i përjetuan përgjatë këtij denacionalizimi, do të përfundonte vetëm me një fakt – u ezauruan të gjitha perpjekjet dhe metodat qeveritare për ta penguar denacionalizimin dhe, në fund, më vitin 2021 u dorëzuan, në këto kohë kur në mënyrë të planifikuar e kishin instaluar Shaqir Fetain në krye të BFI-së!

Shaqir Fetai, qe dy vite instalim i kotë, nuk ia doli që asgjë të nisë e të përfundojë vetë, të ketë një sukses për t'u mburrur karshi myslimanëve! Po, për këto dy vite ai është “lulëzuar” me aq shumë skandale, dështime, rrena, deklarata gjyqësore të rrezikshme, zhvatje, vjedhje, dezorientim të xhematit, degradim të organeve e shkatërrim të BFI-së! Përballë këtyre dukurive shumë të rënda, nuk do të bëjnë para sikur edhe krejt Shkupin t'ia falin Shaqir

Fetait! Kurrë myslimanët e Maqedonisë nuk janë trajtuar si të “putinizuar”, këtë epitet e morën falë Shaqir Fetait, alias ORAO-S!

Shaqir Fetai nuk e prek “arushën” aty ku nuk duhet

Shaqir Fetai, ky farë “patrioti me bateria ruso-kineze”, bashkë me “mishin e egër” të BFI-së, të ahtuquajturin Myfti i Shkupit, Qenan Ismailin, paskan vizituar Institutin për trashëgimi kulturore, të cilit ia lanë në dorë censurimin dhe revidimin e SHQIPTARËVE TË MAQEDONISË! Tjetër motiv nuk kanë pasur përveçse të marrin informacion nga dora e parë se deri ku ka arritur ky proces i turpshëm kombëtar! SHQIPTARËT E MAQEDONISË ishte një simpozium i papërsëritshëm dhe i paparë edhe sot e kësaj dite, i cili e angazhoi autoritetin e BFI-së për ta botuar librin që do t’i ngërthente në vete të gjitha kumtesat shkencore të prezanuara përgjatë simpoziumit. Tani, ky kontribut kombëtar e shkencor nuk i pëlqeu UDB-së as atëherë kur u organizua dhe nuk i pëlqen as sot e kësaj dite. Ndaj, duhet të revidohet e të censurohet! Ne jse, le të ngelë ky problem i historinëve, ndërsa problem i Institutit shqiptar duhet të jetë motivi i largimit të Institutit nga Kurshumli Hani, aty ku e kishte adresën që në themelim të tij! Kapan Hani ishte marrur vite më parë, aty u vendos shumë vite më parë paralelja e Medresesë për vajza, Shkup, aty ishte ngritur “falmuri i BFI-së”, madje edhe me kërcënime deri në shkatërrim të shtetit të Maqedonisë! Pse Shaqir Fetai me “doktorin e peshkut dhe të ushqimit të lehtë”, nuk këmbëngulin për ta rikthyer edhe Kurshumli Hanin dhe t’ia kthejnë Institutit për Trashëgimi Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve të RMV-së? Kurshumli Hani në kohën kur aty ishte i vendosur Instituti, lulëzoi në një qendër të mirëfilltë kulturore shqiptare, fakt këtë që Shaqir Fetai nuk e di, sepse nuk i interesoi! Aty, brenda oborrit të Kurshumli Hanit jepeshin shfaqje, organizoheshin evente popullore, “sofra e muzikës kombëtare”, recitale, po planifikoheshin festivale të filmit dokumentar, të filmave të shkurtër, ekspozita pikturash e fotografishë artistike, thjesht, përmes Kurshumli Hanit kishte filluar të rrezatonte “shqiptaria” nëpër Çarshi të Vjetër!

Çfarë po bën Shaqir Fetai me halldupët e vet për ta rikthyer këtë vatër të kulturës shqiptare! Pse nuk e fillon një proces, madje sikur ky proces të zgjaste 30 vite! Nuk do të kishte njeri në Maqedoninë e Veriut që në fund, meritat dhe suksesin nuk do t'ia nënshkruante Shaqir Fetait. Vetëm le ta nisë këtë proces! A po dëshiron të tregohet i suksesshëm në kthim të vakëfit! Le të nisë me Kurshumli Hanin, pastaj janë edhe disa hane të tjera, le të nisë! Shaqir Fetai nuk e prek “arushën” aty ku nuk duhet! Është i kujdeshëm. Nuk e ka karaktersitikë trimërinë, ndërsa vjedhjen e meritave po, siç karakterizohet edhe nga virtytet e tjera të cilat e shëmtojnë njeriun deri në bishë! / 1KlikLarg/27.05.2022